

**CFRR»**


Centre for Financial and  
Sustainability Reporting Reform



EAASURE



# Standardet Evropiane të Raportimit të Qëndrueshmërisë (ESRS)



## **European Sustainability Reporting Standards (ESRS)**

This text is for informational purposes only and has no legal effect. The institutions of the European Union are not responsible for its content. The authentic versions of the relevant acts, including their preambles, are those published in the Official Journal of the European Union and available on EUR-Lex.

The official text of ESRS is available via the following link: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A02023R2772-20231222>

The translation was performed by the World Bank's Center for Financial and Sustainability Reporting Reform (CFRR), based in Vienna, Austria, under its regional program Enhancing Accounting, Auditing, and Sustainability Reporting Program (EAASURE). EAASURE is co-funded by the Austrian Ministry of Finance, the Swiss State Secretariat for Economic Affairs (SECO), and the Austrian Development Agency (ADA).

## **Standardet Evropiane të Raportimit të Qëndrueshmërisë (ESRS)**

Ky tekst është vetëm për qëllim informimi dhe nuk ka asnjë efekt juridik. Institucionet e Bashkimit Evropian nuk janë përgjegjës për përmbajtjen e tij. Versionet autentike të akteve përkatëse, përfshirë preambulat e tyre, janë ato të botuara në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian dhe të disponueshëm në EUR-Lex. Teksti zyrtar i ESRS-ve është i disponueshëm përmes faqes së mëposhtme:

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A02023R2772-20231222>

Përkthimi u mundësua nga Qendra e Bankës Botërore për Reformën e Raportimit Financiar dhe të Qëndrueshmërisë (CFRR), me qendër në Vjenë, Austri, në kuadrin e programit të saj rajonal për Përmirësimin e Kontabilitetit, Auditimit dhe Raportimit të Qëndrueshmërisë (EAASURE). EAASURE është bashkëfinancuar nga Ministria e Financave Austriake, Sekretariati Shtetëror Zvicëran për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe Agjencia Austriake e Zhvillimit (ADA).

# PËRMBAJTJA

<b>Neni 1. Lënda .....</b>	<b>6</b>
<b>Neni 2. Hyrja në fuqi dhe zbatimi .....</b>	<b>6</b>
<b>Shtojca I. Standardet evropiane të raportimit të qëndrueshmërisë (ESRS) .....</b>	<b>6</b>
<b>ESRS 1. KËRKESAT E PËRGJITHSHME .....</b>	<b>7</b>
Përmbajtja .....	7
Objektivi .....	9
1. Kategoritë e Standardeve ESRS, fushat e raportimit dhe hartimi i marrëveshjeve.	10
2. Karakteristikat cilësore të informacionit.....	13
3. Materialiteti i dyfishtë si bazë e dhënies së informacioneve shpjeguese mbi qëndrueshmërinë .....	13
4. Kujdesi i duhur.....	21
5. Zinxhiri i vlerës .....	23
6. Horizonti kohor .....	25
7. Përgatitja dhe paraqitja e informacionit për qëndrueshmërinë .....	26
8. Struktura e deklaratës së qëndrueshmërisë .....	31
9. Lidhja me pjesët e tjera të raportimit të shoqërisë dhe informacionit përkatës ....	33
10. Dispozita kalimtare.....	36
Shtojca A. Kërkesat për Zbatim .....	38
Shtojca B. Karakteristikat cilësore të informacionit.....	48
Shtojca C. Lista e vënies graduale në zbatim të Kërkesave për Dhënie informacionesh shpjeguese .....	52
Shtojca D. Struktura e deklaratës së qëndrueshmërisë sipas standardeve ESRS.....	58
Shtojca E. Flowchart për përcaktimin e dhënies së informacioneve shpjeguese sipas standardeve ESRS.....	58
Shtojca F. Shembull i strukturës së deklaratës të qëndrueshmërisë ESRS .....	60
Shtojca G. Shembull i përfshirjes me referencë.....	61
<b>ESRS 2. DHËNIE INFORMACIONE SHPJEGUESE TË PËRGJITHSHME .....</b>	<b>62</b>
Përmbajtja .....	62
Objektivi .....	64

1. Baza e përgatitjes .....	65
2. Qeverisja.....	69
3. Strategjia .....	74
4. Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë .....	79
5. Metrikat dhe objektivat .....	84
Shtojca A. Kërkesat për Zbatim .....	87
Shtojca B. Lista e pikave të të dhënave në standardet ndërsektoriale dhe specifike që rrjedhin nga legjislacioni tjetër i BE-së .....	94
Shtojca C. Dhënia e informacioneve shpjeguese dhe Kërkesat për zbatim në ESRS përkatëse që janë të zbatueshme së bashku me ESRS 2 Dhënie e Informacioneve të Përgjithshme .....	108
<b>ESRS E1. NDRYSHIMI KLIMATIK .....</b>	<b>109</b>
Përmbajtja.....	109
Objektivi .....	112
Ndërveprimi me Standardet e tjera ESRS .....	114
Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese .....	114
Shtojca A. Kërkesat për Zbatim .....	130
<b>ESRS E2. NDOTJA.....</b>	<b>167</b>
Përmbajtja.....	167
Objektivi .....	168
Ndërveprimi me standardet e tjera ESRS .....	169
Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese .....	170
Shtojca A. Kërkesat për Zbatim .....	176
<b>ESRS E3. BURIMET UJORE DHE DETARE.....</b>	<b>182</b>
Përmbajtja.....	182
Objektivi .....	183
Ndërveprimi me Standardet e tjera ESRS .....	185
Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese .....	186
Shtojca A. Kërkesat për Zbatim .....	191
<b>ESRS E4. BIODIVERSITETI DHE EKOSISTEMET .....</b>	<b>197</b>
Përmbajtja.....	197
Objektivi .....	199

Ndërveprimi me standardet e tjera ESRS .....	200
Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese .....	201
Shtojca A. Kërkesat për Zbatim .....	211
<b>ESRS E5. PËRDORIMI I BURIMEVE DHE EKONOMIA QARKULLUESE .....</b>	<b>225</b>
Përmbajtja .....	225
Objektivi .....	227
Ndërveprimi me standardet e tjera ESRS .....	228
Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese .....	229
Shtojca A. Kërkesat për Zbatim .....	236
<b>ESRS S1. FUQIA E VET PUNËTORE .....</b>	<b>242</b>
Përmbajtja .....	242
Objektivi .....	246
Ndërveprimi me Standardet e tjera ESRS .....	248
Kërkesat për Dhënie Informacione Shpjeguese.....	248
Shtojca A. Kërkesat për Zbatim .....	267
Shtojca A.1. Kërkesat për Zbatim për deklaratimet që lidhen me ESRS 2 .....	293
Shtojca A.2. Kërkesat për Zbatim për ESRS S1-1 Politikat që lidhen me fuqinë e vet punëtore .....	295
Shtojca A.3. Kërkesat e Zbatimit për ESRS S1-4 Ndërmarrja e veprimeve mbi ndikimet materiale në fuqinë e vet punëtore, qasjet për menaxhimin e rreziqeve materiale dhe ndjekjen e mundësive materiale në lidhje me fuqinë e vet punëtore, dhe efektiviteti i këtyre veprimeve .....	297
Shtojca A.4. Kërkesat për Zbatimin e ESRS S1–5: Objektivat që lidhen me menaxhimin e ndikimeve negative materiale, nxitjen e ndikimeve pozitive dhe menaxhimin e rreziqeve dhe mundësive materiale.....	299
<b>ESRS S2. PUNONJËSIT NË ZINXHIRIN E VLERËS .....</b>	<b>300</b>
Përmbajtja .....	300
Objektivi .....	302
Ndërveprimi me Standardet e tjera ESRS .....	303
Kërkesat për Dhënie Informacione Shpjeguese.....	304
Shtojca A. Kërkesat për Zbatim .....	313
<b>ESRS S3. KOMUNITETET E PREKURA .....</b>	<b>323</b>

Përmbajtja.....	323
Objektivi .....	325
Ndërveprimi me Standardet e tjera ESRS .....	326
Kërkesat për Dhënie Informacione Shpjeguese.....	326
Shtojca A. Kërkesat për Zbatim .....	335
<b>ESRS S4. KONSUMATORËT DHE PËRDORUESIT FUNDORË.....</b>	<b>346</b>
Përmbajtja.....	346
Objektivi .....	347
Ndërveprimi me Standardet e tjera ESRS .....	348
Kërkesat për Dhënie Informacione Shpjeguese.....	349
Shtojca A. Kërkesat për Zbatim .....	357
<b>ESRS G1. DREJTIMI I BIZNESIT.....</b>	<b>367</b>
Përmbajtja.....	367
Objektivi .....	368
Ndërveprimi me Standardet e tjera ESRS .....	368
Kërkesat për Dhënie Informacione Shpjeguese.....	369
Shtojca A. Kërkesat për Zbatim .....	375
<b>Shtojca II. Shkurtime dhe fjalori i termave .....</b>	<b>379</b>

► **B RREGULLORE E DELEGUAR E KOMISIONIT (BE) 2023/2772**

**Datë 31 korrik 2023**

**që plotëson Direktivën 2013/34/BE të Parlamentit Evropian dhe të  
Këshillit në lidhje e standardet e raportimit të qëndrueshmërisë**

**(Tekst me rëndësi për EEA-në (Zona Ekonomike Evropiane))<sup>1</sup>**

(OJ L 2772 22.12.2023, f. 1)

► **C1 Korrigjuar nga: Korrigjimi, OJ L 90241, 19.4.2024, f. 1 ((BE)  
2023/27722023/2772)<sup>2</sup>**

---

<sup>1</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/AUTO/?uri=celex:32023R2772>

<sup>2</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/AUTO/?uri=celex:32023R2772R%2802%29>



## **RREGULLORE E DELEGUAR E KOMISIONIT (BE)**

**2023/2772**

**Datë 31 korrik 2023**

### **që plotëson Direktivën 2013/34/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me standardet e raportimit të qëndrueshmërisë (Tekst me rëndësi për EEA-në)**

#### **NENI 1. LËNDA**

Standardet e raportimit të qëndrueshmërisë që njësitë ekonomike duhet të përdorin për kryerjen e raportimit të tyre të qëndrueshmërisë në përputhje me nenet 19a dhe 29a të Direktivës 2013/34/BE, sipas afateve kohore të përcaktuara në nenin 5(2) të Direktivës (BE) 2022/2464, janë përcaktuar në Shtojcat I dhe II të kësaj Rregulloreje.

#### **NENI 2. HYRJA NË FUQI DHE ZBATIMI**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e tretë pas botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Ajo do të zbatohet duke filluar nga data 1 janar 2024 për vitet financiare që fillojnë në datën 1 janar 2024 ose pas kësaj date.

Kjo Rregullore është detyruese në tërësinë e saj dhe zbatohet drejtpërdrejt në të gjitha Shtetet Anëtare.

#### **SHTOJCA I. STANDARDET EVROPIANE TË RAPORTIMIT TË QËNDRUESHMËRISË (ESRS)**

- ESRS 1 – Kërkesa të përgjithshme
- ESRS 2 – Dhënie Informacione Shpjeguese të Përgjithshme

- ESRS E1 – Ndryshimi klimatik
- ESRS E2 – Ndotja
- ESRS E3 – Burimet ujore dhe detare
- ESRS E4 – Biodiversiteti dhe ekosistemet
- ESRS E5 – Përdorimi i burimeve dhe ekonomia qarkulluese
- ESRS S1 – Fuqia e vet punëtore
- ESRS S2 – Punëtorët në zinxhirin e vlerës
- ESRS S3 – Komunitetet e prekura
- ESRS S4 – Konsumatorët dhe përdoruesit fundorë
- ESRS G1 – Drejtimi e biznesit

## ESRS 1. KËRKESAT E PËRGJITHSHME

### Përmbajtja

<b>Objektivi .....</b>	<b>9</b>
<b>1. Kategoritë e Standardeve ESRS, fushat e raportimit dhe hartimi i marrëveshjeve .....</b>	<b>10</b>
1.1 Kategoritë e Standardeve ESRS.....	10
1.2 Fushat e raportimit dhe kërkesat minimale për dhënie informacionesh shpjeguese mbi politikat, veprimet, objektivat dhe metrikat .....	11
1.3 Hartimi i marrëveshjeve .....	12
<b>2. Karakteristikat cilësore të informacionit .....</b>	<b>13</b>
<b>3. Materialiteti i dyfishtë si bazë e dhënies së informacioneve shpjeguese mbi qëndrueshmërinë .....</b>	<b>13</b>
3.1 Palët e interesuara dhe rëndësia e tyre në procesin e vlerësimit të materialitetit ...	14
3.2 Çështjet materiale dhe materialiteti i informacionit.....	14
3.3 Materialiteti i dyfishtë .....	17
3.4 Materialiteti i ndikimit .....	18
3.5 Materialiteti financiar .....	18
3.6 Ndikimet ose rreziqet materiale që shfaqen nga veprimet për të trajtuar çështjet e qëndrueshmërisë .....	19
3.7 Niveli i shpërndarjes .....	20
<b>4. Kujdesi i duhur.....</b>	<b>21</b>

<b>5. Zinxhiri i vlerës .....</b>	<b>23</b>
5.1 Njësia ekonomike raportuese dhe zinxhiri i vlerës.....	23
5.2 Vlerësimi duke përdorur mesataret e sektorit dhe përafres (të ngjashëm) .....	24
<b>6. Horizonti kohor .....</b>	<b>25</b>
6.1 Periudha e raportimit .....	25
6.2 Lidhja e së shkuarës, të tashmes dhe të ardhmes.....	25
6.3 Raportimi i ecurisë kundrejt vitit bazë.....	25
6.4 Përkufizimi i periudhës afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë për qëllime raportimi.....	26
<b>7. Përgatitja dhe paraqitja e informacionit për qëndrueshmërinë.....</b>	<b>26</b>
7.1 Paraqitja e informacionit krahasues .....	27
7.2 Burimet e vlerësimit dhe pasiguria e rezultatit .....	27
7.3 Përditësimi i dhënies së informacioneve shpjeguese mbi ngjarjet pas fundit të periudhës së raportimit .....	28
7.4 Ndryshimet në përgatitjen ose paraqitjen e informacionit për qëndrueshmërinë ...	29
7.5 Raportimi i gabimeve të periudhave të mëparshme.....	29
7.6 Raportimi i konsoliduar dhe përjashtimi për filialin .....	30
7.7 Informacioni i klasifikuar, informacioni i ndjeshëm, si dhe informacioni mbi pronësinë intelektuale, njohuritë ose rezultatet e novacionit.....	30
7.8 Raportimi mbi mundësitë .....	31
<b>8. Struktura e deklaratës së qëndrueshmërisë .....</b>	<b>31</b>
8.1 Kërkesa të përgjithshme për paraqitjen .....	31
8.2 Përmbajtja dhe struktura e deklaratës së qëndrueshmërisë .....	32
<b>9. Lidhja me pjesët e tjera të raportimit të shoqërisë dhe informacionit përkatës.....</b>	<b>33</b>
9.1 Përfshirja me referencë .....	33
9.2 Informacioni i lidhur dhe lidhja me pasqyrat financiare .....	35
<b>10. Dispozita kalimtare .....</b>	<b>36</b>
10.1 Dispozita kalimtare lidhur me dhënie informacionesh shpjeguese specifike për njësinë ekonomike .....	36
10.2 Dispozita kalimtare lidhur me kapitullin 5 Zinxhiri i vlerës.....	37
10.3 Dispozita kalimtare lidhur me seksionin 7.1 Paraqitja e informacionit krahasues ..	38
10.4 Dispozita kalimtare: Lista e Kërkesave për Dhënie informacionesh shpjeguese që janë vendosur për zbatim gradual .....	38

<b>Shtojca A. Kërkesat për Zbatim .....</b>	<b>38</b>
Dhënia e informacioneve shpjeguese specifike për njësinë ekonomike.....	38
Materialiteti i dyfishtë .....	40
Vlerësimi duke përdorur mesataret e sektorit dhe për afrues (të ngjashëm) .....	47
Përmbajtja dhe struktura e deklaratës së qëndrueshmërisë .....	47
<b>Shtojca B. Karakteristikat cilësore të informacionit .....</b>	<b>48</b>
Përkatësia.....	48
Paraqitja besnike.....	48
Krahasueshmëria .....	50
Verifikueshmëria.....	50
Kuptueshmëria.....	51
<b>Shtojca C. Lista e vënies graduale në zbatim të Kërkesave për Dhënie informacionesh shpjeguese .....</b>	<b>52</b>
<b>Shtojca D. Struktura e deklaratës së qëndrueshmërisë sipas standardeve ESRS .....</b>	<b>58</b>
<b>Shtojca E. Flowchart për përcaktimin e dhënies së informacioneve shpjeguese sipas standardeve ESRS .....</b>	<b>58</b>
<b>Shtojca F. Shembull i strukturës së deklaratës të qëndrueshmërisë ESRS.....</b>	<b>60</b>
<b>Shtojca G. Shembull i përfshirjes me referencë .....</b>	<b>61</b>

## Objektivi

1. Objektivi i Standardeve Evropiane të Raportimit të Qëndrueshëm (ESRS) është të specifikojnë informacionin për qëndrueshmërinë që një njësi ekonomike duhet të publikojë në përputhje me Direktivën 2013/34/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit,<sup>3</sup> të ndryshuar nga Direktiva (BE) 2022/2464 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit.<sup>4</sup> Raportimi në përputhje me ESRS nuk i përjashton njësitë ekonomike nga detyrimet e tjera të paraqitura në legjislacionin e Bashkimit.
2. Konkretisht, ESRS specifikojnë informacionin që duhet të publikojë një njësi ekonomike mbi ***ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë*** lidhur me ***çështje të qëndrueshmërisë*** të

<sup>3</sup> Direktiva 2013/34/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 26 qershorit 2013 mbi pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportet përkatëse të disa llojeve të njësive ekonomike, që ndryshoi Direktivën 2006/43/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe shfuqizoi Direktivat e Këshillit 78/660/KE dhe 83/349/KE (GZ L 182, 29.6.2013, p. 19).

<sup>4</sup> Direktiva (BE) 2022/2464 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 14 dhjetorit 2022 që ndryshoi Rregulloren (BE) Nr. 537/2014, Direktiva 2004/109/KE, Direktiva 2006/43/KE dhe Direktiva 2013/34/BE, për sa i takon raportimit të shoqërive mbi qëndrueshmërinë (GZ L 322, n16.12.2022, f. 15).

mjedisit, shoqërore dhe të qeverisjes. ESRS nuk kërkon që njësitë ekonomike të publikojnë informacione mbi mjedisin, shoqërinë dhe qeverisjen, që mbulohen nga ESRS nëse njësi ekonomike ka vlerësuar që tema në fjalë nuk është materiale (Shih Shtojcën E të këtij Standardi “*Flowchart për përcaktimin e dhënies së informacioneve shpjeguese që duhen përfshirë*”). Informacioni për t’u publikuar në përputhje me ESRS, u mundëson **përdoruesve të deklaratës së qëndrueshmërisë** të kuptojnë ndikimet materiale të njësisë ekonomike mbi njerëzit dhe mjedisin, si dhe efektet materiale të çështjeve të qëndrueshmërisë mbi zhvillimin, performancën dhe pozicionin e njësisë ekonomike.

- Objektivi i këtij Standardi (ESRS 1) është të sigurojë kuptimin e arkitekturës së ESRS, hartimin e marrëveshjeve dhe të koncepteve themelore të përdorura, si dhe kërkesat e përgjithshme për përgatitjen dhe paraqitjen e informacionit për qëndrueshmërinë në përputhje me Direktivën 2013/34/BE, të ndryshuar nga Direktiva (BE) 2022/2464.

## 1. Kategoritë e Standardeve ESRS, fushat e raportimit dhe hartimi i marrëveshjeve

### 1.1 Kategoritë e Standardeve ESRS

- Janë tri kategori të ESRS:
  - standarde të përgjithshme;
  - standarde sipas temave (Standarde për Mjedisin, për Shoqërinë dhe për Qeverisjen); dhe
  - standarde specifike sipas sektorëve.Standardet e përgjithshme dhe standardet sipas temave janë të pavarur nga sektori, që do të thotë se ata zbatohen për të gjitha njësitë ekonomike pavarësisht sektorit apo sektorëve në të cilët vepron njësi ekonomike.
- Standardet e përgjithshme ESRS 1 *Kërkesat e përgjithshme* dhe ESRS 2 *Dhënie informacionesh shpjeguese të përgjithshme* zbatohen për **çështje të qëndrueshmërisë** të mbuluara nga standardet sipas temave dhe nga standardet specifike sipas sektorëve.
- Ky standard (ESRS 1) përshkruan arkitekturën e standardeve ESRS, shpjegon marrëveshjet paraprake dhe konceptet themelore, si dhe paraqet kërkesat e përgjithshme për përgatitjen dhe paraqitjen e informacionit të lidhur me qëndrueshmërinë.
- ESRS 2 përcakton Kërkesat për Dhënie informacioni shpjegues që njësi ekonomike duhet t’i sigurojë në një nivel të përgjithshëm për të gjitha **çështjet e qëndrueshmërisë** materiale, mbi fushat e raportimit të qeverisjes, strategjisë, **ndikimit, rrezikut** dhe menaxhimit të **mundësisë**, si dhe **metrikat** dhe **objektivat**.

8. ESRS sipas temave mbulon një temë të qëndrueshmërisë dhe strukturohet në tema, nëntema dhe nëse është e nevojshme edhe në nëntema specifike. Tabela në Kërkesat për Zbatim 16 (AR 16) të këtij standardi siguron një panoramë të temave të qëndrueshmërisë, nëntemave dhe nëntemave specifike (të gjitha ndryshe "**çështje të qëndrueshmërisë**") të mbuluara nga ESRS sipas temave.
9. ESRS sipas temave mund të përfshijnë kërkesa specifike që plotësojnë Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese të nivelit të përgjithshëm të ESRS 2. ESRS 2 Shtojca C *Kërkesa për Dhënie informacionesh shpjeguese / Kërkesa për Zbatim në ESRS sipas temave që janë të zbatueshme, së bashku me ESRS 2 Kërkesa për Dhënie informacionesh shpjeguese të Përgjithshme* japin një listë të kërkesave shtesë në ESRS sipas temave që njësia ekonomike duhet të zbatojë së bashku me kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të nivelit të përgjithshëm të ESRS 2.
10. Standardet specifike sipas sektorëve janë të zbatueshëm për të gjitha njësitë ekonomike brenda një sektori. Ato trajtojnë **ndikimet, rreziqet** dhe **mundësitë** që mund të jenë materiale për të gjitha njësitë ekonomike në një sektor të caktuar dhe nuk janë mbuluar, ose nuk mbulohen mjaftueshëm, nga standardet sipas temave. Standardet specifike sipas sektorëve janë me shumë tema dhe mbulojnë temat që janë më të rëndësishme për sektorin në fjalë. Standardet specifike sipas sektorëve arrijnë një shkallë të lartë krahasueshmërie.
11. Përveç kërkesave për dhënie informacionesh shpjeguese të paraqitura në tri kategoritë e ESRS, nëse njësia ekonomike del në përfundimin se një ndikim, rrezik ose mundësi nuk është mbuluar ose nuk mbulohet me hollësi të mjaftueshme nga një ESRS por është i rëndësishëm për shkak të fakteve dhe rrethanave specifike të tij, ajo duhet të japë informacione shpjeguese shtesë, specifike për njësinë ekonomike për t'u mundësuar përdoruesve të kuptojnë **ndikimet, rreziqet** ose **mundësitë** e lidhura me qëndrueshmërinë për njësinë ekonomike. Kërkesat për zbatim AR 1 deri tek AR 5 sigurojnë udhëzim të mëtjshëm lidhur me dhënien e informacioneve shpjeguese specifike për njësinë ekonomike.

## 1.2 Fushat e raportimit dhe kërkesat minimale për dhënie informacionesh shpjeguese mbi politikat, veprimet, objektivat dhe metrikat

12. Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese në ESRS 2, në ESRS sipas temave dhe në ESRS sipas sektorëve specifike, strukturohen në fushat e raportimit në vijim:
  - (a) **Qeverisja** (GOV): proceset qeverisëse, kontrollet dhe procedurat e përdorura për të monitoruar, menaxhuar dhe mbikëqyrur **ndikimet, rreziqet dhe mundësitë** (shih *ESRS 2, kapitulli 2 Qeverisja*);
  - (b) **Strategjia** (SBM): si strategjia e njësisë ekonomike dhe  **modeli i biznesit** ndërvepron me ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të saj, përfshirë dhe sesi njësia ekonomike i trajton këto ndikime, rreziqe dhe mundësi (shih *ESRS 2, kapitulli 3 Strategjia*);

- (c) **Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë** (IRO): procesi(proceset) përmes të cilit njësia ekonomike:
  - i. identifikon ndikimet, rreziqet dhe mundësitë, si dhe vlerëson **materialitetin** e tyre (shih IRO-1 në seksionin 4.1 të ESRS 2),
  - ii. menaxhon **çështje materiale të qëndrueshmërisë** përmes **politikave** dhe **veprimeve** (shih seksionin 4.2 të ESRS 2).
- (d) **Metrikat dhe objektivat** (MT): performanca e njësisë ekonomike, duke përfshirë objektivat që ajo ka vendosur dhe ecurinë në realizimin e tyre (shih ESRS 2, kapitulli 5 *Metrikat dhe objektivat*).

13. ESRS 2 përfshin:

- (a) në seksionin 4.2 Kërkesat Minimale për Dhënie informacionesh shpjeguese lidhur me **politikat** (MDR-P) dhe **veprimet** (MDR-A);
- (b) në seksionin 5 Kërkesat Minimale për Dhënie informacionesh shpjeguese lidhur me metrikat (MDR-M) dhe **objektivat** (MDR-T).

Njësia ekonomike do të zbatojë **kërkesat minimale për dhënie informacionesh shpjeguese** lidhur me politikat, veprimet, metrikat dhe objektivat së bashku me Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese korrespondente në ESRS-të sipas temave dhe sipas sektorëve.

### 1.3 Hartimi i marrëveshjeve

14. Në të gjitha ESRS-të:

- (a) termi **“ndikimet”** i referohet ndikimeve pozitive dhe negative të lidhura me qëndrueshmërinë që lidhen me biznesin e njësisë ekonomike, sipas identifikimit përmes një vlerësimi **të materialitetit të ndikimit** (shih seksion 3.4 *Materialiteti i ndikimit*). Termi i referohet ndikimeve aktuale dhe ndikimeve potenciale në të ardhmen.
- (b) Termat **“rreziqet dhe mundësitë”** u referohen rreziqeve financiare dhe mundësive të lidhura me qëndrueshmërinë të njësisë ekonomike, duke përfshirë ato që vijnë nga varësitë në burimet natyrore, humane dhe sociale, të identifikuara përmes një vlerësimi të **materialitetit financiar** (shih seksionin 3.5).

Së bashku, ato referohen si **“ndikimet, rreziqet dhe mundësitë”** (IROs). Ato pasqyrojnë perspektivën e ESRS-ve për **materialitetin e dyfishtë** të përshkruar në seksionin 3.

15. Përgjatë ESRS-ve, termat e përkufizuar në fjalorin e përkufizimeve (Aneksi II) janë theksuar me **ngjyrë më të errët dhe me shkrim të pjerrët (italic)**, me përjashtim të rastit kur termi i përkufizuar është përdorur më shumë se një herë në të njëjtin paragraf.

16. ESRS-të strukturojnë informacionin që duhet të paraqitet në Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese. Çdo Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese përbëhet nga një ose më shumë pika të dhënash të dallueshme. Termi “pikë të dhënash” mund t’i referohet edhe një nënelementi përshkruar të një Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese.
17. Përveç Kërkesave për Dhënie informacionesh shpjeguese shumica e ESRS-ve përmbajnë edhe Kërkesa për t’u Zbatuar. Kërkesat për t’u Zbatuar mbështetin zbatimin e Kërkesave për Dhënie informacionesh shpjeguese dhe kanë të njëjtën autoritet si pjesët e tjera të një standardi ESRS.
18. ESRS përdorin termat në vijim për të dalluar mes shkallëve të ndryshme të detyrimit që ka njësia ekonomike për të paraqitur informacionin:
  - (a) “do të paraqesë” – tregon që kërkesa përshkruhet nga një Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese ose një pikë të dhënash;
  - (b) “mund të paraqesë” – tregon dhënie informacionesh shpjeguese vullnetare për të nxitur praktikën pozitive.

Gjithashtu, ESRS-të përdorin termin “do të paraqesë” kur i referohen çështjeve, burimeve ose metodologjive që pritet të marrë në konsideratë njësia ekonomike ose pritet t’i përdorë në përgatitjen e një paraqitjeje të caktuar të informacioneve shpjeguese nëse është e zbatueshme.

## 2. Karakteristikat cilësore të informacionit

19. Kur përgatit **deklaratën e saj të qëndrueshmërisë**, njësia ekonomike do të zbatojë:
  - (a) karakteristikat themelore cilësore të informacionit, d.m.th. përkatësinë dhe paraqitjen besnike; dhe
  - (b) karakteristikat cilësore shtesë të informacionit, d.m.th. krahasueshmërinë, vërtetueshmërinë dhe kuptueshmërinë.
20. Këto karakteristika cilësore të informacionit përkufizohen dhe përshkruhen në Shtojcën B të këtij Standardi.

## 3. Materialiteti i dyfishtë si bazë e dhënies së informacioneve shpjeguese mbi qëndrueshmërinë

21. Njësia ekonomike do të raportojë mbi **çështjet e qëndrueshmërisë** bazuar në parimin e **materialitetit të dyfishtë** siç përshkruhet dhe sqarohet në këtë kapitull.

### 3.1 Palët e interesuara dhe rëndësia e tyre në procesin e vlerësimit të materialitetit

22. **Palët e interesuara** janë ata që mund të ndikojnë dhe mund të ndikohen nga njësia ekonomike. Ekzistojnë dy grupe kryesore të palëve të interesuara:
- (a) palë të interesuara të ndikuara: individë ose grupe interesat e të cilëve janë ndikuar ose mund të ndikohen – pozitivisht ose negativisht – nga aktivitetet e njësisë ekonomike ose **marrëdhëniet e saj të biznesit** të drejtpërdrejta ose të tërthorta përmes **zinxhirit të saj të vlerës**; dhe
  - (b) përdoruesit e **deklaratave të qëndrueshmërisë**: përdoruesit primarë të raportimit financiar për qëllime të përgjithshme (investitorët ekzistues dhe potencialë, huadhënësit dhe kreditorët e tjerë përfshirë menaxhuesit e aktiveve, institucionet e kredisë, shoqëritë e sigurimit), si dhe përdorues të tjerë të deklaratave të qëndrueshmërisë që përfshijnë partnerët e biznesit të njësisë ekonomike, sindikatat dhe partnerët socialë, organizatat e shoqërisë civile dhe joqeveritare, qeveritë, analistët dhe akademikët.
23. Disa **palë të interesuara**, por jo të gjitha, mund t’u përkasin të dy grupeve të referuara në paragrafin 22.
24. Angazhimi me **palët e interesuara** të ndikuara është i rëndësishëm për proceset e vijueshme të kujdesit të duhur të njësisë ekonomike (shih kapitullin 4 *Kujdesi i duhur*) dhe vlerësimin e **materialitetit** të qëndrueshmërisë. Kjo përfshin proceset e saj për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet aktuale dhe potenciale negative, që më pas informojnë procesin e vlerësimit për të identifikuar ndikimet materiale për qëllime të raportimit të qëndrueshëm (shih seksionin 3.4 të këtij Standardi).

### 3.2 Çështjet materiale dhe materialiteti i informacionit

25. Kryerja e një vlerësimi për **materialitetin** (shih seksionet 3.4 *Materialiteti i ndikimit* dhe 3.5 *Materialiteti financiar*) është e nevojshme që njësia ekonomike të identifikojë **ndikimet, rreziqet** dhe **mundësitë** materiale për t’u raportuar.
26. Vlerësimi i **materialitetit** është pikënisja për raportimin e qëndrueshëm sipas ESRS-ve. IRO-1 në seksionin 4.1 të ESRS 2 përfshin kërkesat e përgjithshme për dhënie informacionesh shpjeguese mbi proceset e njësisë ekonomike për të identifikuar **ndikimet, rreziqet** dhe **mundësitë**, si dhe për të vlerësuar materialitetin e tyre. SBM-3 i ESRS 2 siguron kërkesat e përgjithshme për dhënie informacionesh shpjeguese mbi ndikimet, rreziqet dhe mundësitë, që rezultojnë nga vlerësimi i materialitetit i njësisë ekonomike.
27. Kërkesat për t’u Zbatuar në Shtojcën A të këtij Standardi përfshijnë një listë të **çështjeve të qëndrueshmërisë** që mbulohen nga ESRS-të sipas temave, të kategorizuara në tema, nëntema dhe nën-nëntema, për të mbështetur vlerësimin e **materialitetit**. Në Shtojcën E *Flowchart për*

*përcaktimin e dhënies së informacioneve shpjeguese që duhen përfshirë të këtij Standardi jepet një ilustrim i vlerësimit të materialitetit të përshkruar në këtë seksion.*

28. Një çështje e qëndrueshmërisë është “materiale” nëse plotëson kriterin e përkufizuar në **materialitetin e ndikimit** (shih seksionin 3.4 të këtij Standardi) ose **materialitetin financiar** (shih seksionin 3.5 të këtij Standardi), ose të dy bashkë.
29. Pavarësisht rezultatit të vlerësimit të saj të materialitetit, njësia ekonomike do të paraqesë gjithmonë informacionin e kërkuar nga ESRS 2 *Dhënie informacionesh shpjeguese të Përgjithshme* (d.m.th. të gjitha Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese dhe pikat e të dhënave të specifikuara në ESRS 2) dhe Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese (përfshirë pikat e tyre të të dhënave) në ESRS-të sipas temave të lidhur me Kërkesën për Dhënie informacionesh shpjeguese. IRO-1 *Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale*, sic radhiten në ESRS 2 *Shtojca C Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese / Kërkesat për Zbatim në ESRS-të sipas temave që janë të zbatueshme së bashku me ESRS 2 Dhënie informacionesh shpjeguese të Përgjithshme*.
30. Nëse njësia ekonomike del në përfundimin se një çështje e qëndrueshmërisë është materiale si rezultat i një vlerësimi të saj të **materialitetit**, për të cilën IRO-1, IRO-2 dhe SBM-3 të ESRS 2 përcaktojnë kërkesa për dhënie informacionesh shpjeguese, ajo do të:
  - (a) japë informacion shpjegues në përputhje me Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese (përfshirë Kërkesat për Zbatim) të lidhur me atë çështje specifike të qëndrueshmërisë në ESRS përkatëse sipas temës dhe sipas sektorit. dhe
  - (b) japë informacion shpjegues shtesë, specifik për njësinë ekonomike (shih paragrafin 11 dhe AR 1 deri te AR 5 të këtij Standardi) nëse çështja materiale e qëndrueshmërisë nuk mbulohet nga një ESRS ose nuk mbulohet mjaftueshëm në hollësi.
31. Informacioni i zbatueshëm i përshkruar në Kërkesën për Dhënie informacionesh shpjeguese, përfshirë pikat e saj të të dhënave, ose një dhënie informacionesh shpjeguese specifike për njësinë ekonomike, do të jepet kur njësia ekonomike vlerëson, si pjesë e vlerësimit të saj për informacionin material, se informacioni është përkatës për një ose më shumë prej perspektivave në vijim:
  - (a) rëndësinë e informacionit në lidhje me çështjen që synon të përshkruajë ose të shpjegojë; ose
  - (b) kapacitetin një informacioni të tillë për të plotësuar nevojat vendimmarrëse të përdoruesve, përfshirë nevojat e përdoruesve kryesorë të raportimit financiar për qëllime të përgjithshme të përshkruar në paragrafin 48 dhe/ose nevojat e përdoruesve që kanë si interes kryesor informacionin mbi ndikimet e njësisë ekonomike.
32. Nëse njësia ekonomike del në përfundimin se ndryshimi klimatik nuk është material dhe prandaj nuk paraqet informacionet e kërkuara në ESRS E1 *Ndryshimi klimatik*, ajo do të japë

një shpjegim të hollësishëm të përfundimeve lidhur me vlerësimin e saj të **materialitetit** në lidhje me ndryshimin klimatik (shih ESRS 2 IRO-2 *Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese në ESRS të mbuluara nga deklarata e qëndrueshmërisë e njësisë ekonomike*) duke përfshirë një analizë parashikuese të kushteve që mund të sjellin që njësia ekonomike në të ardhmen të dalë në përfundimin që ai ndryshim klimatik është material. Nëse njësia ekonomike del në përfundimin se një temë e ndryshme nga ndryshim klimatik nuk është materiale dhe prandaj nuk paraqet informacionet e kërkuara në ESRS korrespondente sipas temës, ajo mund të shpjegojë shkurt përfundimet e vlerësimit të saj për materialitetin e asaj teme.

33. Kur jep informacion shpjegues mbi **politikat, veprimet dhe objektivat** lidhur me një **çështje të qëndrueshmërisë** që është vlerësuar si materiale, njësia ekonomike do të përfshijë informacionin e përshkruar nga të gjitha Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese dhe pikat e të dhënave në ESRS-të sipas temave dhe sektorëve të lidhura me atë çështje dhe në **Kërkesat Minimale për Dhënie informacionesh shpjeguese** korrespondente mbi politikat, veprimet dhe objektivat të kërkuar sipas ESRS 2. Nëse njësia ekonomike nuk mund të japë informacionet shpjeguese të përshkruara në Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese dhe pikat e të dhënave në ESRS-të sipas temave ose sipas sektorëve, ose në Kërkesat Minimale për Dhënie informacionesh shpjeguese në ESRS 2 mbi politikat, veprimet dhe objektivat, për shkak se nuk ka përdorur politikat përkatëse, nuk ka implementuar veprimet përkatëse ose nuk ka vendosur objektivat përkatës, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt dhe mund të raportojë një afat brenda të cilit synon t'i vërë ato në zbatim.
34. Kur jep informacion shpjegues mbi **metrikat** për një **çështje** materiale **të qëndrueshmërisë** sipas seksionit të Metrikave dhe Objektivave të ESRS përkatëse sipas temës, njësia ekonomike:
- (a) do të përfshijë informacionin e përshkruar nga një Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese nëse vlerëson se ky informacion do të jetë material; dhe
  - (b) mund të mos japë informacionin e përshkruar nga një pikë të dhënash e një Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese nëse vlerëson se ky informacion nuk do të jetë material dhe del në përfundimin se ky informacion nuk është i nevojshëm për të plotësuar objektivin e Kërkesës për Dhënie informacionesh shpjeguese.
35. Nëse njësia ekonomike nuk jep informacionin e përshkruar nga një pikë të dhënash që vjen nga një legjislacion tjetër i BE i renditur në Shtojcën B të ESRS 2, ajo do të deklarojë qartë se informacioni në fjalë “nuk është material”.
36. Njësia ekonomike do të vendosë sesi i zbaton kriteret, përfshirë pragun e duhur, për të përcaktuar:
- (a) informacionin shpjegues që jep mbi **metrikat** për një çështje materiale të qëndrueshmërisë sipas seksionit të Metrikave dhe Objektivave të ESRS përkatëse sipas temës, në përputhje me paragrafin 34: dhe

(b) informacionin shpjegues për t'u paraqitur si dhënie informacionesh shpjeguese specifike për njësinë ekonomike.

### 3.3 Materialiteti i dyfishtë

37. **Materialiteti i dyfishtë** ka dy dimensione, përkatësisht: **materialitetin e ndikimit** dhe **materialitetin financiar**. Me përjashtim të rasteve kur cilësohet ndryshe, termat “material” dhe “materialitet” përdoren në standardet ESRS për t’iu referuar materialitetit të dyfishtë.
38. Vlerësimet e **materialitetit të ndikimit** dhe të **materialitetit financiar** janë të ndërlidhura dhe varësia reciproke mes këtyre dy dimensioneve duhet të merret në konsideratë. Në përgjithësi, pikënisja është vlerësimi i ndikimeve, megjithëse mund të ketë **rreziqe** dhe **mundësi** materiale që nuk lidhen me **ndikimet** e njësisë ekonomike. Një ndikim i qëndrueshmërisë mund të jetë material në këndvështrimin financiar që në krijim ose të bëhet financiarisht material, kur mund të pritët në mënyrë të arsyeshme të ndikojë pozicionin financiar, performancën financiare, flukset monetare, mundësinë e financimit ose koston e kapitalit të njësisë ekonomike përgjatë një periudhe afatshkurtër, afatmesme ose afatgjatë. Ndikimet merren nga perspektiva e materialitetit të ndikimit pavarësisht nëse ata janë ose jo materiale nga këndvështrimi financiar.
39. Kur identifikon dhe vlerëson **ndikimet**, **rreziqet** dhe **mundësitë** në **zinxhirin e vlerës** të njësisë ekonomike për të përcaktuar **materialitetin** e tyre, njësia ekonomike do të përqendrohet në zonat ku ndikimet, rreziqet dhe mundësitë mendohet se ka mundësi të shfaqen bazuar në natyrën e aktiviteteve, marrëdhënieve të biznesit, gjeografisë ose faktorëve të tjerë përkatës.
40. Njësia ekonomike do të marrë në konsideratë sesi ndikohet nga **varësitë** e saj mbi burimet natyrore, humane dhe sociale në dispozicion me çmimet dhe cilësinë e duhur, pavarësisht **ndikimeve** të saj potenciale mbi këto burime.
41. **Ndikimet**, **rreziqet** dhe **mundësitë** kryesore të një njësie ekonomike, nënkuptohet të jenë të njëjta me ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të identifikuar sipas parimit të **materialitetit të dyfishtë** dhe prandaj raportohen në **deklaratën e saj të qëndrueshmërisë**.
42. Njësia ekonomike do të zbatojë kriteret e paraqitura në seksionet 3.4 dhe 3.5 të këtij Standardi, duke përdorur pragjet e duhura sasiore dhe/ose cilësore. Pragjet e duhura janë të nevojshëm për të përcaktuar se cilat **ndikime**, **rreziqe** dhe **mundësi** janë identifikuar dhe trajtuar nga njësia ekonomike si materiale dhe për të përcaktuar se cilat **çështje të qëndrueshmërisë** janë materiale për qëllime të raportimit. Disa standarde dhe kuadro referimi ekzistuese përdorin shprehjen “ndikimet më të rëndësishme” kur i referohen pragut të përdorur për të identifikuar ndikimet që janë përshkruar në standardet ESRS si “ndikime materiale”.

### 3.4 Materialiteti i ndikimit

43. Një **çështje e qëndrueshmërisë** është materiale nga perspektiva e ndikimit nëse i përket **ndikimeve** materiale aktuale ose potenciale të njësisë ekonomike, pozitive ose negative mbi njerëzit ose mjedisin përgjatë një periudhe afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë. Ndikimet përfshijnë ndikimet e lidhura me veprimtarinë e vetë njësisë ekonomike dhe me rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës, të lidhura me produktet dhe shërbimet e saj, si edhe përmes marrëdhënieve të saj të biznesit. **Marrëdhëniet e biznesit** përfshijnë ato në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të vlerës** të njësisë ekonomike dhe nuk kufizohen vetëm në marrëdhëniet kontraktuale të drejtpërdrejta.
44. Në këtë kontekst, ndikimet mbi njerëzit ose mjedisin përfshijnë ndikimet në lidhje me çështjet e mjedisit, sociale dhe qeveritare.
45. Vlerësimi i **materialitetit** të një ndikimi negativ merret nga procesi i kujdesit të duhur të përkufizuar në instrumentet ndërkombëtare të Parimet Udhëzuese në Biznes dhe për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara dhe Udhëzuesin e Sipërmarrjeve Shumëkombëshe të OECD. Për ndikimet aktuale negative, materialiteti bazohet në ashpërsinë e ndikimit, ndërsa për ndikimet negative potenciale bazohet në ashpërsinë dhe probabilitetin e ndikimit. Ashpërsia bazohet në faktorët në vijim:
- (a) shkallën;
  - (b) fushëveprimin; dhe
  - (c) karakterin e pakthyeshëm të ndikimit.
- Në rast të ndikimit negativ potencial në të drejtat e njeriut, ashpërsia e ndikimit merr përparësi ndaj probabilitetit të ndodhjes së tij.
46. Për ndikimet pozitive, **materialiteti** bazohet në:
- (a) shkallën dhe fushëveprimin e ndikimit për ndikimet aktuale; dhe
  - (b) shkallën, fushëveprimin dhe probabilitetin e ndikimit për ndikimet potenciale.

### 3.5 Materialiteti financiar

47. Objekti i **materialitetit financiar** për raportimin e qëndrueshëm është një zgjerim i objektit të materialitetit të përdorur në procesin e përcaktimit se cili informacion duhet të përfshihet në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike.
48. Vlerësimi i **materialitetit financiar** përkon me identifikimin e informacionit që konsiderohet material për përdoruesit kryesorë të raporteve financiare për qëllime të përgjithshme në vendimmarrjen e lidhur me sigurimin e burimeve për njësinë ekonomike. Veçanërisht, informacioni konsiderohet material për përdoruesit kryesorë të raporteve financiare për qëllime të përgjithshme nëse heqja, paraqitja jo e saktë ose fshehja e atij informacioni mund

të pritët në mënyrë të arsyeshme të ndikojë vendimet që ata marrin bazuar në **deklaratën e qëndrueshmërisë** të njësisë ekonomike.

49. Një çështje e qëndrueshmërisë është materiale nga perspektiva financiare nëse prodhon **efekte financiare** materiale mbi njësinë ekonomike ose pritët në mënyrë të arsyeshme që të prodhojë efekte financiare materiale. Ky është rasti kur një çështje e qëndrueshmërisë gjeneron **rreziqe** ose **mundësi** që kanë një ndikim material ose pritët në mënyrë të arsyeshme që të ketë një ndikim material në zhvillimin, pozicionin financiar, performancën financiare, flukset monetare, mundësinë për financim ose koston e kapitalit të njësisë ekonomike përgjatë një periudhe afatshkurtër, afatmesme ose afatgjatë. Rreziqet dhe mundësitë mund të vijnë nga ngjarje të shkuara ose të ardhshme. **Materialiteti financiar** i një çështjeje të qëndrueshmërisë nuk kufizohet vetëm tek çështjet që janë brenda kontrollit të njësisë ekonomike, por përfshin informacionin mbi **rreziqet** dhe **mundësitë** materiale që u takojnë **marrëdhëniet të biznesit** përtej objektit të konsolidimit të përdorur në përgatitjen e pasqyrave financiare.
50. **Varësitë** nga burimet natyrore, humane dhe sociale mund të jenë origjina për **rreziqet** ose **mundësitë** financiare. Varësitë mund të prodhojnë efekte në dy mënyra të mundshme:
- (a) ato mund të influencojnë aftësinë e njësisë ekonomike për të vazhduar përdorimin ose marrjen e burimeve të nevojshme në proceset e saj të biznesit, si dhe cilësinë dhe çmimin e këtyre burimeve; dhe
  - (b) ato mund të ndikojnë aftësinë e njësisë ekonomike për t'u mbështetur në marrëdhëniet e nevojshme në proceset e saj të biznesit në kushte të përshtatshme.
51. **Materialiteti** i **rreziqeve** dhe **mundësive** vlerësohet bazuar në kombinimin e probabilitetit të ndodhjes dhe madhësisë potenciale të **efekteve financiare**.

### 3.6 Ndikimet ose rreziqet materiale që shfaqen nga veprimet për të trajtuar çështjet e qëndrueshmërisë

52. Vlerësimi i **materialitetit** të njësisë ekonomike mund të sjellë identifikimin e situatave në të cilat **veprimet** e saj për të trajtuar disa **ndikime** ose **rreziqe**, ose për të përfituar nga disa **mundësi** në lidhje me një çështje të qëndrueshmërisë, mund të ketë ndikime negative materiale ose mund të shkaktojë rreziqe materiale në lidhje me një ose më shumë **çështje të tjera të qëndrueshmërisë**. Për shembull:
- (a) një plan veprimi për të dekarbonizuar prodhimin që përfshin braktisjen e disa produkteve mund të ketë ndikime negative materiale në **forcën e vet të punës** të njësisë ekonomike dhe të sjellë rreziqe materiale për shkak të pagesave për ndërprerjen e marrëdhëniet të punës (pushimit nga puna); ose

(b) një plan veprimi i një **furnizuesi** të mjeteve të transportit për t'u përqendruar në ofrimin e mjeteve elektrike mund të sjellë bllokimin e aktiveve për prodhimin e pjesëve të ofruara për mjetet tradicionale.

53. Në situata të tilla, njësia ekonomike do të:

(a) japë informacion shpjegues mbi ekzistencën e ndikimeve materiale negative ose të rreziqeve materiale së bashku me **veprimet** që i gjenerojnë ato, me një referencë të kryqëzuar me temën me të cilën lidhen ndikimet ose rreziqet; dhe

(b) japë një përshkrim sesi ndikimet negative materiale ose rreziqet materiale trajtohen sipas temës me të cilën lidhen.

### 3.7 Niveli i shpërndarjes

54. Nëse është e nevojshme për të kuptuar si duhet **ndikimet**, **rreziqet** dhe **mundësitë** materiale të saj, njësia ekonomike do të shpërndajë informacionin e raportuar:

(a) sipas vendit, nëse ka variacione të rëndësishme të ndikimeve, rreziqeve dhe mundësive materiale mes vendeve dhe nëse paraqitja e informacionit në një nivel grupimi më të lartë do të fshihte informacion material mbi ndikimet, rreziqet dhe mundësitë; ose

(b) sipas **vendndodhjes** ose aktivitet kryesor, nëse ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale varen shumë nga një zonë ose aktiv i caktuar.

55. Kur përcaktohet niveli i përshtatshëm i shpërndarjes për raportim, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë shpërndarjen e përdorur në vlerësimin e saj të materialitetit. Në varësi të fakteve dhe rrethanave specifike për njësinë ekonomike, mund të jetë e nevojshme një shpërndarje sipas filialeve.

56. Nëse të dhënat nga nivele të ndryshme, ose zona të shumta brenda një niveli, grupohen, njësia ekonomike do të sigurojë që ky bashkim nuk fsheh specifikën dhe kontekstin e nevojshëm për të interpretuar informacionin. Njësia ekonomike nuk do të grupojë zërat materialë që kanë natyrë të ndryshme.

57. Nëse njësia ekonomike paraqet informacionin e shpërndarë sipas sektorëve, ajo duhet të zbatojë klasifikimin sipas sektorëve të standardeve ESRS për t'u specifikuar në një akt të deleguar të përdorur nga Komisioni në vijim të artikullit 29, germa b, pika (1), nënparagrafi i tretë, germa (ii), e Direktivës 2013/34/BE. Nëse një standard ESRS sipas temës ose sektorit specifik kërkon që të përdoret një nivel i caktuar i shpërndarjes në përgatitjen e një zëri të caktuar të informacionit, merr përparësi kërkesa në standardin ESRS sipas temës ose sektorit specifik.

## 4. Kujdesi i duhur

58. Rezultati i procesit të kujdesit të duhur për qëndrueshmërinë e njësisë ekonomike (i referuar si “kujdesi i duhur” në instrumentet ndërkombëtarë të përmendur më poshtë) kontribuon në vlerësimin e njësisë ekonomike për **ndikimet**, **rreziqet** dhe **mundësitë** materiale të saj. Standardet ESRS nuk imponojnë kërkesa për sjelljen lidhur me kujdesin e duhur; as nuk zgjerojnë ose modifikojnë rolin e organeve administrative, të drejtimit ose të mbikëqyrjes të njësisë ekonomike lidhur me mënyrën e realizimit të kujdesit të duhur.
59. Kujdesi i duhur është procesi përmes të cilit njësitë ekonomike identifikojnë, parandalojnë, zbusin dhe japin llogari sesi ato trajtojnë **ndikimet** negative aktuale dhe potenciale mbi mjedisin dhe njerëzit e lidhur me bizneset e tyre. Këto përfshijnë ndikimet negative të lidhura me veprimtarinë e vetë njësisë ekonomike dhe me rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të saj të vlerës, të lidhura me produktet dhe shërbimet e saj, si edhe përmes marrëdhënieve të saj të biznesit. Kujdesi i duhur është një praktikë në vijimësi që u përgjigjet dhe mund të prodhojë ndryshime në strategjinë, modelin e biznesit, aktivitetet, marrëdhëniet e biznesit, veprimtarinë, kontekstet e sigurimit të burimeve dhe realizimit të shitjeve të njësisë ekonomike. Ky proces përshkruhet në instrumentet ndërkombëtare: Parimet Udhëzuese në Biznes dhe për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara dhe në Udhëzuesin e Sipërmarrjeve Shumëkombëshe të OECD.
60. Këto instrumente ndërkombëtare identifikojnë një numër hapash në procesin e kujdesit të duhur, që përfshijnë identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve negative të lidhura me veprimtarinë e vetë njësisë ekonomike dhe me rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të saj të vlerës, të lidhura me produktet dhe shërbimet e saj, si edhe përmes marrëdhënieve të saj të biznesit. Nëse njësi ekonomike nuk mund të trajtojë të gjitha ndikimet menjëherë, procesi i kujdesit të duhur lejon për dhënie përparësi të veprimit bazuar në ashpërsinë dhe probabilitetin e ndodhjes së ndikimit. Ky aspekt i procesit të kujdesit të duhur kontribuon në vlerësimin e ndikimeve materiale (shih seksionin 3.4 të këtij Standardi). Identifikimi i ndikimeve materiale mbështet edhe identifikimin e **rreziqeve** dhe **mundësive** materiale të qëndrueshmërisë që janë shpesh produkt i ndikimeve të tilla.
61. Elementët kryesorë të kujdesit të duhur pasqyrohen drejtpërdrejt në Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese të paraqitura në ESRS 2 dhe në standardet ESRS sipas temave, siç ilustron në vijim:
- (a) integrimi i kujdesit të duhur në qeverisje, strategji dhe në modelin e biznesit.<sup>5</sup> Kjo trajtohet sipas sa vijon:

---

<sup>5</sup> Parimi Udhëzues 16 i KB dhe komentari i tij; Udhëzues Interpretimi i KB, Pyetjet 21 dhe 25 si dhe Udhëzuesit e OECD Kapitulli II mbi Politikën e Përgjithshme (paragrafi A.10) dhe kapitulli IV mbi të Drejtat e Njeriut (paragrafi 4; dhe paragrafi 44 i Komentarit); dhe Udhëzuesi për Kujdesin e Duhur i OECD, Seksioni II (1.1 dhe 1.2) dhe Aneksi, Pyetjet 14 dhe 15.

- i. ESRS 2 GOV-2: *Informacioni i siguruar dhe çështjet e qëndrueshmërisë të trajtuara nga organet administrative, të drejtimit dhe të mbikëqyrjes të njësisë ekonomike;*
- ii. ESRS 2 GOV-3: *Integrimi i performancës së lidhur me qëndrueshmërinë në skemat nxitëse; dhe*
- iii. ESRS 2 SBM-3: *Ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit.*

(b) Angazhimi me **palët e interesuara** të ndikuara.<sup>6</sup> Kjo trajtohet sipas sa vijon:

- i. ESRS 2 GOV-2;
- ii. ESRS 2 SBM-2: *Interesat dhe këndvështrimet e palëve të interesit;*
- iii. ESRS 2 IRO-1;
- iv. ESRS 2 MDR-P; dhe
- v. Standardet ESRS sipas temës që reflektojnë fazat e ndryshme dhe qëllimet e angazhimit të palës së interesuar përgjatë procesit të kujdesit të duhur.

(c) identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve negative mbi njerëzit dhe mjedisin.<sup>7</sup> Kjo trajtohet sipas sa vijon:

- i. ESRS 2 IRO-1 (përfshirë Kërkesat për Zbatim të lidhura me **çështje të caktuara të qëndrueshmërisë** në standardet ESRS përkatëse); dhe
- ii. ESRS 2 SBM-3;

(d) ndërmarrja e veprimit për të trajtuar ndikimet negative mbi njerëzit dhe mjedisin.<sup>8</sup> Kjo trajtohet sipas sa vijon:

- i. ESRS 2 MDR-A; dhe
- ii. Standardet ESRS sipas temës që pasqyrojnë gamën e **veprimeve**, përfshirë **planet e tranzicionit**, përmes të cilave trajtohen ndikimet.

(e) gjurmimi i efektivitetit të këtyre përpjekjeve.<sup>9</sup> Kjo trajtohet sipas sa vijon:

- i. ESRS 2 MDR-M;
- ii. ESRS 2 MDR-T; dhe

<sup>6</sup> Parimi Udhëzues 18 i KB dhe Komentari i tij, Parimi Udhëzues 20 i KB, Komentari i Parimeve Udhëzuese 21 dhe 19, si dhe Parimi Udhëzues 31 (h) dhe komentari i tij; si dhe Udhëzues Interpretimi i KB, Pyetjet 30, 33, 42 dhe 76 si dhe Udhëzuesit e OECD Kapitulli II mbi Politikat e Përgjithshme (paragrafi A.14 dhe paragrafi 25 i Komentarit); dhe Udhëzuesi për Kujdesin e Duhur i OECD, Seksioni II (2.1.c, 2.3.2.4.a, 3.1.b dhe 3.1.f) dhe Aneksi i Pyetjeve 8- 11.

<sup>7</sup> Parimet Udhëzues 17, 18 dhe 24 të KB dhe Komentaret e tyre, si dhe Komentari i Parimit Udhëzues 29 i KB; dhe Udhëzuesi i Interpretimi i KB, Pyetjet 9, 12-13, 27-28, 36-42, dhe 85-89 dhe Udhëzuesi i OECD Kapitulli II mbi Politikat e Përgjithshme (paragrafët A.10-11 dhe paragrafi 14 Komentarit), dhe Kapitulli IV mbi të Drejtat e Njeriut (paragrafët 1-2 dhe paragrafët 41-43 të Komentarit); dhe Udhëzuesi për Kujdesin e Duhur i OECD, Seksioni II (2.1 dhe 2.4) dhe Aneksi, Pyetjet 3-5 dhe 19-31.

<sup>8</sup> Parimet Udhëzuese 19, 22 dhe 23 të KB dhe Komentaret e tyre; dhe Udhëzuesi i Interpretimi i KB, Pyetjet 11, 32, 46-47, 64-68, dhe 82-83 dhe Udhëzuesi i OECD Kapitulli II mbi Politikat e Përgjithshme (paragrafët A.12 dhe paragrafët 18-22 të Komentarit), dhe Kapitulli IV mbi të Drejtat e Njeriut (paragrafët 3 dhe paragrafët 42-43 të Komentarit); dhe Udhëzuesi për Kujdesin e Duhur i OECD, Seksioni II (3.1-3.2) dhe Aneksi i Pyetjeve 32-40).

<sup>9</sup> Parimet Udhëzuese 20 dhe 31(g) të KB dhe Komentaret e tyre; dhe Udhëzuesi i Interpretimit i Kombeve të Bashkuara (KB), Pyetjet 49-53 dhe 80, si dhe Udhëzuesi për Kujdesin e Duhur i OECD, Seksioni II (4.1 dhe 5.1) dhe Pyetjet 41-47 të Aneksit.

iii. Standardet ESRS sipas temës: lidhur me **metrikat** dhe **objektivat**.

## 5. Zinxhiri i vlerës

### 5.1 Njësia ekonomike raportuese dhe zinxhiri i vlerës

62. **Deklarata e qëndrueshmërisë** do të jetë për të njëjtën periudhë raportimi të njësisë ekonomike si dhe pasqyrat financiare. Për shembull, nëse njësia ekonomike është njësi mëmë që i kërkohet të përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara, deklarata e qëndrueshmërisë do të jetë për grupin. Kjo kërkesë nuk zbatohet nëse njësia ekonomike raportuese nuk i kërkohet të hartojë pasqyra financiare ose nëse njësia ekonomike raportuese përgatit raportim të konsoliduar për qëndrueshmërinë në përputhje me artikullin 48, germa i të Direktivës 213/34/BE.
63. Informacioni mbi njësinë ekonomike raportuese, i dhënë në **deklaratën e qëndrueshmërisë** duhet të zgjerohet për të përfshirë informacionin mbi **ndikimet, rreziqet** dhe **mundësitë** materiale të lidhura me njësinë ekonomike përmes **marrëdhënieve të saj të biznesit**, të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në rrjedhën e sipërme dhe/ose të poshtme të **zinxhirit të vlerës** ("informacioni mbi zinxhirin e vlerës"). Kur plotëson informacionin mbi njësinë ekonomike raportuese, njësia ekonomike do të përfshijë ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës:
- (a) duke ndjekur rezultatet e procesit të saj të kujdesit të duhur dhe të vlerësimit të saj të **materialitetit**; dhe
  - (b) në përputhje me çdo kërkesë specifike të lidhur me zinxhirin e vlerës në standardet e tjera ESRS.
64. Paragrafi 63 nuk kërkon informacion mbi secilin dhe çdo **aktor në zinxhirin e vlerës**, por vetëm përfshirjen e informacionit material të rrjedhës së sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të vlerës. Çështje të ndryshme të qëndrueshmërisë** mund të jenë materiale në lidhje me pjesë të ndryshme të rrjedhës së sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës të njësisë ekonomike. Informacioni do të plotësohet që të përfshijë informacionin e zinxhirit të vlerës të lidhur vetëm me ato pjesë të zinxhirit të vlerës për të cilat çështja është materiale.
65. Njësia ekonomike do të përfshijë informacionin material të zinxhirit të vlerës kur kjo është e nevojshme për:
- (a) të lejuar përdoruesit e **deklaratave të qëndrueshmërisë** të kuptojnë **ndikimet, rreziqet** dhe **mundësitë** materiale të njësisë ekonomike; dhe/ose
  - (b) të prodhuar një bashkësi informacioni që plotëson karakteristikat cilësore të informacionit (shih Shtojcën B të këtij Standardi).

66. Kur përcaktohet se në cilin nivel brenda veprimtarisë së saj dhe rrjedhës së sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të saj të vlerës mund të shfaqet një çështje materiale e qëndrueshmërisë, njësia ekonomike duhet të përdorë vlerësimin e saj të **ndikimeve**, **reziqeve** dhe **mundësive** duke ndjekur parimin e **materialitetit të dyfishtë** (shih kapitullin 3 të këtij Standardi).
67. Nëse pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkëta, të kontabilizuara sipas metodës së kapitalit neto ose të konsoliduara në mënyrë proporcionale në pasqyrat financiare, janë pjesë e zinxhirit të vlerës të njësisë ekonomike, për shembull si furnizues, njësia ekonomike do të përfshijë informacionin e lidhur me këto pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkëta në përputhje me paragrafin 63 dhe në mënyrë të qëndrueshme me qasjen e përdorur për **marrëdhëniet e tjera të biznesit** në zinxhirin e vlerës. Në këtë rast, kur përcaktohen **metrikat** e ndikimit, të dhënat e pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët, nuk kufizohen në pjesën e zotëruar të kapitalit neto por duhet të merren në konsideratë, bazuar në ndikimet e lidhura me produktet dhe shërbimet e njësisë ekonomike përmes marrëdhënieve të saj të biznesit.

## 5.2 Vlerësimi duke përdorur mesataret e sektorit dhe përafrues (të ngjashëm)

68. Aftësia e njësisë ekonomike për të marrë informacionin e nevojshëm të rrjedhës së sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të vlerës** mund të varet nga faktorë të ndryshëm, të tillë si marrëveshjet kontraktuale të njësisë ekonomike, niveli i kontrollit që ajo ushtron mbi veprimtarinë jashtë objektit të konsolidimit dhe fuqisë së saj blerëse. Nëse njësia ekonomike nuk ka aftësinë për të kontrolluar aktivitete të rrjedhës së sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të saj të vlerës dhe marrëdhëniet e saj të biznesit, marrja e informacionit për zinxhirin e vlerës mund të jetë edhe më sfiduese.
69. Ekzistojnë rrethana në të cilat njësia ekonomike nuk mund të mbledhë informacionin e kërkuar nga paragrafi 63 mbi rrjedhën e sipërme ose të poshtme të **zinxhirit të vlerës** edhe pas bërjes së përpjekjeve të arsyeshme për këtë. Në këto rrethana, njësia ekonomike do të vlerësojë informacionin për t'u raportuar mbi rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës, duke përdorur të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe mbështetës, të tillë si të dhënat mesatare të sektorit dhe përafrues të tjerë.
70. Marrja e informacionit mbi **zinxhirin e vlerës** mund të jetë sfiduese edhe në rastin e NJVM-ve dhe njësive ekonomike të tjera në rrjedhën e sipërme dhe/ose të poshtme të zinxhirit të vlerës që nuk janë objekt i raportimit të qëndrueshëm të kërkuar nga neni 19, germa a dhe neni 29, germa a të Direktivës 2013/34/BE (shih ESRS 2 BP-2 Dhënie informacionesh shpjeguese në rrethana specifike).
71. Për sa i takon **politikave**, **veprimeve** dhe **objektivave**, raportimi i njësisë ekonomike do të përfshijë informacionin e rrjedhës së sipërme dhe/ose të poshtme të **zinxhirit të vlerës** në madhësinë që këto politika, veprime dhe objektiva përfshijnë **aktorët në zinxhirin e vlerës**. Në shumë raste, lidhur me **metrikat**, veçanërisht për çështjet e mjedisit për të cilat gjenden

në dispozicion përafrues, njësia ekonomike mund të jetë në gjendje të plotësojë kërkesat e raportimit pa mbledhur të dhëna nga aktorët në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të saj të vlerës, veçanërisht për NJVM, për shembull kur llogariten emetimet GHG të perimetrit 3 të njësisë ekonomike.

72. Përfshirja e vlerësimeve të bëra duke përdorur të dhënat mesatare të sektorit ose përafrues të tjerë nuk do të rezultojë në informacion që nuk plotëson karakteristikat cilësore të informacionit (shih kapitullin 2 dhe seksionin 7.2 *Burimet e vlerësimit dhe pasiguria e rezultatit të këtij Standardi*).

## 6. Horizonti kohor

### 6.1 Periudha e raportimit

73. Periudha e raportimit për **deklaratën e qëndrueshmërisë** të njësisë ekonomike duhet të jetë në pajtim me atë të pasqyrave financiare të saj.

### 6.2 Lidhja e së shkuarës, të tashmes dhe të ardhmes

74. Njësia ekonomike do të vendosë lidhjet e duhura në **deklaratën e saj të qëndrueshmërisë** mes informacionit retrospektiv dhe parashikues, kur është e rëndësishme, për të garantuar një kuptim të qartë sesi informacioni historik lidhet me informacionet e orientuara nga e ardhmja.

### 6.3 Raportimi i ecurisë kundrejt vitit bazë

75. Viti bazë është data ose periudha referencë historike për të cilën ekziston informacion në dispozicion dhe me të cilin mund të krahasohet në kohë informacioni pasues.
76. Njësia ekonomike do të paraqesë informacion krahasues lidhur me vitin bazë për shumat e raportuara në periudhën aktuale kur raporton zhvillimet dhe ecurinë drejt një objekti, me përjashtim të rastit kur Kërkesa për Dhënie informacionesh shpjeguese përkatëse përkufizon tashmë sesi duhet të raportohet ecuria. Njësia ekonomike mund të përfshijë edhe informacion historik rreth piketave të arritura mes vitit bazë dhe periudhës së raportimit nëse ky informacion është i rëndësishëm.

## 6.4 Përkufizimi i periudhës afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë për qëllime raportimi

77. Kur përgatit **deklaratën e saj të qëndrueshmërisë**, njëسيا ekonomike do të zbatojë intervalet kohore në vijim si fund të periudhës raportuese:
- (a) për periudhën afatshkurtër: periudhën e përdorur nga njëسيا ekonomike si periudhë raportimi në pasqyrat financiare të saj;
  - (b) për periudhën afatmesme: nga fundi i periudhës afatshkurtër të raportimit të përkufizuar në germën (a) deri në 5 vite; dhe
  - (c) për periudhën afatgjatë: më shumë se 5 vite.
78. Njëسيا ekonomike do të përdorë një zberthim shtesë për periudhën afatgjatë nëse **ndikimet** ose **veprimet** priten për një periudhë më të gjatë se 5 vite nëse kjo është e nevojshme për të siguruar informacion të rëndësishëm për përdoruesit të **deklaratave të qëndrueshmërisë**.
79. Nëse kërkohen përcaktime të ndryshme për periudhat afatmesme ose afatgjata, për zëra të caktuar të dhënies së informacioneve shpjeguese në standardet e tjera ESRS, kanë përparësi përkufizimet në ato standarde ESRS.
80. Mund të ekzistojnë rrethana kur përdorimi i periudhave afatmesme ose afatgjata të përkufizuara në paragrafin 77 të rezultojë në informacion jo të rëndësishëm, sepse njëسيا ekonomike përdor një përkufizim të ndryshëm për (i) proceset e saj të identifikimit dhe menaxhimit të **ndikimeve, rreziqeve dhe mundësive** materiale ose (ii) përkufizimin e **veprimeve** dhe vendosjen e **objektivave** të saj. Këto rrethana mund të vijnë për shkak të karakteristikave specifike të industrisë, të tilla si fluksi monetar dhe ciklet e biznesit, kohëzgjatja e pritshme e investimeve kapitale, horizontet kohore përgjatë të cilave përdoruesit e **deklaratave të qëndrueshmërisë** kryejnë vlerësimet e tyre ose horizontet e planifikimit zakonisht të përdorura për vendimmarrje në industrinë e njësisë ekonomike. Në këto rrethana, njëسيا ekonomike mund të përdorë një përkufizim të ndryshëm për periudhën afatmesme dhe/ose afatgjatë (shih ESRS 2 BP-2, paragrafi 9).
81. Referencat për “afatshkurtër”, “afatmesëm” dhe “afatgjatë” në standardet ESRS i referohen horizontit kohor të përkufizuar nga njëسيا ekonomike në përputhje me parashikimet në paragrafët 77 deri në 80.

## 7. Përgatitja dhe paraqitja e informacionit për qëndrueshmërinë

82. Ky kapitull jep kërkesat e përgjithshme për t’u zbatuar kur përgatitet dhe paraqitet informacioni mbi qëndrueshmërinë.

## 7.1 Paraqitja e informacionit krahasues

83. Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues krahasues për periudhën e mëparshme për të gjitha **metrikat** sasiore dhe shumat monetare të paraqitura në periudhën aktuale. Nëse është e rëndësishme për të kuptuar **deklaratën e qëndrueshmërisë** të periudhës aktuale, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues krahasues edhe për paraqitjet përshkruese.
84. Nëse njësia ekonomike raporton informacion krahasues që ndryshon nga informacioni i raportuar në periudhën e mëparshme, ajo do të japë informacion shpjegues për:
- (a) diferencën mes shifrës së raportuar në periudhën e mëparshme dhe shifrës krahasuese të rishikuar; dhe
  - (b) për arsyet e rishikimit të shifrës.
85. Në disa rrethana, nuk është praktike të rregullohen informacionet krahasuese për një ose më shumë periudha paraardhëse për të arritur krahasueshmërinë me periudhën aktuale. Për shembull, mund të mos jenë grumbulluar të dhëna në periudhën (at) paraardhëse në mënyrë që të lejojnë qoftë zbatimin retrospektiv të një përkufizimi të ri të një metrike ose objektivi, qoftë rideklarimin retrospektiv për të korrigjuar një gabim të periudhës paraardhëse, si dhe mund të mos jetë praktike të rikrijohet informacioni (shih ESRS 2 BP-2). Nëse nuk është praktike të rregullohen informacionet krahasuese për një ose më shumë periudha paraardhëse, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt.
86. Nëse një standard ESRS kërkon që njësia ekonomike të paraqesë më shumë se një periudhë krahasuese për një metrikë ose pikë të dhënash, kanë përparësi kërkesat e atij standardi ESRS.

## 7.2 Burimet e vlerësimit dhe pasiguria e rezultatit

87. Nëse **metrikat** sasiore dhe shumat monetare, përfshirë informacionin e rrjedhës së sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të vlerës** (shih kapitullin 5 të këtij Standardi), nuk mund të maten drejtpërdrejt dhe mundet vetëm të vlerësohen, mund të shfaqen pasiguri të matjes.
88. Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për t'u mundësuar përdoruesve të kuptojnë pasiguritë më të rëndësishme që ndikojnë metrikat sasiore dhe shumat monetare të raportuara në deklaratën e saj të qëndrueshmërisë.
89. Përdorimi i supozimeve dhe vlerësimeve të arsyeshme, përfshirë analizën e **skenarit** ose të ndjeshmërisë, është pjesë esenciale në përgatitjen e informacionit të lidhur me qëndrueshmërinë dhe nuk cenon dobinë e atij informacioni, me kushtin që supozimet dhe vlerësimet të jenë përshkruar dhe shpjeguar me kujdes. Edhe një nivel lartë i pasigurisë në matje nuk e pengon me patjetër një supozim ose vlerësim të tillë në sigurimin e informacionit

të dobishëm ose në përmbushjen e karakteristikave cilësore të informacionit (shih Shtojcën B të këtij Standardi).

90. Të dhënat dhe supozimet e përdorura në përgatitjen e deklaratës së qëndrueshmërisë do të jenë në pajtim për sa është e mundur me të dhënat financiare dhe supozimet përkatëse të përdorura në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike.
91. Disa standarde ESRS kërkojnë dhënie informacionesh shpjeguese si shpjegime mbi ngjarje të mundshme të ardhshme që kanë rezultate të pasigurta. Kur gjykon nëse informacioni mbi ngjarje të tilla të mundshme të ardhshme është material, njësia ekonomike do t'u referohet kritereve në Kapitullin 3 të këtij Standardi dhe do të marrë në konsideratë:
- (a) ► **C1 efektet financiare** të parashikueshme të ngjarjeve ◀ (rezultati i mundshëm);
  - (b) ashpërsinë dhe probabilitetin e ndikimeve mbi njerëzit dhe mjedisin, që vijnë nga ngjarjet e mundshme, duke marrë në konsideratë faktorët e ashpërsisë të specifikuar në paragrafin 45; dhe
  - (c) gamën e plotë të rezultateve dhe probabilitetin e rezultateve të mundshme brenda asaj game.
92. Kur vlerëson rezultatet e mundshme, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë të gjitha faktet dhe rrethanat, përfshirë informacionin për rezultatet me probabilitet të ulët dhe me ndikim të lartë, i cili kur grupohet mund të jetë material. Për shembull, njësia ekonomike mund të ekspozohet ndaj ndikimeve ose rreziqeve të ndryshme, secili prej të cilëve mund të shkaktojë të njëjtin tip shqetësimi, të tillë si ndërprerje të **zinxhirit furnizues** të njësisë ekonomike. Informacioni mbi një burim individual rreziku mund të mos jetë material nëse shqetësimi nga ai burim ka pak gjasa të ndodhë. Megjithatë, informacioni mbi rrezikun e grupuar të ndërprerjes së **zinxhirit furnizues** nga të gjitha burimet mund të jetë material (shih ESRS 2 BP-2).

### 7.3 Përditësimi i dhënies së informacioneve shpjeguese mbi ngjarjet pas fundit të periudhës së raportimit

93. Në disa raste, njësia ekonomike mund të marrë informacion pas periudhës së raportimit por para se të miratohet për publikim raporti i drejtimit. Nëse një informacion i tillë siguron evidencë ose qartëson mbi kushtet ekzistuese në fund të periudhës, njësia ekonomike do të përditësojë, kur është e përshtatshme, vlerësimet dhe dhënien e informacioneve shpjeguese lidhur me qëndrueshmërinë nën dritën e informacionit të ri.
94. Nëse ky informacion siguron evidencë ose qartëson mbi transaksionet materiale, ngjarjet dhe kushtet e tjera që shfaqen pas fundit të periudhës raportuese, njësia ekonomike do të sigurojë, kur është e përshtatshme, informacion përshkrues që tregon ekzistencën, natyrën dhe pasojat potenciale të këtyre ngjarjeve pas fundit të vitit.

## 7.4 Ndryshimet në përgatitjen ose paraqitjen e informacionit për qëndrueshmërinë

95. Përkufizimi dhe llogaritja e **metrikave**, përfshirë metrikat e përdorura për të vendosur **objektivat** dhe për të monitoruar ecurinë drejt tyre, do të jetë i qëndrueshëm përgjatë kohës. Njësia ekonomike do të sigurojë shifra krahasuese të riparaqitura, përveçse kur kjo nuk është praktike për t'u bërë (shih ESRS 2 BP-2), nëse ajo ka:
- (a) ripërkufizuar ose zëvendësuar një metrikë ose një objektiv;
  - (b) identifikuar informacion të ri në lidhje me shifrat e vlerësuara dhe të dhëna si informacion shpjegues në periudhën e mëparshme dhe informacioni i ri siguron evidencë për rrethanat që ekzistonin në atë periudhë.

## 7.5 Raportimi i gabimeve të periudhave të mëparshme

96. Njësia ekonomike do të korrigjojë gabimet materiale të periudhave të mëparshme duke riparaqitur shumat krahasuese për periudhën (at) e mëparshme të paraqitur, përveçse kur kjo nuk është praktike për t'u realizuar. Kjo kërkesë nuk shtrihet për periudhat e raportimit para vitit të parë të zbatimit të standardeve ESRS nga njësia ekonomike.
97. Gabimet e periudhës së mëparshme janë harresa dhe pasaktësi në **deklaratën e qëndrueshmërisë** të njësisë ekonomike për një ose më shumë periudha të mëparshme. Gabime të tilla shfaqen nga dështimi në përdorim, ose keqpërdorimi i informacionit të besueshëm që:
- (a) ishte në dispozicion kur autorizohet për publikim raporti i drejtimit, që përfshin deklaratën e qëndrueshmërisë për ato periudha; dhe
  - (b) mund të mendohet në mënyrë të arsyeshme se ishte siguruar dhe marrë në konsideratë në përgatitjen e dhënies së informacioneve shpjeguese lidhur me qëndrueshmërinë në këto raporte.
98. Gabime të tilla përfshijnë: efektet e gabimeve matematikore, të gabimeve në zbatimin e përkufizimeve për **metrikat** ose **objektivat**, pakujdesi ose keqinterpretime të fakteve, si dhe mashtrimin.
99. Gabimet potenciale në periudhën aktuale të zbuluara në atë periudhë korrigjohen para se të miratohet për publikim raporti i drejtimit. Por, ndonjëherë gabimet materiale zbulohen vetëm në një periudhë pasuese.
100. Kur nuk është praktike përcaktimi i efektit të një gabimi në të gjithë periudhat paraardhëse, njësia ekonomike do të rideklarojë informacionin krahasues për të korrigjuar gabimin nga data më e hershme e zbatueshme. Kur jep informacion shpjegues korrigjues për një periudhë të mëparshme, njësia ekonomike nuk do të përdorë retrospektivën as në bërjen e supozimeve

se cilat do të ishin synimet e drejtimit në periudhën e mëparshme dhe as në vlerësimin e shumave të paraqitura në një periudhë të mëparshme. Kjo kërkesë zbatohet për të korrigjuar si dhënien e informacioneve shpjeguese për të shkuarën ashtu edhe për të ardhmen.

101. Korrigjimet e gabimeve dallohen nga ndryshimet në vlerësime. Mund të jetë e nevojshme të rishihen vlerësimet, kur vihet në dispozicion informacion shtesë (shih ESRS 2 BP-2).

## 7.6 Raportimi i konsoliduar dhe përjashtimi për filialin

102. Nëse njësi ekonomike raporton në një nivel të konsoliduar, ajo do të kryejë vlerësimin e saj për **ndikimet**, **rreziqet** dhe **mundësitë** materiale për të gjithë grupin e konsoliduar, pavarësisht strukturës ligjore të grupit të saj. Ajo duhet të sigurojë që të gjitha filialet të mbulohen në një mënyrë që lejon identifikimin e paanshëm të ndikimeve, rreziqeve dhe mundësitë materiale. Kriteret dhe pragjet për vlerësimin si material të një ndikimi, rreziku ose mundësie do të përcaktohen bazuar në kapitullin 3 të këtij Standardi.
103. Kur njësi ekonomike konstaton diferenca të rëndësishme mes **ndikimeve**, **rreziqeve** apo **mundësive** materiale në nivel grupi dhe ndikimeve, rreziqeve apo mundësive materiale të një ose më shumë filialeve të saj, njësi ekonomike do të japë një përshkrim të përshtatshëm të ndikimeve, rreziqeve dhe mundësive, sipas rastit, të filialit ose filialeve përkatëse.
104. Kur vlerëson nëse diferencat mes **ndikimeve**, **rreziqeve** ose **mundësive** materiale në nivel grupi dhe ndikimeve, rreziqeve ose mundësive materiale të një ose disa filialeve të saj janë të rëndësishme, njësi ekonomike mund të marrë në konsideratë rrethana të ndryshme, të tilla si nëse filiali ose filialet veprojnë në sektorë të ndryshëm nga pjesa tjetër e grupit ose rrethanat e pasqyruara në seksionin 3.7 *Niveli i shpërndarjes*.

## 7.7 Informacioni i klasifikuar, informacioni i ndjeshëm, si dhe informacioni mbi pronësinë intelektuale, njohuritë ose rezultatet e novacionit

105. Njësisë ekonomike nuk i kërkohet të japë si informacion shpjegues **informacion të klasifikuar** ose **informacion të ndjeshëm**, edhe nëse ky informacion konsiderohet material.
106. Kur jep informacion shpjegues mbi **strategjinë** e saj dhe **veprimet**, nëse një pjesë e caktuar e informacionit që përkon me pronësinë intelektuale, njohuritë ose rezultatet e novacionit është e rëndësishme për të plotësuar objektivin e një Kërkese për Dhënie informacionesh shpjeguese, njësi ekonomike mund të mos e paraqesë atë pjesë specifike të informacionit nëse:
- (a) ai është sekret në kuptimin që nuk është, as i gjithi as një pjesë e caktuar e konfigurimit dhe e bashkuar me përbërësit e tjerë, zakonisht i njohur ose gati në dispozicion për personat brenda rrjetit që zakonisht merren me llojin e informacionit në fjalë;

- (b) ka vlerë tregtare sepse është sekret; dhe
- (c) ka qenë objekt i hapave të rëndësishëm nga njësi ekonomike për t'u mbajtur sekret.

107. Nëse njësi ekonomike heq **informacionin e klasifikuar** ose **informacionin e ndjeshëm (delikat)**, ose një pjesë të caktuar të informacionit që përkon me pronësinë intelektuale, njohuritë ose rezultatet e novacionit sepse plotëson kriterin e vendosur në paragrafin e mësipërm, ajo do të plotësojë kërkesën për dhënie informacionesh shpjeguese në fjalë duke paraqitur të gjithë informacionin tjetër të kërkuar.
108. Njësi ekonomike do të bëjë çdo përpjekje të arsyeshme për të siguruar që përveç heqjes së **informacionit të klasifikuar** ose **të informacionit të ndjeshëm (delikat)** ose të pjesës specifike të informacionit që përkon me pronësinë intelektuale, njohuritë ose rezultatet e novacionit, të mos cenohet përkatësia e përgjithshme e dhënies së informacioneve shpjeguese në fjalë.

## 7.8 Raportimi mbi mundësitë

109. Kur raportohet mbi **mundësitë**, dhënia e informacioneve shpjeguese duhet të jetë përshkruese për të lejuar lexuesin të kuptojë mundësinë për njësinë ekonomike apo për të gjithë sektorin. Kur raportohet mbi mundësitë, njësi ekonomike do të marrë në konsideratë **materialitetin** e informacionit që do të paraqitet. Në këtë kontekst, ajo do të marrë në konsideratë mes faktorëve të tjerë:
- (a) nëse mundësia aktualisht po ndiqet dhe është përfshirë në strategjinë e përgjithshme të saj, kundrejt një mundësie të përgjithshme për njësinë ekonomike ose sektorin; dhe
  - (b) nëse përfshirja e matësve sasiore të **efekteve financiare të parashikuara** është e përshtatshme, duke marrë në konsideratë numrin e supozimeve që mund të nevojiten dhe pasigurinë pasuese.

## 8. Struktura e deklaratës së qëndrueshmërisë

110. Ky kapitull siguron bazën për paraqitjen e informacionit mbi **çështjet e qëndrueshmërisë** të përgatitur në përputhje me nenin 19, germa a dhe nenin 29, germa a të Direktivës 2013/34/BE (d.m.th. **deklarata e qëndrueshmërisë**) brenda raportit të drejtimit të njësisë ekonomike. Ky informacion paraqitet në një seksion të dedikuar të raportit të drejtimit të identifikuar si deklarata e qëndrueshmërisë. Shtojca F *Shembull i strukturës së deklaratës të qëndrueshmërisë* e këtij Standardi ofron një shembull ilustrues të një deklarate të qëndrueshmërisë të strukturuar në përputhje me kërkesat e këtij kapitulli.

### 8.1 Kërkesa të përgjithshme për paraqitjen

111. Informacioni mbi qëndrueshmërinë do të paraqitet:

- (a) Në një mënyrë që lejon një dallim mes informacionit të kërkuar nga dhënia e informacioneve shpjeguese në standardet ESRS dhe informacionit tjetër të përfshirë në raportin e drejtimit; dhe
- (b) Sipas një strukture që lehtëson përdorimin dhe kuptimin e **deklaratës së qëndrueshmërisë**, në një format që mund të lexohet si nga njerëzit edhe nga makinat.

## 8.2 Përmbajtja dhe struktura e deklaratës së qëndrueshmërisë

112. Me përjashtim të mundësisë për të përfshirë informacionin si referencë në përputhje me seksionin 9.1 *Përfshirja me referencë* të këtij Standardi, njësia ekonomike do të raportojë të gjitha dhëniet e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga standardet ESRS në përputhje me kapitullin 1 të këtij Standardi, brenda një seksioni të dedikuar të raportit të drejtimit.
113. Njësia ekonomike do të përfshijë në **deklaratën e saj të qëndrueshmërisë** dhënien e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga neni 8 i Rregullores (BE) 2020/852 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit<sup>10</sup> dhe të Rregulloreve të Deleguara të Komisionit që specifikojnë përmbajtjen dhe mënyrat e tjera të dhënies së informacioneve shpjeguese. Njësia ekonomike do të sigurojë që këto dhënie informacionesh shpjeguese të jenë të identifikueshme veçmas brenda deklaratës së qëndrueshmërisë. Dhëniet e informacioneve shpjeguese që lidhen me secilin prej objektivave të mjedisit të përkufizuar në Rregulloren e Taksonomisë do të paraqiten së bashku në një pjesë të identifikueshme qartë të seksionit për mjedisin të deklaratës së qëndrueshmërisë. Këto dhënie informacionesh shpjeguese nuk janë objekt i parashikimeve të standardeve ESRS, me përjashtim të këtij paragrafi dhe fjalisë së parë të paragrafit 115 të këtij standardi.
114. Nëse njësia ekonomike përfshin në **pasqyrën e saj të qëndrueshmërisë** informacione shtesë që rrjedhin nga (i) legjislacion tjetër që i kërkon njësisë ekonomike të publikojë informacion mbi qëndrueshmërinë, ose (ii) standardet përgjithësisht të pranura dhe kuadrot e raportimit të qëndrueshëm, përfshirë udhëzuesit jo të detyrueshëm dhe udhëzuesit sipas sektorëve, të publikuar në organe të tjera që vendosin standardet (të tillë si materialet teknike të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Qëndrueshmërisë ose Nisma Globale e Raportimit), këto dhënie informacionesh shpjeguese do të:
- (a) identifikohen qartë me një referencë të përshtatshme me legjislacionin, standardin ose kuadrin (shih ESRS 2 BP-2, paragrafi 15);
  - (b) plotësojnë kërkesat për karakteristikat cilësore të informacionit të specifikuar në kapitullin 2 dhe Shtojcën B të këtij standardi.
115. Njësia ekonomike do të strukturojë **deklaratën e saj të qëndrueshmërisë** në katër pjesë, sipas rendit në vijim: informacion i përgjithshëm, informacion për mjedisin (përfshirë dhënien e

---

<sup>10</sup> Rregullorja (BE) 2020/852 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 18 qershorit 2020 mbi krijimin e një kuadri për të lehtësuar investimin e qëndrueshëm dhe ndryshimin e Rregullores (BE) 2019/2088 (GZ L 198, 22.6.2020, f. 13).

informacioneve shpjeguese të kërkuara nga neni 8 i Rregullores (BE) 2020/852), informacion për shoqërinë dhe informacion për qeverisjen. Respektimi i parashikimeve në seksionin 3.6 *Ndikimet ose rreziqet materiale që shfaqen nga veprimet për të trajtuar çështjet e qëndrueshmërisë* të këtij Standardi, nëse informacioni i dhënë në një pjesë përmban informacion që duhet të raportohet në një pjesë tjetër, njësia ekonomike mund të shmangë dublimin duke iu referuar njëres pjesë me informacionin e paraqitur në pjesën tjetër. Njësia ekonomike mund të zbatojë strukturën e hollësishme të ilustruar në Shtojcën F të këtij Standardi.

116. Dhëniet e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga standardet ESRS sipas sektorit specifik do të grupohen sipas zonave të raportimit dhe, sipas rastit, sipas temës së qëndrueshmërisë. Ato do të paraqiten së bashku me dhëniet e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga ESRS 2 dhe standardet përkatëse të ESRS sipas temës.
117. Nëse njësia ekonomike zhvillon dhënie informacionesh shpjeguese materiale specifike për njësinë, në përputhje me paragrafin 11, ajo do të raportojë këto dhënie informacionesh shpjeguese së bashku me dhëniet e informacioneve shpjeguese më të rëndësishme që nuk varen nga sektori dhe ato që lidhen me sektorin specifik.

## 9. Lidhja me pjesët e tjera të raportimit të shoqërisë dhe informacionit përkatës

118. Njësia ekonomike do të sigurojë informacion që u mundëson përdoruesve të **deklaratës së saj të qëndrueshmërisë** të kuptojnë lidhjen mes pjesëve të ndryshme të informacionit në deklaratë, si dhe lidhjet mes informacionit në deklaratën e qëndrueshmërisë dhe informacionit tjetër që njësia ekonomike paraqet në pjesët e tjera të raportimit të saj si shoqëri.

### 9.1 Përfshirja me referencë

119. Me kushtin që të plotësohen kriteret në paragrafin 120, informacioni i përshkruar nga një Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese e një standardi ESRS, përfshirë një pikë të dhënash specifike të përshkruar nga një Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese, mund të përfshihet në **deklaratën e qëndrueshmërisë** duke iu referuar me:
- (a) një seksion tjetër të raportit të drejtimit;
  - (b) pasqyrat financiare;
  - (c) deklaratën e qeverisjes së shoqërisë (nëse nuk është pjesë e raportit të drejtimit);

- (d) raportin e shpërblimit të kërkuar nga Direktiva 2007/36/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit;<sup>11</sup>
- (e) dokumentin universal të regjistrimit, siç përcaktohet në nenin 9 të Rregullores (BE) 2017/119;<sup>12</sup> dhe
- (f) dhëniet e informacioneve shpjeguese publike sipas Rregullores (BE) Nr 575/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (Shtylla 3 e dhënies së informacioneve shpjeguese).<sup>13</sup> Nëse njësi ekonomike përfshin me referencë informacionin nga Shtylla 3 e dhënies së informacioneve shpjeguese, ajo do të sigurojë që informacioni përputhet me objektin e konsolidimit të përdorur në **deklaratën e qëndrueshmërisë** duke plotësuar informacionin e përfshirë me elementët shtesë sipas nevojës.

120. Njësia ekonomike mund të përfshijë informacion duke iu referuar dokumenteve ose pjesës së dokumenteve të renditur në paragrafin 119, me kushtin që dhënia e informacioneve shpjeguese të përfshira me referencë:

- (a) të përbëjë një element të veçantë të informacionit dhe të jetë e identifikuar qartë në dokumentin në fjalë që trajton kërkesën përkatëse për dhënie informacionesh shpjeguese, ose pikën përkatëse të të dhënave specifike të përshkruar nga një Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese;
- (b) të publikohet para ose në të njëjtën kohë si raporti i drejtimit;
- (c) të jetë në të njëjtën gjuhë si dhe **deklarata e qëndrueshmërisë**;
- (d) të jetë objekt i të paktën të njëjtit nivel sigurie si deklarata e qëndrueshmërisë; dhe
- (e) plotëson të njëjtat kërkesa teknike të digjitalizimit si dhe deklarata e qëndrueshmërisë.

121. Me kushtin që të plotësohen kriteret në paragrafin 120, informacioni i përshkruar nga një Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese e një standardi ESRS, përfshirë një pikë të dhënash specifike të përshkruar nga një Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese, mund të përfshihet në **deklaratën e qëndrueshmërisë** me referencë ndaj raportit të njësisë ekonomike të përgatitur në përputhje me Rregulloren (BE) Nr 1221/2009 për Skemën e Menaxhimit Ekologjik dhe të Auditimit të BE (EMAS).<sup>14</sup> Në këtë rast, njësi ekonomike do të sigurojë se informacioni i përfshirë me referencë prodhohet duke përdorur të njëjtën bazë të përgatitjes së informacionit sipas standardeve ESRS, përfshirë objektin e konsolidimit dhe trajtimin e informacionit për **zinxhirin e vlerës**.

<sup>11</sup> Direktiva 2007/36/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 korrikut 2007 mbi ushtrimin e disa të drejtave nga aksionarët në shoqëritë e kuotuar (GZ L 184, 14.7.2007, f. 17).

<sup>12</sup> Rregullorja (BE) 2017/1129 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 14 qershorit 2017 mbi prospektin për tu publikuar kur letrat me vlerë i ofrohen publikut ose pranohen për tregtim në një treg të rregulluar dhe shfuqizimi i Direktivës 2003/71/KE (GZ L 168, 30.6.2017, f. 12).

<sup>13</sup> Rregullorja (BE) Nr 575/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 26 qershorit 2013 mbi kërkesat për kujdesin e institucioneve të kredisë dhe shoqërive të investimit dhe ndryshoi Rregulloren (BE) 648/2012 (GZ L 176, 27.6.2013, f. 1).

<sup>14</sup> Rregullorja (KE) Nr 1221/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 25 Nëntorit 2009 mbi pjesëmarrjen vullnetare të organizatave në një skemë komunitare të menaxhimit ekologjik dhe auditimit (EMAS), duke shfuqizuar Rregulloren (KE) Nr 761/2001 Vendimet e Komisionit 2001/681/KE dhe 2006/193/KE (GZ L 342, 22.12.2009, f. 1).

122. Kur përgatit **deklaratën e saj të qëndrueshmërisë** duke përdorur përfshirjen me referencë, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë kohezionin e përgjithshëm të informacionit të raportuar dhe do të sigurojë që përfshirja me referencë nuk cenon leximin e qartë të deklaratës së qëndrueshmërisë. Shtojca G *Shembull i përfshirjes me referencë* e këtij Standardi është një shembull ilustrues i përfshirjes me referencë (shih ESRS 2 BP-2).

## 9.2 Informacioni i lidhur dhe lidhja me pasqyrat financiare

123. Njësia ekonomike do të përshkruajë marrëdhëniet mes pjesëve të informacionit. Kjo mund të kërkojë lidhjen e informacionit përshkrues mbi qeverisjen, strategjinë dhe menaxhimin e rrezikut të lidhur me **metrikat** dhe **objektivat**. Për shembull, kur sigurohet informacioni i lidhur, njësia ekonomike mund të ketë nevojë të shpjegojë efektin e strategjisë së saj ose efektin e mundshëm në pasqyrat financiare të saj ose planet financiare, ose të shpjegojë sesi strategjia e saj lidhet me metrikat dhe objektivat e përdorura për të matur ecurinë kundrejt performancës. Për më tepër, njësia ekonomike mund të duhet të shpjegojë sesi përdorimi i saj i **burimeve natyrore** dhe ndryshimeve brenda **zinxhirit të saj furnizues** mund të rrisë, ndryshojë ose pakësojë **ndikimet, rreziqet** dhe **mundësitë** e saj. Mund të jetë e nevojshme që ta lidhë këtë informacion me informacionin mbi efektet financiare aktuale ose të parashikuara mbi kostot e saj të prodhimit, me përgjigjen e strategjisë së saj për zbutjen e ndikimeve ose rreziqeve të tilla, si dhe investimin e saj përkatës në aktive të reja. Njësia ekonomike mund të duhet të lidhë informacionin përshkrues me metrikat dhe objektivat përkatës dhe me informacionin në pasqyrat financiare. Informacioni që përshkruan lidhjet duhet të jetë i qartë dhe i përmbledhur.

124. Nëse **deklarata e qëndrueshmërisë** përfshin shuma monetare dhe pika të tjera të dhënash sasiore që kapërcejnë një prag të **materialitetit** dhe që janë paraqitur në pasqyrat financiare (lidhje e drejtpërdrejtë mes informacionit të paraqitur në deklaratën e qëndrueshmërisë dhe informacionin e paraqitur në pasqyrat financiare), njësia ekonomike do të përfshijë një referencë në paragrafin përkatës të pasqyrave financiare të saj ku mund të gjendet informacioni përkatës.

125. **Deklarata e qëndrueshmërisë** mund të përfshijë shuma monetare ose pika të tjera të dhënash sasiore që kapërcejnë një prag të **materialitetit** dhe që janë ose një grupim, apo një pjesë e tij, i shumave monetare ose të të dhënave sasiore të paraqitura në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike (lidhja e tërthortë mes informacionit të paraqitur në deklaratën e qëndrueshmërisë dhe informacionit të paraqitur në pasqyrat financiare). Nëse ndodh ky rast, njësia ekonomike do të shpjegojë sesi këto shuma ose pika të dhënash në deklaratën e qëndrueshmërisë lidhen me shumat më të rëndësishme në pasqyrat financiare. Kjo dhënie informacionesh shpjeguese do të përfshijë një referencë me nënzërin dhe/ose paragrafët përkatës të pasqyrave financiare të saj ku mund të gjendet informacioni përkatës. Sipas rastit, mund të jepet një përmbledhje e cila mund të paraqitet në formë tabele.

126. Në rastin e informacionit jo të mbuluar nga paragrafët 124 dhe 125, njësia ekonomike do të shpjegojë, bazuar në një prag materialiteti, qëndrueshmërinë e të dhënave, supozimeve dhe informacionit cilësor kryesor në **deklaratën e saj të qëndrueshmërisë** me të dhënat, supozimet dhe informacionin cilësor përkatës të përfshirë në pasqyrat financiare. Kjo mund të ndodhë kur deklarata e qëndrueshmërisë përfshin:
- (a) shuma monetare ose të dhëna sasiore të tjera të lidhura me shumën monetare ose të dhënat sasiore të tjera të paraqitura në pasqyrat financiare; ose
  - (b) informacion cilësor të lidhur me informacionin cilësor të paraqitur në pasqyrat financiare.
127. Qëndrueshmëria që kërkohet nga paragrafi 126 do të jetë në nivelin e një pike të vetme të dhënash dhe do të përfshijë një referencë për nënzërin ose paragrafin përkatës në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Nëse të dhënat, supozimet dhe informacioni cilësor kryesor nuk janë të qëndrueshme, njësia ekonomike do të deklarojë këtë fakt dhe do të shpjegojë arsyen.
128. Shembujt e zërave për të cilët kërkohet sqarimi në paragrafin 126, janë:
- (a) kur e njëjta metrikë paraqitet si në datën e raportimit në pasqyrat financiare dhe si një parashikim për periudhat e ardhshme në **deklaratën e qëndrueshmërisë**; dhe
  - (b) kur parashikimet makroekonomike ose të biznesit përdoren për të zhvilluar **metrikat** në **deklaratën e qëndrueshmërisë** dhe ato janë njëkohësisht të rëndësishme në vlerësimin e shumës së rikuperueshme të aktiveve, shumës së detyrimeve ose të provizioneve në pasqyrat financiare.
129. Standardet ESRS sipas temës dhe sipas sektorëve mund të përmbajnë kërkesa për të përfshirë përmbledhje ose për të ilustruar qëndrueshmërinë e të dhënave dhe të supozimeve për Kërkesa specifike për Dhënie informacionesh shpjeguese. Në të tilla raste, kanë përparësi kërkesat në ato standarde ESRS.

## 10. Dispozita kalimtare

### 10.1 Dispozita kalimtare lidhur me dhënie informacionesh shpjeguese specifike për njësinë ekonomike

130. Madhësia në të cilën **çështjet materiale** mbulohen nga standardet ESRS pritet të evoluojë me zhvillimin e mëtejshëm të Kërkesave për Dhënie informacionesh shpjeguese. Prandaj, nevoja për dhënie informacionesh shpjeguese specifike për njësinë ekonomike ka gjasa të zvogëlohet në kohë, veçanërisht si pasojë e zbatimit në të ardhmen të standardeve specifike sipas sektorëve.

131. Kur përcakton dhënien e informacioneve shpjeguese specifike për njësinë ekonomike, njësia mund të zbatojë masa të përkohshme për përgatitjen e tyre në tre **deklaratat e qëndrueshmërisë** vjetore të parat, sipas të cilave mundet që si prioritet:
- (a) të përfshijë në raportimin e saj ato dhënie informacionesh shpjeguese specifike për njësinë ekonomike, nëse këto informacione plotësojnë ose janë përshtatur për të plotësuar karakteristikat cilësore të informacionit të referuara në kapitullin 2 të këtij Standardi; dhe
  - (b) të plotësojë dhëniet e saja të informacioneve shpjeguese të përgatitura në bazë të standardeve ESRS sipas temës me një bashkësi të përshtatshme të informacioneve shtesë për të mbuluar **çështje të qëndrueshmërisë** që janë materiale për njësinë ekonomike në sektorin (ët) e saj, duke përdorur praktikën më të mirë në dispozicion dhe/ose kuadrot e referimit ose standardet e raportimit në dispozicion, të tilla si udhëzuesin e SNRF-ve sipas sektorëve dhe Standardet sipas Sektorëve të Nismës Globale të Raportimit (GRI).

## 10.2 Dispozita kalimtare lidhur me kapitullin 5 Zinxhiri i vlerës

132. Për 3 vitet e para të raportimit të qëndrueshëm të njësisë ekonomike sipas standardeve ESRS, në rast se nuk disponohet i gjithë informacioni i nevojshëm lidhur me rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të vlerës**, njësia ekonomike do të shpjegojë përpjekjet e bëra për të marrë informacionin e nevojshëm mbi rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës, arsyet pse nuk mund të merret i gjithë informacioni i nevojshëm, si dhe planet e saj për të marrë informacionin e nevojshëm në të ardhmen.
133. Për 3 vitet e para të raportimit të saj për qëndrueshmërinë sipas standardeve ESRS, me qëllim që të marrë në konsideratë vështirësitë që njësia ekonomike mund të ndeshë në mbledhjen e informacionit nga aktorët përmes **zinxhirit të tyre të vlerës** dhe me qëllim kufizimin e ngarkesës për NJVM-të në zinxhirin e vlerës:
- (a) kur jep informacion shpjegues mbi **politikat, veprimet** dhe **objektivat** në përputhje me ESRS 2 dhe standardet e tjera ESRS, njësia ekonomike mund të kufizojë informacionin mbi rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës në dispozicion nga brenda, të tilla si të dhëna tashmë gati në dispozicion për njësinë ekonomike dhe informacion në dispozicion i publikuar; dhe
  - (b) kur jep informacion shpjegues mbi **metrikat**, njësisë ekonomike nuk i kërkohet të përfshijë informacion për rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës, me përjashtim të pikave të të dhënave të nxjerra nga legjislacioni tjetër i BE, siç renditet në Shtojcën B të ESRS 2.
134. Paragrafët 132 dhe 133 zbatohen pavarësisht nëse **aktori përkatës në zinxhirin e vlerës** është një NJVM.

135. Duke filluar nga viti i katërt i raportimit të saj sipas standardeve ESRS, njësia ekonomike do të përfshijë informacionin mbi rrjedhën e sipërme dhe/ose të poshtme të **zinxhirit të vlerës** në përputhje me paragrafin 63. Në këtë kontekst, informacioni i kërkuar nga standardet ESRS, për t'u marrë nga njësitet ekonomike NJVM në rrjedhën e sipërme dhe/ose të poshtme të zinxhirit të vlerës të njësitet ekonomike nuk do të tejkalojë përmbajtjen e standardeve të ardhshme ESRS për NJVM të renditura.

### 10.3 Dispozita kalimtare lidhur me seksionin 7.1 Paraqitja e informacionit krahasues

136. Për të lehtësuar zbatimin për herë të parë të këtij Standardi, njësisë ekonomike nuk i kërkohet të japë informacionin shpjegues krahasues të kërkuar nga seksioni 7.1 *Paraqitja e informacionit krahasues* në vitin e parë të përgatitjes së **deklaratës së qëndrueshmërisë** sipas standardeve ESRS. Për kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të renditura në Shtojcën C *Lista e vënies graduale në zbatim të Kërkesave për Dhënie informacionesh shpjeguese*, kjo dispozitë kalimtare zbatohet duke iu referuar vitit të parë të zbatimit të detyrueshëm të kërkesës për dhënie informacionesh shpjeguese graduale.

### 10.4 Dispozita kalimtare: Lista e Kërkesave për Dhënie informacionesh shpjeguese që janë vendosur për zbatim gradual

137. Shtojca C *Lista e vënies graduale në zbatim të Kërkesave për Dhënie informacionesh shpjeguese* në këtë Standard, paraqet dispozitat graduale për Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese ose pikat e të dhënave për vënie graduale në zbatim të Kërkesave për Dhënie informacionesh shpjeguese sipas standardeve ESRS që mund të hiqen ose që nuk janë të zbatueshme në vitin(et) e parë të përgatitjes së **deklaratës së qëndrueshmërisë** sipas standardeve ESRS.

## Shtojca A. Kërkesat për Zbatim

Kjo shtojcë është një pjesë integrale e ESRS 1 dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të Standardit.

### Dhënia e informacioneve shpjeguese specifike për njësinë ekonomike

- AR 1. Dhënia e informacioneve shpjeguese specifike për njësinë ekonomike do t'u mundësojë **përdoruesve** të kuptojnë **ndikimet**, **rreziqet** dhe **mundësitë** e lidhura me çështjet e mjedisit, shoqërisë ose të qeverisjes.

- AR 2. Kur zhvillon dhënie informacionesh shpjeguese specifike për njësinë ekonomike, ajo do të sigurojë që:
- (a) dhënia e informacioneve shpjeguese plotëson karakteristikat cilësore të informacionit të paraqitura në kapitullin 2 *Karakteristikat cilësore të informacionit*; dhe
  - (b) dhëniet e saj të informacioneve shpjeguese përfshijnë, sipas rastit, të gjithë informacionin material të lidhur me zonat e raportimit të qeverisjes; strategjia; menaxhimi i **ndikimit**, **rreziqut** dhe **mundësisë**; si dhe **metrikat** dhe **objektivat** (shih ESRS 2 kapitujt 2 deri në 5).
- AR 3. Kur përcakton dobinë e **metrikave** për përfshirjen në dhëniet e informacioneve shpjeguese specifike për njësinë ekonomike, ajo do të marrë në konsideratë nëse:
- (a) metrika e zgjedhur prej saj për performancën siguron qartësi mbi:
    - i. sa efektive janë praktikat e saj në pakësimin e rezultateve negative dhe/ose në rritjen e rezultateve pozitive për njerëzit dhe mjedisin (për ndikimet); dhe/ose
    - ii. mundësinë që praktikat e saj të sjellin **efekte financiare** mbi njësinë ekonomike (për **rreziqet** dhe **mundësitë**);
  - (b) rezultatet e matura janë mjaftueshëm të besueshme, që do të thotë se ato nuk përfshijnë një numër të tepërt supozimesh dhe të panjohurash që do t'i bënin metrikat shumë arbitrare për të siguruar një paraqitje besnike; dhe
  - (c) ka siguruar mjaftueshëm informacion konteksti për të interpretuar si duhet metrikat e performancës, si dhe nëse ndryshimet në këtë informacion konteksti mund të ndikojnë krahasueshmërinë e metrikave në kohë.
- AR 4. Kur zhvillon dhëniet e saj të informacioneve shpjeguese specifike për njësinë ekonomike, ajo do të marrë në konsideratë me kujdes:
- (a) krahasueshmërinë mes njërive ekonomike, duke siguruar ndërkohë përkatësinë e informacionit të dhënë, duke pranuar që krahasueshmëria mund të jetë e kufizuar për dhënien e informacioneve shpjeguese specifike për njësinë ekonomike. Njësia ekonomike do të marrë në konsideratë nëse kuadrot e referimit, nismat, standardet e raportimit dhe standardet e krahasimit, në dispozicion dhe përkatës (të tillë si materiali teknik i publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Qëndrueshmërisë ose Nisma Globale e Raportimit) sigurojnë elementë që mund të mbështesin krahasueshmërinë në maksimumin e mundshëm; dhe
  - (b) krahasueshmëria në kohë: qëndrueshmëria e metodologjive dhe dhënies së informacioneve shpjeguese është një faktor kyç për arritjen e krahasueshmërisë në kohë.
- AR 5. Udhëzime shtesë për zhvillimin e dhënies së informacioneve shpjeguese specifike për njësinë ekonomike mund të gjenden duke marrë në konsideratë informacionin e kërkuar sipas standardeve ESRS sipas temave që trajtojnë **çështje të qëndrueshmërisë** të ngjashme.

## Materialiteti i dyfishtë

### *Palët e interesuara dhe rëndësia e tyre në procesin e vlerësimit të materialitetit*

- AR 6. Përveç kategorive të palëve të interesuara të renditura në paragrafin 22, kategori të zakonshme të **palëve të interesuara** janë: **punonjësit** dhe të punësuar të tjerë, **furnitorët, konsumatorët, klientët, përdoruesit fundorë**, komunitetet lokale dhe njerëzit në situata të vështira, si dhe autoritetet publike, përfshirë rregullatorët, mbikëqyrësit dhe bankat qendrore.
- AR 7. Natyra mund të konsiderohet si një **palë e interesuar** e heshtur. Në këtë rast, të dhënat ekologjike dhe të dhënat mbi mbrojtjen e specieve mund të mbështesin vlerësimin e **materialitetit** të njësisë ekonomike.
- AR 8. Dialogu me palët e interesuara kontribuon në vlerësimin e **materialitetit**. Njësia ekonomike mund të angazhohet me **palët e interesuara** të ndikuara ose përfaqësuesit e tyre (të tillë si **punonjësit** ose sindikatat), së bashku me përdoruesit e raportimit të qëndrueshmërisë dhe ekspertë të tjerë, për të siguruar inpute ose komente mbi përfundimet e saj lidhur me **ndikimet, rreziqet** dhe **mundësitë** materiale të saj.

### *Vlerësimi për materialitetin e ndikimit*

- AR 9. Kur vlerëson **materialitetin e ndikimit** dhe përcakton çështjet materiale për t'u raportuar, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë tre hapat në vijim:
- të kuptojë kontekstin lidhur me ndikimet e saj, përfshirë aktivitetet, marrëdhëniet e biznesit dhe **palët e interesuara** të saj;
  - identifikimin e ndikimeve aktuale dhe potenciale (negative dhe pozitive), përfshirë angazhimin me palë të interesuara dhe ekspertët. Në këtë hap, njësia ekonomike mund të mbështetet në kërkimin shkencor dhe analitik mbi ndikimet në **çështjet e qëndrueshmërisë**;
  - vlerësimi i materialitetit të ndikimeve të saj aktuale dhe potenciale dhe përcaktimi i çështjeve materiale. Në këtë hap, njësia ekonomike do të përdorë pragje për të përcaktuar se cilat ndikime do të mbulohen në **deklaratën e saj të qëndrueshmërisë**.

### *Karakteristikat e ashpërsisë*

- AR 10. Ashpërsia përcaktohet nga faktorët në vijim:

- shkalla: sa i ashpër është ndikimi negativ ose sa përfitues është ndikimi pozitiv për njerëzit ose mjedisin;
- objekti: sa të përhapur janë ndikimet negative ose pozitive. Në rastin e ndikimeve mjedisore, objekti mund të kuptohet si madhësia e dëmit mjedisor ose një perimetër gjeografik. Në rastin e ndikimeve mbi njerëzit, objekti mund të kuptohet si numri i njerëzve të ndikuar negativisht; dhe

(c) karakteri i pakthyeshëm: nëse dhe sa ndikimet negative mund të rregullohen, d.m.th. rikthimi i mjedisit ose njerëzve të ndikuar në gjendjen e mëparshme.

AR 11. Secila prej tri karakteristikave (shkalla, objekti dhe karakteri i pakthyeshëm) mund ta bëjnë një ndikim negativ të ashpër. Në rast të ndikimit negativ potencial në të drejtat e njeriut, ashpërsia e ndikimit merr përparësi ndaj probabilitetit të ndodhjes së tij.

#### *Ndikimet e lidhura me njësinë ekonomike*

AR 12. Shembull:

- (a) nëse njësia ekonomike përdor kobaltin në produktet e saj, i cili nxirret nga miniera që përdorin punën e fëmijëve, ndikimi negativ (d.m.th. puna e fëmijëve) lidhet me produktet e njësisë ekonomike përmes ndërmjetësimit të **marrëdhënieve të biznesit** në rrjedhën e sipërme të zinxhirit të saj të vlerës. Këto marrëdhënie përfshijnë marrëdhëniet me njësinë e fonderisë dhe tregtarin e mineraleve, si dhe shoqërinë e minierës që përdor punën e fëmijëve; dhe
- (b) nëse njësia ekonomike i jep hua financiare një shoqërie për aktivitetet e biznesit që, duke thyer standardet e rëna dakord, ndot ujërat dhe terrenin për qark veprimtarisë, ky ndikim negativ lidhet me njësinë ekonomike përmes marrëdhënies së saj me shoqërinë të cilës i jep hua.

#### *Vlerësimi për materialitetin financiar*

AR 13. Shembujt në vijim tregojnë sesi ndikimet dhe **varësitë** janë burime të **rreziqeve** ose të **mundësive**:

- (a) nëse **modeli i biznesit** i njësisë ekonomike varet nga një burim natyror – për shembull uji – ka mundësi që të ndikohet nga ndryshimet në cilësinë, në përdorimin dhe në çmimin e atij burimi;
- (b) nëse aktivitetet e njësisë ekonomike sjellin ndikime negative, p.sh. në komunitetet lokale, aktivitetet mund të jenë objekt i rregullimeve të forta nga qeveria dhe/ose ndikimi mund të prodhojë pasoja në prestigj. Këto mund të kenë efekte negative në markën e njësisë ekonomike dhe mund të shfaqen rritje në kostot e punësimit; dhe
- (c) nëse partnerët e biznesit të njësisë ekonomike përballen me rreziqe të lidhura me qëndrueshmërinë, ajo gjithashtu mund të ekspozohet ndaj pasojave përkatëse.

AR 14. Identifikimi i **rreziqeve** dhe **mundësive** që ndikojnë ose mund të pritët në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë pozicionin financiar, performancën financiare, flukset monetare, përdorimin e financimit ose koston e kapitalit të njësisë ekonomike për periudha afatshkurtra, afatmesme ose afatgjata, është pikënisja për vlerësimin e **materialitetit financiar**. Në këtë kontekst, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë:

(a) ekzistencën e **varësive** ndaj burimeve natyrore dhe shoqërore si burime të **efekteve financiare** (shih paragrafin 50);

(b) klasifikimin e tyre si burime të:

- i. rreziqeve (që kontribuojnë në shmangien negative të flukseve monetare hyrëse të pritshme në të ardhmen ose në rritjen e shmangies në flukset monetare dalëse të pritshme në të ardhmen dhe/ose shmangien negative nga një ndryshim i pritshëm në kapitalet e panjohura në pasqyrat financiare); ose
- ii. mundësive (që kontribuojnë në shmangien pozitive të flukseve monetare hyrëse të pritshme në të ardhmen ose në pakësimin e shmangies në flukset monetare dalëse në të ardhmen dhe/ose shmangien pozitive nga një ndryshim i pritshëm në kapitalet e panjohura në pasqyrat financiare).

AR 15. Pasi njësi ekonomike identifikon **rreziqet** dhe **mundësitë** e saj, ajo do të përcaktojë se cilat prej tyre janë materiale për t'u raportuar. Kjo do të bazohet në një kombinim të (i) mundësisë së ndodhjes dhe (ii) madhësisë potenciale të **efekteve financiare** të përcaktuara mbi pragjet e duhura. Në këtë hap do të merret në konsideratë kontributi i atyre rreziqeve dhe mundësive në efektet financiare në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, bazuar në:

(a) parashikimet/ **skenarët** që mendohet se kanë mundësi të realizohen; dhe

(b) ► **C1** efektet financiare të parashikuara lidhur me **çështjet e qëndrueshmërisë që vijnë** ◀ ose nga situata me një prag më të ulët se “më shumë e mundur se e pamundur” ose nga aktive/detyrime të panjohura (ende) në pasqyrat financiare. Kjo përfshin:

- i. situatat potenciale që në vijim të ndodhjes së ngjarjeve të ardhshme mund të ndikojnë potencialin e gjenerimit të fluksit monetar;
- ii. kapitalet që nuk janë njohur si aktive nga perspektiva e kontabilitetit dhe e raportimit financiar por që kanë një ndikim të rëndësishëm në performancën financiare, të tillë si kapitalet natyrore, intelektuale (organizative), njerëzore, shoqërore dhe të marrëdhënieve; dhe
- iii. ngjarjet e mundshme të ardhshme që mund të kenë një ndikim në zhvillimin e kapitaleve të tilla.

#### *Çështje të qëndrueshmërisë për t'u përfshirë në vlerësimin e materialitetit*

AR 16. Kur kryen vlerësimin e saj të **materialitetit**, njësi ekonomike do të marrë në konsideratë listën në vijim të **çështjeve të qëndrueshmërisë** të mbuluara në standardet ESRS sipas temave. Nëse si rezultat i vlerësimit të materialitetit të njësisë ekonomike (shih ESRS 2 IRO-1), një çështje e caktuar e qëndrueshmërisë në këtë listë vlerësohet si materiale, njësi ekonomike do të raportojë në përputhje me Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese përkatëse të standardeve ESRS përkatës sipas temës. Përdorimi i kësaj liste nuk zëvendëson procesin e përcaktimit të çështjeve materiale. Kjo listë është një mjet mbështetës për vlerësimin e materialitetit të njësisë ekonomike. Njësi ekonomike duhet të marrë në konsideratë

rrethanat e saj specifike kur përcakton çështjet e saja materiale. Njësia ekonomike, nëse është e nevojshme, do të zhvillojë edhe dhënie informacionesh shpjeguese specifike për njësinë mbi **ndikimet**, **rreziqet** dhe **mundësitë** materiale jo të mbuluara nga standardet ESRS siç përshkruhet në paragrafin 11 të këtij Standardi.

Tematika ESRS	Çështje të qëndrueshmërisë të mbuluara në standardet ESRS sipas temës		
	Tema	Nëntema	Nëntema specifike
ESRS E1	Ndryshimi klimatik	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshtatja ndaj ndryshimit klimatik</li> <li>• Zbutja e ndryshimit klimatik</li> <li>• Energjia</li> </ul>	
ESRS E2	Ndotja	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndotja e ajrit</li> <li>• Ndotja e ujit</li> <li>• Ndotja e terrenit</li> <li>• Ndotja e organizmave të gjallë dhe e burimeve ushqimore</li> <li>• Substancat shqetësuese</li> <li>• Substancat shumë shqetësuese</li> <li>• Mikroplastikat</li> </ul>	
ESRS E3	Burimet ujore dhe detare	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Uji</li> <li>• Burimet detare</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Konsumi i ujit</li> <li>• Tërheqja e ujit</li> <li>• Shkarkimi më pas i ujit</li> <li>• Shkarkimi më pas i ujit në oqeanë</li> <li>• Nxjerrja dhe përdorimi i burimeve detare</li> </ul>
ESRS E4	Biodiversiteti dhe ekosistemet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Faktorët e drejtpërdrejtë të ndikimit në humbjen e biodiversitetit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndryshimi Klimatik</li> <li>• Ndryshimi i përdorimit të terrenit, ndryshimi i përdorimit të ujit të ëmbël dhe ndryshimi i përdorimit të detit</li> <li>• Shfrytëzimi i drejtpërdrejtë</li> <li>• Specie të huaja pushtuese</li> </ul>

Tematika ESRS	Çështje të qëndrueshmërisë të mbuluara në standardet ESRS sipas temës		
	Tema	Nëntema	Nëntema specifike
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndotja</li> <li>• Të tjera</li> <li>• Ndikime në gjendjen e specieve</li> <li>• Ndikimet në madhësinë dhe kushtet e ekosistemeve</li> <li>• Ndikimet dhe varësitë në shërbimet e ekosistemit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shembuj:</li> <li>• Madhësia e popullatës së specieve</li> <li>• Rreziku i zhdukjes së specieve në nivel global</li> <li>• Shembuj:</li> <li>• Degradimi i terrenit</li> <li>• Kthimi në shkretëtirë</li> <li>• Izolimi i (papërshkueshmëria e) terrenit</li> </ul>
ESRS E5	Ekonomia qarkulluese	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Burime hyrëse, përfshirë përdorimin e burimit</li> <li>• Burimet dalëse të lidhura me produktet dhe shërbimet</li> <li>• Mbetjet</li> </ul>	
ESRS S1	Fuqia e vet punëtore	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kushtet e punës</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Punësimi i sigurt</li> <li>• Koha e punës</li> <li>• Pagat e përshtatshme</li> <li>• Dialogu social</li> <li>• Liria e organizimit, ekzistenca e këshillave të punës dhe të drejtat e punonjësve për informim, konsultim dhe pjesëmarrje</li> <li>• Bashkëpunimi kolektiv, përfshirë pjesën e punonjësve të mbuluar nga marrëveshjet kolektive</li> <li>• Ekuilibri punë-jetë</li> </ul>

Tematika ESRS	Çështje të qëndrueshmërisë të mbuluara në standardet ESRS sipas temës		
	Tema	Nëntema	Nëntema specifike
			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shëndeti dhe siguria</li> </ul>
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Trajtim dhe mundësi të barabarta për të gjithë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Barazia gjinore dhe pagë e barabartë për punë të barabartë</li> <li>• Trajnimi dhe zhvillimi i aftësive</li> <li>• Punësimi dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuara</li> <li>• Masat ndaj dhunës dhe ngacmimit në vendin e punës</li> <li>• Diversiteti (Larmia)</li> </ul>
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të tjera të drejta të lidhura me punën</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Puna e fëmijëve</li> <li>• Puna e detyrueshme</li> <li>• Banim i përshtatshëm</li> <li>• Privatësia</li> </ul>
ESRS S2	Punonjësit në zinxhirin e vlerës	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kushtet e punës</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Punësimi i sigurt</li> <li>• Koha e punës</li> <li>• Pagat e përshtatshme</li> <li>• Dialogu social</li> <li>• Liria e organizimit, përfshirë ekzistencën e këshillave të punës</li> <li>• Bashkëpunimi kolektiv</li> <li>• Ekuilibri punë-jetë</li> <li>• Shëndeti dhe siguria</li> </ul>
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Trajtim dhe mundësi të barabarta për të gjithë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Barazia gjinore dhe pagë e barabartë për punë të barabartë</li> <li>• Trajnimi dhe zhvillimi i aftësive</li> <li>• Punësimi dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuara</li> </ul>

Tematika ESRS	Çështje të qëndrueshmërisë të mbuluara në standardet ESRS sipas temës		
	Tema	Nëntema	Nëntema specifike
			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Masat ndaj dhunës dhe ngacmimit në vendin e punës</li> <li>• Diversiteti (Larmia)</li> </ul>
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të tjera të drejta të lidhura me punën</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Puna e fëmijëve</li> <li>• Puna e detyrueshme</li> <li>• Banim i përshtatshëm</li> <li>• Uji dhe shërbimi i higjienës</li> <li>• Privatësia</li> </ul>
ESRS S3	Komunitetet e prekura	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore të komuniteteve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Banim i përshtatshëm</li> <li>• Ushqim i përshtatshëm</li> <li>• Uji dhe shërbimi i higjienës</li> <li>• Ndikimet e lidhura me terrenin</li> <li>• Ndikimet e lidhura me sigurinë</li> </ul>
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të drejtat civile dhe politike të komuniteteve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Liria e fjalës</li> <li>• Liria e mbledhjes</li> <li>• Ndikimet në mbrojtësit e të drejtave të njeriut</li> </ul>
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të drejtat e popujve indigjenë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Miratim i lirë, paraprak dhe i informuar</li> <li>• Vetë-përcaktimi</li> <li>• Të drejtat kulturore</li> </ul>
ESRS S4	Konsumatorët dhe përdoruesit fundorë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndikimet e lidhura me informacionin për konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Privatësia</li> <li>• Liria e fjalës</li> <li>• Mundësia e përdorimit (cilësia) të informacionit</li> </ul>
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Siguria personale e konsumatorëve dhe/ose e përdoruesve fundorë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shëndeti dhe siguria</li> <li>• Siguria e një personi</li> <li>• Mbrojtja e fëmijëve</li> </ul>

Tematika ESRS	Çështje të qëndrueshmërisë të mbuluara në standardet ESRS sipas temës		
	Tema	Nëntema	Nëntema specifike
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përfshirja sociale e konsumatorëve dhe/ose e përdoruesve fundorë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mos-diskriminimi</li> <li>• Mundësia e përdorimit të produkteve dhe shërbimeve</li> <li>• Praktika marketingu të përgjegjshme</li> </ul>
ESRS G1	Drejtimi i biznesit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kultura e sipërmarrjes</li> <li>• Mbrojtja e sinjalizuesve</li> <li>• Mirëqenia e kafshëve</li> <li>• Angazhimi politik dhe aktivitete influencuese</li> <li>• Menaxhimi i marrëdhënieve me furnitorët përfshirë praktikën e pagesës</li> </ul>	
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korrupsioni dhe ryshfeti</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Parandalimi dhe zbulimi përfshirë trajnimin</li> <li>• Incidentet</li> </ul>

## Vlerësimi duke përdorur mesataret e sektorit dhe përafrues (të ngjashëm)

AR 17. Nëse njësi ekonomike nuk mund të mbledhë informacionin e rrjedhës së sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të vlerës** të kërkuar nga paragrafi 63, pas bërjes së përpjekjeve të arsyeshme për ta mbledhur, ajo do të vlerësojë informacionin për t'u raportuar duke përdorur të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe mbështetës që ka në dispozicion në datën e raportimit pa kosto apo përpjekje të papërshtatshme. Kjo përfshin, por nuk kufizohet në, informacionin e brendshëm dhe të jashtëm, të tillë si të dhëna nga burime të tërthorta, të dhëna mesatare të sektorit, analiza me kampione, të dhëna nga tregu ose grupe palë, përafrues të tjerë ose të dhëna të bazuara në shpenzimet.

## Përmbajtja dhe struktura e deklaratës së qëndrueshmërisë

AR 18. Për të ilustruar paragrafin 115, të seksionit 8.2 *Përmbajtja dhe struktura e deklaratës së qëndrueshmërisë* të këtij Standardi, njësi ekonomike që mbulon çështjet e mjedisit dhe sociale në të njëjtën **politikë** mund të përdorë referenca të kryqëzuara. Kjo do të thotë se

njësia ekonomike mund të raportojë për politikën në dhënien e saj të informacioneve shpjeguese për mjedisin dhe ta referojë në mënyrë të kryqëzuar me dhënien e informacioneve shpjeguese sociale ose anasjelltas. Lejohet paraqitja e konsoliduar e **politikave** përgjatë temave.

## Shtojca B. Karakteristikat cilësore të informacionit

Kjo shtojcë është një pjesë integrale e ESRS 1 dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të Standardit. Kjo shtojcë përkufizon karakteristika cilësore që duhet të plotësojë informacioni i paraqitur në **deklaratën e qëndrueshmërisë** të përgatitur në përputhje me standardet ESRS.

### Përkatësia

- QC 1. Informacioni për qëndrueshmërinë është përkatës nëse ai bën dallimin në vendimet e përdoruesve sipas një qasjeje të **materialitetit të dyfishtë** (shih kapitullin 3 të këtij Standardi).
- QC 2. Informacioni mund të bëjë të mundur një ndryshim në një vendim edhe nëse disa përdorues zgjedhin të mos përfitojnë prej tij ose janë tashmë të vetëdijshëm për të nga burime të tjera. Informacioni për qëndrueshmërinë mund të ndikojë vendimet e përdoruesve nëse ka vlerë parashikuese, vlerë miratuese ose të dyja bashkë. Informacioni financiar ka vlerë parashikuese nëse ai mund të përdoret si një input në proceset e përdorura nga përdoruesit për të parashikuar rezultatet e ardhshme. Nuk është e nevojshme që informacioni për qëndrueshmërinë të jetë një supozim ose një parashikim që të ketë vlerë parashikuese, por ka vlerë parashikuese nëse përdoret nga përdoruesit kur bëjnë parashikimet e tyre.
- QC 3. Informacioni financiar ka vlerë miratuese nëse ai siguron reagime në lidhje me (vërteton ose ndryshon) vlerësimet e mëparshme.
- QC 4. Materialiteti është një aspekt i përkatësisë i veçantë për njësinë ekonomike, në funksion të natyrës ose madhësisë, ose i të dyjave, së zërave me të cilat lidhet informacioni kur vlerësohet në kontekstin e raportimit për qëndrueshmërinë të një njësie ekonomike (shih kapitullin 3 të këtij Standardi).

### Paraqitja besnike

- QC 5. Që të jetë i dobishëm, informacioni jo vetëm duhet të përfaqësojë dukuritë përkatëse, por gjithashtu duhet të paraqesë me besnikëri thelbin e dukurisë që ai synon të paraqesë. Paraqitja besnike kërkon që informacioni të jetë (i) i plotë, (ii) neutral dhe (iii) i saktë.
- QC 6. Një përshkrim i plotë i një ndikimi, rreziku ose mundësie përfshin të gjithë informacionin material të nevojshëm që përdoruesit të kuptojnë ndikimin, rrezikun ose mundësinë. Kjo

përfshin sesi njësia ekonomike ka përshtatur strategjinë, menaxhimin e rrezikut dhe geverisjen e saj në përgjigje të atij ndikimi, rreziku ose mundësie, si dhe **metrikat** e identifikuar për të vendosur **objektivat** dhe matjen e performancës.

- QC 7. Një përshkrim neutral është zgjedhja apo paraqitja e informacionit pa paragjykim. Informacioni është neutral nëse nuk shtrembërohet, rëndohet, mbivlerësohet, nënvlerësohet ose manipulohet ndryshe për të rritur mundësinë që përdoruesit ta marrin atë informacion në mënyrë më të favorshme ose më pak të favorshme. Ai duhet të jetë i ekuilibruar, në mënyrë që të mbulojë si aspektet e favorshme/pozitive edhe aspektet jo të favorshme/negative. Si ndikimet materiale pozitive dhe negative nga një perspektivë e **materialitetit të ndikimit** edhe **rreziqet** dhe **mundësitë** materiale nga një perspektivë e **materialitetit financiar** do të marrin të njëjtën vëmendje. Çdo informacion për qëndrueshmërinë e dëshiruar, për shembull **objektivat** ose planet, do të mbulojnë si synimet e dëshiruara edhe faktorët që mund të pengojnë njësinë ekonomike në arritjen e këtyre dëshirave me qëllim pasjen e një përshkrimi neutral.
- QC 8. Neutraliteti mbështetet nga ushtrimi i kujdesit që është ushtrimi i vëmendjes kur gjykohet në kushtet e pasigurisë. Informacioni nuk do të paraqitet në shuma neto apo të kompensohet për të qenë neutral. Ushtrimi i kujdesit do të thotë që **mundësitë** të mos mbivlerësohen dhe **rreziqet** të mos nënvlerësohen. Po ashtu, ushtrimi i kujdesit nuk lejon nënvlerësim të mundësive ose mbivlerësim të rreziqeve. Njësia ekonomike mund të paraqesë informacion në shuma neto, përveç atyre në shuma bruto, nëse kjo paraqitje nuk fsheh informacion përkatës dhe përfshin një shpjegim të qartë mbi efektet e paraqitjes për shuma neto dhe arsyet që e motivojnë.
- QC 9. Informacioni mund të jetë i saktë edhe pa qenë i përkryer në të gjitha aspektet. Informacioni i saktë nënkupton se njësia ekonomike ka zbatuar proceset dhe kontrollet e brendshme të duhura për të shmangur gabime materiale ose pasaktësi materiale. Si të tilla, vlerësimet do të paraqiten me një theks të qartë mbi kufizimet e mundshme të tyre dhe pasigurinë e lidhur me to (shih seksionin 7.2 të këtij Standardi). Niveli i nevojshëm i saktësisë dhe i arritshëm, si dhe faktorët që e bëjnë informacionin të saktë, varen nga natyra e informacionit dhe natyra e çështjeve që ai trajton. Për shembull, saktësia kërkon që:
- (a) informacioni faktik të jetë pa gabime materiale;
  - (b) përshkrimet të jenë të sakta;
  - (c) vlerësimet, përafrimet dhe parashikimet të jenë identifikuar qartë si të tilla;
  - (d) të mos jenë bërë gabime materiale në zgjedhjen dhe zbatimin e një procesi të duhur për zhvillimin e një vlerësimi, përafrimi ose parashikimi, si dhe inputet për atë proces të jenë të arsyeshme dhe të bazuara;
  - (e) pohimet të jenë të arsyeshme dhe të bazuara në informacion me cilësi dhe sasi të mjaftueshme; dhe

- (f) informacioni mbi gjykimet për të ardhmen të reflektojë me besnikëri si ato gjykime edhe informacionin mbi të cilin ato janë bazuar.

## Krahasueshmëria

- QC 10. Informacioni për qëndrueshmërinë është i krahasueshëm nëse ai mund të krahasohet me informacionin e dhënë nga njësi ekonomike në periudhat e mëparshme dhe mund të krahasohet me informacionin e dhënë nga njësi ekonomike të tjera, veçanërisht ato me aktivitet të ngjashëm ose që veprojnë brenda së njëjtës industri. Një pikë reference për krahasim mund të jetë një objektiv, një bazë reference, një standard krahasimi industrial, informacion krahasues ose nga njësi ekonomike të tjera ose nga një organizatë e njohur në nivel ndërkombëtar, etj.
- QC 11. Koherenca është e lidhur, por nuk është e njëjtë me krahasueshmërinë. Koherenca i referohet përdorimit të qasjeve ose metodave të njëjta për të njëjtën çështje të qëndrueshmërisë, nga periudha në periudhë nga njësi ekonomike dhe njësitë ekonomike të tjera. Koherenca ndihmon për të arritur qëllimin e krahasueshmërisë.
- QC 12. Krahasueshmëria nuk është uniformitet. Që informacioni të jetë i krahasueshëm, përbërësit e ngjashëm duhet të duken të ngjashëm dhe përbërësit e ndryshëm duhet të duken të ndryshëm. Krahasueshmëria e informacionit për qëndrueshmërinë nuk rritet duke i bërë gjërat e ndryshme të duken njësoj dhe për më tepër ajo nuk rritet duke i bërë gjërat e njëjta të duken ndryshe.

## Verifikueshmëria

- QC 13. Verifikueshmëria ndihmon që përdoruesit të kenë besim se informacioni është i plotë, neutral dhe i saktë. Informacioni për qëndrueshmërinë është i verifikueshëm nëse është e mundur të vërtetohet informacionin vetë ose inputet e përdorura për të krijuar atë.
- QC 14. Verifikueshmëria do të thotë se vëzhguesit e ndryshëm të mirinformuar dhe të pavarur mund të arrijnë konsensusin, edhe pse jo domosdo marrëveshjen e plotë, se një përshkrim i veçantë është një paraqitje besnike. Informacioni për qëndrueshmërinë do të jepet në një mënyrë që rrit verifikueshmërinë e tij, për shembull:
- (a) duke përfshirë informacion që mund të vërtetohet duke e krahasuar me informacion tjetër në dispozicion të përdoruesve mbi biznesin e njësisë ekonomike, mbi bizneset e tjera ose mbi mjedisin e jashtëm;
  - (b) duke dhënë informacion mbi inputet dhe metodat e llogaritjeve të përdorura për prodhimin e vlerësimeve ose të përafrimeve; dhe
  - (c) duke dhënë informacion të rishikuar dhe të miratuar nga **organet administrative, të drejtimit dhe të mbikëqyrjes** ose komitetet e tyre.

QC 15. Disa informacione për qëndrueshmërinë do të jenë në formën e shpjegimeve ose të informacionit parashikues. Këto dhënie informacionesh shpjeguese mund të jenë mbështetëse duke paraqitur me besnikëri një bazë faktike për shembull strategjitë, planet dhe analizat e rreziqeve të njësisë ekonomike. Për të ndihmuar përdoruesit të vendosin nëse do të përdorin këtë informacion, njësia ekonomike do të përshkruajë supozimet dhe metodat e nënkuptuara në prodhimin e informacionit, si dhe faktorët e tjerë që sjellin evidencë që pasqyron planet aktuale të hartuara ose vendimet aktuale të marra nga njësia ekonomike.

## Kuptueshmëria

QC 16. Informacioni për qëndrueshmërinë është i kuptueshëm nëse është i qartë dhe i përmbledhur. Informacioni i kuptueshëm i mundëson çdo përdoruesi të mirinformuar në mënyrë të arsyeshme, të kuptojë pa vështirësi informacionin e komunikuar.

QC 17. Që dhënia e informacioneve shpjeguese për qëndrueshmërinë të jetë e përmbledhur, nevojitet që (a) të shmanget informacioni i përgjithshëm “mbushës”, i cili nuk është specifik për njësinë ekonomike; (b) të shmanget përsëritja e panevojshme e informacionit, përfshirë edhe informacionin e paraqitur në pasqyrat financiare; dhe (c) të përdoret një gjuhë e qartë, me fjali dhe paragrafë të strukturuar si duhet. ► **C1** Dhënia e informacioneve shpjeguese të përmbledhura do të përfshijë vetëm informacion material. Informacioni plotësues i paraqitur sipas kërkesave të paragrafit 114 do të jepet në një mënyrë që shmang fshehjen e informacionit material. ◀

QC 18. Qartësia mund të zgjerohet duke dalluar informacionin mbi zhvillimet në periudhën e raportimit nga informacioni “i përhershëm” që mbetet relativisht i pandryshuar nga njëra periudhë në tjetrën. Kjo mund të bëhet, për shembull, duke përshkruar veçmas tiparet e qeverisjes dhe të proceseve të menaxhimit të rrezikut të lidhura me qëndrueshmërinë e njësive ekonomike, që kanë ndryshuar që nga periudha e mëparshme e raportimit krahasuar me ato që mbeten të pandryshuara.

QC 19. Plotësia, qartësia dhe krahasueshmëria e dhënies së informacioneve shpjeguese, varen të gjitha nga informacioni i paraqitur si një bashkësi koherente. Që dhënia e informacioneve shpjeguese për qëndrueshmërinë të jetë koherente, ajo duhet të paraqitet në një mënyrë që shpjegon kontekstin dhe lidhjet mes informacionit përkatës. Koherenca kërkon edhe që njësia ekonomike të japë informacion në një mënyrë që lejon përdoruesit të lidhin informacionin mbi **ndikimet**, **rreziqet** dhe **mundësitë** e lidhura me qëndrueshmërinë e saj me informacionin në pasqyrat financiare të njësive ekonomike.

QC 20. Nëse **rreziqet** dhe **mundësitë** e lidhura me qëndrueshmërinë, të trajtuara në pasqyrat financiare kanë ndikime në raportimin e qëndrueshmërisë, njësia ekonomike do të përfshijë në **deklaratën e qëndrueshmërisë** informacionin e nevojshëm për përdoruesit për të vlerësuar ato ndikime dhe do të paraqesë lidhjet e duhura me pasqyrat financiare (shih

kapitullin 9 të këtij Standardi). Niveli i informacionit, hollësitë dhe teknikat do të përshtaten me nevojat dhe pritjet e përdoruesve. Shkurtimet do të shmangen dhe njësitë e matjes do të përkufizohen dhe do të jepet informacion shpjegues për to.

## Shtojca C. Lista e vënies graduale në zbatim të Kërkesave për Dhënie informacionesh shpjeguese

Kjo shtojcë është një pjesë integrale e ESRS 1 dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të Standardit.

ESRS	Kërkesa për Dhënie informacionesh shpjeguese	Emërtimi i plotë i Kërkesës për Dhënie informacionesh shpjeguese	Vënia graduale në zbatim ose data e hyrjes në fuqi (përfshirë vitin e parë)
ESRS 2	SBM-1	Strategjia, modeli i biznesit dhe zinxhiri i vlerës	Njësia ekonomike do të raportojë informacionin e përshkruar në ESRS 2 SBM-1, paragrafi 40, germa (b) (zbërthimi i të ardhurave totale sipas sektorëve kryesorë sipas standardeve ESRS) dhe paragrafi 40, germa (c) (lista e sektorëve kryesorë shtesë sipas standardeve ESRS) duke filluar nga data e zbatimit të cilësuar në Aktin e Deleguar të Komisionit për t'u zbatuar sipas nenit 29, germa b, pika (1), paragrafi i tretë, pika (ii) e Direktivës 2013/34/BE.
ESRS 2	SBM-3	Ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit.	Njësia ekonomike mund të mos paraqesë informacionin e përshkruar në ESRS 2 SBM-3, paragrafi 48, germa (e) (efektet financiare të parashikuara) për vitin e parë të përgatitjes së deklaratës së saj të qëndrueshmërisë. Njësia ekonomike mund të plotësojë kërkesat e ESRS 2 SBM-3, paragrafi 48, germa (e) duke raportuar vetëm dhënie informacionesh shpjeguese cilësore për 3 vitet e para të përgatitjes së deklaratës

ESRS	Kërkesa për Dhënie informacionesh shpjeguese	Emërtimi i plotë i Kërkesës për Dhënie informacionesh shpjeguese	Vënia graduale në zbatim ose data e hyrjes në fuqi (përfshirë vitin e parë)
			së saj të qëndrueshmërisë, nëse nuk është praktike përgatitja e dhënies së informacioneve shpjeguese sasiore.
ESRS E1	E1-6	Emetimet bruto GHG të perimetrit 1, 2, 3 dhe emetimet totale GHG	Njësitë ekonomike ose grupet që nuk tejkalojnë në datën e tyre të bilancit numrin mesatar prej 750 punonjësish gjatë vitit financiar (mbi një bazë të konsoliduar kur kjo është e mundur) mund të mos paraqesin pika të dhënash për emetimet e perimetrit 3 dhe emetimet totale GHG për vitin e parë të përgatitjes së deklaratës së tyre të qëndrueshmërisë.
ESRS E1	E1-9	Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet fizike dhe të tranzicionit materiale dhe mundësitë potenciale të lidhura me klimën.	Njësia ekonomike mund të mos paraqesë informacionin e përshkruar në ESRS E1-9 për vitin e parë të përgatitjes së deklaratës së saj të qëndrueshmërisë. Njësia ekonomike mund të plotësojë kërkesat e ESRS E1-9 duke raportuar vetëm dhënie informacionesh shpjeguese cilësore për 3 vitet e para të përgatitjes së deklaratës së saj të qëndrueshmërisë, nëse nuk është praktike përgatitja e dhënies së informacioneve shpjeguese sasiore.
ESRS E2	E2-6	► <b>C1</b> Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet dhe mundësitë e lidhura me ndotjen. ◀	Njësia ekonomike mund të mos paraqesë informacionin e përshkruar nga ESRS E2-6 për vitin e parë të përgatitjes së deklaratës së saj të qëndrueshmërisë. Me përjashtim të informacionit të përshkruar në paragrafin 40, germa (b) mbi shpenzimet e shfrytëzimit dhe shpenzimet kapitale të shfaqura gjatë periudhës së

ESRS	Kërkesa për Dhënie informacionesh shpjeguese	Emërtimi i plotë i Kërkesës për Dhënie informacionesh shpjeguese	Vënia graduale në zbatim ose data e hyrjes në fuqi (përfshirë vitin e parë)
			raportimit në lidhje me incidentet dhe depozitat kryesore, njësia ekonomike mund të plotësojë kërkesat e ESRS E2-6 duke raportuar vetëm dhënien e informacioneve cilësore për 3 vitet e para të përgatitjes së deklaratës së saj të qëndrueshmërisë.
ESRS E3	E3-5	► <b>C1</b> Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet dhe mundësitë e lidhura me burimet ujore dhe detare. ◀	Njësia ekonomike mund të mos paraqesë informacionin e përshkruar nga ESRS E3-5 për vitin e parë të përgatitjes së deklaratës së saj të qëndrueshmërisë. Njësia ekonomike mund të plotësojë kërkesat e ESRS E3-5 duke raportuar vetëm dhënie informacionesh shpjeguese cilësore për 3 vitet e para të përgatitjes së deklaratës së saj të qëndrueshmërisë.
ESRS E4	Të gjitha kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese	Të gjitha kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese	Njësitë ekonomike ose grupet që nuk tejkalojnë në datën e tyre të bilancit numrin mesatar prej 750 punonjësish gjatë vitit financiar (mbi një bazë të konsoliduar kur kjo është e mundur) mund të mos paraqesin informacionin e specifikuar në kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të ESRS E4 për 2 vitet e para të përgatitjes së deklaratës së tyre të qëndrueshmërisë.
ESRS E4	E4-6	► <b>C1</b> Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet dhe mundësitë e lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet. ◀	Njësia ekonomike mund të mos paraqesë informacionin e përshkruar nga ESRS E4-6 për vitin e parë të përgatitjes së deklaratës së saj të qëndrueshmërisë.  Njësia ekonomike mund të plotësojë kërkesat e ESRS E4-6 duke raportuar

ESRS	Kërkesa për Dhënie informacionesh shpjeguese	Emërtimi i plotë i Kërkesës për Dhënie informacionesh shpjeguese	Vënia graduale në zbatim ose data e hyrjes në fuqi (përfshirë vitin e parë)
			vetëm dhënie informacionesh shpjeguese cilësore për 3 vitet e para të përgatitjes së deklaratës së saj të qëndrueshmërisë.
ESRS E5	E5-6	► <b>C1</b> Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet dhe mundësitë e lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese. ◀	Njësia ekonomike mund të mos paraqesë informacionin e përshkruar nga ESRS E5-6 për vitin e parë të përgatitjes së deklaratës së saj të qëndrueshmërisë.  Njësia ekonomike mund të plotësojë kërkesat e ESRS E5-6 duke raportuar vetëm dhënie informacionesh shpjeguese cilësore për 3 vitet e para të përgatitjes së deklaratës së saj të qëndrueshmërisë.
ESRS S1	Të gjitha kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese	Të gjitha kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese	Njësitë ekonomike ose grupet që nuk tejkalojnë në datën e tyre të bilancit numrin mesatar prej 750 punonjësish gjatë vitit financiar (mbi një bazë të konsoliduar kur kjo është e mundur) mund të mos paraqesin informacionin e specifikuar në kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të ESRS S1 për vitin e parë të përgatitjes së deklaratës së tyre të qëndrueshmërisë.
ESRS S1	S1-7	Karakteristikat e të punësuarve jo punonjës në forcën e vet të punës të njësisë ekonomike	Njësia ekonomike mund të mos paraqesë informacionin për të gjitha pikat e të dhënave të kësaj kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese për vitin e parë të përgatitjes së deklaratës së saj të qëndrueshmërisë.
ESRS S1	S1-8	Mbulimi i bashkëpunimit	Njësia ekonomike mund të anashkalojë këtë kërkesë për dhënie informacionesh

ESRS	Kërkesa për Dhënie informacionesh shpjeguese	Emërtimi i plotë i Kërkesës për Dhënie informacionesh shpjeguese	Vënia graduale në zbatim ose data e hyrjes në fuqi (përfshirë vitin e parë)
		kolektiv dhe dialogu social	shpjeguese lidhur me punonjësit e vet në vendet jo të ZEE (zonës ekonomike evropiane) për vitin e parë të përgatitjes së deklaratës së saj të qëndrueshmërisë.
ESRS S1	S1-11	Mbrojtja sociale	Njësia ekonomike mund të mos paraqesë informacionin e përshkruar në ESRS S1-11 për vitin e parë të përgatitjes së deklaratës së saj të qëndrueshmërisë.
ESRS S1	S1-12	► C1 Persona me aftësi të kufizuara ◀	Njësia ekonomike mund të mos paraqesë informacionin e përshkruar në ESRS S1-12 për vitin e parë të përgatitjes së deklaratës së saj të qëndrueshmërisë.
ESRS S1	S1-13	Trajnimi dhe zhvillimi i aftësive	Njësia ekonomike mund të mos paraqesë informacionin e përshkruar në ESRS S1-13 për vitin e parë të përgatitjes së deklaratës së saj të qëndrueshmërisë.
ESRS S1	S1-14	Shëndeti dhe siguria	Njësia ekonomike mund të mos paraqesë pikat e të dhënave në rastet e sëmundjeve profesionale dhe ditëve të humbura për shkak të plagosjeve, aksidenteve, fatkeqësive dhe sëmundjeve profesionale për vitin e parë të përgatitjes së deklaratës së saj të qëndrueshmërisë.
ESRS S1	S1-14	Shëndeti dhe siguria	Njësia ekonomike mund të mos paraqesë informacionin mbi jo punonjësit për vitin e parë të përgatitjes së deklaratës së saj të qëndrueshmërisë.
ESRS S1	S1-15	Ekulibri punë-jetë	Njësia ekonomike mund të mos paraqesë informacionin e përshkruar në ESRS S1-15 për vitin e parë të përgatitjes së deklaratës së saj të qëndrueshmërisë.

ESRS	Kërkesa për Dhënie informacionesh shpjeguese	Emërtimi i plotë i Kërkesës për Dhënie informacionesh shpjeguese	Vënia graduale në zbatim ose data e hyrjes në fuqi (përfshirë vitin e parë)
ESRS S2	Të gjitha kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese	Të gjitha kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese	Njësitë ekonomike ose grupet që nuk tejkalojnë në datën e tyre të bilancit numrin mesatar prej 750 punonjësish gjatë vitit financiar (mbi një bazë të konsoliduar kur kjo është e mundur) mund të mos paraqesin informacionin e specifikuar në kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të ESRS S2 për 2 vitet e para të përgatitjes së deklaratës së tyre të qëndrueshmërisë.
ESRS S3	Të gjitha kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese	Të gjitha kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese	Njësitë ekonomike ose grupet që nuk tejkalojnë në datën e tyre të bilancit numrin mesatar prej 750 punonjësish gjatë vitit financiar (mbi një bazë të konsoliduar kur kjo është e mundur) mund të mos paraqesin informacionin e specifikuar në kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të ESRS S3 për 2 vitet e para të përgatitjes së deklaratës së tyre të qëndrueshmërisë.
ESRS S4	Të gjitha kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese	Të gjitha kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese	Njësitë ekonomike ose grupet që nuk tejkalojnë në datën e tyre të bilancit numrin mesatar prej 750 punonjësish gjatë vitit financiar (mbi një bazë të konsoliduar kur kjo është e mundur) mund të mos paraqesin informacionin e specifikuar në kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të ESRS S4 për 2 vitet e para të përgatitjes së deklaratës së tyre të qëndrueshmërisë.

## Shtojca D. Struktura e deklaratës së qëndrueshmërisë sipas standardeve ESRS


Kjo shtojcë është një pjesë integrale e ESRS 1 dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të Standardit lidhur me raportimin në katër pjesë siç është paraqitur në paragrafin 115.

Pjesë e raportit të drejtimit	Kodi sipas standardeve ESRS	Titulli
1. Informacion i përgjithshëm	ESRS 2	<i>Dhënie informacionesh shpjeguese të Përgjithshme, duke përfshirë informacionin e dhënë sipas Kërkesave për Zbatim të standardeve ESRS sipas temave të renditur në Shtojcën C të ESRS 2.</i>
2. Informacioni mbi mjedisin	<i>Jo e zbatueshme</i>	<i>Dhënie informacionesh shpjeguese sipas nenit 8 të Rregullores (BE) 2020/852 (Rregullorja e Taksonomisë)</i>
	ESRS E1	<i>Ndryshimi klimatik</i>
	ESRS E2	<i>Ndotja</i>
	ESRS E3	<i>Burimet ujore dhe detare</i>
	ESRS E4	<i>Biodiversiteti dhe ekosistemet</i>
	ESRS E5	<i>Përdorimi i burimeve dhe ekonomia qarkulluese</i>
3. Informacioni social	ESRS S1	<i>Fuqia e vet punëtore</i>
	ESRS S2	<i>Punonjësit në zinxhirin e vlerës</i>
	ESRS S3	<i>Komunitetet e prekura</i>
	ESRS S4	<i>Konsumatorët dhe përdoruesit fundorë</i>
4. Informacioni për qeverisjen	ESRS G1	<i>Drejtimi i biznesit</i>

## Shtojca E. Flowchart për përcaktimin e dhënies së informacioneve shpjeguese sipas standardeve ESRS

**Vlerësimi i materialitetit** është pikënisja për raportimin e qëndrueshëm sipas standardeve ESRS. Kjo shtojcë jep një ilustrim jo detyrues të vlerësimit të materialitetit të ndikimit dhe materialitetit financiar të paraqitur në kapitullin 3. IRO-1 në seksionin 4.1 të ESRS 2 përfshin kërkesat e përgjithshme për dhënie informacionesh shpjeguese (KD) mbi proceset e njësive

ekonomike për të identifikuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë, si dhe për të vlerësuar materialitetin e tyre. SBM-3 i ESRS 2 siguron kërkesat e përgjithshme për dhënie informacionesh shpjeguese mbi ndikimet, rreziqet dhe mundësitë, që rezultojnë nga vlerësimi i materialitetit i njësisë ekonomike. Njësia ekonomike mund të mos paraqesë të gjitha kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të një standardi sipas temës nëse ka vlerësuar se tema në fjalë nuk është materiale. Në atë rast ajo mund të paraqesë një shpjegim të shkurtër të përfundimeve të vlerësimit për materialitetin e asaj teme por *do të japë* një shpjegim të hollësishëm në rastin e një ndryshimi klimatik sipas ESRS E1 (IRO-2 ESRS 2). Standardet ESRS paraqesin kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese, jo kërkesat për sjelljen. Kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese në lidhje me **planet e veprimeve, objektivat, politikat, analizat e skenarit dhe planet e tranzicionit** janë proporcionale sepse ato varen nga ekzistenca e këtyre elementëve në njësinë ekonomike, e cila mund të varet nga madhësia, kapaciteti, burimet dhe aftësitë e njësisë ekonomike. *Shënim: Flowchart në vijim nuk mbulon situatën kur njësia ekonomike vlerëson si materiale një çështje të qëndrueshmërisë që nuk mbulohet nga një standard sipas temës, në të cilën njësia do të japë informacione shpjeguese shtesë specifike për njësinë ekonomike (ESRS 1 paragrafi 30, germa b).*




## Shtojca F. Shembull i strukturës së deklaratës të qëndrueshmërisë ESRS

Kjo shtojcë plotëson ESRS 1. Ajo ofron një ilustrim jo të detyrueshëm të strukturës së **deklaratës së qëndrueshmërisë** të paraqitur në seksionin 8.2 të këtij Standardi. Në këtë ilustrim, njësia ekonomike ka dalë në përfundimin se biodiversiteti dhe ekosistemet, ndotja dhe komunitetet e ndikuara nuk janë materiale.



## Shtojca G. Shembull i përfshirjes me referencë

Kjo shtojcë plotëson ESRS 1. Ajo ofron një ilustrim jo të detyrueshëm të përfshirjes me referencë një seksion tjetër të raportit të drejtimit në **deklaratën e qëndrueshmërisë** të paraqitur në seksionin 9.1 të këtij Standardi.



# ESRS 2. DHËNIE INFORMACIONE SHPJEGUESE TË PËRGJITHSHME

## Përmbajtja

<b>Objektivi .....</b>	<b>64</b>
<b>1. Baza e përgatitjes .....</b>	<b>65</b>
Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese BP -1– Baza e përgjithshme për përgatitjen e deklaratës së qëndrueshmërisë.....	65
Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese BP -2– Dhënia e informacioneve shpjeguese në lidhje me rrethanat specifike.....	66
Afatet kohore .....	66
Vlerësimi i zinxhirit të vlerës.....	67
Burimet e vlerësimit dhe pasiguria e rezultateve.....	67
Ndryshimet në përgatitjen ose paraqitjen e informacionit për qëndrueshmërinë	67
Raportimi i gabimeve të periudhave të mëparshme.....	68
Dhënia e informacioneve shpjeguese që rrjedhin nga legjislacioni tjetër ose nga deklaratat e pranura përgjithësisht të raportimit të qëndrueshmërisë.....	68
Përfshirja me referencë .....	68
Përdorimi i dispozitave të fazës së hyrjes në fuqi në përputhje me Shtojcën C të ESRS 1.....	68
<b>2. Qeverisja .....</b>	<b>69</b>
Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese GOV -1– Roli i organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse .....	69
Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese GOV-2 – Informacioni i dhënë dhe çështjet e qëndrueshmërisë të adresuara nga organet administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse të njësisë ekonomike .....	71
Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese GOV-3– Integrimi i performancës së lidhur me qëndrueshmërinë në skemat stimuluese.....	72
Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese GOV-4 - Deklaratë për kujdesin e duhur	72
Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese GOV -5- Menaxhimi i rrezikut dhe kontrollet e brendshme mbi raportimin e qëndrueshmërisë .....	73
<b>3. Strategjia.....</b>	<b>74</b>
Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese SBM -1– Strategjia, modeli i biznesit dhe zinxhiri i vlerës .....	74

Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese SBM -2– Interesat dhe pikëpamjet e palëve të interesuara .....	76
Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese SBM -3- Ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit.....	77
<b>4. Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë .....</b>	<b>79</b>
4.1 Dhënia e informacioneve shpjeguese mbi procesin e vlerësimit të materialitetit ....	79
▶ <b>C1</b> Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese IRO -1- Përshkrimi i procesit për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë ◀ .....	80
Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese IRO-2 - Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese në ESRS që mbulojnë nga deklarata e qëndrueshmërisë së njësisë ekonomike .....	81
4.2 Kërkesa minimale për informacione shpjeguese mbi politikat dhe veprimet .....	82
Kërkesa Minimale për Informacione Shpjeguese - Politikat MDR -P - Politikat e miratuara për të menaxhuar çështjet e rëndësishme të qëndrueshmërisë .....	83
Kërkesa Minimale për Informacione Shpjeguese - Veprimet MDR -A - Veprimet dhe burimet në lidhje me çështjet të rëndësishme të qëndrueshmërisë.....	83
<b>5. Metrikat dhe objektivat .....</b>	<b>84</b>
Kërkesa minimale për informacione shpjeguese – Metrikat në MDR -M - Metrikat në lidhje me çështjet të rëndësishme të qëndrueshmërisë.....	85
Kërkesa Minimale për Informacione Shpjeguese Objektivat MDR– T – Ndjekja e efektivitetit të politikave dhe veprimeve përmes objektivave.....	86
<b>Shtojca A. Kërkesat për Zbatim .....</b>	<b>87</b>
1. Baza e përgatitjes.....	88
Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese BP -1– Baza e përgjithshme për përgatitjen e deklaratave të qëndrueshmërisë .....	88
Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese BP -2– Dhënia e informacioneve shpjeguese në lidhje me rrethanat specifike.....	88
2. Qeverisja .....	88
Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese GOV -1– Roli i organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse.....	88
Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese GOV-2 – Informacioni i dhënë dhe çështjet e qëndrueshmërisë të adresuara nga organet administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse të njësisë ekonomike .....	89

Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese GOV-3– Integrimi i performancës së lidhur me qëndrueshmërinë në skemat stimuluese.....	89
Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese GOV-4– Deklaratë për kujdesin e duhur.....	90
Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese GOV -5– Menaxhimi i rrezikut dhe kontrollet e brendshme mbi raportimin e qëndrueshmërisë .....	90
<b>3. Strategjia .....</b>	<b>91</b>
Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese SBM -1 Strategjia, modeli i biznesit dhe zinxhiri i vlerës .....	91
Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese SBM -2– Interesat dhe pikëpamjet e palëve të interesuara .....	92
Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese SBM -3– Ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit .....	92
<b>4. Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë .....</b>	<b>92</b>
Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese IRO-2 - Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese në ESRS që mbulohen nga deklarata e qëndrueshmërisë së njësive ekonomike .....	92
Kërkesa minimale për Informacione Shpjeguese - Politikat MDR -P - Politikat e miratuara për të menaxhuar çështjet e rëndësishme të qëndrueshmërisë .....	92
Kërkesa Minimale për Informacione Shpjeguese - Veprimet MDR -A - Veprimet dhe burimet në lidhje me çështjet të rëndësishme të qëndrueshmërisë.....	93
<b>5. Metrikat dhe objektivat .....</b>	<b>93</b>
Kërkesa Minimale për Informacione Shpjeguese Objektivat MDR– T – Ndjekja e efektivitetit të politikave dhe veprimeve përmes objektivave.....	93
<b>Shtojca B. Lista e pikave të të dhënave në standardet ndërsektoriale dhe specifike që rrjedhin nga legjislacioni tjetër i BE-së .....</b>	<b>94</b>
<b>Shtojca C. Dhënia e informacioneve shpjeguese dhe Kërkesat për zbatim në ESRS përkatëse që janë të zbatueshme së bashku me ESRS 2 Dhënie e Informacioneve të Përgjithshme .....</b>	<b>108</b>

## Objektivi

1. Ky ESRS përcakton kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese që zbatohen për të gjitha njësitë ekonomike, pavarësisht nga sektori i tyre i aktivitetit (d.m.th., sektori agnostik) dhe

zbatohen për temat e qëndrueshmërisë (d.m.th., ndërsektoriale). ► **C1** Ky ESRS mbulon fushat e raportimit të përcaktuara në ESRS 1 *Kërkesat e përgjithshme* në seksionin 1.2 *Fushat e raportimit dhe kërkesat minimale për informacione shpjeguese mbi politikat, veprimet, objektivat dhe treguesit sasiorë (metrikat)*. ◀

2. Në përgatitjen e dhënies së informacioneve shpjeguese sipas këtij Standardi, njësi ekonomike do të zbatojë kërkesat e dhënies së informacioneve shpjeguese (përfshirë pikat e tyre të të dhënave) të vendosura në një ESRS specifike, siç renditen në Shtojcën C të këtij Standardi *Dhënie e Informacionit Shpjegues/Kërkesa për Zbatimit të një ESRS specifike që janë të zbatueshme së bashku me ESRS 2 Dhënia e informacioneve të përgjithshme*. Njësi ekonomike do të zbatojë kërkesat e renditura në Shtojcën C:
  - (a) në të gjitha rastet për kërkesat sipas një standardi specifik në lidhje me Kërkesën për Informacione Shpjeguese IRO-1 *Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë*; dhe
  - (b) për të gjitha kërkesat e tjera të renditura në shtojcën C, vetëm nëse tema e qëndrueshmërisë është e rëndësishme bazuar në vlerësimin e materialitetit të njësisë ekonomike (shih ESRS 1 kapitulli 3 *Materialiteti i dyfishtë si bazë për dhënie e informacioneve shpjeguese të qëndrueshmërisë*).

## 1. Baza e përgatitjes

### Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese BP -1– Baza e përgjithshme për përgatitjen e deklaratës së qëndrueshmërisë

3. **Njësi ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese mbi bazën e përgjithshme për përgatitjen e deklaratës së saj të qëndrueshmërisë.**
4. Objektivi i kësaj Kërkese për Informacione shpjeguese është të ofrojë një kuptim se si njësi ekonomike përgatit **deklaratën** e saj të **qëndrueshmërisë**, duke përfshirë qëllimin e konsolidimit, informacion për rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të vlerës** dhe, aty ku është e nevojshme, nëse njësi ekonomike ka përdorur ndonjë nga opsionet për të mos paraqitur informacionin e përmendur në pikat d) dhe e) të paragrafit vijues.
5. Njësi ekonomike duhet të japë informacionin e mëposhtëm:
  - (a) nëse **deklarata e qëndrueshmërisë** është përgatitur në baza të konsoliduara ose individuale;
  - (b) për deklaratat e konsoliduara të qëndrueshmërisë:

- i. një konfirmim që qëllimi i konsolidimit është i njëjtë me atë të pasqyrave financiare, ose, aty ku është e zbatueshme, një deklaratë që njësia ekonomike raportuese nuk i kërkohet të hartojë pasqyra financiare ose që njësia ekonomike raportuese është duke përgatitur raportimin e konsoliduar të qëndrueshmërisë në përputhje me nenin 48i të Direktivës 2013/34/BE; dhe
  - ii. aty ku është e aplikueshme, një tregues se cilat njësi ekonomike filiale të përfshira në konsolidim janë të përjashtuara nga raportimi individual ose i konsoliduar i qëndrueshmërisë në përputhje me nenet 19a(9) ose 29a(8) të Direktivës 2013/34/BE;
- (c) deri në çfarë mase deklarata e qëndrueshmërisë mbulon rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të vlerës** të njësia ekonomike (shih ESRS 1 seksionin 5.1 *Raportimi i njësia ekonomike dhe zinxhiri i vlerës*);
- (d) nëse njësia ekonomike ka përdorur opsionin për të hequr një pjesë specifike të informacionit që korrespondon me pronësinë intelektuale, njohuritë ose rezultatet e inovacionit (shih ESRS 1 seksionin 7.7 *Informacioni i klasifikuar dhe i ndjeshëm dhe informacioni mbi pronësinë intelektuale, njohuritë ose rezultatet e inovacionit*); dhe
- (e) për ndërmarrjet të vendosura në një shtet anëtar të BE-së që lejon përjashtimin nga kërkesa për dhënie informacioni për zhvillimet ose çështjet në proces negociatash, siç parashikohet në nenet 19a(3) dhe 29a(3) të Direktivës 2013/34/BE, nëse njësia ekonomike e ka përdorur atë përjashtim.

## **Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese BP -2– Dhënia e informacioneve shpjeguese në lidhje me rrethanat specifike**

6. **Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese në lidhje me rrethanat specifike.**
7. Objektivi i kësaj kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese është të sigurojë një kuptueshmëri të efektit të këtyre rrethanave specifike në përgatitjen e **deklaratës së qëndrueshmërisë**.
8. Njësia ekonomike mund të raportojë këtë informacion së bashku me shënimet e tjera shpjeguese të cilave ato i referohen.

### *Afatet kohore*

9. Kur njësia ekonomike ka devijuar nga afatet kohore afatmesme ose afatgjata të përcaktuara nga standardi ESRS 1 seksioni 6.4 *Përkufizimi i afateve afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për qëllime raportimi*, ajo duhet të përshkruajë:
  - (a) përkufizimet e saj për afatet kohore afatmesme ose afatgjata; dhe
  - (b) arsyet për zbatimin e këtyre përkufizimeve.

### *Vlerësimi i zinxhirit të vlerës*

10. Kur metrikat përfshijnë të dhëna të rrjedhës së sipërme dhe/ose të poshtme të **zinxhirit të vlerës** e vlerësuar duke përdorur burime të tërthorta, të tilla si të dhënat mesatare të sektorit ose tregues të tjerë, njësia ekonomike duhet:
- (a) të identifikojë metrikat;
  - (b) të përshkruajë bazën për përgatitjen;
  - (c) të përshkruajë nivelin saktësisë që rezulton; dhe
  - (d) aty ku është e zbatueshme, të përshkruajë veprimet e planifikuara për të përmirësuar saktësinë në të ardhmen (shih ESRS 1 kapitulli 5 *Zinxhiri i vlerës*)

### *Burimet e vlerësimit dhe pasiguria e rezultateve*

11. Në përputhje me SSRS 1 seksioni 7.2 *Burimet e vlerësimit dhe pasiguria e rezultatit*, njësia ekonomike duhet:
- (a) të identifikojë metrikat dhe shumat monetare të paraqitura të cilat i nënshtrohen një niveli të lartë të pasigurisë në matje;
  - (b) në lidhje me çdo shumë sasiore dhe monetare të identifikuar:
    - i. të japë informacione për burimet e pasigurisë së matjes (për shembull, varësia e vlerës nga rezultati i një ngjarjeje të ardhshme, nga një teknikë matjeje ose nga disponueshmëria dhe cilësia e të dhënave nga rrjedha e sipërme dhe/ose e poshtme e zinxhirit të vlerës të njësisë ekonomike); dhe
    - ii. të japë informacion për supozimet, përafrimet dhe gjykimet që njësia ekonomike ka bërë në matjet e saj.
12. Gjatë dhënies së informacioneve shpjeguese për të ardhmen, njësia ekonomike mund të tregojë se e konsideron këtë informacion të pasigurt.

### *Ndryshimet në përgatitjen ose paraqitjen e informacionit për qëndrueshmërinë*

13. Kur ndodhin ndryshime në përgatitjen dhe paraqitjen e informacionit të qëndrueshmërisë në krahasim me periudhën(t) e mëparshme raportuese, (shih ESRS 1 seksionin 7.4 *Ndryshimet në përgatitjen ose paraqitjen e informacionit të qëndrueshmërisë*), njësia ekonomike duhet:
- (a) të shpjegojë ndryshimet dhe arsyet për to, duke përfshirë arsyen pse metrikat të zëvendësuar ofrojnë informacion më të dobishëm;
  - (b) të tregojë shifrat krahasuese të rishikuara, përveç rasteve kur është e pamundur të bëhet një gjë e tillë. Kur është e pamundur të rregullohet informacioni krahasues për një ose më shumë periudha të mëparshme, njësia ekonomike duhet ta paraqesë këtë fakt; dhe
  - (c) të japë informacion shpjegues midis shifrës së paraqitur në periudhën paraardhëse dhe shifrës krahasuese të rishikuar.

### *Raportimi i gabimeve të periudhave të mëparshme*

14. Kur njësi ekonomike identifikon gabime materiale të periudhës së mëparshme (shih ESRS 1 seksionin 7.5 *Raportimi i gabimeve të periudhave të mëparshme*), ajo duhet të paraqesë informacion për:
- (a) natyrën e gabimit material të periudhës së mëparshme;
  - (b) për aq sa është praktike, korigjimi që është bërë për çdo periudhë të mëparshme të përfshirë në deklaratën e qëndrueshmërisë; dhe
  - (c) nëse korigjimi i gabimit nuk është i praktikueshëm, të shpjegohen rrethanat që çuan në ekzistencën e atij kushti.

### *Dhënia e informacioneve shpjeguese që rrjedhin nga legjislacioni tjetër ose nga deklaratat e pranuar përgjithësisht të raportimit të qëndrueshmërisë*

15. Kur njësi ekonomike përfshin në deklaratën e saj të qëndrueshmërisë informacione që rrjedhin nga një legjislacion tjetër i cili kërkon që njësi ekonomike të japë informacione për qëndrueshmërinë ose nga standardet dhe kornizat e pranuar përgjithësisht të raportimit të qëndrueshmërisë (shih ESRS 1 seksionin 8.2 *Përmbajtja dhe struktura e deklaratës së qëndrueshmërisë*), përveç informacionit të përshkruar nga ESRS, njësi ekonomike duhet të shtjellojë edhe këtë fakt. Në rast të zbatimit të pjesshëm të standardeve ose kornizave të tjera raportuese, njësi ekonomike duhet të sigurojë një referencë të saktë për paragrafët e standardit ose kornizës së zbatuar.

### *Përfshirja me referencë*

16. Kur njësi ekonomike përfshin informacion me referencë (shih ESRS 1 seksioni 9.1 *Përfshirja me referencë*), ajo duhet të paraqesë një listë të kërkesave për informacione shpjeguese të ESRS, ose pikat specifike të të dhënave të mandatuara nga një Kërkesë për Dhënie Informacioni, që janë përfshirë me referencë.

#### **▼C1**

### *Përdorimi i dispozitave të fazës së hyrjes në fuqi në përputhje me Shtojcën C të ESRS 1*

#### **▼B**

17. Nëse një njësi ekonomike ose grup që në datën e bilancit të saj nuk e kalon numrin mesatar prej 750 punonjësish gjatë vitit financiar, vendos të heqë informacionin e kërkuar nga ESRS E4, ESRS S1, ESRS S2, ESRS S3 ose ESRS S4 në përputhje me Shtojcën C të ESRS 1, ajo megjithatë duhet të japë informacion nëse temat e qëndrueshmërisë respektivisht sipas ESRS4. S1, ESRS S2, ESRS S3 dhe ESRS S4 janë vlerësuar të jenë materiale si rezultat i vlerësimit të materialitetit të njësisë ekonomike. Përveç kësaj, nëse një ose më shumë nga këto tema janë vlerësuar si materiale, njësi ekonomike, për secilën temë të rëndësishme duhet:

- (a) të japë listën e çështjeve (d.m.th. temën, nën-temën ose nën-nën-temën) në AR 16 ESRS 1 Shtojca A që vlerësohen të jenë materiale dhe të përshkruajë shkurtimisht se si **modeli i biznesit** dhe strategjia e njësisë ekonomike marrin parasysh ndikimet e njësisë ekonomike në lidhje me ato çështje. Njësia ekonomike mund të identifikojë çështjen në nivelin e temës, nën-temës ose nën-nën-temës;
- (b) të përshkruajë shkurtimisht çdo **objektiv** të kufizuar në kohë që ka vendosur në lidhje me çështjet në fjalë, progresin që ka bërë drejt arritjes së këtyre objektivave dhe nëse objektivat e saj që kanë të bëjnë me **biodiversitetin** dhe **ekosistemet** janë bazuar në prova përfundimtare shkencore;
- (c) të përshkruajë shkurtimisht **politikat** e saj në lidhje me çështjet në fjalë;
- (d) të përshkruajë shkurtimisht **veprimet** ka marrë përsipër të identifikojë, monitorojë, parandalojë, zbusë, korrigjojë ose t'i japë fund ndikimeve negative aktuale ose të pritshme në lidhje me çështjet në fjalë dhe rezultatin e veprimeve të tilla; dhe
- (e) të japë informacion shpjegues për **treguesit sasiore (metrikat)** që kanë lidhje me çështjet në fjalë.

## 2. Qeverisja

- 18. Objektivi i këtij kapitulli është të përcaktojë kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese që mundësojnë të kuptuarit e proceseve të qeverisjes, kontrolleve dhe procedurave të vendosura për të monitoruar, menaxhuar dhe mbikëqyrur **çështjet e qëndrueshmërisë**.

### Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese GOV -1– Roli i organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse

- 19. Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për përbërjen e organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse, rolet dhe përgjegjësitë e tyre, si dhe aksesin në ekspertizë dhe aftësi në lidhje me çështjet e qëndrueshmërisë.
- 20. Objektivi i kësaj kërkesë për informacione shpjeguese është të sigurojë një kuptueshmëri të:
  - (a) përbërjes dhe diversitetit të organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse;
  - (b) roleve dhe përgjegjësisë të organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse në ushtrimin e mbikëqyrjes së procesit për të menaxhuar ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë, duke përfshirë rolin e drejtuesve në këto procese; dhe
  - (c) ekspertizës dhe aftësisë së organeve të saj administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse për çështjet e qëndrueshmërisë ose qasjes së saj ndaj ekspertizës dhe aftësive të tilla.

21. Njësia ekonomike duhet të japë informacionin e mëposhtëm në lidhje me përbërjen dhe diversitetin e anëtarëve të organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse të njësisë ekonomike:
- (a) numrin e anëtarëve ekzekutivë dhe joekzekutivë;
  - (b) përfaqësimin e **punonjësve** dhe punëtorëve të tjerë;
  - (c) përvojën përkatëse për sektorët, produktet dhe vendndodhjet gjeografike të njësisë ekonomike;
  - (d) përqindjen sipas gjinisë dhe aspekte të tjera të diversitetit që merr parasysh njësia ekonomike. Diversiteti gjinor i bordit drejtues<sup>15</sup> do të llogaritet si një raport mesatar i anëtarëve femra të bordit ndaj meshkujve; dhe
  - (e) përqindjen e **anëtarëve të pavarur të bordit**.<sup>16</sup> Për njësitë ekonomike me një nivel drejtues, kjo korrespondon me përqindjen e anëtarëve të pavarur të bordit joekzekutiv. Për njësitë ekonomike me dy borde drejtuese, ajo korrespondon me përqindjen e anëtarëve të pavarur të organit mbikëqyrës.
22. Njësia ekonomike duhet të japë informacionin e mëposhtëm në lidhje me rolin dhe përgjegjësitë e anëtarëve të organeve **administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse të njësisë ekonomike**:
- (a) identitetin e **organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse** (të tilla si një komitet, bord ose të ngjashme) ose individ(ët) brenda një organi përgjegjës për mbikëqyrjen e **ndikimeve, rreziqeve dhe mundësive**;
  - (b) si pasqyrohen përgjegjësitë e secilit organ ose individ për ndikimet, rreziqet dhe mundësitë në termat e referencës së njësisë ekonomike, mandatet e bordit dhe **politikat** e tjera të lidhura me to;
  - (c) një përshkrim të rolit të drejtuesve në proceset e qeverisjes, kontrollet dhe procedurat e përdorura për të monitoruar, menaxhuar dhe mbikëqyrur ndikimet, rreziqet dhe mundësitë, duke përfshirë:
    - i. nëse ai rol i delegohet një pozicioni apo komiteti specifik të nivelit drejtues dhe si ushtrohet mbikëqyrja mbi atë pozicion apo komitet;
    - ii. informacionin në lidhje me linjat e raportimit tek organet administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse;

---

<sup>15</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve të tregut financiar objekt të Rregullores (BE) 2019/2088 sepse vjen nga një tregues shtesë i lidhur me ndikimet negative kryesore siç paraqitet në treguesin #13 në Tabelën I të Aneksit I, të Rregullores së Deleuar të Komisionit (BE) 2022/1288 të datës 6 prill 2022 që plotëson Rregulloren (BE) 2019/2088 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese për investimet e qëndrueshme ('Diversiteti gjinor i bordit') dhe administratorët e standardeve më të mira për paraqitjen e faktorëve ESG që i nënshtrohen Rregullores së Deleuar të Komisionit (BE) 2020/1818 të datës 17 korrik 2020 që plotëson Rregulloren (BE) 2016/1011 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit siç përcaktohet nga treguesi 'Raporti mesatar i ponderuar i anëtarëve të bordit femra ndaj meshkujve' në seksionin 1 dhe 2 të Aneksit II.

<sup>16</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të administratorëve të standardeve më të mira për të dhënë informacion shpjegues për faktorët ESG që i nënshtrohen Rregulloret (BE) 2020/1816 siç përcaktohet nga treguesi 'Përqindja mesatare e ponderuar e anëtarëve të bordit që janë të pavaruar' në seksionin 1 të Aneksit II.

- iii. nëse kontrollet dhe procedurat e dedikuara zbatohen për menaxhimin e ndikimeve, rreziqeve dhe mundësive dhe, nëse po, si janë integruar ato me funksione të tjera të brendshme; dhe
  - (d) si organet administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse dhe drejtuesit e lartë ekzekutiv mbikëqyrin vendosjen e objektivave lidhur me ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë, dhe si monitorojnë progresin drejt tyre.
23. Informacioni që jepet duhet të përfshijë një përshkrim se si **organet administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse** përcaktojnë nëse aftësitë dhe ekspertiza e duhur janë në dispozicion ose do të zhvillohen për të mbikëqyrur **çështjet e qëndrueshmërisë**, duke përfshirë:
- (a) ekspertizën e lidhur me qëndrueshmërinë që organet, në tërësi, ose e posedojnë drejtpërdrejt ose mund ta përdorin, për shembull nëpërmjet qasjes të ekspertëve ose trajnimit; dhe
  - (b) se si këto aftësi dhe ekspertiza lidhen me ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë e njësisë ekonomike.

### **Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese GOV-2 – Informacioni i dhënë dhe çështjet e qëndrueshmërisë të adresuara nga organet administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse të njësisë ekonomike**

24. **Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues se si organet administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse janë të informuara për çështjet e qëndrueshmërisë dhe se si janë adresuar këto çështje gjatë periudhës raportuese.**
25. Objektivi i kësaj kërkesë për informacione shpjeguese është të sigurojë një kuptim se si **organet administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse** janë të informuar për **çështjet e qëndrueshmërisë**, si dhe për informacionin dhe çështjet që kanë trajtuar gjatë periudhës raportuese. Kjo nga ana tjetër mundëson të kuptuarit nëse anëtarët e këtyre organeve ishin të informuar në mënyrë adekuate dhe nëse ata ishin në gjendje të përmbushnin rolet e tyre.
26. Njësia ekonomike duhet të japë informacionin e mëposhtëm:
- (a) nëse, nga kush dhe sa shpesh **organet administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse**, duke përfshirë komitetet e tyre përkatëse, janë të informuar për ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë (shih Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese IRO-1 - *Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë* e këtij Standardi), zbatimin e kujdesit të duhur dhe rezultatet dhe efektivitetin e **politikave, veprimeve, matjeve dhe objektivat** e miratuara për t'i adresuar ato;
  - (b) se si organet administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse të marrin në konsideratë ndikimet, rreziqet dhe mundësitë kur mbikëqyrin strategjinë e njësisë ekonomike, vendimet e saj për transaksionet kryesore dhe procesin e menaxhimit të rrezikut, duke

përfshirë nëse ata kanë marrë parasysh kompromiset që lidhen me ato ndikime, rreziqe dhe mundësi; dhe

- (c) një listë të ndikimeve materiale, rreziqeve dhe mundësive të adresuara nga organet administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse, ose komitetet e tyre përkatëse gjatë periudhës raportuese.

### **Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese GOV-3– Integrimi i performancës së lidhur me qëndrueshmërinë në skemat stimuluese**

27. **Njësia ekonomike duhet të japë informacion rreth integritit të performancës së saj të lidhur me qëndrueshmërinë në skemat stimuluese.**
28. Objektivi i kësaj kërkesë për Dhënie Informacione Shpjeguese është të sigurojë një kuptim nëse skemat nxitëse u ofrohen anëtarëve të organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse që janë të lidhura me çështjet e qëndrueshmërisë.
29. Njësia ekonomike duhet të japë informacionin e mëposhtëm në lidhje me skemat nxitëse dhe **politikat** e shpërblimit për anëtarët e **organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse** të njësisë ekonomike, lidhur me **çështjet e qëndrueshmërisë**, në ato raste ku ato ekzistojnë:
- (a) një përshkrim të karakteristikave kryesore të skemave nxitëse;
  - (b) nëse performanca është duke u vlerësuar kundrejt **objektivave** specifike të lidhura me qëndrueshmërinë dhe/ose ndikimeve të saj, dhe nëse po, cilat;
  - (c) nëse dhe si metrikat e performancës që lidhen me qëndrueshmërinë konsiderohen si standarde të performancës ose përfshihen në politikat e shpërblimit;
  - (d) përqindjen e shpërblimit të dhënë që varet nga objektivat dhe/ose ndikimet e lidhura me qëndrueshmërinë; dhe
  - (e) nivelin e organigramës të njësisë ekonomike në të cilin miratohen dhe përditësohen kushtet e skemave stimuluese.

### **Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese GOV-4 - Deklaratë për kujdesin e duhur**

30. **Njësia ekonomike duhet të japë një hartë të informacionit të dhënë në deklaratën e saj të qëndrueshmërisë në lidhje me procesin e kujdesit të duhur.**
31. Objektivi i kësaj kërkesë për informacion shpjegues është të lehtësojë të kuptuarit e procesit të kujdesit të duhur të njësisë ekonomike në lidhje me **çështjet e qëndrueshmërisë**.
32. Aspektet kryesore dhe hapat e kujdesit të duhur të përmenduara në ESRS 1 Kapitulli 4 *Kujdesi i duhur*, lidhen me një numër kërkesash për Informacione Shpjeguese të ndërthurura dhe

tematike sipas ESRS. Njësia ekonomike duhet të sigurojë një hartë që shpjegon se si dhe ku reflektohen në deklaratën e saj të qëndrueshmërisë zbatimi i aspekteve dhe hapave kryesorë të procesit të kujdesit të duhur, për të lejuar një përshkrim të praktikave aktuale të njësisë ekonomike në lidhje me kujdesin e duhur.<sup>17</sup>

33. Kjo kërkesë për informacione shpjeguese nuk mandaton ndonjë kërkesë specifike të sjelljes në lidhje me veprimet e kujdesit të duhur dhe nuk e zgjeron apo modifikon rolin e **organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse** siç kërkohet nga legjislacioni ose rregullorja tjetër.

### **Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese GOV -5- Menaxhimi i rrezikut dhe kontrollet e brendshme mbi raportimin e qëndrueshmërisë**

34. **Njësia ekonomike duhet të paraqesë tiparet kryesore të sistemit të saj të menaxhimit të rrezikut dhe kontrollit të brendshëm në lidhje me procesin e raportimit të qëndrueshmërisë.**
35. Objektivi i kësaj kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese është të sigurojë një kuptueshmëri të menaxhimit të rrezikut dhe proceseve të kontrollit të brendshëm të njësisë ekonomike në lidhje me raportimin e qëndrueshmërisë.
36. Njësia ekonomike duhet të japë informacionin e mëposhtëm:
- (a) fushëveprimin, tiparet kryesore dhe komponentët e proceseve dhe sistemeve të menaxhimit të rrezikut dhe kontrollit të brendshëm në lidhje me raportimin e qëndrueshmërisë;
  - (b) qasjen e ndjekur për vlerësimin e rrezikut, duke përfshirë metodologjinë e prioritizimit të rrezikut;
  - (c) rreziqet kryesore të identifikuara dhe strategjitë për zbutjen e tyre, duke përfshirë kontrollet përkatëse;
  - (d) një përshkrim se si njësia ekonomike përfshin gjetjet e vlerësimit të rrezikut dhe kontrolleve të brendshme në lidhje me procesin e raportimit të qëndrueshmërisë në funksionet dhe proceset përkatëse të brendshme; dhe
  - (e) një përshkrim të raportimit periodik të gjetjeve të përmendura në pikën (d) për **organet administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse**.

---

<sup>17</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve të tregut financiar objekt të Rregullores (BE) 2019/2088 sepse vjen nga një tregues i detyrueshëm i lidhur me ndikimet negative kryesore siç paraqitet në treguesin #10 në Tabelën III të Aneksit I, të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese për investimet e qëndrueshme ('Mungesa kujdesit të duhur').

### 3. Strategjia

37. Ky kapitull përcakton kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese që mundësojnë të kuptuarit:
- (a) e elementeve të strategjisë së njësisë ekonomike që lidhen ose ndikojnë në çështjet e qëndrueshmërisë, modelit të saj të biznesit dhe zinxhirit të vlerës;
  - (b) se si interesat dhe pikëpamjet e **palëve të interesuara** të njësisë ekonomike merren parasysh nga strategjia dhe modeli i biznesit të njësisë ekonomike; dhe
  - (c) të rezultatit të vlerësimit të njësisë ekonomike për ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë, duke përfshirë mënyrën se si ato informojnë strategjinë dhe modelin e saj të biznesit.

#### **Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese SBM -1– Strategjia, modeli i biznesit dhe zinxhiri i vlerës**

38. **Njësia ekonomike duhet të paraqesë elementet e strategjisë së saj që lidhen ose ndikojnë në çështjet e qëndrueshmërisë, modelin e saj të biznesit dhe zinxhirin e saj të vlerës.**
39. Objektivi i kësaj kërkesë për informacione shpjeguese është të përshkruajë elementët kryesorë të strategjisë së përgjithshme të njësisë ekonomike që lidhen ose ndikojnë në **çështjet e qëndrueshmërisë** dhe elementët kyç të **modelit të biznesit** të njësisë ekonomike dhe **zinxhirin e vlerës**, për të siguruar një kuptueshmëri të ekspozimit të saj ndaj **ndikimeve, rreziqeve dhe mundësive** dhe nga e kanë origjinën.
40. Njësia ekonomike duhet të japë informacionin e mëposhtëm në lidhje me elementët kryesorë të strategjisë së saj të përgjithshme që lidhen ose ndikojnë në **çështjet e qëndrueshmërisë**:
- (a) një përshkrim të:
    - i. grupeve të rëndësishme të produkteve dhe/ose shërbimeve të ofruara, duke përfshirë ndryshimet në periudhën e raportimit (produkte dhe/ose shërbime të reja dhe ato që janë hequr);
    - ii. tregjeve të rëndësishme dhe/ose grupeve të klientëve të shërbyer, duke përfshirë ndryshimet në periudhën e raportimit (tregje të reja/të hequra dhe/ose grupe klientësh të rinj/të hequr);
    - iii. numrit të **punonjësve** sipas zonave gjeografike; dhe
    - iv. produkteve dhe shërbimeve që janë të ndaluara në tregje të caktuara aty ku është e aplikueshme dhe materiale;
  - (b) një ndarje e të ardhurave totale, siç përfshihen në pasqyrat financiare, sipas sektorëve të rëndësishëm të ESRS. Kur njësia ekonomike paraqet raportim të segmentit siç kërkohet nga SNRF 8 *Segmentet e veprimtarive* në pasqyrat e saj financiare, ky informacion i të

ardhurave të sektorit duhet të harmonizohet, sa më shumë që të jetë e mundur, me informacionin e SNRF 8;

- (c) një listë të sektorëve shtesë të rëndësishëm të ESRS përtej atyre të pasqyruar në paragrafin 40(b), të tilla si aktivitetet që sjellin të ardhura brenda grupit, në të cilat njësia ekonomike zhvillon aktivitete të rëndësishme, ose në të cilat ajo është ose mund të lidhet me ndikime materiale. Identifikimi i këtyre sektorëve shtesë të ESRS duhet të jetë në përputhje me mënyrën se si ato janë marrë parasysh nga njësia ekonomike gjatë kryerje së vlerësimit të **materialitetit** të saj dhe mënyrën se si ajo paraqet informacionin e rëndësishëm specifik për sektorin;
- (d) aty ku është e zbatueshme, një deklaratë që tregon, së bashku me të ardhurat përkatëse, që njësia ekonomike është aktive:
- i. në sektorin e **lëndëve djegëse** fosile (qymyri, nafta dhe gazi),<sup>18</sup> (d.m.th., ajo nxjerr të ardhura nga eksplorimi, minierat, nxjerrja, prodhimi, përpunimi, ruajtja, rafinimi ose shpërndarja, duke përfshirë transportin, ruajtjen dhe tregtinë e karburanteve fosile siç përcaktohet në nenin 2, pika (62), të Rregullores (BE) 2018/1999 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit),<sup>19</sup> duke përfshirë një ndarje të të ardhurave të nxjerra nga qymyri, nga nafta dhe nga gazi, si dhe të ardhurat e nxjerra nga aktivitetet ekonomike të lidhura me gazin fosil të lidhura me Taksonominë, siç kërkohet sipas nenit 8(7)(a) të Rregullores së Deleguar të Komisionit 2021/2178;<sup>20</sup>
  - ii. në prodhimin e kimikateve,<sup>21</sup> d.m.th, aktivitetet e saj klasifikohen nën Divizionin 20.2 të Aneksit I të Rregullores (EC) Nr. 1893/2006;
  - iii. në sektorin e armëve të diskutueshme<sup>22</sup> (mina kundër njerëzve, municione thërmuese, armë kimike dhe armë biologjike); dhe/ose
  - iv. në kultivimin dhe prodhimin e duhanit;<sup>23</sup>

---

<sup>18</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve të tregut financiar objekt të Rregullores (BE) 2019/2088 sepse vjen nga një tregues shtesë i lidhur me ndikimet negative kryesore siç paraqitet në treguesin #4 në Tabelën I të Aneksit I, të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese për investimet e qëndrueshme ('Ekspozimi ndaj shoqërive aktive në sektorin e karburantit fosil').

<sup>19</sup> Rregullorja (BE) 2018/1999 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 dhjetor 2018 mbi Qeverisjen e Unionit të Energjisë dhe Veprimet për Klimën, ndryshoi Rregulloret (KE) Nr. 663/2009 dhe (KE) Nr. 715/2009/ të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, Direktivat 94/22/KE, 98/70/KE, 2009/31/KE, 2009/73/KE, 2010/31/BE, 2012/27/BE dhe 2013/30/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, Direktivat e Këshillit 2009/119/KE dhe (BE) 2015/652 dhe shfuqizoi Rregulloren (BE) Nr. 525/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (GZ L 328, 21.12.2018, f. 1).

<sup>20</sup> Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2021/2178 e datës 6 korrik 2021 që plotëson Rregulloren (BE) 2020/852 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit duke specifikuar përmbajtjen dhe paraqitjen e informacionit që duhet të jepet nga njësitë ekonomike që i nënshtrohen neneve 19a ose 29a të Direktivës 2013/34/BE në lidhje me aktivitetet ekonomike të qëndrueshme mjedisore dhe specifikon metodologjinë për të respektuar atë detyrim për dhënie informacioni shpjegues (GZ L 443, 10.12.2021, f. 9).

<sup>21</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve të tregut financiar objekt të Rregullores (BE) 2019/2088 sepse vjen nga një tregues shtesë i lidhur me ndikimet negative kryesore siç paraqitet në treguesin #9 në Tabelën II të Aneksit I, të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese për investimet e qëndrueshme ('Investimet në shoqëritë që prodhojnë kimikate').

<sup>22</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve të tregut financiar objekt të Rregullores (BE) 2019/2088 sepse vjen nga një tregues shtesë i lidhur me ndikimet negative kryesore siç paraqitet në treguesin #14 në Tabelën I të Aneksit I, të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese për investimet e qëndrueshme ('Ekspozimi ndaj armëve të diskutueshme (mina kundër njeriut, municione thërmuese, armë kimike dhe armë biologjike)').

<sup>23</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të administratorëve të standardeve më të mira për të dhënë informacion shpjegues mbi faktorët ESG që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2020/1818 siç paraqitet në paragrafin b) të nenit 12.1.

- (e) synimet e saj të lidhura me qëndrueshmërinë për sa i përket grupeve të rëndësishme të produkteve dhe shërbimeve, kategorive të klientëve, zonave gjeografike dhe marrëdhënieve me **palët e interesuara**;
  - (f) një vlerësim të produkteve dhe/ose shërbimeve të saj aktuale të rëndësishme, dhe tregjeve dhe grupeve të klientëve të rëndësishëm, në lidhje me objektivat e saj të lidhura me qëndrueshmërinë; dhe
  - (g) elementet e strategjisë së njësisë ekonomike që lidhen ose ndikojnë në çështjet e qëndrueshmërisë, duke përfshirë sfidat kryesore përpara, zgjidhjet kritike ose projektet që duhen zbatuar, kur është e rëndësishme për raportimin e qëndrueshmërisë.
41. Nëse njësi ekonomike është e bazuar në një Shtet Anëtar të BE-së që lejon një përjashtim nga dhënia e informacioneve shpjeguese të përmendur në nenin 18, paragrafi 1, nënpika (a) e Direktivës 2013/34/BE <sup>(24)</sup>, dhe nëse njësi ekonomike e ka përdorur atë përjashtim, ajo mund të mos e përfshijë ndarjen e të ardhurave sipas sektorëve të rëndësishëm ESRS të kërkuar nga paragrafi 40(b). Megjithatë, në këtë rast, njësi ekonomike duhet të paraqesë listën e sektorëve të ESRS që janë të rëndësishëm për ndërmarrjen.
42. Njësi ekonomike duhet të japë një përshkrim të **modelit të saj të biznesit** dhe **zinxhirit të vlerës**, duke përfshirë:
- (a) (a) inputet e saj dhe qasjen e saj për mbledhjen, zhvillimin dhe sigurimin e këtyre inputeve;
  - (b) (b) rezultatet dhe produktet e saj në terma të përfitimeve aktuale dhe të pritshme për klientët, investitorët dhe **palët e tjera të interesuara**; dhe
  - (c) (c) tiparet kryesore të zinxhirit të vlerës në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme dhe pozicionin e njësisë ekonomike në zinxhirin e vlerës, duke përfshirë një përshkrim të aktorëve kryesorë të biznesit (siç janë furnitorët kryesorë, klientët, kanalet e shpërndarjes dhe përdoruesit fundor) dhe marrëdhëniet e tyre me ndërmarrjen. Kur njësi ekonomike ka zinxhirë të shumëfishtë vlerash, informacioni i dhënë duhet të mbulojë zinxhirët kryesorë të vlerës.

## **Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese SBM -2– Interesat dhe pikëpamjet e palëve të interesuara**

43. **Njësi ekonomike duhet të paraqesë se si interesat dhe pikëpamjet e palëve të interesuara merren parasysh nga strategjia dhe modeli i biznesit të njësisë ekonomike.**

---

<sup>24</sup> Neni 18, paragrafi 1, nënpika (a) e Direktivës 2013/34/Be: *xhiroja neto e ndarë sipas kategorive të aktivitetit dhe gjeografisë së tregjeve, për sa kohë këto kategori dhe tregje dallojnë ndjeshëm nga njëri tjetri, duke marrë parasysh mënyrën se si organizohet shitja e produkteve dhe ofrimi i shërbimeve.*

44. Objektivi i kësaj kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese është të sigurojë një kuptueshmëri se si interesat dhe pikëpamjet e palëve të interesuara informojnë strategjinë dhe **modelin e biznesit** të njësisë ekonomike.
45. Njësia ekonomike duhet të japë një përshkrim të përmbledhur:
- (a) të angazhimit të palëve të saj të interesuara, duke përfshirë:
    - i. **palët kryesore** të interesit të njësisë ekonomike;
    - ii. nëse ka ndonjë angazhim me to dhe për cilat kategori të palëve të interesuara është ky angazhim;
    - iii. si është organizuar;
    - iv. qëllimi i angazhimit; dhe
    - v. si merret parasysh rezultati i këtij angazhimi nga njësia ekonomike;
  - (b) të kuptuarit nga ana e njësisë ekonomike të interesave dhe pikëpamjeve të **palëve kryesore** pasi ato lidhen me strategjinë dhe **modelin e biznesit** të njësisë ekonomike, në masën që këto janë analizuar gjatë procesit të kujdesit të duhur dhe/ose procesit të vlerësimit të **materialitetit** të njësisë ekonomike (shih Kërkesën për Dhënie Informacione Shpjeguese IRO-1 të këtij Standardi);
  - (c) ndryshimeve në strategjinë dhe/ose modelin e tij të biznesit nëse është e zbatueshme, duke përfshirë:
    - i. se si njësia ekonomike ka ndryshuar ose pret të ndryshojë strategjinë dhe/ose modelin e saj të biznesit për të adresuar interesat dhe pikëpamjet e palëve të interesuara;
    - ii. çdo hap tjetër që është duke u planifikuar dhe në çfarë afati kohor; dhe
    - iii. nëse këto hapa ka të ngjarë të modifikojnë marrëdhëniet dhe pikëpamjet e palëve të interesuara; dhe
  - (d) nëse **organet administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse** janë të informuar për pikëpamjet dhe interesat e **palëve të interesuara** për sa i takon ndikimeve të njësisë ekonomike në lidhje me qëndrueshmërinë dhe si janë të informuara.

### **Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese SBM -3- Ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit**

46. Njësia ekonomike duhet të paraqesë ndikimet e saj materiale, rreziqet dhe mundësitë dhe mënyrën se si ato ndërveprojnë me strategjinë dhe modelin e saj të biznesit.
47. Objektivi i kësaj kërkesë për informacione shpjeguese është të sigurojë një kuptueshmëri të **ndikimeve** të materiale, **rreziqeve** dhe **mundësive** pasi ato rezultojnë nga vlerësimi i materialitetit të njësisë ekonomike dhe nga mënyra se si ato kanë origjinën dhe shkaktojnë

përshtatjen e strategjisë dhe modelit të biznesit të njësisë ekonomike duke përfshirë alokimin e burimeve të saj. Informacioni që duhet të paraqitet në lidhje me menaxhimin e ndikimeve materiale, rreziqeve dhe mundësive të njësisë ekonomike përshkruhet në ESRS përkatëse dhe në standardet specifike të sektorit, të cilat do të zbatohen në lidhje me **Kërkesat Minimale të Dhënies së informacioneve shpjeguese** mbi **politikat, veprimet dhe objektivat** vendosur në këtë Standard.

48. Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese:

- (a) një përshkrim të shkurtër të **ndikimeve** materiale, **rreziqeve dhe mundësive** që rezultojnë nga vlerësimi i materialitetit të saj (shih Kërkesën e Dhënies së informacioneve shpjeguese IRO-1 të këtij standardi), duke përfshirë një përshkrim se ku janë të përqendruara këto ndikime materiale, rreziqe dhe mundësi në modelin e saj të biznesit, në aktivitetet e veta dhe në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës së saj;
- (b) për efektet aktuale dhe ato të pritshme të ndikimeve, rreziqeve dhe mundësive të saj materiale në modelin e biznesit, zinxhirin e vlerës, strategjinë dhe vendimmarrjen, dhe mënyrën se si është përgjigjur ose planifikon t'i përgjigjet këtyre efekteve, duke përfshirë çdo ndryshim që ka bërë ose planifikon të bëjë në strategjinë ose modelin e saj të biznesit si pjesë e veprimeve të saj për të trajtuar ndikime ose rreziqe të veçanta materiale, ose për të ndjekur mundësi të veçanta materiale;
- (c) në lidhje me **ndikimet** materiale të njësisë ekonomike të paraqesë:
  - i. si ndikimet materiale negative dhe pozitive të njësisë ekonomike (ose, në rastin e ndikimeve të mundshme, ka të ngjarë të ndikojnë) prekin njerëzit ose mjedisin;
  - ii. nëse dhe si ndikimet vijnë prej ose janë të lidhura me strategjinë dhe modelin e biznesit të njësisë ekonomike;
  - iii. afatet kohore të pritshme të arsyeshme të ndikimeve; dhe
  - iv. nëse njësia ekonomike është e përfshirë me ndikimet materiale nëpërmjet aktiviteteve të saj ose për shkak të **marrëdhënieve të saj të biznesit**, duke përshkruar natyrën e aktiviteteve ose marrëdhënieve të biznesit në fjalë;
- (d) për **efektet financiare aktuale** të rreziqeve dhe mundësive materiale të njësisë ekonomike në pozicionin e saj financiar, performancën financiare dhe flukset monetare si dhe rreziqet dhe mundësitë materiale për të cilat ekziston një rrezik i rëndësishëm i një rregullimi material brenda periudhës së ardhshme të raportimit vjetor të vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të raportuara në pasqyrat financiare përkatëse;
- (e) për efektet financiare të parashikuara të rreziqeve dhe mundësive materiale të njësisë ekonomike për pozicionin e saj financiar, performancën financiare dhe flukset monetare në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, duke përfshirë afatet kohore të pritshme të arsyeshme për këto efekte. Kjo do të përfshijë mënyrën se si njësia ekonomike pret që pozicioni i saj financiar, performanca financiare dhe flukset monetare

të ndryshojnë në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, duke pasur parasysh strategjinë e saj për të menaxhuar rreziqet dhe mundësitë, duke marrë parasysh:

i. planet e saj të investimeve dhe nxjerrjes jashtë përdorimit (për shembull, shpenzimet kapitale, blerjet dhe investimet kryesore, sipërmarrjet e përbashkëta, transformimi i biznesit, inovacioni, fushat e reja të biznesit dhe shpërbërjet e aktiveve), duke përfshirë dhe planet për të cilat njësia ekonomike nuk është e angazhuar në mënyrë kontraktore; dhe

ii. burimet e planifikuara të financimit për të zbatuar strategjinë e saj.

(f) informacion në lidhje me qëndrueshmërinë e strategjisë dhe modelit të biznesit të njësisë ekonomike në lidhje me kapacitetin e saj për të trajtuar ndikimet dhe rreziqet materiale dhe për të përfituar nga mundësitë e saj materiale. Njësia ekonomike duhet të japë një analizë cilësore dhe, kur është e zbatueshme, një analizë sasimore të elasticitetit, duke përfshirë mënyrën se si është kryer analiza dhe afatet kohore që janë zbatuar siç përcaktohet në ESRS 1 (shih ESRS 1 kapitulli 6 *Afatet kohore*). Kur jep informacion sasior, njësia ekonomike mund të japë një shumë të vetme ose me rangje diapazonesh;

(g) ndryshimet në ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë në krahasim me periudhën e mëparshme raportuese; dhe

(h) një specifikim të atyre ndikimeve, rreziqeve dhe mundësive që mbulohen nga ESRS Kërkesat për Dhënie të informacioneve shpjeguese në krahasim me ato që mbulohen nga njësia ekonomike duke dhëni informacione shpjeguese shtesë specifike për njësinë ekonomike.

49. Njësia ekonomike mund të japë informacionin përshkrues të kërkuar në paragrafin 46 së bashku me informacionin shpjegues të dhënë sipas ESRS-së përkatëse, në të cilin rast ajo do të paraqesë edhe një deklaratë të **ndikimeve materiale, rreziqeve dhe mundësive** së bashku me informacionet shpjeguese të saj të përgatitura sipas këtij kapitulli të ESRS 2.

## 4. Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë

### 4.1 Dhënia e informacioneve shpjeguese mbi procesin e vlerësimit të materialitetit

50. Ky kapitull përcakton kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese që mundësojnë të kuptuarit:

(a) e procesit për të identifikuar ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë; dhe

(b) e informacionit që, si rezultat i vlerësimit të materialitetit të tij, njësia ekonomike e ka përfshirë në **deklaratën e saj të qëndrueshmërisë**.

*Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese IRO -1- Përshkrimi i procesit për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë*

51. **Njësia ekonomike duhet të paraqesë procesin e saj për të identifikuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë e saj dhe për të vlerësuar se cilat janë materiale.**
52. Objektivi i kësaj kërkesë për informacione shpjeguese është të sigurojë një kuptueshmëri të procesit përmes të cilit njësia ekonomike identifikon **ndikimet, rreziqet dhe mundësitë** dhe vlerëson **materialitetin** e tyre, si bazë për përcaktimin e dhënies së informacioneve shpjeguese në **deklaratën e saj të qëndrueshmërisë** (shih ESRS 1 kapitulli 3 dhe kërkesat përkatëse të zbatimit, të cilat përcaktojnë kërkesat dhe parimet në lidhje me procesin për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë bazuar në parimin e materialitetit të dyfishtë).
53. Njësia ekonomike duhet të japë informacionin e mëposhtëm:
- (a) një përshkrim të metodologjive dhe supozimeve të zbatuara në procesin e përshkruar;
  - (b) një pasqyrë të procesit për të identifikuar, vlerësuar, priorizuar dhe monitoruar ndikimet e pritshme dhe aktuale të njësisë ekonomike mbi njerëzit dhe mjedisin, të informuar nga procesi i kujdesit të duhur të njësisë ekonomike, duke përfshirë një shpjegim nëse dhe si procesi:
    - i. fokusohet në aktivitete specifike, marrëdhënie biznesi, gjeografi ose faktorë të tjerë që shkaktojnë rritje të rrezikut të ndikimeve negative;
    - ii. merr parasysh ndikimet me të cilat është përfshirë njësia ekonomike nëpërmjet veprimtarive të saj ose si rezultat i marrëdhënieve të saj të biznesit;
    - iii. përfshin konsultimin me palët e prekura për të kuptuar se si mund të ndikohen dhe konsultimin me ekspertë të jashtëm;
    - iv. i jep përparësi ndikimeve negative bazuar në ashpërsinë dhe gjasat e tyre përkatëse (shih ESRS 1 seksioni 3.4 *Materialiteti i ndikimit*) dhe, nëse është e zbatueshme, ndikimet pozitive përkatëse në shkallën, fushëveprimin dhe gjasat e tyre, dhe përcakton se cilat çështje të qëndrueshmërisë janë materiale për qëllime raportimi, duke përfshirë pragjet cilësore ose sasiore dhe kritere të tjera të përdorura siç përshkruhet nga ESRS 1 seksioni 3.4 *Materialiteti i ndikimit*;
  - (c) një pasqyrë të procesit të përdorur për identifikimin, vlerësimin, priorizimin dhe monitorimin e **rreziqeve dhe mundësive** që kanë ose mund të kenë **efekte financiare**. Dhënia e informacioneve shpjeguese duhet të përfshijë:
    - i. si i ka konsideruar njësia ekonomike lidhjet e ndikimeve dhe varësive të saj me rreziqet dhe mundësitë që mund të lindin nga ato ndikime dhe varësi;
    - ii. ► **C1** si i vlerëson njësia ekonomike gjasat, madhësinë dhe natyrën e efekteve të rrezikut dhe mundësive të identifikuara (siç janë pragjet cilësore ose sasiore dhe

kriteret e tjera të përdorura siç përshkruhet nga SSRS 1 seksioni 3.5 *Materialiteti financiar*); ◀

- iii. si njësi ekonomike i jep përparësi rreziqeve të lidhura me qëndrueshmërinë në lidhje me llojet e tjera të rreziqeve, duke përfshirë përdorimin e mjeteve të vlerësimit të rrezikut;
- (d) një përshkrim të procesit të vendimmarrjes dhe procedurave përkatëse të kontrollit të brendshëm;
- (e) shkallën e përfshirjes së procesit për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar ndikimet dhe rreziqet në procesin e përgjithshëm të menaxhimit të rrezikut të njësisë ekonomike dhe përdorimi i tyre për të vlerësuar profilin e përgjithshëm të rrezikut dhe proceset e menaxhimit të rrezikut të njësisë ekonomike;
- (f) shkallën e përfshirjes së procesit për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar mundësitë në procesin e përgjithshëm të menaxhimit të njësisë ekonomike, aty ku është e zbatueshme;
- (g) të dhënat e inputeve që janë përdorur (për shembull, burimet e të dhënave, fushëveprimi i aktiviteteve të mbuluara dhe detajet e përdorura në supozimet); dhe
- (h) nëse ka ndryshuar dhe si ka ndryshuar procesi në krahasim me periudhën e mëparshme të raportimit, kur procesi është modifikuar për herën e fundit dhe datat e ardhshme të rishikimit të materialitetit vlerësimi.

*Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese IRO-2 - Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese në ESRS që mbulohen nga deklaratat e qëndrueshmërisë së njësisë ekonomike*

- 54. **Njësia ekonomike duhet të raportojë mbi Kërkesat e Dhënies së informacioneve shpjeguese të përmbushura në deklaratat e saj të qëndrueshmërisë.**
- 55. Objektivi i kësaj Kërkese për Dhënie informacionesh shpjeguese është të sigurojë një kuptueshmëri të Kërkesave për Dhënie Informacionesh të përfshira në deklaratën e qëndrueshmërisë së njësisë ekonomike dhe temave që janë lënë jashtë si jo materiale, si rezultat i vlerësimit të **materialitetit**.
- 56. Njësia ekonomike do të përfshijë një listë të Kërkesave për Dhënie të Informacioneve shpjeguese të që ka përmbushur kur përgatit **deklaratën e qëndrueshmërisë**, sipas rezulttit të vlerësimit të **materialitetit** (shih ESRS 1 kapitulli 3), duke përfshirë numrat e faqeve dhe/ose paragrafët ku është dhënë informacioni përkatës në deklaratën e qëndrueshmërisë. Kjo mund të paraqitet në formën e një table të përmbajtjes. Njësia ekonomike do të përfshijë gjithashtu një tabelë të të gjitha pikave të të dhënave që rrjedhin nga legjislacioni tjetër i BE-së siç renditet në Shtojcën B të këtij standardi, duke treguar se ku mund të gjenden në deklaratën e qëndrueshmërisë dhe duke përfshirë ato që njësia ekonomike i ka vlerësuar si jo materiale, të cilat në këtë rast njësia ekonomike duhet ti shënojë me emërtimin "Jo materiale" në atë tabelë në përputhje me ESRS 1 paragrafi 35.

57. Nëse njësia ekonomike arrin në përfundimin se ndryshimi i klimës nuk është material dhe për rrjedhojë i lë jashtë të gjitha kërkesat për informacione shpjeguese në ESRS E1 *Ndryshimi i klimës*, ajo duhet të japë një shpjegim të detajuar të konkluzioneve të vlerësimit të materialitetit të saj në lidhje me ndryshimet klimatike (shih ESRS 2 IRO-2 *Kërkesat e Dhënies së informacioneve shpjeguese* në ESRS të *shtjelluara në deklaratën e qëndrueshmërisë së njësisë ekonomike*), duke përfshirë një analizë largpamëse të kushteve që mund ta çojnë njësinë ekonomike në përfundimin se ndryshimi klimatik është material në të ardhmen.
58. Nëse njësia ekonomike arrin në përfundimin se një temë tjetër përveç ndryshimeve klimatike nuk është materiale dhe për këtë arsye i lë jashtë trajtimit të gjitha Kërkesat e Dhënies së informacioneve shpjeguese në ESRS përkatëse, ajo mund të japë një shpjegim të shkurtër të përfundimeve të vlerësimit të **materialitetit** të saj për atë temë.
59. Njësia ekonomike duhet të japë një shpjegim se si ka përcaktuar informacionin e rëndësishëm që duhet të japë shpjegime në lidhje me **ndikimet, rreziqet dhe mundësitë** i cili është vlerësuar të jetë i rëndësishëm, duke përfshirë përdorimin e pragjeve dhe/ose mënyrën se si ka zbatuar njësia ekonomike kriteret në ESRS 1 seksioni 3.2 *Çështjet e rëndësishme dhe materialiteti i informacionit*.

## 4.2 Kërkesa minimale për informacione shpjeguese mbi politikat dhe veprimet

60. Ky seksion përcakton **kërkesat minimale të dhënies së informacioneve shpjeguese** që duhet të përfshihen kur njësia ekonomike paraqet informacion mbi **politikat** dhe **veprimet** e saj për të parandaluar, zbutur dhe korigjuar **ndikimet** materiale aktuale dhe të mundshme, për të adresuar **rreziqet** materiale dhe/ose për të ndjekur **mundësitë** materiale (në mënyrë të përmbledhur, për të "menaxhuar çështjet të rëndësishme të **qëndrueshmërisë**"). Ato do të zbatohen së bashku me Kërkesat e Dhënies së informacioneve shpjeguese, duke përfshirë Kërkesat për dhënie informacione shpjeguese, të parashikuara në ESRS përkatëse dhe specifike për sektorin. Ato do të zbatohen gjithashtu kur njësia ekonomike përgatit informacione shpjeguese specifike për njësinë ekonomike.
61. Dhënia e këtyre informacioneve shpjeguese do të vendoset së bashku me informacionet shpjeguese të përshkruara nga ESRS përkatëse. Kur një **politikë** e vetme ose veprime të njëjta adresojnë disa çështje të ndërlidhura të **qëndrueshmërisë**, njësia ekonomike mund të japë informacionin e kërkuar në raportimin e saj sipas një ESRS specifike, dhe t'i referohet këtij informacioni në raportimin e saj sipas ndonjë ESRS tjetër.
62. Nëse njësia ekonomike nuk mund të japë informacionin mbi politikat dhe veprimet që kërkohen sipas një ESRS përkatëse, sepse nuk ka miratuar politika dhe/ose veprime në lidhje me çështjen specifike të **qëndrueshmërisë** në fjalë, ajo do të paraqesë këtë si një rast, dhe do

të japë arsyet për mos zbatimin e politikave dhe/ose veprimeve. Njësia ekonomike mund të japë një afat kohor në të cilin synon t'i miratojë ato.

*Kërkesa Minimale për Informacione Shpjeguese - Politikat MDR -P - Politikat e miratuara për të menaxhuar çështjet e rëndësishme të qëndrueshmërisë*

63. Njësia ekonomike duhet të zbatojë **kërkesat minimale të dhënies** së informacioneve shpjeguese të përcaktuara në këtë dispozitë kur paraqet **politikat** që ajo ka vendosur në lidhje me çdo **çështje të rëndësishme të qëndrueshmërisë**.
64. Objektivi i kësaj **Kërkese për Minimumin e informacione shpjeguese** është të sigurojë një kuptueshmëri të politikave që njësia ekonomike ka për të parandaluar, zbutur dhe korrigjuar **ndikimet** aktuale dhe të mundshme, për të adresuar **rreziqet** dhe për të ndjekur **mundësitë**.
65. Njësia ekonomike duhet të japë informacione rreth **politikave** të miratuar për të menaxhuar **çështjet** të rëndësishme të **qëndrueshmërisë**. Informacioni i dhënë do të përfshijë informacionin e mëposhtëm:
  - (a) një përshkrim të përmbajtjes kryesore të **politikës**, duke përfshirë objektivat e saj të përgjithshme dhe me cilat **ndikime** të rëndësishme, **rreziqe ose mundësi** që kjo politikë ka të bëjë, si dhe procesin e monitorimit;
  - (b) një përshkrim të fushëveprimit të kësaj politike, ose përjashtimeve të saj, për sa i përket aktiviteteve, **zinxhirit të vlerës** në rrjedhën e sipërme dhe/ose në rrjedhën e poshtme, hapësirës gjeografike dhe nëse është e përshtatshme, grupet e **palëve të interesuara** të prekura;
  - (c) nivelin më të lartë në strukturën organizative të njësisë ekonomike që është përgjegjës për zbatimin e kësaj politike;
  - (d) një referencë, nëse është e përshtatshme, për standardet ose iniciativat e palëve të treta që njësia ekonomike zotohet të respektojë nëpërmjet zbatimit të politikës;
  - (e) nëse është e nevojshme, një përshkrim të konsideratës që u është dhënë interesave të **palëve kryesore të interesuara** në përcaktimin e politikës; dhe
  - (f) një informacion nëse njësia ekonomike e vë politikën në dispozicion të palëve të interesuara që mund të preken, dhe palëve të interesuara që duhet të ndihmojnë në zbatimin e saj, nëse është e përshtatshme dhe si e bën këtë.

*Kërkesa Minimale për Informacione Shpjeguese - Veprimet MDR -A - Veprimet dhe burimet në lidhje me çështjet e rëndësishme të qëndrueshmërisë*

66. Njësia ekonomike do të zbatojë kërkesat për përmbajtjen e informacioneve shpjeguese të dhëna në këtë dispozitë kur përshkruan **veprimet** nëpërmjet të cilave ajo menaxhon çdo **çështje të rëndësishme të qëndrueshmërisë** duke përfshirë planet e veprimit dhe burimet e alokuara dhe/ose të planifikuara.

67. Objektivi i kësaj ***Kërkese për Minimumin e Informacione Shpjeguese*** është të sigurojë një kuptueshmëri të veprimeve kryesore të ndërmarra dhe/ose të planifikuara për të ***parandaluar***, zbutur dhe korrigjuar ndikimet aktuale dhe të mundshme, dhe për të adresuar ***rreziqet dhe mundësitë***, dhe aty ku është e zbatueshme për të arritur objektivat dhe ***synimet*** e politikave në fjalë.
68. Aty ku zbatimi i një ***politike*** kërkon ***veprime***, ose një plan veprimi gjithëpërfshirës, për të arritur objektivat e saj, si dhe kur veprimet zbatohen pa një politikë specifike, njësia ekonomike duhet të japë informacionin e mëposhtëm:
- (a) listën e veprimeve kryesore të ndërmarra në vitin raportues dhe të planifikuara për të ardhmen, rezultatet e tyre të pritshme dhe, aty ku është e nevojshme, si kontribuon zbatimi i tyre në arritjen e objektivave dhe ***synimeve*** të politikës;
  - (b) fushën e veprimeve kyçe (d.m.th., mbulimin me aktivitete, rrjedhën e sipërme dhe/ose të poshtme të ***zinxhirit të vlerave***, hapësirat gjeografike dhe, sipas rastit, ***palët e interesuara*** të prekura grupe);
  - (c) afatet kohore sipas të cilave njësia ekonomike synon të përfundojë çdo veprim kyç;
  - (d) nëse është e aplikueshme, veprimet kryesore të ndërmarra (së bashku me rezultatet) për të siguruar dhe bashkëpunuar ose për të mbështetur në dhënien e ***zgjdhjes*** për ata që janë dëmtuar nga ndikimet aktuale materiale;
  - (e) nëse është e zbatueshme, informacionin sasior dhe cilësor në lidhje me ecurinë e veprimeve ose planeve të veprimit të shpallura në periudhat e mëparshme.
69. Kur zbatimi i një plani veprimi kërkon shpenzime të rëndësishme operacionale (Opex) dhe/ose shpenzime kapitale (Capex), njësia ekonomike duhet:
- (a) të përshkruajë llojin e burimeve financiare aktuale dhe të ardhshme dhe burime të tjera të alokuara për planin e veprimit, duke përfshirë nëse është e zbatueshme, kushtet përkatëse të instrumenteve të financimit të qëndrueshëm, të tilla si bonot e gjelbra, bonot sociale dhe kreditë e gjelbra, objektivat mjedisore ose sociale dhe nëse aftësia për të zbatuar veprimet ose planin e veprimit varet nga parakushtet specifike, p.sh., nga dhënia e mbështetjes financiare ose nga politikat publike dhe nga zhvillimi i tregut;
  - (b) të japë shumën e burimeve aktuale financiare dhe të shpjegojë se si ato lidhen me shifrat më të rëndësishme të paraqitura në pasqyrat financiare; dhe
  - (c) të tregojë shumën e burimeve financiare të ardhshme.

## 5. Metrikat dhe objektivat

70. Ky kapitull parashtron ***Kërkesat Minimale të Dhënies së Informacioneve Shpjeguese*** që do të përfshihen kur njësia ekonomike paraqet informacion mbi ***metrikat*** e saj dhe ***objektivat*** lidhur me çdo çështje të te rëndësishme të qëndrueshmërisë. Ato do të zbatohen së bashku

me Kërkesat e Dhënies së informacioneve shpjeguese, duke përfshirë Kërkesat për Zbatim, të parashikuara në një ESRS të veçantë. Ato do të zbatohen gjithashtu kur njësia ekonomike përgatit informacione shpjeguese specifike për njësinë ekonomike.

71. Dhënia e këtyre informacioneve shpjeguese do të vendoset së bashku me informacionet shpjeguese të përshkruara nga ESRS-ja përkatëse.
72. Nëse njësia ekonomike nuk mund të japë informacionin mbi objektivat që kërkohen sipas ESRS-së përkatëse, për shkak se nuk ka vendosur objektiva në lidhje me çështjen specifike të qëndrueshmërisë në fjalë, ajo duhet të paraqesë këtë si rast dhe të japë arsyet pse nuk i ka përcaktuar objektivat. Njësia ekonomike mund të japë një afat kohor në të cilin synon t'i miratojë ato.

### **Kërkesa minimale për informacione shpjeguese – Metrikat në MDR -M - Metrikat në lidhje me çështjet të rëndësishme të qëndrueshmërisë**

73. Njësia ekonomike do të zbatojë kërkesat për përmbajtjen e informacioneve shpjeguese të dhëna në këtë dispozitë kur jep informacione mbi **metrikat** që ajo ka vendosur në lidhje me çdo **çështje të rëndësishme të qëndrueshmërisë**.
74. Objektivi i kësaj **Kërkese për Minimumin e Informacioneve Shpjeguese** është të sigurojë një kuptueshmëri të **metrikave** që njësia ekonomike përdor për të gjurmuar efektivitetin e **veprimeve** të saj për të menaxhuar **çështjet e rëndësishme të qëndrueshmërisë**.
75. Njësia ekonomike duhet të paraqesë çdo **metrikë** që përdor për të vlerësuar performancën dhe efektivitetin, në lidhje me një ndikim të rëndësishëm, rrezik ose mundësi.
76. **Treguesit sasiorë** (ose metrikat) do të përfshijnë ato të përcaktuara në ESRS, si dhe metrikat e identifikuar mbi një bazë specifike të njësisë ekonomike, qoftë të marra nga burime të tjera ose të zhvilluara nga vetë njësia ekonomike.
77. Për çdo **metrikë** që përdor njësia ekonomike do të:
  - (a) tregojë metodologjitë dhe supozimet e rëndësishme që qëndrojnë pas këtyre metrikave, duke përfshirë kufizimet e metodologjive të përdorura;
  - (b) tregojë nëse matja e metrikave është vërtetuar nga një organ i jashtëm përveç certifikuesit të sigurisë dhe, nëse po, cili organ;
  - (c) piketojë dhe përcaktojë metrikat duke përdorur emra dhe përshkrime kuptimplotë, të qarta dhe të sakta;
  - (d) përdorë monedhën me të cilën janë paraqitur pasqyrat financiare të njësisë ekonomike, kur monedha është specifikuar si njësi matëse.

## Kërkesa Minimale për Informacione Shpjeguese Objektivat MDR– T – Ndjekja e efektivitetit të politikave dhe veprimeve përmes objektivate

78. Njësia ekonomike do të zbatojë kërkesat për përmbajtjen e informacioneve shpjeguese të dhëna në këtë dispozitë kur jep informacione rreth **objektivave** që ajo ka vendosur në lidhje me çdo **çështje të rëndësishme të qëndrueshmërisë**.
79. Objektivi i kësaj **Kërkesë Minimale për Informacione Shpjeguese** është të sigurojë një kuptueshmëri për çdo çështje të rëndësishme të qëndrueshmërisë e lidhur me:
- (a) nëse njësia ekonomike ndjek efektivitetin e veprimeve të saj për të adresuar **ndikimet e rëndësishme, rreziqet dhe mundësitë**, duke përfshirë **metrikat** të përdorur për ta bërë këtë dhe si e bën këtë;
  - (b) **objektivat** e matshëm të orientuar drejt rezultateve të kufizuara në kohë të vendosur nga njësia ekonomike për të përmbushur objektivat e **politikës**, të përcaktuara në terma të rezultateve të pritshme për njerëzit, mjedisin ose ndërmarrjen në lidhje me ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë;
  - (c) progresin e përgjithshëm drejt objektivate të miratuara me kalimin e kohës;
  - (d) në rast se njësia ekonomike nuk ka vendosur objektiva të matshme të orientuara drejt rezultateve të kufizuara në kohë, nëse ajo megjithatë ndjek efektivitetin e veprimeve të saj për të adresuar ndikimet e rëndësishme, rreziqet dhe mundësitë dhe mat progresin në arritjen e objektivate të **politikës** së saj dhe si ajo e bën këtë; dhe
  - (e) nëse **palët e interesuara** janë përfshirë në përcaktimin e objektivate për çdo çështje të rëndësishme të qëndrueshmërisë dhe si janë përfshirë.
80. Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese për **objektivat** e matshme, të orientuara drejt rezultateve dhe të kufizuara në kohë për **çështjet të rëndësishme të qëndrueshmërisë** që ajo ka vendosur për të vlerësuar progresin. Për çdo objektivi, informacioni i dhënë do të përfshijë informacionin e mëposhtëm:
- (a) një përshkrim të marrëdhënies midis qëllimit dhe **objektivate** të politikës;
  - (b) nivelin e përcaktuar të synuar që duhet arritur, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, nëse objektivi është absolut apo relativ dhe në cilën njësi matet;
  - (c) qëllimin e objektivit, duke përfshirë aktivitetet e njësisë ekonomike dhe/ose rrjedhën e sipërme dhe/ose rrjedhën e poshtme të **zinxhirit të vlerës** aty ku është e zbatueshme dhe kufijtë gjeografikë;
  - (d) vlerën bazë dhe vitin bazë nga i cili matet progresi i bërë;
  - (e) periudhën për të cilën objektivi zbatohet dhe nëse është e aplikueshme, çdo arritje ose objektivi të përkohshëm;

- (f) metodologjitë dhe supozimet e rëndësishme të përdorura për të përcaktuar objektivat, duke përfshirë aty ku është e zbatueshme, skenarin e përzgjedhur, burimet e të dhënave, përafrimin me qëllimet e politikave kombëtare, të BE-së ose ndërkombëtare dhe mënyrën se si objektivat marrin parasysh kontekstin më të gjerë të zhvillimit të qëndrueshëm dhe/ose situatën lokale në të cilën ndodhin ndikimet;
  - (g) nëse objektivat e njësisë ekonomike në lidhje me çështjet mjedisore bazohen në prova shkencore përfundimtare;
  - (h) nëse, dhe si **palët e interesuara** janë përfshirë në përcaktimin e objektivave për çdo çështje të rëndësishme të qëndrueshmërisë;
  - (i) çdo ndryshim në objektivat dhe **metrikat** përkatëse ose metodologjitë themelore të matjes, supozimet e rëndësishme, kufizimet, burimet dhe proceset për mbledhjen e të dhënave të miratuara brenda horizontit kohor të përcaktuar. Kjo përfshin një shpjegim të arsyetimit për këto ndryshime dhe efektin e tyre mbi krahasueshmërinë (shih Kërkesat për Dhënie e Informacioneve Shpjeguese BP-2 *Dhënia e informacioneve shpjeguese në lidhje me rrethanat specifike të këtij Standardi*); dhe
  - (j) performancën kundrejt objektivave shpallura të saj, duke përfshirë informacionin se si objektivi monitorohet dhe rishikohet dhe metrikat e përdorura, nëse progresi është në përputhje me atë që ishte planifikuar fillimisht, dhe një analizë të tendencave ose ndryshimeve të rëndësishme në performancën e njësisë ekonomike drejt arritjes së objektivit.
81. Nëse njësi ekonomike nuk ka vendosur ndonjë **objektiv** të matshëm të orientuar nga rezultati:
- (a) ajo mund të paraqesë nëse do të vendosen objektiva të tillë dhe afatin kohor për vendosjen e tyre, ose arsye pse njësi ekonomike nuk planifikon të vendosë objektiva të tillë;
  - (b) ajo duhet të japë informacion nëse megjithatë ndjek efektivitetin e **politikave** të saj dhe të **veprimeve** të saj në lidhje me **ndikimet** mbi çështjet e rëndësishme të qëndrueshmërinë, **rrezikun dhe mundësitë**, dhe nëse po:
    - i. çdo proces përmes të cilit e bën këtë;
    - ii. nivelin e përcaktuar të ambicies për t'u arritur dhe çdo tregues cilësor ose sasior që përdor për të vlerësuar progresin e bërë, duke përfshirë periudhën bazë nga e cila matet progresi.

## Shtojca A. Kërkesat për Zbatim

Kjo shtojcë është një pjesë integrale e ESRS 2 dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të Standardit.

## 1. Baza e përgatitjes

### *Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese BP -1– Baza e përgjithshme për përgatitjen e deklaratave të qëndrueshmërisë*

- AR 1. Kur përshkruhet deri në çfarë mase **deklarata e qëndrueshmërisë** mbulon rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës të njësisë ekonomike (shih ESRS 1 seksionin 5.1 *Njësia ekonomike raportuese dhe zinxhiri i vlerës*), njësia ekonomike mund të bëjë dallimin ndërmjet:
- (a) masës në të cilën vlerësimi i saj i **materialitetit** të **ndikimeve, rreziqeve dhe mundësive** shtrihet në rrjedhën e sipërme dhe/ose në rrjedhën e poshtme të zinxhirit të saj të vlerës;
  - (b) masës në të cilën **politikat, veprimet dhe objektivat** e saj shtrihet në zinxhirin e saj të vlerës; dhe
  - (c) masës në të cilën ajo përfshin të dhënat e rrjedhës së sipërme dhe/ose rrjedhës së poshtme të zinxhirit të vlerës kur jep informacion për **metrikat**.

### *Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese BP -2– Dhënia e informacioneve shpjeguese në lidhje me rrethanat specifike*

- AR 2. Njësia ekonomike mund të paraqesë nëse mbështetet në ndonjë standard Evropian të miratuar nga Sistemi Evropian i Standardizimit (standardet ISO/IEC ose CEN/CENELEC), si dhe masën në të cilën të dhënat dhe proceset që përdoren për qëllime të raportimit të qëndrueshmërisë janë verifikuar nga një ofrues i jashtëm i çertifikimit dhe janë konstatuar se janë në përputhje me standardin përkatës ISO/IEC ose CEN/C.

## 2. Qeverisja

### *Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese GOV -1– Roli i organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse*

- AR 3. Në përshkrimin e rolit dhe përgjegjësi të organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse në lidhje me çështjet e qëndrueshmërisë, njësia ekonomike mund të specifikojë:
- (a) aspektet e qëndrueshmërisë mbi të cilat ushtrohet mbikëqyrja në lidhje me çështjet mjedisore, sociale dhe të qeverisjes me të cilat mund të përballet njësia ekonomike, duke përfshirë:
    - i. çdo vlerësim dhe ndryshim në aspektet e lidhura me qëndrueshmërinë e strategjisë dhe modelit të biznesit të njësisë ekonomike;
    - ii. identifikimin dhe vlerësimin e **rreziqeve të rëndësishme, mundësive dhe ndikimet**;
    - iii. politikat e lidhura dhe objektivat planet e veprimit dhe burimet e dedikuara; dhe
    - iv. raportimin i qëndrueshmërisë;

- (b) formën që merr një mbikëqyrje e tillë për secilin nga aspektet e mësipërme: d.m.th., informacion, konsultim ose vendimmarrje; dhe
- (c) mënyrën se si një mbikëqyrje e tillë organizohet dhe formalizohet, d.m.th., proceset me të cilat organet administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse angazhohen me këto aspekte të qëndrueshmërisë.

AR 4. Kur përshkruhet mënyra e organizimit të qeverisjes së njësisë ekonomike në lidhje me **çështjet e qëndrueshmërisë**, një përshkrim i strukturës komplekse të qeverisjes mund të plotësohet me paraqitjen e tyre në formën e një diagrami.

AR 5. Përshkrimi i nivelit të ekspertizës ose qasjes në ekspertizë të **organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse** mund të vërtetohet duke ilustruar përbërjen e organeve, duke përfshirë anëtarët tek të cilët këto organe mbështeten për ekspertizë për të mbikëqyruar **çështjet e qëndrueshmërisë**, dhe se si ata e përdorin atë ekspertizë si një organ. Gjatë përshkrim, njësia ekonomike do të marrë parasysh se si ekspertiza dhe aftësitë janë të rëndësishme për **ndikimet** materiale, **rreziqet dhe mundësitë** e njësisë ekonomike dhe nëse organet dhe/ose anëtarët e tyre kanë qasje në burime të tjera të ekspertizës, siç janë ekspertët dhe **trajnimet** specifike dhe iniciativa të tjera arsimore për të përditësuar dhe zhvilluar ekspertizën e lidhur me qëndrueshmërinë brenda këtyre organeve.

*Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese GOV-2 – Informacioni i dhënë dhe çështjet e qëndrueshmërisë të adresuara nga organet administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse të njësisë ekonomike*

AR 6. Në varësi të strukturës së njësisë ekonomike, **organet administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse** mund të fokusohet në objektiva gjithëpërfshirëse, ndërsa menaxhimi fokusohet në objektivat më të detajuara. Në këtë rast, njësia ekonomike mund të japë informacion se si organet qeverisëse sigurojnë se ekziston një mekanizëm i përshtatshëm për monitorimin e performancës.

*Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese GOV-3– Integrimi i performancës së lidhur me qëndrueshmërinë në skemat stimuluese*

AR 7. Për njësitë ekonomike e listuara në bursë, kjo Kërkesë për Informacione Shpjeguese duhet të jetë në përputhje me raportin e shpërblimit të përfituar prej skemave të përshkruar në nenet 9a dhe 9b të Direktivës 2007/36/KE mbi ushtrimin e të drejtave të caktuara të aksionarëve në shoqëritë e listuara. Në përputhje me dispozitat e ESRS 1, paragrafët 119, 120 dhe 122, një njësi ekonomike e listuar mund t'i referohet raportit të saj të shpërblimit prej skemave stimuluese.

*Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese GOV-4– Deklaratë për kujdesin e duhur*

- AR 8. Harta e kërkuar nga paragrafi 30 mund të paraqitet në formën e një tablele, duke ndërlidhur elementët thelbësorë të kujdesit të duhur, për ndikimet mbi njerëzit dhe mjedisin, me dhënien e informacioneve shpjeguese përkatëse në **deklaratën e qëndrueshmërisë** së njësisë ekonomike, siç përcaktohet më poshtë.
- AR 9. Njësia ekonomike mund të përfshijë kolona shtesë në tabelën e mëposhtme për të identifikuar qartë ato informacione shpjeguese që kanë të bëjnë me ndikimet mbi njerëzit dhe/ose mjedisin duke pasur parasysh se, në disa raste, kur jep më shumë se njëherë një informacion, kjo mund të ofrojë informacion për të njëjtin hap të kujdesit të duhur.
- AR 10. Referencat kryesore në instrumentet ndërkombëtare të Parimeve Udhëheqëse të OKB-së për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut dhe Udhëzimet e OECD-së për Njësitë Ekonomike Shumëkombëshe për elementët thelbësorë të procesit të kujdesit të duhur janë renditur në ESRS 1 kapitulli 4.

<b>Elementet themelore të kujdesit të duhur</b>	<b>Paragrafët në deklaratën e qëndrueshmërisë</b>
<b>a) Përfshirja e kujdesit të duhur në qeverisje, strategji dhe model biznesi</b>	
<b>b) Angazhimi me palët e interesuara të prekura në të gjithë hapat kyç të kujdesit të duhur</b>	
<b>c) Identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve negative</b>	
<b>d) Marrja e veprimeve për të adresuar ato ndikime negative</b>	
<b>e) Ndjekja e efektivitetit të këtyre përpjekjeve dhe komunikimi</b>	

*Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese GOV -5– Menaxhimi i rrezikut dhe kontrollat e brendshme mbi raportimin e qëndrueshmërisë*

- AR 11. Kjo Kërkesë për informacione shpjeguese fokusohet vetëm në proceset e kontrollit të brendshëm mbi procesin e raportimit të qëndrueshmërisë. Njësia ekonomike mund të marrë në konsideratë rreziqe të tilla si plotësia dhe integriteti i të dhënave, saktësia e rezultateve të vlerësimit, disponueshmëria e zinxhirit të vlerës së sipërme dhe/ose të poshtme. të dhënat dhe kohën e disponueshmërisë së informacionit.

### 3. Strategjia

#### *Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese SBM -1 Strategjia, modeli i biznesit dhe zinxhiri i vlerës*

- AR 12. Për të siguruar informacionin mbi sektorët e kërkuar nga paragrafi 40, njësia ekonomike duhet të bëjë grupimin e aktiviteteve të saj të rëndësishme në përputhje me sektorët e ESRS. Nëse për një nën-sektor nuk ekziston një kod, do të përdoret zëri "të tjerë".
- AR 13. Për qëllimet e dhënies së informacioneve shpjeguese të kërkuara në paragrafin 40, një grup produktesh dhe/ose shërbimesh të ofruara, një grup tregjesh dhe/ose grupe klientësh, ose një sektor ESRS, është i rëndësishëm për ndërmarrjen nëse plotëson një ose të dyja kriteret e mëposhtme:
- (a) përbën më shumë se 10 për qind të të ardhurave të njësisë ekonomike;
  - (b) është i lidhur me ndikime të rëndësishme aktuale ose ndikime potenciale negative të njësisë ekonomike.
- AR 14. Në përgatitjen e dhënies së informacioneve shpjeguese në lidhje me **modelin e saj të biznesit dhe zinxhirin e vlerës**, njësia ekonomike do të marrë parasysh:
- (a) aktivitetet e saj kryesore, burimet, kanalet e shpërndarjes dhe segmentet e klientëve;
  - (b) **marrëdhëniet e saj kryesore të biznesit** dhe karakteristikat e tyre kryesore, duke përfshirë marrëdhëniet me klientët dhe **furnitorët**;
  - (c) strukturën e kostos dhe të ardhurat e segmenteve të saj të biznesit, në përputhje me kërkesat e SNRF 8 për dhënien e informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare, aty ku është e zbatueshme;
  - (d) **ndikimet** e mundshme, **rreziqet dhe mundësitë** në sektorin(ët) e saj të rëndësishëm dhe lidhjen e tyre të mundshme me **modelin e vet të biznesit ose zinxhirin e vlerës**.
- AR 15. Informacioni kontekstual mund të jetë veçanërisht i rëndësishëm për përdoruesit e deklaratës së qëndrueshmërisë së njësisë ekonomike, për të kuptuar se deri në çfarë mase dhënia e informacionit përfshin informacionin mbi rrjedhën e sipërme dhe/ose rrjedhën e poshtme të **zinxhirit të vlerës**. Përshkrimi i veçorive kryesore të rrjedhës së sipërme dhe/ose të poshtme të zinxhirit të vlerave dhe aty ku është e zbatueshme, identifikimi i zinxhirëve kryesorë të vlerës duhet të mbështesë të kuptuarit se si njësia ekonomike zbaton kërkesat e ESRS 1 kapitulli 5 dhe vlerësimin e **materialitetit** të kryer nga njësia ekonomike në përputhje me ESRS 1 kapitulli 3. Përshkrimi mund të ofrojë një pasqyrë të nivelit të lartë të veçorive kryesore të njësive ekonomike të zinxhirit të vlerës në rrjedhën e sipërme dhe/ose në rrjedhën e poshtme, duke treguar kontributin e tyre përkatës në performancën dhe pozicionin e njësisë ekonomike dhe duke shpjeguar se si ato kontribuojnë në krijimin e vlerës së njësisë ekonomike.

*Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese SBM -2– Interesat dhe pikëpamjet e palëve të interesuara*

AR 16. Pikëpamjet dhe interesat e **palëve të interesuara** që shprehen si pjesë e angazhimit të njësisë ekonomike me palët e interesuara nëpërmjet procesit të saj të kujdesit të duhur mund të jenë të rëndësishme për një ose më shumë aspekte të strategjisë ose modelit të biznesit të saj. Si të tilla, ato mund të ndikojnë në vendimet e njësisë ekonomike në lidhje me drejtimin e ardhshëm të strategjisë ose modelit të biznesit.

*Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese SBM -3– Ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit*

AR 17. Kur njësi ekonomike përshkruan se në cilën pjesë në **zinxhirin e saj të vlerës** në rrjedhën e sipërme dhe/ose në rrjedhën e poshtme janë të përqendruara **ndikimet** e rëndësishme, **rreziqet dhe mundësitë**, njësi ekonomike do të marrë në konsideratë: zonat gjeografike, objektet ose llojet e aktiveve, inputet, produktet dhe kanalet e shpërndarjes.

AR 18. Ky informacion mund të shprehet në terma të një **ndikimi** të vetëm, **rreziku ose mundësi** ose duke grumbulluar grupe ndikimesh të rëndësishme, rreziqesh dhe mundësish, kur kjo siguron informacion më të rëndësishëm dhe nuk zbeh informacionin e rëndësishëm.

#### **4. Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë**

*Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese IRO-2 - Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese në ESRS që mbulohen nga deklaratat e qëndrueshmërisë së njësisë ekonomike*

AR 19. Pavarësisht bazës për paraqitjen e informacionit në lidhje me **çështjet e qëndrueshmërisë** të përfshira në ESRS 1 kapitulli 8 *Struktura e deklaratës së qëndrueshmërisë*, njësi ekonomike mund të paraqesë listën e Kërkesave për Dhënie të informacioneve shpjeguese të përmbushura në **deklaratën e qëndrueshmërisë** së përgatitur (shih paragrafin 54) në pjesën e informacionit të përgjithshëm ose në pjesë të tjera të deklaratës së qëndrueshmërisë si të jetë më e përshtatshme. Njësi ekonomike mund të përdorë një indeks të përmbajtjes, d.m.th., një listë tabelare të Kërkesave të Dhënies së informacioneve shpjeguese të përfshira në deklaratën e qëndrueshmërisë, me tregues se ku ndodhen (faqe/paragrafët).

*Kërkesa minimale për Informacione Shpjeguese - Politikat MDR -P - Politikat e miratuara për të menaxhuar çështjet e rëndësishme të qëndrueshmërisë*

AR 20. Për shkak të ndërvarësisë ndërmjet ndikimeve mbi njerëzit dhe mjedisin, **rreziqet dhe mundësitë**, një **politikë** e vetme mund të zbatohet për disa **çështje të rëndësishme të qëndrueshmërisë**, duke përfshirë çështjet e trajtuara nga më shumë se një ESRS përkatëse. Për shembull, nëse një politikë e vetme mbulon një çështje mjedisore dhe një çështje sociale, njësi ekonomike mund të raportojë mbi politikën në seksionin mjedisor të **deklaratës së saj**

**të qëndrueshmërisë.** Në këtë rast, ajo duhet të përfshijë në seksionin social një referencë për ta kryqëzuar atë me seksionin mjedisor ku raportohet politika në fjalë. Në të njëjtën mënyrë, një politikë mund të raportohet në seksionin social me një referencë për ta kryqëzuar atë me seksionin mjedisor.

AR 21. Përshkrimi i fushëveprimit të **politikës** mund të shpjegojë se me cilat aktivitete dhe/ose segmente të aktiviteteve të vetë njësisë ekonomike ose **zinxhirit të vlerës** së sipërme dhe të poshtme ka të bëjë. Përshkrimi mund të shpjegojë gjithashtu kufijtë e mëtejshëm të lidhur me temën specifike ose rrethanat e njësisë ekonomike, të cilat mund të përfshijnë gjeografi, cikle jete, etj. Në raste të caktuara, si p.sh. nëse politika nuk mbulon zinxhirin e plotë të vlerës, njësia ekonomike mund të japë informacion të qartë në lidhje me shtrirjen e zinxhirit të vlerës që mbulon politika.

*Kërkesa Minimale për Informacione Shpjeguese - Veprimet MDR -A - Veprimet dhe burimet në lidhje me çështjet të rëndësishme të qëndrueshmërisë*

AR 22. Veprimet kryesore në kontekstin e kësaj **Kërkesë Minimale për Informacione Shpjeguese** janë ato veprime që kontribuojnë materialisht në arritjen e objektivave të njësisë ekonomike në adresimin e **ndikimeve** materiale, **rreziqeve dhe mundësive**. Për arsye të kuptueshmërisë, veprimet kyçe mund të grumbullohen aty ku është e përshtatshme.

AR 23. Informacioni mbi shpërndarjen e burimeve mund të paraqitet në formën e një table dhe të ndahet midis shpenzimeve kapitale dhe shpenzimeve operative, dhe përgjatë horizonteve kohore përkatëse, dhe midis burimeve të aplikuara në vitin aktual raportues dhe shpërndarjes së planifikuar të burimeve në horizonte kohore specifike.

## 5. Metrikat dhe objektivat

*Kërkesa Minimale për Informacione Shpjeguese Objektivat MDR– T – Ndjekja e efektivitetit të politikave dhe veprimeve përmes objektivave*

AR 24. Kur jepet informacion mbi objektivat në lidhje me parandalimin ose zbutjen e ndikimeve mjedisore, njësia ekonomike do të japë përparësi objektivave që lidhen me reduktimin e ndikimeve në terma absolutë dhe jo në terma relativë. Kur objektivat trajtojnë parandalimin ose zbutjen e ndikimeve sociale, ato mund të specifikohen në terma të efekteve në të drejtat e njeriut, mirëqenien ose rezultatet pozitive për **palët** e prekura.

AR 25. Informacioni mbi progresin e bërë drejt arritjes së objektivave mund të paraqitet në një tabelë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë informacionin mbi vlerën bazë dhe objektivin, pikat kryesore dhe performancën e arritur gjatë periudhave të mëparshme.

AR 26. Kur njësia ekonomike përshkruan progresin në arritjen e objektivave të një politike në mungesë të një objektivi të matshëm, ajo mund të përcaktojë një bazë mbi të cilën do të

merret në konsideratë progresi i bërë. Për shembull, njësia ekonomike mund të vlerësojë një rritje të pagave me një përqindje të caktuar për ata që janë nën pagën e drejtë; ose mund të vlerësojë cilësinë e marrëdhënieve të saj me komunitetet lokale duke iu referuar raportit të proporcionit të çështjeve të ngritura nga komunitetet që u zgjidhën sipas pëlqimit të tyre. Niveli bazë dhe vlerësimi i progresit duhet të lidhen me **ndikimet, rreziqet dhe mundësitë** të cilat mbështesin **materialitetin** për çështjen e trajtuar nga politika.

## Shtojca B. Lista e pikave të të dhënave në standardet ndërsektoriale dhe specifike që rrjedhin nga legjislacioni tjetër i BE-së

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e ESRS 2. Tabela më poshtë ilustron pikat e të dhënave në ESRS 2 dhe ESRS specifike (tematike) që rrjedhin nga legjislacioni tjetër i BE-së.

Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese dhe pika e të dhënave përkatëse	SFDR <sup>25</sup> referenca	Shtylla 3 <sup>26</sup> referenca	Rregullorja bazë <sup>27</sup> referenca	BE Klima Ligji <sup>28</sup> referenca
ESRS 2 GOV-1 Diversiteti gjinor i Bordit, paragrafi 21 (d)	Treguesi numër 13 i tabelës nr. 1 të Shtojcës 1		Rregullorja e deleguar e Komisionit (BE) 2020/ 1816, <sup>29</sup> Shtojca II	
ESRS 2 GOV-1 Përqindja e anëtarëve të bordit			Rregullorja e deleguar (BE)	

<sup>25</sup> Rregullorja (BE) 2019/2088 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 27 nëntor 2019, mbi deklarimet që lidhen me qëndrueshmërinë në sektorin e shërbimeve financiare (Rregullorja për dhënien e informacioneve mbi Financat e Qëndrueshme) (GZ L 317, 9.12.2019, f. 1).

<sup>26</sup> Rregullorja (BE) nr. 575/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 26 qershor 2013, mbi kërkesat e kujdesit të duhur për institucionet e kreditit dhe firmat e investimit dhe që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 648/2012 (Rregullorja e Kërkesave të Kapitalit “CRR”) (GZ L 176, 27.6.2013, f. 1).

<sup>27</sup> Rregullorja (BE) 2016/1011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 8 qershorit 2016, mbi indekset e përdorura si pika referimi në instrumentet financiare dhe kontratat financiare ose për të matur performancën e fondeve të investimit dhe që ndryshon Direktivat 2008/48/KE dhe 2014/17/BE dhe Rregulloren (BE) nr. 596/2014 (GZ L 171, 29.6.2016, f. 1).

<sup>28</sup> Rregullorja (BE) 2021/1119 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 30 qershor 2021, që përcakton kornizën për arritjen e neutralitetit klimatik dhe ndryshon Rregulloret (KE) nr. 401/2009 dhe (BE) 2018/1999 (‘Ligji Evropian për Klimën’) (GZ L 243, 9.7.2021, f. 1).

<sup>29</sup> Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2020/1816 e datës 17 korrik 2020 që plotëson Rregulloren (BE) 2016/1011 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me shpjegimin në deklaratën e referencës se si faktorët mjedisorë, socialë dhe të qeverisjes pasqyrohen në secilën referencë të ofruar dhe të publikuar (GZ L 406, 3.12.2020, f. 1).

<b>Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese dhe pika e të dhënave përkatëse</b>	<b>SFDR<sup>25</sup> referenca</b>	<b>Shtylla 3<sup>26</sup> referenca</b>	<b>Rregullorja bazë<sup>27</sup> referenca</b>	<b>BE Klima Ligji<sup>28</sup> referenca</b>
që janë të pavarur, paragrafi 21 (e)			2020/1816, Shtojca II	
ESRS 2 GOV-4 Deklarata mbi kujdesin e duhur paragrafi 30	Treguesi numër 10 i tabelës nr. 3 të Shtojcës 1			
ESRS 2 SBM-1 Përfshirja në aktivitetet që lidhen me aktivitetet e lëndëve djegëse fosile, paragrafi 40 (d) i	Treguesi numër 4 i tabelës nr. 1 të Shtojcës 1	Neni 449a Rregullorja (BE) Nr. 575/2013; Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/2453 <sup>30</sup> Tabela 1: Informacioni cilësor për rrezikun mjedisor dhe Tabela 2: Informacioni cilësor për rrezikun social	Rregullorja e deleguar (BE) 2020/1816, Shtojca II	
ESRS 2 SBM-1 Përfshirja në aktivitete që lidhen me prodhimin e kimikateve paragrafi 40 (d) ii	Treguesi numër 9 i tabelës nr. 2 të Shtojcës 1		Rregullorja e deleguar (BE) 2020/1816, Shtojca II	
ESRS 2 SBM-1 Përfshirja në aktivitete që lidhen me armët e	Treguesi numër 14 i tabelës nr. 1 të Shtojcës 1		Rregullorja e deleguar (BE) 2020/1818, <sup>31</sup> Neni 12(1) Rregullorja e	

<sup>30</sup> Rregullorja për Zbatim e Komisionit (BE) 2022/2453 e datës 30 nëntor 2022 që ndryshon standardet teknike zbatuese të përcaktuara në Rregulloren Zbatuese (BE) 2021/637 në lidhje me informacionin e dhënë për rreziqet mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (GZ L 324, 19.12.2022, f. 1).

<sup>31</sup> Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2020/1818 e datës 17 korrik 2020 që plotëson Rregulloren (BE) 2016/1011 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me standardet minimale për Standardet e Tranzicionit Klimatik të BE-së dhe Standardet e BE-së të harmonizuara me Marrëveshjen e Parisit (GZ L 406, 3.12.2020, f. 17).

Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese dhe pika e të dhënave përkatëse	SFDR <sup>25</sup> referenca	Shtylla 3 <sup>26</sup> referenca	Rregullorja bazë <sup>27</sup> referenca	BE Klima Ligji <sup>28</sup> referenca
diskutueshme paragrafi 40 (d) iii			deleguar (BE) 2020/1816, Shtojca II	
ESRS 2 SBM-1 Përfshirja në aktivitetet që lidhen me kultivimin dhe prodhimin e duhanit paragrafi 40 (d) iv			Rregullorja e deleguar (BE) 2020/1818, Neni 12(1) Rregullorja e deleguar (BE) 2020/1816, Shtojca II	
ESRS E1-1 Plani i tranzicionit për të arritur neutralitetin klimatik deri në vitin 2050, paragrafi 14				Rregullorja (BE) 2021/1119, Neni 2(1)
ESRS E1-1 Njësitë ekonomike të përjashtuara nga Standardet e Përafruara me Parisin, paragrafi 16 (g)		Neni 449a Rregullorja (BE) Nr. 575/2013; Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/2453 Modeli 1: Portofoli Bankar-Rreziku i tranzicionit nga ndryshimet klimatike: Cilësia e kreditit të ekspozimeve sipas sektorëve, emetimeve dhe maturimi i mbetur	Rregullorja e deleguar (BE) 2020/1818, neni 12.1 (d) deri (g) dhe neni 12.2	

<b>Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese dhe pika e të dhënave përkatëse</b>	<b>SFDR<sup>25</sup> referenca</b>	<b>Shtylla 3<sup>26</sup> referenca</b>	<b>Rregullorja bazë<sup>27</sup> referenca</b>	<b>BE Klima Ligji<sup>28</sup> referenca</b>
ESRS E1-4 Objektivat e reduktimit të emetimeve të GHG-ve, paragrafi 34	Treguesi numër 4 i tabelës nr. 2 të Shtojcës 1	Neni 449a Rregullorja (BE) Nr. 575/2013; Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/2453 Modeli 3: Portofoli Bankar – Rreziku i tranzicionit të ndryshimeve klimatike: treguesit e përafrimit	Rregullorja e deleguar (BE) 2020/1818, Neni 6	
ESRS E1-5 Konsumi i energjisë nga burimet fosile i ndarë sipas burimeve (vetëm sektorët me ndikim të lartë në klimë) paragrafi 38	Treguesi numër 5 i Tabelës nr. 1 dhe Treguesi nr. 5 i Tabelës nr. 2 të Shtojcës 1			
ESRS E1-5 Konsumi dhe përzierja e energjisë paragrafi 37	Treguesi numër 5 i tabelës nr. 1 të Shtojcës 1			
ESRS E1-5 Intensiteti i energjisë i lidhur me aktivitetet në sektorët me ndikim të lartë në klimë paragrafët 40 deri në 43	Treguesi numër 6 i Tabelës nr. 1 të Shtojcës 1			
ESRS E1-6 Perimetri bruto 1, 2, 3 dhe emetimet	Treguesi numër 1 dhe 2 të Tabelës	Neni 449a; Rregullorja (BE) Nr. 575/2013;	Rregullorja e deleguar (BE) 2020/1818,	

<b>Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese dhe pika e të dhënave përkatëse</b>	<b>SFDR<sup>25</sup> referenca</b>	<b>Shtylla 3<sup>26</sup> referenca</b>	<b>Rregullorja bazë<sup>27</sup> referenca</b>	<b>BE Klima Ligji<sup>28</sup> referenca</b>
totale të gazrave serrë (GHG) paragrafi 44	nr. 1 të Shtojcës 1	Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/2453 Modeli 1: Portofoli bankar – Rreziku i tranzicionit të ndryshimeve klimatike: Cilësia e kreditit të ekspozimeve sipas sektorit, emetimet dhe maturimi i mbetur	Neni 5(1), neni 6 dhe 8(1)	
ESRS E1-6 Intensiteti i emetimit bruto GHG paragrafët 53 deri 55	Treguesi numër 3 i tabelës nr. 1 të Shtojcës 1	Neni 449a Rregullorja (BE) Nr. 575/2013; Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/2453 Modeli 3: Portofoli Bankar – Rreziku i tranzicionit të ndryshimeve klimatike: treguesit e përfrimit	Rregullorja e deleguar (BE) 2020/1818, neni 8(1)	
ESRS E1-7 Largimi i GHG dhe kreditet e karbonit paragrafi 56				Rregullorja (BE) 2021/1119, Neni 2(1)
ESRS E1-9 Ekspozimi i portofolit standard ndaj rreziqeve fizike të lidhura me klimën, paragrafi 66			Rregullorja e deleguar (BE) 2020/1818, Shtojca II Rregullorja e deleguar (BE)	

Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese dhe pika e të dhënave përkatëse	SFDR <sup>25</sup> referenca	Shtylla 3 <sup>26</sup> referenca	Rregullorja bazë <sup>27</sup> referenca	BE Klima Ligji <sup>28</sup> referenca
			2020/1816, Shtojca II	
<p>ESRS E1-9 Zbërthimi i shumave monetare sipas rrezikut fizik akut dhe kronik, paragrafi 66 (a)</p> <p>ESRS E1-9 Vendndodhja e aktiveve të rëndësishme në rrezik fizik material paragrafi 66 (c).</p>		<p>Neni 449a Rregullorja (BE) Nr. 575/2013;</p> <p>Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/2453 paragrafët 46 dhe 47; Modeli 5: Portofoli bankar - Rreziku fizik i ndryshimeve klimatike: Ekspozimet që i nënshtrohen rrezikut fizik.</p>		
<p>ESRS E1-9 Ndarja e vlerës kontabël të aktiveve të pasurive të paluajtshme sipas klasave të efijencës së energjisë, paragrafi 67 (c).</p>		<p>Neni 449a Rregullorja (BE) Nr. 575/2013;</p> <p>Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/2453, neni 34;Modeli 2: Portofoli bankar - Rreziku i tranzicionit nga ndryshimet klimatike: Huatë e kolateralizuara nga pasuria e paluajtshme - Efijenca energjetike e kolateralit</p>		

<b>Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese dhe pika e të dhënave përkatëse</b>	<b>SFDR<sup>25</sup> referenca</b>	<b>Shtylla 3<sup>26</sup> referenca</b>	<b>Rregullorja bazë<sup>27</sup> referenca</b>	<b>BE Klima Ligji<sup>28</sup> referenca</b>
ESRS E1-9 Shkalla e ekspozimit të portofolit ndaj mundësive të lidhura me klimën, paragrafi 69			Rregullorja e deleguar (BE) 2020/1818, Shtojca II	
ESRS E2-4 Sasia e secilit ndotës të listuar në Aneksin II të Rregullores E- PRTR (Regjistri Evropian i Çlirimit dhe Transferimit të Ndotësve) të emetuar në ajër, ujë dhe tokë, paragrafi 28	Treguesi Numër 8 Tabela #1 e aneksit 1 Treguesi numër 2 Tabela #2 i aneksit 1 Treguesi Numër 1 Tabela #2 i aneksit 1 Treguesi numër 3 Tabela #2 i aneksit 1			
ESRS E3-1 Burimet ujore dhe detare paragrafi 9	Treguesi numër 7 i Tabelës nr. 2 të Shtojcës 1			
ESRS E3-1 Politika e dedikuar paragrafi 13	Treguesi numër 8 i Tabelës nr. 2 të Shtojcës 1			
ESRS E3-1 Oqeanet dhe detet e qëndrueshme paragrafi 14	Treguesi numër 12 i Tabelës nr. 2 të Shtojcës 1			

Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese dhe pika e të dhënave përkatëse	SFDR <sup>25</sup> referenca	Shtylla 3 <sup>26</sup> referenca	Rregullorja bazë <sup>27</sup> referenca	BE Klima Ligji <sup>28</sup> referenca
ESRS E3-4 Uji total i ricikluar dhe i ripërdorur paragrafi 28 (c)	Treguesi numër 6,2 i Tabelës nr. 2 të Shtojcës 1			
ESRS E3-4 Konsumi total i ujit në m 3 për të ardhurat neto nga aktivitetet e veta paragrafi 29	Treguesi numër 6,1 i Tabelës nr. 2 të Shtojcës 1			
► C1 ESRS 2- SBM 3 - E4 paragrafi 16 (a) i ◀	Treguesi numër 7 i Tabelës nr. 1 të Shtojcës 1			
► C1 ESRS 2- SBM 3 - E4 paragrafi 16 (b) ◀	Treguesi numër 10 i Tabelës nr. 2 të Shtojcës 1			
► C1 ESRS 2- SBM 3 - E4 paragrafi 16 (c) ◀	Treguesi numër 14 i Tabelës nr. 2 të Shtojcës 1			
ESRS E4-2 Praktikat ose politikat e qëndrueshme të tokës/bujqësisë, paragrafi 24 (b)	Treguesi numër 11 i Tabelës nr. 2 të Shtojcës 1			
ESRS E4-2 Praktikat ose politikat e qëndrueshme të oqeanëve/deteve paragrafi 24 (c)	Treguesi numër 12 i Tabelës nr. 2 të Shtojcës 1			

<b>Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese dhe pika e të dhënave përkatëse</b>	<b>SFDR<sup>25</sup> referenca</b>	<b>Shtylla 3<sup>26</sup> referenca</b>	<b>Rregullorja bazë<sup>27</sup> referenca</b>	<b>BE Klima Ligji<sup>28</sup> referenca</b>
ESRS E4-2 Politikat për adresimin e shpyllëzimit paragrafi 24 (d)	Treguesi numër 15 i Tabelës nr. 2 të Shtojcës 1			
ESRS E5-5 Mbetjet e pa ricikluara paragrafi 37 (d)	Treguesi numër 13 i Tabelës nr. 2 të Shtojcës 1			
ESRS E5-5 Mbetjet e rrezikshme dhe mbetjet radioaktive paragrafi 39	Treguesi numër 9 i Tabelës nr. 1 të Shtojcës 1			
ESRS 2- SBM3 - S1 Rreziku i incidenteve të punës së detyruar, paragrafi 14 (f)	Treguesi numër 13 i Tabelës nr. 3 të Shtojcës I			
ESRS 2- SBM3 - S1 Rreziku i incidenteve të punës së fëmijëve, paragrafi 14 (f)	Treguesi numër 12 i Tabelës nr. 3 të Shtojcës I			
ESRS S1-1 Angazhimet e politikave të të drejtave të njeriut paragrafi 20	Treguesi numër 9 i Tabelës nr. 3 dhe Treguesi nr. 11 i Tabelës nr. 1 të Shtojcës I			
ESRS S1-1 Politikat e kujdesit të duhur për			Rregullorja e deleguar (BE)	

<b>Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese dhe pika e të dhënave përkatëse</b>	<b>SFDR<sup>25</sup> referenca</b>	<b>Shtylla 3<sup>26</sup> referenca</b>	<b>Rregullorja bazë<sup>27</sup> referenca</b>	<b>BE Klima Ligji<sup>28</sup> referenca</b>
çështjet e adresuara nga Konventat themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës 1 deri në 8, paragrafi 21			2020/1816, Shtojca II	
ESRS S1-1 Proceset dhe masat për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, paragrafi 22	Treguesi numër 11 i Tabelës nr. 3 të Shtojcës I			
ESRS S1-1 Politika ose sistemi i menaxhimit të parandalimit të aksidenteve në vendin e punës paragrafi 23	Treguesi numër 1 i Tabelës nr. 3 të Shtojcës I			
ESRS S1-3 Mekanizmat e trajtimit të ankesave/ankesave paragrafi 32 (c)	Treguesi numër 5 i Tabelës nr. 3 të Shtojcës I			
ESRS S1-14 Numri i viktimave dhe numri dhe shkalla e aksidenteve të lidhura me punën, paragrafi 88 (b) dhe (c)	Treguesi numër 2 i Tabelës nr. 3 të Shtojcës I		Rregullorja e deleguar (BE) 2020/1816, Shtojca II	

Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese dhe pika e të dhënave përkatëse	SFDR <sup>25</sup> referenca	Shtylla 3 <sup>26</sup> referenca	Rregullorja bazë <sup>27</sup> referenca	BE Klima Ligji <sup>28</sup> referenca
ESRS S1-14 Numri i ditëve të humbura për shkak të lëndimeve, aksidenteve, vdekjeve ose sëmundjeve, paragrafi 88 (e)	Treguesi numër 3 i Tabelës nr. 3 të Shtojcës I			
ESRS S1-16 Hendeku i parregulluar gjinor i pagave, paragrafi 97 (a)	Treguesi numër 12 i Tabelës nr. 1 të Shtojcës I		Rregullorja e deleguar (BE) 2020/1816, Shtojca II	
ESRS S1-16 Raporti i pagesave më tepër të CEO, paragrafi 97 (b)	Treguesi numër 8 i Tabelës nr. 3 të Shtojcës I			
ESRS S1-17 Incidentet e diskriminimit paragrafi 103 (a)	Treguesi numër 7 i Tabelës nr. 3 të Shtojcës I			
► C1 ESRS S1-17 Mosrespektimi i UNGP -ve për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut dhe Udhëzimet e OECD paragrafi 104 (a) ◀	Treguesi numër 10 i Tabelës nr. 1 dhe Treguesi numër 14 i Tabelës nr. 3 të Shtojcës I		Rregullorja e deleguar (BE) 2020/1816, Shtojca II Rregullorja e deleguar (BE) 2020/1818 Neni 12 (1)	
ESRS 2- SBM3– S2 Rreziku i rëndësishëm i punës së fëmijëve ose punës së	Treguesi numër 12 dhe 13 i Tabelës nr. 3 të Shtojcës I			

<b>Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese dhe pika e të dhënave përkatëse</b>	<b>SFDR<sup>25</sup> referenca</b>	<b>Shtylla 3<sup>26</sup> referenca</b>	<b>Rregullorja bazë<sup>27</sup> referenca</b>	<b>BE Klima Ligji<sup>28</sup> referenca</b>
detyruar në zinxhirin e vlerës, paragrafi 11 (b)				
ESRS S2-1 Angazhimet e politikës të të drejtave të njeriut paragrafi 17	Treguesi numër 9 i Tabelës nr. 3 dhe Treguesi numër 11 i Tabelës nr. 1 të Shtojcës 1			
ESRS S2-1 Politikat në lidhje me punëtorët e zinxhirit të vlerës paragrafi 18	Treguesi numër 11 dhe numër 4 i Tabelës nr. 3 të Shtojcës 1			
ESRS-S2-1 Mosrespektimi i UNGP -ve për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut dhe Udhëzimet e OECD paragrafi 19	Treguesi numër 10 i Tabelës nr. 1 të Shtojcës 1		Rregullorja e deleguar (BE) 2020/1816, Shtojca II Rregullorja e deleguar (BE) 2020/1818, Neni 12 (1)	
ESRS S2-1 Politikat e kujdesit të duhur për çështjet e adresuara nga Konventat themelore të Organizatës Ndërkombëtare të			Rregullorja e deleguar (BE) 2020/1816, Shtojca II	

Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese dhe pika e të dhënave përkatëse	SFDR <sup>25</sup> referenca	Shtylla 3 <sup>26</sup> referenca	Rregullorja bazë <sup>27</sup> referenca	BE Klima Ligji <sup>28</sup> referenca
Punës 1 deri në 8, paragrafi 19				
ESRS S2-4 Çështjet dhe incidentet e të drejtave të njeriut të lidhura me zinxhirin e vlerave në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme, paragrafi 36	Treguesi numër 14 i Tabelës nr. 3 të Shtojcës 1			
ESRS S3-1 Angazhimet e politikave të të drejtave të njeriut paragrafi 16	Treguesi numër 9 i Tabelës nr. 3 i Shtojcës 1 dhe Treguesi numër 11 i Tabelës nr. 1 të Shtojcës 1			
▶ C1 ESRS- S3-1 Mosrespektimi i UNGP -ve për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut dhe Udhëzimet e OECD paragrafi 17 ◀	Treguesi numër 10 i Tabelës nr. 1 të Shtojcës 1		Rregullorja e deleguar (BE) 2020/1816, Shtojca II Rregullorja e deleguar (BE) 2020/1818, Neni 12 (1)	
ESRS S3-4 Çështjet dhe incidentet e të drejtave të njeriut paragrafi 36	Treguesi numër 14 i Tabelës nr. 3 të Shtojcës 1			

<b>Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese dhe pika e të dhënave përkatëse</b>	<b>SFDR<sup>25</sup> referenca</b>	<b>Shtylla 3<sup>26</sup> referenca</b>	<b>Rregullorja bazë<sup>27</sup> referenca</b>	<b>BE Klima Ligji<sup>28</sup> referenca</b>
ESRS S4-1 Politikat në lidhje me klientët dhe përdoruesit fundorë paragrafi 16	Treguesi numër 9 i Tabelës nr. 3 dhe Treguesi numër 11 i Tabelës nr. 1 të Shtojcës 1			
ESRS S4-1 Mosrespektimi i UNGP -ve për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut dhe Udhëzimet e OECD paragrafi 17	Treguesi numër 10 i Tabelës nr. 1 të Shtojcës 1		Rregullorja e deleguar (BE) 2020/1816, Shtojca II Rregullorja e deleguar (BE) 2020/1818, Neni 12 (1)	
ESRS S4-4 Çështjet dhe incidentet e të drejtave të njeriut paragrafi 35	Treguesi numër 14 i Tabelës nr. 3 të Shtojcës 1			
ESRS G1-1 Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, paragrafi 10 (b)	Treguesi numër 15 i Tabelës nr. 3 të Shtojcës 1			
ESRS G1-1 Mbrojtja e sinjalizuesve paragrafi 10 (d)	Treguesi numër 6 i Tabelës nr. 3 të Shtojcës 1			
ESRS G1-4 Gjobat për shkelje të ligjeve kundër korrupsionit dhe	Treguesi numër 17 i Tabelës nr. 3 të Shtojcës 1		Rregullorja e deleguar (BE) 2020/1816, Shtojca II)	

Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese dhe pika e të dhënave përkatëse	SFDR <sup>25</sup> referenca	Shtylla 3 <sup>26</sup> referenca	Rregullorja bazë <sup>27</sup> referenca	BE Klima Ligji <sup>28</sup> referenca
kundër ryshfetit paragrafi 24 (a)				
ESRS G1-4 Standardet e anti-korrupsionit dhe anti-ryshfetit paragrafi 24 (b)	Treguesi numër 16 i Tabelës nr. 3 të Shtojcës 1			

## Shtojca C. Dhënia e informacioneve shpjeguese dhe Kërkesat për zbatim në ESRS përkatëse që janë të zbatueshme së bashku me ESRS 2 Dhënie e Informacioneve të Përgjithshme

Kjo shtojcë është një pjesë integrale e ESRS 2 dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të Standardit. Tabela e mëposhtme përshkruan kërkesat në ESRS specifike që duhet të merren parasysh kur raportohet kundër Kërkesave të Dhënies së informacioneve shpjeguese në ESRS 2.

ESRS 2 Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese	Paragrafi i lidhur me ESRS specifike
<b>GOV -1 Roli i organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse</b>	ESRS G1 <i>Sjellja e biznesit</i> (paragrafi 5)
<b>GOV-3 Integrimi i performancës së lidhur me qëndrueshmërinë në skemat stimuluese</b>	ESRS E1 <i>Ndryshimet Klimatike</i> (paragrafi 13)
<b>SBM -2 Interesat dhe pikëpamjet e palëve të interesuara</b>	ESRS S1 <i>Fuqia e vet punëtore</i> (paragrafi 12) ESRS S2 <i>Punëtorët në zinxhirin e vlerës</i> (paragrafi 9) ESRS S3 <i>Komunitetet e prekura</i> (paragrafi 7) ESRS S4 <i>Klientët dhe përdoruesit fundorë</i> (paragrafi 8)

<p><b>SBM -3</b> Ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit</p>	<p>ESRS E1 <i>Ndryshimet Klimatike</i> (paragrafi 18 dhe 19)  ESRS E4 <i>Biodiversiteti dhe ekosistemet</i> (paragrafi 16)  ESRS S1 <i>Fuqia e vet punëtore</i> (paragrafi 13 dhe 16)  ESRS S2 <i>Punëtorët në zinxhirin e vlerës</i> (paragrafi 10 dhe 13)  ESRS S3 <i>Komunitetet e prekura</i> (paragrafi 8 dhe 11)  ESRS S4 <i>Klientët dhe përdoruesit fundorë</i> (paragrafi 9 dhe 12)</p>
<p><b>IRO -1</b> Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë</p>	<p>ESRS E1 <i>Ndryshimet Klimatike</i> (paragrafi 20 dhe 21)  ESRS E2 <i>Ndotja</i> (paragrafi 11)  ESRS E3 <i>Burimet ujore dhe detare</i> (paragrafi 8)  ESRS E4 <i>Biodiversiteti dhe ekosistemet</i> (paragrafi 17 dhe 19)  ESRS E5 <i>Përdorimi i burimeve dhe ekonomia rrethore</i> (paragrafi 11)  ESRS G1 <i>Sjellja e biznesit</i> (paragrafi 6)</p>

## ESRS E1. NDRYSHIMI KLIMATIK

### Përmbajtja

<b>Objektivi .....</b>	<b>112</b>
<b>Ndërveprimi me Standardet e tjera ESRS .....</b>	<b>114</b>
<b>Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese .....</b>	<b>114</b>
ESRS 2 Dhënie informacionesh shpjeguese të Përgjithshme .....	114
Qeverisja .....	115
Kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese lidhur me standardin ESRS 2 GOV-3: Integrimi i performancës së lidhur me qëndrueshmërinë në skemat nxitëse .....	115
<b>Strategjia .....</b>	<b>115</b>

Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-1 – Plani i tranzicionit për zbutjen e ndryshimit klimatik .....	115
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese e lidhur me standardin ESRS 2 SBM-3 – Ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit. ....	117
Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë .....	117
Kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese e lidhur me standardin ESRS 2 IRO-1 – Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me klimën .....	117
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-2 – Politikat e lidhura me zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimit klimatik .....	118
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-3 – Veprimet dhe burimet e lidhura me politikat për ndryshimin klimatik.....	119
Metrikat dhe objektivat .....	119
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-4 – Objektivat e lidhura me zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimit klimatik .....	119
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-5 – Konsumi i energjisë dhe miksi i energjisë .....	121
Intensiteti i energjisë i bazuar në shitjet neto .....	122
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-6 – Emetimet bruto GHG të perimetrit 1, 2, 3 dhe emetimet totale GHG.....	123
Intensiteti i GHG i bazuar në shitjet neto .....	125
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-7 – Projektet për heqjen dhe zbutjen e GHG, të financuara përmes krediteve të karbonit .....	125
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-8 – Çmimi i brendshëm i karbonit .....	127
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-9 – Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet fizike dhe të tranzicionit materiale dhe mundësitë potenciale të lidhura me klimën .....	127
<b>Shtojca A. Kërkesat për Zbatim .....</b>	<b>130</b>
Strategjia .....	130
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-1 – Plani i tranzicionit për zbutjen e ndryshimit klimatik .....	130
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese e lidhur me standardin ESRS 2 SBM-3 – Ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit .....	132

Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë .....	133
Kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese e lidhur me standardin ESRS 2 IRO-1 – Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me klimën .....	133
Analiza e skenarit e lidhur me klimën.....	136
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-2 – Politikat e lidhura me zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimit klimatik .....	137
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-3 – Veprimet dhe burimet e lidhura me politikat për ndryshimin klimatik.....	137
Metrikat dhe objektivat .....	138
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-4 – Objektivat e lidhura me zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimit klimatik .....	138
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-5 – Konsumi i energjisë dhe miksi i energjisë .....	142
Udhëzues lidhur me llogaritjen.....	142
Intensiteti i energjisë i bazuar në shitjet neto .....	145
Udhëzues lidhur me llogaritjen.....	145
Lidhja e intensitetit të energjisë i bazuar në shitjet neto me informacionin financiar të raportuar .....	145
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-6 – Emetimet bruto GHG të Perimetrit 1, 2, 3 dhe emetimet totale GHG.....	146
Udhëzues lidhur me llogaritjen.....	146
Intensiteti i GHG i bazuar në shitjet neto .....	155
Udhëzues lidhur me llogaritjen.....	155
Lidhja e intensitetit GHG të bazuar në shitjet neto me informacionin financiar të raportuar .....	155
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-7 – Projektet për heqjen dhe zbutjen e GHG, të financuara përmes krediteve të karbonit .....	156
Heqjet dhe magazinimi i GHG në veprimtarinë e vet dhe në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës .....	156
Udhëzues lidhur me llogaritjen.....	156
Projektet e zbutjes GHG të financuar përmes krediteve të karbonit.....	158
Udhëzues lidhur me llogaritjen.....	159

Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-8 – Çmimi i brendshëm i karbonit .....	160
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-9 – Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet materiale, fizike dhe të tranzicionit, si dhe mundësitë potenciale të lidhura me klimën .....	161
Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet materiale fizike dhe të tranzicionit .....	161
Udhëzues lidhur me llogaritjen - Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet fizike materiale .....	161
Udhëzues lidhur me llogaritjen - Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet e tranzicionit .....	163
Lidhja me informacionin financiar të raportuar .....	166
Mundësitë e lidhura me qëndrueshmërinë .....	166

## Objektivi

- Objektivi i këtij Standardi është të specifikojë Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese që do t'u mundësojnë përdoruesve të **deklaratave të qëndrueshmërisë** të kuptojnë:
  - sesi njësia ekonomike ndikon ndryshimin klimatik, në terma të ndikimeve materiale, pozitive dhe negative, aktuale dhe potenciale;
  - përpjekjet për zbutjen në të shkuarën, të tashmen dhe në të ardhmen, të njësisë ekonomike në linjë me Marrëveshjen e Parisit (ose me një marrëveshje ndërkombëtare të përditësuar mbi ndryshimin klimatik) dhe të krahasueshme me kufizimin e ngrohjes globale në 1.5°C;
  - planet dhe kapacitetin e njësisë ekonomike për të përshtatur strategjinë dhe modelin e saj të biznesit, në linjë me tranzicionin drejt një ekonomie të qëndrueshme dhe për të kontribuar në kufizimin e ngrohjes globale në 1.5°C;
  - çdo **veprim** tjetër të ndërmarrë nga njësia ekonomike dhe rezultatin e veprimeve të tilla për të parandaluar, zbutur ose korigjuar ndikimet negative aktuale ose potenciale, si dhe për të trajtuar **rreziqet** dhe **mundësitë**;
  - natyrën, tipin dhe madhësinë e rreziqeve dhe mundësive materiale të njësisë ekonomike që vijnë nga ndikimet dhe **varësitë** e njësisë ekonomike në ndryshimin klimatik dhe sesi njësia ekonomike i menaxhon ato; dhe

- (f) **efektet financiare** në njësinë ekonomike në periudha afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, të rreziqeve dhe mundësive që vijnë nga ndikimet dhe varësitë e njësisë ekonomike në ndryshimin klimatik.
2. Kërkesa për Dhënie informacionesh shpjeguese e këtij Standardi merr në konsideratë kërkesat e legjislacionit dhe rregullores përkatëse të BE (d.m.th., Ligji për Klimën i BE,<sup>32</sup> Rregullorja e Standardeve Krahasuese më të mira për Klimën,<sup>33</sup> Rregullorja e Publikimit të informacionit për Financat e Qëndrueshme (SFDR),<sup>34</sup> Taksonomia e BE,<sup>35</sup> dhe EBA Shtylla 3 kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese).<sup>36</sup>
  3. Ky Standard mbulon Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese të lidhura me **çështjet e qëndrueshmërisë** në vijim: **“Zbutja e ndryshimit klimatik”** dhe **“Përshtatja ndaj ndryshimit klimatik”**. Gjithashtu, ai mbulon çështjet e lidhura me energjinë në madhësinë që ato janë të rëndësishme për ndryshimin klimatik.
  4. **Zbutja e ndryshimit klimatik** lidhet me përpjekjet e njësisë ekonomike në procesin e përgjithshëm të kufizimit të rritjes së temperaturës mesatare globale në 1,5 °C në krahasim me nivelet paraindustriale, në pajtim me Marrëveshjen e Parisit. Ky Standard mbulon kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të lidhura, por jo të kufizuara vetëm me to, me shtatë **Gazrat me efekt serrë (GHG)** dyoksidi i karbonit (CO<sub>2</sub>), metani (CH<sub>4</sub>), oksidi i azotit (N<sub>2</sub>O), hidrofluorokarbonet (HFCs), perfluorokarbonet (PFCs), sulfuri hexafluoride (SF<sub>6</sub>) dhe nitrogjeni trifluorid (NF<sub>3</sub>). Gjithashtu, ai mbulon Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese sesi njësia ekonomike trajton **emetimet** e saja GHG si dhe **rreziqet e tranzicionit** të lidhura me to.
  5. **Përshtatja ndaj ndryshimit klimatik** lidhet me proceset e njësisë ekonomike për t’u përshtatur ndaj ndryshimit klimatik aktual dhe të pritshëm.
  6. Ky Standard mbulon Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese për rastësitë e lidhura me klimën që mund të sjellin rreziqe klimatike fizike për njësinë ekonomike dhe zgjidhjet e përshtatura të saj për të pakësuar këto rreziqe. Gjithashtu, ai mbulon **rreziqet e tranzicionit** që vijnë nga përshtatjet e nevojshme për rastësitë e lidhura me klimën.

<sup>32</sup> Rregullorja (BE) 2021/1119 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e 30 qershorit 2021 mbi krijimin e një kuadri për arritjen e neutralitetit klimatik dhe ndryshimin e Rregulloreve (KE) Nr 401/2009 dhe (BE) 2018/1999 (‘Ligji Evropian për Klimën’) (GZ L 243, 9.7.2021, f. 1).

<sup>33</sup> Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2020/1818 e 17 korrikut 2020 që plotëson Rregulloren (BE) 2016/1011 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit me standardet minimum si Standardet më të mira për Tranzicionin Klimatik të BE dhe Standardet më të mira të lidhura me Marrëveshjen e Parisit të BE (GZ L 406, 3.12.2020, f. 17).

<sup>34</sup> Rregullorja (BE) 2019/2088 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 27 nëntorit 2019 mbi dhënien e informacioneve shpjeguese të lidhura me qëndrueshmërinë në sektorin e shërbimeve financiare (Rregullorja e Dhënies së informacioneve shpjeguese për Financat e Qëndrueshme) (GZ L 317, 9.12.2019, f. 1).

<sup>35</sup> Rregullorja (BE) 2020/852 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 18 qershorit 2020 mbi krijimin e një kuadri për të lehtësuar investimin e qëndrueshëm dhe ndryshimin e Rregulloreve (BE) 2019/2088 (GZ L 198, 22.6.2020, f. 13).

<sup>36</sup> Rregullorja për Zbatim e Komisionit (BE) 2022/2453 e 30 nëntorit 2022 që ndryshoi standardet teknike për t’u zbatuar, të përkufizuara në Rregulloren për Zbatim (BE) 2021/637 për dhënien e informacioneve shpjeguese në lidhje me rreziqet mjedisore, shoqërore dhe të qeverisjes (GZ L 324, 19.12.2022, f.1.).

7. Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese të lidhura me “Energjinë” mbulojnë të gjitha llojet e prodhimit dhe konsumit të energjisë.

## Ndërveprimi me Standardet e tjera ESRS

8. **Substancat që shkatërrojnë ozonin** (ODS), oksidi i nitrogenit (NOX) dhe oksidi i sulfurit (SOX), përmes emetimeve të tjera në ajër lidhen me ndryshimin klimatik por mbulohen nga kërkesat e raportimit në standardin ESRS E2.
9. Ndikimet në njerëz që mund të shfaqen nga tranzicioni në një ekonomi me neutralitet klimatik mbulohen nga standardet ESRS S1 Forca e vet e punës, ESRS S2 Punonjësit në zinxhirin e vlerës, ESRS S3 Komunitetet e ndikuara dhe ESRS S4 Konsumatorët dhe përdoruesit fundorë.
10. **Zbutja e ndryshimit klimatik** dhe **përshtatja** janë të lidhura ngushtë me temat e trajtuara veçanërisht në standardet ESRS E3 *Burimet ujore dhe detare* dhe ESRS E4 *Biodiversiteti dhe ekosistemet*. Në lidhje me ujin dhe siç ilustron në tabelën e rreziqeve të lidhura me klimën në AR 11, ky standard trajton **rreziqet fizike** akute dhe kronike që vijnë nga rreziqet e lidhura me ujin dhe oqeanin. **Humbja e biodiversitetit** dhe **degradimi** i ekosistemeve që mund të shkaktohet nga ndryshimi klimatik trajtohen në standardin ESRS E4 *Biodiversiteti dhe ekosistemet*.
11. Ky Standard duhet të lexohet dhe zbatohet së bashku me standardin ESRS 1 *Kërkesat e përgjithshme* dhe standardin ESRS 2 *Dhënie informacionesh shpjeguese të Përgjithshme*.

## Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese

### ESRS 2 Dhënie informacionesh shpjeguese të Përgjithshme

12. Kërkesat e këtij seksioni duhet të lexohen dhe të zbatohen së bashku me dhëniet e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga standardi ESRS 2 në Kapitullin 2 *Qeverisja*, në Kapitullin 3 *Strategjia* dhe në Kapitullin 4 *Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë*. ► **C1** Dhëniet e informacioneve shpjeguese të rezultuara do të paraqiten në **deklaratën e qëndrueshmërisë** së bashku me dhëniet e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga standardi ESRS 2, me përjashtim të pjesës ESRS 2 SBM-3 *Ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit*, për të cilën njësia ekonomike mund që, në përputhje me standardin ESRS 2, paragrafi 49, të paraqesë dhënie informacionesh shpjeguese së bashku me dhëniet e tjera të kërkuara në këtë standard sipas temës. ◀

## Qeverisja

### *Kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese lidhur me standardin ESRS 2 GOV-3: Integrimi i performancës së lidhur me qëndrueshmërinë në skemat nxitëse*

13. Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues nëse dhe si konsideratat e lidhura me klimën janë ponderuar në shpërblimin e anëtarëve të **organeve administrative, drejtimit dhe mbikëqyrëse**, përfshirë nëse performanca e tyre është vlerësuar kundrejt **objektivave për pakësimin e emetimeve GHG** të raportuara sipas Kërkesave për Dhënie informacionesh shpjeguese në E1-4 dhe përqindjen e shpërblimit të njohur në periudhën aktuale që lidhet me konsideratat për klimën, me një shpjegim se cilat janë konsideratat për klimën.

## Strategjia

### *Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-1 – Plani i tranzicionit për zbutjen e ndryshimit klimatik*

14. **Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për planin e tranzicionit të saj për zbutjen e ndryshimit klimatik.**<sup>37</sup>
15. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese është që të lejojë kuptimin e përpjekjeve për zbutje të shkuara, të tashme dhe të ardhshme të njësisë ekonomike, për të siguruar që strategjia dhe **modeli i biznesit** të saj pajtohen me tranzicionin drejt një ekonomie të qëndrueshme dhe me kufizimin e ngrohjes globale në 1.5°C, sipas Marrëveshjes së Parisi dhe me objektivin e arritjes së neutralitetit klimatik brenda 2050, si dhe, nëse është e rëndësishme, ekspozimin e njësisë ekonomike ndaj aktiviteteve të lidhura me qymyrin, naftën dhe gazin.
16. Informacioni që kërkohet nga paragrafi 14 do të përfshijë:
  - (a) duke iu referuar **objektivave të pakësimit të emetimeve GHG** (siç kërkohet nga Kërkesa për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-4), një shpjegim sesi objektivat e njësisë ekonomike pajtohen me kufizimin e ngrohjes globale në 1.5°C sipas Marrëveshjes së Parisit;
  - (b) duke iu referuar objektivave të pakësimit të emetimeve GHG (siç kërkohet nga Kërkesa për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-4) dhe **veprimeve për zbutjen e ndryshimit klimatik** (siç kërkohet nga Kërkesa për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-3), një shpjegim për **levat e dekarbonizimit** të identifikuara, si dhe veprimet kryesore të planifikuara, përfshirë ndryshimet në portofolin e produkteve dhe shërbimeve të njësisë

---

<sup>37</sup> Ky informacion është në pajtim me Rregulloren (BE) 2021/1119 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (Ligji për Klimën BE), neni 2, pika (1); dhe me Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2020/1818 (Rregullorja e Standardit më të mirë për Klimën), neni 2.

ekonomike dhe përdorimin e teknologjive të reja në veprimtarinë e vet ose në rrjedhën e sipërme dhe/ose të poshtme të zinxhirit të vlerës;

- (c) duke iu referuar **veprimeve për zbutjen e ndryshimit klimatik** (siç kërkohet nga Kërkesa për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-3), një shpjegim dhe përcaktim sasior të investimeve dhe financimeve të njësishme ekonomike në mbështetje të zbatimit të **planit të tranzicionit** të saj, duke iu referuar treguesve kyç të performancës të taksonomisë së lidhur me CapEx (shpenzimet kapitale) dhe kur është e rëndësishme planet CapEx që njësia ekonomike paraqet në përputhje me Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2021/2178;
- (d) një vlerësim cilësor të **emetimeve GHG të kyçura (të bllokuara)** potenciale nga aktivitetet dhe produktet kryesore të njësishme ekonomike. Kjo do të përfshijë një shpjegim të nëse dhe si këto **emetime** mund të komprometojnë arritjen e **objektivave të pakësimit të emetimeve GHG** të njësishme ekonomike dhe të sjellin **rreziqe të tranzicionit**, si dhe nëse është e zbatueshme një shpjegim të planeve të njësishme ekonomike për të menaxhuar aktivitetet dhe produktet e saj me emetim të lartë GHG dhe me konsum të lartë energjetik;
- (e) për njësitë ekonomike me aktivitetet ekonomik që mbulohet nga rregulloret e deleguara për përshtatjen dhe zbutjen ndaj klimës sipas Rregullores së Taksonomisë, një shpjegim i objektivave ose planeve (CapEX, planet CapEx, OpEX) që njësia ekonomike ka hartuar për të përshtatur aktivitetet e saj ekonomike (të ardhurat, CapEx, OpEx) me kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Deleguar të Komisionit 2021/2139;<sup>38</sup>
- (f) nëse është e zbatueshme, një dhënie informacionesh shpjeguese e shumave CapEx të rëndësishme të investuara gjatë periudhës së raportimit për aktivitetet ekonomik të lidhura me qymyrin, naftën dhe gazin;<sup>39</sup>
- (g) një dhënie informacionesh shpjeguese nëse njësia ekonomike përjashtohet ose jo nga kërkesat për Standardet më të mira sipas Marrëveshjes së Parisit;<sup>40</sup>
- (h) një shpjegim sesi është përfshirë **plani i tranzicionit** në strategjinë e përgjithshme të biznesit dhe planifikimin financiar të njësishme ekonomike dhe si është lidhur me to;
- (i) nëse plani i tranzicionit është miratuar nga **organet administrative, të drejtimit dhe të mbikëqyrjes**; dhe

---

<sup>38</sup> Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2021/2139 e 4 qershorit 2021 që plotëson Rregulloren (BE) 2020/852 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit duke përcaktuar kriteret teknike të shqyrtimit për përcaktimin e kushteve sipas të cilave një aktivitet ekonomik kualifikohet se kontribuon në mënyrë të rëndësishme në zbutjen ose përshtatjen e ndryshimit klimatik dhe për të përcaktuar nëse ai aktivitetet ekonomik shkakton dëm jo të rëndësishëm tek objektivat e tjerë mjedisorë (GZ L 442, 9.12.2021, f. 1).

<sup>39</sup> Shumat CapEx të marra në konsideratë lidhen me kodet NACE në vijim: (a) B.05 Nxjerrja e qymyrit dhe linjtit, B.06 Nxjerrja e naftës bruto dhe e gazit natyror ( e kufizuar në naftën bruto), B.09.01 Aktivitete mbështetëse për nxjerrjen e naftës dhe gazit natyror ( e kufizuar në naftën bruto); (b) C.19 Prodhimi i qymyrit (koksit) dhe produkteve të rafinuara të naftës; (c) D.35.1 - Prodhimi i energjisë elektrike, transmetimi dhe shpërndarja; (d) D.35.3 - Furnizimi me avull dhe ajër të kondicionuar (i kufizuar në prodhimin e energjisë elektrike dhe/ose ngrohjes me qymyr dhe naftë); (e) G.46.71 - Tregtia me shumicë e karburanteve solide, të lëngshëm dhe të gazta, si dhe të produkteve të lidhura (e kufizuar në karburantet solide dhe të lëngshme). Për aktivitetet e lidhura me gazin, përkufizimi i kodit NACE trajton aktivitetet me emetime GHG të drejtpërdrejta që janë më të larta se 207 gCO<sub>2</sub>/KWh.

<sup>40</sup> Kjo kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese përfshihet në pajtim me kërkesat në Rregulloren për Zbatim të Komisionit (BE) 2022/2453 për formatin I të rrezikut të tranzicionit në ndryshimin klimatik; dhe është në pajtim me Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2020/1818 (Rregullorja e Standardit më të mirë për Klimën), neni 12.1, germa (d) deri në (g) dhe neni 12.2.

(j) një shpjegim të progresit të njësisë ekonomike në zbatimin e planit të tranzicionit.

17. Në rastin kur njësi ekonomike nuk disponon një **plan tranzicioni**, ajo do të tregojë nëse dhe kur do të përdorë një plan tranzicioni.

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese e lidhur me standardin ESRS 2 SBM-3 – Ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit.*

18. Njësia ekonomike do të shpjegojë për secilin rrezik material të lidhur me klimën që ka identifikuar, nëse ajo e konsideron rrezikun të jetë një rrezik fizik i lidhur me klimën apo një rrezik tranzicioni i lidhur me klimën.

19. Njësia ekonomike do të përshkruajë qëndrueshmërinë e strategjisë dhe të modelit të biznesit të saj në lidhje me ndryshimin klimatik. Ky përshkrim do të përfshijë:

(a) objektin e analizës së qëndrueshmërisë;

(b) si dhe kur është kryer analiza e qëndrueshmërisë, përfshirë përdorimin e **analizës së skenarit** siç referohet në Kërkesën për Dhënie informacionesh shpjeguese të lidhur me standardin ESRS 2 IRO-1 dhe paragrafët përkatës të kërkesës për zbatim; dhe

(c) rezultatet e analizës së qëndrueshmërisë duke përfshirë rezultatet nga përdorimi i analizës së skenarit.

## **Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë**

*Kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese e lidhur me standardin ESRS 2 IRO-1 – Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me klimën*

20. Njësia ekonomike do të përshkruajë procesin për të identifikuar dhe vlerësuar **ndikimet, rreziqet dhe mundësitë** e lidhura me klimën. Ky përshkrim do të përfshijë procesin përkatës në lidhje me:

(a) ndikimet në ndryshimin klimatik, veçanërisht **emetimet GHG** të njësisë ekonomike (siç kërkohet nga Kërkesa për Dhënie informacionesh shpjeguese ESRS E1-6);

(b) **rreziqet fizike të lidhura me klimën** në veprimtarinë e vet dhe përgjatë rrjedhës së sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të vlerës**, veçanërisht:

i. identifikimin e rreziqeve të lidhura me klimën, duke marrë në konsideratë të paktën **skenarët** e klimës me **emetim** të lartë; dhe

ii. vlerësimin sesi aktivitetet dhe aktivitetet e biznesit të saj mund të ekspozohen dhe janë të ndjeshme ndaj këtyre rreziqeve të lidhura me klimën, duke krijuar **rreziqe fizike bruto** për njësinë ekonomike.

(c) **rreziqet e tranzicionit të lidhura me klimën** dhe mundësitë në veprimtarinë e vet dhe përgjatë rrjedhës së sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të vlerës**, veçanërisht:

- i. identifikimi i ngjarjeve të tranzicionit të lidhura me klimën, duke marrë në konsideratë të paktën një skenar klime në pajtim me kufizimin e ngrohjes globale në 1.5°C me ose pa tejkalim; dhe
- ii. vlerësimin sesi aktivitetet dhe bizneset e saj mund të ekspozohen ndaj këtyre rreziqeve të tranzicionit të lidhura me klimën, duke krijuar **rreziqe të tranzicionit** ose **mundësi** për njësinë ekonomike.

21. Kur paraqet informacionin e kërkuar sipas paragrafëve 20, geramat (b) dhe (c) njësinë ekonomike do të shpjegojë sesi i ka përdorur **analizat e skenarit** të lidhura me klimën duke përfshirë një gamë skenarësh klime, për të informuar identifikimin dhe vlerësimin e **rreziqeve fizike** dhe **rreziqeve të tranzicionit**, si dhe të mundësive përgjatë periudhës afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-2 – Politikat e lidhura me zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimit klimatik*

22. **Njësia ekonomike do të përshkruajë politikat e saj të përdorura për të menaxhuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të saj të lidhura me zbutjen dhe përshtatjen klimatike.**

23. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese është që të lejojë kuptimin e masës në të cilën njësinë ekonomike disponon **politika** që trajtojnë identifikimin, vlerësimin, menaxhimin dhe/ose **korrigjimin e ndikimeve, rreziqeve** dhe **mundësive** materiale të saj të lidhura me **zbutjen e ndryshimit klimatik** dhe **përshtatjen** ndaj tij.

24. Dhënia e informacioneve shpjeguese e kërkuar nga paragrafi 22 do të përmbajë informacionin mbi **politikat** që disponon njësinë ekonomike për të menaxhuar **ndikimet, rreziqet** dhe **mundësitë** e lidhura me **zbutjen e ndryshimit klimatik** dhe **përshtatjen** ndaj tij në përputhje me ESRS 2 MDR-P *Politikat e përdorura për të menaxhuar çështjet materiale të qëndrueshmërisë*.

25. Njësia ekonomike do të tregojë nëse dhe sesi **politikat** e saj trajtojnë (mbulojnë) fushat në vijim:

- (a) **zbutjen e ndryshimit klimatik;**
- (b) **përshtatjen ndaj ndryshimit klimatik;**
- (c) rendimentin energjetik;
- (d) shpërndarjen e **energjisë së rinovueshme**; dhe
- (e) të tjera.

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-3 – Veprimet dhe burimet e lidhura me politikat për ndryshimin klimatik*

26. **Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për veprimet e saj lidhur me *zbutjen e ndryshimit klimatik* dhe *përshtatjen* ndaj tij, si dhe burimet e caktuara për zbatimin e tyre.**
27. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese është që të lejojë kuptimin e **veprimeve** kryesore të ndërmarra dhe të planifikuara për të arritur objektivat e **politikave** dhe **synimet** e lidhura me klimën.
28. Përshkrimi i **veprimeve** dhe burimeve të lidhura me **zbutjen e ndryshimit klimatik** dhe përshtatja do të ndjekë parimet e dhëna në ESRS 2 MDR-A *Veprimet dhe burimet në lidhje me çështjet materiale të qëndrueshmërisë*.
29. Përveç kërkesave në ESRS 2 MDR-A, njësia ekonomike do të:
  - (a) paraqesë veprimet për **zbutjen e ndryshimit klimatik** përmes levës së dekarbonizimit duke përfshirë zgjidhjet e bazuara në natyrë, kur rendit **veprimet** kryesore të ndërmarra në vitin e raportimit dhe të planifikuara në të ardhmen;
  - (b) përfshijë **pakësimin e emetimeve GHG** të arritura dhe të pritshme, kur përshkruan rezultatet e veprimeve për zbutjen e ndryshimit klimatik; dhe
  - (c) tregojë shumat monetare kryesore të CapEx dhe OpEx të kërkuara për zbatimin e veprimeve të ndërmarra ose të planifikuara për t'u ndërmarrë:
    - i. nënzërat kryesorë ose shënimet në pasqyrat financiare;
    - ii. treguesit kryesorë të performancës të kërkuar sipas Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2021/2178; dhe
    - iii. nëse është e zbatueshme, planin CapEx të kërkuar sipas Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2021/2178;

## **Metrikat dhe objektivat**

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-4 – Objektivat e lidhura me zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimit klimatik*

30. **Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për objektivat që ka vendosur lidhur me klimën.**
31. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese është që të lejojë të kuptohen **objektivat** që ka vendosur njësia ekonomike për të mbështetur **politikat** e saj për **zbutjen e ndryshimit klimatik** dhe **përshtatjen** ndaj tij, si dhe për të trajtuar **ndikimet, rreziqet** dhe **mundësitë** materiale të lidhura me klimën.

32. Dhënia e informacioneve shpjeguese mbi **objektivat** e kërkuar në paragrafin 30 do të përmbajë informacionin e kërkuar në ESRS 2 MDR-T *Gjurmimi i efektivitetit të politikave dhe veprimeve përmes objektivave*.
33. Lidhur me dhënien e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga paragrafi 30, njësia ekonomike do të paraqesë nëse dhe si i ka vendosur **objektivat e pakësimit të emetimeve GHG** dhe/ose ndonjë objektiv tjetër për të menaxhuar **ndikimet, rreziqet dhe mundësitë** materiale të lidhura me klimën, për shembull shpërndarjen e **energjisë së rinovueshme**, rendimentin energjetik, **përshtatjen ndaj ndryshimit klimatik** dhe zbutjen e **rrezikut fizik** ose **të tranzicionit**.
34. Nëse njësia ekonomike ka vendosur **objektiva për pakësimin e emetimeve GHG** <sup>(41)</sup>, do të zbatojë kërkesat e ESRS 2 MDR-T dhe kërkesat në vijim:
- (a) objektivat e pakësimit të emetimeve GHG do të paraqiten në vlera absolute (ose në tonë të ekuivalentit të CO<sub>2</sub> ose si përqindje e **emetimeve** ndaj një viti bazë) dhe, nëse është e rëndësishme, në vlera intensiteti;
  - (b) objektivat e pakësimit të emetimeve GHG do të paraqiten për **emetimet GHG të Perimetrit 1, 2, dhe 3**, veçmas ose të kombinuar. Njësia ekonomike do të specifikojë, në rastin e **objektivave të pakësimit të emetimeve GHG** të kombinuar, se cili Perimetër i emetimit GHG (1,2 dhe/ose 3) është mbuluar nga objektivi, pjesën që lidhet me secilin Perimetër emetimi GHG përkatës dhe cilat GHG janë mbuluar. Njësia ekonomike do të shpjegojë sesi sigurohet koherenca e këtyre objektivave me kufijtë e saj të inventarit GHG (siç kërkohet nga Kërkesa për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-6). Objektivat e pakësimit të emetimeve GHG do të jenë objektiva bruto, që do të thotë se njësia ekonomike nuk do të përfshijë heqjet e GHG, **kreditet e karbonit** ose emetimet e shmangura si mjet i arritjes së objektivave të pakësimit të emetimeve GHG;
  - (c) njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për vitin bazë dhe vlerën referencë aktuale të saj, si dhe nga 2030 e më tej, do të përditësojë vitin bazë për objektivat e saj të pakësimit të emetimeve GHG çdo pesë vjet. Njësia ekonomike mund të japë informacion shpjegues për ecurinë e shkuar në arritjen e objektivave të saj para vitit bazë të saj aktual me kushtin që ky informacion të jetë në pajtim me kërkesat e këtij Standardi;
  - (d) objektivat për pakësimin e emetimeve GHG do të përfshijnë të paktën vlera të synuara për vitin 2030 dhe, nëse janë në dispozicion, për vitin 2050. Nga 2030, vlerat e synuara do të vendosen pas çdo periudhe 5-vjeçare;
  - (e) njësia ekonomike do të deklarojë nëse objektivat për pakësimin e emetimeve GHG janë të bazuar në shkencë dhe të krahasueshëm me kufizimin global të ngrohjes në 1.5°C.

---

<sup>41</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve të tregut financiar objekt të Rregullores (BE) 2019/2088 (SFDR) sepse vjen nga një tregues shtesë i lidhur me ndikimet negative kryesore siç paraqitet në treguesin #4 në Tabelën II të Aneksit I, të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese për investimet e qëndrueshme ("Investimet në shoqëri pa nisma për pakësimin e emetimeve të karbonit"); si dhe është në pajtim me Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2020/1818 (Rregullorja e Standardit më të mirë për Klimën), neni 6.

Njësia ekonomike do të deklarojë se cilin kuadër dhe cilën metodologji ka përdorur për të përcaktuar këta **objektiva** duke përfshirë nëse ata janë nxjerrë duke përdorur një trajektore dekarbonizimi të sektorit, se cilët janë **skenarët** e nënkuptuar lidhur me klimën dhe **politikën**, si dhe nëse objektivat janë garantuar lidhur me sigurinë nga jashtë. Si pjesë e supozimeve kritike për vendosjen e objektivave për pakësimin e emetimeve GHG, njësia ekonomike do të shpjegojë shkurt se si ka marrë në konsideratë zhvillimet e ardhshme (p.sh., ndryshimet në vëllimet e shitjeve, ndryshimet në shijet dhe kërkesën e klientëve, faktorët rregullatorë dhe teknologjitë e reja) dhe se si këto do të mund të ndikojnë si emetimet GHG edhe pakësimin e tyre; dhe

- (f) njësia ekonomike do të përshkruajë **levat e dekarbonizimit** të pritshme dhe kontributin e tyre sasiore në total për të arritur objektivat për pakësimin e emetimeve GHG (p.sh., rendimenti energjetik ose materiale dhe pakësimi i konsumit, ndryshimi i karburanteve, përdorimi i **energjisë së rinovueshme**, ndalimi gradual ose zëvendësimi i produkteve dhe proceseve).

#### *Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-5 – Konsumi i energjisë dhe miksi i energjisë*

35. **Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për konsumin dhe miksin e saj të energjisë**
36. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese është që të lejojë të kuptohet konsumi gjithsej i energjisë i njësisë ekonomike në vlerë absolute, përmirësimi në rendimentin energjetik, ekspozimi ndaj aktiviteteve të lidhura me qymyrin, naftën dhe gazin, si dhe pjesën e **energjisë së rinovueshme** në miksin gjithsej energjetik të saj.
37. Kërkesa për dhënie informacionesh shpjeguese e paragrafit 35 do të përfshijë konsumin gjithsej të energjisë në MWh të lidhur me veprimtarinë e saj të zbërthyer sipas:
- (a) konsumit gjithsej të energjisë nga burimet fosile;<sup>42</sup>
- (b) konsumit gjithsej të energjisë nga burimet nukleare (bërthamore);
- (c) konsumit gjithsej të energjisë nga burimet e rinovueshme të ndara sipas:
- i. konsumit të karburantit për burimet e rinovueshme përfshirë biomasën (duke përfshire edhe **mbetjet** industriale dhe të bashkive me origjinë biologjike), karburantët biologjikë, biogazin, hidrogjenin nga burimet e rinovueshme,<sup>43</sup> etj.;

---

<sup>42</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve të tregut financiar objekt të Rregullores (BE) 2019/2088 (SFDR) sepse vjen nga një tregues i detyrueshëm i lidhur me ndikimet negative kryesore siç paraqitet në treguesin #5 në Tabelën II të Aneksit I, të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese për investimet e qëndrueshme ("Pjesa e konsumit dhe prodhimit të lidhur me energjinë jo të rinovueshme"); Zbërthimi shërben si një referencë për një tregues shtesë të lidhur me ndikimet kryesore negative siç paraqitet në treguesin #5 në Tabelën II të të njëjtit Aneks ("Zbërthimi i konsumit të energjisë sipas tipit të burimeve jo të rinovueshme të energjisë").

<sup>43</sup> Në përputhje me kërkesat në vendimin për hidrogjenin nga burimet e rinovueshme të Rregullores së Deleguar të Komisionit të 10 shkurtit 2023 që plotëson Direktivën (BE) 2018/2001 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit duke vendosur një metodologji të BE që

- ii. konsumi i energjisë, ngrohjes, avullit dhe ftohjes së blerë ose të siguruar nga burimet e rinovueshme; dhe
  - iii. konsumi i energjisë së rinovueshme të gjeneruar vetë, jo nga karburanti.
38. Njësia ekonomike me veprimtari në **sektorë me ndikim të lartë klimatik**<sup>44</sup> do të zërthejë më tej konsumin e saj total të energjisë nga burime fosile sipas:
- (a) konsumit të karburantit nga qymyri dhe produktet e tij;
  - (b) konsumit të karburantit nga nafta dhe produktet e saj;
  - (c) konsumit të karburantit nga gazi natyror;
  - (d) konsumit të karburantit nga burimet e tjera fosile;
  - (e) konsumit të **energjisë, ngrohjes, avullit dhe ftohjes së blerë ose të siguruar** nga burimet fosile.
39. Gjithashtu, sipas rastit, njësia ekonomike do të zërthejë dhe do të japë informacion shpjegues veçmas për prodhimin e saj të **energjisë jo të rinovueshme** dhe për prodhimin e saj të **energjisë së rinovueshme** në MWh.<sup>45</sup>

### Intensiteti i energjisë i bazuar në shitjet neto<sup>46</sup>

40. Njësia ekonomike do të sigurojë informacion mbi intensitetin e energjisë (konsumin total të energjisë për shitjet neto) të lidhura me aktivitetet në **sektorët me ndikim të lartë klimatik**.
41. Dhënia e informacioneve shpjeguese për intensitetin e energjisë e kërkuar nga paragrafi 40 do të nxirret vetëm nga konsumi total i energjisë dhe shitjet neto nga aktivitetet në **sektorët me ndikim të lartë klimatik**.
42. Njësia ekonomike do të specifikojë **sektorët me ndikim të lartë klimatik** që janë përdorur për të përcaktuar intensitetin e energjisë të kërkuar nga paragrafi 40.
43. Njësia ekonomike do të japë si informacion shpjegues një rakordim me nënzërat kryesorë ose shënimet në pasqyrat financiare të shumës së të ardhurave (shitjeve) neto nga aktivitetet në

---

përcakton rregulla të hollësishme mbi prodhimin e karburanteve të rinovueshme të lëngët dhe gaz, për sektorin e transportit, me origjinë jo biologjike; dhe Rregulloren e Deleuar të Komisionit të 10 shkurtit 2023 që plotëson Direktivën (BE) 2018/2001 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit duke vendosur një prag minimum për kursimet nga emetimet e gazit me efekt serrë nga karburantet e karbonit të ricikluar dhe duke specifikuar një metodologji për vlerësimin e kursimeve nga emetimet e gazit me efekt serrë nga karburantet e rinovueshme të lëngët dhe gaz, për sektorin e transportit me origjinë jo biologjike dhe nga karburanti i karbonit të ricikluar.

<sup>44</sup> Sektorët me ndikim të lartë klimatik janë ata të renditur në NACE, Seksionet A deri tek H dhe Seksioni L (siç përkufizohet në Rregulloren e Deleuar të Komisionit (BE) 2022/1288).

<sup>45</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve të tregut financiar objekt të Rregullores (BE) 2019/2088 sepse vjen nga një tregues i detyrueshëm i lidhur me ndikimet negative kryesore siç paraqitet në treguesin #5 në Tabelën II të Aneksit I, të Rregullores së Deleuar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese për investimet e qëndrueshme ("Pjesa e konsumit dhe prodhimit të lidhur me energjinë jo të rinovueshme").

<sup>46</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve të tregut financiar objekt të Rregullores (BE) 2019/2088 sepse vjen nga një tregues i detyrueshëm i lidhur me ndikimet negative kryesore siç paraqitet në treguesin #6 në Tabelën II të Aneksit I, të Rregullores së Deleuar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese për investimet e qëndrueshme ("Intensiteti i konsumit të energjisë për sektorin me ndikim të lartë klimatik").

**sektorët me ndikim të lartë klimatik** (emëruesi në llogaritjen e intensitetit të energjisë të kërkuar nga paragrafi 40).

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-6 – Emetimet bruto GHG të perimetrit 1, 2, 3 dhe emetimet totale GHG*

44. **Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për metrikën në tonë ekuivalent të CO<sub>2</sub> të:**<sup>47</sup>
- (a) **emetimeve GHG të perimetrit 1;**
  - (b) **emetimeve GHG të perimetrit 2;**
  - (c) **emetimeve GHG të perimetrit 3; dhe**
  - (d) **emetimeve GHG të tërthorta.**
45. Objektivi i Kërkesës për Dhënie informacionesh shpjeguese në paragrafin 44 në lidhje me:
- (a) **emetimet GHG të Perimetrit 1** bruto siç kërkohet nga paragrafi 44(a), është që të lejojë kuptimin e ndikimeve të drejtpërdrejta të njësisë ekonomike në ndryshimin klimatik dhe pjesës së emetimeve totale GHG të saj që janë të rregulluara sipas skemave të tregtimit të emetimit (sistemit të këmbimit të kuotave të emetimit).
  - (b) **emetimet GHG të Perimetrit 2** bruto siç kërkohet nga paragrafi 44(b), është që të lejojë kuptimin e ndikimeve të tërthorta të njësisë ekonomike në ndryshimin klimatik të shkaktuar nga energjia e konsumuar nga njësia ekonomike, e blerë ose e siguruar nga jashtë.
  - (c) **emetimet GHG të Perimetrit 3** bruto siç kërkohet nga paragrafi 44(c), është që të lejojë kuptimin e emetimeve GHG të njësisë ekonomike që shfaqen në rrjedhën e sipërme ose të poshtme të zinxhirit të vlerës përtej emetimeve GHG të perimetrit 1 dhe 2. Për shumë njësi ekonomike emetimet GHG të Perimetrit 3 mund të jenë përbërësi kryesor i inventarit GHG të tyre dhe janë një faktor i rëndësishëm për të kuptuar **rreziqet e tranzicionit** të njësisë ekonomike.
  - (d) **emetimet GHG totale** siç kërkohet nga paragrafi 44(d), është që të lejojë kuptimin, në mënyrë globale, të emetimeve GHG të njësisë ekonomike dhe nëse ato ndodhin nga veprimtaria e saj apo në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës. Ky informacion është parakusht për matjen e ecurisë në pakësimin e emetimeve GHG në përputhje me **objektivat** e lidhura me klimën të njësisë ekonomike dhe objektivat e **politikës** së BE.

---

<sup>47</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve të tregut financiar objekt të Rregullores (BE) 2019/2088 sepse vjen nga një tregues i detyrueshëm i lidhur me ndikimet negative kryesore siç paraqitet nga treguesit #1 dhe # 2 në Tabelën I të Aneksit I, të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese për investimet e qëndrueshme ("Emetimet GHG" dhe "Gjurma e karbonit"). Ky informacion është në pajtim me Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2020/1818 (Rregullorja e Standardit më të mirë për Klimën), neni 5 (1), neni 6 dhe neni 8 (1).

Gjithashtu, informacioni nga kjo Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese është i nevojshëm për të kuptuar **rreziqet e tranzicionit** të lidhura me klimën të njësisë ekonomike.

46. Kur jepet informacion mbi **emetimet GHG** të kërkuara nga paragrafi 44, njësia ekonomike do t'i referohet paragrafëve 62 deri tek 67 të ESRS 1. Në parim, të dhënat mbi emetimet GHG të pjesëmarrjeve të saj ose të sipërmarrjeve të përbashkëta që janë pjesë e rrjedhës së sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës së njësisë ekonomike (Paragrafi 67 i ESRS 1) nuk kufizohen deri në pjesën e mbajtur (zotëruar) të kapitalit neto. Për pjesëmarrjet, sipërmarrjet e përbashkëta, filialet e pakonsoliduara (njësitë ekonomike investuese) dhe marrëveshjet kontraktuale që janë marrëveshje të përbashkëta jo të strukturura përmes një njësie ekonomike (d.m.th., operacioneve dhe aktiveve me kontroll të përbashkët), njësia ekonomike do të përfshijë emetimet GHG në përputhje me shkallën e **kontrollit të veprimtarisë** së njësisë ekonomike mbi to.
47. Në rast të ndryshimeve të rëndësishme në përkufizimin e përbërësve të njësisë ekonomike raportuese dhe rrjedhës së sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të vlerës** së saj, njësia ekonomike do t'i japë këto ndryshime dhe do të shpjegojë efektin e tyre në krahasimin në vite të **emisioneve** GHG të raportuara prej saj (d.m.th., efektin e krahasimit të emetimeve GHG të raportuara periudhën aktuale kundrejt emetimeve GHG të raportuara në periudhën e mëparshme).
48. Dhënia e informacioneve shpjeguese për **emetimet GHG të Perimetrit 1** të kërkuara nga paragrafi 44(a) do të përfshijë:
  - (a) emetimet GHG të perimetrit 1, bruto në metrikën tonë të ekuivalentit CO<sub>2</sub>; dhe
  - (b) përqindjen e emetimeve GHG të Perimetrit 1 nga skemat e rregulluara për emetimet e tregtueshme.
49. Dhënia e informacioneve shpjeguese për **emetimet GHG të Perimetrit 2** të kërkuara nga paragrafi 44(b) do të përfshijë:
  - (a) emetimet GHG të Perimetrit 2 në bazë të zonës, bruto në metrikën tonë të ekuivalentit CO<sub>2</sub>; dhe
  - (b) emetimet GHG të perimetrit 2 në bazë të tregut, bruto në metrikën tonë të ekuivalentit CO<sub>2</sub>.
50. Për **emetimet e Perimetrit 1 dhe të Perimetrit 2** të dhëna sipas kërkesave të paragrafëve 44(a) dhe (b) njësia ekonomike do të zërtheje informacionin, duke dhënë informacion për emetimet veçmas nga:
  - (a) grupi i konsoliduar kontabël (shoqëri mëmë dhe filiale); dhe
  - (b) i investuari i tillë si pjesëmarrje, sipërmarrje e përbashkët, ose filiale të pakonsoliduara që nuk janë konsoliduar plotësisht në pasqyrat financiare të grupit të konsoliduar kontabël, si dhe marrëveshje kontraktuale që janë marrëveshje të përbashkëta jo të strukturuar

përmes një njësie ekonomike (d.m.th., operacione dhe aktive me kontroll të përbashkët), për të cilat ajo ka kontrollin e veprimtarisë.

51. Dhënia e informacioneve shpjeguese për **emisionet GHG të Perimetrit 3** të kërkuara nga paragrafi 44 (c) do të përfshijë emetimet GHG të shprehura në tonë metrikë të ekuivalentit CO<sub>2</sub>, për secilën **kategori të Perimetrit 3** të rëndësishme (d.m.th., për secilën kategori të Perimetrit 3 që është prioritet për njësinë ekonomike).
52. Dhënia e informacioneve shpjeguese për **emetimet GHG** totale të kërkuara nga paragrafi 44(d) do të jetë shuma e **emetimeve GHG të Perimetrit 1, 2, dhe 3** të kërkuara nga paragrafët 44(a) deri tek (c). Emetimet GHG totale do të paraqiten me një zbërthim që dallon:
  - (a) emetimet GHG totale që vijnë nga emetimet GHG të perimetrit 2 të nënkuptuara të matura duke përdorur metodën e bazuar në zonë (vendndodhje); dhe
  - (b) emetimet GHG totale që vijnë nga emetimet GHG të perimetrit 2 të nënkuptuara të matura duke përdorur metodën e bazuar në treg.

*Intensiteti i GHG i bazuar në shitjet neto<sup>48</sup>*

53. Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për intensitetin e **emetimeve** GHG të saj (emetimet GHG totale ndaj shitjeve neto).
54. Dhënia e informacioneve shpjeguese për intensitetin e GHG të kërkuara nga paragrafi 53 do të sigurojë **emetimet** GHG totale të shprehura në metrikën tonë të ekuivalentit të CO<sub>2</sub> (të kërkuar nga paragrafi 44(d)) ndaj të ardhurave neto.
55. Njësia ekonomike do të japë si informacion shpjegues një rakordim me nënzërat kryesorë ose shënimet në pasqyrat financiare të shumave të shitjeve neto (emëruesi në llogaritjen e intensitetit të **emetimeve** GHG të kërkuar nga paragrafi 53).

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-7 – Projektet për heqjen dhe zbutjen e GHG, të financuara përmes krediteve të karbonit*

56. **Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues:**
  - (a) **për heqjet dhe magazinimin e GHG, në tonë metrikë ekuivalente të CO<sub>2</sub>, që vijnë nga projektet që mund të ketë zhvilluar në veprimtarinë e vet ose të kontribuara në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës të saj; dhe**

---

<sup>48</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve të tregut financiar objekt të Rregullores (BE) 2019/2088 sepse vjen nga një tregues i detyrueshëm i lidhur me ndikimet negative kryesore siç paraqitet në treguesin #3 në Tabelën I të Aneksit I, të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese për investimet e qëndrueshme ("Intensiteti i GHG i shoqërive të investimit"). Ky informacion është në pajtim me Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2020/1818 (Rregullorja e Standardit më të mirë për Klimën), neni 8 (1).

(b) shumën e pakësimit të emetimeve GHG ose të heqjeve nga projektet për zbutjen e ndryshimit klimatik jashtë zinxhirit të saj të vlerës që ka financiar ose synon t'i financojë përmes blerjes së krediteve të karbonit.

57. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese është:

(a) të lejojë të kuptohen **veprimet** e njësisë ekonomike për të hequr në mënyrë të përhershme ose për të mbështetur në mënyrë aktive heqjen e GHG nga atmosfera, për të arritur mundësisht **objektivat zero neto** (siç tregohet në paragrafin 60).

(b) të lejojë të kuptohet madhësia dhe cilësia e **krediteve të karbonit** që ka blerë njësia ekonomike ose që synon të blejë në tregun e lirë, për të mbështetur kërkesat për neutralitetin GHG (siç tregohet në paragrafin 61).

58. Dhënia e informacioneve shpjeguese mbi **heqjet dhe magazinimin GHG** të kërkuara nga paragrafi 56(a) do të përfshijë, nëse është e zbatueshme:

(a) shumën totale të heqjeve dhe magazinimit GHG në tonë metrike ekuivalente të CO<sub>2</sub> të zbërthyer dhe paraqitur veçmas për shumën e lidhur me veprimtarinë e vet të njësisë ekonomike dhe të rrjedhës së sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të saj të vlerës, si dhe të zbërthyer sipas aktivitetit të heqjes; dhe

(b) supozimet në llogaritje, metodologjitë dhe kuadrot e referimit të përdorura nga njësia ekonomike.

59. Dhënia e informacioneve shpjeguese mbi **kreditet e karbonit** të kërkuara nga paragrafi 56(b) do të përfshijë, nëse është e zbatueshme:

(a) shumën totale të krediteve të karbonit jashtë **zinxhirit të vlerës** të njësisë ekonomike të shprehur në tonë në metrikën e ekuivalentit të CO<sub>2</sub> që janë të verifikueshme kundrejt standardeve të njohura të cilësisë dhe të fshira në periudhën e raportimit. dhe

(b) shumën totale të krediteve të karbonit jashtë zinxhirit të vlerës të njësisë ekonomike të shprehur në tonë metrike të ekuivalentit të CO<sub>2</sub> për t'u fshirë në të ardhmen dhe nëse ato janë bazuar në një marrëveshje kontraktuale ekzistuese ose jo.

60. Në rastin kur njësia ekonomike jep si informacion shpjegues një **objektiv zero neto** përveç **objektivave për pakësimin e emetimeve GHG** në përputhje me Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-4, të paragrafit 30, ajo do të shpjegojë objektin, metodologjinë dhe kuadrin e referimit të zbatuar dhe sesi **emetimet** GHG të mbetura (pas pakësimit të emetimeve GHG me afërsisht 90-95% me mundësinë e justifikimit të variacioneve sipas sektorëve në linjë me trajektoren e njohur të dekarbonizimit të sektorit) synohet të neutralizohen, për shembull përmes heqjeve të GHG në veprimtaritë e veta dhe në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të saj të vlerës.

61. Në rastin kur njësia ekonomike mund të ketë bërë deklarata publike të neutralitetit GHG që përfshijnë përdorimin e **krediteve të karbonit**, ajo do të shpjegojë:

- (a) nëse dhe si këto deklarata shoqërohen nga **objektivat e pakësimit të emetimeve GHG** siç kërkohet nga Kërkesa për dhënie informacionesh shpjeguese ESRS E1-4;
- (b) nëse dhe si këto deklarata dhe mbështetja në kreditet e karbonit as nuk e pengon ose as nuk e pakëson arritjen e objektivave të saj për pakësimin e GHG,<sup>49</sup> ose nëse është e zbatueshme, objektivin zero neto; dhe
- (c) besueshmërinë dhe integritetin e krediteve të karbonit të përdorura, duke përfshirë me referencë standardet e njohura të cilësisë.

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-8 – Çmimi i brendshëm i karbonit*

- 62. **Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues nëse ajo zbaton skema të përcaktimit të çmimit të brendshëm të karbonit dhe nëse është kështu, sesi ato skema mbështesin vendimmarrjen e saj dhe nxisin zbatimin e politikave dhe objektivave të lidhura me klimën.**
- 63. Informacioni që kërkohet nga paragrafi 62 do të përfshijë:
  - (a) llojin e skemave të përcaktimit të çmimit të brendshëm të karbonit, për shembull çmimet fiktive të zbatuara për vendimmarrjen lidhur me CapEX ose investimet në kërkim dhe zhvillimin (R&D), ose tarifatat e brendshme të karbonit ose fondet e brendshme të karbonit;
  - (b) objektin specifik të zbatimit të skemave të përcaktimit të çmimit të karbonit (aktivitetet, gjeografia, njësitet ekonomike, etj.);
  - (c) çmimet e karbonit të përdorura sipas llojit të skemës dhe supozimeve kritike të bëra në përcaktimin e çmimeve, duke përfshirë burimin e çmimeve të karbonit të përdorura dhe pse ato mendohet se janë të rëndësishme për zgjedhjen e bërë. Njësia ekonomike mund të japë informacion shpjegues për metodologjinë e llogaritjes së çmimeve të karbonit duke përfshirë madhësinë me të cilën janë përcaktuar këto çmime duke përdorur udhëzues shkencorë dhe se si zhvillimet e tyre në të ardhmen lidhen me trajektoret e çmimeve të karbonit të bazuara në shkencë; dhe
  - (d) vëllimet e emetimeve GHG bruto të përafërta të vitit aktual, sipas Perimetrit 1, 2 dhe kur është e zbatueshme sipas Perimetrit 3, të shprehura në tonë metrike ekuivalente të CO<sub>2</sub> të mbuluar nga këto skema, si dhe pjesën e tyre në **emetimet** GHG gjithsej të njësisë ekonomike për secilin Perimetër.

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-9 – Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet fizike dhe të tranzicionit materiale dhe mundësitë potenciale të lidhura me klimën*

- 64. **Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues:**
  - (a) **për efektet e saj financiare të parashikuara nga rreziqet fizike materiale;**
  - (b) **për efektet e saj financiare të parashikuara nga rreziqet materiale të tranzicionit; dhe**

---

<sup>49</sup> Ky informacion është në pajtim me Rregulloren (BE) 2021/1119 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (Ligji për Klimën BE), neni 2, pika (1).

(c) **përfitimet e saj potenciale nga mundësitë materiale të lidhura me klimën.**

65. Informacioni i kërkuar nga paragrafi 64 i shtohet informacioneve mbi **efektet financiare** aktuale të kërkuara sipas ESRS 2 SBM-3 paragrafi 48, germa (d). Objektivi i kësaj Kërkese për Dhënie informacionesh shpjeguese lidhur me:

(a) **efektet financiare të parashikuara** për shkak të **rreziqeve fizike** materiale dhe **rreziqeve materiale të tranzicionit** është që të lejojë kuptimin sesi këto rreziqe kanë (ose mund të kenë në mënyrë të arsyeshme) një ndikim material në pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset monetare të njësisë ekonomike, përgjatë një periudhe afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë. Rezultatet e **analizës së skenarit** të përdorura për të realizuar testin e qëndrueshmërisë siç kërkohet nga paragrafët AR10 deri tek AR 13 duhet të shërbejnë si vlerësim për efektet financiare të parashikuara nga rreziqet materiale fizike dhe të tranzicionit.

(b) potencialin për të ndjekur **mundësitë** materiale të lidhura me klimën, është të lejojë kuptimin sesi njësia ekonomike mund të përfitojë financiarisht nga mundësitë materiale të lidhura me klimën. Kjo dhënie informacionesh shpjeguese është plotësuese ndaj treguesve kryesorë të performancës për t'u publikuar në përputhje me Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2021/2178.

66. Dhënia e informacioneve shpjeguese për **efektet financiare të parashikuara** nga **rreziqet fizike** materiale të kërkuara nga paragrafi 64, germa (a) do të përfshijë:<sup>50</sup>

(a) shumën monetare dhe pjesën (në përqindje) të aktiveve në rrezik fizik material në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë para marrjes në konsideratë të **veprimeve për përshtatjen ndaj ndryshimit klimatik**; me shumën monetare të këtyre aktiveve të zërthyer sipas rrezikut fizik akut dhe kronik;<sup>51</sup>

(b) pjesën e aktiveve në rrezik fizik material të trajtuar nga **veprimet për përshtatjen ndaj ndryshimit klimatik**;

(c) vendndodhjen e aktiveve kryesore në rrezik fizik material;<sup>52</sup> dhe

(d) shumën monetare dhe pjesën (në përqindje) të shitjeve neto nga aktivitetet e saj të biznesit, në rrezik fizik material gjatë periudhës afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

67. Dhënia e informacioneve shpjeguese për **efektet financiare të parashikuara** nga rreziqet materiale të tranzicionit të kërkuara nga paragrafi 64, germa (b) do të përfshijë:

---

<sup>50</sup> Ky informacion është në pajtim me Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2020/1818 (Rregullorja e Standardit më të mirë për Klimën).

<sup>51</sup> Kjo kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese përfshihet në pajtim me kërkesat në Rregulloren për Zbatim të Komisionit (BE) 2022/2453 për Formatin 5: Portofoli bankar - Rreziku fizik i ndryshimit klimatik: Ekspozimet objekt i rrezikut fizik.

<sup>52</sup> Kjo kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese përfshihet në pajtim me kërkesat në Rregulloren për Zbatim të Komisionit (BE) 2022/2453 për Formatin 5: Portofoli bankar - Rreziku fizik i ndryshimit klimatik: Ekspozimet objekt i rrezikut fizik.

- (a) shumën monetare dhe pjesën (në përqindje) të aktiveve në rrezik material të tranzicionit në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë para marrjes në konsideratë të **veprimeve për zbutjen e ndryshimit klimatik**;
  - (b) pjesën e aktiveve në rrezik material të tranzicionit të trajtuar nga **veprimet për zbutjen e ndryshimit klimatik**;
  - (c) një zbërthim të vlerës së mbartur të aktiveve afatgjata materiale pasuri e patundshme e njësisë ekonomike, sipas klasave të rendimentit energjetik;<sup>53</sup>
  - (d) detyrimet që mund të jenë njohur në pasqyrat financiare gjatë periudhës afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë; dhe
  - (e) shumën monetare dhe pjesën (në përqindje) të shitjeve neto nga aktivitetet e saj të biznesit në rrezik material të tranzicionit gjatë periudhës afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, duke përfshirë, kur është e rëndësishme, shitjet neto nga klientët e njësisë ekonomike që veprojnë në aktivitete të lidhura me qymyrin, naftën dhe gazin.
68. Njësia ekonomike do të japë informacione shpjeguese krahasuese (rakordime) me nënzërat kryesorë ose shënimet në pasqyrat financiare për sa vijon:
- (a) shumat kryesore të aktiveve dhe të ardhurave neto në rrezik fizik material (siç kërkohet nga paragrafi 66);
  - (b) shumat kryesore të aktiveve, detyrimeve dhe të shitjeve neto në rrezik material të tranzicionit (siç kërkohet nga paragrafi 67).
69. Për dhënien e informacioneve shpjeguese lidhur me potencialin e ndjekjes së **mundësive** të lidhura me klimën të kërkuara nga paragrafi 64, germa (c) njësia ekonomike do të marrë në konsideratë.<sup>54</sup>
- (a) kursimet e saj të pritshme në kostot nga **veprimet për zbutjen e ndryshimit klimatik** dhe përshtatjen ndaj ndryshimit klimatik; dhe
  - (b) madhësinë potenciale të tregut ose ndryshimet e pritshme në të shitjet neto nga produktet dhe shërbimet me karbon të ulët ose zgjidhjet e përshtatura që njësia ekonomike ka ose mund të ketë në dispozicion.
70. Nuk kërkohet një përjasje sasiore e **efekteve financiare** që vijnë nga **mundësitë** nëse kjo dhënie informacionesh shpjeguese nuk plotëson karakteristikat cilësore të informacionit të dobishëm të përfshira në Shtojcën B të ESRS 1 *Karakteristikat cilësore të informacionit*.

<sup>53</sup> Kjo kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese përfshihet në pajtim me kërkesat në Rregulloren për Zbatim të Komisionit (BE) 2022/2453 për Formatin 2: Portofoli bankar - Rreziku i tranzicionit nga ndryshimi klimatik: Kredi me garanci pasuri të paluajtshme - Rendimenti energjetik i garancive.

<sup>54</sup> Ky informacion është në pajtim me Rregulloren e Deleuar të Komisionit (BE) 2020/1818 (Rregullorja e Standardit më të mirë për Klimën).

## Shtojca A. Kërkesat për Zbatim

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e ESRS E1. Ajo mbështet zbatimin e kërkesave për dhënie informacionesh shpjeguese të paraqitura në këtë standard dhe ka të njëjtin autoritet si dhe pjesët e tjera të Standardit.

### Strategjia

#### *Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-1 – Plani i tranzicionit për zbutjen e ndryshimit klimatik*

- AR 1. Një **plan tranzicioni** lidhet me përpjekjet e njësisë ekonomike për **zbutjen e ndryshimit klimatik**. Kur jep informacion shpjegues mbi planin e saj të tranzicionit, njësia ekonomike pritet të japë një shpjegim të nivelit të lartë sesi ajo do të përshtatë strategjinë e saj dhe **modelin e biznesit** për të siguruar krahasueshmërinë me tranzicionin drejt një ekonomie të qëndrueshme dhe kufizimin e ngrohjes globale në 1.5°C në pajtim me Marrëveshjen e Parisit (ose një version të përditësuar të marrëveshjes mes vendeve për ndryshimin klimatik) dhe me objektivin e arritjes së neutralitetit klimatik në 2050 pa tejkalime ose me tejkalime të kufizuara siç përcaktohet në Rregulloren (BE) 2021/1119 (Ligji Evropian për Klimën), si dhe kur është e zbatueshme, sesi do të përshtatë ekspozimin e saj ndaj aktiviteteve të lidhura me qymyrin, naftën dhe gazin.
- AR 2. Trajektoret sipas sektorit nuk janë përcaktuar ende nga **politikat** publike për të gjithë sektorët. Prandaj, dhënia e informacioneve shpjeguese sipas paragrafit 16, germa (a) në pajtueshmërinë e **planit të tranzicionit** me objektivin e kufizimit të ngrohjes globale në 1.5°C do të kuptohet si dhënie informacionesh shpjeguese mbi **objektivin e pakësimeve të emetimeve** GHG të njësisë ekonomike. Dhënia e informacioneve shpjeguese sipas paragrafit 16, germa (a) do të vlerësohet si standardi krahasues më i mirë kundrejt trajektores drejt 1.5°C. Ky standard krahasues më i mirë do të bazohet ose në trajektoren e dekarbonizimit të sektorit nëse disponohet për sektorin e njësisë ekonomike ose në një skenar ekonomik më të gjerë duke mbajtur parasysh kufizimet e tij (d.m.th., është një përkthim i thjeshtë i objektivave për **pakësimin e emetimit** nga niveli i shtetit në nivelin e njësisë ekonomike). Gjithashtu, kjo AR duhet të lexohet bashkë me AR 26 dhe AR 27, si dhe trajektoret e dekarbonizimit të sektorit që ato i referohen.
- AR 3. Kur jep informacionin shpjegues të kërkuar sipas paragrafit 16, germa (d) njësia ekonomike mund të marrë në konsideratë:
- (a) **emetimet GHG të kyçura (të bllokuara)** të akumuluar, të lidhura me aktivet kryesore për vitin e raportimit deri në 2030 dhe 2050 në ekuivalentë të CO<sub>2</sub>. Kjo do të vlerësohet si shumë e emetimeve GHG të vlerësuara të Perimetrit 1 dhe 2 përgjatë jetës së shfrytëzimit të aktiveve kryesore, të përdorur dhe të planifikuar mirë. Aktivitet kryesore janë ato që zotërohen ose kontrollohen nga njësia ekonomike dhe që përbëhen nga aktive ekzistuese

ose të planifikuara (të tilla si **impiante**, infrastrukturë dhe pajisje të lëvizshme ose të palëvizshme) që janë burime ose të emetimeve GHG të drejtpërdrejta të rëndësishme ose të emetimeve GHG tërthorta të lidhura me energjinë. Aktivet kryesore të planifikuara mirë janë ato që njësi ekonomike ka shumë gjasa që do t'i lëvizë brenda 5 viteve në vijim.

- (b) emetimet GHG të kyçura (të bllokuara), të akumuluar të lidhura me emetimet GHG të fazës së përdorimit të drejtpërdrejtë të produkteve të shitura në tonë ekuivalentë të CO<sub>2</sub> të vlerësuar si vëllimi i shitjeve të produkteve në vitin e raportimit të shumëzuar me shumën e vlerësuar të emetimeve GHG të fazës së përdorimit të drejtpërdrejtë gjatë jetës së tyre të pritshme. Kjo kërkesë zbatohet vetëm nëse njësi ekonomike ka identifikuar **kategorinë e Perimetrit 3** “përdorimi i produkteve të shitura” si të rëndësishme sipas paragrafit 51 të Kërkesës për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-6; dhe
- (c) një shpjegim të planeve për të menaxhuar, d.m.th., për të transformuar, nxjerrë jashtëpërdorimit ose eliminimit gradual të aktiveve dhe produkteve me intensitet të GHG dhe të energjisë.

AR 4. Kur jep informacionin shpjegues të kërkuar sipas paragrafit 16, germa (e), njësi ekonomike do të shpjegojë sesi pajtueshmëria e aktiviteteve të saj me kërkesat e Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2021/2139 pritet të evoluojë në kohë për të mbështetur tranzicionin drejt një ekonomie të qëndrueshme. Kur bën këtë, njësi ekonomike do të marrë në konsideratë treguesit kryesorë të performancës të kërkuar për t'u publikuar sipas nenit 8 të Rregullores (BE) 2020/852 (veçanërisht shifrat e të ardhurave, CapEx dhe nëse është e zbatueshme planet CapEx, të lidhura me taksonominë).

AR 5. ► **C1** Kur jep informacionin shpjegues të kërkuar sipas paragrafit 16, germa (g), njësi ekonomike do të deklarojë nëse është e përjashtuar nga kërkesat e standardit krahasues më të mirë të Marrëveshjes së Parisit të BE në pajtim me kriteret e përjashtimit të paraqitura në nenin 12, pika 1, germat (d) deri në (g)<sup>55</sup> dhe në nenin 12, pika 2 të Rregullores së Deleguar të Komisionit 2020/1818 (Rregullorja e Standardeve Krahasuese më të mira për Klimën).<sup>56</sup> ◀

---

<sup>55</sup> ► **C1** Neni 12.1 i Rregullores së Standardeve Krahasuese më të mira për Klimën përcakton se “Administratorët e Standardeve krahasuese më të mira të Marrëveshjes së Parisit të BE do të përjashtojnë shoqëritë në vijim:

a) shoqëritë që nxjerrin 1% ose më shumë të të ardhurave të tyre nga kërkimi, miniera, nxjerrja, shpërndarja ose përpunimi i qymyrit dhe linjtit; ose

b) shoqëritë që nxjerrin 10% ose më shumë të të ardhurave të tyre nga kërkimi, nxjerrja, shpërndarja ose rafinimi i karburanteve të naftës; ose

c) shoqëritë që nxjerrin 50% ose më shumë të të ardhurave të tyre nga kërkimi, nxjerrja, prodhimi ose shpërndarja e lëndëve djegëse të gazta; ose

d) shoqëritë që nxjerrin 50% ose më shumë të të ardhurave të tyre nga prodhimi i energjisë elektrike me një intensitet GHG më shumë se 100 g CO<sub>2</sub> e/kWh.”

Neni 12.2 përcakton se “Administratorët e Standardeve krahasuese më të mira të Marrëveshjes së Parisit të BE do të përjashtojnë nga këto standarde çdo shoqëri që gjendet ose vlerësohet nga ata ose nga ofruesit e jashtëm të të dhënave se dëmtojnë ndjeshëm një ose më shumë nga objektivat mjedisore të përmendur në nenin 9 të Rregullores (BE) 2020/852 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në përputhje me rregullat për vlerësimet të paraqitura në nenin 13, pika 2 të kësaj Rregulloreje.” ◀

<sup>56</sup> ► **C1** Kjo kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese është në pajtim me kërkesat në Rregulloren për Zbatim të Komisionit (BE) 2022/2453 për formatin I të rrezikut të tranzicionit në ndryshimin klimatik. ◀

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese e lidhur me standardin ESRS 2 SBM-3 –  
Ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe  
modelin e biznesit*

- AR 6. Kur jep informacion shpjegues mbi objektin e analizës së qëndrueshmërisë siç kërkohet nga paragrafi 19, germa (a), njësia ekonomike do të shpjegojë se cila pjesë e veprimtarisë së vet dhe e rrjedhës së sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të vlerës** të saj, si dhe cilat **rreziqe fizike** dhe **rreziqe të tranzicionit** materiale mund të jenë përjashtuar nga analiza.
- AR 7. Kur jep informacion shpjegues sesi është realizuar analiza e qëndrueshmërisë siç kërkohet nga paragrafi 19, germa (b), njësia ekonomike do të shpjegojë:
- (a) supozimet kryesore sesi tranzicioni drejt një ekonomie me karbon të ulët dhe të qëndrueshme do të ndikojë ecurinë makroekonomike përreth, konsumin e energjisë dhe miksin e energjetik, si dhe supozimet e vendosjes (shpërndarjes) së teknologjisë;
  - (b) hapësirat kohore të përdorura dhe lidhjen e tyre me **skenarët** e klimës dhe të biznesit të marra në konsideratë për përcaktimin e **rreziqeve fizike** dhe **të tranzicionit** materiale (paragrafët AR 11 deri tek AR 12) dhe vendosjen e **objektivave për pakësimin e emetimeve GHG** (të raportuar sipas Kërkesës për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-4); dhe
  - (c) sesi janë marrë në konsideratë **efektet financiare të parashikuara** të vlerësuara nga **rreziqet fizike** dhe **të tranzicionit** materiale (siç kërkohet nga Kërkesa për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-9) si dhe nga **veprimet** dhe burimet e zbutjes (të paraqitura sipas Kërkesës për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-3).
- AR 8. Kur jep informacion shpjegues sesi është realizuar analiza e qëndrueshmërisë siç kërkohet nga paragrafi 19, germa (c), njësia ekonomike do të shpjegojë:
- (a) zonat e pasigurisë të analizës së qëndrueshmërisë dhe deri në çfarë mase janë marrë në konsideratë aktivitetet dhe aktivitetet e biznesit të rrezikuara brenda përkufizimit të strategjisë, vendimeve për investime dhe **veprimeve** për zbutjen, aktuale dhe të planifikuara të njësisë ekonomike;
  - (b) aftësinë e njësisë ekonomike për të rregulluar ose përshtatur strategjinë dhe **modelin e biznesit** të saj për ndryshimin klimatik në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, duke përfshirë sigurimin e vijueshëm të mundësisë së financimit me një kosto kapitali të përballueshme, aftësinë për të rishpërndarë (rivendosur), përditësimin ose nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve ekzistues, duke transferuar portofolin e produkteve dhe shërbimeve të saj, ose duke ritrajnuar fuqinë punëtore.

## Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë

*Kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese e lidhur me standardin ESRS 2 IRO-1 – Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me klimën*

- AR 9. Kur jep informacion shpjegues sesi është realizuar analiza e qëndrueshmërisë siç kërkohet nga paragrafi 20, germa (a), njësia ekonomike do të shpjegojë se si ka:
- (a) analizuar aktivitetet dhe planet e saj për të identifikuar burimet aktuale dhe potenciale të emetimeve GHG të ardhshme dhe, nëse është e zbatueshme, faktorët për ndikimet e tjera të lidhura me klimën (p.sh., **emetimet** e blözës ose të ozonit të troposferës ose **ndryshimi i përdorimit të terrenit**) në veprimtarinë e vet dhe përgjatë zinxhirit të vlerës; dhe
  - (b) vlerësuar ndikimet e saj aktuale dhe potenciale në ndryshimin klimatik (d.m.th., emetimet GHG totale të saj).
- AR 10. Njësia ekonomike mund të lidhë informacionin e paraqitur sipas paragrafit 20, germa (a) dhe AR 9 me informacionin e paraqitur sipas Kërkesave për Dhënie informacionesh shpjeguese në vijim: paragrafi 16, germa (d) për emetimet GHG të kyçura (të bllokuara) i Kërkesës për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-1; Kërkesa për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-4 dhe Kërkesa për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-6.
- AR 11. Kur jep informacion shpjegues mbi proceset për të identifikuar dhe vlerësuar **rreziqet fizike** siç kërkohet nga paragrafi 20, germa (b), njësia ekonomike do të shpjegojë nëse dhe si:
- (a) ka identifikuar rreziqet e lidhura me klimën (shih tabelën më poshtë) në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë dhe analizuar nëse aktivitetet dhe biznesit të saj mund të jenë ekspozuar ndaj këtyre rreziqeve;
  - (b) ka përkufizuar hapësirën kohore afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë dhe se si këto përkufizime lidhen me jetën e pritshme të aktiveve të saj, horizontet e planifikimit strategjik dhe planet e shpërndarjes së kapitalit;
  - (c) ka vlerësuar se sa aktivitetet dhe biznesit të saj mund të jenë të ekspozuara dhe të ndjeshme ndaj rreziqeve të identifikuara të lidhura me klimën, duke marrë në konsideratë mundësinë, madhësinë dhe kohëzgjatjen e rreziqeve si dhe koordinatat gjeohapësinore (të tilla si Nomenklatura e Njësive Territoriale të Statistikës - NUTS per zonën BE) specifike të zonave dhe **zinxhirave furnizues** të njësive ekonomike; dhe
  - (d) identifikimi i rreziqeve të lidhura me klimën dhe vlerësimi i ekspozimit dhe ndjeshmërisë, është bazuar në **skenarët** e klimës për **emetimet** e larta, që mund, për shembull të bazohen në IPCC SSP5-8.5, në parashikime rajonale të rëndësishme të klimës të bazuar në këto skenarë emetimi ose skenarët klimatik NGFS (Rrjeti për Sistemin Financiar të Gjelbër) me rrezik fizik të lartë të tillë si “Bota shtëpi e nxehtë” ose “Shumë pak, shumë vonë”. Për

kërkesat e përgjithshme lidhur me **analizën e skenarit** të lidhur me klimën shih paragrafët 18, 19, AR 13 deri tek AR 15.

<b>Klasifikimi i rrezeve të lidhura me klimën</b> (Burimi: Rregullorja e deleguar e Komisionit (BE) 2021/2139)				
	<b>Të lidhur me temperaturën</b>	<b>Të lidhur me erën</b>	<b>Të lidhur me ujin</b>	<b>Të lidhur me masën e ngurtë</b>
Kronik	Ndryshimi i temperaturës (ajër, ujë i ëmbël, ujë deti)	Ndryshimi i karakteristikave të erës	Ndryshimi i karakteristikave të precipitimit dhe tipet (shi, breshër, borë/akull)	Erozioni i bregdetit
	Stresi nga të nxehtit		Ndryshimi i precipitimit ose hidrologjik	Degradimi i terrenit
	Ndryshueshmëria e temperaturës		Acidifikimi i oqeanit	Erozioni i terrenit
	Shkrirja e akujve (permafrostit)		Infiltrimi i ujit të detit	Solifluksi
			Rritja e nivelit të detit	
			Stresi nga uji	
Akut	Goditje të nxehti	Ciklone, uragane, tajfune	Thatësirë	Ortek
	Goditje (valë) të ftohti / ngricë	Stuhi (përfshirë stuhi dëbore, pluhuri dhe rëre)	Precipitime të forta (shiu, breshëri, bore/akulli)	Rrëshqitje toke
	Zjarr	Tornado	Përmbytje (të brigjeve, të lumenjve, nga shiu, nga ujëra nëntokësorë)	Fundosje
			Shpërthim (shkrirje, përmbytje) i liqenit akullnajor	

AR 12. Kur jep informacion shpjegues mbi proceset për të identifikuar dhe vlerësuar **rreziqet fizike** dhe **mundësitë** siç kërkohet nga paragrafi 20, germa (c), njësia ekonomike do të shpjegojë nëse dhe si ka:

- (a) identifikuar ngjarjet e tranzicionit (shih tabelën më poshtë) në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë dhe analizuar nëse aktivet dhe aktivitetet e biznesit të saj mund të jenë ekspozuar ndaj këtyre ngjarjeve. Në rastin e mundësive dhe rreziqeve të tranzicionit, ajo çfarë konsiderohet afatgjatë mund të shkojë përtej 10 viteve dhe mund të lidhet me objektivat **e politikës** publike të lidhura me klimën;
- (b) vlerësuar se sa aktivet dhe aktivitetet e biznesit të saj mund të jenë të ekspozuar dhe të ndjeshëm ndaj ngjarjeve të identifikuara të tranzicionit duke marrë në konsideratë mundësinë, madhësinë dhe kohëzgjatjen e ngjarjeve të tranzicionit;
- (c) bazuar identifikimin e ngjarjeve të tranzicionit dhe vlerësimin e ekspozimit ndaj **analizës së skenarit** të lidhur me klimën, duke marrë në konsideratë të paktën një skenar koherent me Marrëveshjen e Parisit dhe kufizimin e ndryshimit klimatik në 1.5°C, për shembull bazuar në skenarët e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë ( Emetimet zero neto deri në 2050, Skenari i Zhvillimit të Qëndrueshëm, etj) ose skenarët klimatikë NGFS (Rrjeti për Sistemin Financiar të Gjelbër). Për kërkesat e përgjithshme lidhur me analizën e skenarit të lidhur me klimën shih paragrafët 18, 19, AR 13 deri tek AR 15; dhe
- (d) identifikuar aktivet dhe aktivitetet e biznesit të saj që janë të papajtueshme me ose kanë nevojë për përpjekje të rëndësishme për të qenë në pajtim me tranzicionin drejt një ekonomike neutrale ndaj klimës (për shembull, për shkak të **emetimeve GHG të kyçura (të bllokuara)** ose të mospërputhjes me kërkesat për lidhjen e Taksonomisë sipas Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2021/2139).

Shembuj të ngjarjeve të tranzicionit të lidhura me klimën (shembuj të bazuar në klasifikimin e TCFD)			
Politika dhe ligji	Teknologjia	Tregu	Prestigji
Çmimi në rritje i emetimeve GHG	Zëvendësimi i produkteve dhe shërbimeve ekzistuese me mundësi me emetime më të ulëta	Ndryshimi i sjelljes së klientëve	Zhvendosja e preferencave të konsumatorëve
Detyrime shtesë për raportimin e emetimeve	Investime të pasuksesshme në teknologjitë e reja	Pasiguri në sinjalet e tregut	Stigmatizimi i sektorit
Urdhëresa dhe rregullime për produkte dhe shërbimet ekzistuese	Kostot e tranzicionit drejt teknologjisë me emetime më të ulëta	Kosto shtesë të lëndëve të para	Shqetësim në rritje i palës së interesuar

Shembuj të ngjarjeve të tranzicionit të lidhura me klimën (shembuj të bazuar në klasifikimin e TCFD)			
Politika dhe ligji	Teknologjia	Tregu	Prestigji
Urdhëresa dhe rregullime për proceset e prodhimit ekzistuese			Komente (reagime) negative nga pala e interesuar
Ekspozimi ndaj konfliktit			

## Analiza e skenarit e lidhur me klimën

AR 13. Kur paraqet informacionin e kërkuar sipas paragrafëve 19, 20, 21, AR 10 dhe AR 11 njësi ekonomike do të shpjegojë sesi i ka përdorur **analizat e skenarit** të lidhura me klimën që përkon me rrethanat e saj për të bazuar identifikimin dhe vlerësimin e **rreziqeve fizike** dhe **rreziqeve të tranzicionit**, si dhe të **mundësive** në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë duke përfshirë:

- se cilët **skenarë** janë përdorur, burimet e tyre dhe lidhjet e tyre me zhvillimet më të mira në shkencë;
- përshkrime, horizonte kohore dhe parametra të përdorur me një diskutim se pse mendohet se gama e skenarëve të përdorur mbulon rreziqet dhe pasiguritë e besueshme;
- forcat dhe faktorët kryesorë të marrë në konsideratë në secilin skenar dhe pse ato janë të rëndësishme për njësinë ekonomike, për shembull, supozimet mbi **politikën**, ecurinë makroekonomike, përdorimin e energjisë dhe miks të energjetik, si dhe supozimet për teknologjinë; dhe
- të dhënat kryesore dhe kufizimet e skenarëve, duke përfshirë nivelin e tyre të hollësive (p.sh., nëse analiza e rreziqeve të lidhura me klimën bazohet në koordinata specifike gjeohapësinore për vendndodhjen e njësisë ekonomike ose të dhëna në nivel të përgjithshëm kombëtar apo rajonal).

AR 14. Kur realizon **analizën e skenarit**, njësi ekonomike mund të marrë në konsideratë udhëzuesit në vijim: TCFD Plotësuesi Teknik për “Përdorimin e Analizës së Skenarit në Dhënie dhe informacioneve shpjeguese mbi Rreziqet dhe Mundësitë e Lidhura me Klimën” (2017); TCFD “Udhëzues për Analizën e Skenarit në Shoqëritë të sektorit jo-Financiar” (2020); ISO 14091:2021 “Përshtatja ndaj ndryshimit klimatik - Udhëzues mbi dobësitë, ndikimet dhe vlerësimin e rreziqeve”; çdo standard tjetër të njohur të industrisë të tillë si NGFS (Rrjeti për Sistemin Financiar të Gjellbër); si dhe rregullimet e BE, kombëtare, rajonale dhe lokale.

AR 15. Njësi ekonomike do të shpjegojë shkurt sesi **skenarët** klimatikë të përdorur janë të pajtueshëm me supozimet kryesore të lidhura me klimën të bëra në pasqyrat financiare.

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-2 – Politikat e lidhura me zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimit klimatik*

- AR 16. **Politikat** që lidhen ose me **zbutjen e ndryshimit klimatik** ose me **përshtatjen klimatike** mund të jepen si informacion shpjegues veçmas pasi janë të ndryshme objektivat e tyre, njerëzit e përfshirë, **veprimet** dhe burimet e nevojshme për zbatimin e tyre.
- AR 17. **Politikat** e lidhura me **zbutjen e ndryshimit klimatik** trajtojnë menaxhimin e **emetimeve GHG**, heqjet GHG dhe **rreziqet e tranzicionit** të njësisë ekonomike përgjatë horizonteve kohore të ndryshme, në veprimtarinë e vet dhe/ose në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të vlerës**. ► **C1** Kërkesa në paragrafin 22 mund të lidhet me politika të veçanta për zbutjen e ndryshimit klimatik ashtu si dhe për politikat përkatëse në çështje të tjera që mbështesin tërthorazi zbutjen e ndryshimit klimatik duke përfshirë politikat për **trajnimin**, politikat e prokurimit ose të **zinxhirit furnizues**, politikat e investimit ose politikat e zhvillimit të produktit. ◀
- AR 18. **Politikat** e lidhura me **përshtatjen ndaj ndryshimit klimatik** trajtojnë menaxhimin e rreziqeve fizike të lidhura me klimën të njësisë ekonomike dhe **rreziqet e tranzicionit** të saj të lidhura me përshtatjen ndaj ndryshimit klimatik. Kërkesa në paragrafin 22 dhe 25 mund të lidhen me politika të veçanta për përshtatjen ndaj ndryshimit klimatik ashtu si dhe për politikat përkatëse në çështje të tjera që mbështesin tërthorazi përshtatjen ndaj ndryshimit klimatik duke përfshirë politikat për **trajnimin**, politikat për çështje urgjente, të shëndetit dhe të sigurisë.

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-3 – Veprimet dhe burimet e lidhura me politikat për ndryshimin klimatik*

- AR 19. Kur jep informacion shpjegues mbi **veprimet** sipas kërkesave në paragrafët 29, germa (a) dhe 29, germa (b), njësia ekonomike mund:
- (a) të paraqesë veprimet kryesore të saj dhe/ose planet për të vënë në zbatim **zbutjen e ndryshimit klimatik** dhe **politikat e përshtatjes** në veprimet e saj unike ose të veçanta;
  - (b) të grupojë llojet e veprimeve zbutëse (levat e dekarbonizimit) të tilla si rendimenti energjetik, elektrifikimin, zëvendësimi i karburanteve, përdorimi i **energjisë së rinovueshme**, ndryshimi i produkteve, dhe dekarbonizimi i zinxhirit furnizues që plotëson veprime specifike të njësisë ekonomike;
  - (c) të paraqesë listën e veprimeve kryesore zbutëse së bashku me **objektivat** e matshëm (siç kërkohet nga Kërkesa për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-4) të zbërthyer sipas levave të dekarbonizimit; dhe
  - (d) të paraqesë veprimet për **përshtatjen ndaj ndryshimit klimatik** sipas llojeve të zgjidhjes së përshtatur të tillë si përshtatje e bazuar në natyrë, përshtatje e bazuar në inxhinieri ose zgjidhje teknologjike.

- AR 20. Kur jep informacion shpjegues mbi burimet siç kërkohet në paragrafin 29, germa (c), njësia ekonomike do të paraqesë vetëm shumat kryesore të OpEx dhe CapEx të kërkuara për vënien në zbatim të **veprimeve**, pasi qëllimi i këtij informacioni është që të tregojë besueshmërinë e veprimeve të saj sesa të rakordojë shumat e paraqitura në pasqyrat financiare. Shumat e publikuara të CapEx dh OpEx do të jenë shtesa të bëra si në aktivet materiale dhe jomateriale gjatë vitit financiar aktual si dhe shtesat e planifikuara për periudhat e ardhshme të vënies në zbatim të veprimeve. Shumat e publikuara do të jenë vetëm investimet financiare rritëse që kontribuojnë drejtpërdrejt në arritjen e **objektivave** të njësisë ekonomike.
- AR 21. Në pajtim me kërkesat e ESRS 2 MDR-A, njësia ekonomike do të shpjegojë nëse dhe deri sa aftësia e saj për të vënë në zbatim **veprimet** varet nga disponimi dhe shpërndarja e burimeve. Mundësia e financimit të vazhdueshëm me një kosto kapitali të përballueshme mund të jetë kritike për vënien në zbatim të veprimeve të njësisë ekonomike, që përfshin përshtatjet e saj ndaj ndryshimeve në ofertë/kërkesë ose blerjet e saj përkatëse dhe investimet e rëndësishme në kërkim-zhvillim (R&D).
- AR 22. Shumat e OpEx and CapEx të kërkuara për vënien në zbatim të **veprimeve** të publikuara sipas paragrafit 29, germa (c) do të jenë në pajtim me treguesit kryesorë të performancës (treguesit kryesorë të performancës CapEx dhe OpEx) dhe, nëse është e zbatueshme, planin CapEx të kërkuar sipas Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2021/2178. Njësia ekonomike do të shpjegojë çdo diferencë të mundshme mes shumave kryesore OpEx dhe CapEx të publikuara sipas këtij Standardi dhe treguesve kryesorë të performancës të publikuar sipas Rregullores të Deleguar të Komisionit (BE) 2021/2178 të shkaktuar, për shembull nga aktivitetet ekonomike jo në pajtim me përkufizimin në atë rregullore të deleguar. Njësia ekonomike mund të strukturojë veprimet e saj sipas aktivitetit ekonomik për të krahasuar OpEx dhe CapEx e saj dhe nëse është e zbatueshme planet e saj OpEx dhe/ose Cap/Ex me Taksonominë e saj të lidhur me treguesit kryesorë të performancës.

## Metrikat dhe objektivat

### *Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-4 – Objektivat e lidhura me zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimit klimatik*

- AR 23. Sipas paragrafit 34, germa (a), njësia ekonomike mund të japë informacion shpjegues për objektivat mbi **pakësimin e emetimeve GHG** në vlera intensiteti. Objektivat e intensitetit formulohen si raport i **emetimeve GHG** ndaj një njësie të aktivitetit fizik ose të një rezultati ekonomik. Njësitë e aktivitetit ose të rezultatit përkatëse i referohen standardeve ESRS specifike sipas sektorëve. Në rastet kur njësia ekonomike ka vendosur vetëm një objektiv pakësimi të intensitetit GHG, ajo do të japë informacion shpjegues edhe për shumat absolute të lidhura me vitin e synuar dhe vitin(et) e ndërmjetëm të synuar. Kjo mund të sjellë një situatë ku njësia ekonomike t'i duhet të japë informacion shpjegues mbi një rritje të emetimeve GHG

absolute për vitin e synuar dhe vitin(et) e ndërmjetëm të synuar, për shembull, sepse ajo paraprin rritjen organike të biznesit të saj.

AR 24. Kur jep informacionin shpjegues të kërkuar sipas paragrafit 34, germa (b), njësia ekonomike do të specifikojë pjesën e objektivit të lidhur me secilin prej **emetimeve GHG të Perimetrit 1, 2 ose 3**. Njësia ekonomike do të deklarojë metodën e përdorur për llogaritjen e **emetimeve** GHG të Perimetrit 2 të përfshira në objektiv (d.m.th., ose metodën e bazuar në vendndodhje ose metodën e bazuar në treg). Nëse kufiri i **objektivit për pakësimin e emetimit** GHG ndryshon nga emetimet GHG të raportuara sipas Kërkesës për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-6, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues se cilat gazra përfshihen, përqindjen përkatëse të emetimeve GHG të Perimetrit 1, 2, 3 dhe të emetimeve GHG totale të mbuluara nga objektivi. Për **objektivat** e pakësimit të emetimeve GHG për filialet e saj, njësia ekonomike do të zbatojë në mënyrë analoge këto kërkesa në nivel filiali.

AR 25. Kur jep informacionin shpjegues të kërkuar nga paragrafi 34, germa (c) mbi vitin bazë dhe vlerën referencë:

- (a) njësia ekonomike do të shpjegojë shkurt sesi është siguruar që vlera e referimit, ndaj së cilës matet ecuria drejt objektivit, është përfaqësuese në terma të aktiviteteve të mbuluara dhe ndikimeve të faktorëve të jashtëm (p.sh., anomalitë e temperaturës në një vit të caktuar që ndikojnë shumën e energjisë së konsumuar dhe emetimet GHG përkatëse). Kjo mund të bëhet duke normalizuar vlerën e referimit ose duke përdorur një vlerë referimi që nxirret nga një mesatare 3-vjeçare nëse kjo rrit përfaqësimin dhe lejon për një paraqitje më të besueshme;
- (b) vlera e referimit dhe viti bazë nuk do të ndryshohen përveçse kur ndodhin ndryshime të rëndësishme në objektiv ose në kufirin e raportimit. Në një rast të tillë, njësia ekonomike do të shpjegojë sesi vlera e re e referimit ndikon objektivin e ri, arritjen e tij dhe paraqitjen e ecurisë në kohë. Për të rritur krahasueshmërinë, kur vendosen **objektiva** të rinj, njësia ekonomike do të zgjedhë një vit të ri bazë që nuk paraprin vitin e parë të raportimit të periudhës së re objektiv me më shumë se 3 vite. Për shembull, nëse 2030 është viti objektiv dhe periudha objektiv është mes 2025 dhe 2030, viti bazë do të zgjidhet nga periudha mes 2022 dhe 2025;
- (c) njësia ekonomike do të përditësojë vitin e saj bazë nga 2030 dhe më pas çdo 5 vite. Kjo do të thotë se para 2030, vitet bazë të zgjedhura nga njësia ekonomike mund të jenë ose viti bazë aktual i zbatuar për objektivat ekzistues ose viti i parë i zbatimit të kërkesave për raportimin e qëndrueshëm të paraqitur në nenin 5, pika (2) të Direktivës (BE) 2022/2464 (2024, 2025 ose 2026) dhe, pas 2030, çdo 5 vite (2030, 2035, etj.); dhe
- (d) kur paraqet objektivat e lidhura me klimën, njësia ekonomike mund të japë informacion shpjegues për realizimin e këtyre objektivave të vendosur para vitit të saj bazë aktual. Kur bën këtë njësia ekonomike do të sigurojë, për sa është e mundur, që informacioni mbi ecurinë e shkuar është koherent me kërkesat e këtij Standardi. Në rast të diferencave në

metodologji, për shembull, lidhur me kufijtë e objektivit, njësia ekonomike do të sigurojë një shpjegim të shkurtër për këto diferenca.

AR 26. Kur jep informacionin shpjegues të kërkuar në paragrafët 34, germa (d) dhe 34, germa (e), njësia ekonomike do të paraqesë informacionin gjatë periudhës objektiv duke iu referuar një sektori specifik, nëse disponohet, ose një trajektoreje të përgjithshme të emetimit të pajtueshme me kufizimin e ngrohjes globale në 1.5°C. Për këtë qëllim, njësia ekonomike do të llogarisë një vlerë referimi objektiv në linjë me 1.5°C për Perimetrin 1 dhe 2 (dhe, nëse është e zbatueshme, një veçmas për Perimetrin 3) ndaj të cilëve mund të krahasohen **objektivat e pakësimit të emetimeve** GHG ose objektivat e ndërmjetëm në Perimetrat përkatës.

AR 27. Vlera objektiv e referimit mund të llogaritet duke shumëzuar **emetimet** GHG në vitin bazë me një faktor **pakësimi të emetimit** ose të sektorit specifik (metodologjia e dekarbonizimit sipas sektorëve) ose ndërmjet sektorëve (metodologjia e kontraktimit). Këta faktorë të pakësimit të emetimit mund të nxirren nga burime të ndryshme. Njësia ekonomike duhet të sigurojë që burimi i përdorur të bazohet në një trajektore pakësimi të emetimit të pajtueshme me kufizimin global të ngrohjes në 1.5°C.

AR 28. Faktorët e **pakësimit të emetimit** janë objekt i zhvillimit të mëtejshëm. Prandaj, njësitë ekonomike nxiten të përdorin vetëm informacionin publik të përditësuar në dispozicion.


	2030	2050
Trajektorja e pakësimit ndërsektorial (ACA) e bazuar në vitin 2020 si viti referencë	-42%	-90%
Burimi: bazuar në dokumentin Trajektorja drejt Zeros-neto –SBTi Përmbledhje Teknike (Versioni 1.0, tetor 2021)		

AR 29. Vlera objektiv e referimit varet nga viti bazë dhe **emetimet** referencë të objektivit për **pakësimin e emetimeve** GHG të njësisë ekonomike. Si pasojë, vlera objektiv e referimit për njësitë ekonomike me një vit bazë të fundit ose nga emetime referencë më të larta mund të jetë më pak sfiduese për t'u arritur se sa do të ishte për njësitë ekonomike që kanë ndërmarrë tashmë **veprime** ambicioze në të shkuarën për të pakësuar emetimet GHG. Prandaj, njësitë ekonomike që kanë arritur në të shkuarën pakësim të emetimeve GHG të pajtueshme me një trajektore ndërsektoriale ose trajektore specifike për sektorin në linjë me 1.5°C, mund të rregullojnë emetimet e tyre referencë në përputhje për të përcaktuar vlerën objektiv të referencës. Për pasojë, nëse njësia ekonomike rregullon emetimet referencë për të përcaktuar vlerën objektiv të referimit, nuk do të marrë në konsideratë pakësimin e emetimeve GHG që paraprijnë vitin 2020 dhe do të sigurojë evidencën e duhur të pakësimit të emetimit GHG të saj të arritur në të shkuarën.

AR 30. Kur jep informacionin shpjegues të kërkuar sipas paragrafit 34, germa (f) njësia ekonomike do të shpjegojë:

- (a) me referencë ndaj **veprimeve** të saj për **zbutjen e ndryshimit klimatik, levat e dekarbonizimit** dhe kontributet e tyre sasiore të vlerësuara në arritjen e **objektivave të pakësimit të emetimeve** GHG të zbërthyer sipas secilit Perimetër (1,2, dhe3);
- (b) nëse planifikon të përdorë teknologji të reja dhe rolin e tyre në arritjen e objektivave për pakësimin e emetimeve GHG; dhe
- (c) nëse dhe si ka marrë në konsideratë **skenarët** e ndryshëm klimatikë, që përfshijnë të paktën një skenar klimatik në koherencë me kufizimin global të ngrohjes në 1.5°C, për të zbuluar zhvillimet e rëndësishme të lidhura me mjedisin, shoqërinë, teknologjinë, tregun dhe **politikat**, si dhe për të përcaktuar levat e saj të dekarbonizimit.

AR 31. Njësia ekonomike mund të paraqesë **objektivat për pakësimin e emetimeve** GHG të saj së bashku me **veprimet për zbutjen e ndryshimit klimatik** të saj (shih paragrafin AR 19) si një tabelë ose trajektore gjeografike që tregon zhvillimet në kohë. Figura dhe tabela në vijim japin shembuj të kombinimit të objektivave dhe levave të dekarbonizimit:



	Viti bazë (p.sh., 2025)	Objektivi 2030	Objektivi 2035	...	Objektivi deri në 2050
Emetimet GHG (kt ekuivalent CO2)	100	60	40		
Rendimenti energjetik dhe pakësimi i konsumit	-	-10	-4		
Rendimenti material dhe pakësimi i konsumit	-	-5	-		
Zëvendësimi i karburantit	-	-2	-		
Elektrifikimi	-	-	-10		
Përdorimi i energjisë së rinovueshme	-	-10	-3		
Heqja graduale, zëvendësimi ose ndryshimi i produktit	-	-	-		
Heqja graduale, zëvendësimi ose ndryshimi i procesit	-	-5	-3		
Të tjera	-	-			

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-5 – Konsumi i energjisë dhe miksi i energjisë*

**Udhëzues lidhur me llogaritjen**

AR 32. Kur përgatit informacionin mbi konsumin e energjisë të kërkuar sipas paragrafit 35, njësia ekonomike do të:

- raportoje vetëm energjinë e konsumuar nga proceset e zotëruara ose të kontrolluara nga njësia ekonomike duke zbatuar të njëjtin perimetër të përdorur për raportimin e emetimeve GHG të Perimetrit 1 dhe 2;
- përfshijë lëndët e para dhe karburantet që nuk përdoren për qëllime energjetike. Njësia ekonomike që konsumon karburant si lëndë të parë mund të japë informacion shpjegues mbi këtë konsum veçmas nga informacioni i kërkuar;
- sigurojë të gjithë informacionin sasior të lidhur me energjinë që raportohet në Mega-Watt për orë (MWh) në Vlerë Nxehtësie më të Ulët ose në vlerë neto kalorje. Nëse informacioni me të dhëna bruto lidhur me energjinë është në dispozicion vetëm në njësi energjie të ndryshme nga MWh (të tillë si Giga-Joules (GJ) ose Njësi Britanike Termike (Btu)), në njësi vëllimi (të tillë si këmbë në kub ose në galonë), ato do të konvertohen në MWh duke përdorur faktorë të përshtatshëm konvertimi (shih për shembull Aneksin II të raportit IPCC

Vlerësimi i Pestë). Faktorët e konvertimit për karburantet do të paraqiten në mënyrë transparente dhe do të zbatohen në mënyrë koherente;

- (d) sigurojë që i gjithë informacioni sasior i lidhur me energjinë raportohet si konsum energjetik final, duke iu referuar shumës së energjisë që njësia ekonomike aktualisht konsumon duke përdorur për shembull tabelën në Aneksin IV të Direktivës 2012/27 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit<sup>57</sup> mbi rendimentin energjetik;
- (e) shmangë dublimin e kontabilizimit të konsumit të karburantit kur jep informacion shpjegues mbi konsumin e energjisë të gjeneruar vetë. Nëse njësia ekonomike prodhon energji elektrike nga një burim karburanti jo-i rinovueshëm ose i rinovueshëm dhe më pas e konsumon atë energji, konsumi i energjisë do të llogaritet vetëm sipas konsumit të karburantit;
- (f) kujdeset të mos kompensojë konsumin edhe nëse në **vendin** e prodhimit, energjia i shitet dhe përdoret nga një palë e tretë;
- (g) të mos llogarisë energjinë si energji “të blerë ose të përfituar”, energjinë që sigurohet nga burime brenda kufijve organizativë;
- (h) të trajtojë nxehtësinë ose ftohjen e marrë nga një palë e tretë si "energji e humbur" nga proceset industriale, nën zërin "energji e blerë ose e përvetësuar";
- (i) të trajtojë hidrogjenin e rinovueshëm<sup>58</sup> si karburant të rinovueshëm. Hidrogjeni që nuk nxirret plotësisht nga burime të rinovueshme do të përfshihet në “karburant për konsum nga burime të tjera jo të rinovueshme”; dhe
- (j) të adoptojë një qasje të kujdeshme kur ndan energjinë elektrike, avullin, ngrohjen ose ftohjen mes burimeve të rinovueshme dhe jo të rinovueshme bazuar në qasjen e zbatuar për të llogaritur emetimet GHG të Perimetrit 2 të bazuara në treg. Njësia ekonomike do të marrë në konsideratë vetëm ato konsume të energjisë që vijnë nga burime të rinovueshme nëse origjina e energjisë së blerë përkufizohet qartë në marrëveshjet kontraktuale me **furnitorët** e saj (marrëveshjet e blerjes së energjisë së rinovueshme, tarifat e standardizuara të energjisë së gjelbër, instrumentet e tregut si Garancitë e Origjinës nga burime të rinovueshme në Evropë<sup>59</sup> ose instrumente të ngjashëm si Certifikatat e Energjisë së Rinovueshme në SHBA dhe Kanada, etj.).

AR 33. ► **C1** Informacioni i kërkuar sipas paragrafit 38 zbatohet nëse njësia ekonomike zhvillon veprimtarinë në të paktën një **sektor me ndikim të madh klimatik**. ◀ Informacioni i kërkuar

<sup>57</sup> Direktiva 2012/27/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 25 tetorit 2012 mbi rendimentin energjetik, që ndryshoi Direktivat 2009/125/KE dhe 2010/30/BE dhe shfuqizoi Direktivat 2005/8/KE dhe 2006/32/KE (GZ L 315, 14.11.2008, f. 1).

<sup>58</sup> Në përputhje me kërkesat në vendimet e deleguara për hidrogjenin nga burimet e rinovueshme të Rregullores së Deleguar të Komisionit të 10 shkurtit 2023 që plotëson Direktivën (BE) 2018/2001 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit duke vendosur një metodologji të BE që përcakton rregulla të hollësishme mbi prodhimin e karburanteve të rinovueshme të lëngshëm dhe gaz, për sektorin e transportit, me origjinë jo biologjike; si dhe Rregulloren e Deleguar të Komisionit të 10 shkurtit 2023 që plotëson Direktivën (BE) 2018/2001 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit duke vendosur një prag minimum për kursimet nga emetimet e gazit me efekt serrë nga karburantet e karbonit të ricikluar dhe duke specifikuar një metodologji për vlerësimin e kursimeve nga emetimet e gazit me efekt serrë nga karburantet e rinovueshme të lëngshëm dhe gaz, për sektorin e transportit me origjinë jo biologjike dhe nga karburanti i karbonit të ricikluar.

<sup>59</sup> Bazuar në Direktivën (BE) 2018/2001 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 11 dhjetorit 2018 mbi nxitjen e përdorimit të energjisë nga burime të rinovueshme.

në paragrafin 38, pika (a) deri në pikën (e), do të përfshijë edhe energjinë nga burimet fosile të konsumuara në veprimtari që nuk janë në sektorë me ndikim të madh klimatik.

AR 34. Informacioni mbi konsumin e energjisë dhe miksin energjetik mund të paraqitet duke përdorur formatin e tabelës në vijim për **sektorët me ndikim të madh klimatik** dhe për të gjithë sektorët e tjerë duke hequr rreshtat (1) deri në (5).

Konsumi i energjisë dhe miksi energjetik	Krahasueshmëria	Viti N
(1) Konsumi i karburantit nga qymyri dhe produktet e tij (MWh)		
(2) Konsumi i karburantit nga nafta dhe produktet e saj (MWh)		
(3) Konsumi i karburantit nga gazi natyror (MWh)		
(4) Konsumi i karburantit nga burimet e tjera fosile (MWh)		
(5) Konsumi i energjisë, ngrohjes, avullit dhe ftohjes së blerë ose të përfituar nga burimet fosile (MWh)		
<b>(6) Konsumi total i energjisë fosile (MWh) (i llogaritur si shuma e rreshtave 1 deri në 5)</b>		
<b>Pjesa e burimeve fosile gjithsej konsumi i energjisë (%)</b>		
(7) Konsumi nga burime bërthamore (MWh)		
<b>Pjesa e konsumit bërthamor Burime gjithsej të konsumit të energjisë (%)</b>		
(8) Konsumi i karburantit për burimet e rinovueshme përfshirë biomasën (duke përfshirë edhe mbetjet industriale dhe të bashkive me origjinë biologjike, biogazin, hidrogjenin nga burimet e rinovueshme, etj.) (MWh)		
(9) Konsumi i energjisë, ngrohjes, avullit dhe ftohjes së blerë ose të përfituar nga burimet e rinovueshme (MWh)		
(10) Konsumi i energjisë të gjeneruar vetë nga karburanti jo i rinovueshëm (MWh)		
<b>(11) Konsumi total i energjisë së rinovueshme (MWh) (i llogaritur si shuma e rreshtave 8 deri në 10)</b>		
<b>Pjesa e burimeve të rinovueshme gjithsej konsumi i energjisë (%)</b>		
<b>► C1 Konsumi total i energjisë (MWh) (i llogaritur si shuma e rreshtave 6, 7 dhe 11) ◀</b>		

AR 35. Totali i konsumit të energjisë duke dalluar mes konsumit të energjisë fosile, bërthamore dhe të rinovueshme mund të paraqitet grafikisht në **deklaratën e qëndrueshmërisë** duke treguar zhvillimet në kohë (p.sh., përmes një diagrame tortë ose me shtylla).

### Intensiteti i energjisë i bazuar në shitjet neto

Udhëzues lidhur me llogaritjen

AR 36. Kur përgatit informacionin mbi intensitetin e energjisë të kërkuar sipas paragrafit 40, njësia ekonomike do të:

(a) llogarisë raportin e intensitetit të energjisë duke përdorur formulën në vijim:

$$\frac{\text{Konsumi total i energjisë nga aktivitete në sektorë me ndikim të lartë klimatik (MWh)}}{\text{Shitjet neto nga aktivitete në sektorë me ndikim të lartë klimatik (Njësi Monetare)'}}$$

(b) paraqesë konsumin total të energjisë në MWh dhe të shitjeve neto në njësi monetare (p.sh., në Euro);

(c) numëruesi dhe emëruesi do t'i përkasin vetëm pjesës së konsumit gjithsej përfundimtar të energjisë (në numërues) dhe të shitjeve neto (në emërues) që u takojnë aktiviteteve në **sektorët me ndikim të madh në klimë**. Në fakt, duhet të ketë koherencë në atë që mbulon si numëruesi dhe emëruesi;

(d) llogarisë konsumin total të energjisë në pajtim me kërkesën e paragrafit 37;

(e) llogarisë të shitjet neto në pajtim me kërkesat e standardeve të kontabilitetit të zbatueshme për pasqyrat financiare, d.m.th., SNRF 15 *Të ardhurat nga Kontratat me Klientët* ose kërkesat e standardeve lokale (PPPK).

AR 37. Informacioni sasior mund të paraqitet në tabelën në vijim.

Intensiteti i energjisë ndaj të shitjeve neto	Krahasueshmëria	N	% N / N-1
Konsumi total i energjisë nga aktivitetet në sektorët me ndikim të lartë në klimë kundrejt të shitjeve neto nga aktivitetet në sektorët me ndikim të lartë në klimë (MWh/Njësi monetare)			

Lidhja e intensitetit të energjisë i bazuar në shitjet neto me informacionin financiar të raportuar

AR 38. Rakordimi i shitjeve neto nga aktivitetet në **sektorët me ndikim të lartë në klimë** me nënzërat përkatës të pasqyrave financiare ose dhëniet e informacioneve shpjeguese (siç kërkohet nga paragrafi 43) mund të paraqitet ose:

(a) me referencë të kryqëzuar me nënzërin përkatës apo dhënien e informacionit shpjegues në pasqyrat financiare; ose

(b) nëse shitjet neto nuk mund të referohen drejtpërdrejt me një nënzë apo dhënie informacionesh shpjeguese në pasqyrat financiare, me një rakordim sasior duke përdorur formën e tabelës në vijim.

<b>Shitjet neto nga aktivitetet në sektorë me ndikim të lartë në klimë të përdorura në llogaritjen e intensitetit të energjisë</b>	
<b>Shitjet neto (të tjera)</b>	
<b>Shitjet neto gjithsej (Pasqyrat financiare)</b>	

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-6 – Emetimet bruto GHG të Perimetrit 1, 2, 3 dhe emetimet totale GHG*

**Udhëzues lidhur me llogaritjen**

AR 39. Kur përgatit informacionin për të raportuar **emetimet** GHG të kërkuara sipas paragrafit 44, njësia ekonomike do të:

- (a) marrë në konsideratë parimet, kërkesat dhe udhëzimet e dhëna në Protokollin GHG të Standardeve për Shoqëritë (versioni 2004). Njësia ekonomike mund të marrë në konsideratë Rekomandimet e Komisionit (BE) 2021/2279<sup>60</sup> ose kërkesat e parashikuara nga EN ISO 14064-1:2018. Nëse njësia ekonomike zbaton tashmë metodologjinë kontabël për GHG të ISO 14064- 1: 2018, ajo do të plotësojë gjithsesi kërkesat e këtij standardi (p.sh., lidhur me kufijtë e raportimit dhe dhënie informacionesh shpjeguese për emetime GHG të Perimetrit 2 të bazuara në treg);
- (b) japë informacion shpjegues për metodologjitë, supozimet kryesore dhe faktorët e emetimit të përdorur për të llogaritur ose matur emetimet GHG të shoqëruara me arsyet se pse ato ishin zgjedhur dhe duke dhënë një referencë ose lidhje me çdo mjet llogaritës të përdorur;
- (c) përfshijë emetimet e CO<sub>2</sub>, CH<sub>4</sub>, N<sub>2</sub>O, HFCs, PFCs, SF<sub>6</sub>, dhe të NF<sub>3</sub>. GHG shtesë mund të merren në konsideratë nëse janë të rëndësishëm; dhe
- (d) përdorë vlerat më të fundit të **Potencialit Global të Ngrohjes (GWP)** të publikuar nga IPCC bazuar në një hark kohor 100-vjeçar për të llogaritur emetimet në ekuivalentë të CO<sub>2</sub> të gazrave jo-CO<sub>2</sub>.

AR 40. Kur përgatit informacionin për raportimin e emetimeve GHG nga pjesëmarrjet e saj, sipërmarrjet e përbashkëta, filialet e pakonsoliduara (njësitë ekonomike investuese) dhe marrëveshjet kontraktuale siç kërkohet nga paragrafi 50, njësia ekonomike do të konsolidojë 100% të emetimeve GHG të njësive ekonomike, veprimtarinë e të cilave ajo kontrollon. Në

<sup>60</sup> Rekomandimi i Komisionit (BE) 2021/2279 i 15 Dhjetorit 2021 mbi përdorimin e metodave të Gjurmës Mjedisore për të matur dhe komunikuar performancën mjedisore gjatë ciklit të jetës së produkteve dhe organizatave (GZ L 471, 30.12.2021, f. 1).

praktikë, kjo ndodh kur njësia ekonomike mban licensën ose lejen për të përdorur aktivet nga këto pjesëmarrje të saj, sipërmarrje të përbashkëta, filiale të pakonsoliduara (njësitë ekonomike investuese) dhe marrëveshje kontraktuale. Nëse njësia ekonomike ka një kontroll të veprimtarisë të kontraktuar për një periudhë kohore të pjeshme, ajo do të konsolidojë 100% të emetimit GHG gjatë kohës së kontrollit të saj të veprimtarisë.

AR 41. Në pajtim me ESRS 1, kapitulli 3.7, njësia ekonomike do të zërthejë informacionin për emetimet GHG të saj sipas rastit. Për shembull, njësia ekonomike mund të zërthejë **emetimet** e saj GHG të Perimetrit 1, 2, 3 ose totale sipas vendeve, segmenteve të veprimtarisë, aktivitetit ekonomik, filialeve, kategorive GHG (CO<sub>2</sub>, CH<sub>4</sub>, N<sub>2</sub>O, HFCs, PFCs, SF<sub>6</sub>, NF<sub>3</sub>, si dhe GHG të tjera të marra në konsideratë nga njësia ekonomike) ose llojit të burimit (djegie e palëvizshme, djegie e lëvizshme, emetime procesi ose emetime kalimtare).

AR 42. Njësia ekonomike mund të ketë një periudhë raportimi të ndryshme nga disa apo të gjitha njësitë ekonomike në zinxhirin e vlerës të saj. Në rrethana të tilla, njësisë ekonomike i lejohet të masë emetimet GHG të saj në përputhje me paragrafin 44 duke përdorur informacion për periudha raportimi që janë të ndryshme nga periudha e saj e raportimit nëse ai informacion merret nga njësitë në zinxhirin e saj të vlerës me periudha raportimi që janë të ndryshme nga periudha e raportimit e njësisë ekonomike, me kushtin që:

- (a) njësia ekonomike përdor të dhënat më të fundit në dispozicion nga këto njësi ekonomike në zinxhirin e saj të vlerës, për të matur dhe dhënë informacion shpjegues mbi emetimet e saj për gazrat me efekt serrë;
- (b) gjatësia e periudhave të raportimit është e njëjtë; dhe
- (c) njësia ekonomike jep informacion shpjegues mbi efektet e ngjarjeve kryesore dhe ndryshimet në rrethanat (të lidhura me emetimet GHG të saj) që ndodhin mes datave të raportimit të njësisë ekonomike në zinxhirin e saj të vlerës dhe datës së pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme të njësisë ekonomike.

AR 43. Kur përgatit informacionin mbi **emetimet GHG të Perimetrit 1** të kërkuar sipas paragrafit 48, germa (a) njësia ekonomike do të:

- (a) llogarisë ose masë emetimet GHG nga djegia e palëvizshme, djegia e lëvizshme, emetime procesi dhe emetimet kalimtare; si dhe përdorë të dhëna të përshtatshme nga aktiviteti që përfshijnë konsumin e karburantit nga burime jo të rinovueshme;
- (b) përdorë faktorë emetimi të përshtatshëm dhe koherentë;
- (c) japë informacion shpjegues për emetimet biogjenike të CO<sub>2</sub> nga djegia ose nga biodegradimi i biomasës veçmas nga emetimet GHG të Perimetrit 1, por do të përfshijë emetimet e tipeve të tjera GHG (veçanërisht të CH<sub>4</sub> dhe N<sub>2</sub>O);
- (d) kujdeset të mos përfshijë ndonjë heqje, blerje, shitje ose transferim të **krediteve të karbonit** ose të zbritjeve GHG në llogaritjen e emetimeve GHG të Perimetrit 1; dhe

(e) për aktivitetet e raportuara sipas ETS të BE, të raportojë emetimet e Perimetrit 1 duke ndjekur metodologjinë ETS të BE. Metodologjia ETS e BE mund të zbatohet edhe për aktivitetet në zona gjeografike ose sektorë që nuk mbulohen nga ETS e BE.

AR 44. Kur përgatit informacionin mbi përqindjen e **emetimeve** GHG të Perimetrit 1 nga skemat e rregulluara për emetimet e tregtueshme sipas paragrafit 48, germa (b), njësia ekonomike do të:

(a) marrë në konsideratë emetimet GHG nga **impiantet** që ajo shfrytëzon dhe janë objekt i rregullimeve për Skemat për Emetimet e Tregtueshme (ETS), duke përfshirë ETS të BE, ETS kombëtare dhe ETS jo të BE, nëse janë të zbatueshme;

(b) përfshijë vetëm emetimet e CO<sub>2</sub>, CH<sub>4</sub>, N<sub>2</sub>O, HFCs, PFCs, SF<sub>6</sub>, dhe të NF<sub>3</sub>;

(c) sigurojë të njëjtën periudhë kontabël për emetimet GHG të Perimetrit 1 bruto dhe emetimet GHG të rregulluara sipas ETS; dhe

(d) llogarisë pjesën duke përdorur formulën në vijim:

$$\frac{\text{Emetimet GHG (në tonë ekuivalentë të CO}_2\text{) nga impiantet me ETS të BE} \\ + \text{ impiantet me ETS kombëtare} \\ + \text{ impiantet me ETS jo të BE}}{\text{Emetime GHG të Perimetrit 1 (në tonë ekuivalentë të CO}_2\text{)}};$$

AR 45. Kur përgatit informacionin mbi **emetimet** GHG të Perimetrit 2 bruto të kërkuar sipas paragrafit 49, njësia ekonomike do të:

(a) marrë në konsideratë parimet dhe kërkesat e Udhëzimit për Protokollin GHG të Perimetrit 2 (versioni 2015, veçanërisht kriteri i cilësisë së Perimetrit 2 në kapitullin 7.1 që lidhet me instrumentet kontraktualë); ajo mund të marrë në konsideratë edhe Rekomandimin e Komisionit (BE) 2021/2279 ose kërkesat përkatëse për përcaktimin sasior të **emetimeve GHG të tërthorta** nga energjia e importuar sipas EN ISO 14064-1:2018;

(b) përfshijë **energjinë, avullin, ngrohjen dhe ftohjen e blerë ose të përfituar** të konsumuar nga njësia ekonomike;

(c) shmangë dublimin në llogaritje të emetimeve GHG të raportuara sipas Perimetrit 1 ose 3;

(d) zbatojë metodën e bazuar në vendndodhje dhe metodën e bazuar në treg për të llogaritur emetime GHG të Perimetrit 2 dhe të japë informacion mbi pjesën dhe llojin e instrumenteve kontraktualë. Metoda e bazuar në vendndodhje përcakton nga ana sasiore emetime GHG të Perimetrit 2 bazuar në mesataren e faktorëve të emetimit të energjisë së gjeneruar sipas vendndodhjes specifike, duke përfshirë kufijtë lokalë, brenda vendit ose kufijtë kombëtarë (Protokolli GHG, Udhëzues për Perimetrin 2, Fjalori, 2015). Metoda e bazuar në treg përcakton nga ana sasiore emetimet GHG të Perimetrit 2 bazuar në emetimet GHG të bëra nga prodhuesit prej të cilëve njësia ekonomike raportuese blen me kontratë energji elektrike të grupuar me instrumente, ose me instrumente të kontraktuar veçmas (Protokolli GHG, Udhëzues për Perimetrin 2, Fjalori, 2015); në këtë rast, njësia ekonomike mund të japë informacion shpjegues për pjesën e emetimeve GHG të

Perimetrit 2 të bazuara në treg të lidhura me energjinë e blerë në grup me instrumente të tilla si Garanci të Origjinës ose Certifikata të Energjisë së Rinovueshme. Njësia ekonomike do të sigurojë informacion mbi pjesën dhe llojin e instrumenteve të lidhura me kontratë të përdorura për shitjen dhe blerjen e energjisë së grupuar me tiparet që i takojnë prodhimit të energjisë ose për deklarimet me tipare jo të grupuara.

- (e) japë informacion shpjegues për emetimet biogjenike të CO<sub>2</sub> nga djegia ose nga biodegradimi i biomasës veçmas nga emetimet GHG të Perimetrit 2, por do të përfshijë emetimet e llojeve të tjera GHG (veçanërisht të CH<sub>4</sub> dhe N<sub>2</sub>O). Në rast se faktorët e emetimit të zbatuar nuk ndajnë përqindjen e biomasës ose të CO<sub>2</sub> biogjenik, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për këtë fakt. Në rast se emetimet GHG të ndryshme nga CO<sub>2</sub> (veçanërisht CH<sub>4</sub> dhe N<sub>2</sub>O) nuk janë në dispozicion për, ose janë përjashtuar nga, faktorët e emetimit mesatar për metodën e bazuar në vendndodhje ose për informacionin sipas metodës së bazuar në treg, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për këtë fakt.
- (f) kujdeset të mos përfshijë ndonjë heqje, blerje, shitje ose transferim të **krediteve të karbonit** ose të zbritjeve GHG në llogaritjen e emetimeve GHG të Perimetrit 2.

AR 46. Kur përgatit informacionin mbi **emetimet** GHG të Perimetrit 3 bruto të kërkuar sipas paragrafit 51, njësia ekonomike do të:

- (a) marrë në konsideratë parimet dhe parashikimet e Protokollit GHG për Zinxhirin e Vlerës të Shoqërisë (Perimetri 3) Standardi i Kontabilitetit dhe i Raportimit (Versioni 2011); dhe mund të marrë në konsideratë Rekomandimin e Komisionit (BE) 2021/2279 ose kërkesat përkatëse për përcaktimin sasior të **emetimeve GHG të tërthorta** sipas EN ISO 14064-1:2018;
- (b) nëse është një institucion financiar, do të marrë në konsideratë Standardin GHG të Kontabilitetit dhe të Raportimit për Industrinë Financiare nga Marrëveshja për Kontabilitetin Financiar të Karbonit (PCAF), veçanërisht pjesa A “Emetimet e Financuara” (versioni i dhjetorit 2022);
- (c) analizojë emetimet GHG të Perimetrit 3, totale të saj bazuar në 15 kategoritë e Perimetrit 3 të identifikuar nga Protokollit GHG i Standardit të Shoqërisë dhe Protokollit GHG i Zinxhirit të Vlerës të Shoqërisë (Perimetrit 3) Standardi i Kontabilitetit dhe i Raportimit (Versioni 2011) duke përdorur vlerësues të përshtatshëm. Gjithashtu, ajo mund të analizojë **emetimet GHG të tërthorta** të saj bazuar në kategoritë e përcaktuara nga EN ISO 14064-1:2018 fjalia 5.2.4 (duke përjashtuar emetime GHG të tërthorta nga energjia e importuar);
- (d) identifikojë dhe japë informacion shpjegues për kategoritë kryesore të Perimetrit 3 të saj bazuar në madhësinë e emetimeve GHG të vlerësuara të tyre dhe në kritere të tjera të përcaktuara nga Protokollit GHG Zinxhiri i Vlerës i Shoqërisë (Perimetrit 3) Standardi i Kontabilitetit dhe i Raportimit (Versioni 2011, f. 61 dhe 65-68) ose EN ISO 14064-1:2018

Aneksi H.3.2, të tilla si shpenzimet financiare, ndikimi, **rreziqet e tranzicionit** dhe **mundësitë** përkatëse ose këndvështrimet e **palëve të interesuara**;

- (e) llogarisë ose vlerësojë emetimet GHG në kategoritë kryesore të Perimetrit 3 duke përdorur faktorë emetimi të përshtatshëm;
- (f) përditësojë emetime GHG të Perimetrit 3 në secilën kategori të rëndësishme çdo vit në bazë të të dhënave aktuale të aktivitetit; përditësojë inventarin e plotë të emetimeve GHG të Perimetrit 3 të paktën çdo 3 vjet ose me ndodhjen e një ngjarjeje të rëndësishme ose të një ndryshimi të rëndësishëm të rrethanave (një ngjarje e rëndësishme ose ndryshim i rëndësishëm në rrethanat mund të lidhet, për shembull, me ndryshimet në aktivitetet ose strukturën e njësisë ekonomike, ndryshimet në aktivitetet ose strukturën e rrjedhës së sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës të saj, një ndryshim, në metodologjinë e llogaritjes ose në zbulimin e gabimeve);
- (g) japë informacion shpjegues për madhësinë që emetimet GHG të Perimetrit 3 të njësisë ekonomike kanë përdorur inpute nga aktivitete specifike brenda rrjedhës së sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës të njësisë ekonomike dhe do të tregojë përqindjen e emetimeve të llogaritura duke përdorur të dhëna primare të marra nga **zinxhiri i vlerës i furnitorëve** ose nga **zinxhiri i vlerës** i partnerëve të tjerë.
- (h) për secilën kategori të rëndësishme të GHG të Perimetrit të 3, do të tregojë kufijtë e raportimit të marra në konsideratë, metodat e llogaritjes për vlerësimin e emetimeve GHG si dhe nëse dhe cilat mjete llogaritëse janë përdorur. Kategoritë e Perimetrit 3 duhet të jenë koherente me GHGP dhe të përfshijnë:
  - i. emetime GHG të Perimetrit 3 të tërthorta nga grupi kontabël i konsoliduar (mëma dhe filialet e saj),
  - ii. emetime GHG të Perimetrit 3 të tërthorta nga pjesëmarrjet, sipërmarrjet e përbashkëta dhe filialet e pakonsolidura për të cilat njësia ekonomike ka aftësinë për të kontrolluar aktivitetet e shfrytëzimit dhe marrëdhëniet (d.m.th., kontrollin e veprimtarisë),
  - iii. emetimet GHG të Perimetrit 1, 2 dhe 3 nga pjesëmarrjet, sipërmarrjet e përbashkëta, filialet e pakonsoliduara (njësitë ekonomike investuese) dhe marrëveshjet e përbashkëta për të cilat njësia ekonomike nuk ka **kontrollin e veprimtarisë** dhe kur këto njësi janë pjesë e rrjedhës së sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës të njësisë ekonomike.
- (i) jep si informacion shpjegues një listë të kategorive të emetimeve GHG të Perimetrit 3 të përfshira dhe të përjashtuara nga inventari me justifikimin për kategoritë e Perimetrit 3 të përjashtuara;
- (j) japë informacion shpjegues për emetimet biogjenike të CO<sub>2</sub> nga djegia ose nga biodegradimi i biomasës që ndodh në pjesën e sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të vlerës** të saj, veçmas nga emetimet GHG të Perimetrit 3 bruto dhe të përfshijë emetimet

e llojeve të tjera të GHG (të tilla si CH<sub>4</sub> dhe N<sub>2</sub>O), si dhe emetimet e CO<sub>2</sub> që ndodhin gjatë ciklit të jetës të biomasës të ndryshme nga djegia ose biodegradimi (të tilla si emetimet GHG nga përpunimi ose transporti i biomasës) në llogaritjen e emetimet GHG të Perimetrit 3;

(k) kujdeset të mos përfshijë ndonjë heqje, blerje, shitje ose transferim të **krediteve të karbonit** ose të zbritjeve GHG në llogaritjen e emetimeve GHG të Perimetrit 3;

AR 47. Kur përgatit informacionin mbi **emetimet** GHG totale të kërkuar sipas paragrafit 52, njësia ekonomike do të:

(a) zbatojë formulat në vijim për të llogaritur emetimet GHG totale:

$$\begin{aligned} \text{Emetime totale GHG}_{\text{të bazuara në vendndodhje}} \text{ (t CO}_2\text{ eq)} &= \text{Emetime bruto të Perimetrit 1} \\ &+ \text{Emetime bruto të Perimetrit 2}_{\text{të bazuara në vendndodhje}} \\ &+ \text{Emetime bruto totale të Perimetrit 3} \end{aligned}$$

$$\begin{aligned} \text{Emetime GHG}_{\text{të bazuara në treg}} \text{ (t CO}_2\text{ eq)} &= \text{Emetime bruto të Perimetrit 1} \\ &+ \text{Emetime bruto të Perimetrit 2}_{\text{të bazuara në treg}} \\ &+ \text{Emetime bruto totale të Perimetrit 3} \end{aligned}$$

(b) japë informacion shpjegues për emetimet GHG totale duke dalluar mes emetimeve që vijnë nga zbatimi i metodës së bazuar në vendndodhjen nga ato që vijnë nga zbatimi i metodës së bazuar në treg kur maten emetime GHG të Perimetrit 2 përkatëse.

AR 48. Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për **emetimet** GHG totale të saj duke i zbërthyer sipas Perimetrit 1 dhe 2, si dhe më të rëndësishmet e Perimetrit 3 në përputhje me tabelën në vijim.

	Retrospektivë				Vitet piketa dhe objektiva			
	Viti bazë	Krahasueshmëria	N	% N / N- 1	2025	2030	2050	Objektivi vjetor % / Viti bazë
<b>Emetime GHG të Perimetrit 1</b>								
Emetime GHG të Perimetrit 1 bruto (në tonë ekuivalentë të CO <sub>2</sub> )								
Përqindja e Perimetrit 1 Emetimet GHG nga skemat e rregulluara								

	Retrospektivë				Vitet piketa dhe objektiva			
	Viti bazë	Krahasueshmëria	N	% N / N- 1	2025	2030	2050	Objektivi vjetor % / Viti bazë
për emetimet e tregtueshme (%)								
<b>Emetime GHG të Perimetrit 2</b>								
Emetime GHG të Perimetrit 2 bruto, të bazuara në vendndodhje (në tonë ekuivalentë të CO2)								
Emetime GHG të Perimetrit 2 bruto, të bazuara në treg (në tonë ekuivalentë të CO2)								
<b>Emetimet GHG të perimetrit 3 të rëndësishme</b>								
Emetime GHG (të Perimetrit 3) të tërthorta bruto gjithsej (në tonë ekuivalentë të CO2)								
1 Mallra dhe shërbime të blera								
[Nën-kategori opsionale: Shërbime informatike në re (cloud) dhe të qëndrës së të dhënave]								
2 Aktive të investimit								
3 Karburant dhe të lidhur me energjinë								

	Retrospektivë				Vitet piketa dhe objektiva			
	Viti bazë	Krahasueshmëria	N	% N / N- 1	2025	2030	2050	Objektivi vjetor % / Viti bazë
Aktivitete (jo të përfshira në Perimetrin 1 ose Perimetrin 2)								
4 Transporti dhe shpërndarja në rrjedhën e sipërme								
5 Mbetjet e gjeneruara nga veprimtaria								
6 Udhëtime biznesi								
7 Transporti i punonjësve								
8 Aktive të dhëna me qira në rrjedhën e sipërme								
9 Transporti në rrjedhën e poshtme								
10 Përpunimi i produkteve të shitura								
11 Përdorimi i produkteve të shitura								
12 Trajtimi në fund të jetës i produkteve të shitura								
13 Aktive të dhëna me qira në rrjedhën e poshtme								
14 Franshizat								

	Retrospektivë				Vitet piketa dhe objektiva			
	Viti bazë	Krahasueshmëria	N	% N / N- 1	2025	2030	2050	Objektivi vjetor % / Viti bazë
15 Investimet								
<b>Emetimet GHG totale</b>								
Emetimet GHG totale (të bazuara në vendndodhje) (në tonë ekuivalentë të CO2)								
Emetimet GHG totale (të bazuara në treg) (në tonë ekuivalentë të CO2)								

AR 49. Për të theksuar **rreziqet e tranzicionit** potenciale, njësia ekonomike mund të japë si informacion shpjegues **emetimet** GHG totale të saj të zbrërthyer sipas vendeve kryesore dhe, nëse është e zbatueshme, sipas segmenteve të shfrytëzimit (duke zbatuar të njëjtët segmente për pasqyrat financiare siç kërkohet nga standardet e kontabilitetit, d.m.th., SNRF 8 Segmente shfrytëzimi ose PPPK (Parime Përgjithësisht të Pranuara të Kontabilitetit) lokale). Emetimet GHG të Perimetrit 3 mund të përjashtohen nga këto zbrërthime sipas vendeve nëse të dhënat përkatëse nuk janë lehtësisht të gatshme.

AR 50. **Emetimet** GHG të Perimetrit 3 mund të paraqiten edhe në funksion të kategorive të emetimit të tërthortë të përcaktuara në EN ISO 14064-1:2018.

AR 51. Nëse është e rëndësishme për emetimet e Perimetrit 3 të njësisë ekonomike, ajo do të japë informacion shpjegues për **emetimet** GHG nga shërbimet informatike në re dhe qendrat e të dhënave si një nënbashkësi të **kategorisë së Perimetrit 3** për “mallrat dhe shërbimet e blera në rrjedhën e sipërme”.

AR 52. **Emetimet** GHG totale të zbrërthyer sipas emetimeve GHG të Perimetrit 1, 2 dhe 3 mund të paraqiten grafikisht në **deklaratën e qëndrueshmërisë** (p.sh., si një diagramë me shtylla ose tortë) duke treguar ndarjen e emetimeve GHG mes **zinxhirit të vlerës** (Rrjedha e sipërme, Veprimtaria e vet, Transporti, Rrjedha e poshtme).

## Intensiteti i GHG i bazuar në shitjet neto

Udhëzues lidhur me llogaritjen

AR 53. Kur përgatit informacionin mbi intensitetin GHG të bazuar në shitjet neto të kërkuar nga paragrafi 53, njësia ekonomike do të:

(a) llogarisë raportin e intensitetit të GHG duke përdorur formulën në vijim:

$$\frac{\text{Emetimet totale GHG (t CO}_2\text{eq)}}{\text{Shitjet neto (Njësi monetare)}}$$

(b) shprehë **emetimet** GHG totale në metrikën tonë të ekuivalentit të CO<sub>2</sub> dhe njësiti monetare të shitjeve neto (p.sh., në Euro) dhe të paraqesë rezultatet për metodën e bazuar në treg dhe metodën e bazuar në vendndodhje;

(c) përfshijë emetimet GHG totale në numërues dhe shitjet neto gjithsej në emërues;

(d) llogarisë emetimet GHG totale siç kërkohet nga paragrafi 44, germa (d) dhe paragrafi 52; dhe

(e) llogarisë shitjet neto në pajtim me kërkesat në standardet e kontabilitetit të përdorura për pasqyrat financiare, d.m.th., SNRF 15 ose PPPK lokale.

AR 54. Informacioni sasior mund të paraqitet në formën e tabelës në vijim.

Intensiteti i GHG ndaj të shitjeve neto	Krahasueshmëria	N	% N / N-1
Emetimet GHG totale (të bazuara në vendndodhje) ndaj shitjeve neto (në tonë ekuivalentë të CO <sub>2</sub> / Njësi monetare)			
Emetimet GHG totale (të bazuara në treg) ndaj shitjeve neto (në tonë ekuivalentë të CO <sub>2</sub> / Njësi monetare)			

Lidhja e intensitetit GHG të bazuar në shitjet neto me informacionin financiar të raportuar

AR 55. Rakordimi i shitjeve neto të përdorura për të llogaritur intensitetin GHG me nënzërat përkatës ose shënimet në pasqyrat financiare (siç kërkohet nga paragrafi 55) mund të bëhet ose përmes:

(a) me referencë të kryqëzuar me nënzërin përkatës apo dhënien e informacionit shpjegues në pasqyrat financiare; ose

(b) nëse shitjet neto nuk mund të referohen drejtpërdrejt me një nënzë apo dhënie informacionesh shpjeguese në pasqyrat financiare, me një rakordim sasior duke përdorur formatin e tabelës në vijim.

<b>Shitjet neto të përdorura për të llogaritur intensitetin GHG</b>	
---	--

Shitjet neto (të tjera)	
Shitjet neto gjithsej (në pasqyrat financiare)	

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-7 – Projektet për heqjen dhe zbutjen e GHG, të financuara përmes krediteve të karbonit*

**Heqjet dhe magazinimi i GHG në veprimtarinë e vet dhe në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës**

AR 56. Përveç inventarit të emetimeve GHG të tyre, njësitë ekonomike do të bëjnë transparencë për si dhe sa ato përmirësojnë “lavamanët” natyrorë ose përdorin zgjidhje teknike për heqjen e GHG nga atmosfera në veprimtarinë e tyre dhe në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës. Megjithëse nuk ka koncepte dhe metodologji të pranuar përgjithësisht për trajtimin kontabël të heqjeve GHG, ky Standard synon të rrisë transparencën në përpjekjet e njësisë ekonomike për heqjen e GHG nga atmosfera (paragrafi 56, germa (a) dhe paragrafi 58). Heqjet e GHG jashtë **zinxhirit të vlerës** që njësia ekonomike mbështet me blerjen e **krediteve të karbonit** duhet të paraqiten veçmas siç kërkohet nga paragrafi 56, germa (b) dhe paragrafi 59.

AR 57. Kur jep informacionin shpjegues mbi **heqjet dhe magazinimin e GHG** nga veprimtaria e vet e njësisë ekonomike dhe nga rrjedha e sipërme dhe e poshtme e **zinxhirit të vlerës** të kërkuar sipas paragrafit 56, germa (a) dhe paragrafit 58, për çdo aktivitet heqjeje dhe magazinimi, njësia ekonomike do të përshkruajë:

- (a) GHG në fjalë;
- (b) nëse heqja dhe magazinimi janë biogjenike ose nga **ndryshimi i përdorimit të terrenit** (p.sh., pyllëzimi, ripyllëzimi, restaurimi i pyllit, mbjellja e pemëve në zonat urbane, agropyllëzimi, rritja e karbonit në **terren**, etj.), teknologjike (p.sh., kapja drejtpërdrejt nga atmosfera), ose hibride (p.sh., bioenergji me kapje dhe magazinim të CO<sub>2</sub>), si dhe hollësi teknologjike mbi heqjen, llojin e magazinës dhe, nëse është e zbatueshme transportin e GHG të hequra;
- (c) nëse është e zbatueshme, një shpjegim i shkurtër nëse aktiviteti cilësohet si zgjidhje e bazuar në natyrë; dhe
- (d) si menaxhohet rreziku nga paqëndrueshmëria, duke përfshirë përcaktimin dhe monitorimin e rrjedhjeve dhe ngjarjeve të anulimit, sipas rastit.

Udhëzues lidhur me llogaritjen

AR 58. Kur përgatit informacionin mbi **heqjet dhe magazinimin e GHG** nga veprimtaria e vet e njësisë ekonomike dhe nga rrjedha e sipërme dhe e poshtme e **zinxhirit të vlerës** të kërkuar sipas paragrafit 56, germa (a) dhe paragrafit 58, njësia ekonomike do të:

- (a) marrë në konsideratë, për sa është i zbatueshëm, Protokollin GHG të Standardit për Shoqëritë (versioni 2004), Standardin e Produktit (versioni 2011), Udhëzuesin për Agrikulturën (versioni 2014), Udhëzuesin për përdorimin e terrenit, **ndryshimin e përdorimit të terrenit** dhe pylltarinë, për trajtimin kontabël të projekteve GHG (versioni 2006);
- (b) zbatojë metoda të pranuar në trajtimin kontabël të heqjeve GHG sapo ato janë në dispozicion, veçanërisht kuadrin rregullator të BE për certifikimin e heqjeve CO<sub>2</sub>;
- (c) nëse është e zbatueshme, të shpjegojë rolin e heqjeve për **politikën e saj për zbutjen e ndryshimit klimatik**;
- (d) të përfshijë heqjet nga veprimtaritë që zotëron, kontrollon, ose kontribuon dhe që nuk janë shitur tek një palë e tretë përmes krediteve të karbonit;
- (e) nëse është e zbatueshme, të tregojë ato aktivitete për heqjen e GHG në veprimtarinë e saj ose në zinxhirin e vlerës që nuk janë konvertuar në kredite karboni dhe shitur tek palë të tjera në tregun vullnetar;
- (f) të kontabilizojë **emetimet** GHG të lidhura me një aktivitet heqjeje, përfshirë transportin dhe magazinimin, sipas Kërkesës për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-6 (Perimetri 1, 2 ose 3). Për të rritur transparencën në rendimentin e aktivitetit të heqjes, përfshirë transportin dhe magazinimin, njësia ekonomike mund të japë informacion shpjegues për emetimet GHG të lidhura me këtë aktivitet (p.sh., emetimet GHG nga konsumi i energjisë elektrike i teknologjive për kapjen e drejtpërdrejtë nga atmosfera) së bashku, por të ndara, nga shuma e emetimeve GHG të hequra;
- (g) në rast të një anulimi, të kontabilizojë emetimet GHG përkatëse si një kompensim për heqjet në periudhën e raportimit;
- (h) të përdorë vlerat më të fundit **GWP** të publikuara nga IPCC bazuar në një hapësirë kohore 100-vjeçare për të llogaritur emetimet ekuivalente në CO<sub>2</sub> të gazrave jo-CO<sub>2</sub> dhe të përshkruajë supozimet e bëra, metodologjitë dhe kuadrot e referimit të përdorura për llogaritjen e shumës së heqjeve GHG; dhe
- (i) të marrë në konsideratë **zgjidhjet e bazuara në natyrë**.

AR 59. Njësia ekonomike do të zbërthejë dhe japë informacion shpjegues veçmas për heqjet GHG që ndodhin në veprimtarinë e vet dhe ato që ndodhin në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës. Aktivitetet e heqjes së GHG në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të vlerës** do të përfshijnë ato që njësia ekonomike mbështet në mënyrë aktive, për shembull, përmes një projekti bashkëpunimi me një **furnizues**. Nuk pritet që njësia ekonomike të përfshijë ndonjë heqje të GHG që mund të ndodhë në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës, për të cilin ajo nuk ka dijeni.

AR 60. Informacioni sasior mbi heqjet GHG mund të paraqitet duke përdorur formën e tabelës në vijim.

Heqjet	Krahasueshmëria	N	% N / N-1
Aktiviteti 1 i heqjes së GHG (p.sh., restaurimi i pyllit)	-		
Aktiviteti 2 i heqjes së GHG (p.sh., kapja e drejtpërdrejtë nga atmosfera)	-		
...			
<b>Heqjet GHG totale nga veprimtaria e vet (në tonë ekuivalentë CO2)</b>			
Aktiviteti 1 i heqjes së GHG (p.sh., restaurimi i pyllit)	-		
Aktiviteti 2 i heqjes së GHG (p.sh., kapja e drejtpërdrejtë nga atmosfera)	-		
...	-		
<b>Heqjet GHG totale në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës (në tonë ekuivalentë CO2)</b>			
<b>Anulimet (në tonë ekuivalentë CO2)</b>			

#### Projektet e zbuties GHG të financuar përmes krediteve të karbonit

- AR 61. Projektet e financimit të **pakësimit të emetimeve** GHG jashtë **zinxhirit të vlerës** të njësisë ekonomike përmes blerjes së **krediteve të karbonit** që plotësojnë standarde të cilësisë së lartë mund të jenë një kontribut i dobishëm për zbutjen e ndryshimit klimatik. Ky Standard kërkon që njësi ekonomike të japë informacion shpjegues nëse përdor **kredite të karbonit** veçmas nga **emetimet** GHG (paragrafi 56, germa (b) dhe paragrafi 59) dhe **objektivat për pakësimin e emetimit** GHG (Kërkesa për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-4). Gjithashtu, ai kërkon që njësi ekonomike të tregojë shtrirjen e përdorimit dhe cilët kritere të cilësisë përdor për ato kredite karboni.
- AR 62. Kur jep informacionin shpjegues mbi **kreditet e karbonit** të kërkuara sipas paragrafit 56, germa (a) dhe paragrafit 59, njësi ekonomike do të japë informacion shpjegues për zberthimet në vijim sipas rastit kur është e zbatueshme:
- (b) pjesën (në përqindje vëllimi) lidhur me projektet e pakësimit dhe projektet e heqjes;
  - (c) kreditet e karbonit nga projektet e heqjes, një shpjegim nëse ato janë nga “lavamanë” biogjenikë apo teknologjikë;
  - (d) pjesën (në përqindje të vëllimit) për secilin standard cilësie të njohur;
  - (e) pjesën (në përqindje vëllimi) të emetuar nga projektet në BE; dhe

- (f) Pjesën (në përqindje vëllimi) që mund të konsiderohet si rregullim korrespondues sipas nenit 6 të Marrëveshjes së Parisit.

Udhëzues lidhur me llogaritjen

AR 63. Kur përgatit informacionin mbi **kreditet e karbonit** të kërkuar sipas paragrafit 56, germa (b) dhe paragrafit 59, njësia ekonomike do të:

- (a) marrë në konsideratë **standardet e njohura të cilësisë**;
- (b) nëse është e zbatueshme, të shpjegojë rolin e krediteve të karbonit për **politikat e saj për zbutjen e ndryshimit klimatik**;
- (c) kujdeset të mos përfshijë kreditet e karbonit të emetuara për projektet për **pakësimin e emetimit** GHG brenda **zinxhirit të vlerës** të saj pasi pakësimi përkatës i emetimeve GHG do të jenë dhënë tashmë si informacion shpjegues sipas Kërkesës për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-6 (Perimetri 2 ose Perimetri 3) në kohën kur ato ndodhin (d.m.th., shmanget llogaritja dy herë);
- (d) kujdeset të mos përfshijë kreditet e karbonit të emetuara për projektet për heqjen e emetimit GHG brenda zinxhirit të vlerës të saj pasi heqjet përkatëse të emetimeve GHG mund të jenë trajtuar tashmë sipas Kërkesës për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-7 në kohën kur ato ndodhin (d.m.th., shmanget llogaritja dy herë);
- (e) kujdeset të mos japë informacion shpjegues për kreditet e karbonit si një kompensim për **emetimet** GHG të saj sipas Kërkesës për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-6 mbi emetimet GHG;
- (f) kujdeset të mos japë informacion shpjegues mbi kreditet e karbonit si një mjet për të arritur objektivat e pakësimit të emetimit GHG të dhëna si informacion shpjegues sipas Kërkesës për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-4; dhe
- (g) llogarisë shumën e krediteve të karbonit për t'u anuluar në të ardhmen, si shumë e krediteve të karbonit në metrikën tonë ekuivalentë të CO<sub>2</sub> përgjatë kohës së marrëveshjeve kontraktuale ekzistuese.

AR 64. Informacioni mbi **kreditet e karbonit** i anuluar në vitin e raportimit dhe të planifikuara për t'u anuluar në të ardhmen mund të paraqiten duke përdorur formatin e tabelave në vijim.

Kreditet e karbonit të anuluar në vitin e raportimit	Krahasueshmëria	N
<b>Totali (në tonë ekuivalentë CO<sub>2</sub>)</b>		
Pjesa nga projektet e heqjes (%)		
Pjesa nga projektet e pakësimit (%)		
<i>Standard i cilësisë 1 i njohur (%)</i>		
<i>Standard i cilësisë 2 i njohur (%)</i>		

Kreditet e karbonit të anuluar në vitin e raportimit	Krahasueshmëria	N
Standard i cilësisë 3 i njohur (%)		
...		
Pjesa nga projektet brenda BE (%)		
Pjesa e krediteve të karbonit që mund të konsiderohen si rregullime korrespondente (%)		

Kreditet e karbonit të planifikuara për t'u anuluar në të ardhmen	Shuma deri në [periudha]
<b>Totali (në tonë ekuivalentë CO2)</b>	

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-8 – Çmimi i brendshëm i karbonit*

AR 65. Kur jep informacionin shpjegues të kërkuara sipas paragrafëve 62 dhe 63, nëse është e zbatueshme, njësia ekonomike do të shpjegojë shkurt nëse dhe si çmimet e karbonit të përdorura në skemat e përcaktimit të çmimit të brendshëm të karbonit janë në koherencë me ato të përdorura në pasqyrat financiare. Kjo do të bëhet në lidhje me çmimet e brendshme të karbonit të përdorura për:

- (a) vlerësimin e jetës së dobishme dhe vlerës së mbetur të aktiveve të saj (jo materiale, toka, ndërtesa, makineri e pajisje);
- (b) zhvlerësimin e aktiveve; dhe
- (c) matjen me vlerën e drejtë të aktiveve të përfituara përmes blerjeve të bizneseve.

AR 66. Informacioni mund të paraqitet duke përdorur tabelën në vijim:

Lloji i çmimeve të brendshme të karbonit	Vëllimi përkatës (në tonë ekuivalentë të CO2)	Çmimet e zbatuara (në Euro / tonë ekuivalentë të CO2)	Përshkrimi i perimetrit
Çmimi fiktiv CapEx			
Çmimi fiktiv i investimit në Kërkim dhe Zhvillim (R&D)			
Të drejta ose fondi i brendshëm i karbonit			

Lloji i çmimeve të brendshme të karbonit	Vëllimi përkatës (në tonë ekuivalentë të CO2)	Çmimet e zbatuara (në Euro / tonë ekuivalentë të CO2)	Përshkrimi i perimetrit
Çmimi i karbonit për testin e zhvlerësimit			
Etj.			

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-9 – Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet materiale, fizike dhe të tranzicionit, si dhe mundësitë potenciale të lidhura me klimën*

**Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet materiale fizike dhe të tranzicionit**

AR 67. **Rreziqet fizike** dhe **rreziqet e tranzicionit** materiale, të lidhura me klimën mund të ndikojnë pozicionin financiar të njësisë ekonomike (p.sh., aktivet e zotëruara, aktivet e dhëna me qira dhe të kontrolluara financiarisht, si dhe detyrimet), performancën (p.sh., rritjet/pakësimet potenciale të ardhshme në shitjet neto dhe kostot për shkak të ndërprerjeve të biznesit, rritja e çmimeve të furnizimit sjell një erozion potencial të marzhit) dhe flukset monetare. Probabiliteti i ulët, ashpërsia e lartë dhe hapësira e gjatë kohore e disa ekspozimeve ndaj rreziqeve fizike të lidhura me klimën dhe pasiguria që vjen nga tranzicioni drejt një ekonomie të qëndrueshme do të thotë që do të ketë **efekte financiare të parashikuara** materiale të lidhura me to, që janë jashtë objektit të kërkesave të standardeve të zbatueshme të kontabilitetit.

AR 68. Aktualisht, nuk ekziston një metodologji e pranuar nga të gjithë për të vlerësuar ose matur se sa **rreziqet fizike** dhe **rreziqet e tranzicionit** materiale mund të ndikojnë në të ardhmen pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset monetare të njësisë ekonomike. Prandaj, dhënia e informacioneve shpjeguese mbi efektet financiare (siç kërkohet nga paragrafët 64, 66 dhe 67) do të varet në metodologjinë e brendshme të njësisë ekonomike dhe në ushtrimin e një gjykimi të rëndësishëm në përcaktimin e inputeve dhe të supozimeve të nevojshme për përcaktimin sasior të **efekteve financiare të parashikuara** të tyre.

Udhëzues lidhur me llogaritjen - Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet fizike materiale

AR 69. Kur jep informacionin shpjegues të kërkuar sipas paragrafit 64, germa (a) dhe paragrafit 66, njësia ekonomike do të shpjegojë nëse dhe si:

(a) ka vlerësuar **efektet financiare të parashikuara** për aktivet dhe aktivitetet e biznesit në rrezik fizik material, duke përfshirë objektin e zbatimit, horizontin kohor, metodologjinë e llogaritjes, supozimet dhe parametrat kryesorë, si dhe kufizimet e vlerësimit; dhe

(b) vlerësimi i aktiveve dhe aktiviteteve të biznesit që konsiderohen të jenë në **rrezik fizik** material, lidhet me ose është pjesë e procesit për përcaktimin e rrezikut fizik material siç kërkohet sipas paragrafit 20, germa (b) dhe AR 11 dhe për të përcaktuar **skenarët** e klimës siç kërkohet sipas paragrafit 19 dhe AR 13 deri tek AR 14. Veçanërisht, ajo do të shpjegojë se si e ka përkufizuar hapësirën kohore afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë dhe se si këto përkufizime lidhen me jetën e pritshme të aktiveve të saj, horizontet e planifikimit strategjik dhe planet e shpërndarjes së kapitalit.

AR 70. Kur përgatit informacionin mbi aktivet në rrezik fizik material të kërkuar për t'u dhënë si informacion shpjegues sipas paragrafit 66, germa (a) njësia ekonomike do të:

(a) llogarisë aktivet në rrezik fizik material në terma të shumës monetare dhe si një pjesë (përqindje) e totalit të aktiveve në datën e raportimit (d.m.th., pjesa është një vlerësim i vlerës kontabël të aktiveve në rrezik fizik material e pjesëtuar me vlerën totale kontabël siç paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar ose bilancin kontabël). Vlerësimi i aktiveve në rrezik fizik material do të nxirret duke filluar nga aktivet e njohura në pasqyrat financiare. Vlerësimi i shumave monetare dhe i pjesës së aktiveve në rrezik fizik mund të paraqitet ose si një shumë e vetme ose si një interval.

(b) të gjitha llojet e aktiveve, përfshirë aktivet me qira financiare / me të drejtë përdorimi do të merren në konsideratë kur përcaktohen aktivet në rrezik fizik material.

(c) për të ta konkretizuar këtë informacion, njësia ekonomike do të:

i. japë informacion shpjegues për vendndodhjen e aktiveve kryesore në rrezik fizik material. Aktivet kryesore që ndodhen<sup>61</sup> në territorin e BE do të grupohen sipas kodeve NUTS me 3 shifra (Nomenklatura e Njësive të Territorit për Statistikat, në anglisht Nomenclature of Territorial Units for Statistics). Për aktivet kryesore që gjenden jashtë territorit të BE, zberthimi sipas kodeve NUTS do të jepet vetëm kur është e mundshme.

ii. zberthejë shumat monetare të aktiveve në rrezik sipas rrezikut fizik akut dhe kronik.<sup>62</sup>

(d) llogarisë pjesën e aktiveve në rrezik fizik material që vjen nga paragrafi 66, germa (a) që trajtohet nga **veprimet përshtatjen ndaj ndryshimit klimatik** bazuar në informacionin shpjegues të dhënë sipas Kërkesës për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-3. Objektivi është të vlerësohen rreziqet neto.

AR 71. Kur përgatit informacionin e kërkuar sipas paragrafit 64, germa (a) dhe paragrafit 66, germa (d), njësia ekonomike mund të vlerësojë dhe të japë informacion shpjegues për pjesën e të ardhurave (shitjeve) neto nga aktivitetet e biznesit në rrezik fizik. Kjo dhënie informacionesh shpjeguese:

---

<sup>61</sup> Kjo kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese përfshihet në pajtim me kërkesat në Rregulloren për Zbatim të Komisionit (BE) 2022/2453 për Formatin 5 të ekspozimeve objekt i rrezikut fizik.

<sup>62</sup> Kjo kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese përfshihet në pajtim me kërkesat në Rregulloren për Zbatim të Komisionit (BE) 2022/2453 për Formatin 5 të ekspozimeve objekt i rrezikut fizik.

- (a) do të bazohet në shitjet neto në pajtim me kërkesat në standardet e kontabilitetit të përdorura për pasqyrat financiare, d.m.th., SNRF 15 ose PPPK lokale.
- (b) mund të përfshijë një zbërthim të aktiviteteve të biznesit të njësisë ekonomike me hollësitë përkatëse të përqindjeve të lidhura me totalin e shitjeve neto, faktorët e rrezikut (rastësitë, ekspozimi dhe ndjeshmëria) dhe, nëse është e mundur, madhësinë e **efekteve financiare të parashikuara** në terma të pakësimit të marzhit në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë. Edhe natyra e aktiviteteve të biznesit mund të zërthehet sipas segmenteve të shfrytëzimit nëse njësia ekonomike ka dhënë informacion shpjegues për marzhin e kontributit sipas segmenteve të shfrytëzimit në raportimin e segmentit në pasqyrat financiare.

Udhëzues lidhur me llogaritjen - Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet e tranzicionit

AR 72. Kur jep informacionin shpjegues të kërkuar sipas paragrafit 64, germa (a) dhe paragrafit 67, germa (a) njësia ekonomike do të shpjegojë nëse dhe si:

- (a) ka vlerësuar efektet potenciale në performancën financiare dhe pozicionin financiar të ardhshëm për aktivet dhe aktivitetet e biznesit në rrezik tranzicioni material, duke përfshirë objektin e zbatimit, metodologjinë e llogaritjes, supozimet dhe parametrat kryesorë, si dhe kufizimet e vlerësimit; dhe
- (b) ► **C1** vlerësimi i aktiveve dhe aktiviteteve të biznesit që konsiderohen të jenë në rrezik tranzicioni material, lidhet me ose është pjesë e procesit për përcaktimin e **rrezikut të tranzicionit** material siç kërkohet sipas paragrafit 20, germa (c) dhe AR 12 dhe për të përcaktuar **skenarët** e klimës siç kërkohet sipas paragrafëve AR 12 deri tek AR 15. ◀ Veçanërisht, ajo do të shpjegojë se si e ka përkufizuar hapësirën kohore afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë dhe se si këto përkufizime lidhen me jetën e pritshme të aktiveve të saj, horizontet e planifikimit strategjik dhe planet e shpërndarjes së kapitalit.

AR 73. Kur jep informacionin shpjegues mbi aktivet në rrezik tranzicioni material të kërkuar sipas paragrafit 67, germa (a) dhe germa (b), njësia ekonomike do të:

- (a) përfshijë të paktën një vlerësim të shumës së aktiveve potencialisht të bllokuara (në shumë monetare dhe në pjesë/ përqindje) nga viti i raportimit deri në 2030 dhe nga 2030 deri në 2050. Me aktive të bllokuara kuptohen aktivet kryesore në përdorim ose të planifikuar mirë të njësisë ekonomike me **emetimet GHG të kyçura (të bllokuara)** përgjatë jetës së tyre të shfrytëzimit. Aktivet kryesore të planifikuara mirë janë ato që njësia ekonomike ka shumë gjasa që do t'i lëvizë brenda 5 viteve në vijim. Shuma mund të shprehet si një interval i vlerave të bazuara në **skenarë** dhe në **politika** klime të ndryshme, duke përfshirë një skenar në pajtim me kufizimin e ndryshimit klimatik deri në 1.5°C.
- (b) japë si informacion shpjegues një zbërthim të vlerës së mbartur të aktiveve të saj afatgjata materiale (tokë, ndërtesa), duke përfshirë aktivet me të drejtë përdorimi, sipas klasave të rendimentit energjetik. Rendimenti energjetik do të paraqitet në terma ose të intervaleve

të konsumit në kWh/m<sup>2</sup> ose sipas klasave të energjisë EPC<sup>63</sup> (Certifikata e Performancës Energjetike, në anglisht Energy Performance Certificate).<sup>64</sup> Nëse njëسيا ekonomike nuk mund ta marrë këtë informacion, pavarësisht përpjekjeve të saj, ajo do të japë informacion shpjegues për vlerën kontabël (neto) totale të aktiveve afatgjata materiale (tokë, ndërtesa) për të cilat konsumi i energjisë bazohet në vlerësimet e brendshme.

(c) llogarisë pjesën (përqindjen) e aktiveve totale (përfshirë aktivet me qira financiare/ me të drejtë përdorimi) në rrezikun material të tranzicionit të trajtuar nga **veprimet për zbutjen e ndryshimit klimatik** bazuar në informacionin e paraqitur sipas Kërkesës për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-3. Shuma totale e aktiveve është vlerë kontabël (neto) në bilancin kontabël në datën e raportimit.

AR 74. Kur jep informacion shpjegues mbi detyrimet potenciale nga **rreziqet e tranzicionit** materiale të kërkuara sipas paragrafit 67, germa (d):

(a) njëسيا ekonomike që shfrytëzon **impiante** të rregulluara sipas një skeme për tregtimin e emetimeve (ETS) mund të përfshijë një interval për detyrimet potenciale të ardhshme që mund të lindin nga këto skema;

(b) njësitë ekonomike, subjekte të ETS të BE, mund të japin informacion shpjegues për detyrimet potenciale të ardhshme që lidhen me planet e tyre të shpërndarjes për periudhën para dhe deri në 2030. Detyrimi potencial mund të vlerësohet në bazë të:

i. numrit të kuotave të mbajtura nga njëسيا ekonomike në fillim të periudhës së raportimit;

ii. numrit të kuotave për t'u blerë në treg çdo vit, d.m.th., para dhe deri në 2030;

iii. hapësirës mes **emetimeve** të ardhshme të vlerësuara sipas **skenarëve** të ndryshëm të tranzicionit dhe shpërndarjeve të lira të kuotave që njihen për periudhën deri në 2030; dhe

iv. kostot vjetore të vlerësuara për tonë CO<sub>2</sub> për të cilat duhet të blihet një kuotë;

(c) kur vlerëson detyrimet potenciale të ardhshme të saj, njëسيا ekonomike mund të marrë në konsideratë dhe të japë informacion shpjegues për numrin e kuotave të emetimit GHG të Perimetrit 1 brenda skemave të rregulluara për tregtimin e emetimeve dhe numrin e akumuluar të kuotave të emetimit të magazinuar (nga kuotat e mëparshme) në fillim të periudhës së raportimit;

(d) njëسيا ekonomike që jep informacion shpjegues për vëllimet e **krediteve të karbonit** të planifikuara për t'u anuluar në të ardhmen e afërt (Kërkesa për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-7) mund të japë informacion shpjegues për detyrimet potenciale të ardhshme të lidhura me to, bazuar në marrëveshjet kontraktuale ekzistuese;

<sup>63</sup> Direktiva 2010/31/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 19 majit 2010 mbi performancën energjetike të ndërtesave (GZ L 153, 18.6.2010, f. 13).

<sup>64</sup> Kjo kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese përfshihet në pajtim me kërkesat në Rregulloren për Zbatim të Komisionit (BE) 2022/2453 për Formatin 2 pasuria e paluajtshme, rendimenti energjetik i garancisë.

(e) gjithashtu, njësia ekonomike mund të përfshijë **emetimet** GHG bruto të Perimetrit 1, 2 dhe emetimet GHG totale të saj, në vlerë monetare (të shprehura në njësi monetare) të llogaritura si vijon:

i. emetimet GHG të Perimetrit 1 dhe 2 në vlerë monetare në vitin e raportimit të ndjekur nga formula në vijim:

$$(a) \text{ (emetimet bruto GHG të Perimetrit 1 (t CO}_2\text{eq) + emetimet bruto GHG të Perimetrit 2 (t CO}_2\text{eq))} \times \text{koeficientin e kostos së emetimeve GHG} \left( \frac{\text{€}}{\text{t CO}_2\text{eq}} \right)$$

ii. emetimet GHG totale në vlerë monetare në vitin e raportimit të ndjekur nga formula në vijim:

$$(b) \text{ emetimet totale GHG (t CO}_2\text{eq)} \times \text{koeficientin e kostos së emetimeve GHG} \left( \frac{\text{€}}{\text{t CO}_2\text{eq}} \right)$$

iii. duke përdorur një raport kostosh të poshtëm, të mesit dhe të sipërm<sup>65</sup> për emetimet GHG (p.sh., çmimi i tregut i karbonit dhe vlerësime të ndryshme për kostot shoqërore të karbonit) dhe arsyet e zgjedhjes së tyre.

AR 75. Qasje dhe metodologji të tjera mund të përdoren për të vlerësuar sesi **rreziqet e tranzicionit** mund të ndikojnë pozicionin financiar të ardhshëm të njësisë ekonomike. Në çdo rast, dhënia e informacioneve shpjeguese mbi **efektet financiare të parashikuara** do të përfshijë një përshkrim të metodologjive dhe përkufizimeve të përdorura nga njësia ekonomike.

AR 76. Kur përgatit informacionin e kërkuar sipas paragrafit 67, germa (e), njësia ekonomike mund të vlerësojë dhe të japë informacion shpjegues për pjesën e të ardhurave (shitjeve) neto nga aktivitetet e biznesit në **rrezik të tranzicionit**. Kjo dhënie informacionesh shpjeguese:

(a) do të bazohet në shitjet neto në pajtim me kërkesat në standardet e kontabilitetit të përdorura për pasqyrat financiare, d.m.th., SNRF 15 ose PPPK lokale.

(b) mund të përfshijë një zberthim të aktiviteteve të biznesit të njësisë ekonomike me hollësitë përkatëse të përqindjeve të lidhura me shitjet neto aktuale, faktorët e rrezikut (ngjarjet dhe ekspozimi) dhe, kur është e mundur, **efektet financiare të parashikuara** të lidhura me pakësimin e marzhit në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë. Edhe natyra e aktiviteteve të biznesit mund të zberthehet sipas segmenteve të shfrytëzimit nëse njësia ekonomike ka dhënë informacion shpjegues për marzhin e kontributit sipas segmenteve të shfrytëzimit në raportimin e segmentit në pasqyrat financiare.

---

<sup>65</sup> Raporti i kostos është faktori që përdoret për të konvertuar ndikimet jo monetare si tonë, hektarë, m<sup>3</sup> etj. në njësi monetare. Raportet e kostos duhet të bazohen në studime të vlerësimit monetar, duhet të jenë mbi baza shkencore dhe metodat e përdorura për nxjerrjen e tyre duhet të jenë transparente. Udhëzime mbi këto metoda mund të merren p.sh., nga projekti TRANSPARENT, i financuar nga LIFE i BE.

Lidhja me informacionin financiar të raportuar

AR 77. Rakordimi i shumës kryesore të aktiveve, detyrimeve dhe të shitjeve neto (të cenueshme ose nga **rreziqet fizike** materiale ose nga **rreziqet e tranzicionit** materiale me nënzërat përkatës ose dhëniet e informacioneve shpjeguese (p.sh., në raportimin e segmentit) në pasqyrat financiare (siç kërkohet nga paragrafi 68) mund të paraqitet nga njësia ekonomike si vijon:

- (a) me një referencë të kryqëzuar me nënzërin përkatës apo dhënien e informacionit shpjegues në pasqyrat financiare, nëse këto shuma janë të identifikueshme në pasqyrat financiare; ose
- (b) nëse këto nuk mund të referohen drejtpërdrejt, si një rakordim sasior i secilit prej nënzërave përkatës ose dhënies së informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare duke përdorur formatin e tabelës më poshtë:

<b>Vlera kontabël (neto) e aktiveve ose detyrimeve ose e shitjeve neto të cenueshme nga rreziqet fizike materiale ose rreziqet e tranzicionit materiale</b>	
<b>Zërat rregullues</b>	
<b>Aktivet ose detyrimet ose shitjet neto në pasqyrat financiare</b>	

AR 78. Njësia ekonomike do të sigurojë koherencën e të dhënave dhe të supozimeve për të vlerësuar dhe raportuar **efektet financiare të parashikuara** nga **rreziqet fizike** materiale dhe nga **rreziqet e tranzicionit** materiale në deklaraten e qëndrueshmërisë me të dhënat dhe supozimet përkatëse të përdorura për pasqyrat financiare (p.sh., çmimet e karbonit të përdorura për të vlerësuar zhvlerësimin e aktiveve, jetën e dobishme të aktiveve, vlerësimet dhe provizionet). Njësia ekonomike do të shpjegojë arsyet për çdo mospërputhje (p.sh., nëse ndikimet e plota financiare të rreziqeve të lidhura me klimën janë ende në vlerësim ose nuk konsiderohen materiale në pasqyrat financiare).

AR 79. Për efektet potenciale të ardhshme në detyrimet (siç kërkohet nga paragrafi 67, germa (d), nëse është e zbatueshme, njësia ekonomike do të tregojë me referenca të kryqëzuara përshkrimin e skemës për tregtimin e emetimit në pasqyrat financiare.

Mundësitë e lidhura me qëndrueshmërinë

AR 80. Kur jep informacion shpjegues sipas paragrafit 69, germa (a), njësia ekonomike do të shpjegojë natyrën e kursimeve në kosto (p.sh., nga pakësimi i konsumit të energjisë), horizontet kohore dhe metodologjitë e përdorura, duke përfshirë objektin e vlerësimit, supozimet kryesore, kufizimet, si dhe nëse dhe si ishte zbatuar **analiza e skenarit**.

AR 81. Kur jep informacionin shpjegues të kërkuara sipas paragrafit 69, germa (a), njësia ekonomike do të shpjegojë sesi ka vlerësuar madhësinë e tregut ose çdo ndryshim të pritshëm të shitjeve

neto nga produktet dhe shërbimet me karbon të ulët, ose nga zgjidhjet e përshtatura duke përfshirë objektin e vlerësimit, horizontin kohor, supozimet kryesore, kufizimet, si dhe deri në çfarë mase ky treg është në dispozicion të njësisë ekonomike. Informacioni mbi madhësinë e tregut mund të paraqitet në perspektivë me të ardhurat aktuale sipas taksonomisë të publikuar sipas parashikimeve të Rregullores (BE) 2020/852. Gjithashtu, njësia ekonomike mund të shpjegojë sesi do të ndjekë **mundësitë** e saj të lidhura me klimën dhe, kur është e mundur, kjo duhet të lidhet me dhënien e informacioneve shpjeguese për **politikat, objektivat** dhe **veprimet** sipas Kërkesave për Dhënie informacionesh shpjeguese E1-2, E1-3 dhe E1-4.

## ESRS E2. NDOTJA

### Përmbajtja

<b>Objektivi .....</b>	<b>168</b>
<b>Ndërveprimi me standardet e tjera ESRS.....</b>	<b>169</b>
<b>Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese .....</b>	<b>170</b>
ESRS 2 Dhënie informacionesh shpjeguese të Përgjithshme .....	170
Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë .....	170
Kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese e lidhur me standardin ESRS 2 IRO-1 – Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me ndotjen .....	170
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E2-1 – Politikat e lidhura me ndotjen .....	171
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E2-2 – Veprimet dhe burimet e lidhura me ndotjen .....	171
Metrikat dhe objektivat .....	172
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E2-3 – Objektivat e lidhura me ndotjen.....	172
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E2-4 – Ndotja e ajrit, ujit dhe terrenit.....	173
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E2-5 – Substancat shqetësuese dhe substancat shumë shqetësuese.....	174
▶ <b>C1</b> Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E2-6 – Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me ndotjen ◀ .....	174

<b>Shtojca A. Kërkesat për Zbatim .....</b>	<b>176</b>
ESRS 2 Dhënie informacionesh shpjeguese të Përgjithshme .....	176
Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë .....	176
Kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese e lidhur me standardin ESRS 2 IRO-1 – Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me ndotjen.....	176
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E2-1 – Politikat e lidhura me ndotjen .....	178
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E2-2 – Veprimet dhe burimet e lidhura me ndotjen .....	178
Metrikat dhe objektivat .....	179
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E2-3 – Objektivat e lidhura me ndotjen.....	179
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E2-4 – Ndotja e ajrit, ujit dhe terrenit.....	179
Metodologjitë .....	181
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E2-5 – Substancat shqetësuese dhe substancat shumë shqetësuese.....	181
Lista e substancave për t’u marrë në konsideratë.....	181
Informacioni kontekstual .....	182
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E2-6 – Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me ndotjen .....	182

## Objektivi

1. Objektivi i këtij Standardi është të specifikojë Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese që do t’u mundësojnë përdoruesve të **deklaratës së qëndrueshmërisë** të kuptojnë:
  - (a) sesi njësia ekonomike ndikon **ndotjen** e ajrit, ujit dhe **terrenit**, në terma të **ndikimeve** materiale, pozitive dhe negative, aktuale dhe potenciale;
  - (b) çdo **veprim** të ndërmarrë dhe rezultatin e veprimeve të tilla për të parandaluar ose zbutur ndikimet negative aktuale ose potenciale, si dhe për të trajtuar **rreziqet** dhe **mundësitë**;

- (c) planet dhe kapacitetin e njësisë ekonomike për të përshtatur **strategjinë** dhe **modelin e saj të biznesit**, në linjë me tranzicionin drejt një ekonomie të qëndrueshme dhe me nevojën për të parandaluar, kontrolluar dhe eliminuar ndotjen. Objektivi është të krijohet një mjedis i lirë nga toksinat dhe me zero ndotje në mbështetje të Plan Veprimit të BE “Drejt një Ndotjeje Zero të Ajrit, Ujit dhe Terrenit”;
- (d) natyrën, llojin dhe madhësinë e rreziqeve dhe mundësive materiale të njësisë ekonomike të lidhura me ndikimet dhe **varësitë** e lidhura me ndotjen të njësisë ekonomike, si dhe parandalimin, kontrollin, eliminimin ose pakësimin e ndotjes, duke përfshirë nëse kjo vjen nga zbatimi i rregulloreve dhe si e menaxhon këtë njësia ekonomike; dhe
- (e) **efektet financiare** në njësinë ekonomike në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, të rreziqeve dhe mundësive që vijnë nga ndikimet dhe varësitë e njësisë ekonomike të lidhura me ndotjen.
2. Ky Standard paraqet Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese të lidhura me **çështjet e qëndrueshmërisë** në vijim: **ndotja** e ajrit, ujit, **terrenit,substancat shqetësuese**, përfshirë **substancat shumë shqetësuese**.
  3. “**Ndotja** e ajrit” i referohet **emetimeve** të njësisë ekonomike në ajër (si brenda dhe jashtë), dhe parandalimit, kontrollit dhe pakësimit të emetimeve të tilla.
  4. “**Ndotja** e ujit” i referohet **emetimeve** të njësisë ekonomike në ujë dhe parandalimit, kontrollit dhe pakësimit të emetimeve të tilla.
  5. “**Ndotja e terrenit**” i referohet **emetimeve** të njësisë ekonomike në terren dhe parandalimit, kontrollit dhe pakësimit të emetimeve të tilla.
  6. Lidhur me “**substancat shqetësuese**”, ky standard mbulon prodhimin, përdorimin dhe/ose shpërndarjen dhe tregtimin nga njësia ekonomike të substancave shqetësuese, përfshirë **substancat shumë shqetësuese**. Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese mbi substancat shqetësuese synojnë të lejojnë përdoruesit të kuptojnë ndikimet aktuale ose potenciale të lidhura me substanca të tilla, duke marrë në konsideratë edhe kufizimet e mundshme lidhur me përdorimin dhe/ose shpërndarjen dhe tregtimin e tyre.

## Ndërveprimi me standardet e tjera ESRS

7. Tema e **ndotjes** është e lidhur ngushtë me nëntemat e tjera të mjedisit si ndryshimi klimatik, **burimet** ujore dhe **detare, biodiversiteti** dhe **ekonomia qarkulluese**. Prandaj, për të siguruar një paraqitje të plotë se çfarë mund të jetë materiale për ndotjen, Kërkesat kryesore për Dhënie informacionesh shpjeguese mbulohen në Standardet e tjera të mjedisit si vijon:
  - (a) ESRS E1 *Ndryshimi klimatik* që trajton shtatë **gazrat me efekt serrë** në vijim, të lidhur me ndotjen e ajrit: dyoksidi i karbonit (CO<sub>2</sub>), metani (CH<sub>4</sub>), oksidi i azotit (N<sub>2</sub>O),

hidrofluorokarbonet (HFCs), perfluorokarbonet (PFCs), heksafluoridi i squfurit (SF6) dhe trifluoridi i azotit (NF3).

- (b) ESRS E3 *Burimet ujore dhe detare* që trajton **konsumin e ujit**, në veçanti në **zonat me rrezik për ujin, riciklimi** dhe magazinimi i ujit. Gjithashtu, ky standard përfshin menaxhimin e përgjegjshëm të burimeve detare, përfshirë natyrën dhe sasinë e lëndëve të para të lidhura me burimet detare (të tilla si zhavorret, mineralet në thellësi të detit, prodhimet ushqimore të detit) të përdorura nga njësia ekonomike. Ky Standard mbulon ndikimet negative, në lidhje me ndotjen e burimeve ujore dhe detare, duke përfshirë mikroplastikat e prodhuara nga aktivitete të tilla.
  - (c) ESRS 4 Biodiversiteti *dhe ekosistemet* që trajton **ekosistemet** dhe speciet. Ndotja si një faktor i drejtpërdrejtë i ndikimit në **humbjen e biodiversitetit** trajtohet nga ky Standard.
  - (d) ESRS 5 *Përdorimi i burimeve dhe ekonomia qarkulluese* që trajton, në veçanti, tranzicionin larg nxjerrjes nga burime jo të rinovueshme dhe vënien në zbatim të praktikave që parandalojnë prodhimin e **mbetjeve**, duke përfshirë ndotjen e krijuar nga mbetjet.
8. Ndikimet e njësisë ekonomike të lidhura me **ndotjen** mund të ndikojnë njerëzit dhe komunitetet. Ndikimet negative materiale mbi **komunitetet e ndikuara** nga ndikimet e lidhura me ndotjen që i takojnë njësisë ekonomike mbulohen në ESRS S3 *Komunitetet e ndikuara*.
9. Ky Standard duhet të lexohet së bashku me standardin ESRS 1 *Kërkesat e përgjithshme* dhe standardin ESRS 2 *Dhënie informacionesh shpjeguese të Përgjithshme*.

## Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese

### ESRS 2 Dhënie informacionesh shpjeguese të Përgjithshme

10. Kërkesat e këtij seksioni duhet të lexohen dhe të raportohen bashkë me dhënien e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga ESRS 2, kapitulli 4 *Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë*.

### Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë

*Kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese e lidhur me standardin ESRS 2 IRO-1 – Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me ndotjen*

11. Njësia ekonomike do të përshkruajë procesin për të identifikuar **ndikimet, rreziqet** dhe **mundësitë** materiale dhe do të japë informacion:

- (a) nëse njësia ekonomike ka analizuar **vendndodhjet** e saj dhe aktivitetet e biznesit për të identifikuar **ndikimet, rreziqet** dhe **mundësitë** e saj, aktuale dhe potenciale, të lidhura me **ndotjen** në veprimtarinë e saj dhe në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të saj të vlerës** dhe nëse e ka bërë këtë, metodologjitë, supozimet dhe mjetet e përdorura në analizë;
- (b) nëse dhe si njësia ekonomike ka realizuar konsultimet, veçanërisht me komunitetet e ndikuara.

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E2-1 – Politikat e lidhura me ndotjen*

- 12. Njësia ekonomike do të përshkruajë politikat e saj të përdorura për të menaxhuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të saj të lidhura me parandalimin dhe kontrollin e ndotjes.
- 13. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese është që të lejojë kuptimin e madhësisë në të cilën njësia ekonomike disponon **politika** që trajtojnë identifikimin, vlerësimin, menaxhimin dhe/ose **korrigjimin** e **ndikimeve, rreziqeve** dhe **mundësive** materiale të lidhura me ndotjen.
- 14. Dhënia e informacioneve shpjeguese e kërkuar nga paragrafi 12 do të përmbajë informacionin mbi **politikat** që disponon njësia ekonomike për të menaxhuar **ndikimet, rreziqet** dhe **mundësitë** e lidhura me **ndotjen** në përputhje me ESRS 2 MDR-P *Politikat e përdorura për të menaxhuar çështjet materiale të qëndrueshmërisë*.
- 15. Njësia ekonomike do të tregojë, në lidhje me veprimtarinë e vet dhe rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të vlerës**, nëse dhe si **politikat** e saj trajtojnë fushat (çështjet) në vijim kur ato janë materiale:
  - (a) zbutja e **ndikimeve** negative të lidhura me **ndotjen** e ajrit, ujit dhe **terrenit** duke përfshirë parandalimin dhe kontrollin;
  - (b) zëvendësimi dhe minimizimi i përdorimit të **substancave shqetësuese** dhe largimi (mospërdorimi) gradual i **substancave shumë shqetësuese**, veçanërisht për përdorimin shoqëror jo thelbësor dhe në produktet e **konsumit**; dhe
  - (c) shmangia e **incidenteve** dhe situatave urgjente, si dhe nëse dhe kur ato ndodhin, kontrolli dhe kufizimi i ndikimit të tyre mbi njerëzit dhe mjedisin.

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E2-2 – Veprimet dhe burimet e lidhura me ndotjen*

- 16. Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për veprimet e saj të lidhura me ndotjen, si dhe burimet e caktuara për zbatimin e tyre.
- 17. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese është që të lejojë kuptimin e veprimeve kryesore të ndërmarra dhe të planifikuara për të arritur objektivat e **politikave** dhe **synimet (objektivat)** e lidhura me **ndotjen**.

18. Përshkrimi i planeve të veprimit dhe i burimeve të lidhura me ndotjen do të përmbajë informacionin e parashikuar në ESRS 2 MDR-A Veprimet dhe burimet në lidhje me çështjet materiale të qëndrueshmërisë.
19. Përveç ESRS 2 MDR-A, njësia ekonomike mund të specifikojë se në cilin nivel të hierarkisë në vijim të masave zbutëse është e përshtatshme të caktohet një veprim dhe burimet:
  - (a) shmangia e **ndotjes** duke përfshirë çdo mospërdorim gradual të materialeve ose përbërësve që kanë një ndikim negativ (parandalimi i ndotjes në burim);
  - (b) pakësimi i ndotjes duke përfshirë: çdo mospërdorim gradual të materialeve ose përbërësve; respektimin e kërkesave rregullatore të tilla si kërkesat për **Teknikat më të Mira në Dispozicion (BAT)**; ose respektimi i kriterit **Mos Bëj Dëm të Rëndësishëm** për parandalimin e ndotjes dhe kontrollin sipas Rregullores së Taksonomisë të BE dhe Akteve të Deleguara të tij (minimizimi i ndotjes); dhe
  - (c) restaurimi, rigjenerimi dhe transformimi i **ekosistemeve** nëse ka ndodhur ndotja (kontrolli i ndikimeve nga aktivitetet e rregullta dhe **incidenteve**).

## Metrikat dhe objektivat

### *Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E2-3 – Objektivat e lidhura me ndotjen*

20. Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për objektivat që ka vendosur lidhur me ndotjen.
21. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese është që të lejojë të kuptohen **objektivat** që ka vendosur njësia ekonomike për të mbështetur **politikat** e saj për **ndotjen** dhe për të trajtuar **ndikimet, rreziqet** dhe **mundësitë** materiale të lidhura me ndotjen.
22. Përshkrimi i **objektivave** do të përmbajë informacionin e kërkuar në ESRS 2 MDR-T *Gjurmimi i efektivitetit të politikave dhe veprimeve përmes objektivave*.
23. Dhënia e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga paragrafi 20 do të tregojë nëse dhe si **objektivat** lidhen me parandalimin dhe kontrollin e:
  - (a) ndotësve të ajrit dhe **ngarkesat specifike** përkatëse;
  - (b) **emetimet** në ujë dhe ngarkesat specifike përkatëse;
  - (c) **ndotjet e terrenit** dhe ngarkesat specifike përkatëse; dhe
  - (d) **substancat shqetësuese** dhe **substancat shumë shqetësuese**.
24. Përveç ESRS 2 MDR-T, njësia ekonomike mund të specifikojë nëse janë marrë në konsideratë **pragjet ekologjike** (p.sh., **integriteti i biosferës (oqeanit)**, shkatërrimi i ozonit të stratosferës, ngarkesa në aerosolin atmosferik, shkatërrimi i terrenit, acidifikimi i oqeanit) dhe attribute specifike të njësisë ekonomike. Nëse po, njësia ekonomike mund të specifikojë:

- (a) **pragjet ekologjike** të identifikuar dhe metodologjinë e përdorur për të identifikuar këto pragje;
  - (b) nëse pragjet janë ose jo specifike për njësinë ekonomike dhe në rast se po, si janë përcaktuar ata; dhe
  - (c) sa përgjegjësi lidhur me respektimin e pragjeve ekologjike të identifikuar i takon njësisë ekonomike.
25. Njësia ekonomike do të specifikojë si pjesë e informacionit kontekstual, nëse **objektivat** që ka vendosur dhe paraqitur janë të detyrueshëm (kërkohen nga legjislacioni) apo vullnetarë.

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E2-4 – Ndotja e ajrit, ujit dhe terrenit*

26. **Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues mbi ndotësit që ajo emeton përmes veprimtarisë së saj, si dhe për mikroplastikat që prodhon apo përdor.**
27. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese është të lejojë që të kuptohen **emetimet** që njësia ekonomike gjeneron në ajër, ujë dhe **terren** nga veprimtaria e vet dhe nga prodhimi dhe përdorimi i mikroplastikave.
28. Njësia ekonomike do të japë si informacion shpjegues shumat e:
- (a) çdo ndotësi të renditur në Aneksin II të Rregullores (KE) Nr 166/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit<sup>66</sup> (Regjistri Evropian i Ndotësve të Emetuar dhe të Transferuar - në anglisht -European Pollutant Release and Transfer Register “E-PRTR Regulation”) të emetuar në ajër, ujë dhe terren, me përjashtim të emetimeve **GHG** që janë publikuar në përputhje me ESRS E1 *Ndryshimi Klimatik*;<sup>67</sup>
  - (b) mikroplastikat e prodhuara ose të përdorura nga njësia ekonomike.
29. Shumat e referuara në paragrafin 28 do të jenë shuma të konsoliduara që përfshijnë emetimet nga impiantet mbi të cilat njësia ekonomike ka kontroll financiar dhe nga impiante mbi të cilat ajo ushtron kontroll të veprimtarisë. Konsolidimi do të përfshijë vetëm emetimet nga impiantet për të cilat tejkalohe vlerat prag të zbatueshme, të cilësuar në Aneksin II të Rregullores (KE) Nr. 166/2006.
30. Njësia ekonomike do të vendosë dhënien e informacioneve shpjeguese në kontekst dhe do të përshkruajë:
- (a) ndryshimet në kohë;

<sup>66</sup> Rregullorja (BE) Nr 166/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 18 janarit 2006 mbi krijimin e Regjistrit Evropian të Ndotësve të Emetuar dhe të Transferuar dhe ndryshimin e Direktivave të Këshillit 91/689/KEE dhe 96/61/KE (GZ L 033, 4.2.2006, f. 1).

<sup>67</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve të tregut financiar objekt të Rregullores (BE) 2019/2088 sepse vjen nga: (a) një tregues shtesë i lidhur me ndikimet negative kryesore siç paraqitet në treguesin #2 në Tabelën II të Aneksit I, të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese për investimet e qëndrueshme (“Emetimet e ndotësve të ajrit”). (b) treguesi #8 në Tabelën I të Aneksit I (“Emetimet në ujë”); (c) treguesi #1 në Tabelën II të Aneksit I (“Emetimet e ndotësve inorganikë”); dhe (d) treguesi #3 në Tabelën II të Aneksit I (“Emetimet e substancave që shkatërrojnë ozonin”).

(b) metodologjitë e matjes; dhe

(c) procesin(et) e mbledhjes së të dhënave për trajtimin kontabël dhe raportimin lidhur me **ndotjen**, duke përfshirë llojin e të dhënave të nevojshme dhe burimet e informacionit.

31. Kur zgjidhet një metodologji inferiore krahasuar me matjen e drejtpërdrejtë të **emetimeve** për të përcaktuar nga ana sasiore emetimet, do të publikohen edhe arsyet për zgjedhjen e kësaj metodologjie inferiore. Nëse njësia ekonomike përdor vlerësime, ajo do të japë informacion shpjegues për standardin, studimin e sektorit ose burimin që përbën bazën e vlerësimeve të saj, si dhe shkallën e mundshme të pasigurisë dhe intervalin e vlerësimeve që reflektojnë pasigurinë e matjes.

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E2-5 – Substancat shqetësuese dhe substancat shumë shqetësuese*

32. **Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për prodhimin, përdorimin, shpërndarjen, tregtimin dhe import/eksportin e substancave shqetësuese dhe të substancave shumë shqetësuese, si në gjendjen e tyre të pastër ose si pjesë në përzierje apo në artikuj (produkte).**
33. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese është të lehtësojë kuptimin e ndikimit të njësisë ekonomike në shëndet dhe në mjedis përmes vetëm **substancave shqetësuese** dhe përmes vetëm **substancave shumë shqetësuese**. Gjithashtu, ai synon të lehtësojë kuptimin e rreziqeve dhe **mundësive** materiale të njësisë ekonomike, duke përfshirë ekspozimin ndaj këtyre substancave dhe rreziqeve që vijnë nga ndryshimet në kuadrin rregullator.
34. Dhënia e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga paragrafi 32 do të përfshijë shumat totale të **substancave shqetësuese** që gjenerohen ose përdoren gjatë prodhimit ose që janë blerë, si dhe shumat totale të substancave shqetësuese që largohen nga impiantet si emetime, si produkte, ose si pjesë e produkteve apo shërbimeve të ndara në klasa kryesore rreziku të substancave shqetësuese.
35. Njësia ekonomike do të paraqesë veçmas informacionin për **substancat shumë shqetësuese**.

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E2-6 – Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me ndotjen*

36. **Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për efektet financiare të parashikuara nga rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me ndotjen**
37. Informacioni i kërkuar nga paragrafi 36 i shtohet informacionit mbi efektet financiare aktuale në pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset monetare të njësisë ekonomike, për periudhën e raportimit të kërkuar sipas ESRS 2 SBM-3, paragrafi 48, germa (d).

38. Objektivi i kësaj Kërkese për Dhënie informacionesh shpjeguese është të lejojë kuptimin e:
- (a) ► **C1 efekteve financiare të parashikuara** për shkak të rreziqeve materiale që vijnë nga ndikimet dhe **varësitë** e lidhura me **ndotjen** dhe sesi këto rreziqe kanë (ose mund të kenë në mënyrë të arsyeshme) një ndikim material në pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset monetare të njësisë ekonomike, në një periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë. ◀
  - (b) **efekteve financiare të parashikuara** për shkak të **mundësive** materiale të lidhura me parandalimin dhe kontrollin e **ndotjes**.
39. Dhënia e informacioneve shpjeguese do të përfshijë:
- (a) një përcaktim sasior të **efekteve financiare të parashikuara** në njësi monetare para se të merren në konsideratë veprime lidhur me ndotjen, ose nëse nuk është e mundur pa kosto apo përpjekje të papërshtatshme, informacion cilësor. Nuk kërkohet një përqasje sasiore e **efekteve financiare** që vijnë nga **mundësitë** nëse kjo dhënie informacionesh shpjeguese nuk plotëson karakteristikat cilësore të informacionit (shih Shtojcën B të ESRS 1 *Karakteristikat cilësore të informacionit*);
  - (b) një përshkrim të efekteve të marra në konsideratë, lidhur me ndikimet dhe horizontet kohore në të cilat ka mundësi të materializohen; dhe
  - (c) supozimet kryesore të përdorura për të përcaktuar nga ana sasiore **efektet financiare të parashikuara**, si dhe burimet dhe nivelin e pasigurisë së atyre supozimeve.
40. ► **C1** Informacioni që kërkohet nga paragrafi 39, germa (a) do të përfshijë: ◀
- (a) Pjesën e të ardhurave (shitjeve) neto të realizuar nga produktet dhe shërbimet që janë ose përmbajnë **substancia shqetësuese**, si dhe pjesën e të ardhurave (shitjeve) neto të realizuar nga produktet dhe shërbimet që janë ose përmbajnë **substancia shumë shqetësuese**;
  - (b) shpenzimet e shfrytëzimit dhe shpenzimet kapitale të ndodhura gjatë periudhës së raportimit në lidhje me **incidentet** dhe **depozitimet** kryesore;
  - (c) parashikimet për mbrojtjen mjedisore dhe kostot e **korrigjimit**, p.sh., për rehabilitimin e **vendeve** të ndotura, rikultivimin e vendeve të grumbullimit të plehrave (landfilleve), heqjen e ndotjes mjedisore në vendin ekzistues të prodhimit ose të magazinimit dhe masa të ngjashme.
41. Njësia ekonomike do të japë si informacion shpjegues çdo informacion kontekstual të rëndësishëm duke përfshirë një përshkrim të **incidenteve** dhe **depozitimeve** materiale, si rezultat i të cilave **ndotja** ka pasur ndikime negative në mjedis dhe/ose pritet të ketë ndikime negative në flukset monetare, në pozicionin financiar dhe në performancën financiare të njësisë ekonomike në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

## Shtojca A. Kërkesat për Zbatim

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e ESRS E2. Ajo mbështet zbatimin e kërkesave për dhënie informacionesh shpjeguese të paraqitura në këtë standard dhe ka të njëjtin autoritet si dhe pjesët e tjera të Standardit.

### ESRS 2 Dhënie informacionesh shpjeguese të Përgjithshme

*Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë*

Kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese e lidhur me standardin ESRS 2 IRO-1 – Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me ndotjen

- AR 1. Kur bën një vlerësim të **materialitetit** mbi nëntema të mjedisit, njësia ekonomike do të vlerësojë materialitetin e ndotjes në veprimtarinë e saj dhe në pjesën e sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të saj të vlerës**, si dhe mund të marrë në konsideratë katër fazat në vijim të njohura edhe si qasja LEAP:
- (a) Faza 1: lokalizohet se ku shfaqet ndërlidhja e veprimtarisë së vet dhe rrjedhës së sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të saj të vlerës** me natyrën;
  - (b) Faza 2: vlerësohen **varësitë** dhe ndikimet e lidhura me **ndotjen**;
  - (c) Faza 3: vlerësohen **rreziqet** dhe **mundësitë** materiale; dhe
  - (d) Faza 4: përgatiten dhe raportohen rezultatet e vlerësimit të materialitetit.
- AR 2. Vlerësimi i **materialitetit** për ESRS E2 përkon me tri fazat e para të kësaj qasjeje LEAP. Faza e katërt trajton rezultatin e procesit.
- AR 3. Procesi i vlerësimit të **materialitetit** të **ndikimeve, të varësive, të rreziqeve** dhe **të mundësive**, do të marrë në konsideratë parashikimet në ESRS 2 IRO-1 *Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale*, si dhe IRO-2 *Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese në ESRS të mbuluara nga deklaratat e qëndrueshmërisë e njësisë ekonomike*.
- AR 4. Nëntemat e mbuluara nga vlerësimi i **materialitetit** sipas ESRS E2 përfshijnë:
- (a) **ndotjen** e ajrit, ujit dhe të **terrenit** (duke përfshirë **emetimet** GHG dhe **mbetjet**), mikroplastikat dhe **substancat shqetësuese**;
  - (b) **Varësitë** nga **shërbimet e ekosistemit** që ndihmojnë të zbuten ndikimet e lidhura me ndotjen.

AR 5. Në Fazën 1, për të lokalizuar se ku shfaqet ndërlidhja e veprimtarisë së vet dhe rrjedhës së sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të saj të vlerës** me natyrën, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë:

- (a) **vendndodhjen** e aktiveve dhe veprimtarisë së drejtpërdrejtë si dhe aktivitetet e lidhura me rrjedhën e sipërme dhe të poshtme përmes zinxhirit të vlerës;
- (b) vendndodhjen ku ndodhin **emetimet** e ndotësve të ujit, të **terrenit** dhe të ajrit; dhe
- (c) sektorët ose njësitë e biznesit të lidhura me ato emetime ose me prodhimin, përdorimin, shpërndarjen, tregtimin dhe import/eksportin e mikroplastikave, **të substancave shqetësuese** dhe **të substancave shumë shqetësuese**, në pjesë të caktuara, bashkë me të tjera ose në paragrafë (artikuj/nene).

AR 6. Faza 2 lidhet me vlerësimin e ndikimeve dhe **varësive** të njësisë ekonomike për secilën **vendndodhje** materiale ose sektor/njësi biznesi duke përfshirë vlerësimin e ashpërsisë dhe mundësisë së ndodhjes së ndikimeve në mjedis dhe shëndetin e njerëzve.

AR 7. Në Fazën 3, për të vlerësuar **rreziqet** dhe **mundësitë** materiale të saj bazuar në Fazat 1 dhe 2, njësia ekonomike mund të:

- (a) identifikojë **rreziqet e tranzicionit** dhe **mundësitë** në veprimtarinë e vet dhe në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të saj të vlerës** sipas kategorive:
  - i. **politika** dhe ligji: p.sh., hyrja në fuqi e rregulloreve, ekspozimi ndaj sanksioneve dhe konflikteve (p.sh., neglizhenca ndaj **ekosistemeve**) detyrime shtesë për raportimin;
  - ii. teknologjia: p.sh., zëvendësimi i produkteve ose shërbimeve me produkte ose shërbime me ndikim më të ulët, tranzicioni drejt braktisjes së **substancave shqetësuese**;
  - iii. tregu: p.sh., zhvendosja e ofertës, e kërkesës dhe e financimit, paqëndrueshmëri dhe kosto shtesë për disa substanca; dhe
  - iv. prestigji: p.sh., ndryshimet në perceptimet shoqërore, të klientëve ose të komunitetit si pasojë e rolit të një organizate në parandalimin dhe kontrollin e **ndotjes**;
- (b) identifikojë rreziqet fizike, p.sh., ndërprerja e papritur e mundësisë së përdorimit të ujit të pastër, shiu acid, ose **incidente** të tjera ndotëse që kanë mundësi të sjellin ose kanë sjellë ndotjen me efekte të mëpasshme në mjedis dhe shoqëri;
- (c) identifikojë mundësitë e lidhura me parandalimin dhe kontrollin e ndotjes të klasifikuara sipas:
  - i. rendimentit të burimit: pakësimi i sasisë së substancave të përdorura ose përmirësimi i rendimentit të procesit të prodhimit për të minimizuar ndikimet;
  - ii. tregut: p.sh., diversifikimi i aktiviteteve të biznesit;
  - iii. financimit: p.sh., mundësia e përdorimit të fondeve, obligacioneve ose huave të gjelbra (të lidhura me mjedisin);

- iv. rezistencës: p.sh., diversifikimi i substancave të përdorura dhe kontrolli i emetimeve përmes rjësive ose teknologjisë; dhe
- v. prestigji: marrëdhëniet pozitive me **palët e interesuara** si pasojë e një qëndrimi të kujdesshëm ndaj menaxhimit të rreziqeve.

AR 8. Me qëllim vlerësimin e **materialitetit**, njësia ekonomike mund të marrë në konsideratë Rekomandimin e Komisionit (BE) 2021/2279 mbi përdorimin e metodave të Gjurmës në Mjedis për matjen dhe komunikimin e performancës mjedisore gjatë jetës së produkteve dhe organizatave.

AR 9. Kur jep informacionin mbi rezultatin e vlerësimit të saj të **materialitetit**, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë:

- (a) një listë të **vendndodhjeve** ku **ndotja** është çështje materiale për veprimtarinë e vet të njësisë ekonomike dhe rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës; dhe
- (b) një listë të aktiviteteve të biznesit të lidhura me ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me ndotjen.

#### Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E2-1 – Politikat e lidhura me ndotjen

AR 10. **Politikat** e përshkruara sipas kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese mund të përfshihen në politikat më të gjera mjedisore ose për qëndrueshmërinë që mbulojnë në nëntema të ndryshme.

AR 11. Përshkrimi i **politikave** do të përfshijë informacionin mbi **ndotësin (it)** ose **substancën(at)** e mbuluar.

AR 12. ► **C1** Kur jep informacionin shpjegues sipas paragrafit 12, njësia ekonomike mund të përfshijë informacion kontekstual për marrëdhëniet mes politikave të saj të zbatuara dhe se si ato mund të kontribuojnë në Planin e Veprimit të BE “Drejt një Ndotjeje Zero të Ajrit, Ujit dhe Terrenit”, veçanërisht: ◀

- (a) se si është ndikuar ose mund të ndikohet nga **objektivat** dhe masat e Planit të Veprimit të BE, si dhe rishikimi i direktivave ekzistuese (p.sh., Direktiva e Emetimeve Industriale);
- (b) se si synon të pakësojë gjurmën e saj të **ndotjes** për të kontribuar në këto objektiva.

#### Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E2-2 – Veprimet dhe burimet e lidhura me ndotjen

AR 13. Nëse **veprimet** lidhen me angazhime në rrjedhën e sipërme ose të poshtme të **zinxhirit të vlerës**, njësia ekonomike do të japë informacion për tipin e veprimeve që reflektojnë këto angazhime.

- AR 14. Kur merr në konsideratë burimet, shembuj të shpenzimeve të shfrytëzimit mund të jenë investimet në kërkim dhe zhvillim për të rinovuar dhe zhvilluar alternativa të sigurta dhe të qëndrueshme kundrejt përdorimit të substancave shqetësuese ose për të pakësuar **emetimet** në një proces prodhimi.
- AR 15. Nëse është e rëndësishme për të arritur synimet dhe **objektivat** e **politikës** së saj të lidhura me **ndotjen**, njësi ekonomike mund të sigurojë informacion në nivel **vendndodhjeje** të planeve të veprimit.

#### *Metrikat dhe objektivat*

##### Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E2-3 – Objektivat e lidhura me ndotjen

- AR 16. Nëse njësi ekonomike i referohet **pragjeve ekologjike** kur vendos **objektivat**, ajo mund të përdorë udhëzuesin e Nismës për Objektiva të Bazuar në Shkencë (SBTN) në udhëzuesin paraprak (Udhëzuesi Fillestar për Bizneset, shtator 2020), ose çdo udhëzues tjetër me një metodologji të njohur shkencore që lejon vendosjen e objektivave të bazuar në shkencë duke identifikuar pragje ekologjike dhe, nëse është e zbatueshme,tribute specifike për njësinë ekonomike. Pragjet ekologjike mund të jenë lokale, kombëtare dhe/ose globale.
- AR 17. Njësi ekonomike mund të specifikojë nëse **objektivi** trajton mungesat e lidhura me kriterin e Kontributit Thelbësor për Parandalimin dhe Kontrollin e Ndotjes siç përkufizohet në aktet e deleguara të përdorura në zbatim të nenit 14, pika (2) të Rregullores (BE) 2020/852. Nëse nuk plotësohet kriteri “Mos Bëj Dëm të Rëndësishëm” (DNSH) për Parandalimin dhe Kontrollin e ndotjes siç përkufizohet në aktet e deleguara në zbatim të nenit 10, pika (3), nenit 11, pika (3), nenit 12, pika (2), nenit 13, pika (2) dhe nenit 15, pika (2) të Rregullores (BE) 2020/852, njësi ekonomike mund të specifikojë nëse objektivi trajton mungesat e lidhura me këtë kriter (DNSH).
- AR 18. Nëse është e rëndësishme për të mbështetur **politikat** që ka përdorur njësi ekonomike, ajo mund të japë informacion për **objektivat** e vendosur në nivel **vendndodhjeje**.
- AR 19. **Objektivat** mund të mbulojnë veprimtarinë e vet të njësisë ekonomike dhe/ose të zinxhirit të saj të vlerës.

##### Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E2-4 – Ndotja e ajrit, ujit dhe terrenit

- AR 20. Informacioni për t’u dhënë lidhur me mikroplastikat sipas paragrafit 28, germa (b), do të përfshijë mikroplastikat që janë gjeneruar ose përdorur gjatë procesit të prodhimit ose që janë blerë, si dhe që lënë impiantet e njësisë ekonomike si emetime, si produkte, ose si pjesë e produkteve ose e shërbimeve. Mikroplastikat mund të jenë prodhuar në mënyrë të paqëllimshme kur pjesë të mëdha plastike si gomat e makinave ose tekstilet sintetike vjetrohen nga përdorimi ose mund të prodhohen në mënyrë të qëllimshme dhe të shtohen

tek produktet për qëllime specifike (p.sh., grimcat e forta në produktet e pastrimit të fytyrës ose të trupit).

- AR 21. Masa e **ndotësve** do të paraqitet në njësi të përshtatshme matjeje, për shembull në tonë ose në kilogramë.
- AR 22. Informacioni i kërkuar sipas kësaj Kërkese për Dhënie informacionesh shpjeguese do të jepet në nivelin e raportimit të njësisë ekonomike. Megjithatë, njësia ekonomike mund të japë si informacion shpjegues hollësi shtesë, duke përfshirë informacion në nivel të **vendndodhjes** ose një zbrërthim të **emetimeve** të saj sipas llojit të burimit, sipas sektorit ose sipas zonës gjeografike.
- AR 23. Kur jep informacion kontekstual mbi emetimet, njësia ekonomike mund të marrë në konsideratë:
- (a) treguesit lokalë të cilësisë së ajrit (AQI) për zonën ku ndodh **ndotja** e ajrit të njësisë ekonomike;
  - (b) shkallën e urbanizimit (DEGURBA)<sup>68</sup> për zonën ku ndodh ndotja e ajrit; dhe
  - (c) përqindjen e **emetimeve** totale të **ndotësve** të ujit dhe të **terrenit** të njësisë ekonomike që ndodhin në zonat me rrezik për ujin, përfshirë zonat me stres të lartë nga uji.
- AR 24. Informacioni i dhënë sipas kësaj Kërkese për Dhënie informacionesh shpjeguese mund t'i referohet informacionit që njësia ekonomike tashmë duhet të raportojë sipas legjislacionit tjetër ekzistues (d.m.th., IED, E- PRTR, etj.).
- AR 25. Nëse aktivitetet e njësisë ekonomike janë objekt i Direktivës 2010/75/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillimit mbi emetimet industriale (IED)<sup>69</sup> dhe Dokumentet përkatëse të Referencës së Teknikave më të Mira në Dispozicion (në anglisht -Best Available Techniques Reference Documents) (**BREFs**), pavarësisht nëse aktiviteti zhvillohet ose jo brenda Bashkimit Evropian, njësia ekonomike mund të japë si informacion shpjegues shtesë sa vijon:
- (a) një listë e **impianteve** që shfrytëzon njësia ekonomike dhe që janë objekt i **Konkluzioneve BAT** të IED dhe BE;
  - (b) një listë e **incidenteve** të papajtueshmërisë ose të **veprimeve** të detyruara, të nevojshme për të siguruar pajtueshmërinë në rast të shkeljeve të kushteve të lejuara;
  - (c) performancën aktuale, siç specifikohet në **konkluzionet BAT** të BE për **impiantet** industriale dhe krahasimin e performancës mjedisore të njësisë ekonomike ndaj “niveleve të emetimit të lidhura me teknikat më të mira në dispozicion” të (**BAT-AEL**) siç përshkruhet në konkluzionet BAT të BE;

---

<sup>68</sup> Sipas Eurostat, Shkalla e urbanizimit (DEGURBA) është një klasifikim që tregon karakterin e një zone. Bazuar në pjesën e popullsisë lokale që jeton në ndarjet dhe qendrat urbane, ai klasifikon Njësitë Lokale Administrative (LAU ose komunitat) në tre tipe zonash: 1) Qytete (zona me denduri të lartë popullore), ii) Qyteza dhe periferi (zona me denduri mesatare të popullsisë) dhe iii) Zona rurale (zona me denduri të ulët të popullsisë).

<sup>69</sup> Direktiva 2010/75/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 24 nëntorit 2010 mbi emetimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes) (GZ L 334, 17.12.2010, f. 17).

- (d) performancën aktuale të njësisë ekonomike ndaj “niveleve të performancës mjedisore të lidhura me **teknikat më të mira në dispozicion**” (**BAT-AEPLs**) me kushtin që ato janë të zbatueshme për sektorin dhe **impiantin**; dhe
- (e) një listë të çdo programi për pajtueshmërinë ose heqjen (braktisjen) e garantuar nga autoritetet kompetente sipas nenit 15, pika (4) të Direktivës 2010/75/BE që janë të lidhura me vënien në zbatim të **BAT-AEL**.

#### *Metodologjitë*

AR 26. Kur jep informacionin mbi **ndotësit**, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë qasjet për përcaktimin sasior sipas rendit të prioritetit në vijim:

- (a) emetimet e matura drejtpërdrejt, rrjedhjet ose **ndotjet** e tjera përmes përdorimit të sistemeve të njohura të monitorimit të vijueshëm (p.sh., Sistemet Automatike të Matjes AMS);
- (b) matjet periodike;
- (c) llogaritjet e bazuara në të dhëna specifike nga **vendndodhja**;
- (d) llogaritjet e bazuara në faktorë të publikuar për ndotjen; dhe
- (e) vlerësimi.

AR 27. Lidhur me dhënien e informacioneve shpjeguese mbi metodologjitë të kërkuara nga paragrafi 30, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë:

- (a) nëse monitorimi i saj kryhet në përputhje me Standardet **BREF** të BE ose të një reference krahasuese më e mirë përkatëse; dhe
- (b) nëse dhe si janë realizuar testet e kalibrimit të AMS, si dhe nëse dhe si është siguruar verifikimi i matjeve periodike nga laboratorë të pavarur.

#### Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E2-5 – Substancat shqetësuese dhe substancat shumë shqetësuese

Lista e substancave për t’u marrë në konsideratë

AR 28. Me qëllim që informacioni të jetë i plotë, do të përfshihen **substancat** në veprimtarinë e vet të njësisë ekonomike dhe ato të blera (p.sh., përbërësit e përfshirë, gjysmë-produktet, ose produkti final).

AR 29. Masa e **ndotësve** do të paraqitet në njësi matjeje, për shembull në tonë ose kilogramë ose njësi matjeje të përshtatshme për masën dhe llojin e ndotësve që po emetohen.

AR 30. Informacioni i dhënë sipas kësaj Kërkese për Dhënie informacionesh shpjeguese mund t'i referohet informacionit që njësia ekonomike tashmë duhet të raportojë sipas legjislacionit tjetër ekzistues (d.m.th., Direktivës 2010/75/BE, Rregullores (KE) Nr. 166/2006 "E- PRTR", etj.).

**Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E2-6 – Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me ndotjen**

AR 31. Shpenzimet e shfrytëzimit dhe kapitale të lidhura me **incidentet** dhe **depozitimet** mund të përfshijnë:

- (a) koston për eliminimin dhe masat korrigjuese për **ndotjen** përkatëse të ajrit, të ujit dhe të **terrenit** duke përfshirë mbrojtjen e mjedisit;
- (b) kostot e kompensimit të dëmit përfshirë pagesat e gjobave dhe kamatave të vendosura nga autoritetet rregullatore ose qeveritare.

AR 32. **Incidentet** mund të përfshijnë, për shembull, ndërprerjet e prodhimit, nëse vijnë nga **zinxhiri furnizues** dhe/ose nga veprimtaria e vet, që solli **ndotjen**.

AR 33. Njësia ekonomike mund të përfshijë një vlerësim të produkteve ose shërbimeve të saj përkatëse në rrezik në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, duke shpjeguar se si janë përkufizuar, sesi janë vlerësuar shumat financiare dhe cilat janë supozimet kryesore të bëra.

AR 34. Përcaktimi sasior i **efekteve financiare të parashikuara** në njësi monetare sipas paragrafit 38, germa (a) mund të jetë një shumë e vetme ose një interval.

## ESRS E3. BURIMET UJORE DHE DETARE

### Përmbajtja

<b>Objektivi</b> .....	<b>183</b>
<b>Ndërveprimi me Standardet e tjera ESRS</b> .....	<b>185</b>
<b>Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese</b> .....	<b>186</b>
ESRS 2 Dhënie informacionesh shpjeguese të Përgjithshme .....	186
Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë .....	186
Kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese e lidhur me standardin ESRS 2 IRO-1 – Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me burimet ujore dhe detare .....	186

Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E3-1 – Politikat e lidhura me burimet ujore dhe detare.....	186
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E3-2 – Veprimet dhe burimet e lidhura me burimet ujore dhe detare.....	187
Metrikat dhe objektivat .....	188
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E3-3 – Objektivat e lidhura me burimet ujore dhe detare .....	188
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E3-4 – Konsumi i ujit .....	189
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E3-5 – Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet dhe mundësitë e lidhura me burimet ujore dhe detare.....	190
<b>Shtojca A. Kërkesat për Zbatim.....</b>	<b>191</b>
ESRS 2 Dhënie informacionesh shpjeguese të Përgjithshme .....	191
Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë .....	191
Kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese e lidhur me standardin ESRS 2 IRO-1 – Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me burimet ujore dhe detare .....	191
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E3-1 – Politikat e lidhura me burimet ujore dhe detare.....	194
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E3-2 – Veprimet dhe burimet e lidhura me politikat për burimet ujore dhe detare .....	195
Metrikat dhe objektivat .....	196
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E3-3 – Objektivat e lidhura me burimet ujore dhe detare .....	196
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E3-4 – Konsumi i ujit .....	196
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E3-5 – Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet dhe mundësitë e lidhura me burimet ujore dhe detare.....	197

## Objektivi

- Objektivi i këtij Standardi është të specifikojë Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese që do t'u mundësojnë përdoruesve të **deklaratës së qëndrueshmërisë** të kuptojnë:

- (a) sesi njësia ekonomike ndikon **burimet ujore dhe detare**, në terma të **ndikimeve** materiale, pozitive dhe negative, aktuale dhe potenciale;
- (b) çdo **veprim** të ndërmarrë dhe rezultatin e këtyre veprimeve për të parandaluar ose zbutur ndikimet materiale negative, aktuale ose potenciale, për të mbrojtur burimet ujore dhe detare, duke iu referuar edhe pakësimit të **konsumit të ujit**, si dhe për të trajtuar **rreziqet dhe mundësitë**;
- (c) nëse, si dhe në çfarë mase njësia ekonomike kontribuon në ambiciet e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane (European Green Deal) për ajrin e pastër, ujin e pastër, **terren** dhe **biodiversitet** të shëndetshëm, si dhe në qëndrueshmërinë e **ekonomisë blu** dhe të sektorëve të peshkimit, duke marrë në konsideratë sa vijon: Direktivën 2000/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit<sup>70</sup> (Direktiva e BE e Kuadrit për Ujin), Direktiva 2008/56/KE e Parlamentit e Evropian dhe e Këshillit<sup>71</sup> (Direktiva BE e Kuadrit Strategjik për Detin), Direktiva 2014/89/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit<sup>72</sup> (Direktiva BE e Planifikimit të Hapësirës Detare), Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (në veçanti SDG 6 Uji i pastër dhe higjienizimi dhe SDG14 Jeta nën ujë), si dhe respektimi i kufijve mjedisorë globalë (p.sh., **kufijtë planetarë** lidhur me **integritetin e biosferës**, acidifikimin e oqeanit, përdorimin e **ujit të ëmbël** dhe flukset biogjeokimike;
- (d) planet dhe kapacitetin e njësisë ekonomike për të përshtatur strategjinë e saj dhe **modelin e biznesit** në pajtim me promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të ujit bazuar në mbrojtjen afatgjatë të burimeve ujore në dispozicion; mbrojtjen e **ekosistemeve** ujore dhe restaurimin e **habitateve** të **ujërave të ëmbël** dhe ujërave detarë;
- (e) natyrën, tipin dhe madhësinë e **rreziqeve** dhe **mundësive** materiale të njësisë ekonomike që vijnë nga **ndikimet** dhe **varësitë** e njësisë ekonomike në **burimet ujore dhe detare** dhe sesi njësia ekonomike i menaxhon ato; dhe
- (f) **efektet financiare** në njësinë ekonomike në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, të rreziqeve dhe mundësive që vijnë nga ndikimet dhe **varësitë** e njësisë ekonomike në burimet ujore dhe detare.
2. Ky Standard paraqet Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese të lidhura me **burimet ujore dhe detare**. Në lidhje me “ujin”, ky standard mbulon **ujërat sipërfaqësorë** dhe **ujërat nëntokësorë**. Ai përfshin kërkesa për dhënie informacionesh shpjeguese mbi **konsumin e ujit** në aktivitetet, produktet dhe shërbimet e njësisë ekonomike, si dhe informacionin përkatës mbi **tërheqjet e ujit** dhe **shkarkimet më pas të ujit**.

<sup>70</sup> Direktiva 2000/60/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 tetor 2000 që përcakton një kuadër për veprimin e Komunitetit në fushën e politikës së ujit (Direktiva Kuadër për Ujin) (GZ L 327, 22.12.2000, f. 1).

<sup>71</sup> Direktiva 2008/56/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 17 qershorit 2008 që përcakton një kuadër për veprimin e Komunitetit në fushën e politikës për mjedisin detar (Direktiva Kuadër e Strategjisë për Detin) (GZ L 164, 25.6.2008, f. 19).

<sup>72</sup> Direktiva 2014/89/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 korrikut 2014 mbi krijimin e një kuadri për planifikimin hapësinor detar (GZ L 257, 28.8.2014, f. 135).

3. Në lidhje me "**burimet detare**" ky standard mbulon nxjerrjen dhe përdorimin e burimeve të tilla, si dhe aktivitetet ekonomike të lidhura.

## Ndërveprimi me Standardet e tjera ESRS

4. Tema e **burimeve ujore dhe detare** është e lidhur ngushtë me nëntemat e tjera të mjedisit si ndryshimi klimatik, **ndotja**, **biodiversiteti** dhe ekonomia qarkulluese. Prandaj, për të siguruar një paraqitje të plotë se çfarë mund të jetë materiale për burimet ujore dhe detare, Kërkesat kryesore për Dhënie informacionesh shpjeguese mbulohen në standardet e tjera të mjedisit ESRS si vijon:
  - (a) ESRS E1 Ndryshimi *klimatik*, që trajton, në veçanti, **rreziqet fizike** akute dhe kronike që vijnë nga rreziqe të lidhura me ujin dhe oqeanet të shkaktuara ose të përkequr nga ndryshimi klimatik, duke përfshirë rritjen e temperaturës së ujit, ndryshimi i karakteristikave të precipitimit dhe llojet (shi, breshër, borë/akull), ndryshueshmëria e precipitimit ose hidrologjike, acidifikimi i oqeanit, kripëzimi (infiltrimi i ujit të detit), rritja e nivelit të detit, thatësira, stresi nga rritja e nivelit të detit, precipitimet e rënduara, përmbytjet dhe shkrirja e akujve;
  - (b) ESRS E2 *Ndotja*, që trajton në veçanti **emetimet** në ujë, që përfshijnë emetimet në oqeane, si dhe përdorimin dhe gjenerimin e mikroplastikave;
  - (c) ESRS E4 *Biodiversiteti dhe ekosistemet* që trajton në veçanti ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të **eksosistemeve** ujore të **ujërave të ëmbël** dhe të ujërave të detit dhe oqeanit, si dhe ndikimet mbi to; dhe
  - (d) ESRS E5 *Përdorimi i burimeve dhe ekonomia qarkulluese* që trajton në veçanti **menaxhimin e mbetjeve** përfshirë plastikën dhe tranzicionin drejt nxjerrjes së burimeve jo të rinovueshme të **ujërave të zeza**; pakësimin e përdorimit të plastikës; dhe **riciklimin** ujërave të zeza.
5. Ndikimet e njësisë ekonomike në **burimet ujore dhe detare** ndikojnë njerëzit dhe komunitetet. Ndikimet negative materiale mbi **komunitetet e ndikuara** nga ndikimet e lidhura me **burimet ujore dhe detare** që i takojnë njësisë ekonomike mbulohen në ESRS S3 *Komunitetet e ndikuara*.
6. Ky Standard duhet të lexohet së bashku me standardin ESRS 1 *Kërkesat e përgjithshme* dhe standardin ESRS 2 *Dhënie informacionesh shpjeguese të Përgjithshme*.

# Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese

## ESRS 2 Dhënie informacionesh shpjeguese të Përgjithshme

7. Kërkesat e këtij seksioni duhet të lexohen dhe të raportohen bashkë me dhënien e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga ESRS 2, kapitulli 4 *Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë*.

## Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë

*Kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese e lidhur me standardin ESRS 2 IRO-1 – Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me burimet ujore dhe detare*

8. Njësia ekonomike do të përshkruajë procesin për të identifikuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale dhe do të japë informacion:
  - (a) nëse dhe si njësia ekonomike ka analizuar aktivet dhe aktivitetet e saj për të identifikuar **ndikimet, rreziqet** dhe **mundësitë** e saj, aktuale dhe potenciale, të lidhura me **burimet ujore dhe detare** në veprimtarinë e saj dhe në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të saj të vlerës** dhe nëse e ka bërë këtë, metodologjitë, supozimet dhe mjetet e përdorura në analizë;
  - (b) nëse dhe si njësia ekonomike ka realizuar konsultimet, veçanërisht me komunitetet e ndikuara.<sup>73</sup>

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E3-1 – Politikat e lidhura me burimet ujore dhe detare*

9. Njësia ekonomike do të përshkruajë politikat e saj të përdorura për të menaxhuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të saj të lidhura me burimet ujore dhe detare.<sup>74</sup>
10. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese është që të lejojë kuptimin e madhësisë në të cilën njësia ekonomike disponon **politika** që trajtojnë identifikimin, vlerësimin, menaxhimin dhe/ose **korrigjimin** e **ndikimeve, rreziqeve** dhe **mundësive** materiale të saj të lidhura me **burimet ujore dhe detare**.
11. Dhënia e informacioneve shpjeguese e kërkuar nga paragrafi 9 do të përmbajë informacionin mbi **politikat** që disponon njësia ekonomike për të menaxhuar **ndikimet, rreziqet** dhe

<sup>73</sup> Burimi: Standardi 6 i Performancës IFC, 2012.

<sup>74</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve të tregut financiar objekt të Rregullores (BE) 2019/2088 sepse vjen nga një tregues shtesë i lidhur me ndikimet negative kryesore siç paraqitet në treguesin #7 në Tabelën II të Aneksit I, të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese për investimet e qëndrueshme ("Investimet në shoqëri pa politika të menaxhimit të ujit").

**mundësitë** e lidhura me **burimet ujore dhe detare** në përputhje me ESRS 2 MDR-P *Politikat e përdorura për të menaxhuar çështjet materiale të qëndrueshmërisë*.

12. Njësia ekonomike do të tregojë nëse dhe sesi **politikat** e saj trajtojnë (mbulojnë) çështjet në vijim, kur janë materiale:
- (a) menaxhimin e ujit, duke përfshirë:
- i. përdorimin dhe sigurimin e **burimeve ujore dhe detare** në veprimtarinë e vet;
  - ii. trajtimin e ujit si një hap drejt një sigurimi më të qëndrueshëm të ujit; dhe
  - iii. parandalimin dhe pakësimin e **ndotjes** së ujit që vjen nga aktivitetet e tij.
- (b) projektimin e produktit dhe shërbimit në këndvështrimin e trajtimit të çështjeve të lidhur me ujin dhe mbrojtjen e burimeve detare; dhe
- (c) angazhimin për të pakësuar në mënyrë të rëndësishme **konsumin e ujit** në **zonat me rrezik për ujin** në veprimtarinë e saj dhe në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të vlerës**.
13. Nëse të paktën një nga **vendndodhjet** e njësisë ekonomike ndodhet në një zonë me stres të lartë nga uji dhe nuk mbulohet nga një **politikë**, njësia ekonomike do të deklarojë këtë fakt dhe do të japë arsyet pse nuk ka adoptuar një politikë për këtë. Njësia ekonomike mund të japë si informacion shpjegues një afat kohor brenda të cilit synon të adoptojë një politikë të tillë.<sup>75</sup>
14. Njësia ekonomike do të specifikojë nëse ka përdorur **politika** ose praktika të lidhura me oqeanet dhe detet e qëndrueshme.<sup>76</sup>

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E3-2 – Veprimet dhe burimet e lidhura me burimet ujore dhe detare*

15. **Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për veprimet e saj të lidhura me burimet ujore dhe detare, si dhe burimet e caktuara për zbatimin e tyre.**
16. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese është që të lejojë kuptimin e **veprimeve** kryesore të ndërmarra dhe të planifikuara për të arritur objektivat e **politikave** dhe **synimet (objektivat)** e lidhura me **burimet ujore dhe detare**.
17. Përshkrimi i **veprimeve** dhe burimeve do të ndjekë parimet e dhëna në ESRS 2 MDR-A *Veprimet dhe burimet në lidhje me çështjet materiale të qëndrueshmërisë*. Përveç ESRS 2

---

<sup>75</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve të tregut financiar objekt të Rregullores (BE) 2019/2088 sepse vjen nga një tregues shtesë i lidhur me ndikimet negative kryesore siç paraqitet në treguesin #8 në Tabelën II të Aneksit I, të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese për investimet e qëndrueshme ("Ekspozimi në zonat me stres të lartë nga uji").

<sup>76</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve të tregut financiar objekt të Rregullores (BE) 2019/2088 sepse vjen nga një tregues shtesë i lidhur me ndikimet negative kryesore siç paraqitet në treguesin #12 në Tabelën II të Aneksit I, të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese për investimet e qëndrueshme ("Investimet në shoqëri pa praktika për oqeanet/detet e qëndrueshme").

MDR-A, njësia ekonomike mund të specifikojë se në cilin nivel të hierarkisë të masave zbutëse është e përshtatshme të caktohet një veprim dhe burime.

18. Burimet mund të caktohen për:
  - (a) të shmangur përdorimin e **burimeve** ujore dhe **detare**;
  - (b) të pakësuar përdorimin e burimeve ujore dhe detare të tilla si përmes masave për përmirësimin e rendimentit;
  - (c) rikuperimin dhe ripërdorimin e ujit; ose
  - (d) restaurimin dhe **rigjenerimin** e ekosistemeve ujore dhe masave ujore.
19. Njësia ekonomike do të specifikojë **veprimet** dhe burimet në lidhje me **zonat me rrezik nga uji**, duke përfshirë **zonat me stres të lartë nga uji**.

## Metrikat dhe objektivat

### *Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E3-3 – Objektivat e lidhura me burimet ujore dhe detare*

20. Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për objektivat që ka vendosur lidhur me burimet ujore dhe detare.
21. Objektivi i kësaj Kërkese për Dhënie informacionesh shpjeguese është që të lejojë të kuptohen objektivat që ka vendosur njësia ekonomike për të mbështetur politikat e saj të lidhura me burimet ujore dhe detare, si dhe për të trajtuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me burimet ujore dhe detare.
22. Përshkrimi i objektivave do të përmbajë informacionin e kërkuar në ESRS 2 MDR-T Gjurmimi i efektivitetit të politikave dhe veprimeve përmes objektivave.
23. Dhënia e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga paragrafi 20 do të tregojë nëse dhe si **objektivat** lidhen me:
  - (a) menaxhimin e **ndikimeve**, **rreziqeve** dhe **mundësive** materiale të lidhura me **zonat me rrezik nga uji**, duke përfshirë përmirësimin e cilësisë së ujit;
  - (b) menaxhimin e përgjegjshëm të ndikimeve, rreziqeve dhe mundësive të lidhura me **burimet detare**, përfshirë natyrën dhe sasinë e lëndëve të para të lidhura me burimet detare (të tilla si zhavorret, mineralet në thellësi të detit, prodhimet ushqimore të detit) të përdorura nga njësia ekonomike. dhe
  - (c) pakësimin e **konsumit të ujit**, duke përfshirë një shpjegim se si këto objektiva lidhen me zonat me rrezik nga uji, përfshirë zonat me stres të lartë nga uji.

24. Përveç ESRS 2 MDR-T, njësia ekonomike mund të specifikojë nëse **pragjet ekologjike** dhe shpërndarjet specifike për njësinë ekonomike janë marrë në konsideratë kur vendosen **objektivat**. Nëse po, njësia ekonomike mund të specifikojë:
- (a) pragjet ekologjike të identifikuar dhe metodologjinë e përdorur për të identifikuar këto pragje;
  - (b) nëse pragjet janë ose jo specifike për njësinë ekonomike dhe në rast se po, si janë përcaktuar ata; dhe
  - (c) sa përgjegjësi lidhur me respektimin e pragjeve ekologjike të identifikuar i takon njësisë ekonomike.
25. Njësia ekonomike do të specifikojë si pjesë e informacionit kontekstual, nëse **objektivat** që ka vendosur dhe paraqitur janë të detyrueshëm (kërkohen nga legjislacioni) apo vullnetarë.

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E3-4 – Konsumi i ujit*

26. Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues mbi performancën e saj në konsumin e ujit të lidhur me ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të saj.
27. Objektivi i kësaj Kërkese për Dhënie informacionesh shpjeguese është të lejojë kuptimin e konsumit të ujit të njësisë ekonomike dhe të çdo progresi të bërë nga njësia ekonomike në lidhje me **objektivat** e saj.
28. Dhënia e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga paragrafi 26 lidhet me veprimtarinë e vet dhe do të përfshijë:
- (a) totalin e **konsumit të ujit** në m<sup>3</sup>;
  - (b) totalin e konsumit të ujit në m<sup>3</sup> në zonat me rrezik nga uji, duke përfshirë **zonat me stres të lartë nga uji**;
  - (c) totalin e ujit të ricikluar dhe të ripërdorur në m<sup>3</sup>;<sup>77</sup>
  - (d) totali i ujit të depozituar dhe ndryshimi në depozitë në m<sup>3</sup>; dhe
  - (e) Çdo informacioni kontekstual të nevojshëm lidhur me gerrat (a) deri tek (d), duke përfshirë cilësinë dhe sasinë e baseneve ujore, sesi janë mbledhur të dhënat, të tilla si standardet, metodologjitë dhe supozimet e përdorura, duke përfshirë nëse informacioni është llogaritur, vlerësuar, projektuar apo marrë nga matje të drejtpërdrejta, si dhe qasjen e përdorur për këtë, të tillë si përdorimi i çdo faktori specifik për sektorin.

---

<sup>77</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve të tregut financiar objekt të Rregullores (BE) 2019/2088 sepse vjen nga një tregues shtesë i lidhur me ndikimet negative kryesore siç paraqitet në treguesin #6.2 në Tabelën II të Aneksit I, të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese për investimet e qëndrueshme ('Përdorimi i ujit dhe riciklimi', 2. Përqindja mesatare e ponderuar e ujit të ricikluar dhe të ripërdorur nga shoqëritë e investimit).

29. Njësia ekonomike do të japë informacion për **intensitetin e saj të ujit**: totalin e **konsumit të ujit** në veprimtarinë e vet në m<sup>3</sup> për milionë të të ardhurave (shitjeve) neto në Euro.<sup>78</sup>

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E3-5 – Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet dhe mundësitë e lidhura me burimet ujore dhe detare*

30. Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për efektet financiare të parashikuara nga rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me burimet ujore dhe detare.
31. Informacioni i kërkuar nga paragrafi 30 i shtohet informacionit mbi efektet financiare aktuale në pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset monetare të njësisë ekonomike, për periudhën e raportimit të kërkuar sipas ESRS 2 SBM-3, paragrafi 48, germa (d).
32. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese është të lejojë kuptimin e:
- (a) **efekteve financiare të parashikuara** për shkak të rreziqeve materiale që vijnë nga ndikimet dhe **varësitë** e lidhura me **burimet ujore dhe detare** dhe sesi këto rreziqe kanë (ose mund të kenë në mënyrë të arsyeshme) një ndikim material në pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset monetare të njësisë ekonomike, në një periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë. dhe
  - (b) **efekteve financiare të parashikuara** për shkak të mundësive materiale të lidhura me burimet ujore dhe detare.
33. Dhënia e informacioneve shpjeguese do të përfshijë:
- (a) një përcaktim sasior të **efekteve financiare të parashikuara** në njësi monetare para se të merren në konsideratë veprime lidhur me burimet ujore dhe detare, ose nëse nuk është e mundur pa kosto apo përpjekje të papërshtatshme, informacion cilësor. Nuk kërkohet një përcaktim sasior i **efekteve financiare** që vijnë nga mundësitë nëse kjo dhënie informacionesh shpjeguese nuk plotëson karakteristikat cilësore të informacionit (shih Shtojcën B të ESRS 1 *Karakteristikat cilësore të informacionit*);
  - (b) një përshkrim të efekteve të marra në konsideratë, të ndikimeve dhe varësive me të cilat lidhen, si dhe horizontet kohore në të cilat ka mundësi të materializohen; dhe
  - (c) supozimet kryesore të përdorura për të përcaktuar nga ana sasiore efektet financiare të parashikuara, si dhe burimet dhe nivelin e pasigurisë së atyre supozimeve.

---

<sup>78</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve të tregut financiar objekt të Rregullores (BE) 2019/2088 sepse vjen nga një tregues shtesë i lidhur me ndikimet negative kryesore siç paraqitet në treguesin #6.1 në Tabelën II të Aneksit I, të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese për investimet e qëndrueshme ('Përdorimi i ujit dhe riciklimi', 1. Shuma mesatare e ujit të konsumuar nga shoqëritë e investuara (në metër kubik) për milionë Euro të të ardhurave të shoqërive të investuara).

## Shtojca A. Kërkesat për Zbatim

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e ESRS E3. Ajo mbështet zbatimin e kërkesave për dhënie informacionesh shpjeguese të paraqitura në këtë standard dhe ka të njëjtin autoritet si dhe pjesët e tjera të Standardit.

### ESRS 2 Dhënie informacionesh shpjeguese të Përgjithshme

*Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë*

Kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese e lidhur me standardin ESRS 2 IRO-1 – Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me burimet ujore dhe detare

- AR 1. Kur bën një vlerësim të **materialitetit** mbi nëntema të mjedisit, njësia ekonomike do të vlerësojë materialitetin e burimeve ujore dhe detare në veprimtarinë e saj dhe në pjesën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të saj të vlerës, si dhe mund të marrë në konsideratë katër fazat në vijim të njohura edhe si qasja LEAP:
- (a) Faza 1: lokalizohet se ku shfaqet ndërlidhja e veprimtarisë së vet dhe rrjedhës së sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të saj të vlerës** me natyrën;
  - (b) Faza 2: vlerësohen **varësitë** dhe **ndikimet**;
  - (c) Faza 3: vlerësohen **rreziqet** dhe **mundësitë** materiale; dhe
  - (d) Faza 4: përgatiten dhe raportohen rezultatet e vlerësimit të materialitetit.
- AR 2. Vlerësimi i **materialitetit** për ESRS E3 përkon me tri fazat e para të kësaj qasjeje LEAP, faza e katërt trajton rezultatin e procesit.
- AR 3. Procesi i vlerësimit të **materialitetit** të **ndikimeve, të varësive, të rreziqeve** dhe **të mundësive**, do të marrë në konsideratë parashikimet në ESRS 2 IRO-1 *Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale*, si dhe IRO-2 *Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese në ESRS të mbuluara nga deklaratat e qëndrueshmërisë e njësisë ekonomike*.
- AR 4. Nëntemat e lidhura me burimet ujore dhe detare të mbuluara nga vlerësimi i **materialitetit** përfshijnë:
- (a) ujin, që përmbledh konsumin e **ujërave sipërfaqësorë, ujërat nëntokësorë**, si dhe tërheqjet dhe **shkarkimet më pas** të ujit; dhe
  - (b) **burimet detare** që përfshijnë nxjerrjen dhe përdorimin e burimeve të tilla, si dhe aktivitetet ekonomike të lidhura.

- AR 5. Në fazën 1, për të lokalizuar se ku janë zonat me rrezik për ujin, si dhe zonat ku ka një ndërlidhje me **burimet detare** që mund të sjellin ndikime dhe **varësi** materiale në veprimtarinë e vet dhe në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të saj të vlerës, njësia ekonomike mund të marrë në konsideratë:
- (a) vendndodhjen e aktiveve dhe të veprimtarisë së drejtpërdrejtë si dhe aktivitetet e lidhura me rrjedhën e sipërme dhe të poshtme përmes **zinxhirit të vlerës**;
  - (b) **vendndodhjen (e aktivitetit)** në **zonat me rrezik nga uji**, duke përfshirë zonat me stres të lartë nga uji; dhe
  - (c) sektorë ose njësi biznesi që ndërlidhen me burimet ujore ose detare në këto zona me prioritet.
- AR 6. Njësia ekonomike do të marrë në konsideratë basenet hidrogeografikë (të lumenjve) si nivel i rëndësishëm për të vlerësuar zonat dhe do të kombinojë atë qasje me një vlerësim të rrezikut të veprimtarisë të impianteve të saj dhe të impianteve të **furnizuesve** me ndikime dhe rreziqe materiale.
- AR 7. Njësia ekonomike do të marrë në konsideratë kriterin për përcaktimin e statusit të masave ujore sipas Aneksive përkatëse të Direktivës 2000/60/KE (Direktiva Kuadër për Ujin) si dhe dokumentet udhëzues të dhënë për zbatimin e Direktivës Kuadër për Ujin. Lista e dokumenteve udhëzues mund të merret në faqen zyrtare për Mjedisin të Komisionit Evropian.
- AR 8. Në fazën 2, për të vlerësuar ndikimet dhe **varësitë** e saj për secilën zonën me prioritet të identifikuar sipas AR 5, njësia ekonomike mund:
- (a) të identifikojë proceset dhe aktivitetet e biznesit që sjellin ndikimet dhe varësitë në aktivet mjedisore dhe **shërbimet e ekosistemit**;
  - (b) të identifikojë ndikimet dhe varësitë të lidhura me **burimet** ujore dhe **detare** përgjatë zinxhirit të vlerës të njësisë ekonomike; dhe
  - (c) vlerësojë ashpërsinë dhe mundësinë e ndodhjes së ndikimeve pozitive dhe negative në burimet ujore dhe detare.
- AR 9. Për identifikimin e **varësive** të lidhura me **burimet** ujore dhe **detare**, njësia ekonomike mund të bazohet në klasifikime ndërkombëtare si Shërbimi i Përbashkët Ndërkombëtar i Klasifikimit të Ekosistemeve (CICES).
- AR 10. Kur identifikon **varësitë** e saj të lidhura me **burimet detare**, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë nëse ato varen nga lëndë të para kryesore të lidhura me burimet detare, përfshirë por jo të kufizuara tek zhavorri dhe produktet ushqimore të detit.
- AR 11. **Burimet detare** përkufizohen sipas përdorimit nga shoqëria njerëzore dhe duhet të merren në konsideratë të lidhura me presionin ndaj të cilit i nënshtrohen. Disa tregues të presionit paraqiten në standardet e tjera ESRS, domethënë mikroplastikat dhe **emetimet** në ujë në ESRS E2 dhe **mbetjet** plastike në ESRS E5.

AR 12. Shembuj të **varësive** nga **burimet detare** që mund të merren në konsideratë nga njësia ekonomike janë:

- (a) varësitë në shfrytëzimin tregtar të peshqve dhe butakëve në veprimtarinë e vet dhe në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të saj të vlerës; dhe
- (b) aktiviteti i peshkimit që përfshin rrjeta me fund të lëvizshëm, që mund të ketë gjithashtu ndikime negative në fund të detit.

AR 13. Në Fazën 3, për të vlerësuar **rreziqet** dhe **mundësitë** materiale të saj bazuar në Fazat 1 dhe 2, njësia ekonomike mund të:

- (a) identifikojë **rreziqet e tranzicionit** dhe **mundësitë** në veprimtarinë e vet dhe në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të saj të vlerës** sipas kategorive:
  - i. **politika** dhe ligji: p.sh., hyrja në fuqi e rregullores ose politikës (p.sh., ndryshime të tilla si rritja e mbrojtjes së ujit, rritja e rregullimeve për cilësinë e ujit, rregullimi i fluksit të furnizimit me ujë), qeverisja jo efektive e masave ujore ose **burimeve detare**, në veçanti përmes kufijve (p.sh., qeverisja dhe bashkëpunimi ndërkuftar) duke sjellë në **degradim** të ujit ose të oqeanëve, ekspozim ndaj sanksioneve dhe konflikte (p.sh., mos respektim i i lejeve ose kuotave; neglizhencë ose vrasje e specieve detare të kërcënuara), detyrime shtesë për raportimin mbi ekosistemet detare dhe shërbimet e lidhura;
  - ii. Teknologjia: p.sh., zëvendësimi i produkteve ose shërbimeve nga produkte ose shërbime me një ndikim më të ulët në burimet ujore dhe detare, tranzicion drejt teknologjive më efektive dhe më të pastra (d.m.th., me ndikime më të ulëta në oqeanë dhe ujë), teknologji të reja monitorimi (p.sh., satelitët), pastrimi i ujit, mbrojtja nga përmbytjet;
  - iii. tregu: p.sh., zhvendosja e ofertës, e kërkesës dhe e financimit, paqëndrueshmëri dhe kosto shtesë për burimet ujore dhe detare;
  - iv. prestigji: p.sh., ndryshimet në perceptimet shoqërore, të klientëve ose të komunitetit si pasojë e ndikimit të një organizate në burimet ujore dhe detare; dhe
  - v. kontributi ndaj **rreziqeve sistemike** përmes veprimtarisë së vet dhe rrjedhës së sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të saj të vlerës, duke përfshirë rreziqet që një ekosistem detar të zhduket ose rreziqet që një sistem natyror kritik të mos funksionojë më (p.sh., arritja e pikës së kthesës, akumulimi i rreziqeve fizike);
- (b) të identifikojë rrezikun fizik duke përfshirë sasinë e ujit (**mungesën e ujit**, stresin nga uji), cilësinë e ujit, rrënimin e infrastrukturës ose mungesën e disa lëndëve të para të lidhura me burimet detare (p.sh., rrallimi i disa specieve të peshqve ose organizmave të tjerë të gjallë të detit që shiten si produkte nga njësia ekonomike) që sjellin, për shembull, pamundësinë e realizimit të veprimtarisë në disa zona gjeografike;
- (c) të identifikojë mundësitë sipas kategorive:

- i. rendimenti i burimit: p.sh., tranzicionin drejt shërbimeve dhe proceseve më efektive që kërkojnë më pak burimet ujore dhe detare;
- ii. tregjet: p.sh., zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve që konsumojnë më pak burime, diversifikimi i aktiviteteve të biznesit;
- iii. financimit: p.sh., mundësia e përdorimit të fondeve, obligacioneve ose huave të gjelbra (të lidhura me mjedisin);
- iv. qëndrueshmërisë: p.sh., diversifikimi i burimeve ujore ose detare dhe i aktiviteteve të biznesit (p.sh., fillimi i një njësie të re biznesi në **restaurimin e ekosistemit**), investimi në infrastrukturë të gjelbër, **zgjdhjet e bazuara në natyrë**, adoptimi i **riciklimit** dhe mekanizmave të qarkullimit që pakësojnë **varësitë** në burimeve ujore ose detare; dhe
- v. prestigji: **angazhimi i palës së interesuar** pozitiv si pasojë e një qëndrimi të kujdesshëm në menaxhimin e rreziqeve të lidhura me natyrën (p.sh., duke sjellë statusin e partnerit të preferuar).

AR 14. Njësia ekonomike mund të bazohet në mbledhje të dhënash primare, sekondare ose të projektuara ose në qasje të tjera të rëndësishme për të vlerësuar ndikimet, **varësitë**, rreziqet dhe mundësitë materiale, duke përfshirë Rekomandimet e Komisionit 2021/2279 mbi përdorimin e metodave për Gjurmen Mjedisore për të matur dhe komunikuar performancën mjedisore gjatë ciklit të jetës së produkteve dhe organizatave (Aneksi I – Gjurma Mjedisore e Produktit; Aneksi III – Gjurma Mjedisore e Organizatës).

AR 15. Kur jep informacionin mbi rezultatin e vlerësimit të saj të **materialitetit**, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë:

- (a) një listë të vendndodhjeve ku uji është çështje materiale për veprimtarinë e vet njësisë ekonomike dhe rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të saj të vlerës;
- (b) një listë të lëndëve të para të lidhura me **burimet detare** të përdorura nga njësia ekonomike që janë të rëndësishme për gjendjen e mirë mjedisore të ujërave detarë si dhe për mbrojtjen e burimeve detare; dhe
- (c) një listë të sektorëve ose segmenteve të lidhura me ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të burimeve ujore dhe detare.

#### Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E3-1 – Politikat e lidhura me burimet ujore dhe detare

AR 16. **Politikat** e përshkruara sipas kësaj Kërkese për Dhënie informacionesh shpjeguese mund të përfshihen në politikat më të gjera mjedisore ose për qëndrueshmërinë që mbulojnë në nëntema të ndryshme.

AR 17. Kur jep informacionin shpjegues sipas paragrafit 9, njësia ekonomike mund të paraqesë nëse **politikat** e saj:

- (a) parandalojnë rrënimin e mëtejshëm, mbrojnë dhe zgjerojnë statusin e masave ujore dhe **ekosistemeve** ujore;
- (b) promovojnë përdorimin e qëndrueshëm të ujit bazuar në një mbrojtje afatgjatë të burimeve ujore në dispozicion;
- (c) synojnë të rrisin mbrojtjen dhe të përmirësojnë mjedisin ujor;
- (d) promovojnë statusin e një mjedisi të mirë të ujërave detare; dhe
- (e) promovojnë pakësimin e **tërheqjeve të ujit** dhe të **shkarkimit më pas të ujit**.

AR 18. Gjithashtu, njësi ekonomike mund të japë informacion shpjegues mbi **politikat** të cilat:

- (a) kontribuojnë në cilësinë e mirë ekologjike dhe kimike të masave të **ujërave sipërfaqësorë** dhe në cilësinë e mirë kimike të masave të ujërave nëntokësorë, për të mbrojtur shëndetin njerëzor, furnizimin me ujë, **ekosistemet** natyrore dhe biodiversitetin, statusin e mirë mjedisor të ujërave detare dhe mbrojtjen e burimit bazë tek i cili varen aktivitetet detare;
- (b) minimizojnë **ndikimet** dhe **rreziqet** materiale dhe vënë në zbatim masa zbutëse që synojnë ruajtjen e vlerës dhe funksionimin e shërbimeve me prioritet, si dhe rritjen e rendimentit të burimit në veprimtarinë e vet; dhe
- (c) shmangin ndikimet në **komunitetet e ndikuara**.

**Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E3-2 – Veprimet dhe burimet e lidhura me politikat për burimet ujore dhe detare**

AR 19. Kur jep informacionin shpjegues të kërkuar sipas paragrafit 15, njësi ekonomike do të marrë në konsideratë **veprimet** ose planet e veprimit, që kontribuojnë për të trajtuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të identifikuara. Aleanca për Mirë Administrimin e Ujit (AWS) jep një udhëzues të dobishëm për këtë qëllim.

AR 20. Duke marrë në konsideratë që **burimet** ujore dhe **detare** janë burime që ndahen dhe mund të kërkojnë **veprime** kolektive, ose plane veprimi, që përfshijnë **palë të interesuara** të tjera, njësi ekonomike mund të sigurojë informacion mbi këto veprime kolektive, duke përfshirë informacion mbi palët e tjera (konkurrentët, **furnizuesit**, shitësit me pakicë, klientët, partnerët e tjerë të biznesit, komunitetet dhe autoritetet lokale, agjencitë qeveritare...) dhe informacion specifik mbi projektin, kontributin e tij specifik, mbështetësit e tij dhe pjesëmarrësit e tjerë.

AR 21. Kur jep informacion mbi shpenzimet kapitale, njësi ekonomike mund të marrë në konsideratë shpenzimet e lidhura për shembull me rehabilitimin e shkarkuesve të ujit të shiut, të kanalizimeve, ose të makinerive të përdorura për të prodhuar produkte që përdorin më pak ujë.

## Metrikat dhe objektivat

### Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E3-3 – Objektivat e lidhura me burimet ujore dhe detare

- AR 22. Nëse njësi ekonomike përdor **pragje ekologjike** kur vendos **objektivat**, ajo mund t'i referohet udhëzuesit të përgatitur nga Nisma për Objektiva të Bazuar në Shkencë për Natyrën (SBTN) në udhëzuesin e saj provizor (Udhëzuesi Fillestar për Biznesin, shtator 2020). Gjithashtu, ajo mund t'i referohet çdo udhëzuesi tjetër me metodologji të pranuar shkencore që lejon vendosjen e objektivave të bazuar në shkencë duke identifikuar pragje ekologjike dhe, nëse është e zbatueshme, kuota specifike për organizatën. Pragjet ekologjike mund të jenë lokale, kombëtare dhe/ose globale.
- AR 23. Njësi ekonomike mund të sigurojë **objektiva** për:
- (a) pakësimin e **tërheqjeve të ujit**; dhe
  - (b) pakësimin e **shkarkimeve më pas të ujit**.
- AR 24. Nëse njësi ekonomike siguron **objektiva** mbi tërheqjet, ajo mund të përfshijë **tërheqjet e ujit nga terrenet** dhe rezervuarët e ndotur, si dhe tërheqjen e ujit dhe trajtimin me qëllim **pastrimin**.
- AR 25. Nëse njësi ekonomike siguron **objektiva** mbi **shkarkimet më pas të ujit**, ajo mund të përfshijë **shkarkimet më pas të ujit** në **ujërat nëntokësorë** të tillë si rihedhja në rezervuar, ose kthimi i ujit në burimin nëntokësor përmes një kanali infiltrimi ose drenazhi.
- AR 26. **Objektivat** mund të mbulojnë veprimtarinë e vet të saj ose rrjedhën e sipërme ose të poshtme të zinxhirit të saj të vlerës.
- AR 27. Njësi ekonomike mund të specifikojë nëse **objektivi** trajton mungesat e lidhura me kriterin e Kontributit Thelbësor për Burimet Ujore dhe Detare siç përkufizohet në aktet e deleguara të Komisionit të përdorura në zbatim të nenit 12, pika (2) të Rregullores (BE) 2020/852. Nëse nuk plotësohet kriteret “Mos Bëj Dëm të Rëndësishëm” (DNSH) për Burimet Ujore dhe Detare siç përkufizohen në aktet e deleguara në zbatim të nenit 10, pika (3), nenit 11, pika (3), nenit 13, pika (2), nenit 14, pika (2) dhe nenit 15, pika (2) të Rregullores (BE) 2020/852, njësi ekonomike mund të specifikojë nëse objektivi trajton mungesat e lidhura me këto kritere DNSH.

### Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E3-4 – Konsumi i ujit

- AR 28. Njësi ekonomike mund të veprojë në **zona me rrezik nga uji** të ndryshme. Kur jep informacionin shpjegues sipas paragrafit 28, germa (b), njësi ekonomike do të përfshijë këtë informacion vetëm për ato zona që janë identifikuar si materiale në përputhje me ESRS2 IRO-1 dhe ESRS2 SBM-3.

AR 29. ► **C1** Kur jep informacionin shpjegues kontekstual mbi performacën lidhur me konsumin e ujit të kërkuara nga paragrafi 28, germa (e), njësia ekonomike do të shpjegojë metodologjitë e llogaritjes dhe në mënyrë më specifike pjesën e matjes të marrë nga matja e drejtpërdrejtë, nga zgjedhja dhe ekstrapolimi, ose nga vlerësimet më të mira. ◀

AR 30. Njësia ekonomike mund të sigurojë informacion mbi hollësi të tjera (p.sh., sipas sektorit ose segmenteve).

AR 31. Kur jep informacionin shpjegues të kërkuar nga paragrafi 29 njësia ekonomike mund të sigurojë raporte shtesë të intensitetit të bazuara në emërues të tjerë.

AR 32. Gjithashtu njësia ekonomike mund të sigurojë informacion mbi **tërheqjet e saj të ujit** dhe **shkarkimet më pas të ujit**.

Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E3-5 – Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet dhe mundësitë e lidhura me burimet ujore dhe detare

AR 33. Njësia ekonomike mund të përfshijë një vlerësim të produkteve ose shërbimeve të saj përkatëse në rrezik në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, duke shpjeguar se si janë përkufizuar, sesi janë vlerësuar shumat financiare dhe cilat janë supozimet kryesore të bëra.

AR 34. ► **C1** Përcaktimi sasior i **efekteve financiare të parashikuara** në njësi monetare sipas paragrafit 33, germa (a) mund të jetë një shumë e vetme ose një interval. ◀

## ESRS E4. BIODIVERSITETI DHE EKOSISTEMET

### Përmbajtja

Objektivi .....	199
Ndërveprimi me standardet e tjera ESRS.....	200
Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese .....	201
ESRS 2 Dhënie informacionesh shpjeguese të përgjithshme .....	201
Strategjia .....	201
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E4-1 – Plani i tranzicionit dhe përfshirja e biodiversitetit dhe e ekosistemeve në strategjinë dhe modelin e biznesit .....	201

Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese SBM 3 – Ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit .....	202
Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë .....	203
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese e lidhur me ESRS 2 IRO-1 – Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet.....	203
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E4-2 – Politikat e lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet.....	205
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E4-3 – Veprimet dhe burimet e lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet.....	206
Metrikat dhe objektivat .....	207
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E4-4 – Objektivat e lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet.....	207
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E4-5 – Metrikat e ndikimit të lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet .....	208
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E4-6 – Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet dhe mundësitë e lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet.....	210
<b>Shtojca A. Kërkesat për Zbatim .....</b>	<b>211</b>
ESRS 2 Dhënie informacionesh shpjeguese të Përgjithshme .....	211
Strategjia .....	211
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E4-1 – Plani i tranzicionit dhe përfshirja e biodiversitetit dhe e ekosistemeve në strategjinë dhe modelin e biznesit .....	211
Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë .....	213
Kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese e lidhur me ESRS 2 IRO-1 – Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet.....	213
Paraqitja e informacionit .....	216
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E4-2 – Politikat e lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet.....	217
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E4-3 – Veprimet dhe burimet e lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet.....	219

Metrikat dhe objektivat .....	221
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E4-4 – Objektivat e lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet .....	221
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E4-5 – Metrikat e ndikimit të lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet .....	222
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E4-6 – Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet dhe mundësitë e lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet .....	225

## Objektivi

1. Objektivi i këtij Standardi është të specifikojë Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese që do t'u mundësojnë përdoruesve të **deklaratës së qëndrueshmërisë** të kuptojnë:
  - (a) sesi njësia ekonomike ndikon **biodiversitetin** dhe **ekosistemet**, në terma të ndikimeve pozitive dhe negative materiale, aktuale dhe potenciale, duke përfshirë madhësinë në të cilën kontribuon tek nxitësit e humbjes dhe degradimit të biodiversitetit dhe të ekosistemit;
  - (b) çdo **veprim** të ndërmarrë dhe rezultatin e veprimeve të tilla për të parandaluar ose zbutur ndikimet negative aktuale ose potenciale, për të mbrojtur dhe restauruar biodiversitetin dhe ekosistemet, si dhe për të trajtuar rreziqet dhe mundësitë; dhe
  - (c) Planet dhe kapacitetin e njësisë ekonomike për të përshtatur strategjinë dhe **modelin e saj të biznesit** në pajtim me:
    - i. respektimin e **kufijve të planetit** të lidhur me **integritetin e biosferës** dhe **ndryshimin e përdorimit të terrenit**;
    - ii. vizionin e Kuadrit Global të Biodiversitetit të Kunming-Montreal dhe synimet dhe **objektivat** e tij të rëndësishëm;
    - iii. aspektet kryesore të Strategjisë për Biodiversitetin të BE për 2030;<sup>79</sup>
    - iv. Direktiva 2009/147/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit dhe Direktiva e Këshillit 92/43/KEE (Direktivat për Shpendët dhe Habitatet të BE);<sup>80</sup> dhe
    - v. Direktiva 2008/56/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (Direktiva Kuadri i Strategjisë për Detin);<sup>81</sup>

<sup>79</sup> Strategjia për Biodiversitetin e BE për 2030- Të kthejmë natyrën në jetën tonë, COM/2020/380 finale.

<sup>80</sup> Direktiva 2009/147/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 30 nëntorit 2009 mbi mbrojtjen e shpendëve të egër (GZ L 20, 26.1.2010, f. 7) Direktiva e Këshillit 92/43/KEE e 21 majit 1992 për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër (GZ L 206, 22.7.1992, f. 7).

<sup>81</sup> Direktiva 2008/56/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 17 qershorit 2008 që përcakton një kuadër për veprimin e Komunitetit në fushën e politikës për mjedisin detar (Direktiva Kuadër e Strategjisë për Detin) (GZ L 164, 25.6.2008, f. 19).

- (d) natyrën, tipin dhe madhësinë e rreziqeve, varësive dhe mundësive materiale të njësisë ekonomike të lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet, si dhe sesi njësia ekonomike i menaxhon ato; dhe
- (e) **efektet financiare** në njësinë ekonomike në periudha afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, të rreziqeve dhe mundësive materiale që vijnë nga ndikimet dhe varësitë e njësisë ekonomike në biodiversitet dhe ekosisteme.
2. Ky standard paraqet Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese të lidhura me marrëdhënien e njësisë ekonomike me habitatet e terrenit, **habitatet e ujërave të ëmbël** dhe detare, **ekosistemet** dhe popullatat përkatëse të specieve fauna dhe flora, duke përfshirë diversitetin brenda specieve, mes specieve dhe të ekosistemeve, si dhe ndërveprimin e tyre me **popujt indigjenë** dhe komunitete të tjera të ndikuara.
3. Termat "**biodiversitet**" dhe "**diversitet biologjik**" u referohen ndryshueshmërisë mes organizmave të gjallë nga të gjitha burimet që përfshijnë, ndër të tjera, **ekosistemet** e terrenit, **ujërave të ëmbël**, detarë dhe të ujërave të tjerë, si dhe komplekset ekologjike në të cilat bëjnë pjesë.

## Ndërveprimi me standardet e tjera ESRS

4. "**Biodiversiteti** dhe **ekosistemet**" janë të lidhura ngushtë me çështjet e tjera mjedisore. Nxitësit kryesorë të drejtpërdrejtë të ndryshimit të biodiversitetit dhe të ekosistemeve janë ndryshimi klimatik, **ndotja**, ndryshimi në përdorimin e terrenit, ndryshimi në përdorimin e **ujit të ëmbël** dhe të ujit të detit, shfrytëzimet e drejtpërdrejta të organizmave dhe speciet e huaja pushtuese. Këta nxitës mbulojnë në këtë standard, me përjashtim të ndryshimit klimatik (që mbulohet nga ESRS E1) dhe të ndotjes (që mbulohet nga ESRS E2).
5. Për një kuptim më të plotë të **ndikimeve** dhe **varësive** materiale mbi **biodiversitetin** dhe **ekosistemet** Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese të ESRS-ve të tjera mjedisore duhet të lexohen dhe interpretohen bashkë me kërkesat specifike për dhënie informacionesh shpjeguese të këtij Standardi. Kërkesat kryesore për dhënie informacionesh shpjeguese në ESRS-të e tjera mjedisore janë:
- (a) ESRS E1 *Ndryshimi klimatik*, që trajton veçanërisht **emetimet** GHG dhe burimet e energjisë (konsumi i energjisë);
- (b) ESRS E2 *Ndotja*, që trajton **ndotjen** e ajrit, ujit dhe të **terrenit**;
- (c) ESRS E3 *Burimet ujore dhe detare* që trajton veçanërisht burimet ujore (konsumi i ujit) dhe **burimet detare**;
- (d) ESRS 5 *Përdorimi i burimeve dhe ekonomia qarkulluese* që trajton, në veçanti, tranzicionin larg nxjerrjes nga burime jo të rinovueshme dhe vënien në zbatim të praktikave që parandalojnë prodhimin e **mbetjeve**, duke përfshirë ndotjen e krijuar nga mbetjet.

6. Ndikimet e njësisë ekonomike në **biodiversitet** dhe **ekosistemet** ndikojnë njerëzit dhe komunitetet. Kur raportohen ndikimet negative materiale mbi **komunitetet e ndikuara** nga ndryshimi në biodiversitet dhe ekosistem sipas ESRS E4, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë kërkesat e ESRS S3 *Komunitetet e ndikuara*.
7. Ky Standard duhet të lexohet së bashku me standardin ESRS 1 *Kërkesat e përgjithshme* dhe standardin ESRS 2 *Dhënie informacionesh shpjeguese të Përgjithshme*.

## Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese

### ESRS 2 Dhënie informacionesh shpjeguese të përgjithshme

8. Kërkesat e këtij seksioni duhet të lexohen bashkë me dhëniet e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga standardi ESRS 2 në Kapitullin 2 Qeverisja, në Kapitullin 3 Strategjia dhe në Kapitullin 4 Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë.
9. Dhëniet e rezultuara të informacioneve shpjeguese do të paraqiten bashkë me dhëniet e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga ESRS 2, me përjashtim të ESRS 2 SBM-3, për të cilin njësia ekonomike ka mundësi të paraqesë dhëniet e informacioneve shpjeguese përgjatë dhënies së informacioneve shpjeguese sipas temave.
10. Përveç kërkesave në ESRS 2, ky Standard përfshin edhe Kërkesën për Dhënie informacionesh shpjeguese, specifike sipas temës, E4-1 Plani i tranzicionit dhe përfshirja e biodiversitetit dhe e ekosistemeve në strategjinë dhe modelin e biznesit.

### Strategjia

#### *Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E4-1 – Plani i tranzicionit dhe përfshirja e biodiversitetit dhe e ekosistemeve në strategjinë dhe modelin e biznesit*

11. Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues sesi ndikimet, varësitë, rreziqet dhe mundësitë e saj të lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemin, vijnë nga strategjia dhe modeli i saj i biznesit dhe nxisin përshtatjen e tyre.
12. Objektivi i kësaj Kërkese për Dhënie informacionesh shpjeguese është të mundësojë kuptimin e qëndrësës së strategjisë dhe **modelit të biznesit** së njësisë ekonomike në lidhje me **biodiversitetin** dhe **ekosistemet**, si dhe pajtueshmërinë e strategjisë dhe modelit të biznesit të njësisë ekonomike me **objektivat** kryesorë të politikës publike lokale, kombëtare dhe globale lidhur me biodiversitetin dhe ekosistemet.
13. Njësia ekonomike do të përshkruajë qëndrueshmërinë e strategjisë dhe të **modelit të biznesit** të saj në lidhje me **biodiversitetin** dhe **ekosistemet**. Ky përshkrim do të përfshijë:

- (a) një vlerësim të qëndrueshmërisë së modelit aktual të biznesit dhe të strategjisë aktuale ndaj rreziqeve fizike, të tranzicionit dhe sistemike të lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet;
  - (b) objektin e analizës së qëndrueshmërisë lidhur me veprimtarinë e vet të njësisë ekonomike dhe rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të saj të vlerës, si dhe rreziqet e marrë në konsideratë në atë analizë;
  - (c) supozimet kryesore të bëra;
  - (d) horizontin kohor të përdorur;
  - (e) rezultatet e analizës së qëndrueshmërisë; dhe
  - (f) përfshirjen e palëve të interesuara, duke përfshirë sipas rastit zotëruesit e njohurive për indigjenët dhe vendin.
14. Nëse informacioni i specifikuar në këtë kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese paraqitet nga njësia ekonomike si pjesë e informacionit të kërkuar sipas ESRS 2 SBM-3, ajo mund t'i referohet informacionit që ka paraqitur sipas ESRS 2 SBM-3.
15. Njësia ekonomike mund të japë informacion shpjegues për **planin e saj të tranzicionit** për të përmirësuar dhe, me synim final, për të arritur pajtueshmërinë e **modelit të biznesit** dhe të strategjisë së saj me Kuadrin Global të Biodiversitetit të Kunming-Montreal dhe synimet dhe objektivat e tij të rëndësishëm; me Strategjinë për Biodiversitetin të BE për 2030, si dhe për respektimin e **kufijve të planetit** të lidhur me integritetin e biosferës dhe **ndryshimin e përdorimit të terrenit**.

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese SBM 3 – Ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit*

16. Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues:
- (a) një listë të **vendndodhjeve** të veprimtarive të saj, duke përfshirë vendndodhjet që ka nën kontroll bazuar në rezultatet e paragrafit 17(a). Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për këto vende duke:
    - i. specifikuar aktivitetet që ndikojnë negativisht **zonat me biodiversitet të ndjeshëm (delikat)**;<sup>82</sup>
    - ii. paraqitur një zberthim të vendndodhjeve sipas **ndikimeve** dhe **varësive** të identifikuara, si dhe të gjendjes ekologjike të zonave (në raport me nivelin e referencës të ekosistemit specifik) në të cilat ato ndodhen; dhe

---

<sup>82</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve të tregut financiar objekt të Rregullores (BE) 2019/2088 sepse vjen nga një tregues shtesë i lidhur me ndikimet negative kryesore siç paraqitet në treguesin #7 në Tabelën 1 të Aneksit 1 të Rregullores së Deleguar përkatëse në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese për investimet e qëndrueshme ("Aktivitetet që ndikojnë negativisht zonat me biodiversitet të ndjeshëm (delikat)").

- iii. specifikuar **zonat me biodiversitet të ndjeshëm (delikat)** të ndikuara, që përdoruesit të jenë në gjendje të përcaktojnë vendndodhjen dhe autoritetin përgjegjës kompetent lidhur me aktivitetet e cilësuara në paragrafin 16, germa (a), pika i.
- (b) nëse ka identifikuar ndikime negative materiale lidhur me **degradimin e terrenit, shkretimin ose izolimin e terrenit;**<sup>83</sup> dhe
- (c) nëse ka veprimtari që ndikojnë **speciet e kërcënuara.**<sup>84</sup>

## Menaxhimi i ndikimit, rreziqut dhe mundësisë

### ▼C1

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese e lidhur me ESRS 2 IRO-1 – Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet*

### ▼B

17. Njësia ekonomike do të përshkruajë procesin e saj për të identifikuar ndikimet, rreziqet, varësitë dhe mundësitë materiale. Përshkrimi i procesit do të përfshijë nëse dhe si njësia ekonomike:
- (a) ka identifikuar dhe vlerësuar ndikimet aktuale dhe potenciale mbi **biodiversitetin** dhe **ekosistemet** në **vendndodhjen** e saj dhe në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës, duke përfshirë kriterin e përdorur në vlerësim;
  - (b) ka identifikuar dhe vlerësuar **varësitë** në biodiversitetin dhe ekosistemet dhe shërbimin e tyre në vendndodhjen e saj dhe në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës, duke përfshirë kriterin e përdorur në vlerësim, si dhe nëse ky vlerësim përfshin **shërbimet e ekosistemit** që janë ndërprerë ose ka mundësi të ndërpriten;
  - (c) ka identifikuar dhe vlerësuar **tranzicionin** dhe **rreziqet fizike**, si dhe mundësitë e lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet, duke përfshirë kriterin e përdorur në vlerësim bazuar në ndikimet dhe varësitë e saj;
  - (d) marrë në konsideratë **rreziqet sistemike**;
  - (e) ka realizuar konsultime me **komunitetet e ndikuara** lidhur me vlerësimet e qëndrueshmërisë të burimeve biologjike dhe **ekosistemeve** të përbashkëta, në veçanti:
    - i. kur një vendndodhje, një prodhues ose burim i **lëndës së parë** ka mundësi të ndikojë negativisht biodiversitetin dhe ekosistemet, identifikimi specifik i vendndodhjeve, i

<sup>83</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve të tregut financiar objekt të Rregullores (BE) 2019/2088 sepse vjen nga një tregues shtesë i lidhur me ndikimet negative kryesore siç paraqitet në treguesin #10 në Tabelën 2 të Aneksit 1 të Rregullores së Deleguar përkatëse në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese për investimet e qëndrueshme ("Degradimi i terrenit, shkretimi, izolimi i terrenit").

<sup>84</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve të tregut financiar objekt të Rregullores (BE) 2019/2088 sepse vjen nga një tregues shtesë i lidhur me ndikimet negative kryesore siç paraqitet në treguesin #14 në Tabelën 2 të Aneksit 1 të Rregullores së Deleguar përkatëse në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese për investimet e qëndrueshme ("Speciet natyrore dhe zonat e mbrojtura").

prodhuesit ose burimit të lëndës së parë me ndikime negative ose të mundshme negative në komunitetet e ndikuara;

ii. nëse komunitetet e ndikuara ka mundësi të ndikohen, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues sesi këto komunitete ishin përfshirë në vlerësimin e **materialitetit**; dhe

iii. lidhur me ndikimet në **shërbimet e ekosistemit** të rëndësishme për komunitetet e ndikuara në veprimtaritë e veta të tij, njësia ekonomike do të tregojë sesi mund të shmangen ndikimet negative. Nëse këto ndikime janë të pashmangshme, njësia ekonomike mund të tregojë planet e saj për t'i minimizuar ato dhe për të implementuar masa zbutëse që synojnë të ruajnë vlerën dhe funksionimin e shërbimeve me prioritet.

18. Njësia ekonomike mund të japë informacion shpjegues nëse dhe si ajo ka përdorur **analizën e skenarit të biodiversitetit** dhe **ekosistemeve** për të informuar për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve dhe mundësive materiale në horizonte kohore afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë. Nëse njësia ekonomike ka përdorur një analizë të tillë skenari, ajo mund të japë informacionin shpjegues në vijim:

(a) pse u zgjodhën **skenarët** e marrë në konsideratë;

(b) si janë përditësuar skenarët e marrë në konsideratë në përgjigje të zhvillimit të kushteve dhe daljes së tendencave; dhe

(c) nëse skenarët mbështeten nga pritjet e publikuara nga organizma ndërqeveritarë autoritarë, të tilla si Konventa për Diversitetin Biologjik dhe, kur është e rëndësishme, nga konsensusi shkencor, si ai i shprehur nga Platforma Ndërqeveritare e politikës Shkencore mbi Biodiversitetin dhe Shërbimet e Ekosistemit (IPBES).

19. Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues në mënyrë specifike:

(a) nëse ka apo jo **vendndodhje** në ose afër **zonave me biodiversitet të ndjeshëm (delikat)** dhe nëse aktivitetet e lidhura me këto vendndodhje ndikojnë negativisht këto zona duke sjellë shkatërrimin e **habitateve** natyrore dhe habitateve të specieve si dhe shqetësimi specieve për të cilat ka qenë projektuar **zona e mbrojtur**; dhe

(b) nëse është dalë në përfundimin se është e nevojshme të implementohen masa për zbutjen e biodiversitetit të tilla si ato të identifikuara në Direktivën 2009/147/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi mbrojtjen e zogjve të egër; Direktiva e Këshillit 92/43/KEE mbi mbrojtjen e habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër; një Vlerësim i Ndikimit Mjedisor (EIA) siç përcaktohet në Nenin 1, pika (2), germa (g), e Direktivës 2011/92/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit <sup>(85)</sup> mbi vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private në mjedis; dhe për aktivitetet e vendosura në vende të treta, në përputhje me parashikimet ekuivalente kombëtare ose standardet

---

<sup>85</sup> Direktiva 2011/92/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 dhjetorit 2011 mbi vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private mbi mjedisin (GZ L 26, 28.1.2012, f. 1).

ndërkombëtare, të tilla si Standardi i Performancës 6: Mbrojtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore të Gjalla, i Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC).

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E4-2 – Politikat e lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet*

20. ► **C1** Njësia ekonomike do të përshkruajë politikat e saj të përdorura për të menaxhuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të saj të lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet. ◀
21. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese është që të lejojë kuptimin e madhësisë në të cilën njësia ekonomike disponon **politika** që trajtojnë identifikimin, vlerësimin, menaxhimin dhe/ose **korrigjimin** e **ndikimeve, varësive, rreziqeve** dhe **mundësive** materiale të saj të lidhura me **biodiversitetin** dhe **ekosistemet**.
22. Dhënia e informacioneve shpjeguese e kërkuar nga paragrafi 20 do të përmbajë informacionin mbi **politikat** që disponon njësia ekonomike për të menaxhuar **ndikimet, rreziqet, varësitë** dhe **mundësitë** e lidhura me **biodiversitetin** dhe **ekosistemet** në përputhje me ESRS 2 MDR-P Politikat e përdorura për të menaxhuar çështjet materiale të qëndrueshmërisë.
23. Përveç parashikimeve në ESRS 2 MDR-P njësia ekonomike do të përshkruajë nëse dhe si **politikat** e saj të lidhura me **biodiversitetin** dhe **ekosistemet**:
  - (a) lidhen me çështjet e cilësuara në ESRS E4 AR 4;
  - (b) lidhen me ndikimet materiale të lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet;
  - (c) lidhen me varësitë, rreziqet fizike dhe të tranzicionit, si dhe mundësitë materiale;
  - (d) mbështet gjurmimin e produkteve, përbërësve dhe lëndëve të para me ndikime materiale aktuale ose potenciale në biodiversitetin dhe ekosistemet përgjatë **zinxhirit të vlerës**;
  - (e) rajtojnë prodhimin, gjenerimin ose konsumin nga ekosistemet që menaxhohen për të mbajtur ose shtuar kushtet për biodiversitetin siç tregohet nga monitorimi dhe raportimi i rregullt i gjendjes së biodiversitetit dhe fitimit ose humbjes së biodiversitetit; dhe
  - (f) trajtojnë pasojat sociale të ndikimeve të lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet.
24. Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues në mënyrë specifike nëse ka adoptuar:
  - (a) **politika** për mbrojtjen e **biodiversitetit** dhe **ekosistemit** që mbulojnë **vendndodhjet** e veprimtarisë të zotëruara, të marra me qira, ose të menaxhuara në ose pranë një **zone me biodiversitet të ndjeshëm**;

- (b) praktika ose politika të terrenit / agrikulturës së qëndrueshme;<sup>86</sup>
- (c) praktika ose politika të qëndrueshme lidhur me oqeanet /detet;<sup>87</sup> dhe
- (d) politika për të trajtuar **shpyllëzimin**.<sup>88</sup>

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E4-3 – Veprimet dhe burimet e lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet*

- 25. Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për veprimet e saj të lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet, si dhe burimet e caktuara për zbatimin e tyre.
- 26. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese është që të lejojë kuptimin e **veprimeve** kryesore të ndërmarra dhe të planifikuara për të arritur objektivat e **politikave** dhe **synimet (objektivat)** e lidhura me **biodiversitetin** dhe **ekosistemet**.
- 27. Përshkrimi i **veprimeve** kryesore dhe i burimeve do të ndjekë përmbajtjen e detyrueshme të përkufizuar në ESRS 2 MDR-A *Veprimet dhe burimet në lidhje me çështjet materiale të qëndrueshmërisë*.
- 28. Gjithashtu, njësia ekonomike:
  - (a) mund të japë informacion shpjegues sesi ka zbatuar hierarkinë e masave zbutëse lidhur me veprimet e saj (shmangien, minimizimin, restaurimin dhe kompensimin);
  - (b) do të japë informacion shpjegues nëse ka përdorur kompensime të **biodiversitetit** në planet e saj të veprimit. Nëse **veprimet** përmbajnë kompensime të biodiversitetit, njësia ekonomike do të përfshijë informacionin në vijim:
    - i. synimin e kompensimit dhe treguesit kryesorë të performancës të përdorur;
    - ii. efektet financiare (kostot e drejtpërdrejta dhe të tërthorta) të kompensimeve të biodiversitetit në terma monetarë; dhe;
    - iii. një përshkrim të kompensimeve përfshirë zonën, tipin, kriterin cilësor të zbatuar dhe standardet që përmbushin kompensimet e biodiversitetit;
  - (c) do të përshkruajë nëse dhe si ka përfshirë njohuritë për zonën dhe për indigjenët si dhe zgjidhjet e bazuara në natyrë në veprimet e lidhura me biodiversitetin dhe **ekosistemet**.

---

<sup>86</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve të tregut financiar objekt të Rregullores (BE) 2019/2088 sepse vjen nga një tregues shtesë i lidhur me ndikimet negative kryesore siç paraqitet në treguesin #11 në Tabelën II të Aneksit I Rregullores së Deleguar nga Komisioni (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese për investimet e qëndrueshme ("Investimet në shoqëri pa praktika për terrenin / agrikulturën e qëndrueshme").

<sup>87</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve të tregut financiar objekt të Rregullores (BE) 2019/2088 sepse vjen nga një tregues shtesë i lidhur me ndikimet negative kryesore siç paraqitet në treguesin #12 në Tabelën II të Aneksit I Rregullores së Deleguar nga Komisioni (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese për investimet e qëndrueshme ("Investimet në shoqëri pa praktika të qëndrueshme për oqeanet/detet").

<sup>88</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve të tregut financiar objekt të Rregullores (BE) 2019/2088 sepse vjen nga një tregues shtesë i lidhur me ndikimet negative kryesore siç paraqitet në treguesin #15 në Tabelën II të Aneksit I të Rregullores së Deleguar nga Komisioni (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese për investimet e qëndrueshme ("Shpyllëzimi").

## Metrikat dhe objektivat

### *Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E4-4 – Objektivat e lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet*

29. **Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për objektivat që ka vendosur lidhur me biodiversitetin dhe ekosistemin.**
30. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese është që të lejojë të kuptohen **objektivat** që ka vendosur njësia ekonomike për të mbështetur **politikat** e saj për **biodiversitetin** dhe **ekosistemet**, si dhe për të trajtuar **ndikimet, varësitë, rreziqet** dhe **mundësitë** materiale të saj.
31. Përshkrimi i **objektivave** do të përmbajë informacionin e kërkuar në ESRS 2 MDR-T *Gjurmimi i efektivitetit të politikave dhe veprimeve përmes objektivave*.
32. Dhënia e informacioneve shpjeguese që kërkohet nga paragrafi 29 do të përfshijë informacionin në vijim:
  - (a) nëse janë zbatuar **pragje ekologjike** dhe shpërndarje të ndikimeve tek njësia ekonomike kur janë vendosur **objektivat**. Nëse po, njësia ekonomike do të specifikojë:
    - i. pragjet ekologjike të identifikuar dhe metodologjinë e përdorur për të identifikuar këto pragje;
    - ii. nëse pragjet janë ose jo specifike për njësinë ekonomike dhe në rast se po, si janë përcaktuar ata; dhe
    - iii. sa përgjegjësi lidhur me respektimin e pragjeve ekologjike të identifikuar i takon njësisë ekonomike;
  - (b) nëse objektivat bazohen në dhe / ose përputhen me Kuadrin Global të Biodiversitetit të Kunming-Montreal, aspektet kryesore të Strategjisë për Biodiversitetin të BE për 2030 dhe **politikat** dhe legjislacionin tjetër kombëtar të lidhur me **biodiversitetin** dhe **ekosistemet**;
  - (c) sesi lidhen objektivat me ndikimet, varësitë, rreziqet dhe mundësitë e lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemin, të identifikuara nga njësia ekonomike në raport me veprimtarinë e saj dhe rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës;
  - (d) objektin gjeografik të objektivave, nëse është e rëndësishme;
  - (e) nëse njësia ekonomike ka përdorur ose jo kompensime të biodiversitetit në vendosjen e objektivave të saj; dhe
  - (f) se cilës shtresë të hierarkisë së masave zbutëse mund t'i takojë objektivi (d.m.th. shmangies, minimizimit, restaurimit, kompensimit).

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E4-5 – Metrikat e ndikimit të lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet*

33. Njësia ekonomike do të raportojë metrikat e lidhura me ndikimet e saj materiale në *biodiversitet* dhe *ekosistemet*.
34. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese është të lejojë kuptimin e performancës së njësisë ekonomike ndaj ndikimeve të identifikuara si materiale në vlerësimin e **materialitetit** në ndryshimin e **biodiversitetit** dhe **ekosistemeve**.
35. Nëse njësia ekonomike ka identifikuar **vendndodhje** që ndikojnë negativisht (shih paragrafin 19(a)) në ose afër **zonave me biodiversitet të ndjeshëm**, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues mbi numrin dhe sipërfaqen (në hektarë) të vendndodhjeve të zotëruara, me qira ose në menaxhim në ose pranë këtyre zonave të mbrojtura ose zonave kryesore të **biodiversitetit**.
36. Nëse njësia ekonomike ka identifikuar ndikime materiale lidhur me ndryshimin e përdorimit të terrenit, ose ndikimet në madhësinë dhe kushtet e **ekosistemeve**, ajo mund të japë informacion shpjegues edhe për përdorimin e terrenit të bazuar në një Vlerësim të Ciklit të Jetës.
37. Për pikat e të dhënave të cilësuar në paragrafët 38 deri tek 41, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë veprimtarinë e vet.
38. Nëse njësia ekonomike ka dalë në përfundimin se ajo kontribuon drejtpërdrejt në **faktorët e ndikimit të ndryshimit të përdorimit të terrenit**, ndryshimin në përdorimin e **ujërave të ëmbël** ose të detit, ajo do të raportojë **metrikat** përkatëse. Njësia ekonomike mund të japë informacion shpjegues për metrikat që masin:
  - (a) konvertimin në kohë (p.sh. 1 ose 5 vite) të mbulimit të kohës (p.sh. **shpyllëzimi** ose nxjerrja e mineraleve);
  - (b) ndryshimet në kohë (p.sh. 1 ose 5 vite) në menaxhimin e ekosistemit (p.sh. përmes intensifikimit të menaxhimit të agrikulturës, ose zbatimit të praktikave më të mira të menaxhimit ose kultivimit të pyjeve);
  - (c) ndryshimet në konfigurimin hapësinor të panoramës (p.sh. fragmentimi i **habitateve**, ndryshimet në lidhjen e ekosistemit);
  - (d) ndryshimet në lidhjen strukturore të ekosistemit (p.sh. përshkueshmëria e habitatit bazuar në tiparet fizike dhe sistemimin e habitatit); dhe
  - (e) lidhjen funksionale (p.sh. Lehtësia me të cilën gjenet ose individët lëvizin në panoramën tokësore, të ujërave të ëmbël dhe ujërave detare.
39. Nëse njësia ekonomike ka dalë në përfundimin se ajo kontribuon drejtpërdrejt në futjen aksidentale ose vullnetare të specieve të huaja pushtuese, njësia ekonomike mund të japë

informacion shpjegues për **metrikat** që ajo përdor për të menaxhuar trajektoren e futjes dhe shpërndarjes së **specieve të huaja pushtuese** dhe rreziqeve që sjellin këto specie të huaja pushtuese.

40. Nëse njësi ekonomike ka identifikuar ndikime materiale të lidhura me gjendjen e specieve, njësi ekonomike mund të raportojë **metrikat** që ajo konsideron të rëndësishme. Njësi ekonomike mund:
- (a) t'u referohet kërkesave për dhënie informacionesh shpjeguese përkatëse në ESRS E1, ESRS E2, ESRS E3 dhe ESRS E5;
  - (b) të marrë në konsideratë madhësinë e popullatës, intervalin brenda **ekosistemeve** si dhe rrezikun e zhdukjes. Këto aspekte hedhin dritë mbi shëndetin e popullatës së një specieje të vetme dhe qëndresën e saj në raport me ndryshimin e shkaktuar nga njeriu dhe të ndodhur në mënyrë natyrore;
  - (c) japin informacion shpjegues mbi metrikat që masin ndryshimet në numrin e individëve të një specieje brenda një zone të caktuar;
  - (d) japin informacion shpjegues mbi metrikat për speciet në rrezik zhdukjeje<sup>89</sup> që masin:
    - i. gjendjen e kërcënuar të specieve dhe sesi aktivitetet/presionet mund të ndikojnë gjendjen e kërcënuar; ose
    - ii. ndryshimet në **habitatit** kryesor për një **specie të kërcënuar** si një variabël për ndikimin e njësisë ekonomike në rrezikun e zhdukjes së popullatës lokale.
41. Nëse njësi ekonomike ka identifikuar ndikimet materiale të lidhura me ekosistemet ajo mund të japë informacion shpjegues:
- (a) në raport me madhësinë e ekosistemeve, për **metrikat** që masin zonën e mbulimit të një ekosistemi të caktuar pa marrë në konsideratë me patjetër cilësinë e zonës që po vlerësohet, të tillë si mbulimi i **habitatit**. Për shembull, mbulimi pyjor është një matës i madhësisë së një tipi të caktuar të ekosistemit, pa iu referuar kushteve të ekosistemit (p.sh. jep zonën pa përshkruar llojet e specieve brenda pyllit).
  - (b) lidhur me kushtet e ekosistemit:
    - i. metrikat që masin cilësinë e ekosistemeve në raport me një gjendje referencë të paracaktuar;
    - ii. metrikat që masin shumë specie brenda një ekosistemi kundrejt numrit të individëve të një specieje të vetme brenda një ekosistemi (për shembull: treguesit e përcaktuar nga shkenca për larminë dhe bollëkun e specieve që masin zhvillimin (natyror) e përbërjes së specieve brenda një ekosistemi kundrejt gjendjes së referuar në fillim të periudhës së parë të raportimit si dhe gjendjes së synuar të paraqitur në Kuadrin

---

<sup>89</sup> Siç tregohet në Listën e Kuqe të Specieve të Kërcënuara IUCN dhe Listën e Kuqe Evropiane të publikuar nga Komisioni Evropian.

Global të Biodiversitetit të Kunming-Montreal, ose një bashkësi e gjendjes së ruajtjes së specieve nëse është e rëndësishme); ose

- iii. metrika që pasqyrojnë përbërësit strukturorë të kushteve si lidhja e habitatit (p.sh., sa të lidhur janë habitatet me njëri-tjetrin).

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E4-6 – Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet dhe mundësitë e lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet*

42. Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për efektet financiare të parashikuara nga rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemin.
43. Informacioni i kërkuar nga paragrafi 42 i shtohet informacionit mbi efektet financiare aktuale në pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset monetare të njësisë ekonomike, për periudhën e raportimit të kërkuar sipas ESRS 2 SBM-3, paragrafi 48, germa (d).
44. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese është të lejojë kuptimin e:
- (a) **efekteve financiare të parashikuara** për shkak të rreziqeve materiale që vijnë nga ndikimet dhe **varësitë** e lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemin dhe sesi këto rreziqe kanë (ose mund të kenë në mënyrë të arsyeshme) një ndikim material në pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset monetare të njësisë ekonomike, në një periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë; dhe
  - (b) ► **C1** efekteve financiare të parashikuara për shkak të mundësive materiale të lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemin. ◀
45. Dhënia e informacioneve shpjeguese do të përfshijë:
- (a) një përcaktim sasior të **efekteve financiare të parashikuara** në njësi monetare para se të merren në konsideratë veprime lidhur me **biodiversitetin** dhe **ekosistemin**, ose nëse nuk është e mundur pa kosto apo përpjekje të papërshtatshme, informacion cilësor. Nuk kërkohet një përcaktim sasior i **efekteve financiare** që vijnë nga mundësitë materiale nëse kjo dhënie informacionesh shpjeguese nuk plotëson karakteristikat cilësore të informacionit (shih Shtojcën B të ESRS 1 *Karakteristikat cilësore të informacionit*). Përcaktimi sasior i efekteve financiare të parashikuara në njësi monetare mund të jetë një shumë e vetme ose një interval;
  - (b) një përshkrim të efekteve të marra në konsideratë, të ndikimeve dhe **varësive** me të cilat lidhen, si dhe horizontet kohore në të cilat ka mundësi të materializohen; dhe
  - (c) supozimet kryesore të përdorura për të përcaktuar nga ana sasiore efektet financiare të parashikuara, si dhe burimet dhe nivelin e pasigurisë së atyre supozimeve.

## Shtojca A. Kërkesat për Zbatim

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e ESRS E4. Ajo mbështet zbatimin e kërkesave për dhënie informacionesh shpjeguese të paraqitura në këtë standard dhe ka të njëjtin autoritet si dhe pjesët e tjera të Standardit.

### ESRS 2 Dhënie informacionesh shpjeguese të Përgjithshme

#### *Strategjia*

#### Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E4-1 – Plani i tranzicionit dhe përfshirja e biodiversitetit dhe e ekosistemeve në strategjinë dhe modelin e biznesit

AR 1. Kur jep informacion shpjegues mbi një plan tranzicioni, njësia ekonomike mund të:

- (a) shpjegojë sesi do të rregullojë strategjinë e saj dhe **modelin e biznesit** për të përmirësuar dhe, me synimin final, arritjen e pajtueshmërisë me synimet dhe **objektivat** e politikave publike të rëndësishme lokale, kombëtare dhe globale lidhur me **biodiversitetin** dhe **ekosistemet** përfshirë vizionin e Kuadrit Global të Biodiversitetit të Kunming-Montreal dhe synimet dhe objektivat e tij të rëndësishëm, Strategjinë e Biodiversitetit të BE për 2030, Direktivën 2009/147/BE dhe Direktivën e Këshillit 92/43/KEE (Direktivat BE për Zogjtë dhe Habitatet) dhe kur është e përshtatshme, **kufijtë e planetit** të lidhur me integritetin e biosferës dhe **ndryshimin e sistemit të tokës**;
- (b) përfshijë informacion mbi veprimtarinë e saj dhe të shpjegojë edhe sesi ajo u përgjigjet ndikimeve materiale në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të saj të vlerës të identifikuar në vlerësimin e saj të materialitetit në përputhje me ESRS 2 IRO-1 Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale;
- (c) shpjegojë sesi strategjia e saj ndërvepron me planin e saj të tranzicionit;
- (d) shpjegojë sesi ajo kontribuon në trajtimin e faktorëve të ndikimit të biodiversitetit dhe ekosistemit dhe veprimet e saj zbutëse të mundshme duke ndjekur hierarkinë e masave zbutëse, si dhe varësitë kryesore dhe aktivitetet dhe burimet kryesore të fiksuara (p.sh., lëndët e para) që lidhen me ndryshimin e biodiversitetit dhe të ekosistemeve;
- (e) shpjegojë dhe përcaktojë nga ana sasiore investimet dhe financimet e njësisë ekonomike në mbështetje të zbatimit të planit të tranzicionit të saj, duke iu referuar treguesve kyç të performancës të taksonomisë së lidhur me CapEx (shpenzimet kapitale) dhe kur është e rëndësishme planet CapEx që njësia ekonomike paraqet në përputhje me Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2021/2178;
- (f) nëse njësia ekonomike ka aktivitet ekonomik që mbulohet nga rregulloret e deleguara për diversitetin sipas Rregullores së Taksonomisë, një shpjegim i objektivave ose planeve (CapEX, planet CapEx, OpEX) që ajo ka hartuar për të përshtatur aktivitetet e saj ekonomike (të ardhurat, CapEx) me kriteret e përcaktuara në rregulloret e deleguara;

- (g) shpjegojë sesi janë përdorur kompensimet e biodiversitetit, si pjesë e planit të tranzicionit dhe nëse është kështu, nëse kompensimet janë planifikuar të përdoren, madhësinë e përdorimit në raport me gjithë planin e tranzicionit dhe nëse është marrë në konsideratë hierarkia e masave zbutëse;
- (h) shpjegojë sesi menaxhohet procesi i zbatimit dhe përditësimit të planit të tranzicionit;
- (i) shpjegojë sesi ajo mat ecurinë, veçanërisht të tregojë metrikat dhe metodologjitë e përdorura për këtë qëllim;
- (j) tregojë nëse plani i tranzicionit ka marrë miratimin e organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse; dhe
- (k) tregojë sfidat aktuale dhe kufizimet për të hartuar një plan në lidhje me zonat me ndikim të rëndësishëm dhe sesi njësia ekonomike po i trajton këto sfida.

AR 2. Kur jep informacion shpjegues mbi një plan tranzicioni, njësia ekonomike mund t'i referohet, për shembull, **objektivave** në vijim nga Strategjia e Biodiversitetit e BE për 2030:

- (a) Përmbysset rënia e pjalmuesve.
- (b) Pakësohet me 50% rreziku dhe përdorimi i pesticideve kimike dhe përdorimi i pesticideve më të rrezikshme pakësohet me 50%.
- (c) Të paktën 25% e terrenit bujqësor është nën menaxhimin e fermave organike dhe rritet ndjeshëm përdorimi i praktikave bujqësore ekologjike.
- (d) Tre miliardë pemë mbillen në BE, në respekt të plotë të parimeve ekologjike.
- (e) Progres i rëndësishëm në **masat riparuese** për **terrenin** e ndotur të **vendndodhjeve**
- (f) Janë restauruar të paktën 25 000 km të rrjedhës së lirë të lumenjve.
- (g) Humbjet e ushqyesve nga përdorimi i plehrave pakësohet me 50%, duke sjellë pakësimin e përdorimit të plehrave me të paktën 20%.
- (h) Pakësohen ndjeshëm ndikimet negative në speciet dhe habitatet e ndjeshme, përfshirë fundin e detit përmes aktiviteteve të peshkimit dhe nxjerrjes, për të arritur gjendjen mjedisore të mirë.

AR 3. Nëse jep informacion shpjegues mbi një plan tranzicioni, njësia ekonomike mund t'i referohet edhe Objektivave për Zhvillimin e Qëndrueshëm (SDG), veçanërisht:

- (a) SDG 2 - Fundi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimi i ushqimit dhe nxitja e bujqësisë së qëndrueshme;
- (b) SDG 6 - Sigurimi i disponimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe shërbimit të higjienës për të gjithë;
- (c) SDG 14 - Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i oqeanëve, deteve dhe **burimeve detare** për zhvillimin e qëndrueshëm; dhe

(d) SDG 15 - Mbrojtja, restaurimi dhe nxitja e përdorimit të qëndrueshëm të **ekosistemeve** tokësore, menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, lufta ndaj **shkretimit**, si dhe ndalimi dhe kthimi i **degradimit të terrenit** dhe pengimin e **humbjes së diversitetit**.

*Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë*

Kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese e lidhur me ESRS 2 IRO-1 – Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet

AR 4. Vlerësimi i **materialitetit** të njësisë ekonomike sipas ESRS E4 përfshin:

- (a) kontributin e njësisë ekonomike mbi **faktorët e ndikimit** të drejtpërdrejtë në **humbjen e biodiversitetit**;<sup>90</sup>
- i. ndryshimi klimatik;
  - ii. **Ndryshimi i përdorimit të terrenit** (p.sh., shndërrimi artificial i terrenit), ndryshimi në përdorimin e **ujit të ëmbël** dhe ndryshimi në përdorimin e detit;
  - iii. shfrytëzimi i drejtpërdrejtë;
  - iv. **specie të huaja pushtuese**;
  - v. **ndotja**; dhe
  - vi. të tjera.
- (b) **ndikimet** në gjendjen e specieve (p.sh., madhësia e popullatës së specieve, rreziku i zhdukjes së specieve në nivel global);
- (c) ndikimet në madhësinë dhe kushtet e **ekosistemeve** përfshirë përmes **degradimit të terrenit, shkretimit** dhe **izolimit të terrenit**; dhe
- (d) ndikimet dhe **varësitë** në **shërbimet e ekosistemit**.

AR 5. Kur vlerëson **materialitetin** e **ndikimeve, varësive, rreziqeve** dhe **mundësitë** njësia ekonomike do të marrë në konsideratë parashikimet në ESRS 2 IRO-1 dhe ESRS 1 Kapitulli 3 *Materialiteti i dyfishtë si bazë e dhënies së informacioneve shpjeguese mbi qëndrueshmërinë* dhe përshkruan qëndrimin e saj.

AR 6. Njësia ekonomike do të vlerësojë materialitetin e biodiversitetit dhe ekosistemeve në veprimtarinë e saj dhe në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të saj të vlerës** dhe mund të realizojë vlerësimin e saj të **materialitetit** në pajtim me tri fazat e para të qasjes LEAP: Lokalizimi (paragrafi AR 7), Vlerësimi (paragrafi AR 8) dhe Përcaktimi (paragrafi AR 9).

---

<sup>90</sup> Faktori i drejtpërdrejtë i ndryshimit klimatik raportohet sipas ESRS E1 Ndryshimi Klimatik dhe i ndotjes raportohet sipas ESRS E2 Ndotja.

AR 7. Faza 1 lidhet me lokalizimin e **vendndodhjeve** kryesore në raport me ndërlidhjen e tyre me **biodiversitetin** dhe **ekosistemet**. Për të identifikuar këto vendndodhje të rëndësishme njësia ekonomike mund:

- (a) të zhvillojë një listë të vendeve të aktiveve dhe veprimtarisë së drejtpërdrejtë dhe të rrjedhës së sipërme dhe të poshtme përkatëse të **zinxhirit të vlerës** që janë të rëndësishme me aktivitetet e biznesit të njësisë ekonomike. Gjithashtu, njësia ekonomike mund të japë informacion mbi vendndodhjet për të cilat janë lajmëruar formalisht veprimtari të ardhshme;
- (b) të rendisë biomat dhe ekosistemet me të cilat ndërvepron, bazuar në listën e vendeve të identifikuar sipas paragrafit AR 7 germa (a);
- (c) të identifikojë integritetin dhe rëndësinë aktuale të biodiversitetit dhe ekosistemit në secilin vend duke marrë në konsideratë informacionin e dhënë në paragrafët 16 dhe 17;
- (d) të zhvillojë një listë të vendeve ku njësia ekonomike ndërlidhet me vendet në ose afër **zonave me biodiversitet të ndjeshëm** duke marrë në konsideratë informacionin e dhënë në paragrafët 16 dhe 17; dhe
- (e) të identifikojë se cilët sektorë, njësi biznesi, zinxhirë vlere ose klasa aktivesh ndërveprojnë me biodiversitetin dhe ekosistemet në këto vendndodhje materiale. Në vend të identifikimit të këtyre ndërlidhjeve sipas vendndodhjeve, njësia ekonomike mund të zgjedhë t'i identifikojë ato sipas **lëndëve të para** të siguruara ose të shitura me peshën në ton, nëse një praktikë e tillë jep një transparencë më të madhe.

AR 8. Në Fazën 2, për të vlerësuar ndikimet e saj aktuale ose potenciale dhe **varësitë** mbi **biodiversitetin** dhe **ekosistemet** për **vendndodhjet** kryesore, njësia ekonomike mund:

- (a) të identifikojë proceset e biznesit dhe aktivitetet që ndërveprojnë me biodiversitetin dhe ekosistemet;
- (b) të identifikojë ndikimet dhe varësitë, aktuale dhe potenciale;
- (c) të tregojë madhësinë, shkallën, frekuencën e ndodhjeve dhe momentin e ndikimeve në biodiversitet dhe ekosistemeve duke marrë në konsideratë dhënien e informacioneve shpjeguese sipas paragrafëve 16 dhe 17. Për më tepër, njësia ekonomike mund të japë informacion shpjegues për:
  - i. përqindjen e impianteve të **furnizuesve** të saj që ndodhen në zonat me rrezik (me **specie të kërcënuara** në Listë e Kuqe të Specieve IUCN, Direktivën për Zogjtë dhe Habitatet ose listën kombëtare të specieve të kërcënuara, ose në Zonat e Mbrojtura të njohura zyrtarisht, rrjetin Natyra 2000 të zonave të mbrojtura dhe Zonat Kyç të Biodiversitetit);
  - ii. ► **C1** përqindjen e blerjeve të shpenzuara pranë furnizuesve të saj me impiante që ndodhen në zonat me rrezik (me specie të kërcënuara në Listë e Kuqe të Specieve IUCN, Direktivën për Zogjtë dhe Habitatet ose listën kombëtare të specieve të

kërcënuara, ose në Zonat e Mbrojtura të njohura zyrtarisht, rreth Natyra 2000 të zonave të mbrojtura dhe Zonat Kyç të Biodiversitetit); ◀

(d) të tregojë madhësinë dhe shkallën e varësive në biodiversitet dhe ekosisteme, duke përfshirë lëndët e para, **burimet natyrore** dhe **shërbimet e ekosistemeve**. Njësia ekonomike mund të mbështetet në klasifikimet ndërkombëtare të tilla si Klasifikimi i Përbashkët Ndërkombëtar i Shërbimeve të Ekosistemeve (CICES).

AR 9. Në Fazën 3, për të vlerësuar **rreziqet** dhe **mundësitë** materiale të saj bazuar në rezultatet e Fazave 1 dhe 2, njësia ekonomike mund të marrë në konsideratë kategoritë në vijim:

(a) **rreziqet fizike:**

- i. rreziqet akute (p.sh., fatkeqësitë natyrore të shkaktuara nga humbja e mbrojtjes bregdetare nga **ekosistemet**, që sjellin kosto lidhur me dëmtimin nga stuhitë të infrastrukturës bregdetare, sëmundje ose parazitë që prekin speciet ose larminë e kulturave bujqësore në të cilat mbështetet njësia ekonomike, veçanërisht në rastin e mungesës ose të një diversitetit gjenetik të ulët, humbjes së specieve dhe **degradimit** të ekosistemit); dhe
- ii. rreziqet kronike (p.sh., humbja e rendimentit të kulturave bujqësore për shkak të rënies në shërbimet e pjalmimit, rritja e mungesave ose ndryshueshmëria e prodhimit të inputeve kryesore natyrore, degradimi i ekosistemit për shkak të veprimtarive që çojnë, për shembull, të erozioni i bregdetit dhe fragmentimi i pyjeve, acidifikimi i oqeanit, humbja e terrenit nga **shkretimi** dhe **degradimi i terrenit** dhe si pasojë humbja e pjellorisë së terrenit, humbja e specieve).

(b) **rreziqet e tranzicionit**, duke përfshirë:

- i. **politikën** dhe ligjin: p.sh., hyrja në fuqi e rregullimeve ose politikave (p.sh., ndryshime të tilla si mbrojtje e shtuar e terrenit); ekspozim ndaj sanksioneve dhe konflikteve (p.sh., derdhjet e ndotësve që dëmtojnë shëndetin e njeriut dhe të ekosistemit; ose shkelja e të drejtave, lejeve apo kuotave të lidhura me biodiversitetin; ose neglizhenca ndaj **specieve të kërcënuara** ose asgjësimi i tyre); detyrime më të mëdha për raportim mbi biodiversitetin, ekosistemet dhe shërbimet e lidhura;
- ii. teknologjia: p.sh., zëvendësimi i produkteve ose shërbimeve nga produkte ose shërbime me ndikim më të ulët në **biodiversitet** ose varësi më të ulët nga **shërbimet e ekosistemit**, mungesa e disponimit të të dhënave, ose disponim i të dhënave me cilësi të ulët që pengojnë vlerësimet e lidhura me biodiversitetin, tranzicioni drejt teknologjive më efektive dhe më të pastra (p.sh., me ndikim më të ulët në biodiversitet), teknologjitë e reja të monitorimit (p.sh., satelitët), kërkesat për të përdorur disa teknologji (p.sh., kultura biologjike me rezistencë ndaj klimës, pjalmues mekanikë, pastrues uji, mbrojtje nga përmytja);

- iii. tregu: p.sh., riorientimi i ofertës, kërkesës dhe financimit, ndryshueshmëria ose rritja kostos së lëndëve të para (p.sh., inpute me biodiversitet intensiv për të cilat çmimi është rritur si pasojë e **degradimit** të ekosistemit);
- iv. prestigji: p.sh., ndryshimet shoqërore, të perceptimeve të klientëve ose të komunitetit si pasojë e rolit të organizatës në humbjen e biodiversitetit, shkeljen e të drejtave të lidhura me natyrën përmes veprimtarisë, mbulimit negativ në media për shkak të ndikimeve në speciet kritike dhe/ose ekosistemet, konfliktet shoqërore të lidhura me biodiversitetin mbi speciet në rrezik, zonat e mbrojtura, burimet ose **ndotjen**.

(c) **rreziqet sistemike**, duke përfshirë:

- i. rreziqet e kolapsit të ekosistemit që një sistem natyror kritik nuk funksionon më, p.sh., janë arritur pikat e kthesës dhe kolapsi i ekosistemeve duke sjellë humbje gjeografike ose sektoriale të përgjithshme (nga bërja bashkë e rreziqeve fizike);
- ii. rreziku i grumbulluar i lidhur me ndikimet themelore të **humbjes së biodiversitetit** në nivelet e tranzicionit dhe rreziku fizik përmes një ose më shumë sektorëve në një portofol (të shoqërisë ose financiar); dhe
- iii. rreziku i infektimit që vështirësitë financiare të disa shoqërive ose institucioneve financiare të lidhura me dështimin ndaj përgjigjes për ekspozimin ndaj rreziqeve të lidhura me biodiversitetin të shpërndahet në të gjithë sistemin ekonomik.

(d) mundësitë, duke përfshirë për shembull:

- i. kategoritë e performancës së biznesit: rendimenti i burimit; produktet dhe shërbimet; tregjet; fluksi i kapitalit dhe financimit; kapitali i prestigjit; dhe
- ii. kategoritë e performancës së qëndrueshme: prodhimi i ekosistemit, restaurimi dhe **rigjenerimi**; përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore.

Paraqitja e informacionit

AR 10. Njësia ekonomike mund të marrë në konsideratë tabelën më poshtë për të lehtësuar vlerësimin e saj të **materialitetit** të **vendndodhjeve** materiale të identifikuar sipas paragrafit AR 7:

Shërbimi i ekosistemit	Varësitë aktuale ose potenciale	
...	Ndryshimi në funksionim	Humbja financiare
...	E kufizuar, e moderuar ose e rëndësishme	E kufizuar, e moderuar ose e rëndësishme
...	...	...

Vendndodhja	Speciet e kërcënuara, zonat e mbrojtura, zonat kyç të biodiversitetit	Varësitë aktuale ose potenciale			
		Frekuenca e ndodhjes	Shpejtësia e ndikimit	Ashpërsia e ndikimit	Mundësia për zbutje
...	...	E lartë, e mesme ose e ulët	<1 vit ose 1-3 vite ose >3 vite	E lartë, e mesme ose e ulët	E lartë, e mesme ose e ulët
...	...	...	...	...	...

Në lidhje me AR 7, germa (e), njësia ekonomike mund të marrë në konsideratë tabelën në vijim:

Ku janë prodhuar ose siguruar lëndët e para?	Pesha absolute e lëndëve të para (dhe përqindja e peshës së lëndëve të para)
Në zonat me specie të renditura në Listën e Kuqe të Specieve të Kërcënuara IUCN, në Direktivën për Zogjtë dhe Habitatet ose në listat kombëtare të specieve të kërcënuara	...
Në Zonat e mbrojtura të njohura zyrtarisht	...
Në Zonat e tjera Kyç të Biodiversitetit	...

**Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E4-2 – Politikat e lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet**

AR 11. **Politikat** e përshkruara sipas kësaj Kërkese për Dhënie informacionesh shpjeguese mund të përfshihen në politika më të gjera mjedisore ose për qëndrueshmërinë që mbulojnë nëntema të ndryshme.

AR 12. Njësia ekonomike mund të japë informacion edhe sesi **politika** i referohet prodhimit, sigurimit ose konsumit të lëndëve të para dhe në mënyrë të veçantë sesi ajo:

- (a) kufizon sigurimin nga **furnizuesit** që nuk mund të provojnë se ata nuk po kontribuojnë në dëmtimin e rëndësishëm të zonave të mbrojtura ose të zonave kyç të **diversitetit** (p.sh., përmes certifikimit);
- (b) i referohet standardeve të njohura ose certifikimit nga palë të treta dhe të mbikëqyrura nga organizmat rregullatorë; dhe
- (c) trajtojnë gjenerimin e lëndëve të para nga **ekosistemet** që janë menaxhuar për të mbajtur ose për të shtuar kushtet për biodiversitetin siç tregohet nga monitorimi dhe raportimi i rregullt i gjendjes së biodiversitetit dhe fitimit ose humbjes së biodiversitetit.

AR 13. Njësia ekonomike mund të japë informacion shpjegues për lidhjet dhe pajtueshmërinë me synimet e tjera globale dhe marrëveshjet si SDG 2, 6, 14 dhe 15 ose çdo konventë globale të mirënjohur lidhur me biodiversitetin dhe ekosistemet.

AR 14. Kur jep informacion shpjegues mbi **politikat** e lidhura me pasojat sociale të **biodiversitetit** dhe **ekosistemeve** të lidhura me **varësitë** dhe **ndikimet** sipas paragrafit 23, germa (f), njësia ekonomike mund t'i referohet veçanërisht Protokollit Nagoya dhe Konventës për Diversitetin Biologjik (CBD).

AR 15. Kur jep informacion shpjegues se kur dhe si **politikat** e saj trajtojnë pasojat sociale të **ndikimeve** të lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet sipas paragrafit 23, germa (f), njësia ekonomike mund të japë informacion shpjegues në lidhje me:

- (a) ndarjen e drejtë dhe të barabartë të avantazheve që vijnë nga përdorimi i burimeve gjenetike; dhe
- (b) **miratimin e lirë, paraprak dhe të informuar** për disponimin e burimeve gjenetike.

AR 16. Njësia ekonomike mund të shpjegojë edhe sesi **politika** e saj i lejon të:

- (a) shmangë ndikimet negative në **biodiversitet** dhe **ekosistemet** në veprimtarinë e saj dhe rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të vlerës** përkatës;
- (b) pakësojë dhe minimizojë ndikimet negative të saj që nuk mund të shmangen, në biodiversitet dhe ekosisteme, në veprimtarinë e saj dhe në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës.
- (c) të restaurojë dhe rehabilitojë ekosistemet e degraduara ose të restaurojë ekosistemet e dëmtuara si pasojë e ndikimeve që nuk mund të shmangen plotësisht dhe/ose nuk mund të minimizohen; dhe
- (d) të zbusë kontributin e saj në faktorët materialë të **humbjes së biodiversitetit**.

AR 17. Kur jep informacion shpjegues për **politikat** e saj nëse i referohet standardeve të sjelljes të palëve të treta, njësia ekonomike mund të japë informacion shpjegues nëse standardi i përdorur:

- (a) është objektiv dhe i arritshëm bazuar në një qasje shkencore për identifikimin e çështjeve dhe në një qasje realiste në vlerësimin sesi këto çështje mund të trajtohen në terren sipas një larmie rrethanash praktike;
- (b) është zhvilluar ose mbajtur përmes një procesi të vazhdueshëm konsultimesh me **grupet e interesit** me inpute të ekuilibruara nga të gjitha palët e rëndësishme të grupeve, përfshirë prodhuesit, tregtarët, përpunuesit, financuesit, popullatën lokale dhe komunitetet, **popujt indigjenë**, organizatat e shoqërisë civile që përfaqësojnë **konsumatorët**, interesat mjedisore dhe shoqërore, ku asnjë grup nuk ka autoritet mbi të tjerët ose të drejtën e vetos mbi përmbajtjen e standardit;
- (c) inkurajon një qasje të kujdesshme dhe me përmirësim të vazhdueshëm, si në standard dhe në zbatimin e tij për praktika menaxhimi më të mira, si dhe kërkon vendosjen e **objektivave** kuptimplotë dhe piketa specifike për të treguar progresin në kohë në raport me parimet dhe kriteret;
- (d) është e verifikueshme përmes certifikimit të pavarur ose organeve verifikuese, të cilët kanë procedura vlerësimi të përcaktuara dhe rigoroze që shmangin konfliktet e interesit dhe janë në pajtim me udhëzimin ISO për procedurat e akreditimi dhe të certifikimit ose nenin 5, pika (2) të Rregullores (BE) Nr 765/2008; dhe
- (e) në pajtim me Kodin e Praktikave të Mira ISEAL.

**Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E4-3 – Veprimet dhe burimet e lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet**

AR 18. Njësia ekonomike mund të lidhë shumat monetare kryesore të CapEx dhe OpEx të kërkuara për zbatimin e veprimeve të ndërmarra ose të planifikuara për t'u ndërmarrë:

- (a) me nënzërat kryesore ose shënimet në pasqyrat financiare;
- (b) treguesit kyç të performancës të kërkuar sipas nenit 8 të Rregullores (BE) 2020/852 dhe sipas Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2021/2178; dhe
- (c) nëse është e zbatueshme, planin CapEx të kërkuar sipas Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2021/2178.

AR 19. Njësia ekonomike mund të japë informacion shpjegues nëse merr në konsideratë një plan veprimi “shmangie”, i cili parandalon **veprimet** e dëmshme para se ato të ndodhin. Shpesh shmangia përfshin një vendim për të devijuar nga trajektorja e projektuar e zhvillimit të një biznesi si zakonisht. Një shembull i shmangies është ndryshimi i gjurmës së **biodiversitetit** dhe të ekosistemit të një projekti për të shmangur shkatërrimin e **habitatit** natyror në **vendndodhje** dhe/ose vendosjen e rezervave nëse mbartin vlera me prioritet lidhur me biodiversitetin dhe duhet të mbrohen. Të paktën, shmangia duhet të merret në konsideratë nëse ka vlera të lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemin që janë në një nga kategoritë në vijim: veçanërisht delikate dhe të pazëvendësueshme, të një shqetësimi të veçantë për **palët e interesuara** ose nëse qasja e kujdesshme duhet të garantohet për shkak të pasigurisë mbi

vlerësimin e ndikimit ose mbi efikasitetin e masave të drejtimit. Tre llojet kryesore të shmangies përkufizohen në vijim:

- (a) ► **C1** shmangie përmes zgjedhjes së vendndodhjes (Lokalizimi i gjithë projektit larg zonave të ndjeshme ndaj biodiversitetit); ◀
- (b) ► **C1** shmangia përmes projektimit të projektit (Konfigurimi i infrastrukturës për të ruajtur zonat të ndjeshme ndaj biodiversitetit); dhe ◀
- (c) shmangia përmes skedimit (Aktivitete të projektuara në kohë për të llogaritur tiparet e sjelljes së specieve (p.sh., të ushqyerit, migrimin) ose funksionet e ekosistemit (p.sh., dinamikat e lumenjve).

AR 20. Lidhur me **veprimet** kryesore, njësia ekonomike mund të japë si informacion shpjegues:

- (a) një listë të **grupeve të interesit** kryesore të përfshira (p.sh., konkurrentët, furnizuesit, shitësit me pakicë, partnerët e tjerë të biznesit, komunitetet e ndikuara dhe autoritetet, agjencitë qeveritare) dhe sesi ato janë të përfshira, duke përmendur grupet kryesore të interesit të ndikuara negativisht ose pozitivisht nga veprimet dhe sesi ato janë ndikuar duke përfshirë ndikimet ose përfitimet e krijuara për komunitetet e ndikuara, grupet e vogla, **popujt indigjenë** ose personat e tjerë në situata të vështira;
- (b) nëse është e zbatueshme, një shpjegim i nevojës për konsultime të përshtatshme dhe nevojën për të respektuar vendimet e komuniteteve të ndikuara;
- (c) një vlerësim të shkurtër nëse veprimet kryesore mund të sjellin **ndikime** të rëndësishme negative lidhur me qëndrueshmërinë;
- (d) një shpjegim nëse veprimi kryesor synohet të jetë një nismë e vetme apo një praktikë e rregullt;
- (e) një shpjegim nëse plani i veprimeve kryesore realizohet vetëm nga njësia ekonomike, duke përdorur burimet e saj, ose nëse është pjesë e një nisme më të gjerë në të cilën njësia ekonomike kontribuon në mënyrë të rëndësishme. nëse plani i veprimeve kryesore është pjesë e një nisme më të gjerë, njësia ekonomike mund të japë më shumë informacion mbi projektin, mbështetësit e saj dhe pjesëmarrësit e tjerë;
- (f) një përshkrim sesi ai kontribuon në ndryshimin e gjerë të sistemit, veçanërisht për të ndryshuar faktorët e ndryshimit të biodiversitetit dhe ekosistemit, p.sh., përmes faktorëve teknologjikë, ekonomikë, institucionalë dhe shoqërorë, si dhe ndryshimeve në vlerat dhe sjelljet bazë;

AR 21. Në kontekstin e kësaj Kërkese për Dhënie informacionesh shpjeguese, “njohuri për zonën dhe për indigjenët” i referohen kuptimeve, aftësive dhe filozofisë të zhvilluar nga shoqëritë me histori të gjatë lidhjesh me ambientin natyror përreth tyre. Për fshatarët dhe **popujt indigjenë**, njohuritë për zonën përbëjnë bazën e vendimmarrjes për aspekte themelore të jetës së përditshme.

*Metrikat dhe objektivat*

Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E4-4 – Objektivat e lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet

AR 22. Njësia ekonomike mund të specifikojë nëse **objektivi** trajton mungesat e lidhura me kriterin e Kontributit Thelbësor për Biodiversitetin siç përkufizohet në aktet e deleguara të Komisionit të përdorura në zbatim të nenit 15, pika (2) të Rregullores (BE) 2020/852. Nëse nuk plotësohet kriteri “Mos Bëj Dëm të Rëndësishëm” (DNSH) për Biodiversitetin siç përkufizohet në aktet e deleguara në zbatim të nenit 10, pika (3), nenit 11, pika (3), nenit 12, pika (2), nenit 13, pika (2) dhe nenit 14, pika (2) të Rregullores (BE) 2020/852, njësia ekonomike mund të specifikojë nëse objektivi trajton mungesat e lidhura me këto kritere DNSH.

AR 23. Kur jep informacionin shpjegues të kërkuar sipas paragrafit 29 për qëllime të vendosjes së **objektivave** njësia ekonomike do të marrë në konsideratë nevojën për një miratim të informuar dhe të lirë të popullatës lokale dhe **popujve indigjenë**, nevojën për konsultime të përshtatshme dhe nevojën për të respektuar vendimet e këtyre komuniteteve.

AR 24. **Objektivat** e lidhur me ndikimet materiale mund të paraqiten në një tabelë, siç ilustron vijim:

Lloji i objektivit sipas hierarkisë së masave zbutëse	Vlera bazë e referimit dhe viti bazë	Vlera objektivi dhe objekti gjeografik			Politika ose legjislatoni i lidhur nëse është e rëndësishme
		2025	2030	Deri në 2050	
Shmangia					
Minimizimi					
Restaurimi					
Kompensimet					

AR 25. **Objektivat** e lidhur me çështjet potencialisht materiale të qëndrueshmërisë të renditura në paragrafin AR 4 të këtij Standardi, mund të paraqiten në një tabelë siç ilustron në vijim:

Lloji i objektivit sipas çështjes së qëndrueshmërisë	Vlera bazë e referimit dhe viti bazë	Vlera objektivi dhe objekti gjeografik			Politika ose legjislatoni i lidhur nëse është e rëndësishme
		2025	2030	Deri në 2050	

AR 26. **Objektivat** e matshëm të lidhur me **biodiversitetin** dhe **ekosistemet** mund të shprehet si:

- (a) madhësia dhe vendi i të gjithë zonave **habitat** të mbrojtura ose të restauruara, nëse kontrollohen drejtpërdrejt ose tërthorazi nga njësi ekonomike, si dhe nëse suksesi i masave të restaurimit ishte apo miratohet nga profesionistë të jashtëm të pavarur;
- (b) sipërfaqet e rikrijuara (mjediset në të cilat implementohen nismat e drejtimit që krijojnë një habitat në **vendndodhjen** aty ku nuk ekzistonte më parë); ose
- (c) numri ose përqindja e projekteve / vendndodhjeve të cilave iu është përmirësuar integriteti ekologjik (p.sh., instalimi i kalimeve për peshqit, korridoreve ekologjike).

Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E4-5 – Metrikat e ndikimit të lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet

AR 27. Kur përgatit informacionin e kërkuar sipas kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese, njësi ekonomike do të marrë në konsideratë dhe mund të përshkruajë:

- (a) metodologjitë dhe **metrikat** e përdorura dhe një shpjegim se pse janë zgjedhur këto metodologji dhe metrika, si dhe supozimet, kufizimet dhe pasiguritë e tyre dhe çdo ndryshim në metodologji i bërë gjatë kohës dhe pse ato kanë ndodhur;
- (b) objekti i metrikave dhe metodologjive, për shembull:
  - i. njësi ekonomike, **vendndodhja**, marka, prodhimi bazë, njësi e biznesit e shoqërisë, aktiviteti;
  - ii. aspektet e mbuluara (siç paraqiten në paragrafin AR 4).
- (c) përbërësit e **biodiversitetit** të metrikave: specifikat e specieve, specifikat e ekosistemit;
- (d) gjeografinë e mbuluar nga metodologjia dhe një shpjegim se pse ndonjë gjeografi e rëndësishme mund të jetë përjashtuar;
- (e) sesi metrikat integrojnë **pragjet ekologjike** (p.sh., **integriteti i biosferës** dhe **ndryshimi i sistemit të terrenit, kufijtë e planetit**) dhe kuotat (shpërndarjet);
- (f) frekuenca e monitorimit, metrikat kryesore që monitorohen, si dhe kushtet/vlerat referencë bazë dhe viti/periudha referencë bazë, si dhe periudha e raportimit;
- (g) nëse këto metrika mbështeten në të dhëna primare, të dhëna sekondare, të dhëna të projektuara ose në një gjykim eksperti, ose një përzierje e tyre;
- (h) një tregues se cili veprim është matur dhe monitoruar me metrikat dhe sesi ato lidhen me arritjen e **objektivave**;
- (i) nëse metrikat janë të detyrueshme (të kërkuara nga legjislacioni) ose vullnetare. Nëse ato janë të detyrueshme, njësi ekonomike mund të tregojë legjislacionin përkatës; nëse janë vullnetare, njësi ekonomike mund t'i referohet çdo standardi ose procedure vullnetare të përdorur; dhe

(j) nëse metrikat bazohen ose korrespondojnë me pritjet ose rekomandimet e udhëzimeve të rëndësishme dhe autoritare në nivel kombëtar, të BE ose ndërqeveritar, **e politikave**, e legjislacionit ose marrëveshjeve, të tilla si Konventa për Diversitetin Biologjik (CBD) ose IPBES.

AR 28. Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për **metrikat** që janë të verifikueshme dhe janë teknikisht dhe shkencërisht të forta, duke marrë në konsideratë hapësira kohore dhe gjeografike të përshtatshme, si dhe mund të japë informacion shpjegues sesi ajo i ka zgjedhur metrikat e saj në korrespondencë me ato kritere. Për të siguruar që metrika është e rëndësishme duhet të ketë një marrëdhënie të qartë mes treguesit dhe qëllimit të matjes. Pasiguritë duhet të pakësohen për sa është e mundur. Të dhënat ose mekanizmat e përdorur duhet të mbështeten nga organizma të mirënjohur dhe duhet të përditësohen në kohë. Nëse ekzistojnë mangësi në të dhëna, mund të përdoren të dhëna nga modele të besueshme dhe gjykimi i ekspertit. Metodologjia duhet të jetë me hollësi të mjaftueshme për të lejuar krahasimin kuptimplotë të ndikimeve dhe të aktiviteteve zbutëse në kohë. Procese të mbledhjes së informacioni dhe përkufizimeve duhet të zbatohen në mënyrë të rregullt. Kjo lejon një rishikim kuptimplotë të performancës së njësisë ekonomike në kohë dhe ndihmon krahasimin e brendshëm dhe mes palëve.

AR 29. Nëse një metrikë korrespondon me një objektiv, duhet që referenca bazë e të dyve të përkojë. Referenca bazë e **biodiversitetit** është një përbërës themelor i procesit më të gjerë të menaxhimit të biodiversitetit dhe **ekosistemeve**. Referenca bazë është e nevojshme për mbështetjen e vlerësimit të ndikimit dhe planifikimin e menaxhimit, si dhe monitorimin e menaxhimit të përshtatur.

AR 30. Metodologjitë në dispozicion për të mbledhur të dhëna dhe matur ndikimet e njësisë ekonomike në **biodiversitet** dhe **ekosistemet** mund të ndahen në tri kategori si vijon:

(a) të dhëna primare: të mbledhura në vend duke përdorur studimet në terren;

(b) të dhëna sekondare: duke përfshirë shtresat e të dhënave gjeohapësinore që mbivendosen me të dhënat gjeografike të vendit të aktiviteteve të biznesit.

i. Në nivel të specieve shtresat e të dhënave në intervalet e specieve të ndryshme mund të përdoren për të parashikuar speciet që mund të paraqiten në vende të ndryshme. Kjo përfshin **vendndodhjet** e veprimtarisë dhe vendet e origjinës. Shtresat e intervaleve të ndryshme do të kenë nivele të ndryshme të saktësisë në varësi të faktorëve të caktuar (p.sh., nëse intervalet e specieve janë ripërcaktuar sipas **habitatit** në dispozicion). Informacioni mbi gjendjen e kërcënuar të specieve dhe aktivitetet që kërcënojnë ato mund të sigurojë një tregues të kontributit të mundshëm që aktivitetet e biznesit mund të kenë në nxitjen e tendencave të popullimit dhe të statusit të kërcënuar.

ii. Në nivel ekosistemi, shtresat e të dhënave pasqyrojnë ndryshimin në madhësinë dhe kushtin e ekosistemeve që mund të zbatohet, përfshirë nivelet e **fragmentimit të habitatit** dhe të lidhjes.

(c) të dhëna të projektuara të gjendjes së biodiversitetit: qasjet e bazuara në model përdoren zakonisht për matjen e treguesve të nivelit të ekosistemit (p.sh., madhësia, kushtet, ose funksioni). Modelet përcaktojnë nga ana sasiore madhësinë e presioneve të ndryshme që ndikojnë gjendjen e biodiversitetit. Këtyre u referohen si marrëdhënie të gjendjes nën presion dhe bazohen në të dhëna të mbledhura në nivel global. Rezultatet e modelimit zbatohen në mënyrë lokale për të vlerësuar sesi nivelet e presionit të njësisë ekonomike mund të shkaktojnë ndryshime në kushtet e ekosistemit. Zakonisht, një faktor ndikimi ka tri karakteristika kryesore: madhësia (p.sh., shumën e ndotësit, intensiteti i zhurmës), shtrirja në hapësirë (p.sh., zona e terrenit e ndotur) dhe shtrirja në kohë (kohëzgjatja e ndotjes).

AR 31. Lidhur me vlerësimin e ciklit të jetës për përdorimin e terrenit, njësia ekonomike mund t'i referohet "Treguesve mjedisorë të lidhur me përdorimin e terrenit të Vlerësimit të Ciklit të Jetës" nga Qendra e Përbashkët e Kërkimit (JRC).

AR 32. Lidhur me futjen e specieve të huaja pushtuese, njësia ekonomike mund të japë informacion shpjegues për trajektoren dhe numrin e **specieve të huaja pushtuese** dhe të madhësisë së sipërfaqes të mbuluar nga speciet e huaja pushtuese.

AR 33. Lidhur me metrikat mbi madhësinë dhe kushtet e **ekosistemeve**, një udhëzim i dobishëm mund të gjendet në punimin e Kombeve të Bashkuara mbi Sistemin e Kontabilitetit të Mjedisit ekonomik dhe të Ekosistemeve (UN SEEA EA).

AR 34. Njësia ekonomike mund të japë informacion shpjegues në njësi sipërfaqeje (p.sh., në m<sup>2</sup> ose ha) mbi përdorimin e terreni duke përdorur udhëzimin e dhënë nga Skema e Menaxhimit Ekologjik dhe të Auditimit (EMAS):<sup>91</sup>

(a) përdorimi total i terrenit;

(b) sipërfaqja totale e izoluar;

(c) sipërfaqja totale e orientuar nga natyra në **vendndodhje**; dhe

(d) sipërfaqja totale e orientuar nga natyra jashtë vendndodhjes.

AR 35. Njësia ekonomike mund të japë informacion shpjegues, për shembull, për ndryshimin në mbulimin e terreni që është një paraqitje fizike e faktorëve "modifikim habitatit" dhe "aktivitete industriale dhe shtëpiake", d.m.th., ndryshimet e bëra nga njeriu ose natyra në karakteristikat fizike të sipërfaqes së tokës në një vend të caktuar.

---

<sup>91</sup> Siç propozohet nga Rregullorja e Komisionit (BE) 2018/2026 e 19 dhjetorit 2018 që ndryshoi Shtojcën IV të Rregullores (KE) Nr 1221/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi pjesëmarrjen vullnetare të organizatave në një komunitet me menaxhim ekologjik dhe skema e auditimit (EMAS) (GZ L 325, 20.12.2018, f. 18).

AR 36. Mbulimi i terreni është një variabël tipik që mund të vlerësohet me të dhëna të vrojtueshme në tokë.

AR 37. Kur raportohen ndikimet materiale të lidhura me **ekosistemet**, njësia ekonomike mund të marrë në konsideratë, përveç madhësisë dhe kushteve të ekosistemeve, edhe funksionimin e ekosistemeve duke përdorur:

(a) një metrikë që mat një proces ose funksion që ekosistemi plotëson ose që pasqyron aftësinë e ekosistemit për të ndërmarrë një proces ose funksion specifik: p.sh., rendimenti primar neto, i cili është një matës i rendimentit të një bime bazuar në normën me të cilën energjia depozitohet nga bimët dhe u vihet në dispozicion specieve të tjera në ekosistem. Ky është një proces kryesor që ndodh që të funksionojnë ekosistemet. Ai lidhet me shumë faktorë, të tillë si diversiteti i specieve, po nuk i mat këta faktorë në mënyrë të drejtpërdrejtë; ose

(b) Një metrikë që mat ndryshime në popullatën e specieve të identifikuar shkencërisht si të kërcënuara.

AR 38. Në nivel ekosistemi, shtresat e të dhënave pasqyrojnë ndryshimin në madhësinë dhe kushtin e **ekosistemeve** që mund të zbatohet, përfshirë nivelet e **fragmentimit të habitatit** dhe të lidhjes.

Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E4-6 – Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet dhe mundësitë e lidhura me biodiversitetin dhe ekosistemet

AR 39. Njësia ekonomike mund të përfshijë një vlerësim të produkteve ose shërbimeve të saj përkatëse në rrezik në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, duke shpjeguar se si janë përkufizuar, sesi janë vlerësuar shumat financiare dhe cilat janë supozimet kryesore të bëra.

AR 40. Përcaktimi sasior i **efekteve financiare të parashikuara** në njësi monetare sipas paragrafit 45, germa (a) mund të jetë një shumë e vetme ose një interval.

## ESRS E5. PËRDORIMI I BURIMEVE DHE EKONOMIA QARKULLUESE

### Përmbajtja

Objektivi .....	227
Ndërveprimi me standardet e tjera ESRS.....	228
Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese .....	229

ESRS 2 Dhënie informacionesh shpjeguese të përgjithshme .....	229
Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë .....	229
Kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese e lidhur me standardin ESRS 2 IRO-1 – Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese.....	229
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E5-1 – Politikat e lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese.....	230
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E5-2 – Veprimet dhe burimet e lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese.....	230
Metrikat dhe objektivat .....	231
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E5-3 – Objektivat e lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese.....	231
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E5-4 – Burimet hyrëse.....	232
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E5-5 – Burimet dalëse .....	233
Produktet dhe materialet .....	233
Mbetjet .....	234
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E5-6 – Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet dhe mundësitë e lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese.....	235
<b>Shtojca A. Kërkesat për Zbatim .....</b>	<b>236</b>
ESRS 2 Dhënie informacionesh shpjeguese të Përgjithshme .....	236
Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë .....	236
Kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese e lidhur me standardin ESRS 2 IRO-1 – Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese.....	236
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E5-1 – Politikat e lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese .....	238
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E5-2 – Veprimet dhe burimet e lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese.....	239
Metrikat dhe objektivat .....	240
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E5-3 – Objektivat e lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese.....	240
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E5-4- Burimet hyrëse .....	240

Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E5-5 – Burimet dalëse .....	241
Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E5-6 – Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet dhe mundësitë e lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese.....	242

## Objektivi

1. Objektivi i këtij Standardi është të specifikojë Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese që do t’u mundësojnë përdoruesve të **deklaratës së qëndrueshmërisë** të kuptojnë:
  - (a) sesi njësia ekonomike ndikon përdorimin e burimeve, duke përfshirë rendimentin e burimeve, shmangien e shkatërrimit të burimeve dhe burimin e qëndrueshëm dhe përdorimin e burimeve të rinovueshme (referuar në këtë Standard si “përdorimi i burimeve dhe ekonomia qarkulluese”) në terma të **ndikimeve** materiale, pozitive dhe negative, aktuale ose potenciale;
  - (b) çdo **veprim** të ndërmarrë, si dhe rezultatin e veprimeve të tilla, për të penguar ose zbutur ndikimet negative aktuale ose potenciale që vijnë nga përdorimi i burimeve, duke përfshirë masat e saj për të ndihmuar shkëputjen e rritjes ekonomike të saj nga përdorimi i materialeve dhe për të trajtuar rreziqet dhe mundësitë;
  - (c) planet dhe kapacitetin e njësisë ekonomike për të përshtatur strategjinë dhe **modelin e saj të biznesit** në pajtim me **parimet e ekonomisë qarkulluese** duke përfshirë, por jo e kufizuar në, minimizimin e **mbetjeve**, duke mbajtur vlerën e produkteve, materialeve dhe të burimeve të tjera në vlerën më të lartë të tyre dhe duke shtuar përdorimin efektiv në prodhim dhe konsum;
  - (d) natyrën, tipin dhe madhësinë e rreziqeve dhe mundësive materiale të njësisë ekonomike të lidhura me ndikimet dhe **varësitë** e njësisë ekonomike, që vijnë nga përdorimi i burimeve dhe ekonomia qarkulluese dhe sesi njësia ekonomike i menaxhon ato; dhe
  - (e) **efektet financiare** në njësinë ekonomike në periudha afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, të rreziqeve dhe mundësive materiale që vijnë nga ndikimet dhe varësitë e njësisë ekonomike në përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese.
  
2. Ky Standard paraqet Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese të lidhura me “përdorimin e burimeve” dhe “ekonominë qarkulluese” dhe në mënyrë të veçantë për:
  - (a) **burimet hyrëse** duke përfshirë qarkullimin e burimeve hyrëse të rëndësishme, duke marrë në konsideratë burimet e rinovueshme dhe jo të rinovueshme; dhe
  - (b) **burimet dalëse** duke përfshirë informacionin mbi produktet dhe materialet; dhe
  - (c) **mbetjet**.

3. **Ekonomia qarkulluese** nënkupton një sistem ekonomik në të cilin vlera e produkteve, materialeve dhe burimeve të tjera në ekonomi ruhet sa më gjatë të jetë e mundur, duke rritur përdorimin efektiv në prodhim dhe konsum, duke pakësuar ndikimin mjedisor të përdorimit të tyre, minimizimin e **mbetjeve** dhe të lëshimit të **substancave** të rrezikshme në të gjitha fazat e ciklit të tyre të jetës, duke përfshirë zbatimin e **hierarkisë së mbetjeve**. Synimi është maksimizimi dhe ruajtja e vlerës së burimeve teknike dhe biologjike, produkteve dhe materialeve duke krijuar një sistem që lejon **jetëgjatësi**, përdorim optimal ose ripërdorim, rinovim, riprodhim, **riciklim** dhe ciklin e lëndëve ushqyese.
4. Ky Standard mbështetet në kuadrin ligjor dhe **politikat** përkatëse të BE, që përfshijnë Planin e Veprimit për Ekonominë Qarkulluese të BE, Direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit<sup>92</sup> (Direktiva Kuadër për Mbetjet) dhe strategjinë industriale të BE.
5. Për të vlerësuar tranzicionin nga biznesi i zakonshëm, që nënkupton një ekonomi në të cilën burime të fundme nxirren për të prodhuar produkte që përdoren dhe më pas flakën (“merrbëj-flak”), drejt një sistemi ekonomik qarkullues, ky Standard mbështetet në identifikimin e flukseve fizike të burimeve, materialeve dhe produkteve të përdorura dhe të gjeneruara nga njësia ekonomike përmes Kërkesës për Dhënie informacionesh shpjeguese E5-4 *Burimet hyrëse* dhe Kërkesës për Dhënie informacionesh shpjeguese E5-5 *Burimet dalëse*.

## Ndërveprimi me standardet e tjera ESRS

6. Përdorimi i burimit është një nxitës kryesor i ndikimeve të tjera mjedisore të tilla si ndryshimi klimatik, **ndotja**, burimet ujore dhe **burimet detare** dhe biodiversiteti. Një **ekonomi qarkulluese** është një sistem që tenton drejt përdorimit të qëndrueshëm të burimeve në nxjerrje, përpunim, prodhim, konsum dhe menaxhimin e **mbetjeve**. Sisteme të tilla sjellin përfitime mjedisore të shumëfishta, veçanërisht në pakësimin e konsumit të materialeve dhe energjisë dhe **emetimet** në ajër (emetimet e gazit me efekt serrë ose të ndotjeve të tjera), kufizimi i **tërheqjeve të ujit** dhe **shkarkimeve më pas**, si dhe **rigjenerimi** i natyrës duke kufizuar ndikimin në biodiversitet.
7. Për të siguruar një paraqitje të plotë se cila çështje tjetër mjedisore mund të jetë materiale për përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese, kërkesat kryesore për dhënie informacionesh shpjeguese mbulohen në standardet e tjera të mjedisit ESRS si vijon:
  - (a) ESRS E1 *Ndryshimi klimatik*, që trajton veçanërisht **emetimet** GHG dhe burimet e energjisë (konsumi i energjisë);
  - (b) ESRS E2 *Ndotja*, që trajton, veçanërisht, emetimet në ujë, në ajër dhe në **terren** si dhe të **substancave shqetësuese**;

---

<sup>92</sup> Direktiva 2008/98/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 19 nëntorit 2008 mbi mbetjet dhe shfuqizimin e disa Direktivave (GZ L 312, 22.11.2008, p. 3).

- (c) ESRS E3 *Burimet ujore dhe detare* që trajton veçanërisht burimet ujore (konsumi i ujit) dhe burimet detare; dhe
  - (d) ESRS E4 *Biodiversiteti dhe ekosistemet*, që trajton veçanërisht ekosistemet, speciet dhe lëndët e para.
8. Ndikimet e njësisë ekonomike të lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese, veçanërisht ndikimet e lidhura me **mbetjet**, mund të ndikojnë njerëzit dhe komunitetet. Ndikimet negative materiale mbi **komunitetet e ndikuara** nga ndikimet e lidhura me përdorimin e burimeve dhe **ekonominë qarkulluese** që i takojnë njësisë ekonomike mbulohen në ESRS S3 *Komunitetet e ndikuara*. Përdorimi efektiv dhe qarkullues i burimeve sjell përfitime edhe për konkurrueshmërinë dhe mirëqenien ekonomike.
9. Ky Standard duhet të lexohet së bashku me standardin ESRS 1 *Kërkesat e përgjithshme* dhe standardin ESRS 2 *Dhënie informacionesh shpjeguese të Përgjithshme*.

## Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese

### ESRS 2 Dhënie informacionesh shpjeguese të përgjithshme

10. Kërkesat e këtij seksioni duhet të lexohen dhe të raportohen bashkë me dhënien e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga ESRS 2, kapitulli 4 *Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë*.

### Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë

*Kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese e lidhur me standardin ESRS 2 IRO-1 – Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese*

11. Njësia ekonomike do të përshkruajë procesin e identifikimit të **ndikimeve**, **rreziqeve** dhe **mundësive** materiale të lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese, në veçanti lidhur me **burimet hyrëse**, **burimet dalëse** dhe **mbetjet**, si dhe do të japë informacion:
- (a) nëse njësia ekonomike ka analizuar aktivet dhe aktivitetet e saj për të identifikuar **ndikimet**, **rreziqet** dhe **mundësitë** e saj, aktuale dhe potenciale, në veprimtarinë e saj dhe në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të saj të vlerës dhe, nëse e ka bërë këtë, metodologjitë, supozimet dhe mjetet e përdorura në analizë;
  - (b) nëse dhe si njësia ekonomike ka realizuar konsultimet, veçanërisht me komunitetet e ndikuara.

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E5-1 – Politikat e lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese*

12. Njësia ekonomike do të përshkruajë politikat e saj të përdorura për të menaxhuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të saj të lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese.
13. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese është që të lejojë kuptimin e madhësisë në të cilën njësia ekonomike disponon **politika** që trajtojnë identifikimin, vlerësimin, menaxhimin dhe/ose **korrigjimin** e **ndikimeve, rreziqeve** dhe **mundësive** materiale të lidhura me përdorimin e burimeve dhe **ekonominë qarkulluese**.
14. Dhënia e informacioneve shpjeguese e kërkuar nga paragrafi 12 do të përmbajë informacionin mbi **politikat** që disponon njësia ekonomike për të menaxhuar **ndikimet, rreziqet** dhe **mundësitë** e lidhura me përdorimin e burimeve dhe **ekonominë qarkulluese** në përputhje me ESRS 2 MDR-P *Politikat e përdorura për të menaxhuar çështjet materiale të qëndrueshmërisë*.
15. Në përmbledhje njësia ekonomike do të tregojë nëse dhe sesi politikat e saj trajtojnë (mbulojnë) çështjet në vijim, kur janë materiale:
  - (a) tranzicionin nga përdorimi i burimeve të virgjëra, duke përfshirë rritjen relative të përdorimit të burimeve sekondare (të ricikluara);
  - (b) qëndrueshmërinë e burimeve dhe përdorimin e burimeve të rinovueshme.
16. Politikat do të trajtojnë ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale në veprimtarinë e vet dhe në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës.

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E5-2 – Veprimet dhe burimet e lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese*

17. Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për veprimet e saj të lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese, si dhe burimet e caktuara për zbatimin e tyre.
18. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese është që të lejojë kuptimin e **veprimeve** kryesore të ndërmarra dhe të planifikuara për të arritur objektivat e **politikave** dhe **synimet (objektivat)** e lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese.
19. Përshkrimi i **veprimeve** dhe burimeve të caktuara, të lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese, do të ndjekë parimet e dhëna në ESRS 2 MDR-A *Veprimet dhe burimet në lidhje me çështjet materiale të qëndrueshmërisë*.
20. Përveç ESRS 2 MDR-A, njësia ekonomike mund të specifikojë nëse dhe si një veprim dhe burimet mbulojnë:

- (a) nivelet më të larta të rendimentit të burimit në përdorim për materiale teknike dhe biologjike dhe ujë, veçanërisht në lidhje me lëndët e para kritike dhe të rralla të tokës siç renditen në Sistemin e Informacionit të Lëndëve të Para;
- (b) normat më të larta të përdorimit të lëndëve të para materiale (të ricikluara);
- (c) zbatimin e projektimit qarkullues, që sjell rritje të **jetëgjatësisë** së produktit dhe optimizimin e përdorimit, si dhe norma më të larta të: Ripërdorimit, Riparimit, Riprojektimit, Riprodhimit, Ripropozimit dhe Riciklimit.
- (d) zbatimin e praktikave të biznesit qarkullues të tilla si (i) **veprimet** për ruajtjen e vlerës (mirëmbajtja, riparimi, riprojektimi, riprodhimi, prodhimi i përbërësve, përditësimi dhe logjistika e kthimit, sistemet e mbyllura, shitja me pakicë e mallrave të përdorur), (ii) veprimet për maksimizimin e vlerës (sistemet prodhim-shërbim, modelet e biznesit bashkëpunuese dhe të ekonomisë së ndarjes bashkë), (iii) veprimet në fund të jetës (**riciklimi**, riciklimi përmirësues, zgjerimi i përgjegjësisë së prodhuesit) dhe (iv) veprimet që nxisin rendimentin e sistemeve (simbioza industriale);
- (e) veprimet e ndërmarra për të parandaluar gjenerimin e **mbetjeve** në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës të njësisë ekonomike; dhe
- (f) optimizimin e **menaxhimit të mbetjeve** në pajtim me **hierarkinë e mbetjeve**.

## Metrikat dhe objektivat

### *Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E5-3 – Objektivat e lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese*

- 21. Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për objektivat që ka vendosur lidhur me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese.
- 22. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese është që të lejojë të kuptohen **objektivat** që ka vendosur njësia ekonomike për të mbështetur **politikën për ekonominë qarkulluese** dhe përdorimin e burimeve të saj dhe për të trajtuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të saj.
- 23. Përshkrimi i **objektivave** do të përmbajë informacionin e kërkuar në ESRS 2 MDR-T *Gjurmimi i efektivitetit të politikave dhe veprimeve përmes objektivave*.
- 24. Dhënia e informacioneve shpjeguese e kërkuar nga paragrafi 21 do të tregojë nëse dhe si **objektivat** e njësisë ekonomike lidhen me **burimet hyrëse** dhe **burimet dalëse**, përfshirë **mbetjet**, si dhe me produktet dhe materialet dhe në mënyrë më specifike me:
  - (a) rritjen e projektimit qarkullues të produktit (duke përfshirë projektimin për **jetëgjatësinë**, çmontimin, riparimin, riciklimin etj.);
  - (b) rritjen e **normës së përdorimit të materialeve qarkulluese**;

- (c) minimizimin e lëndëve të para primare;
  - (d) qëndrueshmërinë e burimeve dhe përdorimin (në pajtim me parimin kaskadë) të burimeve të rinovueshme;
  - (e) **menaxhimin e mbetjeve**, duke përfshirë përgatitjen e trajtimit të duhur; dhe
  - (f) çështje të tjera të lidhura me përdorimin e burimeve ose ekonominë qarkulluese.
25. Njësia ekonomike do të specifikojë se me cilën shtresë të **hierarkisë së mbetjeve** lidhet objektivi.
26. Përveç ESRS 2 MDR-T, njësia ekonomike mund të specifikojë nëse **pragjet ekologjike** dhe shpërndarjet specifike për njësinë ekonomike janë marrë në konsideratë kur vendosen **objektivat**. Nëse po, njësia ekonomike mund të specifikojë:
- (a) pragjet ekologjike të identifikuar dhe metodologjinë e përdorur për të identifikuar këto pragje;
  - (b) nëse pragjet janë ose jo specifike për njësinë ekonomike dhe në rast se po, si janë përcaktuar ata; dhe
  - (c) sa përgjegjësi lidhur me respektimin e pragjeve ekologjike të identifikuar i takon njësisë ekonomike.
27. Njësia ekonomike do të specifikojë si pjesë e informacionit kontekstual, nëse **objektivat** që ka vendosur dhe paraqitur janë të detyrueshëm (kërkohen nga legjislacioni) apo jo të detyrueshëm.

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E5-4 – Burimet hyrëse*

28. Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues mbi burimet e saj hyrëse të lidhura me ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të saj.
29. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese është të lejojë kuptimin e burimit në përdorim në veprimtarinë e vet të njësisë ekonomike dhe në rrjedhën e sipërme të zinxhirit të saj të vlerës.
30. Dhënia e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga paragrafi 28 do të përfshijë një përshkrim të **burimeve hyrëse** të saj nëse janë materiale: produktet (duke përfshirë **ambalazhimin**) dhe materialet (duke specifikuar lëndët e para kritike dhe të rralla të tokës), ujin dhe aktivet afatgjata materiale të përdorura në veprimtarinë e vet të njësisë ekonomike dhe në rrjedhën e sipërme të zinxhirit të vlerës.
31. Nëse njësia ekonomike vlerëson se burimi hyrës është një çështje materiale e lidhur me qëndrueshmërinë, ajo do të japë informacionin shpjegues në vijim mbi materialet e përdorura për të prodhuar produktet dhe shërbimet e njësisë ekonomike gjatë periudhës së raportimit, në tonë ose kilogramë:

- (a) peshën e përgjithshme totale të produkteve dhe materialeve teknike dhe biologjike të përdorura gjatë periudhës së raportimit;
  - (b) përqindjen e materialeve biologjike (dhe të karburantit bio të përdorur jo për qëllime energjie) të përdorur për të prodhuar produktet dhe shërbimet e njësisë ekonomike (përfshirë **ambalazhimin**) që sigurohet nga burime të qëndrueshme, me informacionin për skemat e certifikimit të përdorura dhe mbi zbatimin e parimit kaskadë; dhe
  - (c) peshën në vlerë absolute dhe në përqindje, të përbërësve sekondarë të ripërdorur ose të ricikluar, të produkteve sekondare ndërmjetëse dhe materialeve sekondare të përdorura në prodhimin e produkteve dhe shërbimeve të njësisë ekonomike (përfshirë ambalazhimin);
32. Njësia ekonomike do të sigurojë informacion mbi metodologjitë e përdorura për të llogaritur të dhënat. Ajo do të specifikojë nëse të dhënat burojnë nga matje të drejtëpërdrejta ose vlerësime, si dhe do të japë informacion shpjegues mbi supozimet kryesore të përdorura.

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E5-5 – Burimet dalëse*

33. Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues mbi burimet e saj dalëse të lidhura me ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të saj.
34. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese është të lejojë kuptimin:
- (a) sesi njësia ekonomike kontribuon në **ekonominë qarkulluese** duke i) projektuar produktet dhe materialet në pajtim me **parimet e ekonomisë qarkulluese** dhe ii) rritjen ose maksimizimin e masës në të cilën produktet, materialet dhe përpunimi i **mbetjeve** riqarkullohet në praktikë pas përdorimit të parë; dhe
  - (b) e strategjisë së pakësimit të mbetjeve dhe e **menaxhimit të mbetjeve** të njësisë ekonomike, të madhësisë në të cilën njësia ekonomike njeh sesi menaxhohen mbetjet e saja para konsumit në aktivitetet e saj.

### **Produktet dhe materialet**

35. Njësia ekonomike do të japë një përshkrim të produkteve dhe materialeve kryesore që rezultojnë nga procesi i prodhimit i njësisë ekonomike dhe që janë projektuar sipas parimeve qarkulluese, përfshirë **të jetëgjatësisë**, të ripërdorimit, të riparimit, të zërthimit, të riprodhimit, të riprojektimit, **të riciklimit**, të riqarkullimit sipas ciklit biologjik, ose të optimizimit të përdorimit të produktit ose materialit përmes modeleve të tjerë të biznesit qarkullues.
36. Njësitë ekonomike për të cilat burimet dalëse janë materiale do të japin si informacion shpjegues:

- (a) **jetëgjatësinë** e pritshme të produkteve të hedhura në treg nga njësi ekonomike, në lidhje me mesataren e industrisë për çdo grup produktesh;
- (b) ► **C1** riparueshmërinë e produkteve duke përdorur një sistem vlerësimi të përcaktuar nëse është e mundur; ◀
- (c) normën e përmbajtjes së riciklueshme në produktet dhe **ambalazhin** e tyre.

## Mbetjet

37. Njësi ekonomike do të japë informacionin shpjegues në vijim mbi shumën totale të **mbetjeve** të saj nga veprimtaria e vet, në tonë ose në kilogramë:
- (a) shumën totale të mbetjeve të gjeneruara;
  - (b) shumën totale në peshë që nuk është eliminuar, me një zbërthim mes **mbetjeve të rrezikshme** dhe mbetjeve jo të rrezikshme dhe një zbërthim sipas llojeve në vijim të veprimeve **rikuperuese**:
    - i. përgatitjen për ripërdorim;
    - ii. **riciklimin**; dhe
    - iii. veprimet e tjera të rikuperimit.
  - (c) shumën në peshë të eliminuar sipas llojit të trajtimit të mbetjeve dhe shumën totale të të tre llojeve, me një zbërthim mes **mbetjeve të rrezikshme** dhe mbetjeve jo të rrezikshme. Llojet e trajtimit të mbetjeve për t'u dhënë si informacion shpjegues janë:
    - i. **djegia**;
    - ii. vendi i grumbullimit të mbetjeve (Landfill); dhe
    - iii. veprime të tjera të eliminimit;
  - (d) shumën totale dhe përqindjen e mbetjeve jo të ricikluara.<sup>93</sup>
38. Kur jep informacion shpjegues mbi përbërjen e **mbetjeve**, njësi ekonomike do të specifikojë:
- (a) fluksin e mbetjeve të rëndësishme për sektorin ose aktivitetet e saj (p.sh. Mbetjet minerale për njësitë ekonomike në sektorin minerar, mbetjet elektronike për njësitë ekonomike në sektorin e **konsumit** të elektronikës, ose mbetjet ushqimore për njësitë ekonomike në bujqësi ose në sektorin e turizmit); dhe;
  - (b) materialet që janë të pranishme në mbetjet (p.sh., biomasa, metalet, mineralet jo metale, plastika, tekstilet, lëndët e para kritike dhe të rralla të tokës).

<sup>93</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve të tregut financiar objekt të Rregullores (BE) 2019/2088 sepse vjen nga një tregues shtesë i lidhur me ndikimet negative kryesore siç paraqitet në treguesin #13 në Tabelën II të Aneksit I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese për investimet e qëndrueshme ("Norma e mbetjeve jo të riciklueshme").

39. Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues edhe për shumën totale të **mbetjeve të rrezikshme** dhe mbetjeve radioaktive të gjeneruara nga njësia ekonomike, ku mbetja radioaktive përkufizohet sipas nenin 3, pika (7) e Direktivës së Këshillit 2011/70/Euroatom.<sup>94</sup>
40. Njësi ekonomike do të japë informacioni kontekstual mbi metodologjitë e përdorura për të llogaritur të dhënat dhe në veçanti kriterin dhe supozimet e përdorura për të përcaktuar dhe klasifikuar produktet e projektuara sipas parimeve qarkulluese të paragrafit 35. Ajo do të specifikojë nëse të dhënat burojnë nga matje të drejtpërdrejta ose vlerësime; si dhe do të japë informacion shpjegues mbi supozimet kryesore të përdorura.

*Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E5-6 – Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet dhe mundësitë e lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese*

41. Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues mbi efektet financiare të parashikuara të rreziqeve dhe mundësive materiale që vijnë nga ndikimet e lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese.
42. Informacioni i kërkuar nga paragrafi 41 i shtohet informacionit mbi efektet financiare aktuale në pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset monetare të njësisë ekonomike, për periudhën e raportimit të kërkuar sipas ESRS 2 SBM-3, paragrafi 48, germa (d). Objektivi i kësaj Kërkese për Dhënie informacionesh shpjeguese është të lejojë kuptimin e:
- (a) **efekteve financiare të parashikuara** për shkak të **rreziqeve** materiale që vijnë nga ndikimet materiale të lidhura me përdorimin e burimeve dhe **ekonominë qarkulluese dhe varësitë** dhe sesi këto rreziqe kanë (ose mund të kenë në mënyrë të arsyeshme) një ndikim material në pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset monetare të njësisë ekonomike, në një periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë; dhe
- (b) efekteve financiare të parashikuara për shkak të mundësive materiale të lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese.
43. Dhënia e informacioneve shpjeguese do të përfshijë:
- (a) një përcaktim sasior të **efekteve financiare të parashikuara** në njësi monetare para se të merren në konsideratë veprime lidhur me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese, ose nëse nuk është e mundur pa kosto apo përpjekje të papërshtatshme, informacion cilësor. Nuk kërkohet një përcaktim sasior i **efekteve financiare** që vijnë nga mundësitë materiale nëse kjo dhënie informacionesh shpjeguese nuk plotëson karakteristikat cilësore të informacionit (shih Shtojcën B të ESRS 1 *Karakteristikat cilësore të informacionit*).

<sup>94</sup> Direktiva e Këshillit 2011/70/Euroatom e 19 korrikut 2011 që krijoi kuadrin Komunitar për përgjigjen dhe menaxhimin e sigurt të karburantit të përdorur dhe të mbetjeve radioaktive (GZ L 199, 2.8.2011, f. 48). Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve të tregut financiar objekt të Rregullores (BE) 2019/2088 sepse vjen nga një tregues i detyrueshëm i lidhur me ndikimet negative kryesore siç paraqitet në treguesin #9 në Tabelën II të Aneksit I, të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese për investimet e qëndrueshme ("Norma e mbetjeve të rrezikshme dhe e mbetjeve radioaktive").

- (b) një përshkrim të efekteve të marra në konsideratë, të ndikimeve dhe varësive me të cilat lidhen, si dhe horizontet kohore në të cilat ka mundësi të materializohen;
- (c) supozimet kryesore të përdorura për të përcaktuar nga ana sasiore **efektet financiare të parashikuara**, si dhe burimet dhe nivelin e pasigurisë së atyre supozimeve.

## Shtojca A. Kërkesat për Zbatim

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e ESRS E5. Ajo mbështet zbatimin e kërkesave për dhënie informacionesh shpjeguese të paraqitura në këtë standard dhe ka të njëjtin autoritet si dhe pjesët e tjera të Standardit.

### ESRS 2 Dhënie informacionesh shpjeguese të Përgjithshme

*Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë*

Kërkesë për dhënie informacionesh shpjeguese e lidhur me standardin ESRS 2 IRO-1 – Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese

- AR 1. Kur bën një vlerësim të **materialitetit** mbi nëntema të mjedisit, njësia ekonomike do të vlerësojë materialitetin e përdorimit të burimeve dhe ekonominë qarkulluese në veprimtarinë e saj dhe në pjesën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të saj të vlerës, si dhe mund të marrë në konsideratë katër fazat në vijim të njohura edhe si qasja LEAP:
- (a) Faza 1: lokalizohet se ku shfaqet ndërlidhja e veprimtarisë së vet dhe rrjedhës së sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të saj të vlerës** me natyrën;
  - (b) Faza 2: vlerësohen **varësitë** dhe ndikimet;
  - (c) Faza 3: vlerësohen rreziqet dhe mundësitë materiale;
  - (d) Faza 4: përgatiten dhe raportohen rezultatet e vlerësimit të materialitetit.
- AR 2. Lidhur me ESRS E5, fazat 1 dhe 2 mbështeten kryesisht në vlerësimet e **materialitetit** të realizuara sipas ESRS E1 (përfshirë konsumin e energjisë), ESRS E2 (ndotja), ESRS E3 (burimet detare, konsumi i ujit) dhe ESRS E4 (biodiversiteti, ekosistemet, lëndët e para). Në fakt, **ekonomia qarkulluese** ka si synim pakësimin e ndikimit të përdorimit të produkteve, materialeve dhe burimeve të tjera, duke minimizuar **mbetjet** dhe lëshimin e **substancave** të rrezikshme dhe duke pakësuar kështu ndikimet në natyrë. Kjo kërkesë për zbatim fokusohet kryesisht në fazën e tretë të kësaj qasjeje LEAP, ndërsa faza e katërt trajton rezultatin e procesit.
- AR 3. AR 3. Procesi i vlerësimit të **materialitetit** të **ndikimeve**, të **varësive**, të **rreziqeve** dhe të **mundësive**, do të marrë në konsideratë parashikimet në ESRS 2 IRO-1 Përshkrimi i proceseve

për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale, si dhe IRO-2 Kërkesat për Dhënie informacionesh shpjeguese në ESRS të mbuluara nga deklarata e qëndrueshmërisë e njësisë ekonomike.

AR 4. AR 4. Nën-temat e lidhura me përdorimin e burimeve dhe **ekonominë qarkulluese** të mbuluara nga vlerësimi i **materialitetit** përfshijnë:

- (a) **burime hyrëse**, që përfshijnë qarkullim e burimeve hyrëse të rëndësishme, duke marrë në konsideratë optimizimin e përdorimit të burimit, intensitetin e materialeve dhe produkteve, si dhe burimet e rinovueshme dhe jo të rinovueshme;
- (b) **burimet dalëse** të lidhura me produktet dhe shërbimet; dhe
- (c) **mbetjet**, duke përfshirë **menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme** dhe jo të rrezikshme.

AR 5. AR 5. Në Fazën 3, për të vlerësuar **rreziqet** dhe **mundësitë** materiale të saj bazuar në Fazat 1 dhe 2, njësia ekonomike mund të:

- (a) identifikojë **rreziqet e tranzicionit** dhe mundësitë në veprimtarinë e vet dhe në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të saj të vlerës**, duke përfshirë rrezikun e **skenarit** të vijimit të biznesit si zakonisht:
  - i. nga këndvështrimi i **politikës** dhe ligjit, p.sh., ndalimi i nxjerrjes dhe përdorimit të burimeve jo të rinovueshme, rregullime mbi trajtimin e **mbetjeve**;
  - ii. nga këndvështrimi i teknologjisë, p.sh., futja në treg e teknologjive të reja për të zëvendësuar përdorimin ekzistues të produkteve dhe materialeve;
  - iii. nga këndvështrimi i tregut, p.sh., riorientimi (devijimi) i ofertës, kërkesës dhe financimit;
  - iv. nga këndvështrimi i prestigjit, p.sh., ndryshimi i perceptimeve shoqërore, të klientëve ose të komunitetit.
- (b) identifikojë **rreziqet fizike** duke përfshirë shterimin e stokut dhe përdorimin e burimeve të rinovueshme dhe jo të rinovueshme, të virgjëra ose jo të virgjëra;
- (c) identifikojë mundësitë sipas kategorive:
  - i. rendimenti i burimeve: p.sh., tranzicioni drejt shërbimeve dhe proceseve më efektive që kërkojnë më pak burime, të projektuara në mënyrë ekologjike për **jetëgjatësi**, riparim, ripërdorim, riciklim, nën-produkt, sisteme të rimarrjes, ndarje të aktivitetit nga nxjerrja e materialeve, intensifikimi i përdorimit qarkullues të materialeve, krijimi i një sistemi që lejon dematerializimin (p.sh., numërtimi, përmirësimi i normës së përdorimit, pakësimi i peshës); praktika që sigurojnë se produktet dhe materialet janë mbledhur, klasifikuar dhe ripërdorur, riparuar, riprojektuar, riprodhuar;
  - ii. tregjet: p.sh., kërkesa për produkte dhe shërbime me intensitet më të ulët burimesh, si dhe modele të reja të konsumit si produkti si një shërbim, paguaj ndërsa e përdor, ndarja me të tjerë, marrja me qira financiare;

- iii. financimi: p.sh., mundësia e përdorimit të fondeve, obligacioneve ose huave të gjelbra (të lidhura me mjedisin);
- iv. qëndrueshmëria: p.sh., diversifikimi i burimeve dhe aktiviteteve të biznesit (p.sh., nisja e një njësie të re biznesi për të ricikluar materialet e reja), investimi në infrastruktura të gjelbra, adoptimi i mekanizmave të **riciklimit** dhe qarkullues që pakësojnë **varësitë**, aftësitë e njësisë ekonomike për të ruajtur stoqet e ardhshme dhe flukset e burimeve; dhe
- v. prestigji.

AR 6. Njësia ekonomike mund të marrë në konsideratë metodologjitë në vijim për të vlerësuar **ndikimet, rreziqet** dhe **mundësitë** e saj në veprimtarinë e vet dhe në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të saj të vlerës**:

- (a) Rekomandimi i Komisionit (BE) 2021/2279 mbi përdorimin e metodave të Gjurmës Mjedisore për të matur dhe komunikuar performancën mjedisore gjatë ciklit të jetës së produkteve dhe organizatave (Aneksi I – Gjurma Mjedisore e Produktit; Aneksi III – Gjurma Mjedisore e Organizatës); dhe
- (b) Analiza e Fluksit të Materialeve (MFA) nga Agjencia Evropiane e Mjedisit.

AR 7. Kur jep informacion mbi rezultatin e vlerësimit të saj të **materialitetit**, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë:

- (a) një listë të njësive të biznesit që shoqërojnë ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të lidhura me përdorimin e burimeve dhe **ekonominë qarkulluese** në kontekstin e produkteve dhe shërbimeve të njësisë ekonomike dhe të **mbetjeve** që ajo krijon;
- (b) një listë dhe një hierarki të burimeve materiale të përdorura nga njësia ekonomike;
- (c) ndikimet dhe rreziqet materiale të mbajtjes së status quo (biznesit si zakonisht);
- (d) mundësitë materiale të lidhura me një ekonomi qarkulluese;
- (e) ndikimet dhe rreziqet materiale të lidhura me tranzicionin drejt një ekonomie qarkulluese; dhe
- (f) fazat e **zinxhirit të vlerës** ku përqendrohen përdorimi i burimeve, rreziqet dhe ndikimet negative.

**Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E5-1 – Politikat e lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese**

AR 8. Politikat e përshkruara sipas kësaj Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese mund të përfshihen në politika më të gjera mjedisore ose për qëndrueshmërinë që mbulojnë nëntema të ndryshme.

AR 9. Kur jep informacionin për politikat e saj, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë nëse dhe si politikat e saj trajtojnë:

(a) **hierarkinë e mbetjeve**: (a) parandalimi; (b) përgatitja për ripërdorim; (c) **riciklimi**; (d) **rikuperimi** tjetër, p.sh., rikuperimi i energjisë; dhe (e) eliminimi. Në këtë kontekst, trajtimi i **mbetjeve** nuk mund të konsiderohet si një rikuperim;

(b) dhënien prioritet shmangies ose minimizimit të mbetjeve (Ripërdorimi, Riparimi, Riprojektimi, Riprodhimi dhe Ripropozimi) kundrejt trajtimit të mbetjeve (Riciklimit). Konceptet e projektimit ekologjik,<sup>95</sup> mbetja si një burim ose mbetjet pas konsumit (post konsumator) (në fund të një cikli jete të produktit të **konsumit**), duhet të merren gjithashtu në konsideratë.

AR 10. Kur përcakton politikat e saj, njësi ekonomike mund të marrë në konsideratë punimin “Sistemi i kategorizimit për ekonominë qarkulluese”, që përshkruan projektimin qarkullues dhe modelet e prodhimit, modelet e përdorimit qarkullues, modelet e **rikuperimit** të vlerës qarkulluese dhe mbështetjen qarkulluese me parimet e strategjive ose parimeve të nëntë “R” të **ekonomisë qarkulluese**: refuzoj, rimendoj, reduktoj, ripërdor, riparoj, rimodeloj, riprodhoj, ripropozoj dhe ricikloj.

Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E5-2 – Veprimet dhe burimet e lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese

AR 11. Kur jep informacion sipas paragrafit 17 dhe merr në konsideratë që burimet ndahen me të tjerë dhe që strategjitë e **ekonomisë qarkulluese** mund të kërkojnë veprime kolektive, njësi ekonomike mund të specifikojë **veprimet** e marra për t’u angazhuar në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të saj të vlerës** dhe/ose rrjetin e saj lokal në zhvillimin e bashkëpunimeve ose të nismave që rrisin qarkullimin e produkteve dhe materialeve.

AR 12. Në veçanti, njësi ekonomike mund të specifikojë sa vijon:

(a) sesi ajo kontribuon në ekonominë qarkulluese, duke përfshirë sistemet e mbledhjes inteligjente të **mbetjeve**;

(b) **palët e interesuara** të tjera të përfshira në **veprimet** kolektive: konkurrentët, **furnizuesit**, shitësit me pakicë, klientët, partnerët e tjerë të biznesit, komunitetet dhe autoritetet lokale, agjencitë qeveritare;

(c) një përshkrim të organizimit të bashkëpunimit ose të nismës, duke përfshirë kontributin specifik të njësisë ekonomike dhe rolet e grupeve të ndryshme të interesit në projekt.

AR 13. **Veprimet** mund të mbulojnë veprimtarinë e vet të njësisë ekonomike dhe/ose rrjedhën e sipërme ose të poshtme të zinxhirit të saj të vlerës.

---

<sup>95</sup> Siç përcaktohet nga Direktiva 2009/125/KE. Direktiva 2009/125/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 21 tetorit 2009 që krijoi një kuadër për vendosjen e kërkesave për projektimin ekologjik për produktet e lidhura me energjinë (GZ L 285, 31.10.2009, f. 10).

## *Metrikat dhe objektivat*

### Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E5-3 – Objektivat e lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese

- AR 14. Nëse njësi ekonomike i referohet **pragjeve ekologjike** kur vendos **objektivat**, ajo mund të përdorë udhëzuesin e Nismës për Objektiva të Bazuar në Shkencë për Natyrën (SBTN) në udhëzuesin paraprak (Udhëzuesi Fillestar për Bizneset, shtator 2020), ose çdo udhëzues tjetër me një metodologji të njohur shkencore që lejon vendosjen e objektivave të bazuar në shkencë duke identifikuar pragje ekologjike dhe, nëse është e zbatueshme, kuota specifike për njësinë ekonomike. Pragjet ekologjike mund të jenë lokale, kombëtare dhe/ose globale.
- AR 15. Kur jep informacionin mbi **objektivat**, njësi ekonomike do t'u japë prioritet objektivave në vlerë absolute.
- AR 16. Kur jep informacionin mbi **objektivat** sipas paragrafit 24, njësi ekonomike do të marrë në konsideratë fazën e prodhimit, fazën e përdorimit, si dhe fundin e jetës funksionale të produkteve dhe materialeve.
- AR 17. Kur jep informacion mbi **objektivat** e lidhura me **lëndët e para** të virgjëra, të rinovueshme sipas paragrafit 24, germa (c), njësi ekonomike do të marrë në konsideratë sesi këto objektiva mund të ndikojnë **humbjen e biodiversitetit**, gjithashtu e lidhur me ESRS E4.
- AR 18. Njësi ekonomike mund të japë informacion shpjegues mbi **objektiva** të tjerë sipas paragrafit 24, germa (f), përfshirë ata të lidhur me qëndrueshmërinë e burimeve. Nëse ndodh kështu, njësi ekonomike do të shpjegojë përkufizimin që ajo përdor për qëndrueshmërinë e burimeve dhe sesi ai lidhet me objektivat e paraqitur në paragrafin 22.
- AR 19. **Objektivat** mund të mbulojnë veprimtarinë e vet të njësisë ekonomike dhe/ose rrjedhën e sipërme ose të poshtme të zinxhirit të saj të vlerës.
- AR 20. Njësi ekonomike mund të specifikojë nëse objektivi trajton mungesat e lidhura me kriterin e Kontributit Thelbësor për Ekonominë Qarkulluese siç përkufizohet në aktet e deleguara të përdorura në zbatim të nenit 13, pika (2) të Rregullores (BE) 2020/852. Nëse nuk plotësohet kriteri "Mos Bëj Dëm të Rëndësishëm" (DNSH) për Ekonominë Qarkulluese siç përkufizohet në aktet e deleguara në zbatim të nenit 10, pika (3), nenit 11, pika (3), nenit 12, pika (2), nenit 14, pika (2) dhe nenit 15, pika (2) të Rregullores (BE) 2020/852, njësi ekonomike mund të specifikojë nëse objektivi trajton mungesat e lidhura me këto kritere DNSH.

### Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E5-4- Burimet hyrëse

- AR 21. **Burimet hyrëse** mund të mbulojnë kategoritë vijuese: pajisjet TI, tekstilet, mobilet, ndërtesat, makineritë e rënda, makineritë me peshë mesatare, makineritë e lehta, transportin e rëndë, transportin e peshës mesatare, transportin e lehtë dhe pajisjet e magazinës. Lidhur me

materialet, treguesit e burimeve hyrëse përfshijnë lëndët e para, **materialet ndihmëse të procesit** dhe produkte ose pjesët gjysmë të fabrikua.

- AR 22. Nëse njësia ekonomike duhet të zbatojë paragrafin 31, ajo mund të bëjë transparencë edhe për materialet që vijnë nga **nënproduktet** / fluksi i **mbetjeve** (p.sh., prerjet e një materiali që nuk janë përdorur më parë në një produkt).
- AR 23. Emëruesi i përqindjes së treguesit të kërkuar sipas paragrafit 31, germa (b) dhe paragrafit 31, germa (c), është pesha totale e përgjithshme e materialeve të përdorura gjatë periudhës së raportimit.
- AR 24. Të dhënat e përdorimit të raportuara duhet të pasqyrojnë materialin në gjendjen e tij fillestare dhe nuk duhet të paraqiten me të dhëna të tjera të përpunuara, të tilla si raportimi i materialit si “peshë e thatë”.
- AR 25. Në rastet ku ka një mbivendosje mes kategorive të ripërdorimit, të riciklimit, njësia ekonomike do të specifikojë sesi është shmangur llogaritja dy herë dhe zgjedhjet që janë bërë.

#### Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E5-5 – Burimet dalëse

- AR 26. Informacioni mbi produktet dhe materialet që duhet të jepet sipas paragrafit 35 u referohet të gjitha materialeve dhe produkteve që dalin nga procesi i prodhimit i njësisë ekonomike dhe që një shoqëri i hedh në treg (përfshirë **ambalazhimin**).
- AR 27. Për të llogaritur normën, njësia ekonomike do të përdorë si numërues peshën totale të përgjithshme të materialeve të përdorura gjatë periudhës së raportimit.
- AR 28. Njësia ekonomike mund të japë informacion shpjegues për angazhimin e saj në **menaxhimin e mbetjeve** në fund të jetës së produktit, për shembull përmes skemave të zgjeruara të përgjegjësisë së prodhuesit ose skemave merre mbrapsht.
- AR 29. Tipi i **mbetjeve** duhet të kuptohet si **mbetje e rrezikshme** ose mbetje jo e rrezikshme. Disa mbetje specifike, të tilla si mbetjet radioaktive mund të paraqiten edhe si një tip veçmas.
- AR 30. Kur merr në konsideratë flukset e **mbetjeve** të rëndësishme për sektorët ose aktivitetet e saj, njësia ekonomike mund të mbështetet në listën e përshkrimeve për mbetjet të Katalogut Evropian të Mbetjeve.
- AR 31. Shembuj të tipeve të tjera të operacioneve të **rikuperimit** sipas paragrafit 37, germa (b), pika (iii), mund të gjenden në Aneksin II të Direktivës 2008/98/KE (Direktiva Kuadër për Mbetjet).
- AR 32. Shembuj të llojeve të tjera të operacioneve të eliminimit sipas paragrafit 37, germa (c), pika (iii), mund të gjenden në Aneksin I të Direktivës 2008/98/KE (Direktiva Kuadër për Mbetjet).
- AR 33. Kur jep informacion kontekstual sipas paragrafit 40 njësia ekonomike mund të:

- (a) shpjegojë arsyet për peshat e larta të **mbetjeve** të drejtuara për eliminim (p.sh., rregullimet lokale që ndalojnë vendet e grumbullimit të mbetjeve (landfill) për lloje specifike të mbetjeve);
- (b) përshkruajë praktikën e sektori, standardet e sektorit ose rregullime nga jashtë që detyrojnë një operacion eliminimi specifik; dhe
- (c) specifikojë nëse të dhënat janë projektuar ose vijnë nga matje të drejtpërdrejta, të tilla si dokument transferimi i mbetjeve nga mbledhës të kontraktuar të mbetjeve.

**Kërkesë për Dhënie informacionesh shpjeguese E5-6 – Efektet financiare të parashikuara nga rreziqet dhe mundësitë e lidhura me përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese**

AR 34. Kur jep informacion sipas paragrafit 42, germa (b), njësia ekonomike mund të ilustrojë dhe përshkruajë sesi ajo synon të forcojë ruajtjen e vlerës.

AR 35. Njësia ekonomike mund të përfshijë një vlerësim të produkteve ose shërbimeve të saj përkatëse në rrezik në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, duke shpjeguar se si janë përkufizuar, sesi janë vlerësuar shumat financiare dhe cilat janë supozimet kryesore të bëra.

AR 36. Përcaktimi sasior i **efekteve financiare të parashikuara** në njësi monetare sipas paragrafit 43, germa (a) mund të jetë një interval.

## ESRS S1. FUQIA E VET PUNËTORE

### Përmbajtja

<b>Objektivi .....</b>	<b>246</b>
<b>Ndërveprimi me Standardet e tjera ESRS .....</b>	<b>248</b>
<b>Kërkesat për Dhënie Informacione Shpjeguese .....</b>	<b>248</b>
ESRS 2 Dhënie informacione shpjeguese të përgjithshme.....	248
Strategjia .....	248
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese në lidhje me ESRS 2	
SBM-2 – Interesat dhe pikëpamjet e palëve të interesuara.....	248
Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese në lidhje me standardin	
ESRS 2 SBM -3– Ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë dhe	
ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit .....	249

Menaxhimi i ndikimeve, rreziqeve dhe mundësive.....	250
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-1 – Politikat që lidhen me fuqinë e vet punëtore.....	250
▶ <b>C1</b> Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-2 – Proceset për angazhimin me fuqinë punëtore të vetë njësisë ekonomike dhe përfaqësuesit e punëtorëve në lidhje me ndikimet ◀.....	252
▶ <b>C1</b> Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-3 – Proceset për të ndrequr ndikimet negative dhe kanalet e komunikimit për fuqinë e vet punëtore për të ngritur shqetësime ◀.....	253
▶ <b>C1</b> Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-4 – Ndërmarrja e veprimeve mbi ndikimet materiale në fuqinë e vet punëtore, dhe qasjet për zbutjen e rreziqeve materiale dhe ndjekjen e mundësive që lidhen me fuqinë e vet punëtore, dhe efektiviteti i këtyre veprimeve ◀.....	255
Metrikat dhe objektivat.....	256
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-5 – Objektivat që lidhen me menaxhimin e ndikimeve negative materiale, avancimin e ndikimeve pozitive dhe menaxhimin e rreziqeve dhe mundësive materiale.....	256
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-6 – Karakteristikat e punonjësve të njësisë ekonomike.....	257
▶ <b>C1</b> Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-7 – Karakteristikat e personelit jo-punonjës brenda njësisë ekonomike ◀.....	258
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-8 – Mbulimi nëpërmjet negociatave kolektive dhe dialogut social.....	259
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-9 – Treguesit e diversitetit.....	260
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-10 – Paga të përshtatshme.....	260
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-11 – Mbrojtja sociale.....	261
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-12 – Personat me aftësi të kufizuara.....	262
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-13 – Treguesit e trajnimit dhe zhvillimit të aftësive.....	262
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-14 – Treguesit e shëndetit dhe sigurisë.....	262
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-15 – Treguesit e ekuilibrit midis punës dhe jetës personale.....	264
▶ <b>C1</b> Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-16 – Treguesit e shpërblimit (hendeku në paga dhe shpërblimi total) ◀.....	264

Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-17 – Incidente, ankesa dhe ndikime të rënda në të drejtat e njeriut.....	265
<b>Shtojca A. Kërkesat për Zbatim .....</b>	<b>267</b>
Objektivi .....	267
ESRS 2 Dhënie informacione shpjeguese të përgjithshme .....	268
Strategjia .....	268
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese në lidhje me standardin ESRS 2 SBM-2 – Interesat dhe pikëpamjet e palëve të interesuara .....	268
Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese në lidhje me standardin ESRS 2 SBM -3– Ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit .....	268
Menaxhimi i ndikimeve, rreziqeve dhe mundësive .....	269
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-1 – Politikat që lidhen me fuqinë e vet punëtore.....	269
▶ <b>C1</b> Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-2 – Proceset për angazhimin me fuqinë punëtore të vetë njësisë ekonomike dhe përfaqësuesit e punëtorëve në lidhje me ndikimet ◀.....	272
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-3 – Proceset për të ndrequr ndikimet negative dhe kanalet e komunikimit për fuqinë e vet punëtore për të ngritur shqetësime .....	274
▶ <b>C1</b> Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-4 – Ndërmarrja e veprimeve mbi ndikimet materiale në fuqinë e vet punëtore, dhe qasjet për zbutjen e rreziqeve materiale dhe ndjekjen e mundësive që lidhen me fuqinë e vet punëtore, dhe efektiviteti i këtyre veprimeve ◀....	275
Metrikat dhe objektivat .....	278
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-5 – Objektivat që lidhen me menaxhimin e ndikimeve materiale, avancimin e ndikimeve pozitive, si dhe me rreziqet dhe mundësitë.....	278
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-6 – Karakteristikat e Punonjësve të njësisë ekonomike .....	279
▶ <b>C1</b> Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-7 – Karakteristikat e personelit jo-punonjës brenda njësisë ekonomike ◀ .....	282
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-8 – Mbulimi nëpërmjet negociatave kolektive dhe dialogut social .....	284
Mbulimi nga marrëveshjet kolektive .....	284
Dialogu Social .....	285

Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-9 – Treguesit e diversitetit .....	286
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-10 – Paga të përshtatshme .....	286
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-11 – Mbrojtja sociale .....	287
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-12 – Personat me aftësi të kufizuara .....	287
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-13 – Treguesit e trajnimit dhe zhvillimit të aftësive .....	287
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-14 – Treguesit e shëndetit dhe sigurisë .....	288
Udhëzime për termin "të lidhura me punën" .....	288
Udhëzime për llogaritjen e shkallës së lëndimeve në punë .....	289
Udhëzime mbi sëmundjet e regjistruara në punë .....	290
Udhëzime për numrin e ditëve të humbura .....	290
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-15 – Ekuilibri midis punës dhe jetës personale .....	290
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-16 – Treguesit e shpërblimit (hendeku në paga dhe shpërblimi total) .....	291
Hendeku i pagave .....	291
Raporti i shpërblimit total .....	291
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-17 – Incidente, ankesa dhe ndikime të rënda në të drejtat e njeriut .....	292
<b>Shtojca A.1. Kërkesat për Zbatim për deklaratimet që lidhen me ESRS 2 .....</b>	<b>293</b>
<b>Shtojca A.2. Kërkesat për Zbatim për ESRS S1-1</b>	
<b>Politikat që lidhen me fuqinë e vet punëtore .....</b>	<b>295</b>
<b>► C1 Shtojca A.3. Kërkesat e Zbatimit për ESRS S1-4 Ndërmarrja e veprimeve mbi ndikimet materiale në fuqinë e vet punëtore, qasjet për menaxhimin e rreziqeve materiale dhe ndjekjen e mundësive materiale në lidhje me fuqinë e vet punëtore, dhe efektiviteti i këtyre veprimeve ◀ .....</b>	<b>297</b>
<b>Shtojca A.4. Kërkesat për Zbatimin e ESRS S1–5: Objektivat që lidhen me menaxhimin e ndikimeve negative materiale, nxitjen e ndikimeve pozitive dhe menaxhimin e rreziqeve dhe mundësive materiale .....</b>	<b>299</b>

## Objektivi

1. Objektivi i këtij Standardi është të specifikojë kërkesat për dhënie informacione shpjeguese të cilat do t'u mundësojnë **përdoruesve** të **deklaratës së qëndrueshmërisë** për të kuptuar **ndikimet** materiale të njësisë ekonomike mbi **fuqinë e vet punëtore**, si dhe **rreziqet** dhe **mundësitë** materiale që lidhen me to, duke përfshirë:
  - (a) si ndërmarrja ndikon në **fuqinë e vet punëtore**, në aspektin e ndikimeve materiale pozitive dhe negative aktuale ose të pritshme;
  - (b) çdo **veprim** të ndërmarrja dhe rezultati i veprimeve të tilla, për të parandaluar, zbutur ose ndrequr ndikimet negative aktuale ose të pritshme, dhe për të adresuar rreziqet dhe mundësitë;
  - (c) natyrën, llojin dhe shkallën e rreziqeve dhe mundësive materiale të njësisë ekonomike që lidhen me ndikimet dhe **varësitë** e saj mbi fuqinë e vet punëtore, dhe mënyrën se si ndërmarrja i menaxhon ato; dhe
  - (d) **efektet financiare** mbi njësinë ekonomike, në planin afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, të rreziqeve dhe mundësive materiale që rrjedhin nga ndikimet dhe varësia e saj prej fuqisë së vet punëtore.
2. Për të përmbushur objektivin, ky Standard kërkon gjithashtu një shpjegim të qasjes së përgjithshme që njësia ekonomike ndjek për të identifikuar dhe menaxhuar çdo **ndikim** material aktual dhe të pritshëm në **fuqinë e vet punëtore** në lidhje me faktorët ose çështjet e mëposhtme sociale, duke përfshirë të drejtat e njeriut:
  - (a) kushtet e punës, duke përfshirë:
    - i. punësimin e sigurt;
    - ii. kohën e punës;
    - iii. **pagat e duhura**;
    - iv. **dialogun social**;
    - v. lirinë e shoqërimit, ekzistencën e këshillave të punës dhe të drejtat e punëtorëve për informacion, konsultim dhe pjesëmarrje;
    - vi. **negociatat kolektive**, duke përfshirë nivelin e pagës së fuqisë punëtore të njësisë ekonomike që e mbulon marrëveshja kolektive;
    - vii. ekuilibrin punë-jetë; dhe
    - viii. shëndetin dhe sigurinë në punë.
  - (b) **trajtimin e barabartë** dhe **mundësitë** për të gjithë, duke përfshirë:
    - i. barazinë gjinore dhe pagën e barabartë për punë me vlerë të barabartë;
    - ii. **trajnimin** dhe **zhvillimin** e aftësive;

- iii. punësimin dhe përfshirjen e **personave me aftësi të kufizuara**;
- iv. masat kundër dhunës dhe **ngacmimit** në vendin e punës; dhe
- v. diversitetin.

(c) të drejtat e tjera që lidhen me punën, duke përfshirë ato që lidhen me:

- i. punën e fëmijëve;
- ii. **punën e detyruar**;
- iii. strehimin e përshtatshëm; dhe
- iv. privatësinë.

3. Ky Standard kërkon gjithashtu një shpjegim se si **ndikime** të tilla, si dhe **varësitë** e njësisë ekonomike në **fuqinë e vet punëtore**, mund të krijojnë **rreziqe** materiale ose **mundësi** për njësinë ekonomike. Për shembull, në çështjen e mundësive të barabarta, **diskriminimit** në punësim dhe kundërshtimi i ngritjes së grave në detyrë, mund të zvogëlojë qasjen e njësisë ekonomike në fuqinë punëtore të kualifikuar dhe të dëmtojë reputacionin e saj. Anasjelltas, politikat për të rritur përfaqësimin e grave në fuqinë punëtore dhe në nivelet e larta të menaxhimit mund të kenë efekte pozitive, të tilla si rritja e numrit të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe përmirësimi i reputacionit të njësisë ekonomike.
4. Ky Standard mbulon **fuqinë e vet punëtore** të një njësie ekonomike, e cila kuptohet se përfshin si personat që janë në një marrëdhënie pune me njësinë ekonomike ("**punonjësit**") dhe **jo-punonjësit** të cilët janë ose persona me kontrata me njësinë ekonomike për të ofruar shërbime ("persona të vetëpunësuar") ose persona të ofruar nga njësi ekonomike të angazhuara kryesisht në "aktivitete punësimi" (Kodi NACE N78). Shikoni Kërkesën 3 të Aplikimit për shembuj se kush quhet fuqia e punëtore. Informacioni që kërkohet të jepet në lidhje me jo-punonjësit nuk do të ndikojë në statusin e tyre sipas ligjit të punës në fuqi.
5. Ky Standard nuk i mbulon punëtorët në **zinxhirin e vlerës** në rrjedhën e sipërme ose të poshtme të njësisë ekonomike; këto kategori punëtorësh mbulohe në ESRS S2 *Punëtorët në zinxhirin e vlerës*.
6. Standardi kërkon që njësitë ekonomike të përshkruajnë **fuqinë e tyre punëtore**, duke përfshirë karakteristikat kryesore të **punonjësve** dhe **jo-punonjës** që janë pjesë e tij. Ky përshkrim u ofron **përdoruesve** një kuptim të strukturës së **fuqisë së vet punëtore** të njësisë ekonomike dhe ndihmon në kontekstualizimin e informacionit të dhënë përmes informacioneve të tjera të dhëna.
7. Objektivi i Standardit është gjithashtu t'u mundësojë **përdoruesve** të kuptohet shkalla në të cilën njësia ekonomike përputhet ose shkon krahas me instrumentet dhe konventat ndërkombëtare dhe evropiane për të drejtat e njeriut, duke përfshirë Deklaratën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, Parimet Udhëzuese të OKB-së mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut dhe Udhëzimet e OECD-së për Ndërmarrjet Shumëkombëshe, Deklaratën e

Organizatës Ndërkombëtare të Punës mbi Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë dhe konventat themelore të ILO-s, Konventën e OKB-së mbi Personat me Aftësi të Kufizuara, Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Kartën Sociale Evropiane të rishikuar, Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, **politikën** e BE-së, prioritetet e përcaktuara nga Shtylla Evropiane e të Drejtave Sociale dhe legjislacioni i Bashkimit Evropian duke përfshirë ligjin e BE-së për të drejtën e punës.

## Ndërveprimi me Standardet e tjera ESRS

8. Ky Standard duhet të lexohet së bashku me ESRS 1 Parimet e Përgjithshme dhe ESRS 2 Kërkesat e Përgjithshme.
9. Ky Standard duhet të lexohet së bashku me ESRS S2 Punëtorët në zinxhirin e vlerës, ESRS S3 Komunitetet e prekura dhe ESRS S4 Konsumatorët dhe përdoruesit fundorë.
10. ► **C1** Raportimi sipas këtij Standardi duhet të jetë i qëndrueshëm, koherent dhe, kur është e nevojshme, i lidhur qartë me raportimin mbi **punëtorët e zinxhirit të vlerës** së njësisë ekonomike sipas ESRS S2, me qëllim sigurimin e raportimit efektiv. ◀

## Kërkesat për Dhënie Informacione Shpjeguese

### ESRS 2 Dhënie informacione shpjeguese të përgjithshme

11. Kërkesat e këtij seksioni duhet të lexohen së bashku me informacionet shpjeguese të kërkuara nga ESRS 2 mbi Strategjinë (SBM). Informacionet e dhëna që rezultojnë duhet të paraqiten së bashku me informacionet e kërkuara nga ESRS 2, me përjashtim të ESRS 2 SBM-3, për të cilin njësi ekonomike ka një mundësi për të paraqitur informacionet shpjeguese së bashku me informacionet shpjeguese tematike.

### Strategjia

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese në lidhje me ESRS 2 SBM-2 – Interesat dhe pikëpamjet e palëve të interesuara*

12. Kur i përgjigjet ESRS 2 SBM-2, njësi ekonomike duhet të japë informacion se si interesat, pikëpamjet dhe të drejtat e njerëzve në fuqinë punëtore të saj, duke përfshirë respektin për të drejtat e tyre njerëzore, ndikojnë në strategjinë dhe **modelin e saj të biznesit**. **Fuqia punëtore** e vetë njësisë ekonomike është një grup kyç i **palëve të interesuara** të prekura.

*Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese në lidhje me standardin ESRS 2 SBM -3–  
Ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe  
modelin e biznesit*

13. Kur njësia ekonomike i përgjigjet ESRS 2 SBM-3 paragrafi 48, ajo duhet të japë këto informacione:
- (a) nëse dhe si **ndikimet** aktuale dhe të mundshme në **fuqinë e vet punëtore** siç identifikohet në ESRS 2 IRO-1 *Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale*: (i) burojnë ose janë të lidhura me strategjinë dhe **modelet e biznesit** të njësisë ekonomike, dhe (ii) informojnë dhe kontribuojnë në përshtatjen e strategjisë dhe modelit të biznesit të njësisë ekonomike; dhe
  - (b) marrëdhënien midis **rreziqeve** të saj materiale dhe **mundësive** që rrjedhin nga ndikimet dhe **varësitë** mbi fuqinë e vet punëtore dhe strategjinë dhe modelin e saj të biznesit.
14. Gjatë përmbushjes së kërkesave të paragrafit 48, njësia ekonomike duhet të japë informacion nëse të gjithë njerëzit në **fuqinë e saj punëtore** të cilët mund të ndikohen materialisht nga njësia ekonomike përfshihen në objektin e informacionit të dhënë prej saj sipas ESRS 2. Këto **ndikime** materiale do të përfshijë ndikimet që lidhen me aktivitetet e vetë njësisë ekonomike dhe **zinxhirin e saj të vlerës**, duke përfshirë përmes produkteve ose shërbimeve të saj, si dhe përmes marrëdhënieve të saj të biznesit. Përveç kësaj, njësia ekonomike duhet të ofrojë informacionin e mëposhtëm:
- (a) një përshkrim të shkurtër të llojeve të **punonjësve** dhe **jo-punonjës** të fuqisë së vet punëtore që i nënshtrohet ndikimeve materiale nga aktivitetet e saj, dhe të specifikojë nëse ata janë **punonjës**, persona të vetëpunësuar apo persona të ofruar nga njësi ekonomike si palë të treta të angazhuara kryesisht në aktivitete punësimi;
  - (b) në rastin e ndikimeve negative materiale, të shtjellojnë nëse ato janë (i) të përhapura gjerësisht apo sistemike në kontekstet ku vepron njësia ekonomike (për shembull, **puna e fëmijëve** ose **puna e sforcuar** ose punë e detyruar në vende ose rajone të caktuara jashtë BE-së), ose (ii) të lidhura me **incidente** individuale (për shembull, një aksident industrial ose një derdhje naftë);
  - (c) në rastin e ndikimeve pozitive materiale, një përshkrim të shkurtër të aktiviteteve që rezultojnë në ndikime pozitive, llojet e punonjësve dhe jo-punonjësve në fuqinë punëtore të saj që preken pozitivisht ose mund të preken pozitivisht; njësia ekonomike gjithashtu mund të japë informacion nëse ndikimet pozitive ndodhin në vende ose rajone specifike;
  - (d) çdo **rrezik** material dhe **mundësitë** për njësinë ekonomike që rrjedh nga ndikimet dhe **varësisë** prej fuqisë së vet punëtore;
  - (e) çdo ndikim material në **fuqinë e vet punëtore** që mund të vijë nga **planet e tranzicionit** për zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis dhe arritjen e aktiviteteve më të gjelbra dhe neutrale ndaj klimës, duke përfshirë informacionin mbi ndikimet në fuqinë punëtore të shkaktuara nga planet dhe **veprimet** e njësisë ekonomike për të ulur **emetimet** e

karbonit në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare. Ndikimet, rreziqet dhe mundësitë përfshijnë ristrukturimin dhe humbjen e punësimit, si dhe mundësitë që rrjedhin nga krijimi i vendeve të punës dhe rikualifikimi ose përmirësimi i aftësive;

(f) aktivitetet me rrezik të konsiderueshëm për **incidente** të **punës së sforcuar** ose punës së detyruar<sup>96</sup> qoftë në aspektin e:

- i. llojit të aktivitetit (si p.sh. fabrika e prodhimit); ose
- ii. vendeve ose zonave gjeografike me aktivitete që konsiderohen në rrezik;

(g) aktivitete me rrezik të konsiderueshëm të incidenteve të **punës së fëmijëve**<sup>97</sup> qoftë në aspektin e:

- i. llojit të aktivitetit (si p.sh. fabrika e prodhimit); ose
- ii. vendeve ose zonave gjeografike me aktivitete që konsiderohen në rrezik.

15. Në përshkrimin e llojeve kryesore të njerëzve të **fuqisë së vet punëtore** të cilët janë ose mund të preken negativisht, bazuar në **materialitetin** e vlerësimit të përcaktuar në ESRS 2 IRO 1, njësia ekonomike duhet të japë të dhëna nëse dhe si ka ndihmuar të kuptohet se si njerëzit me karakteristika të veçanta, ata që punojnë në kontekste të veçanta ose ata që ndërmarrin aktivitete të veçanta mund të jenë në rrezik më të madh dëmi.

16. Njësia ekonomike duhet të japë informacion se cilat nga **rreziqet** e saj materiale, nëse ka, dhe **mundësitë** që rrjedhin nga **ndikimet** dhe **varësitë** mbi njerëzit e **fuqisë së vet punëtore** lidhen me grupe specifike njerëzish (për shembull, grupe të caktuara moshe, ose njerëz që punojnë në një fabrikë ose vend të caktuar) në vend të të gjithë fuqisë punëtore të saj (për shembull, një ulje **page** në përgjithësi, ose një **trajnimi** që u ofrohet të gjithë anëtarëve të fuqisë e vet punëtore).

## Menaxhimi i ndikimeve, rreziqeve dhe mundësive

### *Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-1 – Politikat që lidhen me fuqinë e vet punëtore*

17. Njësia ekonomike duhet të përshkruajë politikat e saj që zbaton për të menaxhuar ndikimet materiale në fuqinë e saj punëtore, si dhe rreziqet dhe mundësitë materiale që lidhen me to.

---

<sup>96</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga tregues shtesë që lidhen me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohen nga treguesi #13 në Tabelën III të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacionit shpjegues mbi investimet e qëndrueshme ("Aktivitetet dhe furnizuesit në rrezik të konsiderueshëm të incidenteve të punës së sforcuar ose të detyruar").

<sup>97</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga tregues shtesë që lidhen me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohen nga treguesi #12 në Tabelën III të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacionit shpjegues mbi investimet e qëndrueshme ("Aktivitetet dhe furnizuesit në rrezik të konsiderueshëm të incidenteve të punës së fëmijëve").

18. Objektivi i kësaj Kërkese për Dhënie Informacion Shpjegues është të mundësojë një kuptim se deri në ç'masë njësia ekonomike ka **politika** që trajtojnë identifikimin, vlerësimin, menaxhimin dhe/ose **ndreqjen** e **ndikimeve** materiale mbi **fuqinë e saj punëtore**, si dhe politikat që mbulojnë ndikimet materiale, **rreziqet** dhe **mundësitë** lidhur me fuqinë e vet punëtore.
19. Informacioni i kërkuar nga paragrafi 17 duhet të përmbajë informacion mbi politikat e njësisë ekonomike për të menaxhuar **ndikimet** e saj materiale, **rreziqet** dhe **mundësitë** lidhur me **fuqinë e vet punëtore** në përputhje me ESRS 2 MDR-P *Politikat e miratuara për të menaxhuar çështjet e qëndrueshmërisë materiale*. Përveç kësaj, njësia ekonomike duhet të specifikojë nëse politika të tilla mbulojnë grupe specifike brenda fuqisë punëtore të saj apo të gjithë fuqinë punëtore të saj.
20. Njësia ekonomike duhet të përshkruajë angazhimet në **politikën** e saj të të drejtave të njeriut<sup>98</sup> që janë të rëndësishme për **fuqinë e vet punëtore**, duke përfshirë ato procese dhe mekanizma për të monitoruar pajtueshmërinë me Parimet Udhëzuese të OKB-së mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut, Deklaratën e ILO-s mbi Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë dhe Udhëzimet e OECD-së për Ndërmarrjet Shumëkombëshe.<sup>99</sup> Në informacionin e dhënë prej saj, ajo do të përqendrohet në ato çështje që janë materiale në lidhje me sa më poshtë, si dhe në qasjen e saj të përgjithshme ndaj:
- (a) respektimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e punës brenda fuqisë së vet punëtore;
  - (b) angazhimit me njerëzit brenda **fuqisë së vet punëtore**; dhe
  - (c) masave për të siguruar dhe/ose mundësuar **zgjidhje** për çështjet me ndikim në të drejtat e njeriut.
21. Njësia ekonomike duhet të japë informacion nëse dhe si politikat e saj në lidhje me fuqinë e vet punëtore janë në përputhje me instrumentet përkatëse të njohura ndërkombëtarisht, duke përfshirë Parimet Udhëzuese të OKB-së mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut.<sup>100</sup>

<sup>98</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues shtesë që lidhet me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohet nga treguesi #9 në Tabelën III të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e rregullat e dhënies së informacionit shpjegues mbi investimet e qëndrueshme ("Mungesa e një politike për të drejtat e njeriut").

<sup>99</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues i detyrueshëm që lidhet me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohet nga treguesi #11 në Tabelën I të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacionit shpjegues mbi investimet e qëndrueshme.

<sup>100</sup> Ky informacion mbështet nevojat e administratorëve të standardeve referuese për të shtjelluar informacionin shpjegues mbi faktorët ESG që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2020/1816, siç përcaktohet nga treguesi "Ekspozimi i portofolit të standardeve referuese ndaj kompanive pa politika të kujdesit të duhur mbi çështjet e trajtuara nga Konventat themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës 1 deri në 8" në seksionin 1 dhe 2 të Shtojcës II.

22. Njësia ekonomike duhet të deklarojë nëse politikat e saj në lidhje me **fuqinë e vet punëtore** adresojnë në mënyrë të qartë trafikimin e qenieve njerëzore,<sup>101</sup> **puna e sforcuar ose e detyruara dhe puna e fëmijëve**.
23. Njësia ekonomike duhet të deklarojë nëse ka një **politikë**, ose një sistem të menaxhimit për parandalimin e aksidenteve në vendin e punës.<sup>102</sup>
24. Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues:
- (a) nëse ka politika specifike që synojnë eliminimin e **diskriminimit**, përfshirë **ngacmimin**, promovimin e **mundësive të barabarta** dhe mënyra të tjera për të çuar përpara diversitetin dhe gjithë përfshirjen;
  - (b) nëse çështjet e mëposhtme për **diskriminim** mbulohen në mënyrë të veçantë në **politikën** e saj si: origjina racore dhe etnike, ngjyra, seksi, orientimi seksual, identiteti gjinor, aftësia e kufizuar, mosha, feja, mendimi politik, prejardhja kombëtare ose origjina sociale, ose forma të tjera të diskriminimit të trajtuara nga rregullorja e Bashkimit Evropian dhe ligjit kombëtar;
  - (c) nëse njësia ekonomike ka angazhime specifike në **politikën** e saj që lidhen me përfshirjen ose veprimet pozitive për njerëzit nga grupet në rrezik të veçantë cenueshmërie pjesë e **fuqisë së vet punëtore** dhe, nëse po, cilat janë këto angazhime; dhe
  - (d) nëse këto politika zbatohen dhe si zbatohen përmes procedurave specifike për të siguruar parandalimin dhe zbutjen e **diskriminimit**, si veprohet pasi të zbulohet, si dhe punohet për të çuar përpara diversitetin dhe përfshirjen në përgjithësi.

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-2 – Proceset për angazhimin me fuqinë punëtore të vetë njësisë ekonomike dhe përfaqësuesit e punëtorëve në lidhje me ndikimet*

25. Njësia ekonomike duhet të japë informacion për proceset e saj të përgjithshme për angazhimin me njerëzit në fuqinë e saj punëtore dhe përfaqësuesit e punëtorëve në lidhje me ndikimet aktuale dhe të mundshme në fuqinë punëtore të saj.
26. Objektivi i kësaj Kërkese për Dhënie informacioni shpjegues është të mundësojë një kuptim të mënyrës se si njësia ekonomike angazhohet, si pjesë e procesit të saj të vazhdueshëm të kujdesit të duhur, me njerëzit në **fuqinë punëtore të saj** dhe **përfaqësuesit e punëtorëve** rreth ndikimeve materiale, aktuale dhe të mundshme, pozitive dhe/ose negative që **ndikojnë** ose

<sup>101</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues shtesë që lidhet me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohet nga treguesi #11 në Tabelën III të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacionit shpjegues mbi investimet e qëndrueshme ("Mungesa e proceseve dhe masave për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore").

<sup>102</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues shtesë që lidhet me ndikimin kryesor negativ siç përcaktohet nga treguesi #1 në Tabelën III të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacionit shpjegues mbi investimet e qëndrueshme ("Investimet në kompani pa politika për parandalimin e aksidenteve në vendin e punës").

ka të ngjarë të ndikojnë mbi ta, dhe nëse është ky rasti, si merren parasysh perspektivat e fuqisë punëtore të njësisë ekonomike në proceset e vendimmarrjes.

27. Njësia ekonomike duhet të japë informacion nëse dhe si perspektivat e **fuqisë punëtore të saj** informojnë vendimet ose aktivitetet e saj që synojnë menaxhimin e **ndikimeve** aktuale dhe të mundshme mbi fuqinë e vet punëtore. Kjo do të përfshijë, kur është e nevojshme, një shpjegim:
- (a) nëse angazhimi ndodh drejtpërdrejt me fuqinë punëtore të njësisë ekonomike ose me përfaqësuesit e punëtorëve;
  - (b) të fazës(ve) në të cilën ndodh angazhimi, lloji i angazhimit dhe frekuenca e angazhimit;
  - (c) të funksionit dhe rolit më të lartë brenda njësisë ekonomike që ka përgjegjësinë operative për të siguruar që ky angazhim të ndodhë dhe që rezultatet të informojnë qasjen e njësisë ekonomike;
  - (d) atëherë kur është e aplikueshme, për ndonjë Marrëveshje Kornizë Globale ose marrëveshje të tjetër që njësia ekonomike ka me **përfaqësuesit e punëtorëve** në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut të **fuqisë punëtore të vet**, duke përfshirë një shpjegim se si marrëveshja i mundëson njësisë ekonomike të marrë njohuri mbi perspektivat e fuqisë punëtore të vet; dhe
  - (e) aty ku është e aplikueshme, si e vlerëson njësia ekonomike efektivitetin e angazhimit të saj me fuqinë e saj punëtore, duke përfshirë, aty ku është e nevojshme, çdo marrëveshje ose rezultat që rezulton nga kjo.
28. Kur është e aplikueshme, njësia ekonomike duhet të japë informacion për hapat që ajo ndërmerr për të kuptuar perspektivat e njerëzve në **fuqinë punëtore të saj**, ku këta të fundit mund të jenë veçanërisht të prekshëm dhe/ose të margjinalizuar ndaj ndikimeve (për shembull, gratë, emigrantët, personat me aftësi të kufizuara).
29. Nëse njësia ekonomike nuk mund të japë informacionin e kërkuar më sipër, sepse nuk ka miratuar një proces të përgjithshëm për t'u angazhuar me **fuqinë e saj punëtore**, ajo duhet ta bëjë të ditur këtë fakt. Ajo mund të japë informacion për një afat kohor brenda të cilit synon ta realizojë një proces të tillë.

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-3 – Proceset për të ndrequr ndikimet negative dhe kanalet e komunikimit për fuqinë e vet punëtore për të ngritur shqetësime*

30. **Njësia ekonomike duhet të përshkruajë proceset që ka në vend për të parashikuar ose bashkëpunuar në ndreqjen e ndikimeve negative tek njerëzit në fuqinë punëtore me të cilët është e lidhur njësia ekonomike, si dhe kanalet në dispozicion të fuqisë punëtore të saj për të ngritur shqetësime dhe për t'i adresuar ato.**
31. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacioni shpjegues është të mundësojë një kuptim të mjeteve formale me anë të të cilave **fuqia punëtore** e vetë njësisë ekonomike mund t'i

bëjnë të njohura shqetësimet dhe nevojat e tyre drejtpërdrejt njësisë ekonomike dhe/ose nëpërmjet të cilave njësisë ekonomike mbështet disponueshmërinë e kanaleve të tilla (për shembull, **mekanizmat e ankesave**) në vendin e punës, dhe si kryhet ndjekja e çështjeve të ngritura nga personat e interesuar dhe efektiviteti i këtyre kanaleve.

32. Njësia ekonomike duhet të përshkruajë proceset në fuqi të cilat mbulojnë çështjet e përcaktuara në paragrafin 2 të seksionit Objektivi duke dhënë informacionin shpjegues të mëposhtëm:
- (a) për qasjen e saj të përgjithshme dhe proceset për zgjidhjen ose kontributin në **zgjdhjen** e problemeve që kanë shkaktuar ose kontribuar në një **ndikim** negativ mbi njerëzit në **fuqinë punëtore të saj**, duke përfshirë nëse njësisë ekonomike vlerëson dhe si e vlerëson se **zgjdhja** e ofruar është efektive;
  - (b) për çdo kanal specifik që ka në dispozicion për **fuqinë e vet punëtore** për të ngritur shqetësimet ose nevojat e tyre drejtpërdrejt me njësinë ekonomike dhe se si kjo e fundit i ka adresuar ato, duke përfshirë nëse këto përcaktohen nga vetë njësisë ekonomike dhe/ose përmes pjesëmarrjes në mekanizma të palëve të treta;
  - (c) nëse njësisë ekonomike ka apo jo një **mekanizëm** për trajtimin e **ankesave** që lidhen me çështjet e punonjësve;<sup>103</sup> dhe
  - (d) për proceset përmes të cilave njësisë ekonomike mbështet disponueshmërinë e kanaleve të tilla në vendin e punës për fuqinë punëtore të saj; dhe
  - (e) si i gjurmon dhe monitoron çështjet e ngritura dhe të trajtuara, dhe si siguron efektivitetin e kanaleve, duke përfshirë edhe përfshirjen e **palëve të interesuara** të cilët janë **përdoruesit** e synuar.
33. Njësia ekonomike duhet të japë informacion nëse vlerëson dhe si vlerëson që njerëzit në **fuqinë e saj punëtore** janë në dijeni të këtyre strukturave ose proceseve dhe u besojnë atyre si një mënyrë për të ngritur shqetësimet ose nevojat e tyre dhe për t'i adresuar ato. Përveç kësaj, njësisë ekonomike duhet të japë informacion nëse ka politika në lidhje me mbrojtjen e individëve që i përdorin ato kundër hakmarrjes, përfshirë përfaqësuesit e punëtorëve. Nëse një informacion i tillë është dhënë në përputhje me ESRS G1-1, njësisë ekonomike mund t'i referohet atij informacioni.
34. Nëse njësisë ekonomike nuk mund të japë informacionin e kërkuar sa më sipër, sepse nuk ka miratuar një kanal për të ngritur shqetësime dhe/ose nuk mbështet disponueshmërinë e një kanali të tillë në vendin e punës për fuqinë e saj punëtore, ajo duhet ta deklarojë këtë si rast. Ajo mund të japë informacion për një afat kohor brenda të cilit synon të ketë një kanal të tillë

---

<sup>103</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues shtesë që lidhet me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohet nga treguesi #5 në Tabelën III të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e rregullat e dhënies së informacionit shpjegues mbi investimet e qëndrueshme ("Mungesa e mekanizmave të trajtimit të ankesave në lidhje me çështjet e punonjësve").

në funksion. Ajo mund të japë informacion për një afat kohor brenda të cilit synon ta realizojë një kanal të tillë.

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-4 – Ndërmarrja e veprimeve mbi ndikimet materiale në fuqinë e vet punëtore, dhe qasjet për zbutjen e rreziqeve materiale dhe ndjekjen e mundësive që lidhen me fuqinë e vet punëtore, dhe efektiviteti i këtyre veprimeve*

35. **Njësia ekonomike duhet të japë informacion se si ndërmerr veprime për të adresuar ndikimet negative dhe pozitive të rëndësishme, si dhe për të menaxhuar rreziqet dhe për të ndjekur mundësitë që lidhen me fuqinë punëtore të saj, si dhe efektivitetin e këtyre veprimeve.**
36. Objektivi i kësaj kërkesë për informacione shpjeguese është i dyfishtë. Së pari, për të mundësuar kuptimin e çdo **veprimi** dhe iniciative përmes së cilës ndërmarrja synon:
  - (a) për të parandaluar, zbutur dhe ndrequr **ndikimet** negative materiale mbi **fuqinë e vet punëtore**; dhe/ose
  - (b) për të arritur ndikime pozitive materiale për fuqinë e vet punëtore.Së dyti, është për të mundësuar një kuptim të mënyrave se si njësia ekonomike po adreson **rreziqet** materiale dhe duke ndjekur **mundësitë** lidhur me fuqinë e vet punëtore.
37. Njësia ekonomike duhet të ofrojë një përshkrim të përmbledhur të planeve të veprimit dhe burimeve për të menaxhuar **ndikimet, rreziqet dhe mundësitë** e saj të rëndësishme lidhur me **fuqinë e vet punëtore** në përputhje me ESRS 2 MDR-A Veprimet dhe burimet në lidhje me çështjet e qëndrueshmërisë materiale.
38. Në lidhje me **ndikimet** materiale që lidhen me **fuqinë e vet punëtore**, njësia ekonomike duhet të përshkruajë:
  - (a) **veprimet** e ndërmarrja, të planifikuara ose në proces për të parandaluar ose zbutur ndikimet negative materiale në fuqinë punëtore të saj;
  - (b) nëse ka ndërmarrë dhe si ka ndërmarrë veprime për të siguruar ose mundësuar **zgjdhjen** në lidhje me një ndikim real;
  - (c) çdo veprim ose iniciativë shtesë që ka në zbatim me qëllimin kryesor ofrimin e ndikimeve pozitive për fuqinë punëtore të saj; dhe
  - (d) si e gjurmon dhe vlerëson efektivitetin e këtyre veprimeve dhe iniciativave në ofrimin e rezultateve për fuqinë e vet punëtore.
39. Në lidhje me paragrafin 36, njësia ekonomike duhet të përshkruajë proceset përmes të cilave identifikon se cili veprim është i nevojshëm dhe i përshtatshëm në përgjigje të një **ndikimi** të veçantë negativ aktual ose të mundshëm që prek **fuqinë e vet punëtore**.
40. Në lidhje me **rreziqet** materiale dhe **mundësitë**, njësia ekonomike duhet të përshkruajë:

- (a) çfarë veprimi është planifikuar ose është duke u ndërmarrë për të zbutur rreziqet materiale për njësinë ekonomike që rrjedhin nga ndikimet dhe **varësitë** e saj tek **fuqia e vet punëtore** dhe si e gjurmon efektivitetin në praktikë; dhe
- (b) çfarë veprimi është planifikuar ose është duke u ndërmarrë për të ndjekur mundësitë materiale për njësinë ekonomike në lidhje me fuqinë punëtore të saj.
41. Njësia ekonomike duhet të japë informacion nëse siguron dhe si e siguron që praktikatat e saj nuk shkaktojnë ose kontribuojnë në ndikime negative materiale në **fuqinë e saj punëtore**, duke përfshirë, kur është e nevojshme, praktikatat e saj në lidhje me prokurimin, shitjet dhe përdorimin e të dhënave. Kjo mund të përfshijë dhënien e informacioneve shpjeguese rreth qasjes që ndiqet kur lindin tensione midis parandalimit ose zbutjes së ndikimeve negative materiale dhe presioneve të tjera të biznesit.
42. Kur jepet informacioni i kërkuar sipas paragrafit 40, njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë ESRS 2 MDR-T *Ndjekja e efektivitetit të politikave dhe veprimeve përmes objektivave*, nëse vlerëson efektivitetin e një veprimi duke vendosur një objektiv.
43. Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese se cilat burime janë përcaktuar për menaxhimin e ndikimeve të saj materiale, së bashku me informacionin që u lejon **përdoruesve** për të kuptuar se si menaxhohen ndikimet materiale.

## Metrikat dhe objektivat

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-5 – Objektivat që lidhen me menaxhimin e ndikimeve negative materiale, avancimin e ndikimeve pozitive dhe menaxhimin e rreziqeve dhe mundësive materiale*

44. **Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për objektivat e përcaktuara në kohë dhe të orientuara drejt rezultateve që mund të ketë vendosur në lidhje me:**
- (a) **zvogëlimin e ndikimeve negative në fuqinë e vet punëtore; dhe/ose**
- (b) **avancimin e ndikimeve pozitive në fuqinë e vet punëtore; dhe/ose**
- (c) **menaxhimin e rreziqeve dhe mundësive materiale që lidhen me fuqinë e vet punëtore.**
45. Objektivi i kësaj Kërkese për Dhënie informacioni shpjegues është të mundësojë një kuptim të masës në të cilën njësia ekonomike po përdor **objektiva** të orientuara drejt rezultateve për të nxitur dhe matur progresin e saj në adresimin e **ndikimeve** të saj negative dhe/ose avancimin e ndikimeve pozitive tek **fuqia e vet punëtore**, dhe/ose në menaxhimin e **rreziqeve** materiale dhe **mundësive** lidhur me fuqinë e vet punëtore.
46. Përshkrimi i përmbledhur i **objektivave** që njësia ekonomike ka vendosur për të menaxhuar **ndikimet** e saj materiale, **rreziqet dhe mundësitë** lidhur me **fuqinë e vet punëtore** duhet të përmbajë kërkesat e informacionit të përcaktuara në ESRS 2 MDR-T.

47. Njësia ekonomike duhet të japë informacion për procesin e përcaktimit të **objektivave**, duke përfshirë nëse njësia ekonomike është angazhuar dhe si është angazhuar drejtpërdrejt me **fuqinë e saj punëtore** ose me **përfaqësuesit e punëtorëve** në:
- (a) vendosjen e çdo objekti të tillë;
  - (b) ndjekjen e performancës së njësisë ekonomike kundrejt tyre; dhe
  - (c) identifikimin e çdo mësimi ose përmirësimi si rezultat i performancës së njësisë ekonomike.

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-6 – Karakteristikat e punonjësve të njësisë ekonomike*

48. **Njësia ekonomike duhet të përshkruajë karakteristikat kryesore të punonjësve në fuqinë punëtore të saj.**
49. Objektivi i kësaj Kërkese për Dhënie informacioni shpjegues është të ofrojë një pasqyrë të qasjes së njësisë ekonomike ndaj punësimit, duke përfshirë fushëveprimin dhe natyrën e **ndikimeve** që rrjedhin nga praktikat e saj të punësimit, të ofrojë informacion kontekstual që ndihmon në kuptimin e informacionit të raportuar në deklaratimet e tjera dhe për të shërbyer si bazë për llogaritjen e **metrikave** që do të shtjellohen sipas kërkesave të tjera të dhënies së informacionit shpjegues në këtë Standard.
50. Përveç informacionit të kërkuar nga paragrafi 40(a)iii të ESRS 2 *Informacioni i Përgjithshëm*, njësia ekonomike duhet të japë informacion:
- (a) për numrin e përgjithshëm të **punonjësve** në veta dhe ndarjeve sipas gjinisë dhe vendit për vendet në të cilat njësia ekonomike ka 50 ose më shumë punonjës që përfaqësojnë të paktën 10% të numrit të përgjithshëm të punonjësve të saj;
  - (b) për numrin e përgjithshëm në veta ose ekuivalentit me kohë të plotë (FTE) dhe:
    - i. sa janë punonjës të përhershëm të ndarë sipas gjinisë;
    - ii. sa janë punonjës të përkohshëm të ndarë sipas gjinisë; dhe
    - iii. sa janë punonjës me orë pune të pagarantuar të ndarë sipas gjinisë.
  - (c) për numrin e përgjithshëm të punonjësve që janë larguar nga njësia ekonomike gjatë periudhës raportuese dhe shkalla e qarkullimit të punonjësve në periudhën raportuese.
  - (d) një përshkrim të metodologjive dhe supozimeve të përdorura për të përpiluar të dhënat, duke përfshirë nëse shifrat raportohen:
    - i. në numër të punonjësve ose ekuivalent me kohë të plotë (FTE) (duke përfshirë një shpjegim se si përkufizohet termi “me kohë të plotë” FTE); dhe
    - ii. në fund të periudhës raportuese, si mesatare gjatë gjithë periudhës raportuese, ose duke përdorur një metodologji tjetër.

- (e) kur është e aplikueshme, të japë një informacioni kontekstual të nevojshëm për të kuptuar të dhënat (për shembull, për të kuptuar luhatjet në numrin e punonjësve gjatë periudhës së raportimit); dhe
- (f) një referencë të kryqëzuar të informacionit të raportuar sipas (a) më sipër me numrin më përfaqësues të pasqyrave financiare.

- 51. Për informacionin e specifikuar në pikën (b) të paragrafit 50, njësia ekonomike mund të japë gjithashtu informacion për ndarjen sipas rajonit.
- 52. Njësia ekonomike mund të japë informacionin e mëposhtëm, sipas numrit të punonjësve ose ekuivalentit me kohë të plotë (FTE):
  - (a) **punonjës** me kohë të plotë të ndarë sipas gjinisë dhe rajonit; dhe
  - (b) punonjës me kohë të pjesshme të ndarë sipas gjinisë dhe rajonit.

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-7 – Karakteristikat e personelit jo-punonjës brenda njësisë ekonomike*

- 53. **Njësia ekonomike duhet të përshkruajë karakteristikat kryesore të personelit jo-punonjës në fuqinë punëtore të saj.**
- 54. Objektivi i kësaj Kërkese për Dhënie informacioni shpjegues është të ofrojë një pasqyrë të qasjes së njësisë ekonomike ndaj punësimit, duke përfshirë fushëveprimin dhe natyrën e **ndikimeve** që rrjedhin nga praktikatat e saj të punësimit, të ofrojë informacion kontekstual që ndihmon në kuptimin e informacionit të raportuar në deklaratimet e tjera dhe për të shërbyer si bazë për llogaritjen e **metrikave** që do të shtjellohen sipas kërkesave të tjera të dhënies së informacionit shpjegues në këtë Standard. Gjithashtu, kjo lejon të kuptohet se sa shumë ndërmarrja mbështetet te **jo-punonjësit** si pjesë e fuqisë punëtore të saj.
- 55. Informacionin që kërkohet nga paragrafi 53 duhet të përfshijë::
  - (a) një deklaratim të numrit të përgjithshëm të **jo-punonjësve** të **fuqisë së vet punëtore** të njësisë ekonomike, d.m.th., ose njerëz që kanë kontratë me njësinë ekonomike për të ofruar fuqinë punëtore ("persona të vetë punësuar") ose njerëz të ofruar nga njësitet ekonomike të angazhuara kryesisht në "aktivitete punësimi" (Kodi NACE N78).
  - (b) një shpjegim të metodologjive dhe supozimeve të përdorura për të përpiluar të dhënat, duke përfshirë nëse numri i jo-punonjësve raportohet:
    - i. tek numri i punonjësve ose ekuivalent me kohë të plotë (FTE) (duke dhënë një përkufizim se çfarë përkufizohet si kohë e plotë FTE); dhe
    - ii. në fund të periudhës raportuese, si mesatare gjatë gjithë periudhës raportuese, ose duke përdorur një metodologji tjetër.
  - (c) kur është e aplikueshme, një informacion kontekstual të nevojshëm për të kuptuar të dhënat (për shembull, luhatje të konsiderueshme në numrin e jo-punonjësve në **fuqinë**

**punëtore** të njësisë ekonomike gjatë periudhës së raportimit dhe midis periudhës aktuale dhe asaj të mëparshme të raportimit).

56. Për informacionin e specifikuar në pikën (a) të paragrafit 55, njësia ekonomike mund të japë informacion për llojet më të zakonshme të **jo-punonjësve** (për shembull, persona të vetëpunësuar, persona të ofruar nga njësitë ekonomike që kryejnë kryesisht aktivitete punësimi dhe lloje të tjera që lidhen me njësinë ekonomike), marrëdhënia e tyre me njësinë ekonomike dhe lloji i punës që ata kryejnë.
57. Kur të dhënat nuk janë të disponueshme, njësia ekonomike duhet të vlerësojë numrin dhe të deklarojë se e ka bërë këtë. Kur njësia ekonomike kryen vlerësime, ajo duhet të përshkruajë bazën e përgatitjes së këtij vlerësimi.

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-8 – Mbulimi nëpërmjet negociatave kolektive dhe dialogut social*

58. ► **C1 Njësia ekonomike duhet të japë informacion mbi masën në të cilën kushtet e punës dhe kushtet e punësimit të punonjësve të saj përcaktohen ose ndikohen nga marrëveshjet kolektive të negociuara dhe mbi masën në të cilën punonjësit e saj përfaqësohen në dialogun social në Zonën Ekonomike Evropiane (EEA).** ◀
59. Objektivi i kësaj Kërkese për Dhënie informacioni shpjegues është të mundësojë një kuptim se në çmasë **punonjësit** e vetë njësisë ekonomike mbulohen nëpërmjet **marrëveshjeve kolektive** të negociuara dhe **dialogut social**.
60. Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues:
- (a) për përqindjen e numrit të përgjithshëm të **punonjësve** të saj që mbulohen nga **marrëveshjet kolektive** të negociuara;
- (b) për vendet e Zonës Ekonomike Evropiane (EEA), pavarësisht nëse ka një ose më shumë **marrëveshje kolektive të negociuara** dhe, nëse po, përqindjen e përgjithshme e **punonjësve** të saj të mbuluar nga marrëveshje të tilla për secilin vend në të cilin ka punësim të konsiderueshëm, të përcaktuar si të paktën 50 punonjës sipas numrit të punonjësve që përfaqësojnë të paktën 10% të numrit të përgjithshëm të punonjësve të saj; dhe
- (c) për vendet jashtë EEA-së, përqindjen e punonjësve të vet të mbuluar nga marrëveshjet kolektive të negociuara sipas rajonit.
61. Për **punonjësit** nuk mbulohet nga **marrëveshje kolektive të negociuara**, njësia ekonomike mund të japë informacion nëse ajo i përcakton kushtet e punës dhe kushtet e punësimit bazuar në marrëveshjet kolektive të negociuara që mbulojnë punonjësit e tjerë të saj ose bazuar në marrëveshjet kolektive të negociuara nga njësi ekonomike të tjera.

62. Njësia ekonomike mund të japë informacion për masën në të cilën kushtet e punës dhe kushtet e punësimit të **jo-punonjësve** të **fuqisë së vet punëtore** përcaktohen ose ndikohen nga **marrëveshje kolektive të negociuara**, duke përfshirë një vlerësim të përmasës së mbulimit.
63. Njësia ekonomike duhet të japë informacionin e mëposhtëm në lidhje me **dialogun social**:
- (a) përqindjen e përgjithshme të **punonjësve** të mbuluar nga përfaqësuesit e punëtorëve, të raportuara në nivel vendi për secilin vend të EEA-së në të cilin njësia ekonomike ka punësim të konsiderueshëm; dhe
- (b) ekzistencën e ndonjë marrëveshjeje me punonjësit e saj për përfaqësim nga një Këshill Evropian i Punës (KEV), një Këshill Punës i Shoqërisë Europaea (SE) ose një Këshill Punës i Shoqërisë së Koperativave Europaea (SCE).

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-9 – Treguesit e diversitetit*

64. **Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpërndarjen gjinore në nivelet e larta të menaxhimit dhe shpërndarjen sipas moshës midis punonjësve të saj.**
65. Objektivi i kësaj Kërkese për Dhënie informacioni shpjegues është të mundësojë një kuptim të diversitetit gjinor në nivelin e lartë të menaxhimit dhe shpërndarjen sipas moshës të **punonjësve** të saj.
66. Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për:
- (a) shpërndarjen gjinore në numër dhe përqindje në nivelin e lartë të menaxhimit; dhe
- (b) shpërndarjen e **punonjësve** sipas grupmoshës: nën 30 vjeç; 30-50 vjeç; mbi 50 vjeç.

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-10 – Paga të përshtatshme*

67. **Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues nëse punonjësit e saj paguhen apo jo me një pagë të përshtatshme, dhe nëse jo të gjithëve u paguhet një pagë e përshtatshme, vendet ku punojnë dhe përqindjen e punonjësve përkatës.**
68. Objektivi i kësaj Kërkese për Dhënie informacioni shpjegues është të mundësojë një kuptim nëse të gjithë **punonjësit** e njësisë ekonomike paguhen me një **pagë të përshtatshme**, në përputhje me standardet përkatëse.
69. Njësia ekonomike duhet të japë informacion nëse të gjithë **punonjësit** e saj paguhen me një **pagë të përshtatshme**, në përputhje me standardet përkatëse. Nëse po, një deklaratë që pohon këtë do të jetë e mjaftueshme për të përmbushur këtë kërkesë për deklaram dhe nuk nevojiten informacione të mëtejshme.
70. Nëse jo të gjithë **punonjësit** e saj paguhen me një **pagë të përshtatshme** në përputhje me standardet përkatëse, njësia ekonomike duhet të japë informacion vendet ku punonjësit

paguhen nën nivelin e pagës së përshtatshme të zbatueshme dhe përqindjen e punonjësve që paguhen nën nivelin e pagës së përshtatshme të zbatueshme për secilin prej këtyre vendeve.

71. Njësia ekonomike mund të japë gjithashtu informacionin të specifikuar në këtë kërkesë për dhënie informacioni shpjegues në lidhje me **jo-punonjësit**. në fuqinë punëtore të saj.

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-11 – Mbrojtja sociale*

72. **Njësia ekonomike duhet të japë informacion nëse punonjësit e saj mbulojnë nga mbrojtja sociale kundër humbjes së të ardhurave për shkak të ngjarjeve të mëdha në jetë, dhe, nëse jo, vendet ku nuk është ky rast.**

73. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacioni shpjegues është të mundësojë një kuptim nëse **punonjësit** e njësisë ekonomike janë të mbuluar me **mbrojtje sociale** kundër humbjes së të ardhurave për shkak të ngjarjeve të mëdha në jetë, dhe, nëse jo, vendet ku nuk është ky rasti.

74. Njësia ekonomike duhet të japë informacion nëse të gjithë **punonjësit** e saj janë të mbuluar nga **mbrojtja sociale**, përmes programeve publike ose përmes përfitimeve të ofruara nga njësia ekonomike, kundër humbjes së të ardhurave për shkak të ndonjë prej ngjarjeve të mëdha të jetës në vijim:

- (a) sëmundje;
- (b) papunësia që fillon nga momenti kur punonjësi punon për njësinë ekonomike;
- (c) lëndime në punë dhe paaftësi e shkaktuar gjatë jetës (jo e lindur);
- (d) leje prindërore; dhe
- (e) dalje në pension.

Nëse po, një deklaratë që pohon këtë është e mjaftueshme për të përmbushur këtë kërkesë për deklaram dhe nuk nevojitet asnjë informacion i mëtejshëm.

75. Nëse jo të gjithë **punonjësit** e saj janë të mbuluar me **mbrojtje sociale** në përputhje me paragrafin 72, njësia ekonomike duhet të japë informacion gjithashtu vendet ku punonjësit nuk kanë mbrojtje sociale në lidhje me një ose më shumë nga llojet e ngjarjeve të listuara në paragrafin 72 dhe për secilin prej këtyre vendeve llojet e punonjësve që nuk kanë mbrojtje sociale në lidhje me çdo ngjarje të rëndësishme jetësore përkatëse.

76. Njësia ekonomike mund të japë gjithashtu informacionin të specifikuar në këtë kërkesë për dhënie informacioni shpjegues në lidhje me **jo-punonjësit**. në fuqinë punëtore të saj.

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-12 – Personat me aftësi të kufizuara*

77. **Njësia ekonomike duhet të japë informacion mbi përqindjen e punonjësve të saj me aftësi të kufizuara.**
78. Objektivi i kësaj Kërkese për Dhënie informacioni shpjegues është të mundësojë një kuptim të masës në të cilën **personat me aftësi të kufizuara** përfshihen midis **punonjësve** të njësisë ekonomike.
79. ► **C1** Njësia ekonomike duhet të japë informacion përqindjen e **personave me aftësi të kufizuara** midis **punonjësve** të saj, në varësi të kufizimeve ligjore për mbledhjen e të dhënave.  
◀
80. Njësia ekonomike mund të japë informacion përqindjen e **punonjësve** me aftësi të kufizuara me një ndarje sipas gjinisë.

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-13 – Treguesit e trajnimit dhe zhvillimit të aftësive*

81. **Njësia ekonomike duhet të japë informacion për shkallën në të cilën trajnimi dhe zhvillimi i aftësive u ofrohen punonjësve të saj.**
82. Objektivi i kësaj Kërkese për Dhënie informacioni shpjegues është të mundësojë një kuptim të **trajnimit** dhe **zhvillimit** të aftësive dhe aktivitete të lidhura me to që u janë ofruar **punonjësve**, brenda kontekstit të rritjes së vazhdueshme profesionale, për të përmirësuar aftësitë e punonjësve dhe për të lehtësuar punësimin e vazhdueshëm.
83. Informacionin që kërkohet nga paragrafi 81 duhet të përfshijë::
- (a) përqindjen e **punonjësve** që morën pjesë në rishikimin e rregullt të performancës dhe **zhvillimit** të karrierës; një informacion i tillë duhet të ndahet sipas gjinisë;
- (b) numrin mesatar të orëve të **trajnimit** për punonjës dhe sipas gjinisë.
84. Njësia ekonomike mund të japë informacion ndarje sipas kategorisë së punonjësve për përqindjen e punonjësve që morën pjesë në rishikimin e rregullt të performancës, në zhvillim karrierës dhe për numrin mesatar të orëve të trajnimit për punonjës.
85. Njësia ekonomike mund të japë gjithashtu informacionin të specifikuar në këtë kërkesë për dhënie informacioni shpjegues në lidhje me **jo-punonjësit**. në fuqinë punëtore të saj.

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-14 – Treguesit e shëndetit dhe sigurisë*

86. **Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues mbi masën në të cilën fuqia punëtore e saj mbulohet nga sistemi i saj i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë dhe numrin e incidenteve që lidhen me lëndimet në punë, sëmundjet dhe vdekjet e fuqisë punëtore të saj. Përveç kësaj, ajo duhet të japë informacion mbi numrin e vdekjeve si rezultat i**

**lëndimeve në punë dhe sëmundjeve të lidhura me punën të punëtorëve të tjerë që punojnë në adresat ku njësia ekonomike ushtron aktivitet.**

87. Objektivi i kësaj Kërkese për Dhënie informacioni shpjegues është të japë mundësi që të kuptohet cili është mbulimi, cilësia dhe performanca e sistemit të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë së krijuar për të parandaluar **lëndimet që lidhen me punën**.
88. Informacioni i kërkuar nga paragrafi 86 duhet të përfshijë të dhënat e mëposhtme, kur është e zbatueshme, të ndara midis **punonjës** dhe **jo-punonjës** të **fuqisë së vet punëtore** të njësisë ekonomike:
- (a) përqindjen e njerëzve të fuqisë së vet punëtore që mbulohej nga sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë së njësisë ekonomike bazuar në kërkesat ligjore dhe/ose standardet ose udhëzimet e njohura;
  - (b) numrin e viktimave<sup>104</sup> si pasojë e **lëndimeve të lidhura me punën** dhe **sëmundjeve të lidhura me punën**;
  - (c) numrin dhe shkalla e aksidenteve të regjistruara në punë;
  - (d) në lidhje me punonjësit e njësisë ekonomike, numrin e rasteve të **sëmundjeve të regjistruara në punë**, të cilat i nënshtrohen kufizimeve ligjore për mbledhjen e të dhënave; dhe
  - (e) në lidhje me punonjësit e njësisë ekonomike, numrin e ditëve të humbura për shkak të lëndimeve dhe vdekjeve në punë nga aksidentet në punë, sëmundjeve të lidhura me punën dhe vdekjeve nga sëmundjet<sup>105</sup>

Informacioni për pikën (b) duhet të raportohet gjithashtu edhe për punëtorët e tjerë që punojnë në **vendet** e njësisë ekonomike, siç janë **punëtorët e zinxhirit të vlerës** nëse ata punojnë në këto vende të njësisë ekonomike.

89. Njësia ekonomike mund të japë gjithashtu informacionin e specifikuar në pikat (d) dhe (e) të paragrafit 88 në lidhje me **jo-punonjësit**.
90. Përveç kësaj, njësia ekonomike mund të përfshijë informacionin shtesë të mëposhtëm mbi mbulimin e shëndetit dhe sigurisë: përqindjen e punonjësve të saj të mbuluar nga një sistem menaxhimi i shëndetit dhe sigurisë i cili bazohet në kërkesat ligjore dhe/ose standardet ose

---

<sup>104</sup> Ky informacion mbështet nevojat informative të administratorëve të standardeve për të shtjelluar informacionin për faktorët ESG në përputhje me Rregulloren (BE) 2020/1816, siç përcaktohet nga treguesi "Raporti mesatar i ponderuar i aksidenteve, lëndimeve, vdekjeve" në seksionin 1 dhe 2 të Shtojcës II. Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues shtesë që lidhet me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohet nga treguesi #2 në Tabelën III të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacionit shpjegues mbi investimet e qëndrueshme ("Shkalla e aksidenteve") dhe administratorët e standardeve për të shtjelluar informacionin për faktorët ESG që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2020/1816, siç përcaktohet nga treguesi "Raporti mesatar i ponderuar i aksidenteve, lëndimeve, vdekjeve" në seksionin 1 dhe 2 të Shtojcës II.

<sup>105</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues shtesë që lidhet me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohet nga treguesi #3 në Tabelën III të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacionit mbi investimet e qëndrueshme ("Numri i ditëve të humbura për shkak të lëndimeve, aksidenteve, vdekjeve ose sëmundjeve").

udhëzimet e njohura dhe i cili është audituar së brendshmi dhe/ose i audituar ose certifikuar nga një palë e jashtme.

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-15 – Treguesit e ekuilibrit midis punës dhe jetës personale*

91. **Njësia ekonomike duhet të japë informacion masën në të cilën punonjësit kanë të drejtë për leje familjare dhe e shfrytëzojnë atë.**
92. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacioni shpjegues është të ofrojë një kuptim të të drejtës dhe praktikave aktuale midis **punonjësve** që të marrin leje që lidhen me arsye familjare në mënyrë të barabartë gjinore, pasi është një nga dimensionet e **ekuilibrit midis punës dhe jetës personale**.
93. Informacionin që kërkohet nga paragrafi 91 duhet të përfshijë::
  - (a) përqindjen e **punonjësve** me të drejtë për të marrë leje për arsye familjare; dhe
  - (b) përqindjen e punonjësve me të drejtë që kanë marrë leje për arsye familjare dhe një ndarje sipas gjinisë.
94. Nëse të gjithë **punonjësit** e njësisë ekonomike kanë të drejtë për leje familjare përmes politikës sociale dhe/ose **marrëveshjeve kolektive** të negociuara, mjafton të jepet ky informacion në mënyrë që të përmbushet kërkesa e paragrafit 93a.

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-16 – Treguesit e shpërblimit (hendeku në paga dhe shpërblimi total)*

95. **Njësia ekonomike duhet të japë informacion për përqindjen e hendekut në paga midis punonjësve të saj femra dhe meshkuj dhe raportin midis shpërblimit të individit më të paguar dhe shpërblimit mesatar për punonjësit e saj.**
96. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacioni shpjegues është i dyfishtë: të lejojë një kuptim të shkallës së çdo hendeku në **pagë** midis grave dhe burrave midis **punonjësve** të njësisë ekonomike; dhe për të dhënë një pasqyrë të nivelit të pabarazisë në paga brenda njësisë ekonomike dhe nëse ekzistojnë pabarazi të mëdha në paga.
97. Informacionin që kërkohet nga paragrafi 95 duhet të përfshijë::
  - (a) hendekun e **pagës** gjinore, i përcaktuar si ndryshimi i niveleve mesatare të pagave midis punonjësve femra dhe meshkuj, i shprehur si përqindje e nivelit mesatar të pagave të punonjësve meshkuj;<sup>106</sup>

---

<sup>106</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion: të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues i detyrueshëm që lidhet me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohet nga treguesi #12 në Tabelën I të Shtojcës I të Rregullores së Deleuar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacionit shpjegues mbi

- (b) raportin **e shpërblimit total vjetor** i individit më të paguar me shpërblimin mesatar vjetor total për të gjithë **punonjësit** (duke përjashtuar individin me pagesën më të lartë);<sup>107</sup> dhe
- (c) kur është e aplikueshme, çdo informacion kontekstual i nevojshëm për të kuptuar të dhënat dhe mënyrën se si janë përpiluar të dhënat, si dhe ndryshime të tjera në të dhënat bazë që duhen marrë në konsideratë.

98. Njësia ekonomike mund të japë si informacion një ndarje të **pagës** sipas hendekut të gjinisë siç përcaktohet në paragrafin 97(a) sipas kategorisë së punonjësve dhe/ose sipas vendit/segmentit. Njësia ekonomike gjithashtu mund të japë informacion për hendekun gjinor në paga midis punonjësve sipas kategorive të punonjësve, të ndarë sipas pagës bazë të zakonshme dhe komponentëve plotësues ose të ndryshueshëm.
99. Në lidhje me paragrafin 97 (b), njësia ekonomike mund ta raportojë këtë shifër të rregulluar për ndryshimet e fuqisë blerëse midis vendeve, dhe në këtë rast duhet të raportojë metodologjinë e përdorur për llogaritjen

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-17 – Incidente, ankesa dhe ndikime të rënda në të drejtat e njeriut*

100. ► **C1 Njësia ekonomike duhet të japë informacion numrin e incidenteve dhe/ose ankesave që lidhen me punën dhe ndikimet e rënda në të drejtat e njeriut brenda fuqisë punëtore të saj, si dhe çdo gjobë, sanksion ose kompensim përkatës për periudhën raportuese.** ◀
101. Objektivi i kësaj Kërkese për Dhënie informacioni shpjegues është të lejojë një kuptim të shkallës në të cilën të dhënat për **incidentet e lidhura me punën** dhe rastet e rënda të **me ndikim** në të drejtat e njeriut ndikojnë në **fuqinë e vet punëtore**.
102. Dhënia e informacionit të kërkuar nga paragrafi 100 do të përfshijë, në përputhje me rregulloret përkatëse të privatësisë, të dhënat e **incidenteve të lidhura me punën të diskriminimit** në bazë të gjinisë, origjinës racore ose etnike, kombësisë, fesë ose besimit, aftësisë së kufizuar, moshës, orientimit seksual ose formave të tjera përkatëse të diskriminimit që përfshijnë **palë të interesuara** të brendshme dhe/ose të jashtme në të gjitha aktivitetet në periudhën raportuese. Kjo përfshin incidentet e **ngacmimit** si një formë specifike e diskriminimit.
103. Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për:

---

investimet e qëndrueshme ("Hendeku gjinor mesatar i ponderuar në paga"); dhe administratorëve të standardeve për të shtjelluar informacionin për faktorët ESG në varësi të Rregullores (BE) 2020/1816, siç përcaktohet nga treguesi "Hendeku mesatar i ponderuar gjinor në pagat" në seksionin 1 dhe 2 të Shtojcës II.

<sup>107</sup> Ky informacion mbështet nevojat e informacionit të pjesëmarrësve në tregjet financiare që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues shtesë që lidhet me ndikimet kryesore të padëshiruara siç përcaktohet nga treguesi #8 në tabelën III të aneksit I të Rregullores së deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese mbi investimet e qëndrueshme ("Raporti i pagave të tepërta të CEO").

- (a) numrin e përgjithshëm të **incidenteve** të **diskriminimit**, përfshirë **ngacmimin**, të raportuar në periudhën raportuese;<sup>108</sup>
- (b) numrin e ankesave të regjistruara nëpërmjet kanaleve që kanë njerëzit e **fuqisë punëtore** të njësisë ekonomike për të ngritur shqetësime (duke përfshirë **mekanizmat e ankesave**) dhe, kur është e aplikueshme, dhe nëpërmjet Pikës Kombëtare të Kontaktit për Ndërmarrjet Shumëkombëshe të OECD-së që lidhen me çështjet e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij Standardi, duke përjashtuar ato që janë raportuar tashmë në (a) më sipër;
- (c) shumën totale të gjobave, penaliteteve dhe kompensimit për dëmet si rezultat i **incidenteve** dhe ankesat e paraqitura më sipër, dhe një rakordim (përputhje) të shumave të tilla monetare të paraqitura me shumën më të përshtatshme të paraqitur në pasqyrat financiare; dhe
- (d) kur është e aplikueshme, informacion kontekstual të nevojshëm për të kuptuar të dhënat dhe mënyrën se si janë përpiluar të dhëna të tilla.

104. Njësia ekonomike duhet të japë informacionin e mëposhtëm në lidhje me rastet e identifikuar të **incidenteve** të rënda të të drejtave të njeriut: (p.sh., **punë e detyruar**, trafikim njerëzor ose **punë fëmijësh**):

- (a) numrin e incidenteve të rënda të të drejtave të njeriut të lidhura me fuqinë punëtore të njësisë ekonomike në periudhën raportuese, duke përfshirë një tregues se sa prej këtyre janë raste të mosrespektimit të Parimeve Udhëzuese të OKB-së mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut, Deklaratës së ILO-s mbi Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë ose Udhëzimeve të OECD-së për Ndërmarrjet Shumëkombëshe. Nëse nuk kanë ndodhur incidente të tilla, njësia ekonomike duhet ta deklarojë këtë fakt;<sup>109</sup> dhe
- (b) shumën totale të gjobave, penaliteteve dhe kompensimit për dëmet për incidentet e përshkruara në (a) më sipër, dhe një rakordim të shumave monetare të paraqitura në shumën përkatëse të pasqyrave financiare.

<sup>108</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues shtesë që lidhet me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohet nga treguesi #7 në Tabelën III të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacionit mbi investimet e qëndrueshme ("Incidentet e diskriminimit").

<sup>109</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues i detyrueshëm dhe shtesë që lidhet me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohet nga treguesi #10 në Tabelën I të Shtojcës I dhe nga treguesi #14 në Tabelën III të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacionit shpjegues mbi investimet e qëndrueshme ("Shkeljet e parimeve të UNGC-së dhe Udhëzimeve të OECD-së për Ndërmarrjet Shumëkombëshe" dhe "Numri i rasteve të identifikuar të çështjeve dhe incidenteve të rënda të të drejtave të njeriut"); dhe nevojat për informacion të administratorëve të standardeve për të dhënë informacion shpjegues për faktorët ESG që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2020/1816, siç përcaktohet nga treguesi "Numri i përbërësve të standardeve që i nënshtrohen shkeljeve sociale (numri absolut dhe relativ i pjesëtuar me të gjithë përbërësit e standardeve), siç referohen në traktatet dhe konventat ndërkombëtare, parimet e Kombeve të Bashkuara dhe, kur është e aplikueshme, ligjin kombëtar" në seksionin 1 dhe 2 të Shtojcës II.

## Shtojca A. Kërkesat për Zbatim

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e ESRS S1 *Fuqia e vet punëtore*. Ajo mbështet zbatimin e kërkesave për informacion shpjegues të përcaktuara në këtë standard dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të këtij Standardi.

### Objektivi

- AR 1. Përveç çështjeve të listuara në paragrafin 2, njësia ekonomike mund të marrë në konsideratë edhe dhënien e informacionit rreth çështjeve të tjera që lidhen me një ndikim material për një periudhë më të shkurtër kohore, për shembull iniciativat në lidhje me shëndetin dhe sigurinë e **fuqisë punëtore të saj** gjatë një pandemie.
- AR 2. Përmbledhja e çështjeve sociale e dhënë në paragrafin 2 nuk ka për qëllim të nënkuptojë që të gjitha këto çështje duhet të raportohen në secilën Kërkesë për dhënie informacioni shpjegues në këtë Standard. Përkundrazi, ato ofrojnë një listë të çështjeve që rrjedhin nga kërkesat e raportimit të qëndrueshmërisë të përcaktuara në Direktivën 2013/34/BE që njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë për vlerësimin e **materialitetit** për ESRS 2 në lidhje me **fuqinë e vet punëtore** dhe, sipas rastit, të raportojë si **ndikime** materiale, **rreziqe dhe mundësitë** brenda fushëveprimit të këtij Standardi.
- AR 3. Shembuj të personave që përfshihen brenda fushëveprimit të "**Fuqisë së vet punëtore**" janë:
- (a) Kontraktorë (persona të vetëpunësuar) në **fuqinë punëtore** të njësisë ekonomike, shembuj të cilëve përfshijnë:
- Kontraktorë të punësuar nga njësia ekonomike për të kryer punë që përndryshe do të kryhej nga një **punonjës**
  - Kontraktorë të punësuar nga njësia ekonomike për të kryer punë në një zonë publike (p.sh., në një rrugë, në rrugë).
  - Kontraktorë të punësuar nga njësia ekonomike për të ofruar punën/shërbimin direkt në vendin e punës të një klienti të njësisë ekonomike.
- (b) Shembuj të personave të punësuar nga një palë e tretë e angazhuar në "aktivitete punësimi" përfshijnë njerëz që kryejnë të njëjtën punë që kryejnë punonjësit, të tilla si:
- persona që zëvendësojnë punonjësit që mungojnë përkohësisht (për shkak të sëmundjes, pushimeve, lejes prindërore, etj.);
  - njerëz që kryejnë punë si shtesë mbi punonjësit e rregullt;
  - persona që dërgohen përkohësisht nga një shtet tjetër anëtar i BE-së për të punuar për njësinë ekonomike ("punëtorë të dërguar").

## ESRS 2 Dhënie informacione shpjeguese të përgjithshme

### Strategjia

#### Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese në lidhje me standardin ESRS 2 SBM-2 – Interesat dhe pikëpamjet e palëve të interesuara

- AR 4. ESRS 2 SBM-2 kërkon që njësia ekonomike të ofrojë një kuptim nëse dhe si e konsideron rolin që strategjia dhe **modeli i saj i biznesit** mund të luajë rol në krijimin, përkeqësimin ose zbutjen e **ndikimeve** të rëndësishme materiale mbi **fuqinë e vet punëtore**, dhe nëse po, si modeli dhe strategjia e biznesit përshtaten për të adresuar ndikime të tilla materiale.
- AR 5. Ndërsa **fuqia e vet punëtore** e njësisë ekonomike mund të mos jetë e angazhuar me njësinë ekonomike në nivelin e strategjisë ose **modelit të saj të biznesit**, pikëpamjet e tyre mund të ofrojnë informacion mbi vlerësimin e njësisë ekonomike për strategjinë dhe modelin e saj të biznesit. Njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë pikëpamjet e **përfaqësuesve të punëtorëve** kur është e aplikueshme për të përmbushur këtë kërkesë për informacion shpjegues.

#### Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese në lidhje me standardin ESRS 2 SBM -3– Ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit

- AR 6. **Ndikimet** mbi **fuqinë punëtore** të vet njësisë ekonomike mund të burojnë nga **strategjia ose modeli i saj i biznesit** në mënyra të ndryshme. Për shembull, ndikimet mund të lidhen me vlerat që njësia ekonomike promovon (siç është ofrimi i produkteve ose shërbimeve me kosto të ulët, ose shpërndarja e produkteve me shpejtësi të lartë, në mënyra që të ushtrojë presion mbi të drejtat e punës në veprimtarinë e saj), ose me strukturën e saj të kostos dhe modelin e të ardhurave (siç është zhvendosja e rrezikut të inventarit tek **furnizuesit**, me efekte anësore në të drejtat e punës së njerëzve që punojnë për ata).
- AR 7. Ndikimet në **fuqinë e vet punëtore** të njësisë ekonomike që burojnë nga strategjia ose **modeli i biznesit** mund të sjellin edhe **rreziqe** materiale për njësinë ekonomike. Për shembull, rreziqet lindin nëse disa njerëz në fuqinë punëtore janë të kërcënuar të bëjnë **punë të detyruar** dhe njësia ekonomike importon produkte në ato vendet ku ligji lejon konfiskimin e mallrave të importuara që dyshohet se janë bërë me punë të detyruar. Një shembull i **mundësive** për njësinë ekonomike mund të rezultojë nga ofrimi i mundësive për fuqinë punëtore, siç janë krijimi i vendeve të punës dhe përmirësimi i aftësive në kontekstin e një "tranzicioni të drejtë". Një shembull tjetër i cili, në kontekstin e një pandemie ose ndonjë krize tjetër të rëndë shëndetësore, lidhet me njësinë ekonomike që potencialisht mbështetet tek forca pune të kushtëzuara me pak ose aspak qasje në përfitimet nga kujdesi shëndetësor mund të përballen me rreziqe të mëdha operationale dhe të vazhdimësisë së biznesit, pasi punëtorët nuk kanë zgjidhje tjetër përveçse të vazhdojnë të punojnë ndërsa janë të sëmurë, duke përkeqësuar më

tej përhapjen e sëmundjes dhe duke shkaktuar probleme të mëdha në prishjen e **zinxhirit të furnizimit**. Rreziqet e reputacionit dhe të mundësive të biznesit të lidhura me shfrytëzimin e punëtorëve me kualifikime të ulëta dhe paga të ulëta në vendet e furnizimit me mbrojtje minimale për ta, po rriten bashkë me reagimin e ashpër të medias dhe preferencat e **konsumatorëve** që kalojnë drejt mallrave që vijnë nga burime më etike ose më të qëndrueshme.

- AR 8. Shembuj të karakteristikave të veçanta të njerëzve në **fuqinë punëtore** të njësisë ekonomike që mund të merren në konsideratë nga njësia ekonomike kur i përgjigjen paragrafit 15 lidhen me të rinjtë që mund të jenë më të ndjeshëm ndaj **ndikimeve** mbi zhvillimin e tyre fizik dhe mendor, ose gratë në një kontekst ku gratë diskriminohen rregullisht në kushtet dhe afatet e punës, ose emigrantët në një kontekst ku tregu i punës është i rregulluar dobët dhe punëtorëve u ngarkohen rregullisht tarifa rekrutimi. Për disa njerëz në fuqinë punëtore, karakteristika e natyrshme e aktivitetit që ata duhet të ndër marrin mund t'i vërë ata në rrezik (për shembull, njerëzit që duhet të merren me kimikate ose të përdorin pajisje të caktuara ose punonjësit me paga të ulëta që janë me kontrata "zero orë").
- AR 9. AR 9. Lidhur me paragrafin 16, **rreziqet** materiale mund të lindin edhe për shkak të **varësisë** së njësisë ekonomike tek **fuqia e saj punëtore** ku ngjarjet me probabilitet të ulët, por me ndikim të lartë mund të shkaktojnë **efekte financiare**; Për shembull, kur një pandemi globale çon në ndikime të rënda shëndetësore në fuqinë punëtore të njësisë ekonomike, duke rezultuar në ndërprerje të mëdha të prodhimit dhe shpërndarjes. Shembuj të tjerë të rrezikut që lidhen me varësinë e njësisë ekonomike nga fuqia punëtore përfshijnë mungesën e punëtorëve të kualifikuar ose vendimet politike ose legjislativonin që ndikojnë në veprimtarinë e saj dhe në **fuqinë punëtore**.

#### *Menaxhimi i ndikimeve, rreziqeve dhe mundësive*

#### Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-1 – Politikat që lidhen me fuqinë e vet punëtore

- AR 10. Njësia ekonomike duhet të shqyrtojë nëse shpjegimet e dhëna për ndryshimet e rëndësishme në politikat e miratuara gjatë vitit raportues (për shembull, pritjet e reja për filialet e huaja, qasjet e reja ose shtesë ndaj kujdesit të duhur dhe mjeteve juridike) ofrojnë informacion kontekstual për përdoruesit dhe mund të japë këto shpjegime. Kjo përfshin politikat dhe angazhimet e njësisë ekonomike për të parandaluar ose zbutur **rreziqet** dhe **ndikimet** negative mbi njerëzit e **fuqisë e vet punëtore** nga reduktimi i **emetimeve** të karbonit dhe kalimi në aktivitete më të gjelbra dhe klimatikisht neutrale, si dhe për të ofruar **mundësi** për fuqinë punëtore, siç janë krijimi i vendeve të punës dhe përmirësimi i aftësive, duke përfshirë angazhime të qarta për një "tranzicion të drejtë".
- AR 11. **Politika** mund të marrë formën e një politike të pavarur në lidhje me fuqinë e vet punëtore të njësisë ekonomike ose të përfshihet në një dokument më të gjerë, siç është një kod etik ose

një politikë e përgjithshme e qëndrueshmërisë që është paraqitur tashmë nga njësia ekonomike si pjesë e një ESRS-je tjetër. Në këto raste, njësia ekonomike duhet të ofrojë një referencë të saktë për të identifikuar aspektet e politikës që plotësojnë këto kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese.

- AR 12. Kur jepet informacion shpjegues për përputhshmërinë e politikave të saj me Parimet Udhëzuese të OKB-së mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut, njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë që Parimet Udhëzuese i referohen Deklaratës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, e cila përbëhet nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe dy Paktet që e zbatojnë atë, si dhe Deklaratës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës mbi të Drejtat Themelore dhe Parimet në Punë dhe konventat kryesore që e mbështesin atë, dhe mund të raportojë mbi përputhshmërinë me këto instrumente.
- AR 13. ► **C1** Kur njësia ekonomike shpjegon se si janë të integruara politikat e jashtme, ajo mund të marrë në konsideratë, për shembull, politikat e brendshme të zinxhirit të furnizimit dhe harmonizimin me politikat e tjera përkatëse për fuqinë e saj punëtore, për shembull, në lidhje me punën e detyruar. ◀ Lidhur me kodet e sjelljes së furnizuesve që mund të ketë njësia ekonomike, ajo duhet të tregojë nëse ato përfshijnë dispozita që adresojnë sigurinë e punëtorëve, punën e pasigurt (domethënë, përdorimin e punëtorëve me kontrata afatshkurtra ose me orar të kufizuar, punëtorët e punësuar nëpërmjet palëve të treta, nënkontraktimin të palët e treta ose përdorimin e punëtorëve informalë), trafikimin e qenieve njerëzore, përdorimin e punës së detyruar ose punën e fëmijëve, dhe nëse dispozita të tilla janë plotësisht në përputhje me standardet përkatëse të ILO-s.
- AR 14. Njësia ekonomike mund të ofrojë një ilustrim të llojeve të komunikimit të politikave të saj për ata individë, grupe individësh ose subjekte për të cilët ato janë të rëndësishme, qoftë sepse pritet që ata t'i zbatojnë ato (për shembull, **punonjësit**, kontraktorët dhe **furnizuesit** e njësisë ekonomike), ose sepse ata kanë një interes të drejtpërdrejtë në zbatimin e tyre (për shembull, njerëzit e **fuqisë punëtore** të saj, investitorët). Ajo mund të japë mjetet e informacionit dhe kanalet e komunikimit (për shembull, fletushka, buletine, faqe interneti të dedikuara, media sociale, ndërveprime ballë për ballë, përfaqësues të punëtorëve), që synojnë të sigurojnë që **politika** arrin tek të interesuarit dhe që audienca të ndryshme të kuptojnë implikimet e saj. Njësia ekonomike mund të shpjegojë gjithashtu se si identifikon dhe heq pengesat e mundshme që pengojnë përhapjen, siç është përkthimi në gjuhët përkatëse ose përdorimi i përshkrimeve grafike.
- AR 15. **Diskriminimi** në punësim dhe në profesion ndodh kur dikush trajtohet ndryshe ose në mënyrë më pak të favorshme për shkak të karakteristikave që nuk lidhen me meritën ose kërkesat e natyrshme të punës. Këto karakteristika përcaktohen zakonisht në ligjet kombëtare. Përveç atyre që përmenden në Kërkesën për Dhënie informacione shpjeguese, njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë shkaqe të tjera për diskriminim të ndaluara sipas legjisllacionit kombëtar.

AR 16. **Diskriminimi** mund të lindin në një sërë aktivitetesh të lidhura me punën. Këto përfshijnë qasjen në punësim, profesione të caktuara, **trajnime** dhe orientimin profesional dhe sigurimet shoqërore. Për më tepër, kjo mund të ndodhë në lidhje me kushtet dhe afatet e punësimit, siç janë: rekrutimi, shpërblimi, orët e punës dhe pushimit, pushimet e paguara, leje lindje, siguria e mbajtjes në punë, caktimi i llojit të punës, vlerësimi dhe avancimi i performancës, mundësitë e trajnimit, perspektivat e ngritjes në detyrë, siguria dhe shëndeti në punë, ndërprerja e punësimit. Njësia ekonomike mund t'i trajtojë këto fusha në mënyrë specifike kur jep informacion për politikën dhe procedurat kryesore të saj për të përmbushur kërkesën e dhënies së informacionit.

AR 17. Njësia ekonomike mund të japë informacion nëse ajo:

- (a) ka politika dhe procedura që i bëjnë kualifikimet, aftësitë dhe përvojën bazë për rekrutimin, vendosjen në punë, **trajnimin** dhe avancimin në të gjitha nivelet, duke marrë parasysh faktin se disa individë mund të kenë më shumë vështirësi se të tjerët për të fituar kualifikime, aftësi dhe përvoja të tilla;
- (b) cakton në nivel të lartë të menaxhimit përgjegjësinë për **trajtim të barabartë** dhe **mundësi të barabartë** punësimi, për të nxjerrë politika dhe procedura të qarta në të gjithë ndërmarrjen për të udhëhequr praktikën e barabartë të punësimit dhe të për të lidhur përparimin me performancën e dëshiruar në këtë fushë;
- (c) ofron trajnime për stafin mbi politikën dhe praktika jo-**diskriminuose**, me një fokus të veçantë në menaxhimin e mesëm dhe të lartë për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të adresuar strategjitë e zgjidhjes për parandalimin dhe adresimin e diskriminimit sistematik dhe të rastësishëm;
- (d) bën rregullime në mjedisin fizik për të siguruar shëndetin dhe sigurinë për punëtorët, klientët dhe vizitorët e tjerë me aftësi të kufizuara;
- (e) vlerëson nëse kërkesat e punës janë përcaktuar në ndonjë mënyrë që mund të dëmtojë sistematikisht grupe të caktuara;
- (f) mban të dhëna të azhurnuara mbi rekrutimin, trajnimin dhe ngritjen në detyrë që ofrojnë një pamje transparente të mundësive për **punonjësit** dhe përparimin e tyre brenda njësisë ekonomike;
- (g) vendos procedura ankimi për të adresuar ankesat, për të trajtuar apelimet dhe për të ofruar mjete juridike për punonjësit (veçanërisht në kontekstin e negociatave dhe marrëveshjeve kolektive) kur identifikohet diskriminim, dhe është e vëmendshme ndaj strukturave formale dhe çështjeve kulturore joformale që mund t'i pengojnë punonjësit të ngrenë shqetësime dhe ankesa; dhe
- (h) ka programe për të promovuar qasjen në **zhvillimin** e aftësive.

Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-2 – Proceset për angazhimin me fuqinë punëtore të vetë njësisë ekonomike dhe përfaqësuesit e punëtorëve në lidhje me ndikimet

- AR 18. Njësia ekonomike, kur përshkruan se cili funksion ose rol ka përgjegjësi operative për një angazhim të tillë dhe/ose llogaridhënie përfundimtare, mund të japë informacion nëse ky është një rol ose funksion i dedikuar apo pjesë e një roli ose funksioni më të gjerë, dhe nëse janë ofruar aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për të mbështetur stafin për të ndërmarrë angazhime. Nëse njësia ekonomike nuk mund të identifikojë një pozicion ose funksion të tillë, ajo mund ta deklarojë një fakt të tillë. Kjo dhënie informacioni shpjegues mund të përmbushet gjithashtu duke iu referuar informacionit të dhënë sipas ESRS 2 GOV-1 *Roli i organeve administrative, menaxhuese dhe mbikëqyrëse*.
- AR 19. Gjatë përgatitjes së deklarimeve të përshkruara në paragrafin 27 b) dhe c), mund të merren në konsideratë ilustrimet e mëposhtme për:
- (a) shembuj të fazave në të cilat ndodhet angazhimi të cilat janë i) përcaktimi i qasjes ndaj zbutjes së ndikimeve dhe ii) vlerësimi i efektivitetit të zbutjes së ndikimeve;
  - (b) llojet e angazhimit, që mund të jenë pjesëmarrje, konsultim dhe/ose informacion;
  - (c) frekuencën e angazhimit, që mund të jepet informacion nëse angazhimi ndodh rregullisht, në pika të caktuara të një projekti ose procesi biznesi, (për shembull, kur fillon një sezon i ri korrije ose hapet një linjë e re prodhimi), si dhe nëse ndodh në përgjigje të kërkesave ligjore dhe/ose në përgjigje të kërkesave të **palëve të interesuara** dhe nëse rezultati i angazhimit po integrohet në proceset vendimmarrëse të njësisë ekonomike; dhe
  - (d) rolin që ka përgjegjësi operacionale, nëse njësia ekonomike kërkon që stafi përkatës të ketë aftësi të caktuara, apo nëse ofron **trajtime** ose ndërtimi i kapaciteteve të stafit përkatës për të ndërmarrë angazhime.
- AR 20. Marrëveshjet Kuadër Globale (GFA) shërbejnë për të krijuar një marrëdhënie të vazhdueshme midis një njësie ekonomike shumëkombëshe dhe një Federate Sindikale Globale për të siguruar që njësia ekonomike t'i përmbahet të njëjtave standarde në çdo vend në të cilin ajo ka aktivitet.
- AR 21. Për të ilustruar se si perspektivat e **fuqisë së vet punëtore** kanë informuar vendime ose aktivitete specifike, njësia ekonomike mund të japë shembuj nga periudha aktuale e raportimit.
- AR 22. ► **C1** Kur njësia ekonomike ka marrëveshje me sindikata ose këshilla pune kombëtare, evropiane ose ndërkombëtare në lidhje me të drejtat e njerëzve të fuqisë punëtore të saj, kjo mund të paraqitet për të ilustruar se si marrëveshja i mundëson njësisë ekonomike të përfitojë njohuri mbi perspektivat e këtyre njerëzve. ◀

AR 23. Kur është e mundur, njësia ekonomike mund të japë informacion me shembuj nga periudha e raportimit për të ilustruar se si perspektivat e **fuqisë së saj punëtore** dhe **përfaqësuesve të punëtorëve** kanë informuar vendime ose aktivitete specifike të njësisë ekonomike.

AR 24. Njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë aspektet e mëposhtme kur përmbush këtë Kërkesë për dhënie informacione shpjeguese:

- (a) Llojin e angazhimit (për shembull, informacion, konsultim ose pjesëmarrje) dhe frekuencën e tij (për shembull, i vazhdueshëm, tremujor, vjetor);
- (b) si regjistrohen dhe integrohen reagimet në vendimmarrje, dhe si informohen njerëzit në fuqinë punëtore rreth mënyrës se si reagimet e tyre kanë ndikuar në vendime;
- (c) nëse aktivitetet e angazhimit zhvillohen në nivel organizativ apo në një nivel më të ulët, si p.sh. në **vend** ose në nivel projekti, dhe në rastin e dytë, si centralizohet informacioni nga aktivitetet e angazhimit;
- (d) burimet e alokuara për angazhimin (për shembull, burimet financiare ose njerëzore); dhe
- (e) si angazhohet njësia ekonomike me njerëzit e fuqisë punëtore dhe **përfaqësuesit e punëtorëve** mbi ndikimet në **fuqinë e vet punëtore** që mund të rrjedhin nga ulja e **emetimeve** të karbonit dhe kalimi në aktivitete më të gjelbra dhe klimatikisht neutrale, veçanërisht të tilla si ristrukturimi, humbja ose krijimi i vendeve të punës, trajnimi dhe përmirësimi/rikualifikimi, barazia gjinore dhe sociale, si dhe shëndeti dhe siguria.

AR 25. Njësia ekonomike mund të japë informacionin e mëposhtëm në lidhje me paragrafin 24 mbi diversitetin:

- (a) si angazhohet me personat në rrezik ose në situata të cënueshme (për shembull, nëse ndjek qasje specifike dhe i kushton vëmendje të veçantë pengesave të mundshme);
- (b) si i merr në konsideratë pengesat e mundshme për angazhimin me njerëzit në fuqinë e saj punëtore (për shembull, ndryshimet gjuhësore dhe kulturore, çekuilibrat gjinore dhe të pushtetit, përçarjet brenda një komuniteti ose grupi);
- (c) si u ofron njerëzve të fuqisë punëtore të saj informacion që është i kuptueshëm dhe i arritshëm përmes kanaleve të duhura të komunikimit;
- (d) çdo konflikt interesi që ka lindur midis fuqisë punëtore të saj dhe si njësia ekonomike i ka zgjidhur këto konflikte; dhe
- (e) si kërkon të respektojë të drejtat e njeriut të të gjithë palëve të interesuara të përfshira, për shembull, të drejtat e tyre për privatësi, liri shprehjeje dhe tubim apo protestë paqësore.

AR 26. Njësia ekonomike mund të raportojë gjithashtu informacion në lidhje me efektivitetin e proceseve për angazhimin me **fuqinë e saj punëtore** nga periudhat e mëparshme të raportimit. Kjo zbatohet në rastet kur njësia ekonomike ka vlerësuar efektivitetin e këtyre proceseve ose ka nxjerrë mësim gjatë periudhës aktuale të raportimit. Proceset e përdorura

për të ndjekur efektivitetin mund të përfshijnë auditimin ose verifikimin e brendshëm ose të jashtëm, vlerësimet e ndikimit, sistemet e matjes, reagimet e **palëve të interesuara, mekanizmat e marrjes së ankesave**, vlerësimet e jashtme të performancës dhe krahasimet.

#### ▼C1

Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-3 – Proceset për të ndrequr ndikimet negative dhe kanalet e komunikimit për fuqinë e vet punëtore për të ngritur shqetësime

#### ▼B

- AR 27. Në përmbushjen e kërkesave të përcaktuara nga kriteret e Kërkesës për dhënie informacione shpjeguese ESRS S1-3, njësia ekonomike mund të udhëhiqet nga përmbajtja e Parimeve Udhëzuese të OKB-së mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut dhe Udhëzimi i OECD-së për Kujdesin e Duhur për Sjellje të Përgjegjshme të Biznesit të fokusuar në **mekanizmat e korigjimit** dhe **ankesave**.
- AR 28. Kanalet për ngritjen e shqetësimeve ose nevojave përfshijnë **mekanizmat e ankesave**, linjat telefonike, sindikatat (ku njerëzit e fuqisë punëtore janë të anëtarësuar), këshillat e punës, proceset e dialogut ose mjete të tjera përmes të cilave **fuqia punëtore** e vetë njësisë ekonomike ose **përfaqësuesit e punëtorëve** mund të ngrejë shqetësime në lidhje me **ndikimet** ose të shpjegojnë nevojat që ata do të donin që njësia ekonomike t'i adresonte. Kjo mund të përfshijë si kanalet e ofruara nga njësia ekonomike drejtpërdrejt ashtu edhe kanalet e ofruara nga subjektet ku punon fuqia e tyre punëtore, përveç çdo mekanizmi tjetër që një njësi ekonomike mund të përdorë për të marrë njohuri mbi menaxhimin e ndikimeve në fuqinë e saj punëtore, siç janë auditimet e përputhshmërisë. Kur njësia ekonomike mbështetet vetëm në informacionin në lidhje me ekzistencën e kanaleve të tilla të ofruara nga **marrëdhëniet e saj të biznesit** për t'iu përgjigjur kësaj kërkesë, ajo duhet ta deklarojë këtë fakt.
- AR 29. Mekanizmat e palëve të treta mund të përfshijnë ato që veprojnë në emër të institucioneve qeveritare, OJQ-të, shoqatat e industrisë dhe nisma të tjera bashkëpunuese. Njësia ekonomike mund të japë informacion nëse këto kanale janë të arritshme për të gjithë **fuqinë punëtore** të saj (ose për **përfaqësuesit e punëtorëve** ose, në mungesë të tyre, individë ose organizata që veprojnë në emër të tyre ose që janë në një pozicion tjetër për të qenë të vetëdijshëm për **ndikimet** negative).
- AR 30. Njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë nëse dhe si njerëzit në **fuqinë punëtore** të saj që mund të preken dhe **përfaqësuesit e punëtorëve** të tyre janë në gjendje të kenë qasje në këto kanale në nivelin e njësisë ekonomike nga e cila janë të punësuar ose të kontraktuar për të punuar, në lidhje me secilin **ndikim** material. Kanalet e komunikimit përkatëse mund të përfshijnë linja telefonike, sindikata (ku njerëzit e fuqisë punëtore janë anëtarë) ose këshilla pune, ose **mekanizma të tjerë ankesash** që ofrohen nga njësia ekonomike përkatëse ose nga një palë e tretë.

AR 31. Duke shpjeguar nëse dhe si njësia ekonomike ka informacion që njerëzit e sajë të fuqisë punëtore janë të vetëdijshëm dhe u besojnë ndonjërit prej këtyre kanaleve, njësia ekonomike mund të ofrojë të dhëna të duhura dhe të besueshme në lidhje me efektivitetin e këtyre kanaleve nga perspektiva e personave të përfshirë. Shembuj të burimeve të informacionit janë anketat e njerëzve të fuqisë punëtore të njësisë ekonomike që kanë përdorur kanale të tilla dhe nivelet e tyre të kënaqësisë me procesin dhe rezultatet.

AR 32. Në përshkrimin e efektivitetit të kanaleve të komunikimit për **fuqinë punëtore** të saj dhe **përfaqësuesit e punëtorëve** për të ngritur shqetësime, njësia ekonomike mund të udhëhiqet nga pyetjet e mëposhtme, duke bazuar në "kriteret e efektivitetit për **mekanizmat** jo-gjyqësorë të **ankesave**", siç përcaktohen në Parimet Udhëzuese të OKB-së për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut, në veçanti në parimin 31. Konsideratat e mëposhtme mund të zbatohen për kanale individuale të komunikimit ose për një bashkësi sistem kanalesh:

- (a) a kanë kanalet e komunikimit legjitimitet për të ofruar llogaridhënie të përshtatshme për sjelljen e tyre të drejtë dhe për të ndërtuar besimin e palëve të interesuara?
- (b) a janë kanalet e komunikimit të njohura dhe të arritshme për **palët e interesuara**?
- (c) a kanë kanalet procedura të qarta dhe të ditura në lidhje me treguesit e afateve kohore?
- (d) a sigurojnë kanalet qasje të arsyeshëm për **palët e interesuara** drejt burimeve të informacionit, këshillave dhe ekspertizës?
- (e) a ofrojnë kanalet transparencë duke u ofruar informacion të mjaftueshëm si ankuesve ashtu edhe për të përmbushur çdo interes publik, kur është e aplikueshme?
- (f) a përputhen rezultatet e arritura përmes kanaleve me të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht?
- (g) a identifikon njësia ekonomike njohuri nga kanalet që mbështesin edukimin e vazhdueshëm si në përmirësimin e kanaleve ashtu edhe në parandalimin e ndikimeve të ardhshme?
- (h) a përqendrohet njësia ekonomike në dialogun me ankuesit si mjet për të arritur zgjidhje të dakordësuara, në vend që të përpiqet të përcaktojë në mënyrë të njëanshme rezultatin?

#### ▼C1

Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-4 – Ndërmarrja e veprimeve mbi ndikimet materiale në fuqinë e vet punëtore, dhe qasjet për zbutien e rreziqeve materiale dhe ndjekjen e mundësive që lidhen me fuqinë e vet punëtore, dhe efektiviteti i këtyre veprimeve

#### ▼B

AR 33. Mund të duhet kohë për të kuptuar **ndikimet** negative dhe si njësia ekonomike mund të përfshihet me to përmes **fuqisë punëtore** të saj, si dhe për të identifikuar përgjigjet e duhura dhe për t'i vënë ato në praktikë. Prandaj, njësia ekonomike mund të japë informacion:

- (a) për qasjet e saj të përgjithshme dhe specifike për adresimin e ndikimeve negative materiale;
- (b) për iniciativat e saj që synojnë të kontribuojnë në ndikime të rëndësishme pozitive shtesë;
- (c) sa ka përparuar në përpjekjet e saj gjatë periudhës së raportimit; dhe
- (d) për synimet e saj për përmirësim të vazhdueshëm.

AR 34. Veprimet e duhura mund të ndryshojnë në varësi të faktit nëse njësia ekonomike shkakton ose kontribuon në një **ndikim** material, ose nëse është e përfshirë sepse ndikimi lidhet drejtpërdrejt me aktivitetet, produktet ose shërbimet e saj nga një marrëdhënie biznesi.

AR 35. Duke pasur parasysh se **ndikimet** negative materiale që prekin **fuqinë e vet punëtore** që kanë ndodhur gjatë periudhës raportuese mund të jenë të lidhura edhe me njësi ose veprimtari të tjera jashtë kontrollit të saj të drejtpërdrejtë, njësia ekonomike mund të japë informacion nëse dhe si kërkon të përdorë ndikimin e saj në **marrëdhëniet e saj të biznesit** për të menaxhuar këto ndikime. Kjo mund të përfshijë përdorimin e **ndikimit tregtar** (për shembull, zbatim i kërkesave kontraktuale në marrëdhëniet e biznesit ose zbatim i stimujve), forma të tjera të ndikimit brenda marrëdhënies (siç është ofrimi i **trajnit**, ose ndërtimi i kapaciteteve mbi të drejtat e punëtorëve për subjektet me të cilat njësia ekonomike ka një marrëdhënie biznesi) ose ndikimin bashkëpunues me kolegët ose aktorë të tjerë (siç janë iniciativat që synojnë rekrutimin e përgjegjshëm ose sigurimin që punëtorët të marrin një **pagë të përshatshme**).

AR 36. Kur njësia ekonomike informon për pjesëmarrjen e saj në një industri ose një iniciativë me shumë palë të interesuara si pjesë e **aktiviteteve** të saj për të adresuar ndikimet negative materiale, njësia ekonomike mund të japë informacion se si iniciativa, dhe përfshirja e saj, synon të adresojë ndikimin material në fjalë. Ajo mund të raportojë sipas ESRS S1-5 **objektivat** përkatëse të përcaktuara nga iniciativa dhe progresi drejt tyre.

AR 37. Kur njësia ekonomike paraqet informacione shpjeguese nëse dhe si ajo merr në konsideratë ndikimet aktuale dhe të mundshme mbi **fuqinë e saj punëtore** të vendimeve për të ndërprerë **marrëdhëniet e biznesit** dhe nëse dhe si synon të adresojë çdo ndikim negativ që mund të rezultojë nga kjo ndërprerje, njësia ekonomike mund të përfshijë shembuj.

AR 38. Proceset e përdorura për të ndjekur efektivitetin e **veprimeve** mund të përfshijnë një auditim ose verifikim të brendshëm ose të jashtëm, procedura gjyqësore dhe/ose vendime gjyqësore përkatëse, vlerësime të ndikimit, sisteme matjeje, reagime nga palët e interesuara, **mekanizma ankimi**, vlerësime të performancës së jashtme dhe krahasime.

AR 39. Raportimi mbi efektivitetin synon të mundësojë kuptimin e lidhjeve midis veprimeve të ndërmarra nga një njësia ekonomike dhe menaxhimit efektiv të ndikimeve. Informacion shtesë që njësia ekonomike mund të ofrojë përfshin të dhëna që tregojnë një rënie në numrin e **incidenteve** të identifikuar.

AR 40. Lidhur me iniciativat ose proceset qëllimi kryesor i të cilave është të japin ndikime pozitive për njerëzit e **fuqisë punëtore** të njësisë ekonomike që bazohen në nevojat e tyre, dhe në lidhje me progresin në zbatimin e iniciativave ose proceseve të tilla, njësia ekonomike mund të japë informacionin e mëposhtëm:

(a) informacion nëse dhe si njerëzit e fuqisë së vet punëtore dhe **përfaqësuesit e punëtorëve** luajnë një rol në vendimet që kanë të bëjnë me hartimin dhe zbatimin e këtyre programeve ose proceseve; dhe

(b) informacion në lidhje me rezultatet pozitive të synuara ose të arritura për fuqinë e vet punëtore të njësisë ekonomike nga këto programe ose procese.

AR 41. Njësia ekonomike mund të shpjegojë nëse ndonjë nismë e tillë është hartuar gjithashtu për të mbështetur arritjen e një ose më shumë Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG). Për shembull, një njësi ekonomike që angazhohet ndaj SDG 8 për të "promovuar rritje ekonomike të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë" mund të jetë duke kontribuar në mënyrë aktive drejt eliminimit të **punës së detyruar** ose punës së sforcuar ose në mbështetje të niveleve më të larta të produktivitetit në aktivitetet në vendet në zhvillim përmes përmirësimeve teknologjike dhe **trajtimeve** të fuqisë punëtore lokale, nga e cila mund të përfitojnë si njerëzit specifikë të **fuqisë së vet punëtore** si pjesë e objektivit të **veprimeve** të saj, si dhe komunitetet e tyre lokale.

AR 42. Kur njësia ekonomike paraqet informacion shpjegues për rezultatet pozitive të synuara ose të arritura të **veprimeve** të saj për **fuqinë e vet punëtore**, duhet bërë një dallim midis provave të aktiviteteve të caktuara që kanë ndodhur (për shembull, që x numër njerëzish kanë marrë **trajnim** për njohuri financiare) nga provat e rezultateve aktuale për njerëzit në fjalë (për shembull, që x njerëz raportojnë se janë në gjendje të menaxhojnë më mirë pagat dhe buxhetet e tyre familjare).

AR 43. Nëse njësia ekonomike ka marrë masa për të zbutur **ndikimet** negative në **fuqinë e vet punëtore** që rrjedhin nga kalimi në një ekonomi më të gjelbër dhe klime neutrale, siç është **trajnimi** dhe rikualifikim, garanci punësimi, dhe në rastin e reduktimit të punësimit ose shkarkimit masiv, masa të tilla si këshillimi në punë, trajnimi, punësimet brenda kompanisë dhe plane pensioni të parakohshëm, njësia ekonomike duhet t'i japë informacion për këto masa. Kjo përfshin masa për të përmbushur rregulloret në fuqi. Njësia ekonomike mund të nxjerrë në pah zhvillimet e jashtme aktuale dhe/ose të pritshme që ndikojnë nëse **varësitë** shndërrohen në **rreziqe**. Kjo përfshin shqyrtimin e ndikimeve që mund të lindin nga kalimi në veprimtari më të gjelbra dhe klime neutrale.

AR 44. Kur jepet informacion shpjegues për **rreziqet** materiale dhe **mundësitë** lidhur me **ndikimet** e saj ose **varësitë** mbi **fuqinë e vet punëtore**, njësia ekonomike mund të marrë në konsideratë sa vijon:

- (a) rreziqet që lidhen me ndikimet e njësisë ekonomike në fuqinë punëtore të saj mund të përfshijnë ekspozimin reputacional ose ligjor, kur njerëzit e fuqinë së vet punëtore del se kryejnë ***punë të detyruar*** ose ka ***punë të fëmijëve***;
- (b) rreziqet që lidhen me varësinë e njësisë ekonomike nga fuqia punëtore e saj mund të përfshijnë ndërprerjen e aktiviteteve të biznesit ku ka fluks të konsiderueshëm punonjësish ose mungesë aftësish/ ***zhvillim trajnimesh*** që kërcënojnë biznesin e njësisë ekonomike; dhe
- (c) mundësitë që lidhen me ndikimet e njësisë ekonomike në fuqinë punëtore të saj mund të përfshijnë diferencimin e tregut dhe një ndërgjegjësim më të madh nga na e klientëve për garantimin i një ***page*** dhe kushte të mira për jo-punonjësit.

AR 45. Kur shpjegohet nëse ***varësitë*** shndërrohen në ***rreziqe***, njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë zhvillimet e jashtme.

AR 46. Kur njësia ekonomike paraqet informacion shpjegues për ***politikat, veprimet*** dhe burimet dhe ***objektivat*** lidhur me menaxhimin e ***rreziqeve*** materiale dhe ***mundësive***, në rastet kur rreziqet dhe mundësitë lindin nga një ***ndikim*** material, njësia ekonomike mund të kryqëzojë deklaratimet e saj mbi politikat, veprimet, burimet dhe objektivat në lidhje me atë ndikim.

AR 47. Njësia ekonomike duhet të shqyrtojë nëse dhe si procesi/proceset e saj për të menaxhuar ***rreziqet*** materiale lidhur me ***fuqinë e vet punëtore*** janë të përfshira në procesin/proceset e saj ekzistuese të menaxhimit të riskut.

AR 48. Kur jep informacion për burimet e alokuara për menaxhimin e ndikimeve materiale, njësia ekonomike mund të shpjegojë se cilat funksione të brendshme janë të përfshira në menaxhimin e ndikimeve dhe çfarë lloje veprimesh ndërmarrin ata për të adresuar ndikimet negative dhe për të çuar përpara ndikimet pozitive.

#### *Metrikat dhe objektivat*

#### Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-5 – Objektivat që lidhen me menaxhimin e ndikimeve materiale, avancimin e ndikimeve pozitive, si dhe me rreziqet dhe mundësitë

AR 49. ► **C1** Kur paraqitet informacion shpjegues rreth ***objektivave*** në përputhje me paragrafin 44, njësia ekonomike mund të japë informacion për: ◀

- (a) rezultatet e synuara që duhen arritur në jetët e një numri të caktuar njerëzish të ***fuqisë së vet punëtore***;
- (b) stabilitetin e ***objektivave*** me kalimin e kohës në aspektin e përkufizimeve dhe metodologjive për të mundësuar krahasueshmërinë me kalimin e kohës; dhe/ose
- (c) standardet ose angazhimet mbi të cilat bazohen objektivat (për shembull kodet e sjelljes, politikat e furnizimit, kornizat globale ose kodet e industrisë).

AR 50. **Synimet** e lidhura me **rreziqet** dhe **mundësitë** mund të jenë të njëjta ose të ndryshme nga objektivat që lidhen me **ndikimet**. Për shembull, një objektivi për të arritur **paga të përshtatshme** për **jo-punonjësit** mund të zvogëlojë ndikimet tek ata njerëz dhe të zvogëlojë rreziqet që lidhen me to në aspektin e cilësisë dhe besueshmërisë së rezultateve të tyre.

AR 51. Njësia ekonomike mund të bëjë gjithashtu dallimin midis **objektivave** afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë që mbulon të njëjtën **politikë** angazhim. Për shembull, njësia ekonomike mund të ketë një objektivi afatgjatë për të arritur një ulje prej 80% të **incidenteve** shëndetësore dhe të sigurisë që ndikon te shoferët e shpërndarjes deri në vitin 2030 dhe një objektivi afatshkurtër për të zvogëluar **orët shitesë** të shoferëve të shpërndarjes me x% duke ruajtur të ardhurat e tyre deri në vitin 2024.

AR 52. Kur modifikon ose zëvendëson një **objektiv** në periudhën raportuese, njësia ekonomike mund ta shpjegojë ndryshimin duke e krahasuar atë me ndryshime të rëndësishme në **modelin e biznesit** ose me ndryshime më të mëdha në standardin ose legjislacionin e pranuar nga i cili rrjedh objektivi për të dhënë informacion kontekstual sipas ESRS 2 BP-2 *Deklaratave në lidhje me rrethana specifike*.

#### Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-6 – Karakteristikat e Punonjësve të njësisë ekonomike

AR 53. Kjo Kërkesë për Dhënie informacioni shpjegues mbulon të gjithë **punonjësit** të cilët kryejnë punë për ndonjë nga subjektet e njësisë ekonomike të përfshira në raportimin e saj të qëndrueshmërisë.

AR 54. Ofrimi i një ndarjeje të **punonjësve** sipas vendit jep një pasqyrë të shpërndarjes së aktivitetit nëpër vende. Numri i punonjësve në secilin vend është gjithashtu një shkas kyç për shumë të drejta informacioni, konsultimi dhe pjesëmarrjeje për punëtorët dhe përfaqësuesit e punëtorëve, si në *acquis-in* e së drejtës së punës të Bashkimit (për shembull, Direktiva 2009/38/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit <sup>(110)</sup> "Direktiva e Këshillave Evropiane të Punës" dhe Direktiva 2002/14/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit <sup>(111)</sup> "Direktiva e Informacionit dhe Konsultimit") ashtu edhe në të drejtën kombëtare (për shembull, të drejtat për të krijuar një këshill pune ose për të pasur përfaqësim të punonjësve në nivel bordi). Dhënia e një ndarjeje të punonjësve sipas gjinisë dhe llojit të marrëdhënies së punës jep një pasqyrë të përfaqësimit gjinor në të gjithë njësinë ekonomike. Përveç kësaj, dhënia e një ndarjeje të punonjësve sipas rajonit jep një pasqyrë të ndryshimeve rajonale. Një rajon mund t'i referohet një vendi ose vendndodhjeve të tjera gjeografike, siç është një rajon brenda një vendi ose një rajon botëror.

---

<sup>110</sup> Direktiva 2009/38/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 6 majit 2009, mbi krijimin e një Këshilli Evropian të Punës ose të një procedure në shkallë Komunitare të njësisë ekonomike dhe të grupeve në shkallë Komunitare të njësisë ekonomike me qëllim informimin dhe konsultimin e punonjësve (GZ L 122, 16.5.2009, f. 28).

<sup>111</sup> Direktiva 2002/14/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 marsit 2002 që krijon një kuadër të përgjithshëm për informimin dhe konsultimin e punonjësve në Komunitetin Evropian - Deklarata e përbashkët e Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit mbi përfaqësimin e punonjësve (GZ L 80, 23.3.2002, f. 29).

AR 55. Njësia ekonomike duhet të japë informacionet shpjeguese të kërkuara në formatet tabelare të mëposhtme:

**Tabela 1. Model për paraqitjen e informacionit mbi numrin e punonjësve sipas gjinisë**

Gjinia	Numri i punonjësve (numri i punonjësve)
Meshkuj	
Femra	
Të tjera	
E pa raportuar	
Totali i punonjësve	

Në disa Shtete Anëtare është e mundur që personat të regjistrohen ligjërisht si të kenë një gjini të tretë, shpesh neutrale, e cila kategorizohet si "tjetër" në tabelën e mësipërme. Megjithatë, nëse njësia ekonomike po jep të dhëna rreth **punonjësve** kur kjo nuk është e mundur, mund ta shpjegojë këtë dhe të tregojë se kategoria "tjetër" nuk është e zbatueshme.

**Tabela 2. Model për paraqitjen e numrit të punonjësve në vendet ku njësia ekonomike ka të paktën 50 punonjës që përfaqësojnë të paktën 10% të numrit të përgjithshëm të punonjësve të saj**

Vendi	Numri i punonjësve (numri i punonjësve)
Vendi A	
Vendi B	
Vendi C	
Vendi D	

**Tabela 3. Model për paraqitjen e informacionit mbi punonjësit sipas llojit të kontratës, të ndarë sipas gjinisë (numri i punonjësve ose FTE) (raportimi për punonjësit me kohë të plotë dhe të pjesshme është vullnetar)**

Periudha e raportimit				
Femra	Meshkuj	Të tjerë (*)	E pa treguar	Totali
Numri i punonjësve (numri i punonjësve/ FTE)				
Numri i punonjësve të përhershëm (numri i punonjësve/ FTE)				
Numri i punonjësve të përkohshëm (numri i punonjësve/ FTE)				

Periudha e raportimit				
Femra	Meshkuj	Të tjerë (*)	E pa treguar	Totali
Numri i punonjësve me orë të pa garantuara (numri i punonjësve/ FTE)				
Numri i punonjësve me kohë të plotë (numri i punonjësve/ FTE)				
Numri i punonjësve me kohë të pjesshme (numri i punonjësve/ FTE)				
(*) Gjinia siç specifikohet nga vetë punonjësit.				

**Tabela 4. Model për paraqitjen e informacionit mbi punonjësit sipas llojit të kontratës, të ndarë sipas rajonit (numri i punonjësve ose FTE) (raportimi për punonjësit me kohë të plotë dhe të pjesshme është vullnetar)**

Periudha e raportimit		
Rajoni A	Rajoni B	Totali
Numri i punonjësve (numri i punonjësve/ FTE)		
Numri i punonjësve të përhershëm (numri i punonjësve/ FTE)		
Numri i punonjësve të përkohshëm (numri i punonjësve/ FTE)		
Numri i punonjësve me orë të pa garantuara (numri i punonjësve/ FTE)		
Numri i punonjësve me kohë të plotë (numri i punonjësve/ FTE)		
Numri i punonjësve me kohë të pjesshme (numri i punonjësve/ FTE)		

AR 56. Përkufizimet e **punonjësve** të përhershëm, të përkohshëm, të orëve të pagarantuara, me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme ndryshojnë midis vendeve. Nëse njësi ekonomike ka punonjës në më shumë se një vend, ajo duhet të përdorë përkufizimet sipas ligjeve kombëtare të vendeve ku ndodhen punonjësit për të llogaritur të dhënat në nivel vendi. Të dhënat në

nivel vendi duhet të mblidhen më pas për të llogaritur numrat totalë, duke mos marrë parasysh ndryshimet në përkufizimet ligjore kombëtare. Punonjësit me orë të pagarantuara punësohen nga njësia ekonomike pa një garanci për ndonjë numër minimal ose të fiksuar orësh pune. Punonjësi mund të jetë i disponueshëm për punë sipas kërkesës, por njësia ekonomike nuk është e detyruar kontraktualisht t'i ofrojë punonjësit një numër minimal ose të fiksuar orësh pune në ditë, javë ose muaj. Punonjësit e rastësishëm, punonjësit me kontrata zero orësh dhe punonjësit në gatishmëri janë shembuj që përfshin kjo kategori.

AR 57. Dhënia e numrit të **punonjësve** në fund të periudhës së raportimit ofron informacion për atë pikë kohore, pa kapur luhatjet gjatë periudhës së raportimit. Dhënia e këtyre numrave në mesatare gjatë gjithë periudhës së raportimit merr në konsideratë luhatjet gjatë periudhës së raportimit.

AR 58. Të dhënat sasiore, siç është numri i **punonjësve** të përkohshëm ose me kohë të pjesshme, nuk ka gjasa të jenë të mjaftueshme më vete. Për shembull, një përqindje e lartë e punonjësve të përkohshëm ose me kohë të pjesshme mund të tregojë mungesë sigurie në punësim për punonjësit, por mund të sinjalizojë po aq fleksibilitet në vendin e punës kur ofrohet si një zgjedhje vullnetare. Për këtë arsye, njësia ekonomike kërkohet të japë informacion kontekstual për të ndihmuar **përdoruesit** e informacionit të interpretojnë të dhënat. Njësia ekonomike mund të shpjegojë arsyet për punësim të përkohshëm. Një shembull i një arsyeje të tillë është rekrutimi i punonjësve për të ndërmarë punë në një projekt ose ngjarje të përkohshme ose sezonale. Një shembull tjetër është praktika standarde e ofrimit të një kontrate të përkohshme (për shembull, gjashtë muaj) punonjësve të rinj përpara se të bëhet një ofertë për punësim të përhershëm. Njësia ekonomike gjithashtu mund të shpjegojë arsyet për punësimin me orë të pagarantuara.

AR 59. Për llogaritjen e qarkullimit të punonjësve të vet, njësia ekonomike duhet të llogarisë totalin e numrit të **punonjësve** që largohen vullnetarisht ose për shkak të shkarkimit nga puna, daljes në pension ose vdekjes në punë. Njësia ekonomike duhet ta përdorë këtë numër për numëruesin e raportit të qarkullimit të punonjësve dhe mund të përcaktojë emëruesin e përdorur për të llogaritur këtë raport dhe për të përshkruar metodologjinë e tij.

AR 60. Kur të dhënat nuk janë të disponueshme për informacion të detajuar, njësia ekonomike duhet të përdorë një vlerësim të numrit të punonjësve, ose raporteve në përputhje me ESRS 1, dhe të identifikojë qartë se ku është bërë përdorimi i vlerësimeve.

#### Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-7 – Karakteristikat e personelit jo-punonjës brenda njësisë ekonomike

AR 61. Kjo Kërkesë për Dhënie Informacione Shpjeguese ofron një pasqyrë të qasjes së njësisë ekonomike ndaj punësimit, si dhe fushëveprimit dhe natyrës së ndikimeve që rrjedhin nga praktikatat e saj të punësimit. Ajo gjithashtu ofron informacion kontekstual që ndihmon në kuptimin e informacionit të raportuar në kërkesat e tjera për dhënie informacione shpjeguese. Dhënia e informacionit shpjegues sipas kësaj kërkesë mbulon si kontraktorët individualë që

furnizojnë punë për njësinë ekonomike ("persona të vetë punësuar") ashtu edhe punëtorët e ofruar nga njësitë ekonomike e angazhuara kryesisht në "aktivitete punësimi" (Kodi NACE N78). Nëse të gjithë njerëzit që kryejnë punë për njësinë ekonomike janë **punonjës** dhe njësia ekonomike nuk ka asnjë person të fuqisë punëtore të saj që nuk është punonjës, kjo Kërkesë për Dhënie informacioni shpjegues nuk është e rëndësishme për njësinë ekonomike; megjithatë, njësia ekonomike mund ta deklarojë këtë fakt kur paraqet informacionin e kërkuar nga Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-6 si informacion kontekstual, pasi ky informacion mund të jetë i rëndësishëm për **përdoruesit** e **Deklaratës së Qëndrueshmërisë**.

AR 62. Shembuj të kontraktorëve (persona të vetëpunësuar) në **fuqinë punëtore** të njësisë ekonomike përfshijnë: kontraktorë të punësuar nga njësia ekonomike për të kryer punë që përndryshe do të kryhej nga një punonjës; kontraktorë të punësuar nga njësia ekonomike për të kryer punë në një zonë publike (për shembull, në një rrugë, në rrugë); dhe kontraktorë të punësuar nga njësia ekonomike për të ofruar punën/shërbimin direkt në vendin e punës të një klienti të njësisë ekonomike. Shembuj të personave të punësuar nga një palë e tretë e angazhuar në "aktivitete punësimi", puna e të cilëve është nën drejtimin e njësisë ekonomike përfshijnë: njerëz që kryejnë të njëjtën punë që **punonjësit** kryejnë, siç janë njerëzit që zëvendësojnë punonjësit që mungojnë përkohësisht (për shkak të sëmundjes, pushimeve, lejes prindërore, etj.); njerëz që kryejnë punë të rregullt në të njëjtin **vend** si punonjësit e tjerë; dhe punëtorë që dërgohen përkohësisht nga një shtet tjetër anëtar i BE-së për të punuar për njësinë ekonomike ("punëtorë të dërguar"). Shembuj të **punëtorëve të zinxhirit të vlerës** (ose të punëtorëve që nuk janë pjesë e fuqisë punëtore të njësisë ekonomike dhe të raportuar sipas fushëveprimit të ESRS S2) përfshijnë: punëtorë për një **furnizues** të kontraktuar nga njësia ekonomike që punojnë në ambientet e furnizuesit duke përdorur metodat e punës së furnizuesit; punëtorë për një njësi tjetër ekonomike "në rrjedhën e poshtme" e cila blen mallra ose shërbime nga njësia ekonomike raportuese; dhe punëtorë të një furnizuesi pajisjesh për njësinë ekonomike të cilët, në një ose më shumë vende pune të njësisë ekonomike, kryejnë mirëmbajtje të rregullt të pajisjeve të furnizuesit (për shembull, fotokopjues) siç përcaktohet në kontratën midis furnizuesit të pajisjeve dhe njësisë ekonomike.

AR 63. Nëse njësia ekonomike nuk mund të raportojë shifra të sakta, ajo duhet të përdorë vlerësime sipas dispozitave në ESRS 1 për të informuar rreth numrit të njerëzve në **fuqinë punëtore të saj** të cilët nuk janë **punonjës** me një saktësi përreth dhjetëshen më të afërt ose, kur numri i njerëzve në fuqinë e vet punëtore që nuk janë punonjës është më i madh se 1,000, me saktësi tek 100-shja më e afërt, dhe ta shpjegojë këtë fakt. Përveç kësaj, duhet të identifikojë qartë informacionin që rrjedh nga të dhënat dhe vlerësimet aktuale.

AR 64. Dhënia e informacionit për numrin e njerëzve në **fuqinë punëtore** të njësisë ekonomike të cilët nuk janë **punonjës** në fund të periudhës së raportimit përfshin informacionin aktual në atë pikë kohore pa përmendur luhatjet gjatë periudhës së raportimit. Dhënia e informacionit për këtë numër si mesatare gjatë gjithë periudhës së raportimit merr në konsideratë luhatjet gjatë

periudhës së raportimit dhe mund të ofrojë informacion më të plotë dhe të rëndësishëm për **përdoruesit**.

AR 65. Informacioni i dhënë nga njësia ekonomike u lejon **përdoruesve** për të kuptuar se si numri i të **jo-punësuarve** në **fuqinë e vet punëtore** të njësisë ekonomike ndryshon gjatë periudhës së raportimit ose krahasuar me periudhën e mëparshme të raportimit (domethënë, nëse numrat janë rritur apo janë ulur). Njësia ekonomike gjithashtu mund të japë informacion për arsyet e luhatjeve. Për shembull, një rritje në numrin e jo-punonjësve gjatë periudhës së raportimit mund të jetë për shkak të një ngjarjeje sezonale. Anasjelltas, një rënie në numrin e jo-punonjësve krahasuar me periudhën e mëparshme të raportimit mund të jetë për shkak të përfundimit të një projekti të përkohshëm. Nëse njësia ekonomike paraqet informacion për luhatjet, ajo duhet të shpjegojë gjithashtu kriteret e përdorura për të përcaktuar se cilat luhatje janë shtjelluar. Nëse nuk ka luhatje të konsiderueshme në numrin e jo-punonjësve gjatë periudhës së raportimit ose midis periudhës aktuale dhe asaj të mëparshme të raportimit, njësia ekonomike mund ta japë këtë informacion.

#### Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-8 – Mbulimi nëpërmjet negociatave kolektive dhe dialogut social

Mbulimi nga marrëveshjet kolektive

AR 66. Përqindja e **punonjësve** i mbuluar nga negociatat e **marrëveshjeve kolektive** llogariten duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$\frac{\text{Numri i punonjësve të mbuluar nga marrëveshjet kolektive}}{\text{Numri i përgjithshëm i punonjësve}} \times 100$$

AR 67. **Punonjësit e fuqisë e vet punëtore** të njësisë ekonomike që mbulohen nga negociatat e **marrëveshjeve kolektive** janë ata individë ndaj të cilëve njësia ekonomike është e detyruar të zbatojë marrëveshjen. Kjo do të thotë që nëse asnjë nga punonjësit nuk mbulohet nga një marrëveshje kolektive, përqindja e raportuar është zero. Një punonjës i fuqisë punëtore të njësisë ekonomike i mbuluar nga më shumë se një marrëveshje kolektive duhet të llogaritet vetëm një herë.

AR 68. Kjo kërkesë nuk synon të merret me përqindjen e **punonjësve** të përfaqësuar nga një këshill pune ose që i përket sindikatave, të cilat mund të jenë të ndryshme. Përqindja e punonjësve të mbuluar nga negociatat e **marrëveshjeve kolektive** mund të jenë më të larta se përqindja e punonjësve anëtarë të sindikatave kur marrëveshjet kolektive zbatohen si për anëtarët e sindikatës ashtu edhe për ata që nuk janë anëtarë të sindikatës. Nga ana tjetër, përqindja e punonjësve të mbuluar nga marrëveshjet kolektive mund të jetë më e ulët se përqindja e punonjësve anëtarë të sindikatave. Ky mund të jetë rasti kur nuk ka marrëveshje kolektive në dispozicion ose kur marrëveshjet kolektive nuk i mbulojnë të gjithë punonjësit e sindikatës.

## Dialogu Social

AR 69. Për llogaritjen e informacionit të kërkuar nga paragrafi 63(a), njësia ekonomike duhet të identifikojë se në cilat vende të Zonës Ekonomike Evropiane (EEA) ka punësim të konsiderueshëm (domethënë, të paktën 50 punonjës që përfaqësojnë të paktën 10% të totalit të punonjësve të saj). Për këto vende ajo duhet të raportojë përqindjen e **punonjësve** në atë vend të cilët janë të punësuar në institucione në të cilat punonjësit përfaqësohen nga **përfaqësuesit e punëtorëve**. Institucion do të quhet çdo vend aktiviteti ku njësia ekonomike kryen një aktivitet ekonomik jo-të përkohshëm me mjete njerëzore dhe materiale. Shembujt përfshijnë: një fabrikë, një degë të një zinxhiri shitjeje me pakicë ose selinë e një njësie ekonomike. Për vendet në të cilat ka vetëm një njësi, përqindja e raportuar duhet të jetë ose 100% ose 0%.

$$\frac{\text{Numri i punonjësve që punojnë në njësine ekonomike me përfaqësues të punëtorëve}}{\text{Numri i përgjithshëm i punonjësve}} \times 100$$

AR 70. Informacioni i kërkuar nga kjo Kërkesë për Dhënie informacioni shpjegues duhet të raportohet si më poshtë

**Tabela 1. Model raportimi për mbulimin e marrëveshjeve kolektive dhe dialogun social**

Shkalla e mbulimit	Mbulimi nga marrëveshjet kolektive		Dialogu social
	Punonjësit – EEA (Zona Ekonomike Evropiane) (për vendet me >50 të punësuar që përfaqësojnë >10% të totalit të të punësuarve)	Punonjësit – jo EEA (vlerësim për rajonet me >50 të punësuar që përfaqësojnë >10% të totalit të të punësuarve)	Përfaqësimi në vendin e punës (vetëm për zonën EEA) (për vendet me >50 të punësuar që përfaqësojnë >10% të totalit të të punësuarve)
0 -19 %		Rajoni A	
20 -39 %	Vendi A	Rajoni B	
40 -59 %	Vendi B		Vendi A
60 -79 %			Vendi B
80 -100 %			

### Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-9 – Treguesit e diversitetit

AR 71. Gjatë përgatitjes së deklaramit mbi gjininë në nivelin e menaxhimit të lartë, njësia ekonomike duhet të përdorë përkufizimin e menaxhimit të lartë si një dhe dy nivele poshtë organeve administrative dhe mbikëqyrëse, përveç rastit kur ky koncept është përcaktuar tashmë me aktivitetet e njësisë ekonomike dhe ndryshon nga përshkrimi i mëparshëm. Nëse është ky rasti, njësia ekonomike mund të përdorë përkufizimin e vet për menaxhimin e lartë dhe të japë informacion për këtë fakt dhe për përkufizimin e vet.

### Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-10 – Paga të përshtatshme

AR 72. Paga më e ulët llogaritet për pagën më të ulët në kategori, duke përjashtuar praktikantët dhe nxënësit. Kjo duhet të bazohet mbi pagën bazë plus çdo pagesë shtesë fikse që u garantohet të gjithë **punonjësve**. Paga më e ulët duhet të merret në konsideratë veçmas për secilin shtet në të cilin njësia ekonomike ka aktivitete, përveç jashtë EEA-së kur paga përkatëse e përshtatshme ose minimale përcaktohet në një nivel nën kombëtar.

AR 73. **Paga e përshtatshme** si pike referuese e përdorur për krahasim me pagën më të ulët nuk duhet të jetë më e ulët se:

(a) paga minimale e përcaktuar në përputhje me Direktivën (BE) 2022/2041 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit<sup>112</sup> mbi pagat minimale të përshtatshme në Bashkimin Evropian për vendet EEA. Në periudhën deri në hyrjen në zbatim të Direktivës (BE) 2022/2041, aty ku nuk ka **pagë** minimale të zbatueshme të përcaktuara nga legjislacioni ose marrëveshjet kolektive në një vend të EEA-së, njësia ekonomike duhet të përdorë një **pagë të përshtatshme** si pikë referimi që nuk është as më e ulët se paga minimale në një vend fqinj me një status të ngjashëm social-ekonomik, dhe as më e ulët se një normë ndërkombëtare e referuar zakonisht, siç është 60% e pagës mesatare të vendit dhe 50% e pagës mesatare bruto.

(b) për vendet jashtë EEA:

- i. niveli i pagës i përcaktuar në çdo legjislacion ekzistues ndërkombëtar, kombëtar ose nën kombëtar, norma zyrtare ose marrëveshje kolektive, bazuar në një vlerësim të një niveli page të nevojshëm për një standard të mirë jetese;
- ii. nëse nuk ekziston asnjë nga instrumentet e identifikuar në (i), çdo pagë minimale kombëtare ose nën kombëtare e përcaktuar me legjislacion ose **negociata kolektive**; ose
- iii. nëse nuk ekziston asnjë nga instrumentet e identifikuar në (i) ose (ii), çdo pikë referimi që përmbush kriteret e përcaktuara nga Iniciativa e Tregtisë së Qëndrueshme (IDH) ("*Udhërrëfyese mbi Pagat e Jetesës - Një Platformë për të Siguruar Pagat e Jetesës në Zinxhirët e Furnizimit*"), duke përfshirë pikët referuese të zbatueshme në përputhje

---

<sup>112</sup> Direktiva (BE) 2022/2041 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 19 tetor 2022, mbi pagat minimale të përshtatshme në Bashkimin Evropian (GZ L 275, 25.10.2022, f. 33).

me metodologjinë Anker, ose të ofruara nga Fondacioni i Treguesve të Pagave ose Rrjeti i Pagave të Drejta, me kusht që të sigurohet përparësia e negociatave kolektive për përcaktimin e kushteve dhe afateve të punësimit.

AR 74. Direktiva (BE) 2022/2041 mbi **pagat** minimale të përshtatshme në Bashkimin Evropian, i referohet të dy vlerave referuese që përdoren zakonisht në nivel ndërkombëtar, siç janë 60% e medianës së pagës bruto dhe 50% e pagës mesatare bruto, si edhe vlerat referuese që përdoren në nivel kombëtar. Të dhënat për vlerat referuese prej 60% të medianës së pagës bruto kombëtare ose 50% të pagës mesatare bruto kombëtare mund të merren nga Anketa Evropiane e Forcës Punëtore.

#### Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-11 – Mbrojtja sociale

AR 75. **Mbrojtja sociale** i referohet të gjitha masave që ofrojnë akses në kujdes shëndetësor dhe mbështetje me të ardhura në rastet të tilla të jetës, si humbja e punës, sëmundje dhe nevoja për kujdes mjekësor, lindja dhe rritja e një fëmije, ose dalja në pension dhe nevoja për pension.

#### Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-12 – Personat me aftësi të kufizuara

AR 76. Kur paraqet informacionin e kërkuar në paragrafin 77 në lidhje me **personat me aftësi të kufizuara**, njësia ekonomike duhet të ofrojë çdo informacion kontekstual të nevojshëm për të kuptuar të dhënat dhe mënyrën se si janë përpiluar të dhënat (metodologjia). Për shembull, informacion në lidhje me ndikimin e përkufizimeve të ndryshme ligjore të personave me aftësi të kufizuara në vendet e ndryshme në të cilat njësia ekonomike ushtron aktivitetin.

#### Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-13 – Treguesit e trainimit dhe zhvillimit të aftësive

AR 77. Një rishikim i rregullt i performancës përkufizohet si një rishikim i bazuar në kritere të njohura për punonjësin dhe eprorin e tij ose të saj, i ndërmarrë me dijeninë e punonjësit të paktën një herë në vit. Rishikimi mund të përfshijë një vlerësim nga eprori i drejtpërdrejtë i punonjësit, nga kolegët ose nga një gamë më e gjerë **punonjësish**. Rishikimi mund të përfshijë gjithashtu departamentin e burimeve njerëzore. Për të dhënë informacionin e kërkuar nga paragrafi 83 (a), njësia ekonomike duhet të përdorë numrat e punonjësve të dhëna në Kërkesën për dhënie informacione shpjeguese ESRS S1-6 si emërues për të llogaritur:

- (a) numrin/raportin (proporcionin) e rishikimeve të performancës për punonjës; dhe
- (b) numrin e rishikimeve në përpjesëtim me numrin e rishikimeve të dakordësuara nga drejtuesit.

AR 78. Për të përcaktuar mesataren e kërkuar sipas paragrafit 83 (b), njësia ekonomike duhet të kryejë llogaritjen si më poshtë: totali i orëve të **trajnitimit** të ofruara dhe të përfunduara nga **punonjësit** sipas kategorisë gjinore pjesëtuar me numrin total të punonjësve në secilën kategori gjinore. Për mesataren totale të trajnitimit dhe mesataren sipas gjinisë, do të përdoren

shifrat e numrit të punonjësve për punësimin total dhe për punësimin sipas gjinisë të raportuara në Kërkesën e dhënies së informacioneve shpjeguese ESRS S1-6.

AR 79. Kategoritë e punonjësve janë një ndarje e **punonjësve** sipas nivelit (siç është menaxhimi i lartë, menaxhimi i mesëm) ose sipas funksionit (siç është teknik, administrativ, prodhimi). Ky informacion gjendet në sistemim e burimeve njerëzore të vetë njësisë ekonomike. Në kategorizimin e fuqisë punëtore, njësia ekonomike duhet të përcaktojë kategori të arsyeshme dhe kuptimplota të punonjësve të cilat u mundësojnë **përdoruesve** të informacionit të kuptojnë dallimet e performancës ndërmjet këtyre kategorive. Njësia ekonomike mund të paraqesë një kategori për punonjësit ekzekutivë dhe jo-ekzekutivë.

#### Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-14 – Treguesit e shëndetit dhe sigurisë

AR 80. Në lidhje me paragrafin 88 (a), përqindja e **fuqisë punëtore** që mbulohet nga sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë së njësisë ekonomike duhet të paraqiten në bazë të numrit real të punonjësve dhe jo mbi një bazë ekuivalente me kohë të plotë.

AR 81. Në lidhje me paragrafin 90, kur sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë së njësisë ekonomike, ose pjesë të caktuara të tij, i janë nënshtruar një auditimi të brendshëm ose certifikimi të jashtëm, njësia ekonomike mund ta deklarojë këtë fakt, ose mungesën e tij, dhe standardet për këto auditime/certifikime të tilla, sipas rastit.

AR 82. Vdekjet mund të raportohen veçmas për ato që vijnë nga **lëndime të lidhura me punën** dhe ato që vijnë nga **sëmundje të lidhura me punën**.

Udhëzime për termin "të lidhura me punën"

AR 83. **Lëndime të lidhura me punën** dhe **shëndetin e dobët që lidhet me punën** rrjedhin nga ekspozimi ndaj rreziqeve në punë. Pavarësisht kësaj, lloje të tjera **incidentesh** mund të ndodhin që nuk lidhen me vetë punën. Për shembull, incidentet e mëposhtme në përgjithësi nuk konsiderohen të lidhura me punën, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në legjislacionin kombëtar në fuqi:

- (a) një person i fuqisë punëtore pëson një atak në zemër gjatë punës që nuk lidhet me punën;
- (b) një person i fuqisë punëtore që drejton makinën për në punë ose kthehet nga puna lëndohet në një aksident me makinë (kur drejtimi i makinës nuk është pjesë e punës dhe kur transporti nuk është organizuar nga njësia ekonomike); dhe
- (c) një person i fuqisë punëtore me epilepsi ka një krizë në punë që nuk lidhet me punën.

AR 84. Në lidhje me udhëtimet për qëllime pune, lëndimet dhe sëmundjet që ndodhin gjatë udhëtimit të një personi lidhen me punën nëse, në kohën e lëndimit ose shëndetit të keq, personi ka qenë i angazhuar në aktivitete pune "në interes të punëdhënësit". Shembuj të aktiviteteve të tilla përfshijnë udhëtimin për në vajtje dhe në kthim nga takimet me klientët; kryerjen e detyrave të punës; dhe argëtimin për të kryer transaksione, diskutime ose

promovime të biznesit (sipas udhëzimeve të punëdhënësit). Nëse njësia ekonomike është përgjegjëse për transportin, udhëtimin vajtje-ardhje, **incidentet** që kanë ndodhur gjatë udhëtimit për në punë konsiderohen të lidhura me punën. Megjithatë, incidentet që lindin gjatë udhëtimit, jashtë përgjegjësisë së njësisë ekonomike (p.sh., udhëtimet e rregullta për në punë dhe nga puna), mund të raportohen veçmas me kusht që njësia ekonomike të ketë të dhëna të tilla të disponueshme në të gjithë njësinë ekonomike.

AR 85. Lidhur me punën nga shtëpia, lëndimet dhe problemet shëndetësore që ndodhin gjatë punës nga shtëpia lidhen me punën, nëse lëndimi ose problemet shëndetësore ndodhin ndërsa personi është duke kryer punë nga shtëpia; dhe lëndimi ose problemet shëndetësore lidhen drejtpërdrejt me kryerjen e punës dhe jo me mjedisin ose vendosjen e përgjithshme në shtëpi.

AR 86. Lidhur me sëmundjen mendore, ajo konsiderohet e lidhur me punën, nëse është njoftuar vullnetarisht nga personi përkatës dhe mbështetet nga opinioni i një profesionist të licencuar i kujdesit shëndetësor që ka **trajnimin** dhe përvojën e përshtatshme; dhe nëse një opinion i tillë pohon se sëmundja lidhet me punën.

AR 87. Problemet shëndetësore që vijnë, për shembull, nga pirja e duhanit, abuzimi me drogën dhe alkoolin, mungesa e aktivitetit fizik, dietat e pashëndetshme dhe faktorë psikosocialë që nuk lidhen me punën nuk konsiderohen të lidhura me punën.

AR 88. Sëmundjet profesionale nuk konsiderohen **lëndime të lidhura me punën** por dhe ato mbulohen nga **sëmundjet që lidhen me punën**.

#### Udhëzime për llogaritjen e shkallës së lëndimeve në punë

AR 89. Gjatë llogaritjes së shkallës së lëndimeve në punë, njësia ekonomike duhet të pjesëtojë numrin përkatës të rasteve me numrin total të orëve të punuara nga njerëzit e **fuqisë punëtore** të saj dhe duke e shumëzuar me 1,000,000. Kështu, këto norma përfaqësojnë numrin e rasteve përkatëse për një milion orë pune. Një raport i bazuar në 1,000,000 orë pune tregon numrin e lëndimeve të lidhura me punën për 500 persona me kohë të plotë të fuqisë punëtore gjatë një periudhe kohore 1-vjeçare. Për qëllime krahasimi, një normë e bazuar në 1,000,000 orë pune do të përdoret edhe për njësitë ekonomike me më pak se 500 persona të fuqisë punëtore.

AR 90. Nëse njësia ekonomike nuk mund ta llogarisë drejtpërdrejt numrin e orëve të punuara, ajo mund ta vlerësojë këtë në bazë të orëve normale ose standarde të punës, duke marrë parasysh të drejtat për periudhat e lejes së paguar ose të mungesës në punë (për shembull, pushime të paguara, leje mjekësore të paguara, festa zyrtare) dhe ta shpjegojë këtë në informacionet që duhet të japë.

AR 91. Një njësi ekonomike duhet të përfshijë vdekjet si pasojë e lëndimeve në punë në llogaritjen e numrit dhe shkallës së lëndimeve të regjistruara në punë.

## Udhëzime mbi sëmundjet e regjistruara në punë

- AR 92. Sëmundjet shëndetësore që lidhen me punën mund të përfshijnë probleme shëndetësore akute, të përsëritura dhe kronike të shkaktuara ose të përkeqësuar nga kushtet ose praktikrat e punës. Këto përfshijnë çrregullime muskuloskeletale, sëmundje të lëkurës dhe të frymëmarrjes, kancere malinje, sëmundje të shkaktuara nga agjentë fizikë (për shembull, humbje të dëgjimit të shkaktuar nga zhurma, sëmundje të shkaktuara nga dridhjet) dhe sëmundje mendore (për shembull, ankth, çrregullim të stresit post-traumatik). Për qëllimin e deklarimeve të kërkuara, njësia ekonomike duhet, të paktën, të përfshijë në deklarimin e saj ato raste të përcaktuara në Listën e Sëmundjeve Profesionale të ILO-s.
- AR 93. Në kontekstin e këtij Standardi, çrregullimet muskuloskeletale të lidhura me punën mbulohen tek sëmundjet e lidhura me punën (dhe jo lëndimet).
- AR 94. Rastet që duhen të shtjelluar me informacion shpjegues në paragrafin 88(d) lidhen me rastet e shëndetit të dobët që lidhen me punën, për të cilat është njoftuar njësia ekonomike ose i ka identifikuar vetë nëpërmjet mbikëqyrjes mjekësore, gjatë periudhës së raportimit. Njësia ekonomike mund të njoftohet për rastet e shëndetit të dobët që lidhen me punën nëpërmjet raporteve nga personat e prekur, agjencitë e kompensimit ose nga shërbimi profesional i kujdesit shëndetësor. Dhënia e informacioneve shpjeguese mund të përfshijë rastet e shëndetit të dobët që lidhen me punën, të cilat janë dhënë si informacion gjatë periudhës së raportimit midis atyre personave që më parë kanë qenë pjesë e fuqisë punëtore të njësisë ekonomike.

## Udhëzime për numrin e ditëve të humbura

- AR 95. Njësia ekonomike duhet të llogarisë numrin e ditëve të humbura duke përfshirë ditën e parë e plotë dhe ditën e fundit e mungesës. Ditët kalendarike duhet të merren në konsideratë për llogaritjen, kështu që ditët në të cilat individi i prekur nuk është planifikuar të punojë (për shembull, fundjava, festa zyrtare) do të llogariten si ditë të humbura.

### Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-15 – Ekuilibri midis punës dhe jetës personale

- AR 96. Leja e lidhur me familjen përfshin lejen e lehonisë (pas lindjes), lejen e atësisë, lejen prindërore dhe lejen e kujdestarit që është e disponueshme sipas ligjit kombëtar ose marrëveshjeve kolektive. Për qëllimet e këtij Standardi, këto koncepte përkufizohen si:
- (a) leje lindjeje (e quajtur edhe leje shtatzënie): leje për të mos punuar për gratë e punësuarat menjëherë rreth kohës së lindjes së fëmijës (ose, në disa vende, të birësimit);
  - (b) leje atësie: leje nga puna për baballarët ose, aty ku dhe për atë që njihet nga ligji kombëtar, për prindërit e dytë ekuivalentë, me rastin e lindjes ose birësimit të një fëmije me qëllim ofrimin e kujdesit shëndetsor;

- (c) leje prindërore: leje nga puna për prindërit për shkak të lindjes ose birësimit të një fëmije për t'u kujdesur për atë fëmijë, siç përcaktohet nga secili Shtet Anëtar;
- (d) leje nga puna për kujdestarët: leje për punëtorët për të ofruar kujdes personal ose mbështetje për një të afërm, ose një person që jeton në të njëjtën familje, që ka nevojë për kujdes ose mbështetje të konsiderueshme për një arsye serioze mjekësore, siç përcaktohet nga secili Shtet Anëtar.

AR 97. Lidhur me paragrafin 93 (a), punonjësit që kanë të drejtë për leje familjare janë ata që mbulohen nga rregulloret, politikat organizative, marrëveshjet, kontratat ose **negociatat kolektive**. marrëveshje që përmbajnë të drejta për leje familjare dhe ia kanë raportuar të drejtën e tyre njësisë ekonomike ose njësia ekonomike është në dijeni të së drejtës.

**Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-16 – Treguesit e shpërblimit (hendeku në paga dhe shpërblimi total)**

Hendeku i pagave

AR 98. Gjatë mbledhjes së informacionit të kërkuar sipas paragrafit 97 (a) për hendekun në **pagë** midis punonjëseve të saj femra dhe meshkuj (e njohur edhe si "hendeku gjinor në paga"), njësia ekonomike duhet të përdorë metodologjinë e mëposhtme:

- (a) përfshi të gjithë **punonjësit** niveli i pagës bruto në orë; dhe
- (b) zbato formulën e mëposhtme për të llogaritur hendekun gjinor në paga:

$$\frac{(\text{Niveli mesatar bruto orë përmes meshkuj} - \text{niveli mesatar i pagës bruto orë për femra})}{\text{Niveli mesatar i pagës bruto për orë i punonjësve meshkuj}} \times 100$$

AR 99. Kur jepet informacion shpjegues siç kërkohet nga paragrafi 97 (a), njësia ekonomike duhet të ofrojë çdo informacion kontekstual të nevojshëm për të kuptuar të dhënat dhe mënyrën se si janë përpiluar të dhënat (metodologjia). Mund të raportohet informacion në lidhje me mënyrën se si faktorët objektivë, të tillë si lloji i punës dhe vendi i punësimit, ndikojnë në hendekun gjinor të **pagave**.

AR 100. Masa e hendekut gjinor në **paga** të ndërmarrjes duhet të raportohet për periudhën aktuale të raportimit dhe, nëse është raportuar në raportet e mëparshme të qëndrueshmërisë, për dy periudhat e mëparshme të raportimit.

Raporti i shpërblimit total

AR 101. Gjatë mbledhjes së informacionit të kërkuar nga paragrafi 97 (b), njësia ekonomike duhet të:

- (a) përfshijë të gjithë **punonjësit**;
- (b) të marrë në konsideratë, në varësi të politikave të shpërblimit të njësisë ekonomike, të gjitha sa vijon:
  - i. pagën bazë, e cila është shuma e kompensimit të garantuar, afatshkurtër dhe jo të ndryshueshëm në para;

- ii. përfitimet në para të gatshme, që është shuma e pagës bazë dhe shtesave në para të gatshme, e shpërblimeve, komisioneve, ndarjes së fitimit në para të gatshme dhe formave të tjera të pagesave të ndryshueshme në para të gatshme;
- iii. përfitimet në natyrë, të tilla si makina, sigurim shëndetësor privat, sigurim jete, programe mirëqenieje; dhe
- iv. shpërblimin e drejtpërdrejtë, i cili është shuma e përfitimeve në para të gatshme, përfitimeve në natyrë dhe vlerës totale të drejtë të të gjitha stimuljeve vjetorë afatgjatë (për shembull, shpërblimet me opsione aksionesh, aksionet ose njësitë e aksioneve të kufizuara, aksionet ose njësitë e aksioneve me performancë të lartë, aksionet fantazmë, rivlerësime të të drejtave për aksione dhe shpërblimet afatgjata në para të gatshme).

(c) zbatoni formulën e mëposhtme për raportin e **shpërblimit total vjetor**:

$$\frac{\text{Shpërblimi total vjetor për individin më të paguar të ndërmarrjes}}{\text{Shpërblimi total vjetor median i punonjësve (duke përjashtuar individin më të paguar)}}$$

AR 102. Për të ilustruar informacionin kontekstual, njësia ekonomike mund të japë një shpjegim për të kuptuar të dhënat dhe mënyrën se si janë përpiluar të dhënat (metodologjia). Të dhëna sasiore, siç është raporti i **shpërblimit total vjetor**, mund të mos jetë i mjaftueshëm më vete për të kuptuar pabarazinë e **pagës** dhe faktorët që e shkaktojnë atë. Për shembull, raportet e pagave mund të ndikohen nga madhësia e njësisë ekonomike (për shembull, të ardhurat, numri i **punonjësve**), nga sektori i saj, strategjia e saj e punësimit (për shembull, mbështetja tek punëtorët e jashtëm ose punonjësit me kohë të pjesshme, shkalla e lartë e automatizimit) ose nga paqëndrueshmëria e monedhës.

**Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S1-17 – Incidente, ankesa dhe ndikime të rënda në të drejtat e njeriut**

AR 103. Përveç informacionit të kërkuar nga paragrafët 103 dhe 104, njësia ekonomike mund të japë informacion mbi statusin e **incidenteve** dhe/ose të ankesave dhe veprimet e ndërmarra në lidhje me sa vijon:

- (a) incidentet e shqyrtuara nga njësia ekonomike;
- (b) planet e rehabilitimit që po zbatohen;
- (c) planet e rehabilitimit që janë zbatuar, me rezultatet e shqyrtuara përmes proceseve rutinë të rishikimit të brendshëm të menaxhimit; dhe
- (d) incidentet që nuk i nënshtrohen më veprimeve.

AR 104. ► **C1** Nëse njësia ekonomike përpilon informacionin e përshkruar në AR 103, ajo duhet të marrë në konsideratë sa vijon: ◀

- (a) një **incident** nuk është më subjekt i veprimeve të mëtejshme nëse është zgjidhur, në këtë rast, çështja përfundon ose nuk kërkohet asnjë veprim i mëtejshëm nga njësia ekonomike. Për shembull, një incident për të cilin nuk kërkohet asnjë veprim i mëtejshëm mund të

përfshijë raste që janë tërhequr ose kur rrethanat themelore që çuan në incident nuk ekzistojnë më;

- (b) veprimet rehabilituese drejtohen ndaj ngacmuesit të supozuar dhe viktimës së supozuar. Veprimet korigjuese ndaj viktimës mund të përfshijnë ofrimin për të paguar shpenzimet e tij/saj për seancat e këshillimit, ofrimin e disa ditëve të pushimit të paguar për viktimën, rikthimin e ditëve të pushimit mjekësor ose ditëve të sëmurë nëse viktimja ka pasur ndonjë shpenzim për shkak të **ngacmimit** (si p.sh. shfrytëzimi i ditëve të sëmundjes ose pushimeve); dhe
- (c) veprimet korigjuese ndaj ngacmuesit mund të përfshijnë dhënien e një paralajmërimi me gojë dhe/ose me shkrim ndaj ngacmuesit, dhënien e këshillimit kundër ngacmimit ose dërgimin e ngacmuesit në një seminar të përshtatshëm, **trajnim** për ndërgjegjësim dhe parandalim të ngacmimit. Një pezullim nga puna pa **pagesë** mund të jetë gjithashtu një mundësi. Nëse ndaj ngacmuesit ka pasur masa disiplinore më parë, dhe ai/ajo nuk e kanë ndaluar ngacmimin, atëherë mund të kërkohej një masë disiplinore më serioze.

AR 105. **Incidente** të rënda të të drejtave të njeriut përfshijnë raste të padive, ankesave zyrtare përmes njësisë ekonomike ose mekanizmave të ankesave të palëve të treta, akuzave serioze në raportet publike ose në media, kur këto lidhen me **fuqinë e vet punëtore** të njësisë ekonomike, dhe fakti i incidenteve nuk është kundërshtuar nga njësia ekonomike, si dhe çdo ndikim tjetër të rëndë për të cilin njësia ekonomike është në dijeni.

AR 106. Përveç informacionit të kërkuar nga paragrafi 104 më sipër, njësia ekonomike mund të japë informacion numrin e **incidenteve** të rënda të të drejtave të njeriut ku njësia ekonomike luajti një rol në sigurimin e **zgjdhjes** për ata që janë prekur gjatë periudhës së raportimit.

## Shtojca A.1. Kërkesat për Zbatim për deklarimet që lidhen me ESRS 2

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e ESRS S1 *Fuqia e vet punëtore*. Ajo mbështet zbatimin e kërkesave për informacion shpjegues të ESRS 2 të përcaktuara në këtë standard dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të këtij Standardi. Ajo ofron një listë jo të plotë të faktorëve që duhet të merren në konsideratë nga njësia ekonomike kur përmbushen kërkesat e ESRS 2 SBM-2 dhe ESRS 2 SBM-3. Kjo shtojcë nuk ofron përkufizime të termave të përmendur më poshtë. Të gjithë termat e përcaktuar mund të gjenden në Shtojcën II: Shkurtime dhe Fjalori i Termave.

Çështje sociale dhe të të drejtave të njeriut	Listë jo-shteruese e faktorëve që duhen marrë në konsideratë në Vlerësimin e Materialitetit
Punësim i sigurt	% e punonjësve me kontrata të përkohshme, raporti i jo-punonjësve me punonjësit, mbrojtja sociale

<b>Çështje sociale dhe të të drejtave të njeriut</b>	<b>Listë jo-shteruese e faktorëve që duhen marrë në konsideratë në Vlerësimin e Materialitetit</b>
<b>Koha/Orari i punës</b>	% e punonjësve me kontrata me kohë të pjesshme ose zero orë, kënaqësia e punonjësve me kohën e punës
<b>Pagat e duhura</b>	Përkufizime ligjore të BE-së, kombëtare ose lokale të pagave të përshtatshme, pagave të drejta dhe pagave minimale
<b>Dialogu social / ekzistenca e këshillave të punës / të drejtat e punëtorëve për informacion, konsultim dhe pjesëmarrje</b>	Shkalla e përfaqësimit në vendin e punës, ndërkufitar dhe në nivel bordi përmes sindikatave dhe/ose këshillave të punës
<b>Liria e shoqërimit/negociatat për marrëveshje kolektive, duke përfshirë shkallën e fuqisë punëtore të mbuluar nga marrëveshjet kolektive</b>	% e fuqisë punëtore të mbuluar nga marrëveshjet kolektive, ndërprerjet e punës
<b>Ekulibri punë-jetë</b>	Leje për arsye familjare, orar pune fleksibël, qasje në kujdesin ndaj fëmijëve
<b>Shëndeti dhe siguria në punë</b>	Mbulimi nga sistemi i Shëndetit dhe Sigurisë, shkalla e vdekjeve, aksidentet jo-fatale, sëmundjet që lidhen me punën, ditët e humbura të punës
<b>Barazia gjinore dhe paga e barabartë për punë me vlerë të barabartë</b>	% e grave në menaxhimin e lartë dhe në fuqi punëtore, hendeku i pagave midis burrave dhe grave
<b>Trajnimi dhe zhvillimi i aftësive</b>	Sasia dhe shpërndarja e trajnimit, % e punonjësve me rishikime të rregullta të performancës
<b>Punësimi dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuara</b>	% e punësimit dhe masave të aksesueshmërisë për punonjësit me aftësi të kufizuara
<b>Masat kundër dhunës dhe ngacmimit në vendin e punës</b>	Përhapja e dhunës dhe ngacmimit
<b>Diversiteti</b>	Përfaqësimi i grave dhe/ose grupeve etnike ose minoriteteve në fuqinë e vet punëtore. Shpërndarja sipas moshës e fuqisë e vet punëtore. Përqindja e personave me aftësi të kufizuara brenda fuqisë së vet punëtore.

<b>Çështje sociale dhe të të drejtave të njeriut</b>	<b>Listë jo-shteruese e faktorëve që duhen marrë në konsideratë në Vlerësimin e Materialitetit</b>
<b>Puna e fëmijëve</b>	Lloji i veprimtarive dhe zonat gjeografike në rrezik të punës së fëmijëve
<b>Punë e detyruar</b>	Lloji i veprimtarive dhe zonat gjeografike në rrezik të punës së detyruar

## **Shtojca A.2. Kërkesat për Zbatim për ESRS S1-1 Politikat që lidhen me fuqinë e vet punëtore**

Kjo shtojcë është një pjesë integrale e ESRS S1 *Fuqia e vet punëtore* dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të këtij Standardi. Ajo mbështet zbatimin e Kërkesës për dhënie informacion shpjegues ESRS S1-1 për çështjet sociale dhe të të drejtave të njeriut me shembuj të informacionit që jepet.

<b>Çështje sociale dhe të të drejtave të njeriut</b>	<b>Shembujt e politikave:</b>
<b>Punësim i sigurt</b>	Politikë pa pushime nga puna, pa kufizime në rinovimin e kontratave të përkohshme, ofrim i mbrojtjes sociale nga punëdhënësi aty ku ky shërbim shtetëror mungon.
<b>Koha/Orari i punës</b>	Kufizime në orët shtesë, turnet e gjata dhe të ndara, si dhe puna gjatë natës dhe fundjavës, planifikim adekuat i kohës dhe njoftim në kohë për ndryshimet.
<b>Pagat e duhura</b>	Politikë për të siguruar që të gjithë njerëzit në fuqinë punëtore të marrin një pagë të përshtatshme
<b>Dialogu social / ekzistenca e këshillave të punës / të drejtat e punëtorëve për informacion, konsultim dhe pjesëmarrje</b>	Politikë për të inkurajuar institucionet për dialog social, informim dhe konsultim të rregullt me përfaqësuesit e punëtorëve, konsultim përpara se të merren vendime përfundimtare për çështjet që lidhen me punësimin.
<b>Liria e pjesëmarrjes në shoqata/negociata për marrëveshje kolektive, duke përfshirë shkallën e punonjësve të mbuluar nga marrëveshjet kolektive</b>	Mosndërhyrje në formimin dhe rekrutimin e sindikatave (përfshirë qasjen e sindikatave në ndërmarrje), negociata në mirëbesim, kohë e mjaftueshme pushimi për përfaqësuesit e punëtorëve për të kryer detyrat e tyre, lehtësira dhe mbrojtje nga pushimi nga puna për përfaqësuesit e punëtorëve, mosdiskriminim ndaj

Çështje sociale dhe të të drejtave të njeriut	Shembujt e politikave:
	anëtarëve të sindikatave dhe përfaqësuesve të punëtorëve.
<b>Ekulibri punë-jetë</b>	Sigurimi i lejes familjare, orari fleksibël i punës dhe qasje në qendra kujdesi ditor për të gjithë punonjësit.
<b>Shëndeti dhe siguria në punë</b>	Përfshirja e gjithë forcës punëtore në sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë.
<b>► C1 Barazia gjinore dhe paga e barabartë për punë me vlerë të barabartë ◀</b>	<b>► C1</b> Politika për barazi gjinore dhe pagë të barabartë për punë me vlerë të barabartë ◀
<b>Trajnimi dhe zhvillimi i aftësive</b>	Politika për përmirësimin e aftësive dhe zhvillimin e karrierës për punonjësit
<b>Punësimi dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuara</b>	Politika për t'i bërë vendet e punës të arritshme për personat me aftësi të kufizuara
<b>Masat kundër dhunës dhe ngacmimit në vendin e punës</b>	Politika e tolerancës zero ndaj dhunës dhe ngacmimit në vendin e punës
<b>Diversiteti</b>	Politika për gjithëpërfshirje (domethënë, diversitet etnik ose grupe minoritare) dhe veprime pozitive.
<b>Puna e fëmijëve</b>	Politika për identifikimin e vendeve ku ndodh puna e fëmijëve, identifikimin e vendeve ku ndodh ekspozimi i punëtorëve të rinj ndaj punës së rrezikshme dhe parandalimin e rrezikut të ekspozimit
<b>Punë e detyruar</b>	Politika për identifikimin e vendeve ku ndodh puna e detyruar dhe zvogëlimin e rrezikut të punës së detyruar

▼C1

## Shtojca A.3. Kërkesat e Zbatimit për ESRS S1-4 Ndërmarrja e veprimeve mbi ndikimet materiale në fuqinë e vet punëtore, qasjet për menaxhimin e rreziqeve materiale dhe ndjekjen e mundësive materiale në lidhje me fuqinë e vet punëtore, dhe efektiviteti i këtyre veprimeve

▼B

Kjo shtojcë është një pjesë integrale e ESRS S1 *Fuqia e vet punëtore* dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të këtij Standardi. Ajo mbështet zbatimin e Kërkesës për dhënie informacion shpjegues ESRS S1-4 për çështjet sociale dhe të të drejtave të njeriut me shembuj të informacionit që jepet:

Çështje sociale dhe të të drejtave të njeriut	Shembuj të veprimeve
<b>Punësim i sigurt</b>	Ofroni kontrata të përhershme për punonjësit me kontrata të përkohshme, zbatoni plane për mbrojtje sociale aty ku mungon shërbimi shtetëror.
<b>Koha/Orari i punës</b>	Rotacioni i punës me turne, zgjatja e njoftimit paraprak të orareve, zvogëlimi i orëve të tepërta jashtë orarit
<b>Pagat e duhura</b>	Negocimi i pagave të drejta në marrëveshjet kolektive të punës, verifikimi që agjencitë e punësimit paguajnë një pagë të drejtë
<b>Dialogu social / ekzistenca e këshillave të punës / të drejtat e punëtorëve për informacion, konsultim dhe pjesëmarrje</b>	Zgjerimi i çështjeve të qëndrueshmërisë të trajtuara në dialogun social, rritja e numrit të takimeve, rritja e burimeve për këshillat e punës
<b>Liria e pjesëmarrjes në shoqata/negociata për marrëveshje kolektive, duke përfshirë shkallën e punonjësve të mbuluar nga marrëveshjet kolektive</b>	Zgjerimi i çështjeve të qëndrueshmërisë të trajtuara në negociatat kolektive, rritja e burimeve për përfaqësuesit e punëtorëve
<b>Ekulibri punë-jetë</b>	Zgjerimi i të drejtës për leje familjare dhe i mundësive për orar fleksibël pune, si dhe rritja e ofrimit të kujdesit ditor për fëmijë.

Çështje sociale dhe të të drejtave të njeriut	Shembuj të veprimeve
Shëndeti dhe siguria në punë	Rritja e trajnimeve për shëndetin dhe sigurinë, investime në pajisje më të sigurta
► C1 Barazia gjinore dhe paga e barabartë për punë me vlerë të barabartë ◀	Rekrutimi dhe promovimi i synuar i grave, zvogëlimi i hendekut në paga përmes negocimit të marrëveshjeve kolektive të punës.
Trajnimi dhe zhvillimi i aftësive	Auditime për vlerësimin e aftësive, trajnime për të plotësuar boshllëqet e aftësive
Punësimi dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuara	Rritja e masave të aksesueshmërisë për këtë kategori njerëzish
Masat kundër dhunës dhe ngacmimit në vendin e punës	Përmirësimi i mekanizmave të ankesave, rritja e sanksioneve kundër dhunës dhe ngacmimit, ofrimi i trajnimeve të drejtuesve për parandalim.
Diversiteti	Trajnim mbi diversitetin dhe përfshirjen (duke marrë në konsideratë etninë), rekrutim i synuar i grupeve të pa-përfaqësuara
Puna e fëmijëve	Masat e verifikimit të moshës, partneritetet me organizatat për të eliminuar punën e fëmijëve, masat kundër formave më të këqija të punës së fëmijëve
Punë e detyruar	Masat që sigurojnë pëlqimin e lirë për punësim pa kërcënim me penaltet, kontrata në gjuhë të kuptueshme, lirinë për të ndërprerë punësimin pa penalizim, masat disiplinore nuk duhet të detyrojnë punën, pëlqimin e lirë për orë shtesë, lirinë e lëvizjes (përfshirë daljen nga vendi i punës), trajtimin e drejtë për punëtorët migrantë, monitorimin nga agjencitë e punësimit.

## Shtojca A.4. Kërkesat për Zbatimin e ESRS S1–5: Objektivat që lidhen me menaxhimin e ndikimeve negative materiale, nxitjen e ndikimeve pozitive dhe menaxhimin e rreziqeve dhe mundësive materiale.

Kjo shtojcë është një pjesë integrale e ESRS S1 *Fuqia e vet punëtore* dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të këtij Standardi. Ajo mbështet zbatimin e Kërkesës për dhënie informacion shpjegues ESRS S1-5 për çështjet sociale dhe të të drejtave të njeriut me shembuj të informacionit që jepet:

<b>Çështje sociale dhe të të drejtave të njeriut</b>	<b>Shembuj të objektivave:</b>
<b>Punësim i sigurt</b>	Rritja e përqindjes së fuqisë punëtore me kontrata pune (veçanërisht kontrata të përhershme) dhe me mbrojtje sociale
<b>Koha/Orari i punës</b>	Rritja e përqindjes së fuqisë punëtore me orare pune fleksibël
<b>Pagat e duhura</b>	Sigurimi që të gjithë njerëzit në fuqinë punëtore të marrin një pagë të përshtatshme
<b>Dialogu social / ekzistenca e këshillave të punës / të drejtat e punëtorëve për informacion, konsultim dhe pjesëmarrje</b>	Zgjerimi i dialogut social në më shumë institucione dhe/ose vende
<b>Liria e pjesëmarrjes në shoqata/negociata për marrëveshje kolektive, duke përfshirë shkallën e punonjësve të mbuluar nga marrëveshjet kolektive</b>	Rritja e përqindjes së fuqisë punëtore të mbuluar nga marrëveshjet kolektive, marrëveshjeve të negociuara kolektive mbi çështjet e qëndrueshmërisë
<b>Ekulibri punë-jetë</b>	Zgjerimi i masave të marra për ekuilibrin punë dhe jetë në një përqindje më të madhe të fuqisë së vet punëtore
<b>Shëndeti dhe siguria në punë</b>	Ulja e shkallës së lëndimeve dhe kohës së humbur në punë për shkak të lëndimeve
<b>► C1 Barazia gjinore dhe paga e barabartë për punë me vlerë të barabartë ◀</b>	Rritja e përqindjes së grave në fuqinë punëtore dhe në menaxhimin e lartë, duke zvogëluar hendekun e pagave midis meshkujve dhe femrave

<b>Çështje sociale dhe të të drejtave të njeriut</b>	<b>Shembuj të objektivave:</b>
<b>Trajnimi dhe zhvillimi i aftësive</b>	Rritja e përqindjes së punonjësve që marrin trajnime dhe vlerësime të rregullta të zhvillimit të aftësive
<b>Punësimi dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuara</b>	Rritja e përqindjes së personave me aftësi të kufizuara në fuqinë e vet punëtore
<b>Masat kundër dhunës dhe ngacmimit në vendin e punës</b>	Zgjerimi i masave në të gjitha vendet e punës
<b>Diversiteti</b>	Rritja e përqindjes së grupeve të pak-përfaqësuara në fuqinë punëtore dhe drejtimin e lartë të vetë njësisë ekonomike
<b>Puna e fëmijëve</b>	Zgjerimi i masave për parandalimin e ekspozimit të rinjve ndaj punëve të rrezikshme në një përqindje më të madhe të aktiviteteve.
<b>Punë e detyruar</b>	Zgjerimi i masave për parandalimin e punës së detyruar në një numër më të madh aktivitetsesh

## **ESRS S2. PUNONJËSIT NË ZINXHIRIN E VLERËS**

### **Përmbajtja**

<b>Objektivi .....</b>	<b>302</b>
<b>Ndërveprimi me Standardet e tjera ESRS .....</b>	<b>303</b>
<b>Kërkesat për Dhënie Informacione Shpjeguese .....</b>	<b>304</b>
ESRS 2 Dhënie informacione shpjeguese të përgjithshme.....	304
Strategjia .....	304
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese në lidhje me ESRS 2 SBM-2 - Interesat dhe pikëpamjet e palëve të interesuara.....	304
Kërkesa për Informacione Shpjeguese në lidhje me ESRS 2 SBM -3 Ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit .....	304
Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë .....	306
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S2-1 – Politikat që lidhen me me punëtorët e zinxhirit të vlerës .....	306

Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S2-2 – Proceset për angazhimin me punonjësit e zinxhirit të vlerës në lidhje me ndikimet.....	308
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S2-3 – Procese për të ndrequr ndikimet negative dhe kanalet e komunikimit për punëtorët e zinxhirit të vlerës për të ngritur shqetësime.....	309
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S2-4 – Ndërmarrja e veprimeve mbi ndikimet materiale tek punëtorët e zinxhirit të vlerës, dhe qasjet për menaxhimin e rreziqeve materiale dhe ndjekjen e mundësive që lidhen me punëtorët e zinxhirit të vlerës, dhe efektiviteti i këtyre veprimeve.....	310
Metrikat dhe objektivat .....	312
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S2-5 – Objektivat që lidhen me menaxhimin e ndikimeve negative materiale, avancimin e ndikimeve pozitive dhe menaxhimin e rreziqeve dhe mundësive materiale.....	312
<b>Shtojca A. Kërkesat për Zbatim .....</b>	<b>313</b>
Objektivi.....	313
ESRS 2 Dhënie informacione shpjeguese të përgjithshme.....	314
Strategjia .....	314
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese në lidhje me ESRS 2 SBM-2 - Interesat dhe pikëpamjet e palëve të interesuara.....	314
Kërkesa për Informacione Shpjeguese në lidhje me standardin ESRS 2 SBM -3 - Ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit .....	314
Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë .....	315
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S2-1 – Politikat që lidhen me me punëtorët e zinxhirit të vlerës.....	315
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S2-2 – Proceset për angazhimin me punonjësit e zinxhirit të vlerës në lidhje me ndikimet.....	317
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S2-3 – Procese për të ndrequr ndikimet negative dhe kanalet e komunikimit për punëtorët e zinxhirit të vlerës për të ngritur shqetësime .....	318
▶ <b>C1</b> Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S2-4 – Ndërmarrja e veprimeve mbi ndikimet materiale tek punëtorët e zinxhirit të vlerës, dhe qasjet për menaxhimin e rreziqeve materiale dhe ndjekjen e mundësive që lidhen me punëtorët e zinxhirit të vlerës, dhe efektiviteti i këtyre veprimeve ◀ .....	319

Metrikat dhe objektivat .....322

Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S2-5 – Objektivat që lidhen me menaxhimin e ndikimeve negative materiale, avancimin e ndikimeve pozitive dhe menaxhimin e rreziqeve dhe mundësive materiale....322

## Objektivi

- Objektivi i këtij Standardi është të specifikojë kërkesat për dhënie informacione shpjeguese të cilat do t'u mundësojnë **përdoruesve** të **deklaratës së qëndrueshmërisë** për të kuptuar **ndikimet** materiale në punëtorët e **zinxhirit të vlerës** të lidhura me aktivitetet dhe zinxhirin e vlerës së vetë njësisë ekonomike, përmes produkteve ose shërbimeve të saj, si dhe përmes marrëdhënieve të saj të biznesit, dhe rreziqeve dhe mundësive materiale që lidhen me të, duke përfshirë:
  - si njësia ekonomike ndikon te punëtorët në zinxhirin e saj të vlerës, në aspektin e ndikimeve materiale pozitive dhe negative aktuale ose të mundshme;
  - çdo **veprim** të ndërmarra dhe rezultati i veprimeve të tilla, për të parandaluar, zbutur ose ndrequr ndikimet negative aktuale ose të pritshme, dhe për të adresuar rreziqet dhe mundësitë;
  - natyrën, llojin dhe shkallën e rreziqeve dhe mundësive materiale të njësisë ekonomike, duke përfshirë ato që lidhen me ndikimet dhe **varësitë** e saj mbi punëtorët në zinxhirin e vlerës dhe mënyrën se si njësia ekonomike i menaxhon ato; dhe
  - efektet financiare** mbi njësinë ekonomike, në planin afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të rreziqeve dhe mundësive materiale, duke përfshirë ato që rrjedhin nga ndikimet dhe varësitë e ndërmarrjes prej punëtorëve të zinxhirit të vlerës.
- Për të përmbushur objektivin, ky Standard kërkon një shpjegim të qasjes së përgjithshme që njësia ekonomike ndjek për të identifikuar dhe menaxhuar çdo **ndikim** material aktual dhe potencial në punëtorët e **zinxhirit të vlerës** në lidhje me:
  - kushtet e punës (për shembull, punësimi i sigurt, koha e pune, **paga e përshatshme**, **dialogu social**, liria e për t'u anëtarësuar në shoqata, duke përfshirë ekzistencën e këshillave të punës, **marrëveshjet kolektive**, **ekuilibrin midis punës dhe jetës** dhe shëndetin dhe sigurinë);
  - trajtimin e barabartë** dhe **mundësitë** për të gjithë (për shembull, barazia gjinore dhe paga e barabartë për punë me vlerë të barabartë, **trajnimi** dhe **zhvillimi** i aftësive, punësimi dhe përfshirja e **personave me aftësi të kufizuara**, masat kundër dhunës dhe **ngacmimit** në vendin e punës dhe diversiteti);

(c) të drejta të tjera që lidhen me punën (për shembull, puna e fëmijëve, punë e detyruar, strehim i përshtatshëm, ujë dhe kanalizime dhe privatësi).

3. Ky Standard kërkon gjithashtu një shpjegim se si ndikime të tilla, si dhe **varësitë** e njësisë ekonomike prej **punëtorëve të zinxhirit të vlerës**, mund të krijojnë rreziqe ose mundësi materiale për njësinë ekonomike. Për shembull, ndikimet negative mbi punëtorët e zinxhirit të vlerës mund të prishin aktivitetet e njësisë ekonomike (përmes klientëve që refuzojnë të blejnë produktet e saj ose agjencive shtetërore që sekuestrojnë mallrat e saj) dhe të dëmtojnë reputacionin e saj. Anasjelltas, respektimi i të drejtave të punëtorëve dhe programet aktive të mbështetjes (për shembull përmes iniciativave për njohuri financiare) mund të sjellin mundësi biznesi, të tilla si furnizim më i besueshëm ose zgjerimi i gamës së **konsumatorëve** të ardhshëm.
4. Ky Standard mbulon të gjithë punëtorët e njësisë ekonomike në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të vlerës** të cilët ndikohen ose mund të ndikohen materialisht nga njësia ekonomike, duke përfshirë ndikimet që lidhen me veprimtarinë dhe zinxhirin e vlerës së vetë njësisë ekonomike, përmes produkteve ose shërbimeve të saj, si dhe përmes marrëdhënieve të saj të biznesit. Kjo përfshin të gjithë punëtorët që nuk përfshihen në fushëveprimin e "**fuqisë së vet punëtore**" ("Fuqia punëtore e vet" përfshin **punonjësit**, kontraktorët individë, d.m.th., punëtorët e vetëpunësuar dhe punëtorët e ofruar nga njësi ekonomike të palëve të treta të angazhuara kryesisht në "aktivitete punësimi"). **Fuqia e vet punëtore** mbulohet në ESRS S1 *Fuqia e vet punëtore*. Shih AR 3 për shembuj të asaj që përfshihet në fushëveprimin e këtij Standardi.

## Ndërveprimi me Standardet e tjera ESRS

5. Ky Standard zbatohet kur **ndikimet** materiale dhe/ose **rreziqet** materiale dhe **mundësitë** lidhur me punëtorët e **zinxhirit të vlerës** janë identifikuar përmes procesit të vlerësimit të **materialitetit** siç përcaktohet në ESRS 2 *Dhënie informacione të përgjithshme*.
6. Ky Standard duhet të lexohet së bashku me ESRS 1 *Kërkesat e Përgjithshme* dhe ESRS 2, si dhe ESRS S1, ESRS S3 *Komunitetet e Prekura* dhe ESRS S4 *Konsumatorët dhe përdoruesit fundorë*.
7. Raportimi sipas këtij Standardi duhet të jetë konsistent, koherent dhe, kur është e nevojshme, i lidhur qartë me raportimin mbi **fuqinë punëtore të vetë** njësisë ekonomike. sipas ESRS S1, me qëllim sigurimin e raportimit efektiv.

# Kërkesat për Dhënie Informacione Shpjeguese

## ESRS 2 Dhënie informacione shpjeguese të përgjithshme

8. Kërkesat e këtij seksioni duhet të lexohen së bashku me informacionet shpjeguese të kërkuara nga ESRS 2 mbi Strategjinë (SBM). Informacionet e dhëna që rezultojnë duhet të paraqiten së bashku me informacionet e kërkuara nga ESRS 2, me përjashtim të SBM-3 *Ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale dhe ndërveprimin e tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit*, për të cilat njësi ekonomike ka një mundësi për të dhënë informacione shpjeguese së bashku me informacionin tematik.

## Strategjia

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese në lidhje me ESRS 2 SBM-2 - Interesat dhe pikëpamjet e palëve të interesuara*

9. Kur i përgjigjet ESRS 2 SBM-2 paragrafit 43, njësi ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese se si interesat, pikëpamjet dhe të drejtat e **punonjësve të saj të zinxhirit të vlerës** mund të ndikohen materialisht nga njësi ekonomike, duke përfshirë respektimin e të drejtave të tyre të njeriut, dhe japin informacion për strategjinë dhe modelin e saj të biznesit. Punëtorët e zinxhirit të vlerës janë një grup kyç i **palëve të interesuara** të prekura.

*Kërkesa për Informacione Shpjeguese në lidhje me ESRS 2 SBM -3 Ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit*

10. Kur njësi ekonomike i përgjigjet ESRS 2 SBM-3 paragrafi 48, ajo duhet të japë këto informacione:
  - (a) nëse dhe si ndikimet aktuale dhe të mundshme mbi **punëtorët e zinxhirit të vlerës**, siç identifikohen në ESRS 2 IRO-1 *Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale*: (i) burojnë nga ose janë të lidhura me strategjinë dhe modelet e biznesit të njësisë ekonomike, dhe (ii) japin informacion dhe kontribuojnë në përshtatjen e strategjisë dhe modelit të biznesit të njësisë ekonomike; dhe
  - (b) për marrëdhënien midis rreziqeve të saj materiale dhe mundësive që rrjedhin nga ndikimet dhe **varësitë** nga punëtorët në **zinxhirin e vlerës**, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër strategjisë dhe modelit të saj të biznesit.
11. Gjatë përmbushjes së kërkesave të paragrafit ESRS 2 SBM-3 paragrafi 48, njësi ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese nëse të gjithë **punonjësit e zinxhirit të vlerës** të cilët ka të ngjarë të ndikohen materialisht nga njësi ekonomike, duke përfshirë ndikimet që lidhen me aktivitetet dhe zinxhirin e vlerës së vetë njësisë ekonomike, përmes produkteve ose

shërbimeve të saj, si dhe përmes marrëdhënieve të saj të biznesit, përfshihen në fushëveprimin e informacionit të dhënë sipas ESRS 2. Përveç kësaj, njësia ekonomike duhet të ofrojë informacionin e mëposhtëm:

- (a) një përshkrim të shkurtër të llojeve të punonjësve të zinxhirit të vlerës që mund të ndikohen materialisht nga njësia ekonomike, duke përfshirë ndikimet që lidhen me aktivitetet dhe zinxhirin e vlerës së vetë njësisë ekonomike, duke përfshirë ato përmes produkteve ose shërbimeve të saj, si dhe përmes marrëdhënieve të saj të biznesit, dhe të specifikohen nëse ata janë:
- i. punëtorë që punojnë në **vendin** e njësisë ekonomike por që nuk janë pjesë e **fuqisë punëtore të vet**, d.m.th., që nuk janë punëtorë të vetëpunësuar ose punëtorë të ofruar nga njësi ekonomike të palëve të treta të angazhuara kryesisht në aktivitete punësimi (të mbuluara përmes ESRS S1);
  - ii. punëtorë që punojnë për subjektet në rrjedhën e sipërme të zinxhirit të vlerës së njësisë ekonomike (p.sh., ata që përfshihen në nxjerrjen e metaleve ose mineraleve ose korrjen e mallrave, në rafinim, prodhim ose forma të tjera të përpunimit);
  - iii. punëtorë që punojnë për subjektet në rrjedhën e poshtme të zinxhirit të vlerës së njësisë ekonomike (p.sh., ata të përfshirë në aktivitetet e ofruesve të logjistikës ose shpërndarjes, franchising-marrësve, shitësve me pakicë);
  - iv. punëtorë që punojnë në aktivitetet e një sipërmarrjeje të përbashkët ose në formë tjetër të ngjashme për qëllime të veçanta që përfshin sipërmarrjen raportuese;
  - v. punëtorë që (brenda kategorive të mëparshme ose shtesë) janë veçanërisht të prekshëm ndaj ndikimeve negative, qoftë për shkak të karakteristikave të tyre të lindura apo të kontekstit të veçantë, siç janë sindikalistët, punëtorët migrantë, punëtorët në shtëpi, gratë ose punëtorët e rinj.
- (b) çdo zonë gjeografike, në nivel vendi ose në nivele të tjera, ose mall për të cilin ekziston një rrezik i konsiderueshëm i **punës së fëmijëve** ose i **punës së detyruar**, brenda punëtorëve të zinxhirit të vlerës së njësisë ekonomike;<sup>113</sup>
- (c) në rastin e ndikimeve negative materiale, të specifikojë nëse ato janë (i) të përhapura gjerësisht apo sistemike në kontekstet ku njësia ekonomike kryen aktivitet ose ka marrëdhënie furnizimi ose **marrëdhënie të tjera biznesi**. (p.sh., **puna e fëmijëve** ose **puna e detyruar** në veçanti **zinxhirët e furnizimit** me mallra në vende ose rajone specifike), ose (ii) janë të lidhura me **incidente** individuale (p.sh., një aksident industrial ose një derdhje nafte) ose për marrëdhënie specifike biznesi. Kjo përfshin shqyrtimin e ndikimeve tek **punëtorët e zinxhirit të vlerës** që mund të lindin nga kalimi në operacione më të gjelbra dhe neutrale për klimën. Ndikimet e mundshme përfshijnë ndikimet që lidhen me

---

<sup>113</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga tregues shtesë që lidhen me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohen nga treguesit numër 12 dhe numër 13 në Tabelën III të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacionit shpjegues mbi investimet e qëndrueshme ("Aktivitetet dhe furnizuesit në rrezik të konsiderueshëm të incidenteve të punës së fëmijëve" dhe "Aktivitetet dhe furnizuesit në rrezik të konsiderueshëm të incidenteve të punës së detyruar ose të detyruar")

inovacionin dhe ristrukturimin, mbylljen e minierave, rritjen e nxjerrjes së mineraleve të nevojshme për kalimin në një ekonomi të qëndrueshme dhe prodhimin e paneleve diellore;

- (d) në rastin e ndikimeve pozitive materiale, një përshkrim të shkurtër të aktiviteteve që sjellin ndikime pozitive (p.sh., praktikat e përditësuara të blerjes, ndërtimi i kapaciteteve për punonjësit e zinxhirit të furnizimit), duke përfshirë ofrimin e mundësive për fuqinë punëtore, siç është krijimi i vendeve të punës dhe përmirësimi i aftësive në kontekstin e një "tranzicioni të drejtë", dhe llojet e punonjësve të zinxhirit të vlerës që preken pozitivisht ose mund të preken pozitivisht; njësia ekonomike gjithashtu mund të japë informacion nëse ndikimet pozitive ndodhin në vende ose rajone specifike; dhe
- (e) çdo rrezik dhe mundësi materiale për njësinë ekonomike që rrjedh nga ndikimet dhe **varësia** nga punëtorët e zinxhirit të vlerës.

12. Në përshkrimin e llojeve kryesore të **punëtorëve të zinxhirit të vlerës** të cilët janë ose mund të preken negativisht, bazuar në vlerësimin e **materialitetit** të përcaktuar në ESRS 2 IRO-1, njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese nëse dhe si ka zhvilluar një kuptim se si punëtorët me karakteristika të veçanta, ata që punojnë në kontekste të veçanta ose ata që ndërmarrin aktivitete të veçanta mund të jenë në rrezik më të madh dëmi.
13. Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese se cilat, nëse ka, nga **rreziqet** e saj materiale dhe **mundësitë** që rrjedhin nga **ndikimet** dhe **varësitë** prej **punëtorëve të zinxhirit të vlerës** së saj lidhen me grupe specifike të punëtorëve të zinxhirit të vlerës (për shembull, me grupe të caktuara moshe, punëtorë në një fabrikë ose vend të caktuar) dhe jo me të gjithë punëtorëve të zinxhirit të vlerës.

## Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë

### *Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S2-1 – Politikat që lidhen me me punëtorët e zinxhirit të vlerës*

14. Njësia ekonomike duhet të përshkruajë politikat e saj të miratuara për të menaxhuar ndikimet e saj materiale tek punëtorët e zinxhirit të vlerës, si dhe rreziqet dhe mundësitë materiale që lidhen me to.
15. Objektivi i kësaj Kërkesë për dhënie informacione shpjeguese është të mundësojë një kuptim të masës në të cilën njësia ekonomike ka **politika** që trajtojnë identifikimin, vlerësimin, menaxhimin dhe/ose **ndreqjen** e **ndikimeve** materiale në **punëtorët e zinxhirit të vlerës** konkretisht, si dhe politika që mbulojnë **rreziqet** materiale ose **mundësi** që lidhen me punëtorët e zinxhirit të vlerës.
16. Informacioni i kërkuar nga paragrafi 14 duhet të përmbajë shpjegime mbi politikat e njësisë ekonomike për të menaxhuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë e saj materiale që lidhen me

***punëtorët e zinxhirit të vlerës*** në përputhje me ESRS 2 MDR -P *Politikat e miratuara për të menaxhuar çështjet e qëndrueshmërisë materiale*. Përveç kësaj, njësia ekonomike duhet të specifikojë nëse politika të tilla mbulojnë grupe specifike të ***punonjësve të zinxhirit të vlerës*** ose të gjithë punëtorët e zinxhirit të vlerës.

17. Njësia ekonomike duhet të përshkruajë angazhimet në ***politikën*** e saj të të drejtave të njeriut<sup>114</sup> që janë të rëndësishme për ***punonjësit e zinxhirit të vlerës***, duke përfshirë ato procese dhe mekanizma për të monitoruar pajtueshmërinë me Parimet Udhëzuese të OKB-së mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut, Deklaratën e ILO-s mbi Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë dhe Udhëzimet e OECD-së për Ndërmarrjet Shumëkombëshe.<sup>115</sup> Në informacionin e dhënë prej saj, ajo do të përqendrohet në ato çështje që janë materiale në lidhje me sa më poshtë, si dhe qasjen e saj të përgjithshme ndaj:
- (a) respektimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e punës së punëtorëve;
  - (b) angazhimit me punonjësit e zinxhirit të vlerës; dhe
  - (c) masave për të siguruar dhe/ose mundësuar ***zgjidhje*** për çështjet me ndikim në të drejtat e njeriut.
18. Njësia ekonomike duhet të deklarojë nëse politikat e saj në lidhje me ***punëtorët e zinxhirit të vlerës*** trajtojnë në mënyrë të qartë trafikimin e qenieve njerëzore,<sup>116</sup> ***punën e detyruar*** dhe ***punën e fëmijëve***. Gjithashtu duhet të deklarojë nëse njësia ekonomike ka një kod të sjelljes me ***furnitorët***.<sup>117</sup>
19. Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese nëse dhe si politikat e saj në lidhje me ***punëtorët e zinxhirit të vlerës*** janë në përputhje me instrumentet e njohura ndërkombëtarisht që lidhen me punëtorët e zinxhirit të vlerës, duke përfshirë Parimet Udhëzuese të Kombeve të Bashkuara (OKB) mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut.<sup>118</sup> Njësia ekonomike duhet gjithashtu të japë informacione shpjeguese për shkallën në të cilën rastet e mosrespektimit të Parimeve Udhëzuese të OKB-së mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut,

---

<sup>114</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues shtesë që lidhet me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohet nga treguesi #9 në Tabelën III të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e rregullat e dhënies së informacionit shpjegues mbi investimet e qëndrueshme ("Mungesa e një politike për të drejtat e njeriut").

<sup>115</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues i detyrueshëm që lidhet me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohet nga treguesi #11 në Tabelën I të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat për dhënie informacione shpjeguese mbi investimet e qëndrueshme ('Mungesa e proceseve dhe mekanizmave të pajtueshmërisë për të monitoruar pajtueshmërinë me parimet e Kompaktit Global të OKB-së dhe Udhëzimet e OECD-së për Shoqëritë Shumëkombëshe').

<sup>116</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues shtesë që lidhet me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohet nga treguesi #11 në Tabelën III të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacionit shpjegues mbi investimet e qëndrueshme ("Mungesa e proceseve dhe masave për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore").

<sup>117</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues shtesë që lidhet me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohet nga treguesi #4 në Tabelën III të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e rregullat e dhënies së informacionit shpjegues mbi investimet e qëndrueshme ("Mungesa e një kodi sjellje me furnitorët").

<sup>118</sup> Ky informacion mbështet nevojat e administratorëve të standardeve referuese për të shtjelluar informacionin shpjegues mbi faktorët ESG që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2020/1816, siç përcaktohet nga treguesi "Ekspozimi i portofolit të standardeve referuese ndaj kompanive pa politika të kujdesit të duhur mbi çështjet e trajtuara nga Konventat themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës 1 deri në 8" në seksionin 1 dhe 2 të Shtojcës II.

Deklaratës së ILO-s mbi Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë ose Udhëzimeve të OECD-së për Ndërmarrjet Shumëkombëshe që përfshijnë punëtorë të zinxhirit të vlerës janë raportuar në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të saj të vlerës dhe, nëse është e zbatueshme, një tregues të natyrës së rasteve të tilla.<sup>119</sup>

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S2-2 – Proceset për angazhimin me punonjësit e zinxhirit të vlerës në lidhje me ndikimet*

20. Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese për proceset e saj të përgjithshme për angazhimin me punëtorët e zinxhirit të vlerës dhe përfaqësuesit e tyre në lidhje me ndikimet aktuale dhe të mundshme mbi ta.
21. Objektivi i kësaj Kërkesë për dhënie informacione shpjeguese është të mundësojë një kuptim nëse dhe si njësia ekonomike angazhohet, si pjesë e procesit të saj të vazhdueshëm të kujdesit të duhur, me ***punonjësit e zinxhirit të vlerës*** dhe përfaqësuesve të tyre legjitimë, ose me ***përfaqësues të besueshëm***, rreth ndikimeve materiale pozitive dhe/ose negative aktuale dhe të mundshme që i prekin ose ka të ngjarë t'i prekin ata, dhe si merren parasysh perspektivat e punëtorëve të zinxhirit të vlerës në proceset e vendimmarrjes së njësisë ekonomike.
22. Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese nëse dhe si perspektivat e ***punëtorëve të zinxhirit të vlerës*** ndikojnë në vendimet ose aktivitetet e saj që synojnë menaxhimin e ndikimeve aktuale dhe të mundshme tek punëtorët e zinxhirit të vlerës. Kjo do të përfshijë, kur është e nevojshme, një shpjegim:
  - (a) nëse angazhimi ndodh me punëtorët e zinxhirit të vlerës ose me ***përfaqësuesit e tyre legjitimë*** drejtpërdrejt, ose me ***përfaqësues të besueshëm*** që kanë njohuri për situatën e tyre;
  - (b) të fazës(ve) në të cilën ndodh angazhimi, lloji i angazhimit dhe frekuenca e angazhimit;
  - (c) të funksionit dhe rolit më të lartë brenda njësisë ekonomike që ka përgjegjësinë operative për të siguruar që ky angazhim të ndodhë dhe që rezultatet të japin informacion në qasjen e njësisë ekonomike;
  - (d) aty ku është e aplikueshme, për Marrëveshjet Kornizë Globale ose për marrëveshjet që njësia ekonomike ka me federatat sindikale globale në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut të punëtorëve në zinxhirin e vlerës, duke përfshirë të drejtën e tyre për të negociuar kolektivisht, dhe duke përfshirë një shpjegim se si marrëveshja i mundëson njësisë ekonomike të fitojë njohuri mbi perspektivat e këtyre punëtorëve; dhe

---

<sup>119</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion: të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues i detyrueshëm që lidhet me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohet nga treguesi #10 në Tabelën I të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacionit shpjegues mbi investimet e qëndrueshme; dhe administratorët e standardeve më të mira për dhënie informacioni shpjegues lidhur me faktorët ESG që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2020/1816 siç përcaktohet nga treguesit "Numri i përbërësve të standardeve më të mira objekt i shkeljeve sociale (numri absolut dhe relativ i ndarë me të gjithë përbërësit e standardeve), siç referohet në traktatet dhe konventat ndërkombëtare, në parimet e Kombeve të Bashkuara dhe, nëse është e zbatueshme në ligjin kombëtar" dhe "Ekspozimi i portofolit të standardeve më të mira për shoqëritë pa politika të kujdesit të duhur për çështjet e trajtuara nga Konventat themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës 1 deri në 8' në seksionin 1 dhe 2 të Aneksit II.

(e) aty ku është e aplikueshme, si e vlerëson njësia ekonomike efektivitetin e angazhimit të saj me punëtorët në zinxhirin e vlerës, duke përfshirë, aty ku është e rëndësishme, çdo marrëveshje ose rezultat që rezulton.

23. Kur është e zbatueshme, njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese hapat që ndërmerr për të kuptuar perspektivat e punëtorëve që mund të jenë veçanërisht të prekshëm ndaj ndikimeve dhe/ose të marginalizuar (për shembull, punëtorët gra, punëtorët migrantë, punëtorët me aftësi të kufizuara).
24. Nëse njësia ekonomike nuk mund të japë informacione shpjeguese të sa kërkuar më sipër, sepse nuk ka miratuar një proces të përgjithshëm për t'u angazhuar me punëtorët në zinxhirin e vlerës, ajo duhet ta bëjë të ditur këtë fakt. Ajo mund të japë informacion për një afat kohor brenda të cilit synon ta realizojë një proces të tillë.

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S2-3 – Procese për të ndrequr ndikimet negative dhe kanalet e komunikimit për punëtorët e zinxhirit të vlerës për të ngritur shqetësime*

25. Njësia ekonomike duhet të përshkruajë proceset që ka në vend për të siguruar ose bashkëpunuar në ndreqjen e ndikimeve negative tek punonjësit e zinxhirit të vlerës me të cilët është e lidhur njësia ekonomike, si dhe kanalet në dispozicion të punonjësve të zinxhirit të vlerës për të ngritur shqetësime dhe për t'i adresuar ato.
26. Objektivi i kësaj Kërkesë për dhënie informacione shpjeguese është të mundësojë një kuptim të mjeteve formale me anë të të cilave **punëtorët e zinxhirit të vlerës** mund t'ia bëjnë të ditura shqetësimet dhe nevojat e tyre drejtpërdrejt njësisë ekonomike dhe/ose përmes të cilave njësia ekonomike mbështet disponueshmërinë e kanaleve të tilla (për shembull, **mekanizmat e ankesave**) në vendin e punës të punonjësve të zinxhirit të vlerës, si kryhet ndjekja e këtyre punonjësve në lidhje me çështjet e ngritura dhe efektivitetin e këtyre kanaleve.
27. Njësia ekonomike duhet të përshkruajë:
- (a) qasjen e saj të përgjithshme dhe proceset për zgjidhjen ose kontributin në **zgjidhjen** e problemeve që kanë shkaktuar ose kontribuar në një ndikim negativ material tek **punëtorët e zinxhirit të vlerës**, duke përfshirë nëse njësia ekonomike vlerëson dhe si e vlerëson se zgjidhja e ofruar është efektive;
- (b) çdo kanal specifik që ka në dispozicion për punëtorët e zinxhirit të vlerës për të ngritur shqetësimet ose të paraqesin nevojat e tyre drejtpërdrejt me njësinë ekonomike dhe për t'i adresuar ato, duke përfshirë nëse këto janë përcaktuar nga vetë njësia ekonomike dhe/ose nëse ato janë mekanizma të palëve të treta;
- (c) proceset përmes të cilave mbështet ose kërkon disponueshmërinë e kanaleve të tilla në vendin e punës të punonjësve të zinxhirit të vlerës; dhe

(d) si i gjurmon dhe monitoron çështjet e ngritura dhe të trajtuara, dhe si siguron efektivitetin e kanaleve, duke konsideruar edhe përfshirjen e **palëve të interesuara** të cilët janë **përdoruesit** e synuar.

28. Njësia ekonomike duhet të japë informacion nëse vlerëson dhe si vlerëson që **punonjësit e zinxhirit të vlerës** janë në dijeni të këtyre strukturave ose proceseve dhe u besojnë atyre si një mënyrë për të ngritur shqetësimet ose nevojat e tyre dhe për t'i adresuar ato. Përveç kësaj, njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese nëse ka politika në vend kundër hakmarrjes në lidhje me mbrojtjen e individëve që i përdorin ato. Nëse një informacion i tillë është dhënë në përputhje me ESRS G1-1, njësia ekonomike mund t'i referohet atij informacioni.
29. Nëse njësia ekonomike nuk mund të japë informacione shpjeguese që kërkohen më sipër, sepse nuk ka miratuar një kanal për të ngritur shqetësime dhe/ose nuk mbështet disponueshmërinë e një kanali të tillë në vendin e punës të **punonjësve të zinxhirit të vlerës**, ajo duhet ta paraqesë këtë rast. Ajo mund të japë informacion shpjegues për një afat kohor brenda të cilit synon të ketë në vend një kanal ose procese të tilla.

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S2-4 – Ndërmarrja e veprimeve mbi ndikimet materiale tek punëtorët e zinxhirit të vlerës, dhe qasjet për menaxhimin e rreziqeve materiale dhe ndjekjen e mundësive që lidhen me punëtorët e zinxhirit të vlerës, dhe efektiviteti i këtyre veprimeve*

30. Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese se si ndërmerr veprime për të adresuar ndikimet materiale tek punonjësit e zinxhirit të vlerës, si dhe për të menaxhuar rreziqet materiale dhe për të ndjekur mundësitë që lidhen me punonjësit e zinxhirit të vlerës dhe efektivitetin e këtyre veprimeve.
31. Objektivi i kësaj kërkesë për informacione shpjeguese është i dyfishtë. Së pari, për të mundësuar kuptimin e çdo veprimi ose iniciative përmes së cilës njësia ekonomike synon:
- (a) të parandalojë, zbusë dhe **ndreqë ndikimet** negative materiale mbi **punëtorët e zinxhirit të vlerës**; dhe/ose
- (b) për të arritur ndikime pozitive materiale për punëtorët e zinxhirit të vlerës.

Së dyti, është për të mundësuar një kuptim të mënyrave se si njësia ekonomike po adreson **rreziqet** materiale dhe është duke ndjekur **mundësitë** lidhur me **punonjësit në zinxhirin e vlerës**.

Njësia ekonomike duhet të ofrojë një përshkrim të përmblëdhur të planeve të veprimit dhe burimeve për të menaxhuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë e saj materiale që lidhen me **punëtorët e zinxhirit të vlerës** sipas ESRS 2 MDR -A *Veprime dhe burime në lidhje me çështjet e qëndrueshmërisë materiale*.

32. Në lidhje me **ndikimet** materiale, njësia ekonomike duhet të përshkruajë:

- (a) veprimet e ndërmarra, të planifikuara ose në proces për të parandaluar ose zbutur ndikimet negative materiale mbi **punëtorët e zinxhirit të vlerës**;
  - (b) nëse ka ndërmarrë dhe si ka ndërmarrë veprime për të siguruar ose mundësuar **zgjdhjen** në lidhje me një ndikim real;
  - (c) çdo **veprim** ose iniciativë shtesë që ka në zbatim me qëllimin kryesor ofrimin e ndikimeve pozitive për punëtorët e zinxhirit të vlerës; dhe
  - (d) si gjurmon dhe vlerëson efektivitetin e **veprimeve** të tilla dhe iniciativa në ofrimin e rezultateve të synuara për punëtorët e zinxhirit të vlerës.
33. Në lidhje me paragrafin 30, njësia ekonomike duhet të përshkruajë:
- (a) proceset përmes të cilave identifikohet se çfarë veprimi është i nevojshëm dhe i përshtatshëm në përgjigje të një ndikimi të veçantë negativ aktual ose të pritshëm mbi **punëtorët e zinxhirit të vlerës**;
  - (b) qasjen e saj për të ndërmarrë veprime në lidhje me ndikimet negative specifike materiale mbi punonjësit e zinxhirit të vlerës, duke përfshirë çdo veprim në lidhje me blerjet e veta ose praktikrat e tjera të brendshme, si dhe ndërtimin e kapaciteteve ose forma të tjera të angazhimit me subjektet në zinxhirin e vlerës, ose format e veprimeve bashkëpunuese me kolegët e industrisë ose palët e tjera përkatëse; dhe
  - (c) si siguron që proceset për të ofruar ose mundësuar **zgjdhjen** në rast të ndikimeve negative materiale, janë të disponueshme dhe efektive në zbatimin dhe rezultatet e tyre.
34. Në lidhje me rreziqet materiale dhe mundësitë, njësia ekonomike duhet të përshkruajë:
- (a) çfarë veprimi është planifikuar ose është duke u ndërmarrë për të zbutur rreziqet materiale për njësinë ekonomike që rrjedhin nga ndikimet dhe **varësitë** e saj nga **punëtorët e zinxhirit të vlerës** dhe si e gjurmon efektivitetin në praktikë; dhe
  - (b) çfarë veprimi është planifikuar ose është duke u ndërmarrë për të ndjekur mundësitë materiale për njësinë ekonomike në lidhje me punëtorët e zinxhirit të vlerës.
35. Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese nëse dhe si ndërmerr veprime për të shmangur shkaktimin ose kontributin në ndikime negative materiale tek punëtorët e **zinxhirit të vlerës** përmes praktikave të veta, duke përfshirë, kur është e rëndësishme, në lidhje me prokurimin, shitjet dhe përdorimin e të dhënave. Kjo mund të përfshijë dhënien e informacioneve shpjeguese rreth qasjes që ndiqet kur lindin tensione midis parandalimit ose zbutjes së ndikimeve negative materiale dhe presioneve të tjera të biznesit.
36. Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese gjithashtu nëse çështje dhe **incidente** të rënda të të drejtave të njeriut i lidhur me rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të

**zinxhirit të vlerës** janë raportuar dhe, nëse është e zbatueshme, jepni shënime shpjeguese për këto.<sup>120</sup>

37. Kur njësia ekonomike paraqet informacion shpjegues të kërkuar sipas paragrafit 32 (c), ajo duhet të marrë në konsideratë ESRS 2 (shih ESRS 2 MDR -T Ndjekja e efektivitetit të politikave dhe **veprimeve** përmes **objektivave**) nëse vlerëson efektivitetin e një veprimi duke vendosur një objektiv.
38. Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese se cilat burime janë përcaktuar për menaxhimin e ndikimeve të saj materiale, së bashku me informacionin që u mundëson **përdoruesve** për të kuptuar se si menaxhohen ndikimet materiale.

## Metrikat dhe objektivat

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S2-5 – Objektivat që lidhen me menaxhimin e ndikimeve negative materiale, avancimin e ndikimeve pozitive dhe menaxhimin e rreziqeve dhe mundësive materiale*

39. **Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për objektivat e përcaktuara në kohë dhe të orientuara drejt rezultateve që mund të ketë vendosur në lidhje me:**
  - (a) **zvogëlimin e ndikimeve negative tek punëtorët e zinxhirit të vlerës; dhe/ose**
  - (b) **avancimin e ndikimeve pozitive tek punëtorët e zinxhirit të vlerës; dhe/ose**
  - (c) **menaxhimin e rreziqeve dhe mundësive materiale që lidhen me punëtorët e zinxhirit të vlerës.**
40. Objektivi i kësaj Kërkesë për dhënie informacione shpjeguese është të mundësojë një kuptim të masës në të cilën njësia ekonomike po përdor **objektiva** të kufizuara në kohë dhe të orientuara drejt rezultateve për të nxitur dhe matur progresin e saj në adresimin e ndikimeve negative materiale dhe/ose avancimin e ndikimeve pozitive në punëtorët e **zinxhirit të vlerës**, dhe/ose në menaxhimin e rreziqeve dhe mundësive materiale që lidhen me punëtorët e zinxhirit të vlerës.
41. Përshkrimi i përmbledhur i **objektivave** për të menaxhuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë e saj materiale që lidhen me **punëtorët e zinxhirit të vlerës** duhet të përmbajë kërkesat e informacionit të përcaktuara në ESRS 2 MDR -T.
42. Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese procesin për përcaktimin e **objektivave**, duke përfshirë nëse dhe si njësia ekonomike është angazhuar drejtpërdrejt me

---

<sup>120</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues shtesë që lidhet me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohet nga treguesi #14 në Tabelën III të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e rregullat e dhënies së informacionit shpjegues mbi investimet e qëndrueshme ("Numri i rasteve të identifikuara të çështjeve dhe incidenteve të rënda të drejtave të njeriut").

punëtorët në zinxhirin e vlerës, me përfaqësuesit e tyre legjitimë ose me **përfaqësues të besueshëm** që kanë njohuri për situatën e tyre në:

- (a) vendosjen e çdo objekti të tillë;
- (b) ndjekjen e performancës së njësisë ekonomike kundrejt tyre; dhe
- (c) identifikimin e çdo mësimi ose përmirësimi si rezultat i performancës së njësisë ekonomike.

## Shtojca A. Kërkesat për Zbatim

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e ESRS S2 *Punonjësit në zinxhirin e vlerës*. Ajo mbështet zbatimin e kërkesave për informacion shpjegues të përcaktuara në këtë standard dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të ESRS S2.

### Objektivi

- AR 1. Përveç çështjeve të listuara në paragrafin 2, njësia ekonomike mund të marrë në konsideratë edhe dhënien e informacionit rreth çështjeve të tjera që lidhen me një ndikim material për një periudhë më të shkurtër kohore, për shembull iniciativat në lidhje me shëndetin dhe sigurinë e **punëtorëve të zinxhirit të vlerës** gjatë një pandemie.
- AR 2. Përmbledhja e çështjeve sociale dhe të të drejtave të njeriut e dhënë në paragrafin 2 nuk ka për qëllim të nënkuptojë që për të gjitha këto çështje duhet të jepet informacion shpjegues në secilën Kërkesë për dhënie informacione shpjeguese në këtë Standard. Përkundrazi, ajo ofron një listë çështjesh që njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë në vlerësimin e **materialitetit** të tyre (ref. te ESRS 1 kapitulli 3 *Materialiteti i dyfishtë si bazë për dhënie informacione shpjeguese të qëndrueshmërisë* dhe ESRS 2 IRO-1) në lidhje me **punëtorët e zinxhirit të vlerës** dhe, sipas rastit, të japë informacione shpjeguese si të ishin ndikime, rreziqe dhe mundësi materiale brenda fushëveprimit të këtij Standardi.
- AR 3. Shembuj të personave që përfshihen brenda fushëveprimit të këtij Standardi janë:
  - (a) punëtorët e shërbimeve të kontraktuara jashtë kompanisë që punojnë në vendin e punës së njësisë ekonomike (p.sh., punëtorët e shërbimit të ushqimit ose të sigurisë të palëve të treta);
  - (b) punëtorët e një **furnizuesi** të kontraktuara nga njësia ekonomike që punon në ambientet e furnizuesit duke përdorur metodat e punës së furnizuesit;
  - (c) punëtorë për një njësi tjetër ekonomike "në rrjedhën e poshtme" e cila blen mallra ose shërbime nga njësia ekonomike raportuese;
  - (d) punëtorët e një furnizuesi pajisjesh për njësinë ekonomike të cilët, në një vend pune të kontrolluar nga njësia ekonomike, kryejnë mirëmbajtje të rregullt të pajisjeve të

furnizuesit (p.sh., pajisjen e fotokopjes) siç përcaktohet në kontratën midis furnizuesit të pajisjeve dhe njësisë ekonomike; dhe

(e) punëtorët më në thellësi të **zinxhirit të furnizimit** të cilët nxjerrin mallra të cilat më pas përpunohen në përbërës që hyjnë në produktet e njësisë ekonomike.

## ESRS 2 Dhënie informacione shpjeguese të përgjithshme

### *Strategjia*

#### Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese në lidhje me ESRS 2 SBM-2 - Interesat dhe pikëpamjet e palëve të interesuara

- AR 4. Kërkesat për Dhënie Informacione Shpjeguese ESRS 2 SBM-2 kërkon që njësia ekonomike të ofrojë një kuptueshmëri nëse dhe si e konsideron rolin që strategjia dhe **modeli i saj i biznesit** mund të luajë rol në krijimin, përkeqësimin ose zbutjen e **ndikimeve** të rëndësishme materiale mbi punëtorët **e zinxhirit të vlerës**, dhe nëse po, si modeli dhe strategjia e biznesit përshtaten për të adresuar ndikime të tilla materiale.
- AR 5. Ndërsa punëtorët **e zinxhirit të vlerës** mund të mos jenë duke u angazhuar me njësinë ekonomike në nivelin e strategjisë ose modelit të saj të biznesit, pikëpamjet e tyre mund të ndikojnë në vlerësimin e njësisë ekonomike për strategjinë dhe modelin e saj të biznesit. Njësia ekonomike mund të japë informacione shpjeguese për pikëpamjet e punëtorëve të zinxhirit të vlerës dhe përfaqësuesve të punëtorëve të zinxhirit të vlerës.

#### Kërkesa për Informacione Shpjeguese në lidhje me standardin ESRS 2 SBM -3 - Ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit

- AR 6. **Ndikimet** mbi punëtorët **e zinxhirit të vlerës** të njësisë ekonomike mund të burojnë nga strategjia ose **modeli i saj i biznesit** në mënyra të ndryshme. Për shembull, ndikimet mund të lidhen me propozimin e vlerave të njësisë ekonomike (siç është ofrimi i produkteve ose shërbimeve me koston më të ulët, ose ofrimi me shpejtësi të lartë, në mënyra që ushtrojnë presion mbi të drejtat e punës në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirëve e vlerës), me **zinxhirin e saj të vlerës** (siç është mbështetja në mallra me origjinë të paqartë, mungesë transparence në ndikimet e punëtorëve), ose strukturat e saj të kostos dhe modelit të të ardhurave (p.sh. zhvendosja e rrezikut të inventarit të furnizuesit, me efekte anësore në të drejtat e punës së punëtorëve të tyre).
- AR 7. Ndikimet tek **punëtorët e zinxhirit të vlerës** të njësisë ekonomike që burojnë nga strategjia ose **modeli i biznesit** mund të sjellin edhe **rreziqe** materiale për njësinë ekonomike. Për shembull, në kontekstin e një pandemie ose krize tjetër të rëndë shëndetësore, njësitë ekonomike që mbështeten në punë të kushtëzuar me pak ose aspak qasje në kujdesin ndaj të sëmurëve dhe përfitimeve shëndetësore mund të përballen me rreziqe të rënda operative dhe

të vazhdimësisë së biznesit, pasi punëtorët nuk kanë zgjidhje tjetër veçse të vazhdojnë të punojnë ndërsa janë të sëmurë, duke përkeqësuar më tej përhapjen e sëmundjes dhe duke shkaktuar probleme të mëdha në prishjen e **zinxhirit të furnizimit**. Një shembull tjetër është kur shitja e mallrave bazuar në çmimet më të lira për klientët krijon rreziqe operationale pasi **furnizuesit** nën presion ekstrem të çmimeve mund të nënkontraktjnë prodhimin, duke çuar në cilësi më të ulët dhe një zinxhir furnizimi më të gjatë, më pak transparent dhe më pak të kontrollueshëm. Rreziqet e reputacionit dhe të mundësive të biznesit të lidhura me shfrytëzimin e punëtorëve me kualifikime të ulëta dhe paga të ulëta në vendet e furnizimit me mbrojtje minimale për ta, po rriten bashkë me reagimin e ashpër të medias dhe preferencat e **konsumatorëve** që kalojnë drejt mallrave që vijnë nga burime më etike ose më të qëndrueshme.

- AR 8. Shembuj të karakteristikave të veçanta të **punëtorëve të zinxhirit të vlerës** që mund të merren në konsideratë nga njësia ekonomike kur i përgjigjen paragrafit 12 lidhen me punëtorët e rinj që mund të jenë më të ndjeshëm ndaj **ndikimeve** mbi zhvillimin e tyre fizik dhe mendor, ose punëtorët gra në një kontekst ku gratë diskriminohen rregullisht në kushtet dhe afatet e punës, ose punëtorët migrante në një kontekst ku tregu për furnizimin me punë është i rregulluar dobët dhe punëtorëve u ngarkohen rregullisht tarifa rekrutimi. Për disa punëtorë, natyra e zakonshme e aktivitetit që ata duhet të ndërmarrin mund t'i vërë ata në rrezik (p.sh., punëtorët që duhet të merren me kimikate ose të operojnë pajisje të caktuara ose punëtorët me pagë të ulët që janë me kontrata "zero orë pune të garantuara").
- AR 9. Lidhur me paragrafin 13, rreziqet materiale mund të lindin edhe për shkak të varësisë së njësisë ekonomike nga **punëtorët e zinxhirit të vlerës** ku ngjarjet me probabilitet të ulët, por me ndikim të lartë, mund të shkaktojnë **efekte financiare**; për shembull, kur një pandemi globale çon në ndikime të rënda shëndetësore tek punëtorët në të gjitha fazat e zinxhirit të vlerës, duke rezultuar në ndërprerje të mëdha të prodhimit dhe shpërndarjes. Shembuj të tjerë të rrezikut që lidhen me varësinë e njësisë ekonomike nga punëtorët e zinxhirit të vlerës përfshijnë mungesën e punëtorëve të kualifikuar ose vendimet politike ose legjislatonin që prek punëtorët e zinxhirit të vlerës që punojnë për ofruesit e logjistikës. Për shembull, nëse disa punëtorë në zinxhirin e vlerës së njësisë ekonomike janë të rrezikuar nga **puna e detyruar** dhe njësia ekonomike po eksporton produkte në vendet ku ligji lejon konfiskimin e mallrave të importuara që dyshohet se janë bërë me punë të detyruar.

#### *Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë*

#### Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S2-1 – Politikat që lidhen me me punëtorët e zinxhirit të vlerës

- AR 10. Nëse politikat janë të kufizuara në **fuqinë punëtore të vetë** njësisë ekonomike dhe nuk mbulojnë punëtorët në entitetet dhe marrëdhëniet e rrjedhës së sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës, për ato duhet të jepet informacion shpjegues sipas ESRS S1 dhe jo sipas kërkesë.

- AR 11. Nëse informacionet e dhëna sipas ESRS S1 përfshijnë informacione që kanë lidhje me punëtorët në zinxhirin e vlerës, këtu mund të bëhet një referencë për këtë; informacionet për elementët e mbetur do të jepen më pas sipas kësaj Kërkesë për dhënie informacione shpjeguese.
- AR 12. Njësia ekonomike mund të japë informacione shpjeguese për ndryshime të rëndësishme në politikat e miratuara gjatë vitit raportues (p.sh., pritje të reja për **furnizuesit**, qasje të reja ose shtesë ndaj kujdesit të duhur dhe për ndreqen e pasojave).
- AR 13. **Politika** mund të marrë formën e një politike të pavarur në lidhje me **zinxhirin e vlerës** punëtorëve ose të përfshihet në një dokument më të gjerë, siç është një kod etik ose një politikë e përgjithshme e qëndrueshmërisë që është paraqitur tashmë nga njësia ekonomike si pjesë e një ESRS-je tjetër. Në këto raste, njësia ekonomike duhet të ofrojë një referencë të saktë për të identifikuar aspektet e politikës që plotësojnë këto kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese.
- AR 14. Kur jepet informacion shpjegues për përputhshmërinë e politikave të saj me Parimet Udhëzuese të OKB-së mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut, njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë që Parimet Udhëzuese i referohen Deklaratës Ndërkombëtare të të Drejtave, e cila përbëhet nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe dy Paktet që e zbatojnë atë, si dhe Deklaratës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës mbi të Drejtat Themelore dhe Parimet në Punë dhe konventat kryesore që e mbështesin atë, dhe mund të raportojë mbi përputhshmërinë me këto instrumente.
- AR 15. Kur jep informacion se si janë të integruara politikat e jashtme, njësia ekonomike mund të marrë në konsideratë, për shembull, politikat e brendshme të furnizimit të përgjegjshëm dhe harmonizimin me politikat e tjera të lidhura me punëtorët e **zinxhirit të vlerës**, për shembull, në lidhje me **punën e detyruar**. Lidhur me kodet e sjelljes së **furnitorëve** që mund të ketë njësia ekonomike, përmbledhja duhet të tregojë nëse ato përfshijnë dispozita që trajtojnë sigurinë e punëtorëve, punën e pasigurt (për shembull, përdorimin e punëtorëve me kontrata afatshkurtra ose me orar të kufizuar, punëtorët e punësuar nëpërmjet palëve të treta, nënkontraktimin të palët e treta ose përdorimin e punëtorëve informalë), trafikimin e qenieve njerëzore, përdorimin e punës së detyruar ose **punën e fëmijëve**, dhe nëse dispozita të tilla janë plotësisht në përputhje me standardet përkatëse të ILO-s.
- AR 16. Njësia ekonomike mund të ofrojë një ilustrim të llojeve të komunikimit të politikave të saj për ata individë, grupe individësh ose subjekte për të cilët ato janë të rëndësishme, qoftë sepse pritët që ata t'i zbatojnë ato (për shembull, **punonjësit**, kontraktorët dhe **furnizuesit** e njësisë ekonomike), ose sepse ata kanë një interes të drejtpërdrejtë në zbatimin e tyre (për shembull, punëtorët e saj, investitorët). Ajo mund të japë mjetet e informacionit dhe kanalet e komunikimit (për shembull, fletushka, buletine, faqe interneti të dedikuara, media sociale, ndërveprime ballë për ballë, përfaqësues të punëtorëve), që synojnë të sigurojnë që **politika** arrin tek të interesuarit dhe që audienca të ndryshme të kuptojnë implikimet e saj. Njësia

ekonomike mund të shpjegojë gjithashtu se si identifikon dhe heq pengesat e mundshme që pengojnë përhapjen, siç është përkthimi në gjuhët përkatëse ose përdorimi i përshkrimeve grafike.

Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S2-2 – Proceset për angazhimin me punonjësit e zinxhirit të vlerës në lidhje me ndikimet

- AR 17. Njësia ekonomike, kur përshkruan se cili funksion ose rol ka përgjegjësi operative për një angazhim të tillë dhe/ose llogaridhënie përfundimtare, mund të japë informacion nëse ky është një rol ose funksion i dedikuar apo pjesë e një roli ose funksioni më të gjerë, dhe nëse janë ofruar aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për të mbështetur stafin për të ndërmarrë angazhime. Nëse njësia ekonomike nuk mund të identifikojë një pozicion ose funksion të tillë, ajo mund ta deklarojë një fakt të tillë. Kjo dhënie informacioni shpjegues mund të përmbushet gjithashtu duke iu referuar informacionit të dhënë sipas ESRS 2 GOV-1 *Roli i organeve administrative, menaxhuese dhe mbikëqyrëse*.
- AR 18. Gjatë përgatitjes së deklarimeve të përshkruara në paragrafin 22 b) dhe c), mund të merren në konsideratë ilustrimet e mëposhtme për:
- (a) shembuj të fazave në të cilat ndodhet angazhimi të cilat janë i) përcaktimi i qasjes ndaj zbutjes së ndikimeve dhe ii) vlerësimi i efektivitetit të zbutjes së ndikimeve;
  - (b) llojet e angazhimit, që mund të jenë pjesëmarrje, konsultim dhe/ose informacion;
  - (c) frekuencën e angazhimit, që mund të jepet informacion nëse angazhimi ndodh rregullisht, në pika të caktuara të një projekti ose procesi biznesi, për shembull, kur fillon një sezon i ri korrije ose hapet një linjë e re prodhimi, si dhe nëse ndodh në përgjigje të kërkesave ligjore dhe/ose në përgjigje të kërkesave të palëve të interesuara dhe nëse rezultati i angazhimit po integrohet në proceset vendimmarrëse të njësisë ekonomike; dhe
  - (d) rolin që ka përgjegjësi operacionale, nëse njësia ekonomike kërkon që stafi përkatës të ketë aftësi të caktuara, apo nëse ofron **trajtime** ose ndërtimi i kapaciteteve të stafit përkatës për të ndërmarrë angazhime.
- AR 19. Marrëveshjet Kuadër Globale (GFA) shërbejnë për të krijuar një marrëdhënie të vazhdueshme midis një njësie ekonomike shumëkombëshe dhe një Federate Sindikale Globale për të siguruar që njësia ekonomike t'i përmbahet të njëjtave standarde në çdo vend në të cilin ajo ka aktivitet.
- AR 20. Për të ilustruar se si perspektivat e punëtorëve të **zinxhirit të vlerës** kanë ndikuar vendime ose aktivitete specifike të njësisë ekonomike, njësia ekonomike mund të japë shembuj nga periudha aktuale e raportimit.

Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S2-3 – Procese për të ndrequr ndikimet negative dhe kanalet e komunikimit për punëtorët e zinxhirit të vlerës për të ngritur shqetësime

- AR 21. Në përmbushjen e kërkesave të përcaktuara nga Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese ESRS S2-3, njësi ekonomike mund të udhëhiqet nga përmbajtja e Parimeve Udhëzuese të OKB-së mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut dhe Udhëzimet e OECD-së për Ndërmarrjet Shumëkombëshe të fokusuar në **mekanizmat e korrigjimit** dhe **ankesave**.
- AR 22. Kanalet për ngritjen e shqetësimeve ose nevojave përfshijnë **mekanizmat e ankesave**, linjat telefonike, sindikatat (ku punëtorët janë të anëtarësuar), proceset e dialogut ose mjete të tjera përmes të cilave punëtorët e **zinxhirit të vlerës** ose **përfaqësuesve të tyre legjitimë** mund të ngrenë shqetësime në lidhje me ndikimet ose të shpjegojnë nevojat që do të donin që njësi ekonomike të adresonte. Kjo mund të përfshijë si kanalet e ofruara nga njësi ekonomike drejtpërdrejt ashtu edhe kanalet e ofruara nga subjektet ku punojnë punonjësit e zinxhirit të vlerës, përveç çdo mekanizmi tjetër që njësi ekonomike mund të përdorë për të fituar njohuri mbi menaxhimin e ndikimeve tek punonjësit, siç janë auditimet e përputhshmërisë. Kur njësi ekonomike mbështetet vetëm në informacionin në lidhje me ekzistencën e kanaleve të tilla të ofruara nga **marrëdhëniet e saj të biznesit** për t'iu përgjigjur kësaj kërkesë, ajo duhet ta deklarojë këtë fakt.
- AR 23. Për të dhënë një pasqyrë më të gjerë të informacionit të mbuluar në Kërkesën për dhënie informacione shpjeguese ESRS S2-3, njësi ekonomike mund të shpjegojë se si punëtorët e prekur të **zinxhirit të vlerës** janë në gjendje të përdorin kanale në nivelin e njësisë ekonomike nga e cila janë të punësuar ose për të cilën janë kontraktuar të punojnë, në lidhje me secilin ndikim material.
- AR 24. Mekanizmat e palëve të treta mund të përfshijnë ato që veprojnë në emër të institucioneve qeveritare, OJQ-të, shoqatat e industrisë dhe nisma të tjera bashkëpunuese. Njësi ekonomike mund të japë informacione shpjeguese nëse këto janë të arritshme për të gjithë punëtorët që mund të preken potencialisht ose realisht në mënyrë materiale nga njësi ekonomike, ose nga individët ose organizatat që veprojnë në emër të tyre ose që janë në një pozicion tjetër për të qenë të vetëdijshëm për ndikimet negative.
- AR 25. Në lidhje me mbrojtjen e individëve që përdorin mekanizmat kundër hakmarrjes, njësi ekonomike mund të përshkruajë nëse i trajton ankesat në mënyrë konfidenciale dhe në lidhje me të drejtat e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave; dhe nëse mekanizmat u lejojnë punëtorëve t'i përdorin ato në mënyrë anonime (për shembull, përmes përfaqësimit nga një palë e tretë).
- AR 26. Në dhënien e informacioneve shpjeguese nëse dhe si njësi ekonomike ka informacion që punëtorët e **zinxhirit të vlerës** janë të vetëdijshëm dhe u besojnë ndonjërit prej këtyre kanaleve, njësi ekonomike mund të ofrojë të dhëna të duhura dhe të besueshme në lidhje me efektivitetin e këtyre kanaleve nga perspektiva e vetë punëtorëve të zinxhirit të vlerës.

Shembuj të burimeve të informacionit janë anketat e punëtorëve që kanë përdorur kanale të tilla dhe shkalla e tyre e vlerësimit (kënaqësisë) për procesin dhe rezultatet.

AR 27. Në përshkrimin e efektivitetit të kanaleve për të ngritur shqetësime për punëtorët e **zinxhirit të vlerës**, njësia ekonomike mund të udhëhiqet nga pyetjet e mëposhtme, bazuar në "kriteret e efektivitetit për **mekanizmat** jo-gjyqësorë **të ankesave**", siç përcaktohen në Parimet Udhëzuese të OKB-së për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut, në veçanti Parimin 31. Konsideratat e mëposhtme mund të zbatohen për kanalet individuale ose për një sistem kolektiv kanalesh komunikimi:

- (a) a kanë kanalet e komunikimit legjitimitet për të ofruar llogaridhënie të përshtatshme për sjelljen e tyre të drejtë dhe për të ndërtuar besimin e palëve të interesuara?
- (b) a janë kanalet e komunikimit të njohura dhe të arritshme për **palët e interesuara**?
- (c) a kanë kanalet procedura të qarta dhe të ditura në lidhje me treguesit e afateve kohore?
- (d) a sigurojnë kanalet qasje të arsyeshëm për **palët e interesuara** drejt burimeve të informacionit, këshillave dhe ekspertizës?
- (e) a ofrojnë kanalet transparencë duke u ofruar informacion të mjaftueshëm si ankuesve ashtu edhe për të përmbushur çdo interes publik, kur është e aplikueshme?
- (f) a përputhen rezultatet e arritura përmes kanaleve me të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht?
- (g) a identifikon njësia ekonomike njohuri nga kanalet që mbështesin edukimin e vazhdueshëm si në përmirësimin e kanaleve ashtu edhe në parandalimin e ndikimeve të ardhshme?
- (h) a përqendrohet njësia ekonomike në dialogun me ankuesit si mjet për të arritur zgjidhje të dakordësuara, në vend që të përpiqet të përcaktojë në mënyrë të njëanshme rezultatin?

**Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S2-4 – Ndërmarrja e veprimeve mbi ndikimet materiale tek punëtorët e zinxhirit të vlerës, dhe qasjet për menaxhimin e rreziqeve materiale dhe ndjekjen e mundësive që lidhen me punëtorët e zinxhirit të vlerës, dhe efektiviteti i këtyre veprimeve**

AR 28. Mund të duhet kohë për të kuptuar ndikimet negative dhe se si njësia ekonomike mund të jetë e përfshirë në to përmes zinxhirit të saj të vlerës, si dhe për të identifikuar përgjigjet e duhura dhe për t'i vënë ato në praktikë. Prandaj, njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë:

- (a) qasjet e saj të përgjithshme dhe specifike për adresimin e ndikimeve negative materiale;
- (b) iniciativat e saj që synojnë të kontribuojnë në ndikime të rëndësishme pozitive shtesë;

- (c) sa ka përparuar në përpjekjet e saj gjatë periudhës së raportimit; dhe
- (d) synimet e saj për përmirësim të vazhdueshëm.

- AR 29. Veprimet e duhura mund të ndryshojnë në varësi të faktit nëse njësia ekonomike shkakton ose kontribuon në një ndikim material ose nëse ndikimi material lidhet drejtpërdrejt me veprimet, produktet ose shërbimet e saj përmes një marrëdhënieje biznesi.
- AR 30. Duke pasur parasysh se ndikimet negative materiale që prekin punëtorët e **zinxhirit të vlerës** që kanë ndodhur gjatë periudhës raportuese mund të jenë të lidhura edhe me njësi ose veprimtari të tjera jashtë kontrollit të saj të drejtpërdrejtë, njësia ekonomike mund të japë informacion nëse dhe si kërkon të përdorë ndikimin e saj në **marrëdhëniet e saj të biznesit** për të menaxhuar këto ndikime. Kjo mund të përfshijë përdorimin e **ndikimit tregtar** (për shembull, zbatimi i kërkesave kontraktuale në marrëdhëniet e biznesit ose zbatimi i stimujve), formave të tjera të ndikimit brenda marrëdhënies (siç është ofrimi i **trajnitimit**, ose ndërtimi i kapaciteteve mbi të drejtat e punëtorëve për subjektet me të cilat njësia ekonomike ka një marrëdhënie biznesi) ose ndikimin bashkëpunues me kolegët ose aktorë të tjerë (siç janë iniciativat që synojnë rekrutimin e përgjegjshëm ose sigurimin që punëtorët të marrin një **pagë të përshatshme**).
- AR 31. Kur njësia ekonomike informon për pjesëmarrjen e saj në një industri ose një iniciativë me shumë palë të interesuara si pjesë e **aktiviteteve** të saj për të adresuar ndikimet negative materiale, njësia ekonomike mund të japë informacion se si iniciativa, dhe përfshirja e saj, synon të adresojë ndikimin material në fjalë. Ajo mund të japë informacion shpjegues sipas ESRS S2-5 **objektivat** përkatëse të përcaktuara nga iniciativa dhe progresi drejt tyre.
- AR 32. Kur njësia ekonomike jep informacione shpjeguese nëse dhe si ajo merr në konsideratë ndikimet aktuale dhe të mundshme mbi punëtorët e **zinxhirit të vlerës** në vendimet që merr për të ndërprerë **marrëdhëniet e biznesit** dhe nëse dhe si synon të adresojë çdo ndikim negativ që mund të rezultojë nga kjo ndërprerje, njësia ekonomike mund të përfshijë shembuj.
- AR 33. Në dhënien e informacionit shpjegues se si gjurmon efektivitetin e **veprimeve** të saj për të menaxhuar ndikimet materiale gjatë periudhës së raportimit, njësia ekonomike mund të japë informacione shpjeguese për çdo mësim të nxjerrë nga periudhat e mëparshme dhe aktuale të raportimit.
- AR 34. Proceset e përdorura për të ndjekur efektivitetin e **veprimeve** mund të përfshijnë një auditim ose verifikim të brendshëm ose të jashtëm, procedura gjyqësore dhe/ose vendime gjyqësore përkatëse, vlerësime të ndikimit, sisteme matjeje, reagime nga palët e interesuara, **mekanizma ankimi**, vlerësime të performancës së jashtme dhe krahasime.
- AR 35. Raportimi mbi efektivitetin synon të mundësojë kuptimin e lidhjeve midis **veprimeve** të ndërmarra nga njësia ekonomike dhe menaxhimit efektiv të ndikimeve. Për shembull, për të treguar efektivitetin e **veprimeve** të saj për të mbështetur **furnizuesit** e saj në përmirësimin e kushteve të tyre të punës, njësia ekonomike mund të japë informacione shpjeguese reagime

nga anketat e punëtorëve të furnizuesve që tregojnë se kushtet e punës janë përmirësuar që nga koha kur njësi ekonomike filloi të punojë me këta furnizues. Informacion shtesë që njësi ekonomike mund të ofrojë përfshin të dhëna që tregojnë një rënie në numrin e **incidenteve** të identifikuar, për shembull, përmes auditimeve të pavarura.

AR 36. Lidhur me iniciativat ose proceset që njësi ekonomike ka në zbatim, të cilat bazohen në nevojat e punëtorëve të prekur dhe në lidhje me progresin në zbatimin e iniciativave ose proceseve të tilla, njësi ekonomike mund të japë informacione shpjeguese:

- (a) nëse dhe si punëtorët e **zinxhirit të vlerës** dhe **përfaqësuesit legjitimë** ose **përfaqësuesit e tyre të besueshëm** luajnë një rol në vendimet që kanë të bëjnë me hartimin dhe zbatimin e këtyre programeve ose proceseve; dhe
- (b) në lidhje me rezultatet pozitive të synuara ose të arritura për punonjësit e zinxhirit të vlerës të këtyre iniciativave ose proceseve.

AR 37. Njësi ekonomike mund të japë informacione shpjeguese nëse është marrë ndonjë iniciativë ose proces, qëllimi kryesor i të cilit është të japë ndikime pozitive për punëtorët e **zinxhirit të vlerës** gjithashtu për të mbështetur arritjen e një ose më shumë Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) të OKB-së. Për shembull, përmes një angazhimi për të çuar përpara SDG 8 të OKB-së për të "promovuar rritje ekonomike të qëndrueshme gjithëpërfshirëse, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë", njësi ekonomike mund të ofrojë ndërtim kapacitetesh për pronarët e vegjël në **zinxhirin e saj të furnizimit**, duke rezultuar në rritje të të ardhurave të tyre; ose mund të mbështesë **trajtime** për të rritur përqindjen e grave të afta të marrin punë si shpërndarëse në rrjedhën e poshtme të zinxhirit të saj të vlerës.

AR 38. Kur jepet informacion shpjegues për rezultatet pozitive të synuara ose të arritura të **veprimeve** të saj për punëtorët e **zinxhirit të vlerës**, duhet bërë dallim midis provave të aktiviteteve të caktuara që kanë ndodhur (p.sh., që x numër punëtorësh kanë marrë **trajnim** për njohuri financiare) nga provat e rezultateve aktuale për punëtorët (p.sh., që x punëtorë raportojnë se janë në gjendje të menaxhojnë më mirë buxhetet e tyre familjare në mënyrë që të përmbushin objektivat e tyre të kursimit).

AR 39. Kur jepet informacion shpjegues nëse iniciativat ose proceset luajnë gjithashtu një rol në zbutjen e ndikimeve negative materiale, njësi ekonomike mund të marrë në konsideratë, për shembull, programe që synojnë të përmirësojnë njohuritë financiare të punëtorëve gra, të cilat kanë rezultuar në ngritjen në detyrë të më shumë grave, si dhe në raportime për uljen e **ngacmimit** seksual në vendin e punës.

AR 40. Kur jepet informacion shpjegues për rreziqet dhe mundësitë materiale që lidhen me ndikimet ose **varësitë** e njësisë ekonomike nga punëtorët e **zinxhirit të vlerës**, njësi ekonomike mund të marrë në konsideratë sa vijon:

- (a) rreziqet që lidhen me ndikimet e njësisë ekonomike tek punëtorët e zinxhirit të vlerës mund të përfshijnë ekspozimin reputacional ose ligjor kur punëtorët e zinxhirit të vlerës del se kryejnë **punë të detyruar** ose ka **punë të fëmijëve**;
- (b) rreziqet që lidhen me varësinë e njësisë ekonomike nga punëtorët e zinxhirit të vlerës mund të përfshijnë ndërprerjen e operacioneve të biznesit kur një pandemi mbyll pjesë të rëndësishme të **zinxhirit të furnizimit** të saj ose të rrjetit të shpërndarjes;
- (c) mundësitë që lidhen me ndikimet e njësisë ekonomike tek punëtorët e zinxhirit të vlerës mund të përfshijnë diferencimin e tregut dhe një apel më të madhe nga klientët për garantimin e një **pagë** të mirë dhe kushtet për punëtorët jo-punëmarrës; dhe
- (d) ► **C1** mundësitë që lidhen me varësinë e njësisë ekonomike nga punëtorët e zinxhirit të vlerës mund të përfshijnë arritjen e një furnizimi të qëndrueshëm në të ardhmen të një malli duke siguruar që fermerët e vegjël të fitojnë mjaftueshëm për të bindur brezat e ardhshëm të vazhdojnë të kultivojnë atë kulturë. ◀

AR 41. Kur jepet informacion shpjegues nëse **varësitë** shndërrohen në rreziqe, njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë zhvillimet e jashtme.

AR 42. Kur njësia ekonomike paraqet informacion shpjegues për politikat, **veprimet** dhe burimet dhe **objektivat** lidhur me menaxhimin e **rreziqeve** materiale dhe **mundësive**, në rastet kur rreziqet dhe mundësitë lindin nga një **ndikim** material, njësia ekonomike mund të kryqëzojë deklaratimet e saj mbi politikat, veprimi dhe burimet dhe objektivat në lidhje me atë ndikim.

AR 43. Njësia ekonomike duhet të shqyrtojë nëse dhe si procesi/proceset e saj për të menaxhuar rreziqet materiale lidhur me punëtorët e **zinxhirit të vlerës** janë të përfshira në procesin/proceset e saj ekzistuese të menaxhimit të riskut.

AR 44. Kur paraqet informacion shpjegues për burimet e alokuara për menaxhimin e ndikimeve materiale, njësia ekonomike mund të shpjegojë se cilat funksione të brendshme janë të përfshira në menaxhimin e ndikimeve dhe çfarë lloje veprimesh ndërmarrin ata për të adresuar ndikimet negative dhe për të çuar përpara ndikimet pozitive.

#### *Metrikat dhe objektivat*

#### Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S2-5 – Objektivat që lidhen me menaxhimin e ndikimeve negative materiale, avancimin e ndikimeve pozitive dhe menaxhimin e rreziqeve dhe mundësive materiale

AR 45. Kur paraqitet informacion shpjegues rreth **objektivave** në përputhje me paragrafin 39, njësia ekonomike mund të japë informacion për:

- (a) rezultatet e synuara që duhen arritur në jetën e punëtorëve të **zinxhirit të vlerës**, duke qenë sa më specifike të jetë e mundur;

- (b) stabilitetin e **objektivave** me kalimin e kohës në aspektin e përkufizimeve dhe metodologjive për të mundësuar krahasueshmërinë me kalimin e kohës;
- (c) standardet ose angazhimet mbi të cilat bazohen objektivat (për shembull kodet e sjelljes, politikat e furnizimit, kornizat globale ose kodet e industrisë).

AR 46. **Synimet** e lidhura me **rreziqet** dhe **mundësitë** materiale mund të jenë të njëjta ose të ndryshme nga objektivat që lidhen me **ndikimet** materiale. Për shembull, një objektivi për të arritur **pagën** minimale të jetesës për punëtorët e **zinxhirit të furnizimit** mund të zvogëlojnë ndikimet tek ata punëtorë dhe të zvogëlojnë rreziqet që lidhen me to në aspektin e cilësisë dhe besueshmërisë së furnizimit.

AR 47. Njësia ekonomike mund të bëjë gjithashtu dallimin midis **objektivave** afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë që mbulon të njëjtën **politikë** angazhim. Për shembull, njësia ekonomike mund të ketë një objektivi afatgjatë për të arritur një ulje prej 80% të **incidenteve** shëndetësore dhe të sigurisë që ndikojnë te punëtorët e një **furnizuesi** të caktuar deri në vitin 2030 dhe një objektivi afatshkurtër për të zvogëluar **orët e tyre shtesë** për shoferët e shpërndarjes me x% duke ruajtur të ardhurat e tyre deri në vitin 2024.

AR 48. Kur modifikon ose zëvendëson një **objektiv** në periudhën raportuese, njësia ekonomike mund ta shpjegojë ndryshimin duke e krahasuar atë me ndryshime të rëndësishme në **modelin e biznesit** ose me ndryshime më të mëdha në standardin ose legjisllacionin e pranuar nga i cili rrjedh objektivi për të dhënë informacion kontekstual sipas ESRS 2 BP-2 *Deklaratave në lidhje me rrethana specifike*.

## ESRS S3. KOMUNITETET E PREKURA

### Përmbajtja

<b>Objektivi .....</b>	<b>325</b>
<b>Ndërveprimi me Standardet e tjera ESRS .....</b>	<b>326</b>
<b>Kërkesat për Dhënie Informacione Shpjeguese .....</b>	<b>326</b>
ESRS 2 Dhënie informacione shpjeguese të përgjithshme.....	326
Strategjia.....	326
Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese në lidhje me ESRS 2 SBM-2 – Interesat dhe pikëpamjet e palëve të interesuara.....	326
Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese në lidhje me standardin ESRS 2 SBM -3– Ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit .....	327

Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë .....	328
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S3-1 – Politikat që lidhen me komunitetet e prekura .....	328
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S3-2 – Proceset për angazhimin me komunitetet e prekura në lidhje me ndikimet .....	330
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S3-3 – Proceset për të ndrequr ndikimet negative dhe kanalet e komunikimit për komunitetet e prekura për të ngritur shqetësime .....	331
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S3-4 – Ndërmarrja e veprimeve mbi ndikimet materiale në komunitetet e prekura, dhe qasjet për zbutjen e rreziqeve materiale dhe ndjekjen e mundësive që lidhen me komunitetet e prekura dhe efektiviteti i këtyre veprimeve .....	332
Metrikat dhe objektivat .....	334
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S3-5 – Objektivat që lidhen me menaxhimin e ndikimeve negative materiale, avancimin e ndikimeve pozitive dhe menaxhimin e rreziqeve dhe mundësive materiale.....	334
<b>Shtojca A. Kërkesat për Zbatim .....</b>	<b>335</b>
Objektivi .....	335
ESRS 2 Dhënie informacione shpjeguese të përgjithshme.....	336
Strategjia .....	336
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese në lidhje me standardin ESRS 2 SBM-2 – Interesat dhe pikëpamjet e palëve të interesuara .....	336
Kërkesa për Informacione Shpjeguese në lidhje me standardin ESRS 2 SBM -3 - Ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit .....	336
Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë .....	337
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S3-1 – Politikat që lidhen me komunitetet e prekura .....	337
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S3-2 – Proceset për angazhimin me komunitetet e prekura në lidhje me ndikimet .....	338
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S3-3 – Proceset për të ndrequr ndikimet negative dhe kanalet e komunikimit për komunitetet e prekura për të ngritur shqetësime .....	339
▶ <b>C1</b> Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S3-4 – Ndërmarrja e veprimeve mbi ndikimet materiale në komunitetet e prekura,	

dhe qasjet për zbutjen e rreziqeve materiale dhe ndjekjen e mundësive që lidhen me komunitetet e prekura dhe efektiviteti i këtyre veprimeve ◀ ...	341
Metrikat dhe objektivat .....	345
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S3-5 – Objektivat që lidhen me menaxhimin e ndikimeve negative materiale, avancimin e ndikimeve pozitive dhe menaxhimin e rreziqeve dhe mundësive materiale....	345

## Objektivi

- Objektivi i këtij Standardi është të specifikojë kërkesat për dhënie Informacione Shpjeguese të cilat do t'u mundësojnë **përdoruesve** të **deklaratës së qëndrueshmërisë** për të kuptuar ndikimet materiale në **komunitetet e prekura** të lidhura me aktivitetet e vetë njësisë ekonomike, përmes produkteve ose shërbimeve të saj, si dhe përmes **marrëdhënieve të saj të biznesit**, dhe rreziqeve dhe mundësive materiale që lidhen me të, duke përfshirë:
  - si ndikon njësia ekonomike në komunitetet e prekura, në zonat ku ndikimet kanë më shumë të ngjarë të jenë të pranishme dhe të rënda, në aspektin e ndikimeve materiale pozitive dhe negative aktuale ose të mundshme;
  - çdo **veprim** të ndërmarra dhe rezultati i veprimeve të tilla, për të parandaluar, zbutur ose ndrequr ndikimet negative aktuale ose të pritshme, dhe për të adresuar rreziqet dhe mundësitë;
  - natyrën, llojin dhe shkallën e rreziqeve dhe mundësive materiale të njësisë ekonomike që lidhen me ndikimet dhe **varësitë** e saj mbi **komunitetet e prekura**, dhe mënyrën se si njësia ekonomike i menaxhon ato; dhe
  - efektet financiare** mbi njësinë ekonomike, në planin afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, të rreziqeve dhe mundësive materiale që rrjedhin nga ndikimet dhe varësitë e prej komuniteteve të prekura.
- Për të përmbushur objektivin, ky Standard kërkon një shpjegim të qasjes së përgjithshme që njësia ekonomike ndjek për të identifikuar dhe menaxhuar çdo ndikim material aktual dhe potencial mbi **komunitetet e prekura** në lidhje me:
  - të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të komuniteteve (për shembull, strehim i përshtatshëm, ushqim, ujë dhe shëndetësi të përshtatshme, ndikime që lidhen me tokën dhe sigurinë);
  - të drejtat civile dhe politike të komuniteteve (për shembull, liria e shprehjes, liria e tubimit, ndikimet te mbrojtësit e të drejtave të njeriut); dhe
  - të drejtat e veçanta të **popujve indigjenë** (për shembull, pëlqimi i lirë, paraprak dhe i informuar, vetëvendosja, të drejtat kulturore).

3. Ky Standard kërkon gjithashtu një shpjegim se si ndikime të tilla, si dhe **varësitë** e njësisë ekonomike prej komuniteteve të prekura, mund të krijojnë rreziqe ose mundësi materiale për njësinë ekonomike. Për shembull, marrëdhëniet negative me **komunitetet e prekura** mund të prishin aktivitetet e vetë njësisë ekonomike ose të dëmtojnë reputacionin e saj, ndërsa marrëdhëniet konstruktive mund të sjellin përfitime biznesi, të tilla si operacione të qëndrueshme dhe pa konflikte dhe një lehtësi më të madhe të rekrutimit në nivel lokal.

## Ndërveprimi me Standardet e tjera ESRS

4. Ky standard zbatohet kur ka ndikime materiale mbi dhe/ose rreziqe dhe mundësi materiale që lidhen me **komunitetet e prekura** janë identifikuar përmes procesit të vlerësimit të **materialitetit** siç përcaktohet në ESRS 2 *Dhënie informacione të përgjithshme*.
5. Ky Standard duhet të lexohet së bashku me ESRS 1 *Kërkesat e Përgjithshme* dhe ESRS 2, si dhe ESRS S1 *Fuqia e vet punëtore*, ESRS S2 *Punonjësit në zinxhirin e vlerës* dhe ESRS S4 *Konsumatorët dhe përdoruesit fundorë*.

## Kërkesat për Dhënie Informacione Shpjeguese

### ESRS 2 Dhënie informacione shpjeguese të përgjithshme

6. Kërkesat e këtij seksioni duhet të lexohen së bashku me informacionet shpjeguese të kërkuara nga ESRS 2 mbi Strategjinë (SBM). Informacionet e dhëna që rezultojnë duhet të paraqiten së bashku me informacionet e kërkuara nga ESRS 2, me përjashtim të SBM-3 *Ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale dhe ndërveprimin e tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit*, për të cilat njësi ekonomike ka një mundësi për të dhënë informacione shpjeguese së bashku me informacionin tematik.

### Strategjia

*Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese në lidhje me ESRS 2 SBM-2 – Interesat dhe pikëpamjet e palëve të interesuara*

7. Kur i përgjigjet ESRS 2 SBM-2, paragrafi 43, njësi ekonomike duhet të japë informacion se si pikëpamjet, interesat dhe të drejtat e **komuniteteve të prekura**, duke përfshirë respektin për të drejtat e tyre të njeriut (dhe të drejtat e tyre si **popuj indigjenë**, kur është e aplikueshme), ndikojnë në strategjinë dhe modelin e saj të biznesit. **Komunitetet e prekura** janë një grup kyç i **palëve të interesuara** të prekura.

*Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese në lidhje me standardin ESRS 2 SBM -3–  
Ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe  
modelin e biznesit*

8. Kur njësia ekonomike i përgjigjet ESRS 2 SBM-3 paragrafi 48, ajo duhet të japë këto informacione:
- (a) nëse dhe si ndikimet aktuale dhe të mundshme mbi **komunitetet e prekura**, siç identifikohen në ESRS 2 IRO-1 *Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale*: (i) burojnë nga ose janë të lidhura me strategjinë dhe modelet e biznesit të njësisë ekonomike, dhe (ii) japin informacion dhe kontribuojnë në përshtatjen e strategjisë dhe modelit të biznesit të njësisë ekonomike; dhe
  - (b) mbi marrëdhënien midis rreziqeve të saj materiale dhe mundësive që rrjedhin nga ndikimet dhe **varësitë** nga komunitetet e prekura me strategjinë dhe modelin e saj të biznesit.
9. Gjatë përmbushjes së kërkesave të paragrafi 48, njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese nëse të gjithë **komunitetet e prekura** të cilët ka të ngjarë të ndikohen materialisht nga njësia ekonomike, duke përfshirë ndikimet që lidhen me aktivitetet dhe **zinxhirin e vlerës** së vetë njësisë ekonomike, përmes produkteve ose shërbimeve të saj, si dhe përmes **marrëdhënieve të saj të biznesit**, përfshihen në fushëveprimin e informacionit shpjegues sipas ESRS 2. Përveç kësaj, njësia ekonomike duhet të ofrojë informacionin e mëposhtëm:
- (a) një përshkrim të shkurtër të llojeve të komuniteteve që preken nga ndikimet materiale të operacioneve të veta ose përmes rrjedhës së sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës së saj, dhe të specifikojë nëse ato janë:
    - i. komunitete që jetojnë ose punojnë përreth **vendeve të aktivitetit** të njësisë ekonomike, fabrikave, objekteve ose operacioneve të tjera fizike, ose komunitete më të largëta të prekura nga aktivitetet në ato vende (për shembull nga **ndotja** e ujërave në rrjedhën e poshtme);
    - ii. komunitete përgjatë zinxhirit të vlerës së njësisë ekonomike (për shembull, ato të prekura nga veprimtaritë e **furnizuesve** ose nga aktivitetet e ofruesve të logjistikës ose shpërndarjes);
    - iii. komunitete në njëerën ose të dyja pikat fundore të zinxhirit të vlerës (për shembull, në pikën e nxjerrjes së metaleve ose mineraleve ose vjeljes së produkteve, ose komunitete përreth zonës së **mbeturinave** ose të **riciklimit**);
    - iv. komunitete të **popujve indigjenë**.
  - (b) në rastin e ndikimeve negative materiale, të paraqesë nëse ato janë (i) të përhapura gjerësisht ose sistemike në kontekstet ku njësia ekonomike operon ose ka marrëdhënie furnizimi ose marrëdhënie të tjera biznesi (për shembull, popullatat e marginalizuara që vuajnë ndikime në shëndetin dhe cilësinë e jetës së tyre në një zonë shumë të

industrializuar), ose (ii) të lidhura me **incidente** individuale në aktivitetet e vetë ndërmarrjes (p.sh., një derdhje e **mbeturinave** toksike që ndikon në qasjen e një komuniteti në ujë të pijshëm të pastër) ose me një marrëdhënie specifike biznesi (p.sh., një protestë paqësore nga komunitetet kundër operacioneve të biznesit që u prit me një përgjigje të dhunshme nga shërbimet e sigurisë së ndërmarrjes). Kjo përfshin shqyrtimin e ndikimeve në komunitetet e prekura që mund të lindin nga kalimi në veprimtari më të gjelbra dhe me klimë neutrale. Ndikimet e mundshme përfshijnë ndikimet që lidhen me inovacionin dhe ristrukturimin, mbylljen e minierave, rritjen e nxjerrjes së mineraleve të nevojshme për kalimin në një ekonomi të qëndrueshme dhe prodhimin e paneleve diellore;

- (c) në rastin e ndikimeve pozitive materiale, duhet të japë një përshkrim të shkurtër të aktiviteteve që rezultojnë në ndikime pozitive (për shembull, ndërtimi i kapaciteteve për të mbështetur më shumë forma dhe forma të reja të jetesës lokale) dhe llojet e komuniteteve që preken pozitivisht ose mund të preken pozitivisht; njësia ekonomike gjithashtu mund të japë informacion nëse ndikimet pozitive ndodhin në vende ose rajone specifike; dhe
- (d) çdo rrezik dhe mundësi materiale për njësinë ekonomike që rrjedh nga ndikimet dhe **varësia** nga komunitetet e prekura.

- 10. Në përshkrimin e llojeve kryesore të komuniteteve të cilët janë ose mund të preken negativisht, bazuar në vlerësimin e **materialitetit** të përcaktuar në Kërkesat për Dhënie Informacione Shpjeguese ESRS 2 IRO-1, njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese nëse dhe si ka zhvilluar një kuptim se si **komunitetet e prekura** me karakteristika të veçanta, ata që punojnë në kontekste të veçanta ose ata që ndërmarrin aktivitete të veçanta mund të jenë në rrezik më të madh dëmi.
- 11. Ndërmarrja duhet të japë informacion, nëse ka, cilat nga rreziqet dhe mundësitë e saj materiale që rrjedhin nga ndikimet dhe **varësitë** prej **komuniteteve të prekura** lidhen me grupe specifike të komuniteteve të prekura në vend që të gjitha komunitetet e prekura.

## Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S3-1 – Politikat që lidhen me komunitetet e prekura*

- 12. **Njësia ekonomike duhet të përshkruajë politikat e saj të miratuara për të menaxhuar ndikimet e saj materiale tek komunitetet e prekura, si dhe rreziqet dhe mundësitë materiale që lidhen me to.**
- 13. Objektivi i kësaj Kërkesë për dhënie informacione shpjeguese është të mundësojë një kuptim të masës në të cilën njësia ekonomike ka politika që trajtojnë identifikimin, vlerësimin, menaxhimin dhe/ose **ndreqjen** e ndikimeve materiale në **komunitetet e prekura** në mënyrë

të veçantë, si dhe politika që mbulojnë rreziqet materiale ose mundësi që lidhen me komunitetet e prekura.

14. Informacioni i kërkuar nga paragrafi 12 duhet të përmbajë shpjegime mbi politikat e njësive ekonomike për të menaxhuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë e saj materiale që lidhen me **komunitetet e prekura** në përputhje me ESRS 2 MDR -P *Politikat e miratuara për të menaxhuar çështjet e qëndrueshmërisë materiale*. Përveç kësaj, njësia ekonomike duhet të specifikojë nëse politika të tilla mbulojnë komunitete specifike të prekura apo të gjitha komunitetet e prekura.
15. Njësia ekonomike duhet të japë informacion për çdo dispozitë të veçantë të **politikës** për parandalimin dhe adresimin e ndikimeve mbi **popujt indigjenë**.
16. Njësia ekonomike duhet të përshkruajë angazhimet në **politikën** e saj të drejtave të njeriut<sup>121</sup> që janë të rëndësishme për komunitetet e prekura, duke përfshirë ato procese dhe mekanizma për të monitoruar pajtueshmërinë me Parimet Udhëzuese të OKB-së mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut, Deklaratën e ILO-s mbi Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë dhe Udhëzimet e OECD-së për Ndërmarrjet Shumëkombëshe. Në informacionin e dhënë prej saj, ajo do të përqendrohet në ato çështje që janë materiale në lidhje me sa më poshtë,<sup>122</sup> si dhe në qasjen e saj të përgjithshme në lidhje me:
  - (a) respektimin e të drejtave të njeriut të komuniteteve dhe **popujve indigjenë** në mënyrë të veçantë;
  - (b) angazhimin me komunitetet e prekura; dhe
  - (c) masat për të siguruar dhe/ose mundësuar **zgjidhje** për çështjet me ndikim në të drejtat e njeriut.
17. Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese nëse dhe si politikat e saj në lidhje me **komunitetet e prekura** janë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht që lidhen me komunitetet dhe **popujt indigjenë** në mënyrë të veçantë, duke përfshirë Parimet Udhëzuese të Kombeve të Bashkuara (OKB) mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut.. Njësia ekonomike duhet gjithashtu të japë informacione shpjeguese për shkallën në të cilën rastet e mosrespektimit të Parimeve Udhëzuese të OKB-së mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut, Deklaratës së ILO-s mbi Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë ose Udhëzimeve të OECD-së për Ndërmarrjet Shumëkombëshe që përfshijnë komunitetet e prekura janë raportuar në

---

<sup>121</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues shtesë që lidhet me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohet nga treguesi #9 në Tabelën III të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e rregullat e dhënies së informacionit shpjegues mbi investimet e qëndrueshme ("Mungesa e një politike për të drejtat e njeriut").

<sup>122</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues i detyrueshëm që lidhet me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohet nga treguesi #11 në Tabelën I të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat për dhënie informacione shpjeguese mbi investimet e qëndrueshme ('Mungesa e proceseve dhe mekanizmeve të pajtueshmërisë për të monitoruar pajtueshmërinë me parimet e Kompaktit Global të OKB-së dhe Udhëzimet e OECD-së për Shoqëritë Shumëkombëshe').

aktivitetet e saj ose rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të **zinxhirit të saj të vlerës** dhe, nëse është e zbatueshme, një tregues të natyrës së rasteve të tilla <sup>(123)</sup>.

18. **Politika** mund të marrë formën e një politike të pavarur në lidhje me komunitetet e prekura ose të përfshihet në një dokument më të gjerë, siç është një kod etik ose një politikë e përgjithshme e qëndrueshmërisë që është paraqitur tashmë nga njësia ekonomike si pjesë e një ESRS-je tjetër. Në këto raste, njësia ekonomike duhet të ofrojë një referencë të saktë për të identifikuar aspektet e politikës që plotësojnë këto kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese.

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S3-2 – Proceset për angazhimin me komunitetet e prekura në lidhje me ndikimet*

19. **Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese për proceset e saj të përgjithshme për angazhimin me komunitetet e prekura dhe përfaqësuesit e tyre në lidhje me ndikimet aktuale dhe të mundshme mbi ta.**
20. Objektivi i kësaj Kërkesë për dhënie informacione shpjeguese është të mundësojë një kuptim nëse dhe si njësia ekonomike angazhohet, si pjesë e procesit të saj të vazhdueshëm të kujdesit të duhur, me komunitetet e prekura dhe përfaqësuesve të tyre legjitimë, ose me **përfaqësues të besueshëm**, rreth ndikimeve materiale pozitive dhe/ose negative aktuale dhe të mundshme që i prekin ose ka të ngjarë t'i prekin ata, dhe si merren parasysh perspektivat e **komuniteteve të prekura** në proceset e vendimmarrjes së njësisë ekonomike.
21. Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese nëse dhe si perspektivat e **komuniteteve të prekura** ndikojnë vendimet ose aktivitetet e saj që synojnë menaxhimin e ndikimeve aktuale dhe të mundshme në komunitete. Kjo do të përfshijë, kur është e nevojshme, një shpjegim:
  - (a) nëse angazhimi ndodh me komunitetet e prekura ose me **përfaqësuesit e tyre legjitimë** drejtpërdrejt, ose me **përfaqësues të besueshëm** që kanë njohuri për situatën e tyre;
  - (b) të fazës(ve) në të cilën ndodh angazhimi, lloji i angazhimit dhe frekuenca e angazhimit;
  - (c) të funksionit dhe rolit më të lartë brenda njësisë ekonomike që ka përgjegjësinë operative për të siguruar që ky angazhim të ndodhë dhe që rezultatet të japin informacion në qasjen e njësisë ekonomike;

---

<sup>123</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues i detyrueshëm që lidhet me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohet nga treguesi #10 në Tabelën I të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat për dhënie informacione shpjeguese mbi investimet e qëndrueshme ("Shkeljet e parimeve të Kompaktit Global të OKB-së dhe Udhëzimet e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) për Shoqëritë Shumëkombëshe"); dhe administratorët e standardeve më të mira për dhënie informacioni shpjegues lidhur me faktorët ESG që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2020/1816 siç përcaktohet nga treguesit "Numri i përbërësve të standardeve më të mira objekt i shkeljeve sociale (numri absolut dhe relativ i ndarë me të gjithë përbërësit e standardeve), siç referohet në traktatet dhe konventat ndërkombëtare, në parimet e Kombeve të Bashkuara dhe, nëse është e zbatueshme në ligjin kombëtar" në seksionin 1 dhe 2 të Aneksit II.

(d) aty ku është e aplikueshme, si e vlerëson njësia ekonomike efektivitetin e angazhimit të saj me komunitetet e prekura, duke përfshirë, aty ku është e nevojshme, çdo marrëveshje ose rezultat që rezulton nga kjo.

22. Kur është e aplikueshme, njësia ekonomike duhet të japë informacion për hapat që ndërmerr për të kuptuar perspektivat e **komuniteteve të prekura** që mund të jenë veçanërisht të prekshme ndaj ndikimeve dhe/ose të marginalizuara, dhe për perspektivën e grupeve specifike brenda komuniteteve të prekura, siç janë gratë dhe vajzat.
23. Aty ku **komunitetet e prekura** janë **popuj indigjenë**, njësia ekonomike duhet të japë informacion gjithashtu se si i merr parasysh dhe siguron respektimin e të drejtave të tyre të veçanta në **angazhimin e saj me palët e interesuara**, duke përfshirë të drejtën e tyre për **pëlqim të lirë, paraprak dhe të informuar** në lidhje me: (i) pasurinë e tyre kulturore, intelektuale, fetare dhe shpirtërore; (ii) aktivitetet që ndikojnë në tokat dhe territoret e tyre; dhe (iii) masat legislative ose administrative që i prekin ato. Në veçanti, kur ndodh angazhimi me **popujt indigjenë**, ndërmarrja duhet të japë informacion gjithashtu nëse dhe si popujt indigjenë janë konsultuar mbi mënyrën dhe parametrat e angazhimit (për shembull, në hartimin e axhendës, natyrës dhe afateve kohore të angazhimit).
24. Nëse njësia ekonomike nuk mund të japë informacionin e kërkuar më sipër, sepse nuk ka miratuar një proces të përgjithshëm për t'u angazhuar me komunitetet e prekura, ajo duhet ta bëjë të ditur këtë fakt. Ajo mund të japë informacion për një afat kohor brenda të cilit synon ta realizojë një proces të tillë.

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S3-3 – Proceset për të ndrequr ndikimet negative dhe kanalet e komunikimit për komunitetet e prekura për të ngritur shqetësime*

25. **Njësia ekonomike duhet të përshkruajë proceset që ka në vend për të siguruar ose bashkëpunuar në ndreqjen e ndikimeve negative tek komunitetet e prekura me të cilët është e lidhur njësia ekonomike, si dhe kanalet në dispozicion të komuniteteve të prekura për të ngritur shqetësime dhe për t'i adresuar ato.**
26. Objektivi i kësaj Kërkesë për dhënie informacione shpjeguese është të mundësojë një kuptim të mjeteve formale me anë të të cilave **komunitetet e prekura** mund t'ia bëjnë të ditura shqetësimet dhe nevojat e tyre drejtpërdrejt njësisë ekonomike dhe/ose përmes të cilave njësia ekonomike mbështet disponueshmërinë e kanaleve të tilla (për shembull, **mekanizmat e ankesave**) nëpërmjet marrëdhënieve të saj të biznesit, si kryhet ndjekja e tyre me këto komunitete në lidhje me çështjet e ngritura dhe efektivitetin e këtyre kanaleve.
27. Njësia ekonomike duhet të përshkruajë:
  - (a) qasjen e saj të përgjithshme dhe proceset për zgjidhjen ose kontributin në **zgjidhjen** e problemeve që kanë shkaktuar ose kontribuar në një **ndikim** negativ material tek

komunitetet e prekura, duke përfshirë nëse njësia ekonomike vlerëson dhe si e vlerëson se zgjidhja e ofruar është efektive;

- (b) çdo kanal specifik që ka në dispozicion për **komunitetet e prekura** për të ngritur shqetësimet ose nevojat e tyre drejtpërdrejt me njësinë ekonomike dhe se si kjo e fundit i ka adresuar ato, duke përfshirë nëse këto përcaktohen nga vetë njësia ekonomike dhe/ose përmes pjesëmarrjes në mekanizma të palëve të treta;
- (c) proceset e saj përmes të cilave njësia ekonomike mbështet disponueshmërinë e kanaleve të tilla nëpërmjet marrëdhënieve të saj të biznesit; dhe
- (d) si i gjurmon dhe monitoron çështjet e ngritura dhe të trajtuara, dhe si siguron efektivitetin e kanaleve, duke konsideruar edhe përfshirjen e **palëve të interesuara** të cilët janë **përdoruesit** e synuar të këtyre kanaleve.

28. Njësia ekonomike duhet të japë informacion nëse vlerëson dhe si vlerëson që **komunitetet e prekura** janë në dijeni të këtyre strukturave ose proceseve dhe u besojnë atyre si një mënyrë për të ngritur shqetësimet ose nevojat e tyre dhe për t'i adresuar ato. Përveç kësaj, njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese nëse ka politika në vend kundër hakmarrjes në lidhje me mbrojtjen e individëve që i përdorin ato. Nëse një informacion i tillë është dhënë në përputhje me ESRS G1-1, njësia ekonomike mund t'i referohet atij informacioni.
29. Nëse njësia ekonomike nuk mund të japë informacionin e kërkuar sa më sipër, sepse nuk ka miratuar një kanal për të ngritur shqetësime dhe/ose nuk mbështet disponueshmërinë e një kanali të tillë nëpërmjet marrëdhënieve të biznesit, ajo duhet ta deklarojë këtë si rast. Ajo mund të japë informacion shpjegues për një afat kohor brenda të cilit synon të ketë në vend një kanal ose procese të tilla.

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S3-4 – Ndërmarrja e veprimeve mbi ndikimet materiale në komunitetet e prekura, dhe qasjet për zbutjen e rreziqeve materiale dhe ndjekjen e mundësive që lidhen me komunitetet e prekura dhe efektiviteti i këtyre veprimeve*

30. **Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese se si ndërmerr veprime për të adresuar ndikimet materiale tek komunitetet e prekura, si dhe për të menaxhuar rreziqet materiale dhe për të ndjekur mundësitë që lidhen me komunitetet e prekura dhe efektivitetin e këtyre veprimeve.**
31. Objektivi i kësaj kërkesë për Informacione Shpjeguese është i dyfishtë. Së pari, për të mundësuar kuptimin e çdo **veprimi** dhe initiative përmes së cilës njësia ekonomike synon:
- (a) të parandalojë, zbusë dhe ndreqë **ndikimet** negative materiale mbi komunitetet e prekura; dhe/ose
  - (b) për të arritur ndikime pozitive materiale për komunitetet e prekura.

Së dyti, është për të mundësuar një kuptim të mënyrave se si njësia ekonomike po adreson **rreziqet** materiale dhe duke ndjekur mundësitë lidhur me komunitetet e prekura.

Njësia ekonomike duhet të ofrojë një përshkrim të përmbledhur të planeve të veprimit dhe burimeve për të menaxhuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë e saj materiale që lidhen me komunitetet e prekura sipas ESRS 2 MDR -A *Veprime dhe burime në lidhje me çështjet e qëndrueshmërisë materiale*.

32. Në lidhje me ndikimet materiale, njësia ekonomike duhet të përshkruajë:
- (a) veprimet e ndërmarra, të planifikuara ose në proces për të parandaluar ose zbutur ndikimet negative materiale mbi komunitetet e prekura;
  - (b) nëse ka ndërmarrë dhe si ka ndërmarrë veprime për të siguruar ose mundësuar **zgjidhjen** në lidhje me një ndikim real;
  - (c) çdo **veprim** ose iniciativë shtesë që ka në zbatim me qëllimin kryesor ofrimin e ndikimeve pozitive për komunitetet e prekura; dhe
  - (d) si gjurmon dhe vlerëson efektivitetin e **veprimeve** të tilla dhe iniciativa në ofrimin e rezultateve të synuara për komunitetet e prekura.
33. ► **C1** Në lidhje me paragrafin 30, njësia ekonomike duhet të përshkruajë: ◀
- (a) proceset përmes të cilave identifikohet se çfarë veprimi është i nevojshëm dhe i përshtatshëm në përgjigje të një ndikimi të veçantë negativ aktual ose të pritshëm mbi komunitetet e prekura;
  - (b) qasjen e saj për të ndërmarrë veprime në lidhje me ndikimet negative specifike materiale mbi komunitetet, duke përfshirë çdo veprim në lidhje me praktikatat e veta në lidhje me blerjen e tokës, planifikimin dhe ndërtimin, operimin ose praktikatat e mbylljes, si dhe nëse do të kërkohet veprim më i gjerë i industrisë ose bashkëpunues me palë të tjera përkatëse; dhe
  - (c) si siguron që proceset për të ofruar ose mundësuar **zgjidhjen** në rast të ndikimeve negative materiale, janë të disponueshme dhe efektive në zbatimin dhe rezultatet e tyre.
34. Në lidhje me rreziqet materiale dhe mundësitë, njësia ekonomike duhet të përshkruajë:
- (a) çfarë veprimi është planifikuar ose është duke u ndërmarrë për të zbutur rreziqet materiale për njësinë ekonomike që rrjedhin nga ndikimet dhe **varësitë** e saj nga **komunitetet e prekura** dhe si e gjurmon efektivitetin në praktikë; dhe
  - (b) çfarë veprimi është planifikuar ose është duke u ndërmarrë për të ndjekur mundësitë materiale për njësinë ekonomike në lidhje me komunitetet e prekura.
35. Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues nëse dhe si ndërmerr veprime për të shmangur shkaktimin ose kontributin në ndikime negative materiale në **komunitetet e prekura** përmes praktikave të veta, duke përfshirë, aty ku është e nevojshme, në lidhje me

planifikimin, blerjen dhe shfrytëzimin e tokës, financimin, nxjerrjen ose prodhimin e lëndëve të para, përdorimin e burimeve natyrore dhe menaxhimin e ndikimeve mjedisore. Kjo mund të përfshijë dhënien e informacioneve shpjeguese rreth qasjes që ndiqet kur lindin tensione midis parandalimit ose zbutjes së ndikimeve negative materiale dhe presioneve të tjera të biznesit.

36. Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues gjithashtu nëse çështje dhe **incidente** të rënda të të drejtave të njeriut të lidhura me **komunitetet e prekura** janë raportuar dhe, nëse është e aplikueshme, t'i shtjellojë këto <sup>(124)</sup>.
37. ► **C1** Kur jepet informacioni i kërkuar sipas paragrafit 32, njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë ESRS 2 MDR-T *Ndjekja e efektivitetit të politikave dhe veprimeve përmes objektivave*, nëse vlerëson efektivitetin e një veprimi duke vendosur një objektivi. ◀
38. Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese se cilat burime janë përcaktuar për menaxhimin e ndikimeve të saj materiale, së bashku me informacionin që u mundëson **përdoruesve** për të kuptuar se si menaxhohen ndikimet materiale.

## Metrikat dhe objektivat

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S3-5 – Objektivat që lidhen me menaxhimin e ndikimeve negative materiale, avancimin e ndikimeve pozitive dhe menaxhimin e rreziqeve dhe mundësive materiale*

39. **Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për objektivat e përcaktuara në kohë dhe të orientuara drejt rezultateve që mund të ketë vendosur në lidhje me:**
  - (a) **zvogëlimin e ndikimeve negative në komunitetet e prekura; dhe/ose**
  - (b) **avancimin e ndikimeve pozitive në komunitetet e prekura; dhe/ose**
  - (c) **menaxhimin e rreziqeve dhe mundësive materiale që lidhen me komunitetet e prekura.**
40. Objektivi i kësaj Kërkesë për dhënie informacione shpjeguese është të mundësojë një kuptim të masës në të cilën njësia ekonomike po përdor **objektiva** të kufizuara në kohë dhe të orientuara drejt rezultateve për të nxitur dhe matur progresin e saj në adresimin e ndikimeve negative materiale dhe/ose avancimin e ndikimeve pozitive në komunitetet e prekura dhe/ose në menaxhimin e rreziqeve dhe mundësive materiale që lidhen me komunitetet e prekura.

---

<sup>124</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues shtesë që lidhet me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohet nga treguesi #14 në Tabelën III të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e rregullat e dhënies së informacionit shpjegues mbi investimet e qëndrueshme ("Numri i rasteve të identifikuar të çështjeve dhe incidenteve të rënda të të drejtave të njeriut").

41. Përshkrimi i përmbledhur i **objektivave** për të menaxhuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë e saj materiale që lidhen me **komunitetet e prekura** duhet të përmbajë kërkesat e informacionit të përcaktuara në ESRS 2 MDR -T.
42. Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese procesin për përcaktimin e **objektivave**, duke përfshirë nëse dhe si njësia ekonomike është angazhuar drejtpërdrejt me komunitetet e prekura, me përfaqësuesit e tyre legjitimë ose me **përfaqësues të besueshëm** që kanë njohuri për situatën e tyre në:
- (a) vendosjen e çdo objekti të tillë;
  - (b) ndjekjen e performancës së njësisë ekonomike kundrejt tyre; dhe
  - (c) identifikimin e çdo mësimi ose përmirësimi si rezultat i performancës së njësisë ekonomike.

## Shtojca A. Kërkesat për Zbatim

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e ESRS S3 *Komunitetet e prekura*. Ajo mbështet zbatimin e kërkesave për dhënie informacion shpjegues të përcaktuara në këtë standard dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të këtij standardi.

### Objektivi

- AR 1. Përmbledhja e çështjeve sociale dhe të të drejtave të njeriut e dhënë në paragrafin 2 nuk ka për qëllim të nënkuptojë që për të gjitha këto çështje duhet të jepet informacion shpjegues në secilën Kërkesë për dhënie informacione shpjeguese në këtë Standard. Përkundrazi, ajo ofron një listë çështjesh që njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë në vlerësimin e **materialitetit** të saj (shih te ESRS 1 kapitulli 3 *Materialiteti i dyfishtë si bazë për dhënie informacione shpjeguese të qëndrueshmërisë* dhe ESRS 2 IRO-1) në lidhje me **komunitetet e prekura** dhe sipas rastit, të japë informacione shpjeguese si të ishin ndikime, rreziqe dhe mundësi materiale brenda fushëveprimit të këtij Standardi.
- AR 2. Përveç çështjeve të listuara në paragrafin 2, njësia ekonomike mund të marrë në konsideratë edhe dhënien e informacionit rreth çështjeve të tjera që lidhen me një ndikim material për një periudhë më të shkurtër kohore, për shembull iniciativat në lidhje me ndikimet në komunitete që lidhen me aktivitetet e ndërmarrjes për shkak të kushteve ekstreme dhe të papritura të motit.

## ESRS 2 Dhënie informacione shpjeguese të përgjithshme

### Strategjia

#### Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese në lidhje me standardin ESRS 2 SBM-2 – Interesat dhe pikëpamjet e palëve të interesuara

- AR 3. Kërkesat për Dhënie Informacione Shpjeguese ESRS 2 SBM-2 kërkon që njësia ekonomike të ofrojë një kuptueshmëri nëse dhe si e konsideron rolin që strategjia dhe **modeli i saj i biznesit** mund të luajë rol në krijimin, përkeqësimin ose zbutjen e **ndikimeve** të rëndësishme materiale mbi **komunitetet e prekura**, dhe nëse po, si modeli dhe strategjia e biznesit përshtaten për të adresuar ndikime të tilla materiale.
- AR 4. Ndërsa **komunitetet e prekura** mund të mos jenë duke u angazhuar me njësinë ekonomike në nivelin e strategjisë ose **modelit të saj të biznesit**, pikëpamjet e tyre mund të ndikojnë në vlerësimin e njësisë ekonomike për strategjinë dhe modelin e saj të biznesit. Njësia ekonomike mund të paraqesë pikëpamjet e komuniteteve të prekura dhe përfaqësuesve të komuniteteve të prekura.

#### Kërkesa për Informacione Shpjeguese në lidhje me standardin ESRS 2 SBM -3 - Ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit

- AR 5. **Ndikimet** mbi **komunitetet e prekura** të njësisë ekonomike mund të burojnë nga strategjia ose **modeli i saj i biznesit** në mënyra të ndryshme. Për shembull, ndikimet mund të lidhen me propozimin e vlerës së njësisë ekonomike (si p.sh., ndërtimi ose fillimi i projekteve me afate kohore që nuk lejojnë kohë të mjaftueshme për konsultim me grupet e prekura nga projektet), me **zinxhirin e saj të vlerës** (për shembull, **përdorimi i tokës** në vendet ku pronësia shpesh kontestohet ose të dhënat nuk janë të besueshme ose në të cilat përdoruesit e tokës, siç janë **popujt indigjenë**, nuk njihen), ose me strukturat e kostos dhe modelin i të ardhurave (siç janë strategjitë agresive për të minimizuar taksimin, veçanërisht në lidhje me aktivitetet në vendet në zhvillim).
- AR 6. Ndikimet tek **komunitetet e prekura** të njësisë ekonomike që burojnë nga strategjia ose modeli i biznesit mund të sjellin edhe rreziqe materiale për njësinë ekonomike. Për shembull, kur strategjia e njësisë ekonomike përfshin zhvendosje gjeografike me rrezik më të lartë në ndjekje të mallrave të caktuara, dhe nëse komunitetet e prekura i rezistojnë pranisë së saj ose kundërshtojnë praktikën e saj lokale, kjo mund të krijojë vonesa të gjera dhe të kushtueshme, dhe të ndikojë në aftësinë e ndërmarrjes për të siguruar koncesione ose leje të tokës në të ardhshmen. Në mënyrë të ngjashme, nëse modeli i biznesit të njësisë ekonomike mbështetet në nxjerrjen intensive të ujit në impiantet e saj, në masën që ndikon në qasjen e ujit për konsumin, higjienën dhe jetesën e komuniteteve, kjo mund të rezultojë në bojkote, ankesa dhe padi që dëmtojnë reputacionin.

- AR 7. Shembuj të karakteristikave të veçanta të **komuniteteve të prekura** që mund të merret në konsideratë nga njësi ekonomike kur i përgjigjet paragrafit 10 mund të jetë një komunitet i prekur që është i izoluar fizikisht ose ekonomikisht dhe është veçanërisht i ndjeshëm ndaj sëmundjeve të futura ose ka qasje të kufizuar në shërbimet sociale dhe për këtë arsye mbështetet në infrastrukturën e ngritur nga njësi ekonomike. Mund të jetë për shkak se kur toka e punuar nga gratë blihet nga njësi ekonomike dhe pagesat shkojnë tek kryefamiljarët meshkuj, gratë privohen më tej nga e drejta e votës në komunitet. Mund të jetë gjithashtu për shkak se komuniteti është indigjen dhe anëtarët e tij kërkojnë të ushtrojnë të drejta kulturore ose ekonomike për tokën në pronësi ose në përdorim nga njësi ekonomike - ose nga një nga subjektet me të cilat ajo ka një marrëdhënie biznesi - në një kontekst ku të drejtat e tyre nuk mbrohen nga shteti. Përveç kësaj, njësi ekonomike duhet të marrë në konsideratë nëse karakteristika të ndryshme mbivendosen me njëra-tjetrën. Për shembull, karakteristika të tilla si etnia, statusi socioekonomik, statusi i migrantit dhe gjinia mund të krijojnë rreziqe të mbivendosura dëmi për disa komunitete të prekura ose për pjesë të dallueshme të atyre komuniteteve të prekura, pasi komunitetet e prekura shpesh janë heterogjene në natyrë.
- AR 8. Lidhur me paragrafin 11, rreziqet materiale mund të lindin edhe për shkak të varësisë së njësisë ekonomike nga **komunitetet e prekura** ku ngjarjet me probabilitet të ulët, por me ndikim të lartë, mund të shkaktojnë **efekte financiare**; për shembull, kur një fatkeqësi natyrore çon në një aksident katastrofik industrial që përfshin aktivitetet e njësisë ekonomike, duke rezultuar në dëme të rënda për komunitetet e prekura.

*Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë*

Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S3-1 – Politikat që lidhen me komunitetet e prekura

- AR 9. Përshkrimi duhet të përfshijë informacionin kryesor të nevojshëm për të siguruar një përfaqësim besnik të politikave në lidhje me **komunitetet e prekura** dhe për këtë arsye, njësi ekonomike duhet të marrë në konsideratë shpjegimet e ndryshimeve të rëndësishme në politikat e miratuara gjatë vitit raportues (për shembull, qasje të reja ose shtesë ndaj angazhimit, kujdesit të duhur dhe mjeteve juridike).
- AR 10. Kur jepet informacion shpjegues për përputhshmërinë e politikave të saj me Parimet Udhëzuese të OKB-së mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut, njësi ekonomike duhet të marrë në konsideratë që Parimet Udhëzuese i referohen Deklaratës Ndërkombëtare të të Drejtave, e cila përbëhet nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe dy Paktet që e zbatojnë atë, si dhe Deklaratën e OKB-së mbi të Drejtat e Popujve Indigjenë, Konventën e Organizatës Ndërkombëtare të Punës në lidhje me Popujt Indigjenë dhe Fisnorë (ILO Nr. 169) dhe konventat kryesore që e mbështesin atë, dhe mund të tregojë përputhshmërinë e saj me këto instrumente.

- AR 11. Njësia ekonomike mund të ofrojë një ilustrim të llojeve të komunikimit të politikave të saj për ata individë, grupe individësh ose subjekte për të cilët ato janë të rëndësishme, qoftë sepse pritet që ata t'i zbatojnë ato (për shembull, **punonjësit**, kontraktorët dhe **furnizuesit** e njësive ekonomike), ose sepse ata kanë një interes të drejtpërdrejtë në zbatimin e tyre (për shembull, punëtorët e saj, investitorët). Ajo mund të japë mjetet e informacionit dhe kanalet e komunikimit (për shembull, fletushka, buletine, faqe interneti të dedikuara, media sociale, ndërveprime ballë për ballë, përfaqësues të punëtorëve), që synojnë të sigurojnë që politika arrin tek të interesuarit dhe që audienca të ndryshme të kuptojnë implikimet e saj. Njësia ekonomike mund të shpjegojë gjithashtu se si identifikon dhe heq pengesat e mundshme që pengojnë përhapjen, siç është përkthimi në gjuhët përkatëse ose përdorimi i përshkrimeve grafike.
- AR 12. Kur jepet informacion për çështje dhe **incidente** të rënda të të drejtave të njeriut të lidhura me komunitetet e prekura, njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë çdo mosmarrëveshje ligjore që lidhet me të drejtat e tokës dhe me **pëlqimin e lirë, paraprak dhe të informuar të popujve indigjenë**.

Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S3-2 – Proceset për angazhimin me komunitetet e prekura në lidhje me ndikimet

- AR 13. Shpjegime se si njësia ekonomike merr në konsideratë dhe siguron respektimin e të drejtës së popujve indigjenë **për pëlqim të lirë, paraprak dhe të informuar** mund të përfshijë informacion në lidhje me proceset e konsultimit me popujt indigjenë për të marrë një pëlqim të tillë. Njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë se si konsultimi përfshin një negociim me mirëbesim me **popujt indigjenë** të prekur për të marrë pëlqimin e tyre të lirë, paraprak dhe të informuar kur njësia ekonomike ndikon tek tokat, territoret ose burimet që popujt indigjenë zakonisht i zotërojnë, i zënë ose i përdorin në një lloj forme; ose i zhvendos ata nga toka ose territoret që i përkisnin pronësisë tradicionale ose përdorimit ose zënies së zakonshme; ose ndikon ose shfrytëzon pronën e tyre kulturore, intelektuale, fetare dhe shpirtërore.
- AR 14. Njësia ekonomike, kur përshkruan se cili funksion ose rol ka përgjegjësi operative për një angazhim të tillë dhe/ose llogaridhënie përfundimtare, mund të japë informacion nëse ky është një rol ose funksion i dedikuar apo pjesë e një roli ose funksioni më të gjerë, dhe nëse janë ofruar aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për të mbështetur stafin për të ndërmarrë angazhime. Nëse njësia ekonomike nuk mund të identifikojë një pozicion ose funksion të tillë, ajo mund ta deklarojë një fakt të tillë. Kjo dhënie informacioni shpjegues mund të përmbushet gjithashtu duke iu referuar informacionit të dhënë sipas ESRS 2 GOV-1 Roli i organeve administrative, menaxhuese dhe mbikëqyrëse.
- AR 15. ► **C1** Gjatë përgatitjes së deklarimeve të përshkruara në paragrafin 21 b) dhe c), mund të merren në konsideratë ilustrimet e mëposhtme për: ◀

- (a) shembuj të fazave në të cilat ndodhet angazhimi të cilat janë i) përcaktimi i qasjes ndaj zbutjes së ndikimeve dhe ii) vlerësimi i efektivitetit të zbutjes së ndikimeve;
- (b) llojet e angazhimit, që mund të jenë pjesëmarrje, konsultim dhe/ose informacion;
- (c) për frekuencën e angazhimit, mund të jepet informacion nëse angazhimi ndodh rregullisht, në pika të caktuara të një projekti ose procesi biznesi; dhe
- (d) rolin që ka përgjegjësi operacionale, nëse njësia ekonomike kërkon që stafi përkatës të ketë aftësi të caktuara, apo nëse ofron **trajtime** ose ndërtimi i kapaciteteve të stafit përkatës për të ndërmarrë angazhime. Në rastin e ndikimeve materiale, rreziqeve dhe mundësive që lidhen me **popujt indigjenë**, kjo përfshin trajnimin mbi të drejtat e popujve indigjenë, duke përfshirë pëlqimin e lirë, paraprak dhe të informuar.

AR 16. Për të ilustruar se si perspektivat e komuniteteve kanë ndikuar vendime ose aktivitete specifike të njësisë ekonomike, njësia ekonomike mund të japë shembuj nga periudha aktuale e raportimit.

Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S3-3 – Proceset për të ndrequr ndikimet negative dhe kanalet e komunikimit për komunitetet e prekura për të ngritur shqetësime

AR 17. Në përmbushjen e kërkesave të përcaktuara nga Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese ESRS S3-3, njësia ekonomike mund të udhëhiqet nga përmbajtja e Parimeve Udhëzuese të OKB-së mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut dhe Udhëzimet e OECD-së për Ndërmarrjet Shumëkombëshe të fokusuar në **veprimet korigjuese** dhe **mekanizmat e ankesave**.

AR 18. Kanalet për ngritjen e shqetësimeve ose nevojave përfshijnë **mekanizmat e ankesave**, linjat telefonike, proceset e dialogut ose mjete të tjera përmes të cilave **komunitetet e prekura** ose **përfaqësuesve të tyre legjitimë** mund të ngrenë shqetësime në lidhje me ndikimet ose të shpjegojnë nevojat që do të donin që njësia ekonomike të adresonte. Kjo mund të përfshijë kanalet e ofruara nga njësia ekonomike drejtpërdrejt, përveç çdo mekanizmi tjetër që njësia ekonomike mund të përdorë për të fituar njohuri mbi menaxhimin e ndikimeve në komunitete, siç janë auditimet e përputhshmërisë. Kur njësia ekonomike mbështetet vetëm në informacionin në lidhje me ekzistencën e kanaleve të tilla të ofruara nga **marrëdhëniet e saj të biznesit** për t'iu përgjigjur kësaj kërkesë, ajo duhet ta deklarojë këtë fakt.

AR 19. Për të ofruar një pasqyrë më të gjerë të informacionit të mbuluar në ESRS S3-3, njësia ekonomike mund të shpjegojë nëse dhe si komunitetet që mund të preken janë në gjendje të kenë qasje në kanale në nivelin e njësisë ekonomike nga e cila preken, në lidhje me secilin ndikim material. Informacionet përkatëse përfshijnë informacion nëse **komunitetet e prekura** mund të hyjnë në kanale në një gjuhë që e kuptojnë dhe nëse janë konsultuar me ta në hartimin e kanaleve të tilla.

AR 20. Mekanizmat e palëve të treta mund të përfshijnë ato që veprojnë në emër të institucioneve qeveritare, OJQ-të, shoqatat e industrisë dhe nisma të tjera bashkëpunuese. Njësia ekonomike mund të japë informacione shpjeguese nëse këto janë të arritshme për të gjithë **komunitetet**

**e prekura** që mund të preken potencialisht ose realisht në mënyrë materiale nga njësi ekonomike, ose nga individët ose organizatat që veprojnë në emër të tyre ose që janë në një pozicion tjetër për të qenë të vetëdijshëm për ndikimet negative.

- AR 21. Në lidhje me mbrojtjen e individëve që përdorin mekanizmat kundër hakmarrjes, njësi ekonomike mund të përshkruajë nëse i trajton ankesat në mënyrë konfidenciale dhe në lidhje me të drejtat e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave; dhe nëse mekanizmat mund të përdoren në mënyrë anonime (për shembull, përmes përfaqësimit nga një palë e tretë).
- AR 22. Kur jepet informacion shpjegues për proceset që lidhen me ofrimin e **kompensimit** për **popujt indigjenë**, informacioni përkatës përfshin nëse dhe si njësi ekonomike i ka marrë në konsideratë zakonet, traditat, rregullat dhe sistemet e tyre ligjore.
- AR 23. Në dhënien e informacioneve shpjeguese nëse dhe si njësi ekonomike ka informacion që **komunitetet e prekura** janë të vetëdijshëm dhe u besojnë ndonjërit prej këtyre kanaleve, njësi ekonomike mund të ofrojë të dhëna përkatëse dhe të besueshme në lidhje me efektivitetin e këtyre kanaleve nga perspektiva e vetë komuniteteve të prekura. Shembuj të burimeve të informacionit janë anketat e komunitetit që kanë përdorur kanale të tilla dhe shkalla e tyre e vlerësimit (kënaqësisë) për procesin dhe rezultatet.
- AR 24. Në përshkrimin e efektivitetit të kanaleve për të ngritur shqetësime për **komunitetet e prekura**, njësi ekonomike mund të udhëhiqet nga pyetjet e mëposhtme, bazuar në "kriteret e efektivitetit për **mekanizmat** jo-gjyqësorë **të ankesave**", siç përcaktohen në Parimet Udhëzuese të OKB-së për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut, në veçanti Parimin 31. Konsideratat e mëposhtme mund të zbatohen për kanalet individuale ose për një sistem kolektiv kanalesh komunikimi:
- (a) a kanë kanalet e komunikimit legjitimitet për të ofruar llogaridhënie të përshtatshme për sjelljen e tyre të drejtë dhe për të ndërtuar besimin e palëve të interesuara?
  - (b) a janë kanalet e komunikimit të njohura dhe të arritshme për palët e interesuara?
  - (c) a kanë kanalet procedura të qarta dhe të njohura, afate kohore të përcaktuara dhe qartësi mbi proceset?
  - (d) a sigurojnë kanalet qasje të arsyeshëm drejt burimeve të informacionit, këshillave dhe ekspertizës?
  - (e) a ofrojnë kanalet transparencë duke u ofruar informacion të mjaftueshëm si ankuesve ashtu edhe, kur është e aplikueshme, për të përmbushur çdo interes publik në fjalë?
  - (f) a përputhen rezultatet e arritura përmes kanaleve me të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht?
  - (g) a identifikon njësi ekonomike njohuri nga kanalet që mbështesin edukimin e vazhdueshëm si në përmirësimin e kanaleve ashtu edhe në parandalimin e ndikimeve të ardhshme?

(h) a përqendrohet njësia ekonomike në dialogun me ankuesit si mjet për të arritur zgjidhje të dakordësuara, në vend që të përpiqet të përcaktojë në mënyrë të njëanshme rezultatin?

Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S3-4 – Ndërmarrja e veprimeve mbi ndikimet materiale në komunitetet e prekura, dhe qasjet për zbutjen e rreziqeve materiale dhe ndjekjen e mundësive që lidhen me komunitetet e prekura dhe efektiviteti i këtyre veprimeve

AR 25. Mund të duhet kohë për të kuptuar ndikimet negative dhe se si njësia ekonomike mund të jetë e përfshirë në to përmes zinxhirit të saj të vlerës, si dhe për të identifikuar përgjigjet e duhura dhe për t'i vënë ato në praktikë. Prandaj, njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë:

- (a) qasjet e saj të përgjithshme dhe specifike për adresimin e ndikimeve negative materiale;
- (b) investimin e saj social ose programe të tjera **zhvillimi** që synojnë të kontribuojnë në ndikime pozitive materiale shtesë;
- (c) sa ka përparuar në përpjekjet e saj gjatë periudhës së raportimit; dhe
- (d) synimet e saj për përmirësim të vazhdueshëm.

AR 26. Veprimet e duhura mund të ndryshojnë në varësi të faktit nëse njësia ekonomike shkakton ose kontribuon në një ndikim material ose nëse ndikimi material lidhet drejtpërdrejt me veprimet, produktet ose shërbimet e saj përmes një marrëdhënieje biznesi.

AR 27. Duke pasur parasysh se ndikimet negative materiale që prekin komunitetet e prekura që kanë ndodhur gjatë periudhës raportuese mund të jenë të lidhura edhe me njësi ose veprimtari të tjera jashtë kontrollit të saj të drejtpërdrejtë, njësia ekonomike mund të japë informacion nëse dhe si kërkon të përdorë ndikimin e saj në **marrëdhëniet** e saj të biznesit për të menaxhuar këto ndikime. Kjo mund të përfshijë përdorimin e **ndikimit tregtar** (për shembull, zbatimi i kërkesave kontraktuale me marrëdhëniet e biznesit ose zbatimi i stimuljeve), formave të tjera të ndikimit brenda marrëdhënies (siç është ofrimi i **trajnit** ose ndërtimi i kapaciteteve mbi të drejtat e popujve indigjenë për subjektet me të cilat njësia ekonomike ka marrëdhënie biznesi) ose ndikimin bashkëpunues me kolegët ose aktorë të tjerë (siç janë iniciativat që synojnë minimizimin e ndikimeve të lidhura me sigurinë në komunitete ose pjesëmarrja në partneritete kompani-komunitet).

AR 28. Ndikimet në komunitete mund të rrjedhin nga çështjet mjedisore të cilat trajtohen dhe përcillen nga njësia ekonomike sipas ESRS E1 deri në E5. Shembujt përfshijnë:

- (a) ESRS E1 **Ndryshimet Klimatike**: Zbatimi i planeve të **zbutjes së ndryshimeve klimatike** mund të kërkojnë që njësia ekonomike të investojë në projekte të **energjisë së rinovueshme** që mund të ndikojnë në toka, territore dhe **burime natyrore të popujve indigjenë**. Nëse njësia ekonomike nuk konsultohet me popujt indigjenë të prekur, kjo

mund të ndikojë negativisht në të drejtën e komuniteteve të prekura për **pëlqim të lirë, paraprak dhe të informuar**;

- (b) ESRS E2 *Ndotja*: Njësia ekonomike mund të ndikojë negativisht në **komunitetet e prekura** duke dështuar në mbrojtjen e tyre nga **ndotja** prej një strukturë të caktuar prodhimi që u shkakton atyre probleme shëndetësore;
- (c) ESRS E3 *Burimet ujore dhe detare*: Njësia ekonomike mund të ndikojë negativisht në aksesin e komuniteteve në ujë të pijshëm të pastër kur tërheq ujin në drejtim të zonave me burime të kufizuara ujore (zona nën stres ujor);
- (d) ESRS E4 *Biodiversiteti dhe ekosistemet*: Njësia ekonomike mund të ndikojë negativisht në jetesën e fermerëve vendas përmes operacioneve që ndotin **tokën**. Shembuj të tjerë përfshijnë izolimin e tokës përmes ndërtimit të infrastrukturës së re, e cila mund të zhdukë speciet bimore që janë kritike për **biodiversitetin** vendas ose për të filtruar ujin për komunitetet; ose futjen e **specieve pushtuese** (qofshin bimë apo kafshë) që mund të ndikojnë në **ekosisteme** dhe të shkaktojë dëme të mëvonshme;
- (e) ESRS E5 *Përdorimi i burimeve dhe ekonomia rrethore*: Njësia ekonomike mund të ndikojë negativisht në jetën e komuniteteve duke ndikuar në shëndetin e tyre përmes keqmenaxhimit të **mbetjeve të rrezikshme**.

Kur lidhja midis ndikimeve mjedisore dhe komuniteteve lokale trajtohet në informacionet shpjeguese sipas ESRS E1-E5, njësia ekonomike mund të bëjë referenca të kryqëzuara me ato dhe t'i identifikojë qartë këto informacione shpjeguese.

AR 29. Kur njësia ekonomike informon për pjesëmarrjen e saj në një industri ose një iniciativë me shumë palë të interesuara si pjesë e **aktiviteteve** të saj për të adresuar ndikimet negative materiale, njësia ekonomike mund të japë informacion se si iniciativa, dhe përfshirja e saj, synon të adresojë ndikimin material në fjalë. Ajo mund të japë informacion shpjegues sipas ESRS S3-5 **objektivat** përkatëse të përcaktuara nga iniciativa dhe progresi drejt tyre.

AR 30. Kur njësia ekonomike jep informacione shpjeguese nëse dhe si ajo merr në konsideratë ndikimet aktuale dhe të mundshme mbi **komunitetet e prekura** në vendimet që merr për të ndërprerë **marrëdhëniet e biznesit** dhe nëse dhe si synon të adresojë çdo ndikim negativ që mund të rezultojë nga kjo ndërprerje, njësia ekonomike mund të përfshijë shembuj.

AR 31. Në dhënien e informacionit shpjegues se si gjurmon efektivitetin e **veprimeve** për të menaxhuar ndikimet materiale gjatë periudhës së raportimit, njësia ekonomike mund të japë informacione shpjeguese për çdo mësim të nxjerrë nga periudhat e mëparshme dhe aktuale të raportimit.

AR 32. Proceset e përdorura për të ndjekur efektivitetin e **veprimeve** mund të përfshijnë një auditim ose verifikim të brendshëm ose të jashtëm, procedura gjyqësore dhe/ose vendime gjyqësore përkatëse, vlerësime të ndikimit, sisteme matjeje, reagime nga palët e interesuara, **mekanizma ankimi**, vlerësime të performancës së jashtme dhe krahasime.

AR 33. Raportimi mbi efektivitetin synon të mundësojë kuptimin e lidhjeve midis **veprimeve** të ndërmarra nga një njësi ekonomike dhe menaxhimit efektiv të ndikimeve.

AR 34. Lidhur me iniciativat ose proceset qëllimi kryesor i të cilave është të japin ndikime pozitive për komunitetet e prekura që bazohen në nevojat e tyre, dhe në lidhje me progresin në zbatimin e iniciativave ose proceseve të tilla, njësi ekonomike mund të japë informacionin e mëposhtëm:

- (a) informacion nëse dhe si **komunitetet e prekura** dhe **përfaqësuesit legjitimë** ose **përfaqësuesit e tyre të besueshëm** luajnë një rol në vendimet që kanë të bëjnë me hartimin dhe zbatimin e këtyre programeve ose proceseve; dhe
- (b) informacion në lidhje me rezultatet pozitive të synuara ose të arritura për **komunitetet e prekura** të këtyre iniciativave ose proceseve.
- (c) një shpjegim të fushëveprimit të përafërt të **komuniteteve të prekura** të mbuluara nga investimet sociale ose programet e **zhvillimit** të përshkruar, dhe, kur është e zbatueshme, arsyetimin pse komunitetet e përzgjedhura u zgjodhën për zbatimin e një investimi të caktuar social ose të një programi zhvillimi.

AR 35. Njësi ekonomike mund të japë informacione shpjeguese nëse është marrë ndonjë iniciativë ose proces, qëllimi kryesor i të cilit është të japë ndikime pozitive për **komunitetet e prekura** gjithashtu për të mbështetur arritjen e një ose më shumë Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) të OKB-së. Për shembull, përmes një angazhimi për të çuar përpara SDG 5 të OKB-së për "arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave", njësi ekonomike mund të jetë duke marrë masa të menduara mirë për të përfshirë gratë në procesin e konsultimit me një komunitet të prekur për të përmbushur standardet e **angazhimit të palëve të interesuara**, gjë që mund të ndihmojë në fuqizimin e grave në vetë procesin, por potencialisht edhe në jetën e tyre të përditshme.

AR 36. Kur jepet informacion shpjegues për rezultatet pozitive të synuara ose të arritura të **veprimeve** të saj për **komunitetet e prekura** duhet bërë një dallim midis provave të aktiviteteve të caktuara që kanë ndodhur (për shembull, që x numër anëtarësh gra të komunitetit janë **trajnuar** se si të bëhen **furnizuese** vendase të njësisë ekonomike) nga provat e rezultateve aktuale për komunitetet e prekura (për shembull, që x gra anëtare të komunitetit kanë ngritur biznese të vogla dhe u janë rinovuar kontratat me njësinë ekonomike vit pas viti).

AR 37. Kur njësi ekonomike jep informacion shpjegues nëse iniciativat ose proceset luajnë gjithashtu një rol në zbutjen e ndikimeve negative materiale, ajo mund të marrë në konsideratë, për shembull, programe që synojnë të përmirësojnë infrastrukturën lokale që rrethon aktivitetet e një njësie ekonomike, të tilla si përmirësimet në rrugë që çojnë në një ulje të numrit të aksidenteve të rënda rrugore që përfshijnë anëtarë të komunitetit.

AR 38. Kur jepet informacion shpjegues për rreziqet dhe mundësitë materiale që lidhen me ndikimet ose **varësitë** e njësisë ekonomike nga komunitetet e prekura njësia ekonomike mund të marrë në konsideratë sa vijon:

- (a) rreziqet që lidhen me ndikimet e njësisë ekonomike në **komunitetet e prekura** mund të përfshijë ekspozim reputacional ose ligjor, si dhe rreziqet operacionale, ku komunitetet e prekura protestojnë kundër zhvendosjeve ose mohimit të qasjes në tokat e tyre, duke çuar në vonesa, bojkote ose padi të kushtueshme;
- (b) rreziqet që lidhen me varësinë e njësisë ekonomike nga **komunitetet e prekura** mund të përfshijë ndërprerjen e veprimtarive të biznesit aty ku **popujt indigjenë** vendosin të mos japin pëlqimin e tyre për një projekt në tokat e tyre, duke e detyruar njësinë ekonomike ta modifikojë ose ta braktisë ndjeshëm projektin;
- (c) ► **C1** mundësitë që lidhen me ndikimet e njësisë ekonomike në **komunitetet e prekura** që mund të përfshijë financim më të lehtë të projekteve dhe të qenit një partner i zgjedhur për komunitetet, qeveritë dhe bizneset e tjera; dhe ◀
- (d) mundësitë që lidhen me varësitë e njësisë ekonomike nga **komunitetet e prekura** që mund të përfshijë zhvillimin e marrëdhënieve pozitive midis njësisë ekonomike dhe popujve indigjenë që mundësojnë zgjerimin e projekteve ekzistuese me mbështetje të fortë.

AR 39. ► **C1** Gjatë dhënies së informacionit shpjegues sipas AR 38, njësia ekonomike mund të marrë në konsideratë shpjegimet e rreziqeve dhe mundësive që rrjedhin nga ndikimet ose **varësitë** mjedisore (ju lutemi referojuni AR 28 për më shumë detaje), duke përfshirë ndikimet e lidhura me të drejtat e njeriut (ose ndikimet sociale). ◀ Shembujt përfshijnë rreziqet e reputacionit që rrjedhin nga ndikimi në shëndetin e komuniteteve prej **shkarkimeve** ndotëse të pakontrolluara; ose **efektet financiare** të protestave që mund të prishin ose ndërpresin aktivitetet e një njësie ekonomike, për shembull, në përgjigje të veprimeve në zona që kanë deficit ujor që mund të ndikojnë në jetën e komuniteteve të prekura.

AR 40. Kur jepet informacion shpjegues nëse **varësitë** shndërrohen në **rreziqe**, njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë zhvillimet e jashtme.

AR 41. Kur njësia ekonomike paraqet informacion shpjegues për politikat, veprimet dhe burimet dhe **objektivat** lidhur me menaxhimin e rreziqeve materiale dhe mundësive, në rastet kur rreziqet dhe mundësitë lindin nga një ndikim material, njësia ekonomike mund të kryqëzojë referencat për deklaratimet e saj mbi politikat, veprimi dhe burimet dhe objektivat në lidhje me atë ndikim.

AR 42. Njësia ekonomike duhet të shqyrtojë nëse dhe si proceset e saj për të menaxhuar rreziqet materiale që lidhen me **komunitetet e prekura** janë të integruara në proceset e saj ekzistuese të menaxhimit të riskut.

AR 43. Kur paraqet informacion shpjegues për burimet e alokuara për menaxhimin e ndikimeve materiale, njësia ekonomike mund të shpjegojë se cilat funksione të brendshme janë të

përfshira në menaxhimin e ndikimeve dhe çfarë lloje veprimesh ndërmarrin ata për të adresuar ndikimet negative dhe për të çuar përpara ndikimet pozitive.

### *Metrikat dhe objektivat*

#### Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S3-5 – Objektivat që lidhen me menaxhimin e ndikimeve negative materiale, avancimin e ndikimeve pozitive dhe menaxhimin e rreziqeve dhe mundësive materiale

- AR 44. ► **C1** Kur paraqitet informacion shpjegues rreth **objektivave** në përputhje me paragrafin 39, njësia ekonomike mund të japë informacion për: ◀
- (a) rezultatet e synuara që duhen arritur në jetë e komuniteteve të prekura, duke qenë sa më specifike të jetë e mundur;
  - (b) stabilitetin e **objektivave** me kalimin e kohës në aspektin e përkufizimeve dhe metodologjive për të mundësuar krahasueshmërinë me kalimin e kohës;
  - (c) standardet ose angazhimet mbi të cilat bazohen objektivat (për shembull kodet e sjelljes, politikat e furnizimit, kornizat globale ose kodet e industrisë).
- AR 45. **Synimet** e lidhura me **rreziqet** dhe **mundësitë** materiale mund të jenë të njëjta ose të ndryshme nga objektivat që lidhen me ndikimet materiale. Për shembull, një objektivi për të rivendosur plotësisht jetesën e **komuniteteve të prekura** pas zhvendosjes, mund të zvogëlojë si ndikimet në ato komunitete ashtu dhe rreziqet që lidhen me to, siç janë protestat e komunitetit.
- AR 46. Njësia ekonomike mund të bëjë gjithashtu dallimin midis **objektivave** afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë që mbulon të njëjtën **politikë** angazhim. Për shembull, njësia ekonomike mund të ketë si objektivi kryesor punësimin e anëtarëve të komunitetit në një **kantier** minierash lokale, me qëllimin afatgjatë të punësimit 100% të stafit lokal deri në vitin 2025, dhe me objektivin afatshkurtër të shtimit të x përqind të **punonjësve** lokalë çdo vit deri në vitin 2025.
- AR 47. Kur modifikon ose zëvendëson një objektivi në periudhën raportuese, njësia ekonomike mund ta shpjegojë ndryshimin duke e krahasuar atë me ndryshime të rëndësishme në modelin e biznesit ose me ndryshime më të mëdha në standardin ose legjislacionin e pranuar nga i cili rrjedh objektivi për të dhënë informacion kontekstual sipas ESRS 2 BP-2 *Deklaratave në lidhje me rrethana specifike*.

## ESRS S4. KONSUMATORËT DHE PËRDORUESIT FUNDORË

### Përmbajtja

<b>Objektivi .....</b>	<b>347</b>
<b>Ndërveprimi me Standardet e tjera ESRS .....</b>	<b>348</b>
<b>Kërkesat për Dhënie Informacione Shpjeguese .....</b>	<b>349</b>
ESRS 2 Dhënie informacione shpjeguese të përgjithshme .....	349
Strategjia .....	349
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese në lidhje me ESRS 2 SBM-2 – Interesat dhe pikëpamjet e palëve të interesuara .....	349
▶ <b>C1</b> Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese në lidhje me standardin SERS 2 SBM -3– Ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit ◀ .....	349
Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë .....	351
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S4-1 – Politikat që lidhen me konsumatorët dhe përdoruesit fundorë .....	351
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S4-2 – Proceset për angazhimin me <b>konsumatorët dhe përdoruesit fundorë në lidhje me ndikimet</b> .....	352
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S4-3 – Proceset për të ndrequr ndikimet negative dhe kanale për konsumatorët dhe përdoruesit fundorë për të ngritur shqetësimet .....	353
Kërkesa për dhënie informacion shpjegues S4-4 – Ndërmarrja e veprimeve mbi ndikimet materiale tek konsumatorët dhe përdoruesit fundorë, dhe qasjet për menaxhimin e rreziqeve materiale dhe ndjekjen e mundësive materiale që lidhen me konsumatorët dhe përdoruesit fundorë, dhe efektiviteti i këtyre veprimeve .....	354
Metrikat dhe objektivat .....	356
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S4-5 – Objektivat që lidhen me menaxhimin e ndikimeve negative materiale, avancimin e ndikimeve pozitive dhe menaxhimin e rreziqeve dhe mundësive materiale .....	356
<b>Shtojca A. Kërkesat për Zbatim .....</b>	<b>357</b>
Objektivi .....	357
ESRS 2 Dhënie informacione shpjeguese të përgjithshme .....	358
Strategjia .....	358

Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese në lidhje me ESRS 2 SBM-2 – Interesat dhe pikëpamjet e palëve të interesuara .....	358
Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese në lidhje me standardin SERS 2 SBM -3– Ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit .....	358
Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë .....	359
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S4-1 – Politikat që lidhen me konsumatorët dhe përdoruesit fundorë .....	359
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S4-2 – Proceset për angazhimin me konsumatorët dhe përdoruesit fundorë në lidhje me ndikimet .....	360
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S4-3 – Proceset për të ndrequr ndikimet negative dhe kanale për konsumatorët dhe përdoruesit fundorë për të ngritur shqetësime .....	361
► <b>C1</b> Kërkesa për dhënie informacion shpjegues S4-4 – Ndërmarrja e veprimeve mbi ndikimet materiale tek konsumatorët dhe përdoruesit fundorë, dhe qasjet për menaxhimin e rreziqeve materiale dhe ndjekjen e mundësive materiale që lidhen me konsumatorët dhe përdoruesit fundorë, dhe efektiviteti i këtyre veprimeve ◀ .....	363
Metrikat dhe objektivat .....	366
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S4-5 – Objektivat që lidhen me menaxhimin e ndikimeve negative materiale, avancimin e ndikimeve pozitive dhe menaxhimin e rreziqeve dhe mundësive materiale....	366

## Objektivi

- Objektivi i këtij Standardi është të specifikojë kërkesat për informacione shpjeguese të cilat do t'u mundësojnë **përdoruesve** të **deklaratës së qëndrueshmërisë** për të kuptuar **ndikimet** materiale mbi **konsumatorët** dhe **përdoruesit fundorë** të lidhura me veprimtaritë dhe **zinxhirin e vlerës** së vetë njësisë ekonomike, përmes produkteve ose shërbimeve të saj, si dhe përmes **marrëdhënieve të saj të biznesit**, dhe **rreziqeve** të saj materiale dhe **mundësive** që lidhen me to, duke përfshirë:
  - si ndikon njësia ekonomike te konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë të produkteve dhe/ose shërbimeve të saj (të referuar në këtë Standard si "konsumatorë dhe përdorues fundorë"), në aspektin e ndikimeve materiale pozitive dhe negative aktuale ose të mundshme;

- (b) çdo **veprim** të ndërmarrë dhe rezultati i veprimeve të tilla, për të parandaluar, zbutur ose ndrequr ndikimet negative aktuale ose të pritshme, dhe për të adresuar rreziqet dhe mundësitë;
  - (c) natyrën, llojin dhe shkallën e rreziqeve dhe mundësive materiale të njësisë ekonomike që lidhen me ndikimet dhe **varësitë** e saj nga konsumatorët dhe përdoruesit fundorë, dhe si njësia ekonomike i menaxhon rreziqet dhe mundësitë e tilla; dhe
  - (d) **efektet financiare** mbi njësinë ekonomike në afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të rreziqeve dhe mundësive materiale që rrjedhin nga ndikimet dhe varësitë e njësisë ekonomike nga konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë.
2. Për të përmbushur objektivin, ky Standard kërkon një shpjegim të qasjes së përgjithshme që njësia ekonomike ndjek për të identifikuar dhe menaxhuar çdo **ndikim** material aktual dhe potencial. mbi **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë** lidhur me produktet dhe/ose shërbimet e saj në lidhje me:
- (a) ndikimet që lidhen me informacionin tek konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë (për shembull, privatësia, liria e shprehjes dhe qasja në informacion (cilësor);
  - (b) sigurinë personale të konsumatorëve dhe/ose përdoruesve fundorë (për shembull, shëndeti dhe siguria, siguria e një personi dhe mbrojtja e fëmijëve);
  - (c) përfshirjen sociale të konsumatorëve dhe/ose përdoruesve fundorë (për shembull, jo-**diskriminim**, qasje në produkte dhe shërbime dhe praktika të përgjegjshme të marketingut).
3. Ky Standard kërkon gjithashtu një shpjegim se si ndikime të tilla, si dhe **varësitë** e njësisë ekonomike nga **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë**, mund të krijojë **rreziqe** materiale ose **mundësi** për njësinë ekonomike. Për shembull, ndikimet negative në reputacionin e produkteve dhe/ose shërbimeve të njësisë ekonomike mund të jenë të dëmshme për performancën e saj të biznesit, ndërsa besimi në produkte dhe/ose shërbime mund të sjellë përfitime biznesi, të tilla si rritja e shitjeve ose zgjerimi i bazës së konsumatorëve në të ardhmen.
4. Përdorimi i paligjshëm ose keqpërdorimi i produkteve dhe shërbimeve të njësisë ekonomike nga **konsumatorët** dhe **përdoruesit fundorë** është jashtë fushëveprimit të këtij standardi.

## Ndërveprimi me Standardet e tjera ESRS

5. Ky standard zbatohet kur **ndikimet** materiale mbi dhe/ose **rreziqet** materiale dhe **mundësitë** lidhur me **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë** janë identifikuar përmes procesit të vlerësimit të **materialitetit** siç përcaktohet në ESRS 2 *Dhënie informacione të përgjithshme*.

6. Ky Standard duhet të lexohet së bashku me ESRS 1 *Kërkesat e Përgjithshme* dhe ESRS 2, si dhe ESRS S1 *Fuqia e vet punëtore*, ESRS S2 *Punonjësit në zinxhirin e vlerës* dhe ESRS S3 *Komunitetet e prekura*.

## Kërkesat për Dhënie Informacione Shpjeguese

### ESRS 2 Dhënie informacione shpjeguese të përgjithshme

7. Kërkesat e këtij seksioni duhet të lexohen së bashku me informacionet shpjeguese të kërkuara nga ESRS 2 mbi Strategjinë (SBM). Informacionet e dhëna që rezultojnë duhet të paraqiten së bashku me informacionet e kërkuara nga ESRS 2, me përjashtim të SBM-3 *Ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale dhe ndërveprimin e tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit*, për të cilat njësi ekonomike ka një mundësi për të dhënë informacione shpjeguese së bashku me informacionin tematik.

### Strategjia

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese në lidhje me ESRS 2 SBM-2 – Interesat dhe pikëpamjet e palëve të interesuara*

8. Kur i përgjigjet ESRS 2 SBM-2, paragrafi 43, njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues se si interesat, pikëpamjet dhe të drejtat e **konsumatorëve** të saj dhe/ose **përdoruesit fundorë**, duke përfshirë respektin për të drejtat e tyre të njeriut, ndikojnë në strategjinë dhe modelin e saj të biznesit. Konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë janë një grup kyç i **palëve të interesuara** të prekura.

*Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese në lidhje me standardin ESRS 2 SBM -3– Ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit*

9. Kur njësi ekonomike i përgjigjet ESRS 2 SBM-3 paragrafi 48, ajo duhet të japë këto informacione:
  - (a) nëse **ndikimet** aktuale dhe të mundshme mbi **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit** fundorë siç identifikohet në Kërkesat për dhënie informacione shpjeguese ESRS 2 IRO-1 *Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale*:
    - (i) burojnë nga ose janë të lidhura me strategjinë dhe **modelin e biznesit** të njësisë ekonomike, dhe (ii) ndikojnë dhe kontribuojnë në përshtatjen e strategjisë dhe modelit të biznesit të njësisë ekonomike, dhe si kanë ndikuar, dhe

(b) mbi marrëdhënien midis rreziqeve të saj materiale dhe mundësive që rrjedhin nga ndikimet dhe **varësitë** prej konsumatorëve dhe/ose përdoruesve fundorë me strategjinë dhe modelin e saj të biznesit.

10. Gjatë përmbushjes së kërkesave të paragrafi 48, njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese nëse të gjithë **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë** të cilët ka të ngjarë të ndikohen materialisht nga njësia ekonomike, duke përfshirë **ndikimet** që lidhen me operacionet dhe **zinxhirin e vlerës** së vetë njësisë ekonomike, përmes produkteve ose shërbimeve të saj, si dhe përmes **marrëdhënieve të saj të biznesit**, përfshihen në fushëveprimin e zbulimit të saj sipas ESRS 2. Përveç kësaj, njësia ekonomike duhet të ofrojë informacionin e mëposhtëm:

(a) një përshkrim të shkurtër të llojeve të konsumatorëve dhe/ose përdoruesve fundorë që preken nga ndikimet materiale të operacioneve të veta ose përmes rrjedhës së sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës së saj, dhe të specifikojë nëse ato janë:

- i. konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë të produkteve që janë në thelb të dëmshme për njerëzit dhe/ose rrisin rreziqet për sëmundje kronike;
- ii. konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë të shërbimeve që potencialisht ndikojnë negativisht në të drejtat e tyre për privatësi, për të pasur të dhënat e tyre personale të mbrojtura, për lirinë e shprehjes dhe për ndalimin e **diskriminimit**;
- iii. konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë që varen nga informacion i saktë dhe i arritshëm në lidhje me produktin ose shërbimin, siç janë manualët dhe etiketat e produkteve, për të shmangur përdorimin potencialisht të dëmshëm të një produkti ose shërbimi;
- iv. konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë që janë veçanërisht të prekshëm ndaj ndikimeve në shëndet ose privatësi ose ndaj ndikimeve nga strategjitë e marketingut dhe shitjeve, siç janë fëmijët ose individët financiarisht të prekshëm;

(b) në rastin e ndikimeve negative materiale, të paraqesë nëse ato janë (i) të përhapura gjerësisht apo sistemike në kontekstet ku njësia ekonomike shet ose ofron produktet ose shërbimet e saj (për shembull, mbikëqyrja shtetërore që ndikon në privatësinë e përdoruesve të shërbimit), ose (ii) të lidhura me **incidente** individuale (për shembull, një defekt i lidhur me një produkt të caktuar) ose me marrëdhënie specifike biznesi (për shembull, një partner biznesi përdor marketing që synon në mënyrë të papërshtatshme **konsumatorët** e rinj);

(c) në rastin e ndikimeve pozitive materiale, të paraqesë një përshkrim të shkurtër të aktiviteteve që rezultojnë në ndikime pozitive (për shembull, dizajni i produktit që përmirëson aksesin e tij për personat me aftësi të kufizuara) dhe llojet e konsumatorëve dhe/ose përdoruesve fundorë që preken pozitivisht ose mund të preken pozitivisht; njësia ekonomike gjithashtu mund të japë informacion nëse ndikimet pozitive ndodhin në vende ose rajone specifike; dhe

(d) çdo rrezik dhe mundësi materiale për biznesin që rrjedh nga ndikimet dhe varësitë prej konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë.

11. Në përshkrimin e llojeve kryesore të **konsumatorëve** dhe/ose **përdoruesve fundorë** të cilët janë ose mund të preken negativisht, bazuar në vlerësimin e **materialitetit** të përcaktuar në ESRS 2 IRO-1, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues nëse dhe si ka zhvilluar të kuptuarin se si konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë me karakteristika të veçanta, ose ata që përdorin produkte ose shërbime të veçanta, mund të jenë të rrezikuar nga një dëm më i madh.
12. Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues, nëse ndonjë nga rreziqet dhe mundësitë e saj materiale që rrjedhin nga ndikimet dhe **varësitë** nga **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë**, lidhen me grupe specifike të konsumatorëve dhe/ose përdoruesve fundorë (për shembull, grupe të caktuara moshe) në vend të të gjithë konsumatorëve dhe/ose përdoruesve fundorë.

## Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë

### *Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S4-1 – Politikat që lidhen me konsumatorët dhe përdoruesit fundorë*

13. **Njësia ekonomike duhet të përshkruajë politikat e saj të miratuara për të menaxhuar ndikimet materiale të produkteve dhe/ose shërbimeve të saj mbi konsumatorët dhe përdoruesit fundorë, si dhe rreziqet dhe mundësitë materiale që lidhen me to.**
14. Objektivi i kësaj Kërkesë për dhënie informacione shpjeguese është të mundësojë një kuptim të masës në të cilën njësia ekonomike ka politika që adresojnë identifikimin, vlerësimin, menaxhimin dhe/ose **ndreqjen** e **ndikimeve** materiale mbi **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë** në mënyrë specifike, si dhe politikat që mbulojnë rreziqet ose mundësitë materiale që lidhen me konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë.
15. Informacioni i kërkuar nga paragrafi 13 duhet të përmbajë informacionin mbi politikat e njësisë ekonomike për të menaxhuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë e saj materiale që lidhen me **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë** në përputhje me Politikat e ESRS 2 MDR -P *Politikat e miratuara për të menaxhuar çështjet e qëndrueshmërisë materiale*. Përveç kësaj, njësia ekonomike duhet të specifikojë nëse politika të tilla mbulojnë grupe specifike ose të gjithë konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë.
16. Njësia ekonomike duhet të përshkruajë angazhimet në **politikën** e saj të të drejtave të njeriut<sup>125</sup> që janë të rëndësishme për **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë**, duke

---

<sup>125</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues shtesë që lidhet me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohet nga treguesi #9 në Tabelën III të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e rregullat e dhënies së informacionit shpjegues mbi investimet e qëndrueshme ("Mungesa e një politike për të drejtat e njeriut").

përfshirë ato procese dhe mekanizma për të monitoruar pajtueshmërinë me Parimet Udhëzuese të OKB-së mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut, Deklaratën e ILO-s mbi Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë dhe Udhëzimet e OECD-së për Ndërmarrjet Shumëkombëshe. Në informacionin e dhënë prej saj, ajo do të përqendrohet në ato çështje që janë materiale në lidhje me sa më poshtë, si dhe qasjen e saj të përgjithshme në lidhje me:<sup>126</sup>

- (a) respektimin e të drejtave të njeriut të konsumatorëve dhe/ose përdoruesve fundorë
- (b) angazhimin me konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë; dhe
- (c) masat për të siguruar dhe/ose mundësuar **zgjidhje** për çështjet me ndikim në të drejtat e njeriut.

17. Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues nëse dhe si politikat e saj në lidhje me **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë** janë në përputhje me instrumentet e njohura ndërkombëtarisht që lidhen me konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë, duke përfshirë Parimet Udhëzuese të Kombeve të Bashkuara (OKB) mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut. Njësia ekonomike duhet gjithashtu të zbulojë shkallën në të cilën rastet e mosrespektimit të Parimeve Udhëzuese të OKB-së mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut, Deklaratës së ILO-s mbi Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë ose Udhëzimeve të OECD-së për Ndërmarrjet Shumëkombëshe që përfshijnë konsumatorë dhe/ose përdorues fundorë janë raportuar në rrjedhën e poshtme të **zinxhirit të saj të vlerës** dhe, nëse është e aplikueshme, një tregues i natyrës së rasteve të tilla.<sup>127</sup>

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S4-2 – Proceset për angazhimin me konsumatorët dhe përdoruesit fundorë në lidhje me ndikimet*

18. Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese për proceset e saj të përgjithshme për angazhimin me konsumatorët dhe përdoruesit fundorë dhe përfaqësuesit e tyre në lidhje me ndikimet aktuale dhe të mundshme mbi ta.
19. Objektivi i kësaj Kërkese për dhënie informacione shpjeguese është të mundësojë një kuptim nëse dhe si njësia ekonomike angazhohet, si pjesë e procesit të saj të vazhdueshëm të kujdesit të duhur, me **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë** dhe përfaqësuesve të tyre legjitimë, ose me **përfaqësues të besueshëm**, rreth ndikimeve materiale pozitive dhe/ose

---

<sup>126</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues i detyrueshëm që lidhet me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohet nga treguesi #11 në Tabelën I të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacionit shpjegues mbi investimet e qëndrueshme.

<sup>127</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues i detyrueshëm që lidhet me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohet nga treguesi #10 në Tabelën I të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat për dhënie informacione shpjeguese mbi investimet e qëndrueshme ("Shkeljet e parimeve të Kompaktit Global të OKB-së dhe Udhëzimet e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) për Ndërmarrjet Shumëkombëshe"); dhe të administratorëve të standardeve për të dhënë informacion shpjegues për faktorët ESG që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2020/1816, siç përcaktohet nga treguesi "Numri i përbërësve të standardeve që i nënshtrohen shkeljeve sociale (numri absolut dhe relativ i pjesëtuar me të gjithë përbërësit e standardeve), siç referohen në traktatet dhe konventat ndërkombëtare, në parimet e Kombeve të Bashkuara dhe, kur është e aplikueshme, në ligjin kombëtar" në seksionin 1 dhe 2 të Shtojcës II.

negative aktuale dhe të mundshme që i prekin ose ka të ngjarë t'i prekin ata, dhe si merren parasysh perspektivat e konsumatorëve dhe/ose përdoruesve fundorë në proceset e vendimmarrjes së njësisë ekonomike.

20. Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues nëse dhe si perspektivat e **konsumatorëve** dhe/ose **përdoruesve fundorë** ndikojnë në vendimet ose aktivitetet e saj që synojnë menaxhimin e ndikimeve aktuale dhe të mundshme tek konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë. Kjo do të përfshijë, kur është e nevojshme, një shpjegim:
- (a) nëse angazhimi ndodh me konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë të prekur ose me **përfaqësuesit e tyre legjitimë** drejtpërdrejt, ose me **përfaqësues të besueshëm** që kanë njohuri për situatën e tyre;
  - (b) të fazës(ve) në të cilën ndodh angazhimi, lloji i angazhimit dhe frekuenca e angazhimit;
  - (c) të funksionit dhe rolit më të lartë brenda njësisë ekonomike që ka përgjegjësinë operative për të siguruar që ky angazhim të ndodhë dhe që rezultatet të japin informacion në qasjen e njësisë ekonomike; dhe
  - (d) aty ku është e aplikueshme, mënyrën se si njësia ekonomike vlerëson efektivitetin e angazhimit të saj me konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë, dhe, aty ku është e rëndësishme, çdo marrëveshje ose rezultat që rrjedh nga një angazhim i tillë.
21. Kur është e zbatueshme, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për hapat që ajo ndërmerr për të kuptuar perspektivat e **konsumatorëve** dhe/ose **përdoruesve fundorë** që mund të jenë veçanërisht të prekshme nga ndikimet dhe/ose të margjinalizuara (për shembull, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, etj.).
22. Nëse njësia ekonomike nuk mund të japë informacion shpjegues informacionin e kërkuar më sipër sepse nuk ka miratuar një proces të përgjithshëm për t'u angazhuar me **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë**, duhet ta paraqesë këtë si rast. Ajo mund të japë informacion për një afat kohor brenda të cilit synon ta realizojë një proces të tillë.

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S4-3 – Proceset për të ndrequr ndikimet negative dhe kanale për konsumatorët dhe përdoruesit fundorë për të ngritur shqetësime*

23. Njësia ekonomike duhet të përshkruajë proceset që ka në vend për të parashikuar ose bashkëpunuar në ndreqjen e ndikimeve negative tek konsumatorët dhe përdoruesit fundorë me të cilët njësia ekonomike është e lidhur, si dhe kanalet në dispozicion të konsumatorëve dhe përdoruesve fundorë për të ngritur shqetësime dhe për t'i adresuar ato.
24. Objektivi i kësaj Kërkese për dhënie informacione shpjeguese është të mundësojë një kuptim të mjeteve formale me të cilat **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë** mund t'ia bëjnë të ditura shqetësimet dhe nevojat e tyre drejtpërdrejt njësisë ekonomike dhe/ose përmes të cilave njësia ekonomike mbështet disponueshmërinë e kanaleve të tilla (për shembull,

**mekanizmat e ankesave**) përmes marrëdhënieve të saj të biznesit, si kryhet ndjekja me këta konsumatorë dhe/ose përdoruesit fundorë në lidhje me çështjet e ngritura dhe efektivitetin e këtyre kanaleve.

25. Njësia ekonomike duhet të përshkruajë:

- (a) qasjen e saj të përgjithshme dhe proceset për zgjidhjen ose kontributin në **zgjidhjen** e problemeve që kanë shkaktuar ose kontribuar në një ndikim negativ material tek **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë**, duke përfshirë nëse njësia ekonomike vlerëson dhe si e vlerëson se zgjidhja e ofruar është efektive;
- (b) çdo kanal specifik që ka në dispozicion për konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë për të ngritur shqetësimet ose nevojat e tyre drejtpërdrejt me njësinë ekonomike dhe se si kjo e fundit i ka adresuar ato, duke përfshirë nëse këto përcaktohen nga vetë njësia ekonomike dhe/ose përmes pjesëmarrjes në mekanizma të palëve të treta;
- (c) proceset e saj përmes të cilave njësia ekonomike mbështet disponueshmërinë e kanaleve të tilla nëpërmjet marrëdhënieve të saj të biznesit; dhe
- (d) si i gjurmon dhe monitoron çështjet e ngritura dhe të trajtuara, dhe si siguron efektivitetin e kanaleve, duke konsideruar edhe përfshirjen e **palëve të interesuara** të cilët janë përdoruesit e synuar.

26. Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues nëse dhe si vlerëson që **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë** janë në dijeni të këtyre strukturave ose proceseve dhe u besojnë atyre si një mënyrë për të ngritur shqetësimet ose nevojat e tyre dhe për t'i adresuar ato. Përveç kësaj, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues nëse ka politika në funksion për të mbrojtur individët nga hakmarrja kur ata përdorin struktura ose procese të tilla. Nëse një informacion i tillë është dhënë në përputhje me ESRS G1-1, njësia ekonomike mund t'i referohet atij informacioni.

27. Nëse njësia ekonomike nuk mund të japë informacionin e kërkuar sa më sipër, sepse nuk ka miratuar një kanal për të ngritur shqetësime dhe/ose nuk mbështet disponueshmërinë e një kanali të tillë nëpërmjet marrëdhënieve të biznesit, ajo duhet ta deklarojë këtë si rast. Ajo mund të japë informacion shpjegues për një afat kohor brenda të cilit synon të ketë në vend një kanal ose procese të tilla.

*Kërkesa për dhënie informacion shpjegues S4-4 – Ndërmarrja e veprimeve mbi ndikimet materiale tek konsumatorët dhe përdoruesit fundorë, dhe qasjet për menaxhimin e rreziqeve materiale dhe ndjekjen e mundësive materiale që lidhen me konsumatorët dhe përdoruesit fundorë, dhe efektiviteti i këtyre veprimeve*

28. Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues se si ndërmerr veprime për të adresuar ndikimet materiale tek konsumatorët dhe përdoruesit fundorë, si dhe për të menaxhuar rreziqet materiale dhe për të ndjekur mundësitë materiale që lidhen me konsumatorët dhe përdoruesit fundorë, si dhe efektivitetin e këtyre veprimeve.

29. Objektivi i kësaj kërkesë për Informacione Shpjeguese është i dyfishtë. Së pari, për të mundësuar kuptimin e çdo **veprimi** dhe iniciative përmes së cilës njësia ekonomike synon të:
- (a) parandalojë, zbusë dhe ndreqë ndikimet negative materiale tek **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë**, dhe/ose
  - (b) arrijë ndikime pozitive materiale për konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë.
- Së dyti, është për të mundësuar një kuptim të mënyrave se si njësia ekonomike po adreson rreziqet materiale dhe po ndjek mundësitë materiale që lidhen me konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë.
30. Njësia ekonomike duhet të ofrojë një përshkrim të përmbledhur të planeve të veprimit dhe burimeve për të menaxhuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë e saj materiale që lidhen me **konsumatorët** dhe **përdoruesit fundorë** sipas ESRS 2 MDR -A *Veprime dhe burime në lidhje me çështjet e qëndrueshmërisë materiale*.
31. Në lidhje me ndikimet materiale, njësia ekonomike duhet të përshkruajë:
- (a) **veprimet** e ndërmarra, të planifikuara ose në proces për të parandaluar, zbutur ose ndrequr ndikimet negative materiale tek **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë**;
  - (b) nëse ka ndërmarrë dhe si ka ndërmarrë veprime për të siguruar ose mundësuar **zgjidhjen** në lidhje me një ndikim real;
  - (c) çdo veprim ose iniciativë shtesë që ka në zbatim me qëllimin kryesor për të kontribuar pozitivisht në përmirësimin e rezultateve sociale për konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë; dhe
  - (d) si e gjurmon dhe vlerëson efektivitetin e këtyre **veprimeve** dhe iniciativat në ofrimin e rezultateve të synuara për konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë.
32. Në lidhje me paragrafin 28, njësia ekonomike duhet të përshkruajë:
- (a) proceset përmes të cilave identifikohet se çfarë veprimi është i nevojshëm dhe i përshtatshëm në përgjigje të një ndikimi të veçantë negativ aktual ose të pritshëm tek **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë**;
  - (b) qasjet e saj për të ndërmarrë veprime në lidhje me ndikimet negative specifike materiale mbi konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë, duke përfshirë çdo veprim në lidhje me praktikën e saj në lidhje me dizajnin, marketingun ose shitjet e produktit, si dhe nëse do të kërkohet veprim më i gjerë i industrisë ose bashkëpunim me palë të tjera përkatëse; dhe
  - (c) si siguron që proceset për të ofruar ose mundësuar **zgjidhjen** në rast të ndikimeve negative materiale, janë të disponueshme dhe efektive në zbatimin dhe rezultatet e tyre.
33. Në lidhje me rreziqet materiale dhe mundësitë, njësia ekonomike duhet të përshkruajë:

- (a) çfarë veprimi është planifikuar ose është duke u ndërmarrë për të zbutur rreziqet materiale për njësinë ekonomike që rrjedhin nga ndikimet dhe **varësitë** e saj prej **konsumatorëve** dhe/ose **përdoruesve fundorë** dhe si e gjurmon efektivitetin në praktikë; dhe
- (b) çfarë veprimi është planifikuar ose është duke u ndërmarrë për të ndjekur mundësitë materiale për njësinë ekonomike në lidhje me konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë.
34. Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese nëse dhe si ndërmerr veprime për të shmangur shkaktimin ose kontributin në ndikime negative materiale tek **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë** përmes praktikave të veta, duke përfshirë, kur është e rëndësishme, në lidhje me prokurimin, shitjet dhe përdorimin e të dhënave. Kjo mund të përfshijë dhënien e informacioneve shpjeguese rreth qasjes që ndiqet kur lindin tensione midis parandalimit ose zbutjes së ndikimeve negative materiale dhe presioneve të tjera të biznesit.
35. Gjatë përgatitjes së këtij shpjegimi, njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë nëse çështje dhe **incidente** të rënda të të drejtave të njeriut të lidhur me **konsumatorët** e saj dhe/ose **përdoruesit fundorë** janë raportuar dhe, nëse është e zbatueshme, këto të shtjellohen me informacion shpjegues <sup>(128)</sup>.
36. ► **C1** Kur njësia ekonomike vlerëson efektivitetin e një veprimi duke vendosur një objektiv, në dhënien e informacionit të kërkuar sipas paragrafit 31(d), njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë ESRS 2 MDR -T, *Ndjekjen e efektivitetit të politikave dhe veprimeve përmes objektivave*. ◀
37. Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese se cilat burime janë përcaktuar për menaxhimin e ndikimeve të saj materiale, së bashku me informacionin që u mundëson **përdoruesve** për të kuptuar se si menaxhohen ndikimet materiale.

## Metrikat dhe objektivat

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S4-5 – Objektivat që lidhen me menaxhimin e ndikimeve negative materiale, avancimin e ndikimeve pozitive dhe menaxhimin e rreziqeve dhe mundësive materiale*

38. **Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për objektivat e përcaktuara në kohë dhe të orientuara drejt rezultateve që mund të ketë vendosur në lidhje me:**

<sup>128</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues shtesë që lidhet me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohet nga treguesi #14 në Tabelën III të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacionit shpjegues mbi investimet e qëndrueshme ("Numri i rasteve të identifikuara të çështjeve dhe incidenteve të rënda të të drejtave të njeriut").

- (a) zvogëlimin e ndikimeve negative tek konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë; dhe/ose
  - (b) avancimin e ndikimeve pozitive tek konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë; dhe/ose
  - (c) menaxhimin e rreziqeve dhe mundësive materiale që lidhen me konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë.
39. Objektivi i kësaj Kërkesë për dhënie informacione shpjeguese është të mundësojë një kuptim të masës në të cilën njësia ekonomike po përdor **objektiva** të kufizuara në kohë dhe të orientuara drejt rezultateve për të nxitur dhe matur progresin e saj në adresimin e ndikimeve negative materiale dhe/ose avancimin e ndikimeve pozitive tek **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë**, dhe/ose në menaxhimin e rreziqeve dhe mundësive materiale që lidhen me konsumatorët dhe/ose **përdoruesit fundorë**.
40. Përshkrimi i përmbledhur i objektivave për të menaxhuar **ndikimet** e saj materiale, **rreziqet** dhe **mundësitë** lidhur me **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë** duhet të përmbajë kërkesat e informacionit të përcaktuara në ESRS 2 MDR -T.
41. Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues procesin për përcaktimin e **objektivave**, duke përfshirë nëse dhe si njësia ekonomike është angazhuar drejtpërdrejt me **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë**, përfaqësuesit e tyre legjitimë, ose me **përfaqësues të besueshëm** që kanë njohuri për situatën e tyre në:
- (a) vendosjen e çdo objektivi të tillë;
  - (b) ndjekjen e performancës së njësisë ekonomike kundrejt tyre; dhe
  - (c) identifikimin e çdo mësimi ose përmirësimi si rezultat i performancës së njësisë ekonomike.

## Shtojca A. Kërkesat për Zbatim

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e ESRS S4 *Konsumatorët dhe përdoruesit fundorë*. Ajo mbështet zbatimin e kërkesave të përcaktuara në këtë standard dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të këtij standardi.

### Objektivi

- AR 1. Njësia ekonomike mund të nxjerrë në pah çështje të veçanta që lidhen me një ndikim material për një periudhë më të shkurtër kohore, për shembull iniciativa në lidhje me shëndetin dhe sigurinë e **konsumatorëve** dhe/ose **përdoruesve fundorë** në lidhje me kontaminimin e një produkti ose shkeljen e rëndë të privatësisë për shkak të një rrjedhjeje masive të të dhënave.

AR 2. Përmbledhja e çështjeve sociale dhe të të drejtave të njeriut e dhënë në paragrafin 2 nuk ka për qëllim të nënkuptojë që për të gjitha këto çështje duhet të jepet informacion shpjegues në secilën Kërkesë për dhënie informacione shpjeguese në këtë Standard. Përkundrazi, ajo ofron një listë çështjesh që njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë në vlerësimin e **materialitetit** të saj (shih te ESRS 1 kapitulli 3 *Materialiteti i dyfishtë si bazë për dhënie informacione shpjeguese të qëndrueshmërisë* dhe ESRS 2 IRO-1) në lidhje me **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë** dhe, më pas, të shtjellojnë me informacion shpjegues si ndikime materiale, rreziqe dhe mundësi brenda fushëveprimit të këtij Standardi.

## ESRS 2 Dhënie informacione shpjeguese të përgjithshme

### *Strategjia*

#### Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese në lidhje me ESRS 2 SBM-2 – Interesat dhe pikëpamjet e palëve të interesuara

AR 3. ESRS 2 SBM-2 kërkon që njësia ekonomike të ofrojë një kuptim nëse dhe si e konsideron rolin që strategjia dhe modeli i saj i biznesit mund të luajë rol në krijimin, përkeqësimin ose zbutjen e ndikimeve të rëndësishme materiale tek **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë**, dhe nëse dhe si përshtaten modeli dhe strategjia e biznesit për të adresuar ndikime të tilla materiale.

AR 4. Ndërsa **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë** mund të mos jenë duke u angazhuar me njësinë ekonomike në nivelin e strategjisë ose modelit të saj të biznesit, pikëpamjet e tyre mund të ndikojnë në vlerësimin e njësisë ekonomike për strategjinë dhe modelin e saj të biznesit. Njësia ekonomike mund të japë informacion shpjegues për pikëpamjet e konsumatorëve (aktuale ose potencialë) të prekur materialisht dhe/ose **përfaqësuesve legjitimë** të përdoruesve fundorë. ose ato të **përfaqësuesve të besueshëm** që kanë një pasqyrë të situatës së tyre.

#### Kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese në lidhje me standardin ESRS 2 SBM -3– Ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin e biznesit

AR 5. Ndikimet tek **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë** mund të burojnë nga modeli ose strategjia e biznesit të njësisë ekonomike në një numër mënyrash të ndryshme. Për shembull, ndikimet mund të lidhen me propozimin e vlerës së njësisë ekonomike (për shembull, ofrimi i platformave online që mund të sjellin dëme potenciale online dhe offline), me **zinxhirin e saj të vlerës** (për shembull, shpejtësia në zhvillimin e produkteve ose shërbimeve, ose realizimin e projekteve, me rreziqe për shëndetin dhe sigurinë), ose me struktura e kostos dhe modeli i të ardhurave (për shembull, stimujt që maksimizojnë shitjet dhe që i vënë konsumatorët në rrezik).

- AR 6. Ndikimet tek **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë** që burojnë nga strategjia ose modeli i biznesit mund të sjellin gjithashtu rreziqe materiale për njësinë ekonomike. Për shembull, nëse modeli i biznesit të njësisë ekonomike bazohet në nxitjen e forcës së saj të shitjeve për të shitur vëllime të larta të një produkti ose shërbimi (për shembull, karta krediti ose ilaçe kundër dhimbjeve) me shpejtësi, dhe kjo rezulton në dëme në shkallë të gjerë për konsumatorët, njësia ekonomike mund të përballlet me padi dhe dëmtim të reputacionit që ndikojnë në biznesin dhe besueshmërinë e saj të ardhshme.
- AR 7. Shembuj të karakteristikave të veçanta të **konsumatorëve** dhe/ose **përdoruesve fundorë** që mund të merren në konsideratë nga njësia ekonomike kur i përgjigjen paragrafit 11 përfshijnë konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë të rinj të cilët mund të jenë më të ndjeshëm ndaj ndikimeve në zhvillimin e tyre fizik dhe mendor, ose që nuk kanë njohuri financiare dhe mund të jenë më të ndjeshëm ndaj praktikave shfrytëzuese të shitjeve ose marketingut. Ato gjithashtu mund të përfshijnë gratë në një kontekst ku gratë diskriminohen rregullisht në aksesin e tyre në shërbime të caktuara ose në marketingun e produkteve të caktuara.
- AR 8. Lidhur me paragrafin 12, rreziqet mund të lindin për shkak të varësisë së njësisë ekonomike nga **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë** ku ngjarjet me probabilitet të ulët, por me ndikim të lartë, mund të shkaktojnë **efekte financiare**. Për shembull, kur një pandemi globale çon në ndikime të rënda në jetesën e disa konsumatorëve, duke rezultuar në ndryshime të mëdha në modelet e konsumit.

*Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë*

**Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S4-1 – Politikat që lidhen me konsumatorët dhe përdoruesit fundorë**

- AR 9. Përshkrimi duhet të përfshijë informacionin kryesor të nevojshëm për të siguruar një përfaqësim besnik të politikave në lidhje me **konsumatorët** dhe **përdoruesit fundorë**, dhe për këtë arsye, njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë shpjegimet e ndryshimeve të rëndësishme në politikat e miratuara gjatë vitit raportues (për shembull, pritshmëritë e reja për klientët e biznesit, qasjet e reja ose shtesë ndaj kujdesit të duhur dhe veprimeve korrigjuese).
- AR 10. **Politika** mund të marrë formën e një politike të pavarur në lidhje me **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë** ose të përfshihet në një dokument më të gjerë, siç është një kod etik ose një politikë e përgjithshme e qëndrueshmërisë që është paraqitur tashmë nga njësia ekonomike si pjesë e një ESRS-je tjetër. Në këto raste, njësia ekonomike duhet të ofrojë një referencë të saktë për të identifikuar aspektet e politikës që plotësojnë këto kërkesa për Dhënie Informacione Shpjeguese.
- AR 11. Kur jepet informacion shpjegues për përputhshmërinë e politikave të saj me Parimet Udhëzuese të OKB-së mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut, njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë që Parimet Udhëzuese i referohen Deklaratës Ndërkombëtare të të Drejtave të

Njeriut, e cila përbëhet nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe dy Paktet që e zbatojnë atë, dhe mund të japë informacion shpjegues përputhshmërinë e saj me këto instrumente.

- AR 12. Kur jep informacion shpjegues se si janë të integruara politikat e jashtme, njësia ekonomike mund të marrë në konsideratë, për shembull, politikat e shitjes dhe shpërndarjes të brendshme dhe harmonizimin me politikat e tjera relevante për **konsumatorin** dhe/ose **përdoruesit fundorë**. Njësia ekonomike duhet gjithashtu të marrë në konsideratë politikat e saj për të mbrojtur vërtetësinë dhe dobinë e informacionit të ofruar konsumatorëve dhe/ose përdoruesve fundorë potencialë dhe aktualë, si para ashtu edhe pas shitjes.
- AR 13. Njësia ekonomike mund të ofrojë një ilustrim të llojeve të komunikimit të politikave të saj për ata individë, grupe individësh ose subjekte për të cilët ato janë të rëndësishme, qoftë sepse pritet që ata t'i zbatojnë ato (për shembull, **punonjësit**, kontraktorët dhe **furnizuesit** e njësisë ekonomike), ose sepse ata kanë një interes të drejtpërdrejtë në zbatimin e tyre (për shembull, punëtorët e saj, investitorët). Ajo mund të japë mjetet e informacionit dhe kanalet e komunikimit (për shembull, fletushka, buletine, faqe interneti të dedikuara, media sociale, ndërveprime ballë për ballë, përfaqësues të punëtorëve), që synojnë të sigurojnë që **politika** arrin tek të interesuarit dhe që audienca të ndryshme të kuptojnë implikimet e saj. Njësia ekonomike mund të shpjegojë gjithashtu se si identifikon dhe heq pengesat e mundshme që pengojnë përhapjen, siç është përkthimi në gjuhët përkatëse ose përdorimi i përshkrimeve grafike.

**Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S4-2 – Proceset për angazhimin me konsumatorët dhe përdoruesit fundorë në lidhje me ndikimet**

- AR 14. **Përfaqësues të besueshëm** që kanë njohuri për interesat, përvojat ose perspektivat e **konsumatorëve** dhe **përdoruesve fundorë**, mund të përfshijë organe kombëtare të mbrojtjes së konsumatorit për disa konsumatorë.
- AR 15. Njësia ekonomike, kur përshkruan se cili funksion ose rol ka përgjegjësi operative për një angazhim të tillë dhe/ose llogaridhënie përfundimtare, mund të japë informacion nëse ky është një rol ose funksion i dedikuar apo pjesë e një roli ose funksioni më të gjerë, dhe nëse janë ofruar aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për të mbështetur stafin për të ndërmarrë angazhime. Nëse njësia ekonomike nuk mund të identifikojë një pozicion ose funksion të tillë, ajo mund ta deklarojë një fakt të tillë. Kjo dhënie informacioni shpjegues mund të përmbushet gjithashtu duke iu referuar informacionit të dhënë sipas ESRS 2 GOV-1 Roli i organeve administrative, menaxhuese dhe mbikëqyrëse.
- AR 16. Gjatë përgatitjes së deklarimeve të përshkruara në paragrafin 20 b) dhe c), mund të merren në konsideratë ilustrimet e mëposhtme për:
- (a) fazën/fazat në të cilat ndodh angazhimi, shembujt mund të jenë përcaktimi i qasjeve të zbutjes ose vlerësimi i efektivitetit të tyre;

- (b) llojet e angazhimit, që mund të jenë pjesëmarrje, konsultim dhe/ose informacion;
- (c) frekuencën e angazhimit, mund të jepet informacion nëse angazhimi ndodh rregullisht, në pika të caktuara të një projekti ose procesi biznesi, si dhe nëse ai ndodh në përgjigje të kërkesave ligjore dhe/ose në përgjigje të kërkesave të palëve të interesuara dhe nëse rezultati i angazhimit po integrohet në proceset vendimmarrëse të njësisë ekonomike; dhe
- (d) rolin që ka përgjegjësi operacionale, nëse njësia ekonomike kërkon që stafi përkatës të ketë aftësi të caktuara, apo nëse ofron **trajtime** ose ndërtimi i kapaciteteve të stafit përkatës për të ndërmarrë angazhime.

AR 17. Për të ilustruar se si perspektivat e **konsumatorëve** dhe/ose **përdoruesve fundorë** kanë ndikuar në vendime ose aktivitete specifike të njësisë ekonomike, njësia ekonomike mund të japë shembuj nga periudha aktuale e raportimit.

Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S4-3 – Proceset për të ndrequr ndikimet negative dhe kanale për konsumatorët dhe përdoruesit fundorë për të ngritur shqetësime

AR 18. Në përmbushjen e kërkesave të përcaktuara nga Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese ESRS S4-3, njësia ekonomike mund të udhëhiqet nga përmbajtja e Parimeve Udhëzuese të OKB-së mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut dhe Udhëzimet e OECD-së për Ndërmarrjet Shumëkombëshe të fokusuar në **veprimet korrigjuese** dhe **mekanizmat e ankesave**.

AR 19. Kanalet për ngritjen e shqetësimeve ose nevojave përfshijnë **mekanizmat e ankesave**, linja telefonike, procese dialogu ose mjete të tjera përmes të cilave **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë ose përfaqësuesit e tyre legjitimë** mund të ngrënë shqetësime në lidhje me ndikimet ose të shpjegojnë nevojat që ata do të donin që njësia ekonomike të adresonte. Kjo mund të përfshijë kanalet e ofruara nga njësia ekonomike drejtpërdrejt dhe duhet të shtjellohet me informacion shpjegues përveç çdo mekanizmi tjetër që njësia ekonomike mund të përdorë për të fituar njohuri mbi menaxhimin e ndikimeve tek konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë, siç janë auditimet e përputhshmërisë. Kur njësia ekonomike mbështetet vetëm në informacionin në lidhje me ekzistencën e kanaleve të tilla të ofruara nga **marrëdhëniet e saj të biznesit** për t'iu përgjigjur kësaj kërkesë, ajo duhet ta deklarojë këtë fakt.

AR 20. Për të ofruar një pasqyrë më të gjerë të informacionit të kërkuar nga ESRS S4-3, njësia ekonomike mund të ofrojë një pasqyrë nëse dhe si **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë** që mund të preken janë në gjendje të hyjnë në kanale në nivelin e njësisë ekonomike nga e cila preken, në lidhje me secilin ndikim material.

AR 21. Mekanizmat e palëve të treta mund të përfshijnë ato që veprojnë në emër të institucioneve qeveritare, OJQ-të, shoqatat e industrisë dhe nisma të tjera bashkëpunuese. Lidhur me fushëveprimin e këtyre mekanizmave, njësia ekonomike mund të japë informacion shpjegues nëse këto janë të arritshme për të gjithë **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë** të cilët

mund të ndikohen potencialisht ose në të vërtetë materialisht nga njësi ekonomike, ose individë ose organizata që veprojnë në emër të tyre ose që janë në një pozicion për të qenë të vetëdijshëm për ndikimet negative, dhe përmes të cilave konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë (ose individët ose organizatat që veprojnë në emër të tyre ose që janë në një pozicion për të qenë të vetëdijshëm për ndikimet negative), mund të ngrenë ankesa ose shqetësime në lidhje me aktivitetet e vetë njësisë ekonomike.

AR 22. Në lidhje me mbrojtjen e individëve që përdorin mekanizmat kundër hakmarrjes, njësi ekonomike mund të përshkruajë nëse i trajton ankesat në mënyrë konfidenciale dhe në lidhje me të drejtat e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave; dhe nëse ato lejojnë që **konsumatori** dhe/ose **përdoruesit fundorë** për t'i përdorur ato në mënyrë anonime (për shembull, nëpërmjet përfaqësimit nga një palë e tretë).

AR 23. Në dhënien e informacioneve shpjeguese nëse dhe si njësi ekonomike ka informacion që **konsumatori** dhe/ose **përdoruesit fundorë** janë të vetëdijshëm dhe u besojnë ndonjërit prej këtyre kanaleve, njësi ekonomike mund të ofrojë të dhëna relevante dhe të besueshme në lidhje me efektivitetin e këtyre kanaleve nga perspektiva e vetë konsumatorëve dhe/ose përdoruesve fundorë. Shembuj të burimeve të informacionit janë anketat e konsumatorëve dhe/ose përdoruesve fundorë që kanë përdorur kanale të tilla dhe nivelet e tyre të kënaqësisë me procesin dhe rezultatet. Për të ilustruar nivelin e përdorimit të kanaleve të tilla, njësi ekonomike mund të japë informacion shpjegues numrin e ankesave të marra nga konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë gjatë periudhës së raportimit.

AR 24. Në përshkrimin e efektivitetit të kanaleve për **konsumatorin** dhe/ose **përdoruesit fundorë** për të ngritur shqetësime, njësi ekonomike mund të udhëhiqet nga pyetjet e mëposhtme, bazuar në "kriteret e efektivitetit për **mekanizmat e ankesave** jo-gjyqësore" ', siç përcaktohet në Parimet Udhëzuese të OKB-së mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut. Konsideratat e mëposhtme mund të zbatohen për kanalet individuale ose për një sistem kolektiv kanalesh komunikimi:

- (a) a kanë kanalet e komunikimit legjitimitet për të ofruar llogaridhënie të përshtatshme për sjelljen e tyre të drejtë dhe për të ndërtuar besimin e palëve të interesuara?
- (b) a janë kanalet e komunikimit të njohura dhe të arritshme për **palët e interesuara**?
- (c) a kanë kanalet procedura të njohura, afate kohore të përcaktuara dhe qartësi mbi proceset?
- (d) a sigurojnë kanalet qasje të arsyeshëm drejt burimeve të informacionit, këshillave dhe ekspertizës?
- (e) a ofrojnë kanalet transparencë duke u ofruar informacion të mjaftueshëm si ankuesve ashtu edhe, kur është e aplikueshme, për të përmbushur çdo interes publik në fjalë?
- (f) a përputhen rezultatet e arritura nga kanalet me të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht?

(g) a identifikon njësia ekonomike njohuri nga kanalet që mbështesin edukimin e vazhdueshëm si në përmirësimin e kanaleve ashtu edhe në parandalimin e ndikimeve të ardhshme?

(h) a përqendrohet njësia ekonomike në dialogun me ankuesit si mjet për të arritur zgjidhje të dakordësuara, në vend që të përpiqet të përcaktojë në mënyrë të njëanshme rezultatin?

Për më shumë informacion, shih Parimin 31 të Parimeve Udhëzuese të OKB-së mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut.

Kërkesa për dhënie informacion shpjegues S4-4 – Ndërmarrja e veprimeve mbi ndikimet materiale tek konsumatorët dhe përdoruesit fundorë, dhe qasjet për menaxhimin e reziqeve materiale dhe ndjekjen e mundësive materiale që lidhen me konsumatorët dhe përdoruesit fundorë, dhe efektiviteti i këtyre veprimeve

AR 25. Mund të duhet kohë për të kuptuar ndikimet negative dhe se si njësia ekonomike mund të jetë e përfshirë në to përmes zinxhirit të saj të vlerës, si dhe për të identifikuar përgjigjet e duhura dhe për t'i vënë ato në praktikë. Prandaj, njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë:

- (a) qasjet e saj të përgjithshme dhe specifike për adresimin e ndikimeve negative materiale;
- (b) iniciativat e saj që synojnë të kontribuojnë në ndikime të rëndësishme pozitive shtesë;
- (c) sa ka përparuar në përpjekjet e saj gjatë periudhës së raportimit; dhe
- (d) synimet e saj për përmirësim të vazhdueshëm.

AR 26. Veprimet e duhura mund të ndryshojnë në varësi të faktit nëse njësia ekonomike shkakton ose kontribuon në një ndikim material ose nëse ndikimi material lidhet drejtpërdrejt me veprimet, produktet ose shërbimet e saj përmes një marrëdhënieje biznesi.

AR 27. Duke pasur parasysh ndikimet negative materiale që prekin **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë** që kanë ndodhur gjatë periudhës raportuese mund të jenë gjithashtu të lidhura me njësi ose operacione jashtë kontrollit të saj të drejtpërdrejtë, njësia ekonomike mund të japë informacion shpjegues nëse dhe si kërkon të përdorë ndikimin e saj në **marrëdhëniet përkatëse të biznesit** për të menaxhuar këto ndikime. Kjo mund të përfshijë përdorimin e **ndikimit tregtar** (për shembull, zbatimi i kërkesave kontraktuale me marrëdhëniet e biznesit ose zbatimi i stimuljve), forma të tjera të ndikimit brenda marrëdhënies (siç është ofrimi i **trajnitimit** ose ndërtimin e kapaciteteve mbi përdorimin e duhur të produktit ose praktikat e shitjes në marrëdhëniet e biznesit) ose shfrytëzimin e bashkëpunimit me kolegët ose aktorë të tjerë (siç janë iniciativat që synojnë marketingun e përgjegjshëm ose sigurinë e produktit).

AR 28. Kur njësia ekonomike informon për pjesëmarrjen e saj në një industri ose një iniciativë me shumë palë të interesuara si pjesë e **aktiviteteve** të saj për të adresuar ndikimet negative

materiale, njësia ekonomike mund të japë informacion se si iniciativa, dhe përfshirja e saj, synon të adresojë ndikimin material në fjalë. Ajo mund të japë informacion shpjegues sipas ESRS S4-5 **objektivat** përkatëse të përcaktuara nga iniciativa dhe progresi drejt tyre.

AR 29. Kur njësia ekonomike jep informacione shpjeguese nëse dhe si ajo merr në konsideratë ndikimet aktuale dhe të mundshme mbi **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë** në vendimet që merr për të ndërprerë **marrëdhëniet e biznesit** dhe nëse dhe si synon të adresojë çdo ndikim negativ që mund të rezultojë nga kjo ndërprerje, njësia ekonomike mund të përfshijë shembuj.

AR 30. Në dhënien e informacionit shpjegues se si gjurmon efektivitetin e **veprimeve** për të menaxhuar ndikimet materiale gjatë periudhës së raportimit, njësia ekonomike mund të japë informacione shpjeguese për çdo mësim të nxjerrë nga periudhat e mëparshme dhe aktuale të raportimit.

AR 31. Proceset e përdorura për të ndjekur efektivitetin e **veprimeve** mund të përfshijnë një auditim ose verifikim të brendshëm ose të jashtëm, procedura gjyqësore dhe/ose vendime gjyqësore përkatëse, vlerësime të ndikimit, sisteme matjeje, reagime nga palët e interesuara, **mekanizma ankimi**, vlerësime të performancës së jashtme dhe krahasime.

AR 32. Raportimi mbi efektivitetin synon të mundësojë kuptimin e lidhjeve midis **veprimeve** të ndërmarra nga njësia ekonomike dhe menaxhimit efektiv të ndikimeve.

AR 33. Lidhur me iniciativat ose proceset që njësia ekonomike ka në vend, të cilat bazohen te **konsumatorët** e prekur dhe/ose nevojat e **përdoruesve fundorë** dhe nivelin e tyre të zbatimit, njësia ekonomike mund të japë informacion shpjegues:

(a) nëse dhe si konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë dhe **përfaqësuesit legjitimë** ose **përfaqësuesit e tyre të besueshëm** luajnë një rol në vendimet që kanë të bëjnë me hartimin dhe zbatimin e këtyre programeve ose proceseve; dhe

(b) në lidhje me rezultatet pozitive të synuara ose të arritura për konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë të këtyre programeve ose proceseve.

AR 34. Njësia ekonomike mund të japë informacione shpjeguese nëse është marrë ndonjë iniciativë ose proces, qëllimi kryesor i të cilit është të japë ndikime pozitive për **konsumatorin** dhe/ose **përdoruesit fundorë** gjithashtu për të mbështetur arritjen e një ose më shumë Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) të OKB-së. Për shembull, përmes një angazhimi për të çuar përpara SDG 3 të OKB-së për të "siguruar jetesë të shëndetshme dhe për të promovuar mirëqenie për të gjithë në të gjitha moshat", njësia ekonomike mund të jetë duke punuar në mënyrë aktive për t'i bërë produktet e saj më pak problematike dhe të dëmshme për shëndetin fizik dhe psikologjik.

AR 35. ► **C1** Kur zbulohen rezultatet pozitive të synuara të veprimeve të njësisë ekonomike për **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë**, duhet bërë një dallim midis provave të

aktiviteteve të caktuara që kanë ndodhur (për shembull, që x numër konsumatorësh kanë marrë informacion në lidhje me zakonet e shëndetshme të të ngrënit) nga provat e rezultateve aktuale për konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë (për shembull, që x numër konsumatorësh kanë përvetësuar zakone më të shëndetshme të të ngrënit). ◀

AR 36. Kur jep informacion shpjegues nëse iniciativat ose proceset luajnë gjithashtu një rol në zbutjen e ndikimeve negative materiale, njësia ekonomike mund të marrë në konsideratë, për shembull, programe që synojnë të mbështesin ndërgjegjësimin e shtuar për rrezikun e mashtrimeve online, duke çuar në një ulje të numrit të rasteve të **përdoruesve fundorë** duke përjetuar shkelje të privatësisë së të dhënave.

AR 37. Kur jepet informacion shpjegues për rreziqet dhe mundësitë materiale që lidhen me ndikimet ose varësitë e njësisë ekonomike nga **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë**, njësia ekonomike mund të marrë në konsideratë sa vijon:

(a) rreziqet që lidhen me ndikimet e njësisë ekonomike të konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë mund të përfshijnë ekspozim reputacional ose ligjor, kur produktet e projektuara dobët ose me defekt rezultojnë në lëndime ose vdekje;

(b) rreziqet që lidhen me varësinë e njësisë ekonomike nga konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë mund të përfshijnë humbjen e vazhdimësisë së biznesit kur një krizë ekonomike i bën konsumatorët të paaftë të përballojnë produkte ose shërbime të caktuara;

(c) ▶ **C1** mundësitë që lidhen me ndikimet e njësisë ekonomike të konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë mund të përfshijnë diferencimin e tregut dhe një tërheqje më të madhe ndaj klientit nga ofrimi i produkteve të sigurta ose shërbimeve që respektojnë privatësinë; dhe ◀

(d) ▶ **C1** mundësitë që lidhen me varësinë e njësisë ekonomike nga konsumatorët dhe/ose përdoruesit fundorë mund të përfshijnë arritjen e një baze besnike të konsumatorëve në të ardhmen duke siguruar, për shembull, që personat LGBTQI të respektohen dhe që praktikatat e shitjes së njësisë ekonomike të mos i përjashtojnë këta persona nga produktet ose shërbimet që ajo ofron. ◀

AR 38. Kur jepet informacion shpjegues nëse **varësitë** shndërrohen në rreziqe, njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë zhvillimet e jashtme.

AR 39. Kur njësia ekonomike paraqet informacion shpjegues për politikën, veprimet dhe burimet dhe **objektivat** lidhur me menaxhimin e rreziqeve materiale dhe mundësive, në rastet kur rreziqet dhe mundësitë lindin nga një ndikim material, njësia ekonomike mund të kryqëzojë referencat për deklaratimet e saj mbi politikën, veprimin dhe burimet dhe **objektivat** në lidhje me atë ndikim.

AR 40. Njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë shkallën në të cilën proceset e saj për të menaxhuar rreziqet materiale që lidhen me **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë** janë të integruara në proceset e saj ekzistuese të menaxhimit të riskut dhe si.

AR 41. Kur paraqet informacion shpjegues për burimet e alokuara për menaxhimin e ndikimeve materiale, njësia ekonomike mund të shpjegojë se cilat funksione të brendshme janë të përfshira në menaxhimin e ndikimeve dhe çfarë lloje veprimesh ndërmarrin ata për të adresuar ndikimet negative dhe për të çuar përpara ndikimet pozitive.

#### *Metrikat dhe objektivat*

#### Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese S4-5 – Objektivat që lidhen me menaxhimin e ndikimeve negative materiale, avancimin e ndikimeve pozitive dhe menaxhimin e rreziqeve dhe mundësive materiale

AR 42. Kur zbulohen **objektivat** në raport me **konsumatorët** dhe/ose **përdoruesit fundorë**, njësia ekonomike mund të japë informacion shpjegues për:

- (a) rezultatet e synuara që duhen arritur në jetën e konsumatorëve dhe/ose përdoruesve fundorë, duke qenë sa më specifike të jetë e mundur;
- (b) stabilitetin e tyre me kalimin e kohës në aspektin e përkufizimeve dhe metodologjive për të mundësuar krahasueshmërinë; dhe/ose
- (c) ► **C1** standardet ose angazhimet mbi të cilat **objektivat** bazohen duhet të përcaktohen qartë në raportim (për shembull kodet e sjelljes, politikat e furnizimit, kornizat globale ose kodet e industrisë). ◀

AR 43. **Synimet** e lidhura me **rreziqet** dhe **mundësitë** materiale mund të jenë të njëjta ose të ndryshme nga objektivat që lidhen me **ndikimet** materiale. Për shembull, një objektiv për të siguruar qasje të barabartë në financim për konsumatorët e pashpërblyer mund të zvogëlojnë ndikimin e **diskriminimit** tek ata **konsumatorë** dhe zgjerojnë grupin e klientëve të njësise ekonomike.

AR 44. Njësia ekonomike mund të bëjë gjithashtu dallimin midis **objektivave** afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë që mbulon të njëjtën **politikë** angazhim. Për shembull, njësia ekonomike mund të ketë si objektiv kryesor t'i bëjë shërbimet e saj online të arritshme për personat me aftësi të kufizuara, me qëllimin afatgjatë për të përshtatur 100% të shërbimeve të saj online deri në vitin 2025, dhe me objektivin afatshkurtër për të shtuar x numër veçorish të arritshme çdo vit deri në vitin 2025.

AR 45. Kur modifikon ose zëvendëson një objektiv në periudhën raportuese, njësia ekonomike mund ta shpjegojë ndryshimin duke e krahasuar atë me ndryshime të rëndësishme në modelin e biznesit ose me ndryshime më të mëdha në standardin ose legjislacionin e pranuar nga i cili rrjedh objektivi për të dhënë informacion kontekstual sipas ESRS 2 BP-2 *Deklaratave në lidhje me rrethana specifike*.

## ESRS G1. DREJTIMI I BIZNESIT

### Përmbajtja

<b>Objektivi .....</b>	<b>368</b>
<b>Ndërveprimi me Standardet e tjera ESRS .....</b>	<b>368</b>
<b>Kërkesat për Dhënie Informacione Shpjeguese .....</b>	<b>369</b>
ESRS 2 Dhënie informacione shpjeguese të përgjithshme .....	369
Qeverisja .....	369
Kërkesa për Dhënie Informacion Shpjegues në lidhje me ESRS 2 GOV-1 – Roli i organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse .....	369
Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë .....	369
Kërkesa për dhënie informacion shpjegues në lidhje me ESRS 2 IRO-1 – Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale .....	369
▶ <b>C1</b> Kërkesa për dhënie informacion shpjegues G1-1– Politikat e drejtimit të biznesit dhe kultura e korporatës ◀ .....	369
Kërkesa për dhënie informacion shpjegues G1-2 – Menaxhimi i marrëdhënieve me furnizuesit .....	371
Kërkesa për dhënie informacion shpjegues G1-3 – Parandalimi dhe zbulimi i korrupsionit dhe ryshfetit .....	371
Metrikat dhe objektivat .....	372
▶ <b>C1</b> Kërkesa për dhënie informacion shpjegues G1-4 – Incidente të korrupsionit ose të ryshfetit ◀ .....	372
Kërkesa për dhënie informacion shpjegues G1-5 – Ndikimi politik dhe aktivitetet e lobimit .....	373
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese G1-6 – Praktikrat e Pagesës .....	374
<b>Shtojca A. Kërkesat për Zbatim .....</b>	<b>375</b>
Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë .....	375
▶ <b>C1</b> Kërkesa për dhënie informacion shpjegues G1-1– Politikat e drejtimit të biznesit dhe kultura e korporatës ◀ .....	375
Kërkesa për dhënie informacion shpjegues G1-2 – Menaxhimi i marrëdhënieve me furnizuesit .....	375
Kërkesa për dhënie informacion shpjegues G1-3 – Parandalimi dhe zbulimi i korrupsionit dhe ryshfetit .....	376

Shembull ilustrues i trajnimit kundër korrupsionit dhe ryshfetit .....	376
Metrikat dhe objektivat .....	377
Kërkesa për dhënie informacion shpjegues G1-5 – Ndikimi politik dhe aktivitetet e lobimit .....	377
Angazhimi politik (duke përfshirë aktivitetet e lobimit) shembull ilustrues .....	378
Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese G1-6 – Praktikrat e Pagesës .....	379

## Objektivi

- Objektivi i këtij Standardi është të specifikojë kërkesat e zbulimit të cilat do t'u mundësojnë përdoruesve të **deklaratave të qëndrueshmërisë** së njësisë ekonomike të kuptojë strategjinë dhe qasjen e saj, proceset dhe procedurat, si dhe performancën e saj në lidhje me drejtimin e biznesit.
- Ky Standard përqendrohet në çështjet e mëposhtme, të cilat në këtë Standard referohen kolektivisht si "drejtimi i biznesit ose çështje të drejtimit së biznesit":
  - etika e biznesit dhe **kultura korporative**, duke përfshirë anti- **korrupsionin** dhe anti- **ryshfetin**, mbrojtjen e denoncuesve dhe mirëqenien e kafshëve;
  - menaxhimi i marrëdhënieve me **furnizuesit**, duke përfshirë praktikrat e pagesave, veçanërisht në lidhje me vonesat në pagesa për njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme.
  - aktivitetet dhe angazhimet e njësisë ekonomike që lidhen me ushtrimin e ndikimit të saj politik, duke përfshirë **aktivitetet e lobimit**;

## Ndërveprimi me Standardet e tjera ESRS

- Përmbajtja e këtij Standardi mbi kërkesat e përgjithshme për dhënie informacione shpjeguese, si dhe ndikimin, menaxhimin e rrezikut dhe mundësive dhe **metrikat** dhe **objektivat** duhet të lexohet në lidhje përkatësisht me ESRS 1 *Parimet e Përgjithshme* dhe ESRS 2 *Kërkesat e Përgjithshme*.

# Kërkesat për Dhënie Informacione Shpjeguese

## ESRS 2 Dhënie informacione shpjeguese të përgjithshme

4. Kërkesat e këtij seksioni duhet të lexohen së bashku me dhe të raportohen së bashku me informacionet shpjeguese të kërkuara nga ESRS 2 mbi Qeverisjen (GOV), Strategjinë (SBM) dhe Menaxhimin e ndikimeve, rreziqeve dhe mundësive (IRO).

## Qeverisja

*Kërkesa për Dhënie Informacion Shpjegues në lidhje me ESRS 2 GOV-1 – Roli i organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse*

5. Kur paraqet informacion në lidhje me rolin e **organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse**, njësia ekonomike duhet të mbulojë aspektet e mëposhtme:
  - (a) roli i **organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse** që lidhen me drejtimin e biznesit; dhe
  - (b) ekspertizën e organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse mbi çështjet e drejtimit të biznesit.

## Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë

*Kërkesa për dhënie informacion shpjegues në lidhje me ESRS 2 IRO-1 – Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale*

6. Gjatë përshkrimit të procesit për identifikimin e ndikimeve, rreziqeve dhe mundësive materiale në lidhje me çështjet e drejtimit të biznesit, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për të gjitha kriteret përkatëse të përdorura në proces, duke përfshirë vendndodhjen, aktivitetin, sektorin dhe strukturën e transaksionit.

*Kërkesa për dhënie informacion shpjegues G1-1– Politikat e drejtimit të biznesit dhe kultura e korporatës*

7. Njësia ekonomike duhet të paraqesë politikat e saj në lidhje me çështjet e drejtimit të biznesit dhe mënyrën se si nxit kulturën e saj korporative.
8. Objektivi i kësaj Kërkese për dhënie informacion shpjegues është të mundësojë një kuptim të masës në të cilën njësia ekonomike ka politika që adresojnë identifikimin, vlerësimin, menaxhimin dhe/ose **ndreqjen e ndikimeve** të saj materiale, **rreziqet dhe mundësitë** që lidhen me çështjet e drejtimit të biznesit. Gjithashtu synon të ofrojë një kuptim të qasjes së njësisë ekonomike ndaj **kulturës korporative**.

9. Informacionet e kërkuara sipas paragrafit 7 duhet të përfshijnë mënyrën se si njësia ekonomike krijon, zhvillon, promovon dhe vlerëson **kulturën e saj korporative**.
10. Informacionet e dhëna në paragrafin 7 duhet të mbulojnë aspektet e mëposhtme që lidhen me politikat e njësisë ekonomike mbi çështjet e drejtimit të biznesit:
- (a) një përshkrim të mekanizmave për identifikimin, raportimin dhe hetimin e shqetësimeve në lidhje me sjellje të paligjshme ose sjellje në kundërshtim me kodin e saj të biznesit ose rregulla të brendshme të ngjashme; dhe nëse ajo akomodon raportimin nga **palët e interesuara** të brendshme dhe/ose të jashtme;
  - (b) kur njësia ekonomike nuk ka politika anti - **korrupsion** ose anti- **ryshfet** në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit,<sup>129</sup> duhet ta deklarojë këtë dhe nëse ka plane për t'i zbatuar ato, si dhe afatin kohor për zbatimin e tyre;
  - (c) si i mbron njësia ekonomike sinjalizuesit, duke përfshirë:
    - i. detaje mbi krijimin e kanaleve të brendshme të raportimit të sinjalizuesve, duke përfshirë nëse njësia ekonomike ofron informacion dhe **trajnim** për punonjësit e vet dhe informacion në lidhje me caktimin dhe trajnimin e stafit që merr raportime; dhe
    - ii. masat për të mbrojtur nga hakmarrja punonjësit e vet që janë sinjalizues në përputhje me ligjin në fuqi që zëvendëson Direktivën (BE) 2019/1937 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit;<sup>130</sup>
  - (d) kur njësia ekonomike nuk ka politika për mbrojtjen e sinjalizuesve,<sup>131</sup> ajo duhet ta deklarojë këtë dhe nëse ka plane për t'i zbatuar ato, si dhe afatin kohor për zbatimin e tyre;
  - (e) nëse njësia ekonomike ka procedura për të hetuar incidentet e drejtimit të biznesit, duke përfshirë **incidentet e korrupsionit** dhe **ryshfetit**, menjëherë, në mënyrë të pavarur dhe objektive, përtej procedurave për të ndjekur raportet nga sinjalizuesit në përputhje me ligjin në fuqi që zëvendëson Direktivën (BE) 2019/1937;
  - (f) kur është e aplikueshme, nëse njësia ekonomike ka politika në fuqi në lidhje me mirëqenien e kafshëve;
  - (g) **politikat** e njësisë ekonomike për **trajnim** brenda organizatës mbi drejtimin e biznesit, duke përfshirë audiencën e synuar, frekuencën dhe thellësinë e mbulimit; dhe

---

<sup>129</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues shtesë që lidhet me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohet nga treguesi #15 në Tabelën III të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacioneve shpjeguese mbi investimet e qëndrueshme ("Mungesa e një politike anti- korrupsion dhe anti- ryshfet").

<sup>130</sup> Direktiva (BE) 2019/1937 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 23 tetor 2019, mbi mbrojtjen e personave që raportojnë shkelje të ligjit të Bashkimit Evropian (GZ L 305, 26.11.2019, f. 17).

<sup>131</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregun financiar që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088 sepse rrjedh nga një tregues shtesë që lidhet me ndikimet kryesore negative, siç përcaktohet nga treguesi #6 në Tabelën III të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacionit mbi investimet e qëndrueshme ("Mbrojtje e pamjaftueshme ndaj sinjalizuesve").

(h) funksionet brenda njësisë ekonomike që janë më të rrezikuara në lidhje me **korrupsionin** dhe **ryshfet**.

11. Njësitë ekonomike që i nënshtrohen kërkesave ligjore sipas ligjit kombëtar që zëvendëson Direktivën (BE) 2019/1937, ose kërkesave ligjore ekuivalente në lidhje me mbrojtjen e sinjalizuesve, mund të përmbushin detyrimet e dhënies së informacionit të specifikuar në paragrafin 10 (d) duke deklaruar se ato i nënshtrohen këtyre kërkesave ligjore.

*Kërkesa për dhënie informacion shpjegues G1-2 – Menaxhimi i marrëdhënieve me furnizuesit*

12. Njësia ekonomike duhet të ofrojë informacion në lidhje me menaxhimin e marrëdhënieve të saj me furnizuesit e saj dhe ndikimet e saj në zinxhirin e furnizimit.
13. Objektivi i kësaj Kërkese për Dhënie informacion shpjegues është të ofrojë një kuptim të menaxhimit të procesit të prokurimit nga njësia ekonomike, duke përfshirë sjelljen e drejtë me **furnizuesit**.
14. Njësia ekonomike duhet të japë një përshkrim të **politikës** së saj për të parandaluar vonesat në pagesa, veçanërisht për njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme.
15. Informacioni shpjegues i kërkuar sipas paragrafit 12 duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:
  - (a) qasjen e njësisë ekonomike ndaj marrëdhënieve të saj me **furnizuesit**, duke marrë parasysh rreziqet për njësinë ekonomike që lidhen me **zinxhirin e saj të furnizimit** dhe të **ndikimeve** mbi **çështjet e qëndrueshmërisë**; dhe
  - (b) nëse dhe si i merr parasysh kriteret sociale dhe mjedisore për përzgjedhjen e furnizuesve të saj.

*Kërkesa për dhënie informacion shpjegues G1-3 – Parandalimi dhe zbulimi i korrupsionit dhe ryshfetit*

16. Njësia ekonomike duhet të ofrojë informacion në lidhje me sistemin e saj për të parandaluar dhe zbuluar, hetuar dhe për t'iu përgjigjur akuzave ose incidenteve që lidhen me korrupsionin dhe ryshfetin, duke përfshirë dhe trajnimet përkatës.
17. Objektivi i kësaj Kërkese për Dhënie informacion shpjegues është të sigurojë transparencë mbi procedurat kryesore të njësisë ekonomike për të parandaluar, zbuluar dhe adresuar akuzat për **korrupsion** dhe **ryshfet**. Kjo përfshin trajnimin e ofruar për punëtorët e vet dhe/ose informacionin e ofruar brenda kompanisë apo për **furnitorët**.
18. Informacioni shpjegues i kërkuar sipas paragrafit 16 duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:
  - (a) një përshkrim të procedurave në fuqi për të parandaluar, zbuluar dhe adresuar akuzat ose **incidentet e korrupsionit** dhe **ryshfetit**;

- (b) nëse ata që hetojnë këtë çështje ose komiteti hetimor janë të ndarë nga zinxhiri i menaxhimit të përfshirë në këtë çështje; dhe
- (c) procesin për të raportuar rezultatet tek **organet administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse** nëse ka.
19. Kur njësia ekonomike nuk ka procedura të tilla në zbatim, ajo duhet ta paraqesë këtë fakt dhe planet e saj për t'i miratuar ato, kur është e aplikueshme.
20. Informacionet shpjeguese të kërkuara nga paragrafi 16 duhet të përfshijnë informacion në lidhje me mënyrën se si njësia ekonomike i komunikon politikat e saj tek ata që janë të rëndësishme për të siguruar që **politika** është e arritshme dhe se ata i kuptojnë implikimet e saj.
21. Informacionit shpjegues i kërkuar nga paragrafi 16 duhet të përfshijë informacion e mëposhtëm në lidhje me trajnimin:
- (a) natyrën, fushëveprimin dhe thellësinë e programeve të trajnimit të ofruara ose të kërkuara nga njësia ekonomike në lidhje me anti-**korrupsionin** dhe anti-**ryshfetin**;
- (b) Përqindjen e funksioneve në rrezik që mbulohen nga programet e trajnimit; dhe
- (c) shkallën në të cilën u ofrohet trajnim anëtarëve të organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse.

## Metrikat dhe objektivat

### *Kërkesa për dhënie informacion shpjegues G1-4 – Incidente të korrupsionit ose të ryshfetit*

22. Njësia ekonomike duhet të ofrojë informacion mbi incidentet e korrupsionit ose ryshfetit gjatë periudhës së raportimit.
23. Objektivi i kësaj Kërkese për Dhënie informacion shpjegues është të sigurojë transparencë mbi incidentet që lidhen me **korrupsionin** ose **ryshfetet** gjatë periudhës së raportimit dhe rezultatet përkatëse.
24. Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për:
- (a) Numrin e dënimeve dhe shumën e gjobave për shkelje të ligjeve kundër korrupsionit dhe kundër ryshfetit;<sup>132</sup> dhe

---

<sup>132</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion: të pjesëmarrësve në tregjet financiare që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088, pasi rrjedh nga një tregues shtesë që lidhet me ndikimet kryesore negative të përcaktuara në treguesin nr. 17 të Tabelës III të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacionit shpjegues për investimet e qëndrueshme ("Numri i dënimeve dhe shuma e gjobave për shkelje të ligjeve kundër korrupsionit dhe ryshfetit"); dhe administratorëve të standardeve më të mira për dhënie informacioni shpjegues mbi faktorët ESG, në përputhje me Rregulloren (BE) 2020/1816, siç përcaktohet nga treguesi "Numri i dënimeve dhe shuma e gjobave për shkelje të ligjeve kundër korrupsionit dhe ryshfetit" në seksionet 1 dhe 2 të Shtojcës II.

(b) çdo veprim të ndërmarrë për të adresuar shkeljet në procedurat dhe standardet e antikorrupsionit dhe anti-ryshfetit.<sup>133</sup>

25. Njësia ekonomike mund të japë informacion shpjegues për:

(a) numrin e përgjithshëm dhe natyrën e **incidenteve të konfirmuara** për korrupsion ose ryshfet;

(b) numrin e **incidenteve të konfirmuara** në të cilat punëtorët e vet u pushuan nga puna ose u ndëshkuan për korrupsion ose incidente të lidhura me ryshfetin;

(c) numrin e **incidenteve të konfirmuara** në lidhje me kontratat me partnerët e biznesit që janë ndërprerë ose nuk janë rinovuar për shkak të shkeljeve që lidhen me korrupsionin ose ryshfetin; dhe

(d) detaje të çështjeve ligjore publike në lidhje me **korrupsionin** ose **ryshfetin** të ngritura kundër njësisë ekonomike dhe punëtorëve të saj gjatë periudhës raportuese dhe rezultatet e rasteve të tilla. Kjo përfshin rastet që janë iniciuar në vitet e mëparshme, ku rezultati është përcaktuar vetëm në periudhën aktuale raportuese.

26. Shpjegimet që kërkohen duhet të përfshijnë **incidentet** duke përfshirë aktorët në **zinxhirin e saj të vlerës** vetëm kur njësia ekonomike ose **punonjësit** e saj janë të përfshirë drejtpërdrejt.

*Kërkesa për dhënie informacion shpjegues G1-5 – Ndikimi politik dhe aktivitetet e lobimit*

27. Njësia ekonomike duhet të ofrojë informacion mbi aktivitetet dhe angazhimet që lidhen me ndikimin e saj politik, duke përfshirë aktivitetet e lobimit që lidhen me ndikimet, rreziqet dhe mundësitë e saj materiale.

28. Objektivi i kësaj Kërkese për Dhënie informacion shpjegues është të sigurojë transparencë mbi aktivitetet dhe angazhimet e njësisë ekonomike në lidhje me ushtrimin e ndikimit të saj politik me kontribute politike, duke përfshirë llojet dhe qëllimin e **aktiviteteve të lobimit**.

29. Informacionin që kërkohet nga paragrafi 27 duhet të përfshijë::

(a) përfaqësuesin/përfaqësuesit përgjegjës në **organet administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse** për mbikëqyrjen e këtyre aktiviteteve, nëse është e zbatueshme;

(b) për kontributet politike financiare ose në natyrë të japë:

i. vlerën totale monetare të kontributeve financiare dhe të kontributeve politike në natyrë të bëra drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga njësia ekonomike, e përmbledhur sipas vendit ose zonës gjeografike, kur është e rëndësishme, si dhe natyrën e marrësit/përfituesit; dhe

---

<sup>133</sup> Ky informacion mbështet nevojat për informacion të pjesëmarrësve në tregjet financiare që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2019/2088, pasi rrjedh nga një tregues shtesë që lidhet me ndikimet kryesore negative të përcaktuara në treguesin nr. 16 të Tabelës III të Shtojcës I të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 në lidhje me rregullat e dhënies së informacionit shpjegues për investimet e qëndrueshme ("Raste të mungesës së veprimeve të mjaftueshme për të adresuar shkeljet e standardeve kundër korrupsionit dhe ryshfetit").

- ii. si është vlerësuar vlera monetare e kontributeve në natyrë, kur është e përshtatshme.
  - (c) temat kryesore të mbuluara nga **aktivitetet e saj të lobimit** dhe qëndrimet kryesore të njësisë ekonomike mbi to në mënyrë të shkurtër. Kjo duhet të përfshijë shpjegime se si kjo ndërvepron me ndikimet, rreziqet dhe mundësitë materiale të identifikuar në vlerësimin e **materialitetit** të saj sipas ESRS 2; dhe
  - (d) nëse njësia ekonomike është e regjistruar në Regjistrin e Transparencës së BE-së ose në një regjistër ekuivalent të transparencës në një Shtet Anëtar, emri i çdo regjistri të tillë dhe numri i identifikimit të saj në atë regjistër.
30. Dhënia e informacionit shpjegues duhet të përfshijë gjithashtu informacion në lidhje me emërimin e çdo anëtari të **organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse**, i cili ka mbajtur një pozicion të krahasueshëm në administratën publike (duke përfshirë entet rregullatore) në 2 vitet fundit para një emërimi të tillë në periudhën aktuale raportuese.

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese G1-6 – Praktikrat e Pagesës*

30. Njësia ekonomike duhet të ofrojë informacion mbi praktikrat e saj të pagesave, veçanërisht në lidhje me vonesat në pagesa për njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme (NVM).
31. Objektivi i kësaj Kërkesë për Dhënie informacion shpjegues është të ofrojë një kuptueshmëri mbi kushtet kontraktuale të pagesës dhe mbi performancën e saj në lidhje me pagesat, veçanërisht se si këto ndikojnë te Njësitë ekonomike të Vogla dhe të Mesme (NVM) dhe konkretisht në lidhje me pagesat e vonuara ndaj NVM-ve.
32. Dhënia e informacionit shpjegues sipas paragrafit 31 duhet të përfshijë:
- (a) kohën mesatare që i duhet njësisë ekonomike për të paguar një faturë nga data kur fillon të llogaritet afati kontraktual ose statutor i pagesës, në numër ditësh;
  - (b) një përshkrim të kushteve standarde të pagesave të njësisë ekonomike në numër ditësh sipas kategorive kryesore të **furnizuesve** dhe përqindjen e pagesave të saj në përputhje me këto kushte standarde;
  - (c) numrin e rasteve (çështjeve) ligjore (gjyqësore) që janë aktualisht në pritje (të pambyllura) për pagesa të vonuara; dhe
  - (d) informacion plotësues të nevojshëm për të ofruar kontekst të mjaftueshëm. Nëse njësia ekonomike ka përdorur kampion përfaqësues për të llogaritur informacionin e kërkuar sipas pikës (a), ajo duhet ta deklarojë këtë fakt dhe të përshkruajë shkurtimisht metodologjinë e përdorur.

## Shtojca A. Kërkesat për Zbatim

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e ESRS S1 *Drejtimi i Biznesit*. Ajo mbështet zbatimin e kërkesave për dhënie informacion shpjegues të përcaktuara në këtë standard dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të këtij Standardi.

### Menaxhimi i ndikimit, rrezikut dhe mundësisë

#### *Kërkesa për dhënie informacion shpjegues G1-1 – Politikat e drejtimit të biznesit dhe kultura e korporatës*

AR 1. Njësia ekonomike mund të marrë në konsideratë aspektet e mëposhtme kur përcakton informacionin shpjegues që duhet të japë sipas paragrafit 7:

- (a) aspektet e **kulturës korporative** që merren në konsideratë dhe diskutohen nga **organet administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse** si dhe shpeshtësia me të cilën ato diskutohen;
- (b) temat kryesore që promovohen dhe komunikohen si pjesë e kulturës korporative;
- (c) si anëtarët e organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse të njësisë ekonomike japin udhëzime për të promovuar një kulturë korporative; dhe
- (d) stimujt ose mjetet specifike për punonjësit e vet për të nxitur dhe inkurajuar kulturën e saj korporative.

#### *Kërkesa për dhënie informacion shpjegues G1-2 – Menaxhimi i marrëdhënieve me furnizuesit*

AR 2. Për qëllimet e këtij standardi, menaxhimi i marrëdhënieve me **furnitorët** e ndërmarrjes mund të përfshijë sa vijon:

- (a) si praktikat e njësisë ekonomike, duke përfshirë aktivitetet për të shmangur ose minimizuar ndikimet e ndërprerjeve në **zinxhirin e furnizimit**, mbështesin strategjinë dhe menaxhimin e riskut të saj;
- (b) trajnimin e fuqisë punëtore të zinxhirit të prokurimit/furnizimit të njësisë ekonomike mbi angazhimin dhe dialogun me **furnizuesit** si dhe stimujt e fuqisë punëtore të prokurimit, duke përfshirë nëse stimujt të tillë i referohen faktorëve të çmimit, cilësisë ose qëndrueshmërisë;
- (c) shqyrtimin dhe vlerësimin e performancës sociale dhe mjedisore të furnizuesve;
- (d) përfshirjen e furnizuesve vendas në zinxhirin e furnizimit dhe/ose të furnizuesve me certifikim;
- (e) si i trajtojnë praktikat e njësisë ekonomike furnizuesit e delikatë ose të cenueshëm;
- (f) **objektivat** e njësisë ekonomike dhe **veprimet** në lidhje me komunikimin dhe menaxhimin e marrëdhënieve me furnizuesit; dhe

(g) si vlerësohen rezultatet e këtyre praktikave, duke përfshirë vizitat që shkëmbehen me furnizuesit, auditimet ose pyetësorët.

AR 3. "Furnizues delikat ose të cenueshëm" përfshin **furnizuesit** që janë të ekspozuara ndaj rreziqeve të konsiderueshme ekonomike, mjedisore dhe/ose sociale.

*Kërkesa për dhënie informacion shpjegues G1-3 – Parandalimi dhe zbulimi i korrupsionit dhe ryshfetit*

AR 4. "Funksione në rrezik" do të thotë ato funksione që konsiderohen të jenë në rrezik **korrupsioni** dhe **ryshfeti** si rezultat i detyrave dhe përgjegjësi të tyre.

AR 5. Informacioni që mund të jepet në këtë rast mund të përfshijnë detaje rreth vlerësimeve dhe/ose hartëzimit të rrezikut, si dhe programeve të monitorimit dhe/ose procedurave të kontrollit të brendshëm të kryera nga njësia ekonomike për të zbuluar **korrupsionin** dhe **ryshfetin**.

AR 6. Politikat e njësisë ekonomike mbi **korrupsionin** dhe **ryshfet** mund të jenë të rëndësishme për grupe specifike njerëzish, sepse pritet që ata t'i zbatojnë ato (për shembull, **punonjësit**, kontraktorët dhe **furnizuesit** e njësisë ekonomike), ose sepse ata kanë një interes të drejtpërdrejtë në zbatimin e tyre (për shembull, **zinxhiri i vlerës**, punëtorë, investitorë). Njësia ekonomike mund të paraqesë mjetet dhe kanalet e komunikimit (p.sh., fletushka, buletine, faqe interneti të dedikuara, media sociale, ndërveprime ballë për ballë, sindikata dhe/ose përfaqësues të punëtorëve) për të komunikuar politikat e saj me grupe të tilla. Kjo mund të përfshijë gjithashtu identifikimin dhe/ose eliminimin e pengesave të mundshme për shpërndarjen e tyre, siç është përkthimi në gjuhët përkatëse ose përdorimi i përshkrimeve grafike.

AR 7. Njësia ekonomike mund të paraqesë një analizë të aktiviteteve të saj të trajnimit për shembull, sipas rajonit të trajnimit ose kategorive të **fuqisë së saj punëtore** ku programet e saj ndryshojnë ndjeshëm bazuar në faktorë të tillë dhe një informacioni i tillë do të ishte i dobishëm për përdoruesit.

AR 8. Njësia ekonomike mund të paraqesë informacionin e kërkuar në lidhje me trajnimin duke përdorur tabelën e mëposhtme:

**Shembull ilustrues i trajnimit kundër korrupsionit dhe ryshfetit**

*Gjatë vitit financiar 20XY, ABC ofroi trajnime për punonjësit e saj nën rrezik sipas politikës së saj (shih shënimin x). Për ato funksione në rrezik, trajnimi është i detyrueshëm, por ABC gjithashtu ofroi trajnime vullnetare për punonjësit e tjerë të saj. Detajet e trajnimit të saj gjatë vitit janë si më poshtë:*

	Funksionet në rrezik	Menaxherët	AMSB <sup>134</sup>	Punëtorë të tjerë të njësive ekonomike
<b>Mbuluar me trajnime</b>				
Totali	20,000	200	16	70,000
Totali i atyre që janë trajnuar	19,500	150	8	5,000
<b>Metoda dhe kohëzgjatja e dhenies së trajnimit</b>				
Trajnim në klasë	5 orë			
Trajnim nëpërmjet kompjuterit	1 orë	2 orë	1 orë	
Trajnim vullnetar me kompjuter				1 orë
<b>Shpeshtësia</b>				
Sa shpesh kërkohet trajnimi	I përvitshëm	I përvitshëm	Dy herë në vit	-
<b>Çështjet e trajtuara</b>				
Përkufizimi i korrupsionit	X	X	X	X
Politikë	X	X	X	X
Procedurat në rast dyshimi/zbulimi	X	X		
Etj.	X			

## Metrikat dhe objektivat

*Kërkesa për dhënie informacion shpjegues G1-5 – Ndikimi politik dhe aktivitetet e lobimit*

AR 9. Për qëllimet e këtij Standardi, "kontribut politik" do të thotë mbështetje financiare ose në natyrë e ofruar drejtpërdrejt partive politike, përfaqësuesve të tyre të zgjedhur ose personave që kërkojnë poste politike. Kontributet financiare mund të përfshijnë donacione, kredi, sponsorizime, pagesa paraprake për shërbime ose blerjen e biletave për ngjarje për mbledhjen e fondeve dhe praktika të tjera të ngjashme. Kontributet në natyrë mund të përfshijnë reklamimin, përdorimin e ambienteve, dizajnin dhe printime/publikime, dhurimin

<sup>134</sup> Organet administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse

e pajisjeve, anëtarësi në borde, punësimin ose shërbime konsulente për politikanë të zgjedhur ose kandidatë për poste publike.

AR 10. "Kontribut politik indirekt" i referohet atyre kontributeve politike të bëra përmes një organizate ndërmjetëse, siç është një lobist ose një organizatë bamirëse, ose mbështetjes së dhënë një organizate, siç është një grup ekspertësh ose një shoqatë tregtare e lidhur me ose që mbështet një parti ose kauza të caktuara politike.

AR 11. Gjatë përcaktimit të "pozicionit të krahasueshëm" në këtë standard, njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë faktorë të ndryshëm, duke përfshirë nivelin e përgjegjësisë dhe fushëveprimin e aktiviteteve të ndërmarra.

AR 12. Njësia ekonomike mund të ofrojë informacionin e mëposhtëm mbi kontributet e saj financiare ose në natyrë në lidhje me shpenzimet e saj të lobimit:

(a) shumën totale monetare të shpenzimeve të tilla të brendshme dhe të jashtme; dhe

(b) shumën totale të paguar për anëtarësim në shoqatat e lobimit.

AR 13. Nëse njësia ekonomike është e detyruar ligjërisht të jetë anëtare e një dhome tregtie ose një organizate tjetër që përfaqëson interesat e saj, ajo mund të deklarojë edhe këtë si rast.

AR 14. Për të përmbushur kërkesën në paragrafin 29(i), njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë përputhjen midis deklaratave të saj publike mbi ndikimet, rreziqet dhe mundësitë e saj materiale dhe **aktiviteteve të saj të lobimit**.

AR 15. Një shembull se si mund të duken këto informacione shpjeguese:

**Angazhimi politik (duke përfshirë aktivitetet e lobimit) shembull ilustrues**

*Gjatë vitit financiar 20XY, ABC u përfshi në aktivitete rreth rregullores së propozuar XXX, të cilat mund të kenë ndikime të konsiderueshme negative mbi **modelin e biznesit të saj** nëse zbatohet në formatin aktual. ABC konsideron se, ndërsa rregullorja e propozuar do të sjellë disa përmirësime në regjimin rregullator, siç është xxx, në formatin e saj aktual kostot që lidhen me xxx do të tejkalojnë përfitimet. ABC dhe homologët e saj vazhdojnë të punojnë me XXX (emri i entit rregullator) për të përmirësuar këtë ekuilibër.*

*ABC mbështeti gjithashtu partinë politike QRP në Shtetin X dhe partinë EFG në Shtetin Y pasi të dyja... ABC është e regjistruar në regjistrin e saj lokal të transparencës, d.m.th., XYZ, dhe numri i saj i regjistrimit është 987234.*

*Shumat në mijëra €.*

	2023	2022 [për t'u konfirmuar]
Financimi politik i ofruar	100	
Financimi për QRP	75	

	2023	2022 [për t'u konfirmuar]
Financimi për EFG	25	
	<b>100</b>	

*Kërkesa për dhënie informacione shpjeguese G1-6 – Praktikrat e Pagesës*

AR 16. Në disa raste, kushtet standarde kontraktuale të pagesës së njësisë ekonomike mund të ndryshojnë ndjeshëm në varësi të vendit ose llojit të **furnizuesit**. Në raste të tilla, informacioni në lidhje me kushtet standarde sipas kategorive kryesore të furnizuesve ose vendit ose rajonit gjeografik mund të jetë si shembuj të informacionit shtesë kontekstual për të shpjeguar informacionet e kërkuara në paragrafin 33(b).

AR 17. Një shembull se si mund të duket përshkrimi i kushteve standarde të kontratës në paragrafin 33(b):

*Kushtet standarde të pagesës së kontratës së ABC-së janë pagesa me marrjen e faturës nga shitësit me shumicë, të cilat përfaqësojnë afërsisht 80% të faturave të saj vjetore sipas vlerës. Ajo paguan për shërbimet e marra brenda 30 ditëve pas marrjes së faturës, të cilat përbëjnë rreth 5% të faturave të saj vjetore. Pjesa tjetër e faturave të saj paguhen brenda 60 ditëve nga marrja, përveç atyre në shtetin X, të cilat, në përputhje me standardet e tregut, paguhen brenda 90 ditëve nga marrja.*

## SHTOJCA II. SHKURTIME DHE FJALORI I TERMAVE

Kjo Shtojcë paraqet të gjitha shkurtime e gjetura në ESRS (Tabela 1) si dhe të gjithë termat e përcaktuar në ESRS (Tabela 2).

**Tabela 1. Shkurtime**

Shkurtimi	Përshkrimi
AMS	Sisteme Matëse të Automatizuara
AQI	Indekset e Cilësisë së Ajrit
KZ	Kërkesat për Zbatim
AWS	Aleanca për Administrimin e Ujit
BAT	Teknika më e Mirë në Dispozicion
BAT-AEL	Niveli i Emetimit i Lidhur me Teknikën më të Mirë në Dispozicion

Shkurtimi	Përshkrimi
BAT-AEPL	Niveli i Performancës Mjedisore i Lidhur me Teknikën më të Mirë në Dispozicion
BREFs	Dokumentet e Referencës për Teknikat më të Mira të Disponueshme
Btu	Njësitë Termike Britanike
CapEx	Shpenzimet Kapitale
CBD	Konventa për Diversitetin Biologjik
CDDA	Baza e Përbashkët e të Dhënave për Zonat e Përcaktuara
CEN	Komiteti Evropian për Standardizimin
CENELEC	Komiteti Evropian për Standardizimin Elektroteknik
CH4	Gazi Metan
CICES	Klasifikimi i Përbashkët Ndërkombëtar i Shërbimeve të Ekosistemeve
CO2	Dyoksidi i Karbonit
CRR	► <b>C1</b> Rregullorja (BE) 575/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit <sup>135</sup> (Rregullorja e Kërkesave për Kapitalin) ◀
DEGURBA	Shkalla e Urbanizimit
DR BP-1	Kërkesa për Dhënie Informacioni Shpjegues - Baza e përgjithshme për përgatitjen e deklaratave të qëndrueshmërisë
DR BP-2	Kërkesa për Dhënie Informacioni Shpjegues - Dhënia e informacioneve shpjeguese në lidhje me rrethanat specifike
DR GOV-1	Kërkesa për Dhënie Informacioni Shpjegues - Roli i organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse
DR GOV-2	Kërkesa për Dhënie Informacioni Shpjegues – Informacioni i dhënë dhe çështjet e qëndrueshmërisë të adresuara nga organet administrative, menaxhuese dhe mbikëqyrëse të njësisë ekonomike
DR GOV-3	Kërkesa për Dhënie Informacioni Shpjegues - Integrimi i performancës së lidhur me qëndrueshmërinë në skemat nxitëse
DR GOV-4	Kërkesa për Dhënie Informacioni Shpjegues - Deklaratë për kujdesin e duhur të qëndrueshmërisë
DR GOV-5	Kërkesa për Dhënie Informacioni Shpjegues - Menaxhimi i rrezikut dhe kontrollet e brendshme mbi raportimin e qëndrueshmërisë

<sup>135</sup> Rregullorja (BE) 575/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 qershor 2013 mbi kërkesat e kujdesit për institucionet e kreditit dhe firmat e investimeve dhe ndryshimin e Rregullores (BE) 648/2012 ( GZ L 176, 27.6.2013, f. 1).

Shkurtimi	Përshkrimi
DR SBM-1	Kërkesa për Dhënie Informacioni Shpjegues - Pozicioni i tregut, strategjia, modeli(et) e biznesit dhe zinxhiri i vlerës
DR SBM-2	Kërkesa për Dhënie Informacioni Shpjegues - Interesat dhe pikëpamjet e palëve të interesuara
DR SBM-3	Kërkesa për Dhënie Informacioni Shpjegues - Ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë dhe ndërveprimi i tyre me strategjinë dhe modelin(et) e biznesit
DR IRO-1	Kërkesa për Dhënie Informacioni Shpjegues - Përshkrimi i proceseve për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet materiale, rreziqet dhe mundësitë
DR IRO-2	Kërkesa për Dhënie Informacioni Shpjegues në ESRS që mbulojnë nga deklaratat e qëndrueshmërisë së njësisë ekonomike
DNSH	Parimi “mos bëj dëm të rëndësishëm”
DR	Kërkesat për Dhënie Informacione Shpjeguese
EBA	Autoriteti Bankar Evropian
EC	Komisioni Evropian
EEA	Zona Ekonomike Evropiane
EFRAG	Grupi Këshillues Evropian i Raportimit Financiar
EFRAG SRB	Grupi Këshillues Evropian i Raportimit Financiar mbi Qëndrueshmërinë Bordi i Raportimit
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
EMAS	Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit dhe të Auditimit
EPC	Certifikata e Performancës së Energjisë
E-PRTR	Regjistri Evropian i Emetimit dhe Transferimit të Ndotjeve
ESA	Autoritetet Mbikëqyrëse Evropiane
ESMA	Autoriteti Evropian i Letrave me Vlerë dhe Tregjeve (i tregjeve Financiare)
ESRS	Standardet Evropiane të Raportimit të Qëndrueshmërisë
ESRS 1	Standardi Evropian i Raportimit të Qëndrueshmërisë 1 Kërkesa të përgjithshme
ESRS 2	Standardi Evropian i Raportimit të Qëndrueshmërisë 2 Dhënia e Informacioneve shpjeguese të përgjithshme
ESRS E1	Standardi Evropian i Raportimit të Qëndrueshmërisë E1 Ndryshimet klimatike
ESRS E2	Standardi Evropian i Raportimit të Qëndrueshmërisë E2 Ndotja

Shkurtimi	Përshkrimi
ESRS E3	Standardi Evropian i Raportimit të Qëndrueshmërisë E3 Burimet ujore dhe detare
ESRS E4	Standardi Evropian i Raportimit të Qëndrueshmërisë E4 Biodiversiteti dhe ekosistemet
ESRS E5	Standardi Evropian i Raportimit të Qëndrueshmërisë E5 Përdorimi i burimeve dhe ekonomia qarkulluese
ESRS G1	Standardi Evropian i Raportimit të Qëndrueshmërisë G1 Drejtimi i biznesit
ESRS S1	Standardi Evropian i Raportimit të Qëndrueshmërisë S1 Fuqia e vet punëtore
ESRS S2	Standardi Evropian i Raportimit të Qëndrueshmërisë S2 Punëtorët në zinxhirin e vlerës
ESRS S3	Standardi Evropian i Raportimit të Qëndrueshmërisë S3 Komunitetet e prekura
ESRS S4	Standardi Evropian i Raportimit të Qëndrueshmërisë S4 Konsumatorët dhe përdoruesit fundorë
BE	Bashkimi Evropian
EU ETS	Sistemi i Tregtimit të Emetimeve të Bashkimit Evropian
EWC	Këshilli Evropian i Punëve
FPIC	Dakordësi e Lirë, Paraprake dhe e Informuar
FTE	Ekuivalent me kohë të plotë
GAAP	Parimet e Kontabilitetit të Pranuara Përgjithësisht
GHG	Gaz me efekt serrë
GJ	Giga-Xhaul (njësi matëse termike)
GRI	Iniciativa Globale e Raportimit
GWP	Potenciali i Ngrohjes Globale
HFCs	Hidrofluorokarburet
IED	Direktiva 2010/75/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit <sup>136</sup> (Direktiva e Emetimeve Industriale)
IFC	Korporata Ndërkombëtare Financiare
SNRF	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës

<sup>136</sup> Direktiva 2010/75/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 24 nëntorit 2010 mbi emetimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes) ( GZ L 334, 17.12.2010, f. 17).

Shkurtimi	Përshkrimi
IPBES	Platforma Ndërqeveritare Shkencë-Politikë për Biodiversitetin dhe Shërbimet e Ekosistemit
IPCC	Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike
ISEAL	Aleanca Ndërkombëtare për Akreditimin dhe Etiketimin Social dhe Mjedisor
ISO	Organizata Ndërkombëtare për Standardizim
ISSB	Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Qëndrueshmërisë
ITS	Zbatimi i Standardeve Teknike
IUCN	Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
KBA	Zonat Kryesore të Biodiversitetit
Kg	Kilogram
lb	Paund (njësi peshimi)
LEAP	Gjeni, Vlerësoni, Çmoni, Përgatisni
LGBTQI	Grupe shoqërore që zgjedhin të identifikohen ndryshe nga klasifikimi gjinor tradicional femër/mashkull
MDR	Kërkesa Minimale për Dhënie Informacione Shpjeguese
MWh	Mega-vat orë
N <sub>2</sub> O	Oksidi i Azotit
NACE	Klasifikimi Statistikor i Aktiviteteve Ekonomike në Komunitetin Evropian
NF <sub>3</sub>	Trifluori i azotit
OJF/OJQ	Organizatë Joqeveritare
NH <sub>3</sub>	Amoniak
NOX	Oksidet e azotit
NUTS	Nomenklatura e Njësive Territoriale të Statistikave
O <sub>3</sub>	Ozon
ODS	Substancë që shkatërron ozonin
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OECDM	Model i vetëm i klimës së Tokës
OpEX	Shpenzime Operative
PBTS	Substanca të qëndrueshme, bioakumuluese dhe toksike
PCAF	Partneriteti për Kontabilitetin Financiar të Karbonit
PCFs	Perfluorokarburet

Shkurtimi	Përshkrimi
PM	Materia e grimcave shumë të imta
PMTs	Substancat e qëndrueshme, të lëvizshme dhe toksike
POPs	Ndotës organikë të qëndrueshëm
REACH	Regjistrimi, Vlerësimi, Autorizimi dhe Kufizimi i Lëndëve Kimike
SBTi	Nisma e objektivave të bazuara në shkencë
SBTN	Rrjeti i objektivave të bazuara në shkencë
SCE	Shoqëria Evropiane e Kooperativave
SDA	Qasja e Dekarbonizimit Sektorial
SDGs	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
SDPI	Treguesi i Performancës së Zhvillimit të Qëndrueshëm
SE	Shoqëria Evropiane
SEEA	Sistemi i Kontabilitetit Mjedisor-Ekonomik
SEEA EA	Sistemi i Kontabilitetit Mjedisor-Ekonomik, Kontabiliteti i Ekosistemit
SFDR	Rregullorja (BE) 2019/2088 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit <sup>137</sup> (Rregullorja e Dhënies së Informacioneve shpjeguese për Financa të Qëndrueshme)
SOX	Oksidet e squfurit
SVHC	Substancat me Shumë Shqetësuese
TCFD	Grupi i Punës për Dhënie Informacionesh Shpjeguese Financiare të Lidhura me Klimën
TNFD	Grupi i Punës për Dhënien Informacionesh Shpjeguese Financiare të Lidhura me Natyrën
OKB	Kombet e Bashkuara
UNEP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
vPvBs	Substanca shumë të qëndrueshme dhe shumë bioakumuluese
vPvMs	Substanca shumë të qëndrueshme dhe shumë të lëvizshme
WDPA	Baza e të dhënave Botërore të Zonave të Mbrojtura
WRI	Instituti i Burimeve Botërore

<sup>137</sup> Rregullorja (BE) 2019/2088 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 nëntor 2019 mbi shënimet shpjeguese të lidhura me qëndrueshmërinë në sektorin e shërbimeve financiare ( GZ L 317, 9.12.2019, f. 1).

Shkurtimi	Përshkrimi
WWF	Fondi mbarë botëror për natyrën

**Tabela 2. Termat e përcaktuara në ESRS**

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
<b>Veprimet</b>	<p><b>Veprimet</b> i referohen për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>i. <b>veprimet</b> dhe planet e veprimit (përfshirë <b>planet e periudhës kalimtare</b>) që ndërmerren për të siguruar që njësia ekonomike të veprojë sipas <b>objektivave</b> të caktuar dhe nëpërmjet të cilave njësia ekonomike kërkon të trajtojë ndikimet e <b>rëndësishme, rreziqet dhe mundësitë</b>; dhe</li> <li>ii. vendimet për t'i mbështetur këto veprime me burime financiare, njerëzore ose teknologjike.</li> </ul>
<b>Aktor në zinxhirin e vlerës</b>	<p>Individë ose subjekte në rrjedhën e sipërme ose të poshtme të <b>zinxhirit të vlerës</b>. Konsiderohet <b>aktor</b> në rrjedhën e poshtme të njësisë ekonomike (p.sh., distributorët, klientët) kur merr produkte ose shërbime nga njësia ekonomike; konsiderohet aktor në rrjedhën e sipërme të njësisë ekonomike (p.sh. <b>furnitorët</b>) kur ofron produkte ose shërbime që përdoren në prodhimin e produkteve ose shërbimeve të vetë njësisë ekonomike.</p>
<b>Paga e duhur</b>	<p>Një pagë që siguron plotësimin e nevojave të punëtorit dhe të familjes së tij në dritën e kushteve ekonomike dhe sociale kombëtare.</p>
<b>Organet administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse</b>	<p>Organet e qeverisjes me autoritetin më të lartë vendimmarrës në një njësi ekonomike përfshi dhe këshillat/komitetet e saj. Nëse në strukturën qeverisëse nuk ka anëtarë të <b>organeve administrative, drejtuese apo mbikëqyrëse</b> të njësisë ekonomike, atëherë Drejtori Ekzekutiv (Administratori) dhe zëvendës drejtori nëse ekziston një funksion i tillë, përfshihen në këtë përkufizim gjithashtu. Në disa juridiksione, sistemet e qeverisjes përbëhen nga dy nivele, ku mbikëqyrja dhe menaxhimi janë të ndara. Në raste të tilla, të dy nivelet përfshihen në përkufizimin e organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse.</p>

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
<b>Komunitetet e Prekura</b>	Njerëz ose grup(e) që jetojnë ose punojnë në të njëjtën zonë që janë prekur ose mund të preken nga operacionet e një njësie ekonomike raportuese ose përmes <b>zinxhirit të vlerës</b> së saj në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme. <b>Komunitetet e prekura</b> mund të variojnë nga ata që jetojnë pranë aktivitetit të njësisë ekonomike (komunitetet lokale) deri te ata që jetojnë në distancë. <b>Komunitetet e prekura</b> përfshijnë popujt indigjenë të prekur realisht dhe potencialisht.
<b>Shpërblimi total vjetor</b>	<b>Shpërblimi total vjetor për fuqinë e vet punëtore</b> përfshin pagën, shtesat, shpërblimet në aksione, shpërblimet në opsione, skemën e kompensimi nxitës në letrat me vlerë jo të kapitalit, ndryshimin në vlerën e pensionit dhe fitimet e kompensimit të shtyrë të pakualifikuara të ofruara gjatë një viti.
<b>Efektet e parashikuara financiare</b>	Efektet financiare që nuk plotësojnë kriteret e njohjes për përfshirje në zërat përkatës të pasqyrës financiare në periudhën raportuese dhe që nuk përfshihen nga <b>efektet aktuale financiare</b> .
<b>Zonë në rrezik uji</b>	Një ujëmbledhës, ku disa aspekte fizike që lidhen me ujin: <ul style="list-style-type: none"> <li>i. çojnë një ose më shumë trupa ujorë që të jenë në status më pak se të mirë dhe/ose përkeqësohen në status (siç përcaktohet në Direktivën 2000/60/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit,<sup>138</sup> duke vënë në dukje kështu çështje të rëndësishme në lidhje me disponueshmërinë, cilësinë, sasinë e ujit (përfshirë stresin e lartë të ujit); dhe/ose</li> <li>ii. çojnë në çështje që kanë lidhje me qasjen e ujit, çështje rregullatore ose të prestigjit (përfshirë përdorimin e përbashkët të ujit me komunitetet dhe përbalueshmërinë e ujit) për objektet e zonës dhe për objektet e furnizuesit(ve) kyç.</li> </ul>
<b>Zona me stres të lartë të ujit</b>	Rajonet ku përqindja e totale e tërheqjes së ujit është e lartë (40-80%) ose jashtëzakonisht e lartë (më e madhe se 80%) sipas Atlasit të Rrezikut të Ujit të Pijshëm nga Instituti Botëror i Burimeve (WRI). Shihni gjithashtu <b>mungesën e ujit</b> .

<sup>138</sup> Direktiva 2000/60/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 tetor 2000 që përcakton një kuadër për veprimin e Komunitetit në fushën e politikës së ujit (GZ L 327, 22.12.2000, p. 1).

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
<b>Materialet shoqëruese të procesit</b>	Materialet që nevojiten për procesin e prodhimit, por që nuk janë pjesë e produktit përfundimtar, siç janë lubrifikantët për makineritë e prodhimit.
<b>Konkluzionet e teknikave më të mira në dispozicion (BAT).</b>	Një dokument që përmban pjesët e një dokumenti të referuar si teknikat më të mira <b>BAT</b> që përcakton konkluzionet mbi <b>teknikat</b> më të mira në dispozicion, përshkrimin e tyre, informacionin për të vlerësuar zbatueshmërinë e tyre, nivelet e <b>emetimit</b> të lidhura me <b>teknikat më të mira në dispozicion</b> , nivelet e performancës mjedisore të lidhura me teknikat më të mira në dispozicion, përmbajtjen minimale të një sistemi të menaxhimit mjedisor duke përfshirë standardet e lidhura me <b>teknikat më të mira në dispozicion</b> , monitorimin përkatës, nivelet e konsumit përkatës dhe, sipas rastit, masat përkatëse për <b>rehabilitimin e vendit</b> . <sup>139</sup>
<b>Niveli i emetimit i lidhur me teknikën më të mirë në dispozicion (BAT- AEL)</b>	Vargu i niveleve të <b>emetimit</b> që merret në kushte normale funksionimi duke përdorur një teknikë më të mirë në dispozicion ose një kombinim të <b>teknikave më të mira në dispozicion</b> , siç përshkruhet në <b>konkluzionet e BAT</b> -ve i shprehur si një mesatare për një periudhë të caktuar kohore, në kushte referimi të specifikuara, p.sh., niveli i <b>emetimit</b> që lidhet me një <b>BAT</b> .
<b>Niveli i emetimit i lidhur me teknikën më të mirë të disponueshëm (BAT-AEPL)</b>	Vargu i niveleve të performancës mjedisore, përveç nivelit të emetimit, i marrë në kushte normale veprimtarie duke përdorur një <b>BAT</b> ose një kombinim të <b>BAT-ve</b> . <sup>140</sup>
<b>Teknikat më të mira në dispozicion (BAT)<sup>141</sup></b>	Faza më efektive dhe më e avancuar në zhvillimin e aktiviteteve dhe metodave të funksionimit të tyre, e cila tregon përshtatshmërinë praktike të teknikave të veçanta për sigurimin e bazës për vlerat limit të <b>emetimit</b> dhe kushteve të tjera të lejuara të krijuara për të parandaluar dhe, kur kjo nuk është praktike për të pakësuar <b>emetimet</b> dhe ndikimin në mjedis në tërësi nënkupton:

<sup>139</sup> Direktiva 2010/75/BE mbi emetimet industriale (IED).

<sup>140</sup> Vendimi për Implementim i Komisionit i 10 shkurtit 2012 paraqet rregullat lidhur me udhëzimin për mbledhjen e të dhënave dhe hartimin e dokumentave referencë BAT dhe mbi sigurimin e cilësisë së tyre sipas Direktivës 2010/75/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për emetimet industriale (GZ L 63, 2.3.2012, p. 1).

<sup>141</sup> Neni 3, pika 10 e Direktivës 2010/75/BE mbi emetimet industriale (IED).

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
	<p>i. "teknikat" që përfshijnë si teknologjinë e përdorur ashtu edhe mënyrën në të cilën një impiant i caktuar është projektuar, ndërtuar, mirëmbajtur, përdorur dhe çinstaluar;</p> <p>ii. "teknikat në dispozicion" që janë zhvilluar në një shkallë që mundësojnë zbatimin e tyre në sektorin përkatës industrial, në kushte të qëndrueshme ekonomike dhe teknike, duke marrë parasysh kostot dhe avantazhet, pavarësisht nëse teknikat përdoren apo prodhohen brenda Shtetit Anëtar në fjalë, për sa kohë që operatori ka qasje të arsyeshme ndaj tyre; dhe</p> <p>iii. "më e mira" do të thotë më efektive në arritjen e një niveli të lartë të përgjithshëm të mbrojtjes së mjedisit në tërësi.</p>
<b>Humbja e biodiversitetit</b>	<p>Pakësimi i çdo aspekti të <b>diversitetit biologjik</b> (d.m.th.. diversiteti në nivel gjenetike, specie dhe ekosistemi) në një zonë të caktuar nëpërmjet vdekjes (përfshirë zhdukjen), shkatërrimit ose heqjes fizike manuale; mund të shfaqet në shkallë të ndryshme, nga zhdukjet globale deri tek zhdukjet e popullsisë, duke sjellë në uljen e diversitetit total në të njëjtën shkallë.</p>
<b>Biodiversiteti ose diversiteti biologjik</b>	<p>Ndryshueshmëria midis organizmave të gjallë nga të gjitha burimet, duke përfshirë <b>ekosistemet</b> tokësore, detare dhe ekosisteme të tjera ujore dhe komplekset ekologjike ku ato bëjnë pjesë. Kjo përfshin ndryshime në atributet gjenetike, fenotipike, filogjenetike dhe funksionale, si dhe ndryshime në bollëk dhe shpërndarje me kalimin e kohës dhe hapësirës brenda dhe midis specieve, komuniteteve biologjike dhe <b>ekosistemeve</b>.</p>
<b>Zonë e ndjeshme ndaj biodiversitetit</b>	<p>Rrjeti Natyra 2000 i <b>zonave të mbrojtura</b>, vendet e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s dhe <b>zonat kryesore të biodiversitetit</b> ("KBA-të"), si dhe <b>zona të tjera të mbrojtura</b>, siç përmendet në Shtojcën D të Aneksit II të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2021/2139.<sup>142</sup></p>

<sup>142</sup> Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2021/2139 e 4 qershorit 2021 që plotëson Rregulloren (BE) 2020/852 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit duke përcaktuar kriteret teknike të shqyrtimit për përcaktimin e kushteve sipas të cilave një aktivitet ekonomik kualifikohet se kontribuon në mënyrë të rëndësishme në zbutjen ose përshtatjen e ndryshimit klimatik dhe për të përcaktuar nëse ai aktivitet ekonomik shkakton dëm jo të rëndësishëm tek objektivat e tjerë mjedisorë (GZ L 442, 9.12.2021, p. 1).

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
<b>Integriteti i biosferës ose integriteti ekologjik</b>	Aftësia e një <b>ekosistemi</b> për të mbështetur dhe ruajtur proceset ekologjike dhe një bashkësi të ndryshme organizmash.
<b>Ekonomia blu</b>	<b>Ekonomia blu</b> përfshin të gjitha industritë dhe sektorët që lidhen me oqeanet, detet dhe brigjet, qofshin ato të bazuara në mjedisin detar (p.sh., transporti detar, peshkimi, gjenerimi i energjisë) ose në tokë (p.sh. portet, kantieret detare, akuakultura në tokë dhe prodhimi i algave, turizmi bregdetar).
<b>Dokumentet e referencës BREF ose Teknikat më të mira në dispozicion të BE-së</b>	Një dokument që rezulton nga shkëmbimi i informacionit të organizuar në përputhje me nenin 13 të Direktivës 2010/75/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit) <sup>143</sup> mbi emetimet industriale, hartuar për aktivitete të përcaktuara dhe përshkruan, në veçanti, teknikat e zbatuara, <b>emetimet</b> aktuale dhe nivelet e konsumit, teknikat për t'u konsideruar në përcaktimin e <b>teknikave më të mira në dispozicion</b> si dhe <b>konkluzionet e BAT</b> dhe çdo teknikë në zhvillim, duke i kushtuar vëmendje të veçantë kriterëve të renditura në Aneksin III të Direktivës 2010/75/BE.
<b>Ryshfeti</b>	Të bindësh në mënyrë të pandershme dikë që të veprojë në favorin tënd duke i dhënë një dhuratë në formë parash ose një nxitje tjetër.
<b>Modeli i biznesit</b>	Sistemi i njësisë ekonomike për transformimin e inputeve në outpute dhe rezultate nëpërmjet aktiviteteve të saj që synon të përmbushë qëllimet strategjike të njësisë ekonomike dhe të krijojë vlerë në afat të shkurtër, të mesëm dhe afatgjatë. ESRS përdor termin " <b>model biznesi</b> " në numrin njëjës, megjithëse pranohet se njësitë ekonomike mund të kenë më shumë se një model biznesi.
<b>Marrëdhëniet e biznesit</b>	Marrëdhëniet që njësia ekonomike ka me partnerët e biznesit, subjektet në zinxhirin e vlerës së saj, dhe çdo subjekt tjetër joshтетëror ose shtetëror i lidhur drejtpërdrejt me veprimtarinë, produktet ose shërbimet e tij të biznesit. Marrëdhëniet e biznesit nuk kufizohen në marrëdhëniet e drejtpërdrejta kontraktuale. Ato përfshijnë <b>marrëdhënie të tërthorta biznesi</b> në zinxhirin e vlerës së njësisë ekonomike

<sup>143</sup> Direktiva 2010/75/BE mbi emetimet industriale (IED).

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
	përtej nivelit të parë, dhe pozicione aksionmbajtëse në sipërmarrje të përbashkëta ose investime.
<b>Nënprodukt</b>	<p>Një <b>substancë</b> ose objekt që rezulton nga një proces prodhimi, qëllimi kryesor i të cilit nuk është prodhimi i asaj <b>substancë</b> ose objekti konsiderohet të mos jetë mbetje, por të jetë një <b>nënprodukt</b> nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>i. përdorimi i mëtejshëm i <b>substancës</b> ose objektit është i sigurt;</li> <li>ii. <b>substancë</b> ose objekti mund të përdoren drejtpërdrejt pa ndonjë përpunim të mëtejshëm përveç praktikës normale industriale;</li> <li>iii. <b>substancë</b> ose objekti prodhohen si pjesë përbërëse e një procesi prodhimi; dhe</li> <li>iv. përdorimi i mëtejshëm është i ligjshëm, d.m.th., <b>substancë</b> ose objekti përmbush të gjitha kërkesat përkatëse të produktit, mjedisit dhe shëndetit për përdorimin specifik dhe nuk do të çojë në ndikime të përgjithshme negative mjedisore ose në <b>shëndetin e njeriut</b>.</li> </ul>
<b>Kredi karboni</b>	Një instrument i transferueshëm ose i tregtueshëm që përfaqëson një <b>pakësim</b> ose largimi të <b>emetimeve</b> ekuivalente të barabartë me një ton CO <sub>2</sub> që lëshohet dhe verifikohet sipas standardeve të njohura të cilësisë.
<b>Ekivalenti i dyoksidit të karbonit (CO<sub>2</sub>) (eq)</b>	Njësia universale e matjes për të treguar potencialin e <b>ngrohjes globale (GWP)</b> të çdo gazi me efekt serrë, të shprehur në terma të <b>GWP</b> për një njësi të dyoksidit të karbonit. Përdoret për të vlerësuar çlirimin (ose shmangien e çlirimit) të <b>gazrave të ndryshme me efekt serrë</b> mbi një bazë të përbashkët.
<b>Puna e fëmijëve</b>	<p>Punë që u privon fëmijëve fëmijërinë, potencialin dhe dinjitetin e tyre dhe që është e dëmshme për zhvillimin fizik dhe mendor. I referohet punës që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>i. është e rrezikshme dhe e dëmshme mendërisht, fizikisht, shoqërisht ose moralisht për fëmijët; dhe/ose</li> </ul>

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
	<p>ii. ndërhyt në shkollimin e tyre duke ua hequr mundësinë për të ndjekur shkollën; detyron ata për të lënë shkollën para kohe; ose duke u kërkuar që ata të përpiqen të kombinojnë frekuentimin e shkollës me një punë tepër të gjatë dhe të rëndë.</p> <p>Një fëmijë përkufizohet si një person nën moshën 18 vjeç. Nëse forma të veçanta të “punës” mund të quhen ose jo si <b>“punë e fëmijëve”</b> varet nga moshja e fëmijës, lloji dhe orët e punës së kryer dhe kushtet në të cilat ajo kryhet. Përgjigja ndryshon nga një vend në një tjetër, si dhe midis sektorëve brenda vendeve.</p> <p>Moshja minimale e punës nuk duhet të jetë më e vogël se moshja minimale e përfundimit të shkollimit të detyrueshëm dhe, në çdo rast, nuk duhet të jetë më e vogël se 15 vjeç sipas Konventës nr. 138 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) për moshën minimale. Përjashtime mund të ndodhin në vende të caktuara ku ekonomitë dhe sistemet arsimore nuk janë mjaftueshëm të zhvilluara dhe zbatohet një moshë minimale prej 14 vjetësh.</p> <p>Këto vende të përjashtuara specifikohen nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) në përgjigje të një kërkesë të veçantë nga vendi në fjalë dhe në konsultim me organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe punëtorëve.</p> <p>Ligjet kombëtare mund të lejojnë punësimin e personave 13 deri në 15 vjeç në punë të lehta për sa kohë që nuk ka gjasa që kjo të jetë e dëmshme për shëndetin ose zhvillimin e tyre dhe nuk paragjykon ndjekjen e shkollës ose pjesëmarrjen në programe profesionale ose trajnime prej tyre. Moshja minimale për t'u pranuar në një punë e cila nga natyra e saj ose nga rrethanat në të cilat kryhet ka gjasa të rrezikojë shëndetin, sigurinë ose moralin e të rinjve nuk duhet të jetë më pak se 18 vjeç.</p>
<b>Ekonomia qarkulluese</b>	<p>Një sistem ekonomik në të cilin vlera e produkteve, materialeve dhe burimeve të tjera në ekonomi ruhet (mirëmbahet) për aq kohë sa të jetë e mundur, duke rritur përdorimin efikas të tyre në prodhim dhe konsum, duke ulur kështu ndikimin mjedisor të përdorimit të tyre, duke</p>

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
	minimizuar <b>mbetjet</b> dhe çlirimin e substancave të rrezikshme në të gjitha fazat e ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë dhe zbatimin e <b>hierarkisë së mbetjeve</b> .
<b>Parimet e ekonomisë qarkulluese</b>	Parimet evropiane të ekonomisë qarkulluese janë: i. përdorshmëria; ii. ripërdorimi; iii. riparueshmëria; iv. çmontueshmëria; v. riprodhimi ose rinovimi; vi. <b>riciklimi</b> ; vii. riqarkullimi sipas ciklit biologjik; viii. mundësi të tjera optimale të përdorimit të produktit dhe materialit.
<b>Shkalla e përdorimit të materialit qarkullues</b>	Riqarkullimi i materialeve, komponentëve dhe produkteve në praktikë pas përdorimit të parë duke përdorur strategjitë e mëposhtme (sipas preferencës): i. mirëmbajtja/zgjatja e përdorimit; ii. ripërdorimi /rishpërndarja; iii. rinovimi/riprodhimi; iv. riciklimi, përzierja ose tretja anaerobike. <b>Shkalla e përdorimit</b> përkufizohet si raporti i përdorimit qarkullues të materialeve mbi atë të përdorimit të përgjithshëm të materialeve.
<b>Informacion i klasifikuar</b>	<b>Informacione të klasifikuara</b> të BE-së siç përcaktohet në Vendimin e Këshillit 2013/488/BE <sup>144</sup> mbi rregullat e sigurisë për mbrojtjen e <b>informacionit të klasifikuar</b> të BE-së ose të klasifikuara nga një prej Shteteve Anëtare dhe të shënuara sipas Shtojcës B të atij vendimi të Këshillit.
<b>Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike</b>	Procesi i përshtatjes me ndryshimet aktuale dhe të pritshme klimatike dhe ndikimet e saj.

<sup>144</sup> 2013/488/BE: Vendimi i Këshillit i 23 shtatorit 2013 mbi rregullat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të BE (GZ L 274, 15.10.2013, p. 1).

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
<b>Zbutja e ndryshimeve klimatike</b>	Procesi i pakësimit të <b>emetimeve GHG</b> dhe ndalimi i rritjes së temperaturës mesatare globale në 1,5 °C mbi nivelet para-industriale, në përputhje me Marrëveshjen e Parisit.
<b>Qëndrueshmëria ndaj klimës</b>	Kapaciteti i një njësie ekonomike për t'u përshtatur me ndryshimet klimatike dhe me zhvillimet ose pasiguritë që lidhen me ndryshimet klimatike. <b>Qëndrueshmëria ndaj klimës</b> përfshin kapacitetin për të menaxhuar objektivat e <b>Perimetrit 1</b> të lidhur me klimën dhe përfitimet nga mundësitë që lidhen me klimën, duke përfshirë aftësinë për t'iu përgjigjur dhe përshtatur <b>rreziqeve të tranzicionit</b> dhe <b>rreziqeve fizike</b> . Qëndrueshmëria e një njësie ekonomike <b>ndaj klimës</b> përfshin si qëndrueshmërinë e saj strategjike ashtu edhe qëndrueshmërinë operacionale ndaj ndryshimeve, zhvillimeve ose pasigurive të lidhura me klimën.
<b>Mundësitë në lidhje me klimën</b>	Efektet e mundshme pozitive në lidhje me ndryshimet klimatike për njësinë ekonomike. Përpjekjet për të zbutur dhe përshtatur ndryshimet klimatike mund të prodhojnë mundësi për njësitë ekonomike. <b>Mundësitë lidhur me klimën</b> do të jenë në varësi të rajonit, tregut dhe industrisë ku operon një njësi ekonomike.
<b>Rreziku fizik i lidhur me klimën (Rreziku fizik nga ndryshimet klimatike)</b>	<b>Rreziqet</b> që rezultojnë nga ndryshimet klimatike që mund të jenë të nxitura nga ngjarje të caktuara (akute) ose nga ndryshimet afatgjata (kronike) në modelet klimatike. <b>Rreziqet akute fizike</b> lindin nga rreziqe të veçanta, veçanërisht ngjarje të lidhura me motin, si stuhitë, përmytjet, zjarret ose valët e të nxehtit. <b>Rreziqet fizike kronike</b> lindin nga ndryshimet afatgjata në klimë, të tilla si ndryshimet e temperaturës dhe efektet e tyre në rritjen e nivelit të detit, pakësimi i ujit në dispozicion, <b>humbja e biodiversitetit</b> dhe ndryshimet në terren dhe në <b>produktivitetin</b> e tij.
<b>Rreziku i tranzicionit të lidhur me klimën</b>	<b>Rreziqet</b> që lindin nga kalimi në një ekonomi me karbon të ulët dhe të qëndrueshme ndaj klimës. Ato zakonisht përfshijnë <b>rrezikun politik</b> , <b>rreziqet</b> ligjore, <b>rreziqet</b> e teknologjisë, <b>rreziqet</b> e tregut dhe <b>rreziqet</b> e prestigjit.
<b>Marrëveshje kolektive</b>	Të gjitha marrëveshjet që zhvillohen ndërmjet një punëdhënësi, një grupi punëdhënësish ose një ose më shumë organizatash punëdhënësish, nga njëra anë, dhe një ose më

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
	<p>shumë sindikatave ose, në mungesë të tyre, përfaqësuesve të punëtorëve të zgjedhur dhe të autorizuar në mënyrën e duhur prej tyre në përputhje me ligjet dhe rregulloret kombëtare, nga ana tjetër, për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>i. përcaktimin e kushteve të punës; dhe/ose</li> <li>ii. rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet punëdhënësve dhe punëmarrësve; dhe/ose rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet punëdhënësve ose organizatave të tyre dhe një organizate ose disa organizatave të punëmarrësve.</li> </ul>
<p><b>Incident i konfirmuar (fëmijë që punon ose punë e detyruar ose trafikim njerëzor)</b></p>	<p><b>Incident</b> në lidhje me një fëmijë ose <b>punë të detyruar</b> apo trafikim të qenieve njerëzore për të cilin është vërtetuar konstatimi. <b>Incidentet e konfirmuara</b> nuk përfshijnë <b>incidentet</b> të fëmijëve ose të <b>punës së detyruar</b> ose trafikimit të qenieve njerëzore që janë ende nën hetim në periudhën raportuese.</p>
<p><b>Incident i konfirmuar korrupsioni ose ryshfeti</b></p>	<p>Një <b>incident i korrupsionit</b> ose <b>ryshfetit</b> për të cilin është vërtetuar konstatimi. <b>Incidente të konfirmuara të korrupsionit</b> apo ryshfetit nuk përfshijnë <b>incidente të korrupsionit</b> ose ryshfet që janë ende nën hetim në fund të periudhës raportuese. Vërtetësia e rasteve të mundshme të mospërputhshmërisë, siç konstatohet, mund të bëhet nga zyrtari i pajtueshmërisë ose një funksion i ngjashëm i njësisë ekonomike, ose nga një autoritet. Nuk kërkohet një përcaktim i vërtetuar nga një gjykatë.</p>
<p><b>Konsumatori</b></p>	<p>Individët që blejnë, konsumojnë ose përdorin mallra dhe shërbime për përdorim personal, qoftë për veten e tyre ose për të tjerët, dhe jo për qëllime të tilla si rishitje, tregtare, biznesi, artizanale ose profesioni.</p>
<p><b>Kulturë korporative</b></p>	<p><b>Kultura e korporatës</b> i shpreh qëllimet e saj nëpërmjet vlerave dhe besimeve. Ajo i drejton aktivitetet e njësisë ekonomike nëpërmjet supozimeve të përbashkëta dhe normave të grupit si psh., deklarata e vlerave ose deklaratat e misionit apo kodi i sjelljes.</p>
<p><b>Korrupsioni</b></p>	<p>Abuzimi nëpërmjet pushtetit ose besimit për përfitime private, i cili mund të nxitet si nga individë ashtu dhe nga organizata. Ai përfshin praktika të tilla si pagesa për lehtësira, mashtrimi, zhvatja, marrëveshje të fshehta dhe pastrimi i</p>

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
	parave. Ai përfshin gjithashtu pranimin ose marrjen e çdo dhurate, borxhi, komisioni, shpërblimi ose avantazhi tjetër nga çdo person si një nxitje për të bërë diçka që është e pandershme, e paligjshme ose në shkelje të besimit në drejtimin e biznesit të një njësie ekonomike. Kjo mund të përfshijë përfitime në para ose në natyrë, të tilla si mallra falas, dhurata dhe pushime, ose shërbime të veçanta personale të ofruara me qëllim të një përfitimi të padrejtë, ose që mund të rezultojë në presion moral për të marrë një avantazh të tillë.
<b>Përfaqësues të besueshëm</b>	Individë me përvojë mjaft të thellë në angazhimin me <i>palët e interesit</i> të prekura nga një rajon apo kontekst i caktuar (për shembull, gra punëtore në ferma, <i>popuj indigjenë</i> ose punëtorë emigrantë) të cilët mund të ndihmojnë për të përcjellë në mënyrë efektive shqetësimet e tyre të mundshme. Në praktikë, kjo mund të përfshijë OJQ-të e angazhuara me të drejtat e njeriut, sindikatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile lokale, duke përfshirë organizatat e besimeve fetare.
<b>Efektet aktuale financiare</b>	<i>Efektet financiare</i> për periudhën aktuale të raportimit që njihen në pasqyrat financiare zyrtare.
<b>Levat e dekarbonizimit</b>	Përmbledhja e llojeve të <i>veprimeve</i> zbutëse të tilla si efikasiteti i energjisë, elektrifikimi, ndërrimi i karburantit, përdorimi i <i>energjisë së rinovueshme</i> , ndryshimet e produkteve dhe dekarbonizimi i zinxhirit të furnizimit që përshtaten me veprimet specifike të njësive ekonomike.
<b>Shpyllëzimi</b>	Shndërrimi i përkohshëm ose i përhershëm i tokës pyjore në tokë jo-pyjore <sup>145</sup> i shkaktuar nga njeriu.
<b>Degradimi ose ekosistem i degraduar</b>	<i>Ndikimet</i> kronike njerëzore që sjellin në humbjen e biodiversitetit dhe prishjen e strukturës, e përbërjes dhe funksionit të një <i>ekosistemi</i> .

<sup>145</sup> Shtojca I, pika 21 Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 të 6 prillit 2022 që plotëson Rregulloren (BE) 2019/2088 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit lidhur me standardet teknike rregullatore që specifikojnë detajet e përmbajtjes dhe paraqitjes së informacionit në lidhje me parimin e “mos bëj dëm të rëndësishëm”, duke specifikuar përmbajtjen, metodologjitë dhe paraqitjen e informacionit lidhur me treguesit e qëndrueshmërisë dhe ndikimet negative në qëndrueshmëri, si dhe përmbajtjen dhe paraqitjen e informacionit lidhur me nxitjen e karakteristikave mjedisore ose sociale dhe objektivave të investimit të qëndrueshëm në dokumente paraprakë, në faqe web dhe në raporte periodike (GZ L 196, 25.7.2022, p. 1).

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
Varësitë	Situata e një njësie ekonomike që varet nga burimet natyrore, njerëzore dhe/ose sociale për proceset e saj të biznesit.
Depozitimi në ujë dhe në tokë	Një sasi e një <b>lënde</b> që është grumbulluar në mjedis, qoftë në ujë apo në <b>terren</b> , dhe qoftë si pasojë e aktiviteteve të rregullta ose nga <b>incidentet</b> ose nga hedhja e mbetjeve prej njësie ekonomike, pavarësisht nëse ky grumbullim ndodh në <b>vendin</b> e prodhimit të një njësie ekonomike ose jashtë saj.
Shkretimi (kthimi në shkretëtirë)	<b>Degradimi i tokës</b> në zona të thata, gjysmë të thata dhe më pak se të lagështa që rezultojnë nga faktorë të ndryshëm, duke përfshirë ndryshimet klimatike dhe aktivitetet njerëzore. <b>Shkretimi</b> nuk i referohet zgjerimit natyror të shkretëtirave ekzistuese.
Shkarkimi	<b>Shkarkimi i ujërave të zeza</b> nënkupton sasinë e ujit (në m <sup>3</sup> ) ose <b>substancës</b> (në kg BOD/d ose njësi të krahasueshme me të) që kullon (derdhet) në një trup ujqor nga një pikë e caktuar burimore ose jo. Derdhja e ujërave të zeza (ose <b>shkarkimi</b> ) nënkupton ujërat e zeza të trajtuara që shkarkohen nga impianti i trajtimit të ujërave të zeza.
Diskriminimi	<b>Diskriminimi</b> mund të jetë i drejtpërdrejtë ose i tërthortë. <b>Diskriminimi</b> i drejtpërdrejtë ndodh kur një individ trajtohet në mënyrë më pak të favorshme në krahasim me mënyrën se si janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët, të cilët janë në një situatë të ngjashme, dhe arsyeja për këtë është një karakteristikë e veçantë që ata mbajnë, e cila përbën një “motiv objekt diskriminimi”. <b>Diskriminimi</b> i tërthortë ndodh kur një rregull në dukje neutral e vë në disavantazh një person ose një grup që ndajnë të njëjtat karakteristika. Duhet të tregohet se një grup është në disavantazh nga një vendim kur krahasohet me një grup tjetër krahasues.
Materialiteti i dyfishtë	<b>Materialiteti i dyfishtë</b> ka dy dimensione: <b>materialitetin e ndikimit</b> dhe <b>materialitetin financiar</b> . Një çështje e qëndrueshmërisë plotëson kriterin e <b>materialitetit të dyfishtë</b> nëse është materiale nga perspektiva e ndikimit ose nga perspektiva financiare, ose nga të dyja.
Qëndrueshmëria e një produkti, përbërësi ose materiali	Aftësia e një produkti, përbërësi ose materiali për të mbetur funksional dhe i rëndësishëm kur përdoret sipas synimit.

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
<b>Pragu ekologjik</b>	Pika në të cilën një ndryshim relativisht i vogël në kushtet e jashtme shkakton një ndryshim të shpejtë në një <b>ekosistem</b> . Kur një <b>prag ekologjik</b> është tejkaluar, <b>ekosistemi</b> mund të mos jetë më në gjendje të kthehet në gjendjen e tij të mëparshme përmes qëndrueshmërisë së tij të brendshme.
<b>Shtrirja e ekosistemit</b>	Madhësia e një aktivi të <b>ekosistemit</b> , ku aktiv i <b>ekosistemit</b> është hapësira e afërt e një lloji specifik <b>ekosistemi</b> që karakterizohet nga një bashkësi e veçantë i përbërësish biotikë dhe abiotikë, si dhe ndërveprimet e tyre.
<b>Restaurimi i ekosistemit</b>	Çdo aktivitet i qëllimshëm që nis ose përshpejton rimëkëmbjen e një <b>ekosistemi</b> nga një gjendje e degraduar.
<b>Shërbimet e ekosistemit</b>	Kontributet e <b>ekosistemeve</b> për përfitimet që shfrytëzohen në veprimtarinë ekonomike dhe aktivitetet tjera njerëzore, përkatësisht përfitimet që njerëzit marrin nga <b>ekosistemet</b> . Në Vlerësimin e Ekosistemit të Mijëvjeçarit, <b>shërbimet e ekosistemit</b> mund të ndahen në mbështetës, rregullues, sigurues dhe kulturorë. Klasifikimi i Përbashkët Ndërkombëtar i Shërbimeve të Ekosistemeve (CICES) klasifikon llojet e shërbimeve të <b>ekosistemeve</b> .
<b>Ekosistemet</b>	Një kompleks dinamik i bashkësive bimore, shtazore dhe mikroorganizmash dhe mjedisi i tyre jo i gjallë që ndërveprojnë si një njësi funksionale. Një tipologji e <b>ekosistemeve</b> ofrohet nga IUCN Global Ecosystem Typology 2.0.
<b>Emetimi</b>	Lëshimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i substancave, dridhjeve, nxehtësisë ose zhurmës nga burime individuale ose të shpërndara në ajër, ujë ose <b>terren</b> . <sup>146</sup>
<b>Punonjës (i punësuar)</b>	Një individ që është në një marrëdhënie pune me njësinë ekonomike sipas ligjit ose praktikës kombëtare.
<b>Përdoruesit fundor</b>	Individët të cilët përdorin të fundit ose synojnë të përdorin të fundit një produkt ose shërbim të caktuar.
<b>Mundësi të barabarta</b>	Qasje e barabartë dhe jodiskriminuese, ndërmjet individëve, ndaj mundësive për arsimim, trajnim, punësim, zhvillim në karrierë dhe ushtrim pushteti pa qenë të nënvlerësuar në bazë të kriterëve të tilla si gjinia, origjina racore ose etnike,

<sup>146</sup> Direktiva 2010/75/BE mbi emetimet industriale (IED).

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
	kombësia, feja ose besimi, aftësia e kufizuar fizike, mosha ose orientimi seksual.
<b>Trajtim i barabartë</b>	Parimi i <b>trajtimit të barabartë</b> është një parim i përgjithshëm i së drejtës evropiane e cili parashtron që situatat e krahasueshme ose palët në situata të krahasueshme trajtohen në të njëjtën mënyrë. Në kontekstin e ESRS S1, fjala " <b>trajtim i barabartë</b> " i referohet edhe parimit të mosdiskriminimit, sipas të cilit nuk do të ketë <b>diskriminim</b> të drejtpërdrejtë apo të tërthortë bazuar në motive të tilla si gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike ose sociale, veçorinë gjenetike, gjuha, feja ose besimi, mendimi politik ose ndonjë opinion tjetër, përkatësia në një pakicë kombëtare, pasuria, lindja, paaftësia, mosha ose orientimi seksual.
<b>Efektet financiare</b>	Efektet nga <b>rreziqet</b> dhe <b>mundësitë</b> që ndikojnë në pozicionin financiar të njësisë ekonomike, performancën financiare dhe flukset monetare në periudhën afatshkurtër, afatmesme ose afatgjatë.
<b>Materialiteti financiar</b>	Një çështje e qëndrueshmërisë është materiale nga perspektiva financiare nëse gjeneron <b>rreziqe</b> ose <b>mundësi</b> që ndikojnë (ose mund të pritet në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë) pozicionin financiar të njësisë ekonomike, performancën financiare, flukset monetare, qasjen në financime ose në koston e kapitalit për një periudhë afatshkurtër, afatmesme ose afatgjatë.
<b>Punë e detyruar</b>	Të gjitha punët ose shërbimet që i kërkohet çdo personi nën kërcënimin e ndëshkimit dhe për të cilat personi nuk është ofruar vullnetarisht. Termi përfshin të gjitha situatat në të cilat personat detyrohen me çfarëdo mënyre të kryejnë punë dhe përfshin si praktikat tradicionale "të ngjashme me skllavërinë" dhe format bashkëkohore të shtrëngimit ku përfshihet shfrytëzimi i punës, të cilat mund të përfshijnë trafikimin e qenieve njerëzore dhe skllavërinë moderne.
<b>Lëndët djegëse fosile</b>	Burimet e energjisë jo të rinovueshme me bazë karboni si lëndët djegëse të ngurta, gazi natyror dhe nafta.
<b>Dakordësi e Lirë, Paraprake dhe e Informuar (FPIC)</b>	Një manifestim i të drejtës së <b>popujve autoktonë</b> për të vetëvendosur prioritetet e tyre politike, sociale, ekonomike dhe kulturore. Ajo përbëhet nga tre të drejta të ndërlidhura

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
	dhe të akumuluar të <b>popujve autoktonë (indigjenë)</b> : e drejta për t'u konsultuar; e drejta për të marrë pjesë; dhe e drejta për tokat, territoret dhe burimet e tyre. <b>FPIC</b> i përket <b>popujve autoktonë (indigjenë)</b> dhe njihet sipas ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, veçanërisht Deklaratës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e <b>Popujve Autokton (indigjenë)</b> (UNDRIP).
<b>Ujëra të ëmbla</b>	<b>Ujërat nëntokësore</b> dhe ujërat sipërfaqësore, me një kripësi mesatare vjetore prej < 0,5 ‰ (d.m.th.. kufiri i përmendur në Aneksin II të Direktivës Kuadër të Ujit).
<b>Pakësimi i emetimeve të GHG</b>	Zvogëlimi i <b>emetimeve GHG</b> të <b>Perimetrit 1, 2 dhe 3</b> dhe emetimeve totale të njësisë ekonomike në fund të periudhës raportuese, krahasuar me <b>emetimet</b> në vitin bazë. <b>Pakësimet e emetimeve</b> mund të rezultojnë, ndër të tjera, nga efienca e energjisë, elektrifikimi, dekarbonizimi i <b>furnizuesve</b> , dekarbonizimi nga përzjerja e energjisë elektrike, zhvillimi i qëndrueshëm i produkteve ose ndryshimet në kufijtë raportimit ose të aktiviteteve (p.sh., kontraktimi i jashtëm, zvogëlimi i kapaciteteve), me kusht që ato të arrihen brenda operacioneve të vetë njësisë ekonomike dhe rrjedhës së sipërme dhe të poshtme të <b>zinxhirit të vlerës</b> . Largimet dhe <b>emetimet</b> e shmangura nuk llogariten si <b>pakësime të emetimeve</b> .
<b>Largimi dhe depozitimi i GHG</b>	Largimet (antropogjenike) i referohen tërheqjes së GHG-ve nga atmosfera si rezultat i aktiviteteve të qëllimshme njerëzore. Këto përfshijnë zgjerimin e puseve biologjike antropogjenike të CO <sub>2</sub> dhe përdorimin e inxhinierisë kimike për të arritur largimin dhe depozitimin afatgjatë. Kapja dhe depozitimi i karbonit (CCS) nga burimet industriale dhe të lidhura me energjinë, që të vetme nuk largojnë CO <sub>2</sub> nga atmosfera, mund të largojnë CO <sub>2</sub> atmosferik nëse kombinohen me prodhimin e bioenergjisë (Bioenergjia me Kapjen dhe Depozitimin e Karbonit - BECCS). Largimet mund të rikthehen nëse <b>GHG</b> të depozituara dalin jashtë depozitave të parashikuara dhe rihyjnë në atmosferë. Për shembull, nëse një pyll që është krijuar për të hequr një sasi specifike të CO <sub>2</sub> digjet nga zjarri, emetimet e kapura më parë nga pemët, tashmë rikthehen në atmosferë.

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
<b>Potenciali i ngrohjes globale (GWP)</b>	Një faktor që përshkruan ndikimin e forcës rrezatuese (shkalla e dëmtimit të atmosferës) të një njësie <b>GHG</b> të caktuar në raport me një njësi CO <sub>2</sub> .
<b>Gazrat serrë (GHG)</b>	Gazrat e renditur në Pjesën 2 të Aneksit V të Rregullores (BE) 2018/1999 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit. <sup>147</sup> Këtu përfshihen dyoksidi i karbonit (CO <sub>2</sub> ), metani (CH <sub>4</sub> ), oksidi i azotit (N <sub>2</sub> O), heksafluoridi i squfurit (SF <sub>6</sub> ), trifluoridi i azotit (NF <sub>3</sub> ), hidrofluorkarbonet (HFCs), perfluorokarburet (PFCs).
<b>Mekanizmi i ankesave</b>	<p>Çdo proces rutinë, shtetëror ose jo-shtetëror, gjyqësor ose jo-gjyqësor përmes të cilit <b>palët e interesuara</b> mund të ngrejnë ankesa dhe të kërkojnë <b>zgjidhje</b>. Shembuj të <b>mekanizmave të ankesave</b> gjyqësore dhe jogjyqësore të bazuara në shtet përfshijnë gjykatat, gjykatat e punës, institucionet kombëtare të drejtave të njeriut, Pikat Kombëtare të Kontaktit sipas Udhëzimeve të OECD-së për Shoqëritë Shumëkombëshe, zyrat e avokatit të popullit, agjencitë e mbrojtjes së konsumatorëve, organet e mbikëqyrjes rregullatore dhe zyrat qeveritare të ankesave. <b>Mekanizmat e ankesave</b> jo shtetërore përfshijnë ato të administruara nga njësi ekonomike, vetëm ose së bashku me <b>palët e interesuara</b>, të tilla si <b>mekanizmat e ankesave</b> në nivel operacional dhe <b>marrëveshjet kolektive</b>, duke përfshirë mekanizmat e krijuar nga <b>marrëveshjet kolektive</b>. Ato përfshijnë gjithashtu mekanizma të administruar nga shoqatat e industrisë, organizatat ndërkombëtare, organizatat e shoqërisë civile ose grupet me shumë palë të interesuara.</p> <p><b>Mekanizmat e ankesave</b> në nivel operacional administrohen nga organizata ose vetëm ose në bashkëpunim me palët e tjera dhe janë të hapura drejtpërdrejt për <b>palët e interesuara</b> të organizatës. Ato lejojnë që ankesat të identifikohen dhe të trajtohen herët dhe drejtpërdrejt, duke parandaluar kështu përshkallëzimin e dëmit dhe ankesave. Gjithashtu ato ofrojnë reagime të rëndësishme mbi efektivitetin e kujdesit të duhur të organizatës nga ata që preken drejtpërdrejt.</p>

<sup>147</sup> Rregullorja (BE) 2018/1999 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 dhjetorit 2018 mbi Qeverisjen e Unionit të Energjisë dhe Veprimin për Klimën, që ndryshoi Rregulloren (KE) Nr 663/2009 dhe (KE) Nr 715/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, Direktivat 94/22/KE, 98/70/KE, 2009/31/KE, 2009/73/KE, 2010/31/BE, 2012/27/BE dhe 2013/30/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, Direktivat e Këshillit 2009/119/KE dhe (BE) 2015/652 dhe shfuqizoi Rregulloren (BE) Nr 525/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (GZ L 328, 21.12.2018, p. 1).

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
	Sipas Parimit Udhëzues 31 të OKB-së, mekanizma efektivë të ankesave janë legjitime, të arritshme, të parashikueshme, të barabarta, transparente, të pajtueshme me të drejtat dhe një burim i të mësuarit të vazhdueshëm. Përveç këtyre kriterëve, <b>mekanizmat</b> efektivë të <b>ankesave</b> në nivel operacional bazohen edhe në angazhim dhe në dialog. Mund të jetë më e vështirë për organizatën të vlerësojë efektivitetin e <b>mekanizmave të ankesave</b> në cilat merr pjesë krahasuar me ato që ka krijuar vetë.
<b>Ujërat nëntokësore</b>	I gjithë uji që është nën sipërfaqen e tokës në zonën e ngopjes dhe në kontakt të drejtpërdrejtë me tokën ose nëntokën. <sup>148</sup>
<b>Vendbanimi (Habitati)</b>	Vendi ose lloji i hapësirës ku një organizëm ose popullatë gjendet natyrshëm. Përdoret gjithashtu për të nënkuptuar atributet mjedisore të kërkuara nga një specie e veçantë ose nga zona e saj ekologjike.
<b>Fragmentimi i habitatit</b>	Një term i përgjithshëm që përshkruan grupin e proceseve me të cilat humbja e <b>habitatit</b> rezulton në ndarjen e habitateve të vazhdueshme në një numër më të madh pjesësh më të vogla me madhësi totale më të vogël dhe të izoluar nga njëra-tjetra nga një matricë <b>habitatesh</b> të ndryshme. <b>Fragmentimi i Habitatit</b> mund të ndodhë nëpërmjet proceseve natyrore (p.sh. zjarret në pyje dhe kullota, përmytje) dhe nëpërmjet aktiviteteve njerëzore (pyllëzimi, bujqësia, urbanizimi).
<b>Ngacmimi</b>	Një situatë ku një sjellje e padëshiruar lidhur me një bazë të <b>mbrojtur diskriminimi</b> (për shembull, gjinia sipas Direktivës 2006/54/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, <sup>149</sup> ose feja ose besimi, aftësia e kufizuar fizike, moshë ose orientimi seksual sipas Direktivës së Këshillit 2000/78/EC) <sup>150</sup> ndodh me qëllimi ose ka si pasojë cenimin e dinjitetit të një personi dhe krijimit të një mjedisi frikësues, armiqësor, poshtërues, degradues ose fyes.

<sup>148</sup> Neni 2, pika (20) e Rregullores (BE) 2020/852 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e 18 qershorit 2020 mbi krijimin e një kuadri për të lehtësuar investimin e qëndrueshëm dhe ndryshimin e Rregullores (BE) 2019/2088 (GZ L 198, 22.6.2020, p. 13).

<sup>149</sup> Direktiva 2006/54/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 korrikut 2006 mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimin të barabartë të burrave dhe grave në çështje të punësimit dhe punëzënies (GZ L 204, 26.7.2006, p. 23).

<sup>150</sup> Direktiva e Këshillit 2000/78/KE e 27 nëntorit 2000 që krijoi një kuadër të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe punëzënie (GZ L 303, 2.12.2000, p. 16).

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
<b>Mbetje të rrezikshme</b>	<b>Mbeturinat</b> që shfaqin një ose më shumë nga vetitë e rrezikshme të renditura në Aneksin III të Direktivës 2008/98/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit <sup>151</sup> mbi <b>mbetjet</b> .
<b>Sektorët me ndikim të lartë klimatik</b>	Sektorët që renditen në seksionet A deri në H dhe seksionin L të aneksit I të Rregullores (KE) Nr. 1893/2006 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit <sup>152</sup> (siç përcaktohet në Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288). <sup>153</sup>
<b>Ndikimet</b>	Efekti që njësi ekonomike ka ose mund të ketë në mjedis dhe tek njerëzit, duke përfshirë efektet në të drejtat e tyre njerëzore, të lidhura me operacionet e veta në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të <b>zinxhirit të vlerës</b> , edhe përmes produkteve dhe shërbimeve të saj, si dhe përmes <b>marrëdhënieve</b> të saj <b>të biznesit</b> . Ndikimet mund të jetë aktuale ose potenciale, negative ose pozitive, të synuar ose të paqëllimshme, të kthyeshme ose të pakthyeshme. Ato mund të shfaqen në afat të shkurtër, të mesëm ose afatgjatë. <b>Ndikimet</b> tregojnë kontributin negativ apo pozitiv të njësisë ekonomike, në zhvillimin e qëndrueshëm.
<b>Faktorët e ndikimit</b>	Të gjithë faktorët që shkaktojnë ndryshime në natyrë, pasuritë e njerëzimit, kontributet e natyrës për njerëzit dhe në cilësinë e mirë të jetës. Faktorët e drejtpërdrejtë të ndryshimit mund të jenë si natyrorë ashtu dhe njerëzorë. Ato kanë ndikime të drejtpërdrejta fizike (mekanike, kimike, zhurmë, dritë etj.) dhe të mënyrës së sjelljes <b>ndaj</b> natyrës. Ato përfshijnë, ndër të tjera, ndryshimet klimatike, <b>ndotjen</b> , llojet e ndryshme të përdorimit të tokës, speciet e huaja pushtuese dhe sëmundjet transmetuese (zoonozat), si dhe shfrytëzimin. <b>Faktorët e ndikimit</b> të tërthortë operojnë në mënyrë të përhapur duke ndryshuar dhe ndikuar faktorët e

<sup>151</sup> Direktiva 2008/98/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 19 nëntorit 2008 mbi mbetjet dhe shfuqizimin e disa Direktivave (GZ L 312, 22.11.2008, p. 3).

<sup>152</sup> Rregullorja (BE) Nr 1893/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 20 dhjetorit 2006 që krijoi klasifikimin statistikor të aktiviteteve ekonomike NACE Revision 2 dhe ndryshoi Rregulloren e Këshillit (KE) Nr 3037/90 si dhe disa Rregullore të KE mbi fushat statistikore specifike (GZ L 393, 30.12.2006, p. 1).

<sup>153</sup> Rregullorja e Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1288 e 6 prillit 2022 që plotëson Rregulloren (BE) 2019/2088 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit lidhur me standardet teknike rregullatore që specifikojnë detajet e përmbajtjes dhe paraqitjes së informacionit në lidhje me parimin e “mos bëj dëm të rëndësishëm”, duke specifikuar përmbajtjen, metodologjitë dhe paraqitjen e informacionit lidhur me treguesit e qëndrueshmërisë dhe ndikimet negative në qëndrueshmëri, si dhe përmbajtjen dhe paraqitjen e informacionit lidhur me nxitjen e karakteristikave mjedisore ose sociale dhe objektivave të investimit të qëndrueshëm në dokumente paraprakë, në faqe web dhe në raporte periodike (GZ L 196, 25.7.2022, p. 1).

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
	<p>drejtpërdrejtë të ndikimit (duke ndikuar nivelin, drejtimin ose shkallën e tyre) si dhe faktorët e tjerë të tërthortë.</p> <p>Ndërveprimet ndërmjet faktorëve të tërthortë dhe të drejtpërdrejtë krijojnë zinxhirë të ndryshëm marrëdhëniesh, atributesh dhe <b>ndikimesh</b>, të cilat mund të ndryshojnë sipas llojit, intensitetit, kohëzgjatjes dhe distancës. Këto marrëdhënie mund të çojnë gjithashtu në lloje të ndryshme të efekteve të përhapura. Faktorët e tërthortë globalë përfshijnë ata ekonomikë, demografikë, qeveritarë, teknologjikë dhe kulturorë. Vëmendje e veçantë ndërmjet faktorëve të tërthortë, i kushtohet rolit të institucioneve (zyrtare dhe jo zyrtare) dhe <b>ndikimeve</b> të modeleve të prodhimit, ofertës dhe konsumit në natyrë, kontributeve të natyrës për njerëzit dhe cilësisë së mirë të jetës.</p>
<b>Materialiteti i ndikimit</b>	<p>Një çështje e qëndrueshmërisë është materiale nga perspektiva e ndikimit nëse i përket <b>ndikimeve</b> materiale aktuale ose potenciale të njësisë ekonomike, pozitive ose negative mbi njerëzit ose mjedisin përgjatë një periudhe afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë. Një çështje materiale e qëndrueshmërisë nga prespektiva e ndikimit përfshin <b>ndikimet</b> e lidhura me veprimtarinë e vetë njësisë ekonomike dhe me rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të <b>zinxhirit të vlerës</b>, të lidhura me produktet dhe shërbimet e saj, si dhe përmes <b>marrëdhënieve të biznesit</b>.</p>
<b>Incident</b>	<p>Një veprim ligjor ose një ankesë regjistruar ndaj njësinë ekonomike ose pranë autoriteteve përgjegjëse përmes një procesi formal, ose një rast mospërputhjeje e identifikuar nga njësia ekonomike përmes procedurave të përcaktuara. Procedurat e përcaktuara për të identifikuar rastet e mospërputhjeve mund të përfshijnë auditime të sistemeve të menaxhimit, programe formale të monitorimit, ose <b>mekanizma të ankesave</b>.</p>
<b>Djegia (Incenerator)</b>	<p>Djegia e kontrolluar e <b>mbetjeve</b> në temperaturë të lartë me ose pa rikthim energjie.</p>
<b>Anëtar i pavarur i bordit (këshillit drejtues)</b>	<p>Anëtarë bordi që ushtrojnë gjykime të pavarura, të lirë nga çdo ndikim i jashtëm ose konflikte interesi. Pavarësia zakonisht nënkupton ushtrimin e gjykimit objektiv dhe të lirë. Kur përdoret si matës për të vlerësuar pavarësinë ose për të</p>

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
	<p>klasifikuar si të pavarur një anëtar jo-ekzekutiv të organeve <b>administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse ose komitetet</b> e tyre, termi nënkupton mungesë interesi, pozicioni, lidhjeje ose marrëdhënieje e cila kur gjykohet nga perspektiva e një pale të tretë të arsyeshme dhe të informuar mund të influencojë padrejtësisht ose të shkaktojë paragjykimet në vendimmarrje.</p>
<p><b>Popuj indigjenë</b></p>	<p>Nuk ka një përkufizim të vetëm për popujt indigjenë të pranuar në nivel ndërkombëtar. Në praktikë, ka një konvergjencë mes agjencive ndërkombëtare se cilat grupe mund të konsiderohen <b>popuj indigjenë</b> dhe si të tillë duhet të gëzojnë mbrojtje speciale. Një kriter i rëndësishëm për të përkufizuar <b>popujt indigjenë</b> është lidhja e tyre me një zonë tradicionale, siç përkufizohet në Konventën Nr. 169, Neni 1 të ONP (ILO), që përcakton se konventa zbatohet për: "(a) <i>popujt tribu në vende të pavarura ku kushtet sociale, kulturore dhe ekonomike i dallojnë nga pjesa tjetër e komunitetit kombëtar, si dhe statusi i të cilëve rregullohet pjesërisht ose plotësisht nga zakonet ose traditat e tyre ose nga ligje apo rregullatorë specialë (të posaçëm); (b) popuj në vende të pavarura që shihen si indigjenë për shkak të origjinës së tyre nga popuj që kanë populluar vendin, ose një zonë gjeografike të cilës i përket vendi, në kohën e pushtimit, kolonizimit, ose të vendosjes së kufijve shtetërorë aktualë dhe të cilët pavarësisht nga statusi i tyre ligjor, ruajtën të gjitha institucionet e tyre sociale, ekonomike, kulturore dhe politike apo pjesë të tyre". Neni 1, paragrafi 2, i Konventës 169 të ONP përcakton edhe se: "vetë identifikimi si indigjenë ose tribu shihet si një kriter themelor për të përcaktuar se për cilat grupe zbatohen parashikimet e kësaj konvente".</i></p>
<p><b>Emetime GHG të tërthorta</b></p>	<p>Emetimet GHG që janë pasojë e aktiviteteve të një njësie ekonomike, por që ndodhin në burimet e zotëruara ose të kontrolluara nga një njësi ekonomike tjetër. <b>Emetimet e tërthorta</b> përfshijnë si <b>emetimet GHG të perimetrit 2 dhe emetimet GHG të perimetrit 3</b>.</p>
<p><b>Instalim</b></p>	<p>Njësi teknike fikse ku mund të zhvillohen një ose më shumë aktivitete dhe mund të ketë një efekt në <b>emetimet dhe ndotjen</b>.</p>

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
<b>Çmimi i brendshëm i karbonit</b>	Çmimi i përdorur nga njësia ekonomike për të vlerësuar pasojat financiare të ndryshimeve në modelin e investimit, të prodhimit dhe të konsumit, si dhe të progresit të mundshëm teknologjik dhe të kostove të ardhshme të pakësimit të <b>emetimeve</b> .
<b>Skema e përcaktimit të çmimit të brendshëm të karbonit</b>	Një marrëveshje organizative që i mundëson njësisë ekonomike të zbatojë çmimet e karbonit në vendimmarrjen strategjike dhe operative. Ekzistojnë dy tipe të <b>çmimeve të brendshme të karbonit</b> që zakonisht përdoren nga njësitë ekonomike. Tipi i parë është një çmim fiktiv, i cili është një kosto teorike ose një shumë imagjinare që njësia ekonomike nuk e ngarkon, por që mund ta përdorë në vlerësimin e pasojave ekonomike ose të kundërpeshave për çështje si <b>ndikimet</b> e rreziqeve, investimet e reja, vlera aktuale neto e projekteve dhe raporti kosto-përfitim i nismave të ndryshme. I dyti është një taksë ose komision i brendshëm, i cili është çmimi i karbonit që i ngarkohet një aktiviteti biznesi, linje prodhimi ose një njësie tjetër biznesi bazuar në <b>emetimet GHG</b> të saj (këto taksa ose komisione të brendshme janë të ngjashme me çmimin e transferimit mes shoqërive).
<b>Kategori pushtuese ose të huaja</b>	Kategori për të cilat futja dhe/ose përhapja nga veprimet njerëzore jashtë zonës së tyre natyrore të shpërndarjes kërcënon <b>larminë biologjike</b> (biodiversitetin), sigurinë ushqimore, si dhe shëndetin e mirëqenien njerëzore. “I huaj” i referohet kategorive që janë futur nga jashtë zonës së tyre natyrore të shpërndarjes (“ekzotik”, “jo-vendas” dhe “jo-indigjenë” janë sinonime për “i huaj”). “Pushtuese” do të thotë që “synon të zgjerohet dhe të modifikojë ekosistemet në të cilat ka hyrë”. Pra, një kategori mund të jetë e huaj pa qenë pushtuese ose në rastin e kategorive vendase të një zone, ato mund të rriten dhe bëhen pushtuese, pa qenë kategori të huaja.
<b>Zona Kryesore e Biodiversitetit (KBA) (Larmisë Biologjike)</b>	Zona që kontribuojnë në mënyrë të rëndësishme në qëndrueshmërinë globale të <b>biodiversitetit</b> , në <b>ekosistemet</b> e tokës, të <b>ujërave të ëmbël</b> dhe detarë. Zonat përcaktohen si <b>KBA</b> globale nëse ato plotësojnë një ose më shumë nga 11 kriteret e grupuara në pesë kategori: <b>biodiversitet</b> i kërcënuar; <b>biodiversitet</b> i kufizuar gjeografikisht; <b>integritet</b>

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
	<b>ekologjik</b> ; procese biologjike; dhe pamundësi për zëvendësim. Baza Botërore e të Dhënave për <b>KBA</b> menaxhohet nga organizata ndërkombëtare Bird Life International për llogari të Partneritetit KBA.
<b>Degradimi i terrenit</b>	Procese të shumta që sjellin pakësimin ose humbjen e <b>biodiversitetit</b> , funksioneve të <b>ekosistemeve</b> ose të përfitimeve të tyre për njerëzit dhe që përfshijnë <b>degradimin</b> e të gjithë <b>ekosistemeve</b> të tokës.
<b>Vend për mbetjet (Landfill)</b>	Një <b>vend</b> për asgjësimin e <b>mbetjeve</b> duke i depozituar <b>mbetjet</b> mbi ose nën tokë. <sup>154</sup>
<b>Sistemi i terrenit (ndryshimi)</b>	Përbërësi tokësor i sistemit të Tokës, që përfshin të gjitha proceset dhe aktivitetet e lidhura me përdorimin e terrenit nga njeriu. Këtu përfshihen burimet dhe marrëveshjet social ekonomike, teknologjike dhe organizative, si edhe përfitimet e marra nga terreni dhe rezultatet e pavullnetshme sociale dhe ekologjike të aktiviteteve shoqërore. Koncepti <b>sistemet e terrenit</b> kombinon përdorimin e terrenit (aktivitetet, marrëveshjet dhe burimet e lidhura me përdorimin e terrenit) me mbulimin e terrenit (bashkësia e karakteristikave fizike të terrenit që mund të dallohen nga vrotimi i Tokës).
<b>Përdorimi i terrenit (ndryshimi)</b>	Përdorimi i një zone specifike për një qëllim të caktuar (të tillë si për banim; për bujqësi; për argëtim; për përdorim industrial, etj.). Ndikohet por nuk është sinonim me mbulimin e terrenit. <b>Ndryshimi i përdorimit të terrenit</b> i referohet ndryshimit në përdorimin ose në menaxhimin e terrenit nga njerëzit, që mund të sjellë një ndryshim në mbulimin e terrenit.
<b>Përfaqësuesit legjitimë</b>	Individë të njohur si legjitimë nga ligji ose praktika, të tillë si përfaqësuesit e zgjedhur të sindikatave në rastin e punonjësve, ose përfaqësues të tjerë të ngjashëm të zgjedhur lirshëm të <b>grupeve të interesit</b> të ndikuar.
<b>Ndikimi</b>	Aftësia e njësisë ekonomike për të bërë një ndryshim në praktikatat e gabuara të një pale tjetër që është e lidhur me një ndikim negativ në çështjen e qëndrueshmërisë.

<sup>154</sup> Neni 2, germa (g) e Direktivës së Këshillit 1999/31/KE të 26 prillit 1999 mbi vendin e grumbullimit të mbetjeve (GZ L 182, 16.7.1999, p. 1).

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
<b>Aktivite influencuese (lobimi)</b>	<p>Aktivite që zhvillohen me qëllim ndikimin e formulimit ose implementimit të politikës ose legjislacionit, ose të proceseve vendimmarrëse të qeverive, institucioneve qeveritare, rregullatorëve, institucioneve të Bashkimit Evropian, organeve, zyrave dhe agjencive ose hartuesve të standardeve. Aktivite të tilla përfshijnë (lista nuk është shteruese):</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>i. organizimi ose pjesëmarrja në takime, konferenca, evente;</li> <li>ii. kontributi ose pjesëmarrja në konsultime publike, dëgjesa ose nisma të tjera të ngjashme;</li> <li>iii. organizimi i fushatave komunikuese, platformave, rrjeteve dhe nismave bazë;</li> <li>iv. përgatitja ose porositja e letër-politikave dhe letër-qëndrimeve, sondazheve të opinionit, anketave, letrave të hapura, punë kërkimore sipas aktiviteteve të mbuluara nga rregullat në regjistrin e transparencës.</li> </ul>
<b>Emetimet GHG të kyçura (të bllokuara)</b>	Vlerësime të <b>emetimeve GHG</b> të ardhshme që ka mundësi të shkaktohen nga aktivet kryesore ose produktet e shitura të një njësie ekonomike përgjatë jetës së tyre operative.
<b>Jetëgjatësia</b>	I projektuar për një mirëmbajtje dhe <b>rezistencë</b> të tillë që nxit përdorimin më të gjatë se standardi praktik i industrisë dhe në një shkallë dhe një mënyrë të tillë që nuk pengon trajtimin qarkullues në fund të jetës funksionale.
<b>Burimet detare</b>	Burime biologjike dhe jo biologjike që gjenden në dete dhe në oqeanë. Shembujt përfshijnë, por nuk kufizohen në mineralet në thellësi të detit, zhavorret dhe produktet (ushqimore) të detit.
<b>Mundësi materiale</b>	<b>Mundësi të lidhura me qëndrueshmërinë</b> me efekte <b>financiare pozitive</b> që ndikojnë në mënyrë të rëndësishme, (ose që pritet në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë) flukset monetare të njësisë ekonomike, mundësinë për financim, ose koston e kapitalit në periudha afatshkurtra, afatmesme ose afatgjata.
<b>Rreziqet materiale</b>	<b>Rreziqet të lidhura me qëndrueshmërinë</b> me efekte <b>financiare negative</b> që ndikojnë në mënyrë të rëndësishme, (ose që pritet në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë) flukset

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
	monetare të njësisë ekonomike, mundësinë për financim, ose koston e kapitalit në periudha afatshkurtra, afatmesme ose afatgjata.
<b>Materialiteti</b>	Një çështje e qëndrueshmërisë është materiale nëse plotëson përkufizimin e <b>materialitetit të ndikimit</b> , <b>materialitetit financiar</b> , ose të dyja bashkë.
<b>Metrika</b>	Treguesit cilësorë dhe sasiorë që njësia ekonomike përdor për të matur dhe raportuar lidhur me efektivitetin e zbatimit të politikave të saj lidhur me qëndrueshmërinë dhe ndaj <b>objektivave</b> të saj gjatë kohës. Metrika mbështet edhe matjen e rezultateve të njësisë ekonomike lidhur me njerëzit, mjedisin dhe biznesin e ndikuar.
<b>Mikroplastikat</b>	Pjesë të vogla plastike, zakonisht më të vogla se 5 milimetra. Një vëllim në rritje i mikroplastikës gjendet në mjedis, përfshirë detin, ushqimin dhe ujin e pijshëm. Pasi gjenden në mjedis, mikroplastikat nuk shpërbëhen në mënyrë biologjike dhe tentojnë të akumulohen, me përjashtim të rastit kur janë projektuar posaçërisht të shpërbëhen në mjedisin e hapur. Shpërbërja në mënyrë biologjike është një fenomen kompleks, veçanërisht në mjedisin detar. Prania e mikroplastikave në pjesë të ndryshme të mjedisit (të tillë si uji), ndikimi i tyre në mjedis dhe me shumë gjasa në shëndetin e njerëzve ka nxitur shqetësime në rritje.
<b>Kërkesa Minimale për Dhënie Informacione Shpjeguese</b>	Një <b>kërkesë minimale për dhënie informacionesh shpjeguese</b> paraqet përmbajtjen e kërkuar të informacionit që një njësi ekonomike përfshin kur ajo raporton mbi politikën, <b>veprimet</b> , <b>metrikat ose objektivat</b> , në ndjekje të një Kërkese për Dhënie informacionesh shpjeguese në një ESRS ose të një baze tjetër specifike për njësine ekonomike.
<b>Burimet natyrore</b>	Burimet natyrore ( <b>lëndët e para</b> ) gjenden në natyrë dhe mund të përdoren për prodhim ekonomik ose konsum.
<b>Zgjidhjet e bazuara në natyrë</b>	<b>Veprime</b> për të mbrojtur, ruajtur, restauruar, përdorur e menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme ekosistemet natyrore ose të modifikuara, të <b>ujit të ëmbël</b> , të bregdetit dhe detit që trajtojnë sfida sociale, ekonomike dhe mjedisore në mënyrë efektive dhe të përshtatshme, ndërsa njëkohësisht sigurojnë përfitime në mirëqenien e njerëzve, në <b>shërbimet e</b>

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
	<b>ekosistemeve</b> , në rezistencë dhe në <b>larminë biologjike</b> (biodiversitet).
<b>Objektivi zero neto</b>	Vendosja e një objektivi zero neto në nivelin e një njësie ekonomike në linjë me plotësimin e qëllimeve sociale klimatike do të thotë: <ul style="list-style-type: none"> <li>i. arritja e një shkalle pakësimi të emetimeve në zinxhirin e vlerës të qëndrueshme me uljen e kërkuar për të arritur objektin global zero neto në trajektoret e kufizimit të ngrohjes në 1.5°C; dhe</li> <li>ii. neutralizimi i ndikimit të çdo <b>emetimi</b> të mbetur (pas pakëimit të <b>emetimit GHG</b> afërsisht me 90-95%, me mundësinë për variacione të justifikuara sektoriale në linjë me trajektoren e njohur të sektorit) duke hequr përfundimisht vëllimin ekuivalent të CO2.</li> </ul>
<b>Jo punonjës (ose punonjës të jashtëm)</b>	<b>Jo punonjës në forcën e vet të punës</b> të një njësie ekonomike përfshijnë si individë të kontraktuar që furnizojnë me punë njësinë ekonomike (“të vet punësuar”) edhe njerëz në dispozicion të njësisë ekonomike përmes angazhimeve në “aktivitete punësimi” (kodi NACE N78).
<b>Energji jo e rinovueshme</b>	Energji e cila nuk mund të identifikohet se vjen nga burime të rinovueshme.
<b>Kontroll i veprimtarisë</b>	Kontroll i veprimtarisë (mbi një njësi ekonomike, vendndodhje, veprim ose aktiv) është situata kur njësi ekonomike ka aftësinë të drejtojë aktivitetet lidhur me veprimtarinë dhe marrëdhëniet e njësisë, të <b>vendndodhjes</b> , të veprimit ose të aktivitetit.
<b>Mundësitë</b>	<b>Mundësitë e lidhura me qëndrueshmërinë</b> me <b>efekte financiare</b> pozitive.
<b>Orët shtesë</b>	Orët e punës aktuale të punuara nga një punonjës mbi orët e kontraktuara të punës.
<b>Forca e vet e punës/punonjësit e vet</b>	<b>Punonjës</b> që janë në një marrëdhënie punësimi me njësinë ekonomike (“ <b>punëmarrës</b> ”) dhe <b>jo punonjës</b> që janë ose individë të kontraktuar që furnizojnë me punë njësinë ekonomike (“individë të vet punësuar”) ose njerëz në dispozicion të njësisë ekonomike përmes angazhimeve në “aktivitete punësimi” (kodi NACE N78).

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
<b>Substanca që shkatërron ozonin</b>	<b>Substancat</b> e renditura në Protokollin e Montrealit mbi substancat që shkatërrojnë shtresën e ozonit.
<b>Paketimi (ambalazhimi)</b>	Produktet e bëra nga materiale të çdo natyre të përdorura për të mbajtur, mbrojtur, lëvruar, magazinuar, transportuar dhe ambalazhuar mallrat, nga <b>lëndë të para</b> tek mallra të përpunuar, nga prodhuesi tek përdoruesi ose <b>konsumatori</b> . <sup>155</sup>
<b>Paga (shpërblimi)</b>	Zakonisht <b>paga</b> bazë ose minimumi i saj, ose rroga dhe çdo shpërblim tjetër, në mjete monetare ose në natyrë që punonjësi merr drejtpërdrejt ose tërthorazi (“përbërësit shtesë ose të ndryshueshëm”), lidhur me punësimin e tij/ të saj nga punëdhënësi i tij / i saj. Niveli i “ <b>pagës</b> ” do të thotë paga bruto vjetore dhe pagesa korresponduese bruto për orë. Niveli “median i <b>pagës</b> ” do të thotë pagesa e <b>punonjësit</b> që gjendet në mes të listës së pagave, ku gjysma e <b>punonjësve</b> marrin më shumë se ai dhe gjysma tjetër më pak.
<b>Persona me aftësi të kufizuara</b>	Persona me dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose të shqisave që ndërveprimi me pengesa të ndryshme mund t’i pengojë në pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të tyre në shoqëri në mënyrë të barabartë me të tjerët.
<b>Rreziqe fizike</b>	E gjithë sipërmarrja ekonomike globale varet nga funksionimi i sistemeve të tokës, si klima e qëndrueshme dhe në shërbimet e ekosistemeve, si sigurimi i biomasës ( <b>lëndët e para</b> ). <b>Rreziqet fizike</b> të lidhura me natyrën janë rezultat i drejtpërdrejtë i varësisë së një organizate nga natyra. <b>Rreziqet fizike</b> shfaqen kur kompromentohen sistemet natyrore, për shkak të ndikimit të ngjarjeve klimatike (p.sh. mot ekstrem si thatësira), ngjarje gjeologjike (p.sh. ngjarje sizmike si tërmeti) ngjarje ose ndryshime në ekuilibrin e <b>ekosistemit</b> , të tilla si cilësia e <b>terrenit</b> ose ekologjia detare, që ndikojnë <b>shërbimet ekosistem</b> në të cilat varen organizatat. Këto mund të jenë akute, kronike ose të dyja bashkë. <b>Rreziqet fizike</b> të lidhura me natyrën shfaqen si rezultat i ndryshimeve në kushtet biotike (të jetës) dhe abiotike (jo të jetës) që mbështesin shëndetin dhe funksionimin e ekosistemeve. <b>Rreziqet fizike</b> zakonisht janë të lidhura me një zonë të caktuar. Shpesh <b>rreziqet fizike</b> të

<sup>155</sup> Neni 3, pika (1) e Direktivës 94/62/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 20 dhjetorit 1994 mbi paketimin dhe mbetjet e paketimit (GZ L 365, 31.12.1994, p. 10).

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
	lidhura me natyrën lidhen me <b>rreziqe fizike të lidhura me klimën</b> .
<b>Kufijtë e planetit</b>	Ky koncept lejon të vlerësohet hapësira e sigurt e shfrytëzimit për njeriun në lidhje me funksionimin e Tokës. Përcaktohet nga ana sasiore kufiri që nuk duhet të shkelet për secilin çelës përpunimi të sistemit tokësor, nëse duam të shmangim ndryshime mjedisore globale të papranueshme.
<b>Politikë</b>	Një bashkësi ose kuadër i objektivave të përgjithshëm dhe parimeve të drejtimit që njësi ekonomike përdor për vendimmarrjen. <b>Politika</b> zbaton strategjinë e njësive ekonomike ose vendimet e drejtimit lidhur me çështje të rëndësishme të qëndrueshmërisë. Çdo <b>politikë</b> është nën përgjegjësinë e një (ose disa) personi të caktuar, specifikon fushën e saj të zbatimit dhe përfshin një ose më shumë objektiva (të lidhur kur është e zbatueshme me <b>objektiva</b> të matshëm). Një <b>politikë</b> vlerësohet dhe rishikohet sipas rregullave të qeverisjes të zbatueshme për njësinë ekonomike. Një <b>politikë</b> zbatohet përmes veprimeve ose planeve të veprimit.
<b>Ndotës</b>	Një <b>substancë</b> , dridhje, nxehtësi, zhurmë, dritë ose papastërti e pranishme në ajër, ujë ose <b>terren</b> e cila mund të jetë e dëmshme për shëndetin e njeriut dhe/ose mjedisin, e cila mund të sjellë dëme në pasurinë fizike, ose që mund të dëmtojë ose të ndikojë rehatinë dhe përdorimet e tjera legjitime të mjedisit. <sup>156</sup>
<b>Ndotja</b>	Futja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë, si pasojë e aktivitetit njerëzor, e <b>ndotësve</b> në ajër, ujë ose <b>terren</b> , të cilat mund të jenë të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe/ose mjedisin, që mund të sjellin dëme në pasurinë fizike, ose që mund të dëmtojnë ose të ndikojnë rehatinë dhe përdorimet e tjera legjitime të mjedisit. <sup>157</sup>
<b>Ndotja e terrenit</b>	Futja në <b>terren</b> – pavarësisht nëse hyrja ndodh në <b>vendin</b> e prodhimit të një njësie ekonomike ose jashtë, ose përmes përdorimit të produkteve dhe /ose shërbimeve të njësive ekonomike – si pasojë e aktivitetit njerëzor, të <b>substancave</b> ,

<sup>156</sup> Neni 2, pika (10) e Rregullores (BE) 2020/852 mbi krijimin e kuadrit për të lehtësuar investimin e qëndrueshëm.

<sup>157</sup> Direktiva 2010/75/BE mbi emetimet industriale (IED).

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
	dridhjeve, nxehtësisë ose zhurmës që mund të jenë të dëmshme për shëndetin e njeriut ose mjedisin, sjellin dëme të pasurisë fizike, ose të dëmtojnë rehatinë dhe përdorimet e tjera legjitime të mjedisit. <sup>158</sup> <b>Ndotësit e terrenit</b> përfshijnë <b>ndotësit inorganikë, ndotësit</b> e vazhdueshëm organikë (POPs), pesticidet, përzierjet e azotit dhe të fosforit, etj.
<b>Zonë e mbrojtur</b>	Një hapësirë gjeografike e përcaktuar qartë, e njohur, e dedikuar dhe e menaxhuar përmes mjeteve ligjore dhe mjeteve të tjera efektive për të arritur mbrojtjen afatgjatë të natyrës si dhe të <b>shërbimeve të ekosistemeve</b> dhe të vlerave kulturore të lidhura me to.
<b>Energji elektrike, nxehtësi, avull ose ftohje e blerë ose e përfituar</b>	Energjia elektrike, nxehtësia, avulli ose ftohja që njësi ekonomike ka marrë nga një palë e tretë. Termi “i përfituar” i referohet rrethanave kur një njësi ekonomike mund të mos e blejë drejtpërdrejt energjinë elektrike (p.sh. qiramarrësi në një ndërtesë), por kur energjia elektrike është e përfshirë në lehtësitë për përdorim të njësisë ekonomike.
<b>Lëndë e parë</b>	Lëndë e parë ose ndihmëse që përdoret për të prodhuar një produkt.
<b>Standarde të njohura të cilësisë për kredite të karbonit</b>	Standarde të cilësisë për <b>kredite të karbonit</b> që janë të verifikueshëm nga palë të treta të pavarura, duke bërë publike kërkesat dhe raportet e projektit dhe duke garantuar minimumin e shtimit, pranisë dhe shmangies së përfshirjes të përsëritur, si dhe duke siguruar rregullat për llogaritjen, monitorimin dhe verifikimin e <b>emetimeve GHG</b> të projektit dhe për eliminimin të tyre.
<b>Dëmtime dhe sëmundje të lidhura me punën që regjistrohen</b>	Dëmtime dhe sëmundje të lidhura me punën që sjellin si pasojë sa vijon: i. vdekjen, mungesa në punë, punë të kufizuar ose transferim në një detyrë tjetër, trajtim mjekësor përtej ndihmës së parë, ose humbje të ndjenjave; ose ii. dëmtim ose sëmundje e rëndësishme e diagnostikuar nga një mjek ose një profesionist tjetër i shëndetit, me licensë edhe nëse nuk sjell vdekjen, mungesa në punë, punë të

<sup>158</sup> Direktiva 2010/75/BE mbi emetimet industriale (IED).

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
	kufizuar ose transferim në detyrë, trajtim mjekësor përtej ndihmës së parë ose humbje ndjenjash.
<b>Rikuperim</b>	Çdo veprim ku rezultati kryesor është përdorimi i mbetjes për një qëllim të dobishëm duke zëvendësuar materialet e tjera të cilat ndryshe do të përdreshin për të plotësuar një funksion të caktuar, ose përgatitja e mbetjes për të plotësuar atë funksion, në një uzinë ose në ekonominë e gjerë. <sup>159</sup>
<b>Riciklimi</b>	Çdo veprim rikuperimi ku materialet <b>mbetje</b> ripërpunohen në prodhime, materiale ose <b>substancë</b> për qëllimin fillestar ose për qëllime të tjera. Përfshin ripërpunimin e materialeve organike por nuk përfshin rikuperim energjie dhe ripërpunimin në materiale që do të përdoren si karburant ose për veprime plotësuese.
<b>Rigjenerimi i burimit</b>	Promovimi i kapacitetit vetrinovues të sistemeve natyrore me qëllim riaktivizimin e proceseve ekologjike të dëmtuara ose të mbishfrytëzuara nga veprimi i njeriut.
<b>Masa riparuese / riparimi</b>	Kundërveprimi ose përmirësimi i ndikimit negativ. Shembuj: ndjesa, kompensimi financiar ose jo financiar, parandalimi i dëmit përmes vendimeve ose garancive për mospërsëritje, masat dënuese (penale ose administrative, si p.sh gjrobat), kthimi, restaurimi, riaftësimi.
<b>Energjia e rinovueshme</b>	Energjia nga burime të rinovueshme jo fosile, domethënë era, energjia diellore (termale dhe fotovoltaike) dhe gjeotermike, energjia e ambientit, batica dhe zbatica, energjia e valëve dhe të tjera të oqeanit, fuqia hidrike, biomasa, gazi i përftuar nga <b>dekompozimi</b> i mbetjeve, gazi i impiantit të trajtimit të ujrave dhe biogazi. <sup>160</sup>
<b>Materiale të rinovueshme</b>	Materiale që vijnë nga burime që janë lehtësisht të zëvendësueshme nga ciklet ekologjike ose proceset bujqësore, kështu që shërbimet e siguruara prej tyre dhe nga burimet e tjera të lidhura nuk janë në rrezik dhe mbeten në dispozicion edhe për brezin pasues.
<b>Burime hyrëse</b>	Burime që hyjnë në impiantet e njësisë ekonomike.

<sup>159</sup> Neni 3, pika 15 e Direktivës 2008/98/BE mbi mbetjet.

<sup>160</sup> Neni 2, pika (1) e Direktivës (BE) 2018/2001 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 11 dhjetorit 2018 mbi nxitjen e përdorimit të energjisë nga burime të rinovueshme (GZ L 328, 21.12.2018, p. 82).

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
<b>Burime dalëse</b>	Burime që dalin nga impiantet e njësisë ekonomike.
<b>Optimizimi i përdorimit të burimit</b>	Projektimi, prodhimi dhe shpërndarja e materialeve dhe produkteve me qëllim mbajtjen e tyre në përdorim në vlerën e tyre më të lartë. Projektimi ekologjik dhe me qëllim <b>jetëgjatësinë</b> , riparimin, <b>ripërdorimin</b> , ricaktimin, çmontimin, riprodhimin janë shembuj të mjeteve për të optimizuar përdorimin e burimit.
<b>Ripërdorimi</b>	Çdo veprim ku produktet dhe përbërësit nuk janë mbetje dhe përdoren përsëri për të njëjtin qëllim për të cilin ishin krijuar. Kjo mund të përfshijë pastrimin ose rregullime të vogla në mënyrë që të jetë gati për përdorimin pasues pa ndryshimeve të rëndësishme.
<b>Shtrati hidrogeografik (basen lumor)</b>	Zona e terrenit në të cilën të gjithë ujërat sipërfaqësorë rrjedhin përmes një rrjeti përrenjsh, lumenjsh dhe, mundësisht, liqenesh në det në një dalje lumi, grykë derdhje ose deltë të vetme.
<b>Rreziqe</b>	<b>Rreziqe të lidhura me qëndrueshmërinë me efekte financiare</b> negative që vijnë nga çështje të mjedisit, sociale ose të qeverisjes dhe që mund të ndikojnë negativisht pozicionin financiar, performancën financiare, flukset monetare, mundësinë për financim, ose koston e kapitalit të njësisë ekonomike në periudha afatshkurtra, afatmesme ose afatgjata.
<b>Skenari</b>	Një përshkrim i mundshëm sesi mund të zhvillohet e ardhmja bazuar në një bashkësi supozimesh koherente dhe të lidhura në mënyrë logjike mbi forcat kryesore nxitëse (p.sh., ritmi i ndryshimit teknologjik, çmimet) dhe marrëdhëniet. Vihet në dukje se <b>skenarët</b> nuk janë as profeci as parashikime, por përdoren për të siguruar një panoramë të pasojave të zhvillimeve dhe <b>veprimeve</b> .
<b>Analiza e skenarit</b>	Procesi për identifikimin dhe vlerësimin e zonës së mundshme të rezultateve të ngjarjeve të ardhshme në kushtet e pasigurisë.
<b>Emetime GHG të perimetrit 1</b>	Emetimet <b>GHG</b> të drejtpërdrejta nga burime që zotërohen ose kontrollohen nga njësi ekonomike.

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
<b>Emetime GHG të perimetrit 2</b>	Emetimet e tërthorta nga gjenerimi i <i>energjisë, avullit, nxehtësisë ose ftohjes së blerë apo të përfituar</i> të konsumuar nga njësia ekonomike.
<b>Emetime GHG të perimetrit 3</b>	Të gjitha <i>emetimet GHG të tërthorta</i> (që nuk janë të përfshira në <i>emetimet GHG të perimetrit 2</i> ) të prodhuara në zinxhirin e vlerës të njësisë ekonomike raportuese, që përfshijnë <i>emetimet</i> e prodhuara në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme. <i>Emetimet GHG të perimetrit 3</i> mund të zërthehen në <i>kategori të perimetrit 3</i> .
<b>Kategori e perimetrit 3</b>	Një nga 15 tipet e <i>emetimeve GHG të perimetrit 3</i> i identifikuar nga Protokollin e standardeve të korporatës <i>GHG</i> (Protocol Corporate Standard) dhe i detajuar në Protokollin e zinxhirit të vlerës të korporatës <i>GHG</i> (Protocol Corporate Value Chain) Standardi i kontabilitetit dhe raportimit ( <i>Perimetri 3</i> ) (përshtatur nga Protokollin e zinxhirit të vlerës të korporatës <i>GHG (Perimetri 3)</i> Standardi i kontabilitetit dhe raportimit, fjalori (Versioni 2011). Njësia ekonomike që zgjedh të trajtojë <i>emetimet e perimetrit 3</i> të saj bazuar në kategoritë për <i>emetimet GHG të tërthorta</i> të ISO 14064-1:2018 mund t'i referohet kategorisë së përcaktuar në fjalinë 5.2.4 (duke përjashtuar <i>emetimet GHG të tërthorta</i> nga energjia e importuar) të ISO 14064-1:2018.
<b>Informacion i ndjeshëm (delikat)</b>	<i>Informacion i ndjeshëm</i> sipas përkufizimit në Rregulloren (BE) 2021/697 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës <sup>161</sup> që përcakton Fondin Evropian të Mbrojtjes.
<b>Vendndodhja</b>	Zona e një ose më shumë <i>instalimeve</i> fizike. Nëse ka më shumë se një <i>instalim</i> fizik nga i njëjti pronar ose operator, ose nga të ndryshëm dhe disa infrastruktura dhe impiante janë të përbashkëta, e gjithë zona ku janë vendosur <i>instalimet</i> fizike mund të përbëjë një <i>vendndodhje</i> .
<b>Dialogu social</b>	Të gjitha llojet e marrëveshjeve, konsultimeve ose këmbimit të thjeshtë të informacionit mes përfaqësuesve të qeverisë, punëdhënësve, organizatave të tyre dhe <i>përfaqësuesve të punonjësve</i> , mbi çështje me interes të përbashkët që lidhen me politikën ekonomike dhe sociale. Mund të ekzistojë si një

<sup>161</sup> Rregullorja (BE) 2021/697 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e 29 prillit 2021 mbi krijimin e një Fondi Evropian të Mbrojtjes dhe shfuqizimi i Rregullores (BE) 2018/1092 (GZ L 170, 12.5.2021, p. 149).

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
	proces trepalësh, me qeverinë si një palë zyrtare në dialog ose mund të realizohet si marrëdhënie dypalëshe vetëm mes <b>përfaqësuesve të punonjësve</b> dhe drejtimit (ose sindikatave dhe organizatave të punëdhënësve).
<b>Mbrojtja sociale</b>	Bashkësia e masave të projektuara për të pakësuar dhe parandaluar varfërinë dhe cënimin përgjatë ciklit të jetës.
<b>Dheu (toka)</b>	Shtresa e sipërme e kores së Tokës që gjendet mes bazës shkëmbore dhe sipërfaqes. <b>Dheu</b> përbëhet nga grimca minerale, material organik, ujë, ajër dhe organizma të gjallë. <sup>162</sup>
<b>Degradimi i terrenit</b>	Pakësimi i kapacitetit të dheut për të siguruar të mirat dhe shërbimet e <b>ekosistemit</b> sipas dëshirës së <b>palëve të interesuara</b> .
<b>Taposja (vulosja) e terrenit</b>	Mbulimi i dheut në një mënyrë që e bën zonën e mbuluar të papërshkueshme (p.sh., një rrugë). Kjo papërshkueshmëri mund të krijojë ndikime mjedisore sipas përcaktimeve në Rregulloren e Komisionit (BE) 2018/2026. <sup>163</sup>
<b>Ngarkesat specifike</b>	Masa e <b>ndotësve</b> të lëshuar sipas masës së produktit të prodhuar. <b>Ngarkesat specifike</b> lejojnë krahasimin e performancës mjedisore të instalimeve pavarësisht nga vëllimet e ndryshme të prodhimit dhe nuk ndikohen nga përzierja ose hollimi. <sup>164</sup>
<b>Angazhimi i palës së interesuar</b>	Një proces i vazhdueshëm ndërveprimi dhe dialogu mes njësisë ekonomike dhe <b>palëve të interesuara</b> të saj që i mundëson njësisë ekonomike të dëgjojë, të kuptojë dhe t'u përgjigjet interesave dhe shqetësimeve të tyre.
<b>Palë e interesuar</b>	Ata që mund të ndikojnë dhe mund të ndikohen nga njësi ekonomike. Ekzistojnë dy grupe kryesore të <b>palëve të interesuara</b> : i. <b>Palët e interesuara</b> të ndikuara: individë ose grupe interesat e të cilëve janë ndikuar ose mund të ndikohen –

<sup>162</sup> Neni 3, pika 21 e Direktivës 2010/75/BE mbi emetimet industriale (IED).

<sup>163</sup> Rregullorja e Komisionit (BE) 2018/2026 e 19 dhjetorit 2018 që ndryshoi Shtojcën IV të Rregullores (KE) Nr 1221/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi pjesëmarrjen vullnetare të organizatave në një komunitet me menaxhim ekologjik dhe skema e auditimit (EMAS) (GZ L 325, 20.12.2018, p. 18).

<sup>164</sup> Vendimi për Implementim i Komisionit i 10 shkurtit 2012 paraqet rregullat lidhur me udhëzimin për mbledhjen e të dhënave dhe hartimin e dokumenteve referencë BAT dhe për cilësinë së tyre, e siguruar sipas Direktivës 2010/75/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për emetimet industriale.

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
	<p>pozitivisht ose negativisht – nga aktivitetet e njësisë ekonomike ose <b>marrëdhëniet e saj të biznesit</b> të drejtpërdrejta ose të tërthorta përmes <b>zinxhirit të saj të vlerës</b>; dhe</p> <p>ii. <b>përdoruesit e deklaratave të qëndrueshmërisë: përdoruesit</b> primarë të raportimit financiar për qëllime të përgjithshme (investitorët ekzistues dhe potencialë, huadhënësit dhe kreditorët e tjerë përfshirë menaxhuesit e aktiveve, institucionet e kredisë, shoqëritë e sigurimit), si dhe <b>përdorues</b> të tjerë që përfshijnë partnerët e biznesit të njësisë ekonomike, sindikatat dhe partnerët socialë, organizatat e shoqërisë civile dhe joqeveritare, analistët dhe akademikët.</p> <p>Disa, por jo të gjitha, <b>palë të interesuara</b> mund t'i përkasin të dy grupeve.</p>
<p><b>Substancat</b></p>	<p>Elementi kimik dhe përbërësit e tij, me përjashtim të <b>substancave</b> në vijim:</p> <p>i. <b>substancat</b> radioaktive siç përcaktohen në nenin 1 të Direktivës së Këshillit 96/29/Euratom<sup>165</sup> që paraqet standardet bazë të sigurisë për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe të publikut të gjerë nga dëmet që vijnë nga rrezatimi i jonizuar;</p> <p>ii. mikroorganizmat e modifikuar gjenetikiisht siç përkufizohen në nenin 2, shkronja (b) të Direktivës 2009/41/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës<sup>166</sup> mbi përdorimin e kufizuar të mikroorganizmave të modifikuar gjenetikiisht;</p> <p>iii. mikroorganizmat e modifikuar gjenetikiisht siç përkufizohen në pikën 2 të nenit 2, të Direktivës 2001/18/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës<sup>167</sup> mbi lënien e lirë në mjedis të mikroorganizmave të modifikuar gjenetikiisht.<sup>168</sup></p>

<sup>165</sup> Direktiva e Këshillit 96/29/Euratom e 13 majit 1996 që paraqet standardet bazë të sigurisë për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe të publikut të gjerë nga rreziqet që vijnë nga rrezatimi i jonizuar (GZ L 159, 29.6.1996, p. 1).

<sup>166</sup> Direktiva 2009/41/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 6 majit 2009 mbi përdorimin e kufizuar të mikroorganizmave të modifikuar gjenetikiisht (GZ L 125, 21.5.2009, p. 75).

<sup>167</sup> Direktiva 2001/18/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 12 marsit 2001 mbi lënien e lirë në mjedis të organizmave të modifikuar gjenetikiisht dhe shfuqizimin e Direktivës të Këshillit 90/220/KE (GZ L 106, 17.4.2001, p. 1).

<sup>168</sup> Direktiva 2010/75/BE mbi emetimet industriale (IED).

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
Substancat shqetësuese	<p>Një <b>substancë</b> që:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>i. plotëson kriterin e paraqitur në nenin 57 dhe identifikohet në përputhje me nenin 59, pika (1) të Rregullores (BE) Nr 1907/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës;<sup>169</sup></li> <li>ii. klasifikohet në Pjesën 3 të Aneksit VI të Rregullores (BE) Nr 1272/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës<sup>170</sup> në një nga klasat ose kategoritë e rrezikshme në vijim: <ul style="list-style-type: none"> <li>• me aftësi për të shkaktuar kancer, kategoritë 1 dhe 2;</li> <li>• me aftësi për të shkaktuar mutacion në qelizat embrion, kategoritë 1 dhe 2;</li> <li>• riprodhim toksik, kategoritë 1 dhe 2;</li> <li>• shqetësim endokrinal të shëndetit të njeriut;</li> <li>• shqetësim endokrinal të mjedisit;</li> <li>• veti të qëndrueshme, të lëvizshme dhe toksike ose veti shumë të qëndrueshme, shumë të lëvizshme;</li> <li>• veti të qëndrueshme, biologjikisht të akumuluar dhe toksike ose veti shumë të qëndrueshme, shumë biologjikisht të akumuluar;</li> <li>• ndjeshmëri në frymëmarrje, kategoria 1;</li> <li>• ndjeshmëri në lëkurë, kategoria 1;</li> <li>• rrezik kronik të mjedisit ujor, kategoritë 1 deri në 4;</li> <li>• rrezikshmëri për shtresën e ozonit;</li> <li>• toksik për një organ specifik të synuar, ekspozim i përsëritur, kategoritë 1 dhe 2;</li> <li>• toksik për një organ specifik të synuar, ekspozim i vetëm, kategoritë 1 dhe 2; ose</li> </ul> </li> </ol>

<sup>169</sup> Rregullorja (KE) Nr 1907/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 18 dhjetorit 2006 lidhur me Regjistrimin, Vlerësimin, Miratimin dhe Kufizimin e Kimikateve (REACH), krijimin e Agjencisë Evropiane të Kimikateve, ndryshimin e Direktivës 1999/45/KE dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 793/93 të Rregullores së Komisionit (KE) Nr 1488/94 si dhe të Direktivës së Këshillit 76/769/KE dhe Direktivës së Komisionit 91/155/KE, 93/67/KE, 93/105/KE dhe 2000/21/KE (GZ L 396, 30.12.2006, p. 1)

<sup>170</sup> Rregullorja (KE) Nr 1272/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 16 dhjetorit 2008 mbi klasifikimin, emërtimin dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve, që ndryshoi dhe shfuqizoi Direktivat 67/548/KE dhe 1999/45/KE, si dhe ndryshoi Rregulloren (KE) Nr 1907/2006 (GZ L 353, 31.12.2008, p. 1).

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
	iii. ndikon negativisht ripërdorimin dhe riciklimin e materialeve në produktin në të cilin është i pranishëm, siç përcaktohet në kërkesat përkatëse të Bashkimit Evropian për projektimin ekologjik të produktit specifik.
<b>Substancat shumë shqetësuese (SVHC)</b>	<b>Substancat</b> që plotësojnë kriteret e paraqitura në nenin 57 të Rregullores (BE) Nr 1907/2006 (REACH) dhe janë identifikuar në përputhje me nenin 59, pika (1) të Rregullores.
<b>Furnizues</b>	Njësi ekonomike në rrjedhën e sipërme të organizatës (d.m.th. të <b>zinxhirit të vlerës</b> të organizatës), që e furnizon me një produkt ose shërbim që përdoret në zhvillimin e produkteve apo shërbimeve të veta të organizatës. Një <b>furnizues</b> mund të ketë një marrëdhënie biznesi të drejtpërdrejtë me organizatën (shpesh i referohen si <b>furnizues</b> i nivelit të parë) ose një marrëdhënie biznesi të tërthortë.
<b>Zinxhiri furnizues</b>	Bashkësia e aktiviteteve ose proceseve të realizuara nga njësi ekonomike në rrjedhën e sipërme të zinxhirit të vlerës së njësisë ekonomike, të cilat furnizojnë produkte ose shërbime që përdoren në zhvillimin dhe prodhimin e produkteve dhe shërbimeve të veta të njësisë ekonomike. Këtu përfshihen njësi ekonomike të rrjedhës së sipërme të zinxhirit të vlerës me të cilat njësi ekonomike ka një marrëdhënie të drejtpërdrejtë (shpesh i referohen si <b>furnizues</b> i nivelit të parë) dhe njësi ekonomike me të cilat njësi ekonomike ka një marrëdhënie biznesi të tërthortë.
<b>Ujëra sipërfaqësorë</b>	Ujëra të brendshme, me përjashtim të <b>ujërave nëntokësorë</b> ; ujërat kalimtare dhe ujërat e bregut të detit, me përjashtim të sa i takon situatës kimike për të cilën duhet të përfshijë edhe ujërat e zonës (territorit). <sup>171</sup>
<b>Çështje të qëndrueshmërisë</b>	Faktorë mjedisorë, socialë dhe të të drejtave të njeriut, si dhe të qeverisjes, që përfshijnë faktorët e qëndrueshmërisë të përkufizuar në nenin 2, pika (24), të Rregullores (BE) 2019/2088 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. <sup>172</sup>

<sup>171</sup> Direktiva 2000/60/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 tetorit 2000 që përcakton një kuadër për veprimin e Komunitetit në fushën e politikës së ujit (Direktiva e Kuadrit të Ujit).

<sup>172</sup> Rregullorja (BE) 2019/2088 mbi dhënie informacionesh shpjeguese lidhur me qëndrueshmërinë në sektorin e shërbimeve financiare.

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
<b>Deklarata e qëndrueshmërisë</b>	Pjesa e dedikuar e raportit të drejtimit të njësisë ekonomike ku paraqitet informacioni mbi <b>çështjet e qëndrueshmërisë</b> i përgatitur në përputhje me Direktivën 2013/34/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit <sup>173</sup> dhe standardet e qëndrueshmërisë (ESRS).
<b>Mundësitë e lidhura me qëndrueshmërinë</b>	Ngjarje ose kushte të pasigurta mjedisore, sociale ose të qeverisjes që, nëse ndodhin, mund të shkaktojnë efekte materiale pozitive në <b>modelin e biznesit</b> , të njësisë ekonomike ose të strategjisë së saj, si dhe në aftësinë e saj për të arritur objektivat dhe synimet dhe për të krijuar vlerë dhe për këtë arsye mund të ndikojnë vendimet e saj dhe ato të partnerëve të saj në marrëdhënie biznesi në lidhje me <b>çështje të qëndrueshmërisë</b> . Si çdo <b>mundësi tjetër, mundësitë e lidhura me qëndrueshmërinë</b> maten si një kombinim i madhësisë së ndikimit dhe probabilitetit të ndodhjes.
<b>Rreziqet e lidhura me qëndrueshmërinë</b>	Ngjarje ose kushte të pasigurta mjedisore, sociale ose të qeverisjes që, nëse ndodhin, mund të shkaktojnë efekte materiale negative në <b>modelin e biznesit</b> , të njësisë ekonomike ose të strategjisë së saj, si dhe në aftësinë e saj për të arritur <b>objektivat</b> dhe synimet dhe për të krijuar vlerë dhe për këtë arsye mund të ndikojë vendimet e saj dhe ato të partnerëve të saj në <b>marrëdhënie biznesi</b> në lidhje me <b>çështje të qëndrueshmërisë</b> . Si çdo rrezik tjetër, <b>rreziqet e lidhura me qëndrueshmërinë</b> maten si një kombinim i madhësisë së ndikimit dhe probabilitetit të ndodhjes.
<b>Ndikimet e lidhura me qëndrueshmërinë</b>	Efekti që njësi ekonomike ka ose mund të ketë mbi mjedisin dhe njerëzit, duke përfshirë efektet në të drejtat e njeriut si pasojë e aktiviteteve të njësisë ekonomike ose të <b>marrëdhënieve të biznesit</b> . <b>Ndikimet</b> mund të jenë aktuale ose potenciale, negative ose pozitive, afatshkurtra, afatmesme ose afatgjata, të qëllimshme ose të paqëllimshme, si dhe të kthyeshme ose të pakthyeshme. <b>Ndikimet</b> tregojnë kontributin negativ ose pozitiv të njësisë ekonomike në zhvillimin e qëndrueshëm.

<sup>173</sup> Direktiva 2013/34/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 26 qershorit 2013 mbi pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportet përkatëse të disa llojeve të njësive ekonomike, që ndryshoi Direktivën 2006/43/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe shfuqizoi Direktivat e Këshillit 78/660/KE dhe 83/349/KE (GZ L 182, 29.6.2013, p. 19).

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
<b>Rreziqet sistemike</b>	<b>Rreziqet</b> që vijnë nga avari të të gjithë sistemit, jo thjesht nga dështimi i pjesëve individuale. Ato karakterizohen nga pika kthese modeste që kombinohen tërthorazi për të gjeneruar dështime të mëdha me ndërveprime të njëpasnjëshme të rreziqeve fizike dhe <b>rreziqeve kalimtare</b> (infektimi), ku një humbje nxit një zinxhir tjetër humbjesh dhe me sisteme të paafta të rifitojnë ekuilibrin pas një goditjeje. Një shembull është humbja e specieve kryesore, të tilla si lundrat e detit, të cilat kanë një rol kritik në strukturën e komunitetit të <b>ekosistemit</b> . Ndërsa në vitet 1900 lundrat e detit gati u zhdukën për shkak të gjuetisë, <b>ekosistemet</b> e bregut të detit u përmbysën dhe u pakësua ndjeshëm prodhimi i biomasës.
<b>Objektivat (Synimet)</b>	Qëllime të matshme, të orientuar nga rezultati dhe të kufizuar në kohë që njësia ekonomike synon të arrijë lidhur me ndikimet, <b>rreziqet ose mundësitë materiale</b> . Ato mund të vendosen vullnetarisht nga njësia ekonomike ose të rezultojnë nga kërkesat ligjore mbi njësinë ekonomike.
<b>Kategori të kërcënuara</b>	Kategori të rrezikuara që përfshijnë florën dhe faunën, të renditura në Listën e Kuqe Evropiane ose në IUCN Red List, siç i referohen në Seksionin 7 të Shtojcës II, të Rregullores së Komisionit të Deleguar (BE) 2021/2139.
<b>Trajnimi</b>	Nisma të marra nga njësia ekonomike me qëllim mirëmbajtjen dhe / ose përmirësimin e aftësive dhe njohurive të <b>punonjësve të vet</b> të saj. Mund të përfshijë metodologji të ndryshme, si trajnimi në vendndodhje dhe trajnimi online.
<b>Plani i tranzicionit (kalimtar)</b>	Një plan specifik që zbatohet nga njësia ekonomike në lidhje me një vendim strategjik dhe që trajton: i. një objektiv të politikës publike; dhe/ose ii. një plan veprimi specifik për njësinë ekonomike, i organizuar si një bashkësi e strukturuar e objektivave (synimeve) dhe veprimeve, të lidhura me një vendim kyç strategjik, një ndryshim të rëndësishëm në modelin e biznesit dhe /ose veprime të caktuara të rëndësishme dhe shpërndarje burimesh.
<b>Plani i tranzicionit për zbutjen e ndryshimit klimatik</b>	Një aspekt i strategjisë së përgjithshme të njësisë ekonomike që paraqet <b>objektivat (synimet), veprimet</b> dhe burimet e njësisë ekonomike për tranzicionin e saj drejt një ekonomie

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
	me më pak karbon, që përfshin <b>veprime</b> si pakësimi i emetimeve <b>GHG</b> të saja në lidhje me objektivin e kufizimit të ngrohjes globale në 1.5°C dhe arritja e neutralitetit klimatik.
<b>Rreziqet e tranzicionit (kalimtare)</b>	<b>Rreziqe</b> që vijnë nga mospërputhja strategjisë dhe menaxhimit të një organizate ose një investitori dhe ndryshimit të panoramës rregullatore, politike dhe shoqërore në të cilën ajo / ai vepron. Zhvillime që synojnë të ndalin ose të kthejnë dëmet ndaj klimës ose ndaj natyrës, si masat e qeverisë, arritjet teknologjike, ndryshimet e tregut, konfliktet dhe ndryshimi i shijeve në konsum mund të krijojnë ose të ndryshojnë <b>rreziqet e tranzicionit</b> .
<b>Përdoruesit</b>	<b>Përdoruesit e deklaratave të qëndrueshmërisë:</b> përdoruesit primarë të raportimit financiar për qëllime të përgjithshme (investitorët ekzistues dhe potencialë, huadhënësit dhe kreditorët e tjerë përfshirë menaxhuesit e aktiveve, institucionet e kredisë, shoqëritë e sigurimit), si dhe <b>përdorues</b> të tjerë që përfshijnë partnerët e biznesit të njësisë ekonomike, sindikatat dhe partnerët socialë, organizatat e shoqërisë civile dhe joqeveritare, qeveritë, analistët dhe akademikët.
<b>Zinxhiri i vlerës</b>	<p>Bashkësia e aktiviteteve, burimeve dhe marrëdhënieve të lidhura me modelin e biznesit të njësisë ekonomike dhe të mjedisit të jashtëm në të cilin ajo vepron.</p> <p>Një <b>zinxhir vlere</b> përfshin aktivitete, burimet dhe marrëdhëniet që njësi ekonomike përdor dhe mbështetet për të krijuar produktet ose shërbimet e saj nga konceptimi deri në shpërndarje, në konsum dhe deri në fund të jetës. Aktivitetet, burimet dhe marrëdhëniet kryesore përfshijnë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>i. ato të lidhura me veprimtarinë e njësisë ekonomike, si burimet njerëzore;</li> <li>ii. ato përgjatë kanaleve të saj të furnizimit, marketingut dhe shpërndarjes, si furnizimi me materiale dhe shërbime, si dhe shitja dhe lëvrimi i produkteve dhe shërbimeve; dhe</li> <li>iii. mjedisi i financimit, gjeografik, gjeopolitik dhe rregullator në të cilin vepron njësi ekonomike.</li> </ol> <p><b>Zinxhiri i vlerës</b> përfshin aktorët e rrjedhës së sipërme dhe të poshtme referuar njësisë ekonomike. Aktorët e rrjedhës së</p>

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
	<p>sipërme referuar njësisë ekonomike (p.sh., <i>furnizuesit</i>) sigurojnë produkte ose shërbime që përdoren në zhvillimin e produkteve ose të shërbimeve të njësisë ekonomike. Njësitë e rrjedhës së poshtme referuar njësisë ekonomike (p.sh., shpërndarësit, klientët) marrin produkte ose shërbime nga njësia ekonomike.</p> <p>Standardet ESRS përdorin termin “<i>zinxhiri i vlerës</i>” në njëjës, megjithëse pranohet se njësia ekonomike mund të ketë disa <i>zinxhira vlere</i>.</p>
<p><b>Punonjës i zinxhirit të vlerës</b></p>	<p>Një individ që kryen punë në zinxhirin e vlerës të njësisë ekonomike, pavarësisht nga ekzistenca ose natyra e marrëdhënies të kontraktuar me njësinë ekonomike. Në standardet ESRS, punonjësit në zinxhirin e vlerës përfshijnë të gjithë punonjësit në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të zinxhirit të vlerës të njësisë ekonomike që ndikohen ose mund të ndikohen materialisht nga njësia ekonomike. Këtu përfshihen ndikimet që lidhen me veprimtarinë e njësisë ekonomike dhe zinxhirin e vlerës, si përmes produkteve ose shërbimeve të saj, ashtu dhe përmes marrëdhënieve të biznesit të saj. Kjo përfshin të gjithë punonjësit që nuk janë objekt i “Forcës së vet të punës” (“Forca e vet e punës” përfshin njerëz që janë në një marrëdhënie punësimi me njësinë ekonomike (“punonjës”) dhe jo punonjës të cilët janë individë të kontraktuar për të furnizuar me punë njësinë ekonomike (“të vetpunësuar”) ose njerëz që angazhohen nga njësia ekonomike kryesisht në aktivitete punësimi. (Kodi NACE N78)</p>
<p><b>Paga</b></p>	<p><b>Paga</b> bruto, duke përjashtuar përbërësit e ndryshueshëm si <b>jashtë orarit</b> dhe <b>pagesa</b> nxitëse, si dhe kompensimet, përveçse kur ato janë të garantuara.</p>
<p><b>Mbetje</b></p>	<p>Çdo <b>substancë</b> ose objekt që mbajtësi e hedh ose synon apo i kërkohet ta hedhë.<sup>174</sup></p>
<p><b>Hierarkia e mbetjeve</b></p>	<p>Radha në parandalimin dhe menaxhimin e mbetjeve:<sup>175</sup></p> <p>i. parandalimi;</p>

<sup>174</sup> Neni 3, pika 1 e Direktivës 2008/98/BE mbi mbetjet.

<sup>175</sup> Neni 4, pika 1 e Direktivës 2008/98/BE mbi mbetjet.

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
	ii. përgatitja për ripërdorim; iii. <b>riciklimi</b> ; iv. rikuperim tjetër (p.sh., rikuperimi i energjisë); dhe v. dalja jashtë përdorimit.
<b>Menaxhimi i mbetjeve</b>	Grumbullimi, transporti, rikuperimi dhe nxjerrja jashtë përdorimit e <b>mbetjeve</b> , që përfshin mbikëqyrjen e veprimeve të tilla dhe kujdesin pas nxjerrjes jashtë përdorimit të <b>vendndodhjes</b> , si dhe përfshin <b>veprimet</b> e ndërmarra si ndërmjetës. <sup>176</sup>
<b>Ujërat e ndotura</b>	Ujë i cili nuk ka vlerë të mëtejshme të menjëhershme për qëllimet për të cilat ishte përdorur ose në vijim të motivit për të cilin ishte prodhuar për shkak të cilësisë, sasisë ose kohës së shfaqjes së tij.  <b>Ujëra të ndotura</b> nga një përdorues mund të jenë furnizim i mundshëm për një përdorues tjetër. Uji ftohës nuk konsiderohet <b>ujë i ndotur</b> .
<b>Konsumi i ujit</b>	Sasia e ujit që hyn në kufijtë e njësisë ekonomike (ose të fabrikës) dhe nuk shkarkohet më pas në mjedisin ujor ose tek një palë e tretë përgjatë periudhës së raportimit.
<b>Shkarkimi më pas i ujit</b>	Sasia e ujit të larguar dhe derdhjeve të tjera nga kufijtë e organizatës dhe lëshimi në sipërfaqen ujore, <b>ujërat nëntokësorë</b> , ose tek palë të treta përgjatë periudhës së raportimit.
<b>Intensiteti i ujit</b>	Një metrikë që siguron marrëdhënien mes një aspekti vëllimor të ujit dhe një njësie të aktivitetit të krijuar (produktet, shitjet, etj.).
<b>Uji (i ricikluar dhe i ripërdorur)</b>	Ujë dhe ujë i ndotur (i trajtuar ose i patrajtuar) që është përdorur më shumë se një herë para se të shkarkohet nga kufijtë e njësisë ekonomike ose të impianteve të përbashkëta, në mënyrë që kërkesa për ujë të pakësohet. Kjo mund të jetë në të njëjtin proces (i ricikluar) ose në procese të ndryshme brenda të njëjtit impiant (që njësia ekonomike zotëron ose ndan me të tjerë) ose në një impiant tjetër të njësisë ekonomike (i ripërdorur).

<sup>176</sup> Neni 3, pika 9 e Direktivës 2008/98/BE mbi mbetjetet.

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
<b>Mungesa e ujit</b>	<p>Bollëku në vëllim ose mungesa e tij në burimet e <b>ujit të ëmbël</b>. Mungesa nxitet nga njeriu, është funksion i vëllimit të <b>ujit të konsumuar</b> nga njeriu në lidhje me vëllimin e burimeve ujore në një zonë të caktuar. Kështu që një zonë e thatë me shumë pak ujë, por pa <b>konsum uji</b> nga njeriu nuk do të konsiderohet e pamjaftueshme, por thjesht e thatë. <b>Mungesa e ujit</b> është një realitet i prekshëm, objektiv që mund të matet në mënyrë të vazhdueshme përmes rajoneve dhe përgjatë kohës. <b>Mungesa e ujit</b> pasqyron më tepër sasinë fizike të <b>ujit të ëmbël</b> sesa nëse uji është i përshtatshëm për përdorim. Për shembull, një rajon mund të ketë burime të bollshme ujore (dhe prandaj nuk mund të konsiderohet si pa ujë) por ai ka një <b>ndotje</b> të madhe që e bën furnizimin me atë ujë të papërshtatshëm për përdorim njerëzor ose ekologjik.</p>
<b>Tërheqja e ujit</b>	<p>Sasia e të gjithë ujit që hyn në kufijtë e njësisë ekonomike nga të gjitha burimet për çdo lloj përdorimi përgjatë periudhës së raportimit.</p>
<b>Përfaqësuesit e punonjësve</b>	<p>Përfaqësues të punonjësve do të thotë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>i. përfaqësues të sindikatave, domethënë përfaqësues të përcaktuar ose të zgjedhur nga sindikatat ose nga anëtarët e këtyre organizimeve në përputhje me legjislacionin dhe praktikën kombëtare;</li> <li>ii. përfaqësues të zgjedhur në mënyrën e duhur, domethënë përfaqësues që janë zgjedhur lirshëm nga punonjësit e organizatës, jo nën dominimin apo kontrollin e punëdhënësit, në përputhje me parashikimet ligjore, rregullatore ose marrëveshjet kolektive kombëtare, funksioni i të cilëve nuk përfshin aktivitete që janë e drejtë ekskluzive e sindikatave në vendin përkatës dhe ekzistenca e të cilëve nuk përdoret për të nënvlerësuar pozicionin e sindikatave të interesuara ose të përfaqësuesve të tyre.</li> </ol>
<b>Ekulibri punë-jetë</b>	<p>Një gjendje e kënaqshme ekuilibri mes punës së një individi dhe jetës së tij private. <b>Ekulibri punë-jetë</b> në një kuptim të gjerë përfshin jo vetëm ekuilibrin mes punë dhe jetës private në kushtet e përgjegjësive familjare ose për kujdes, por edhe</p>

Termi i përcaktuar	Përkufizimi
	shpërndarjen mes kohës së shpenzuar në punë dhe në jetën private përtej përgjegjësive familjare.
<b>Rreziqet e lidhura me punën</b>	<p>Rreziqet e lidhura me punën mund të jenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>i. fizike (p.sh., rrezatimi, temperatura ekstreme, zhurmë e lartë e vazhdueshme, derdhje në dysheme ose rreziqe rënieje, makineri pa mbikëqyrje, pajisje elektrike me defekte);</li> <li>ii. ergonomike (p.sh., vende pune dhe karrige të sistemuara keq, lëvizje të sikletshme, dridhje);</li> <li>iii. kimike (p.sh., ekspozimi ndaj substancave, kancerogjene, mutagjene, reprotoksike, holluesve, monoksidit të karbonit ose pesticideve);</li> <li>iv. biologjike (p.sh., ekspozimi ndaj gjakut dhe lëngjeve të trupit, kërpudhave, baktereve, viruseve, ose pickimit të insekteve);</li> <li>v. psikologjike (p.sh., abuzimi verbal, ngacmimi, tallja);</li> <li>vi. të lidhura me punën në organizatë (p.sh., ngarkesë pune e tepërt, punë me turne, orë të gjata, punë natën, dhunë në vendin e punës).</li> </ul>
<b>Incidente të lidhura me punën</b>	<p>Ndodhi që ndeshen në punë ose gjatë punës që sjellin ose mund të sjellin plagosje (dëmtime) ose sëmundje. Incidentet mund të jenë për shkak, për shembull, të problemeve elektrike, shpërthimit, zjarrit, përmbytjes, përmbysjes, rrjedhjes, thyerjes, djegies, ndarjes, humbjes së kontrollit, rrëshqitjes, pengimit dhe rënies, lëvizjes së trupit pa stres, lëvizjes së trupit nën / me stres, goditjes, frikës, dhunës në vendin e punës ose <b>ngacmimit</b> (p.sh., <b>ngacmimi</b> seksual). Një incident që sjell plagosje ose sëmundje shpesh referohet si “aksident”. Një incident që ka mundësi të sjellë plagosje ose sëmundje por që asnjëra nuk ndodh, shpesh referohet si “pothuajse aksident”, “humbje nga afër”, ose “goditje nga afër”.</p>

## Programi EAASURE bashkëfinancohet nga



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
**State Secretariat for Economic Affairs SECO**



Federal Ministry  
Republic of Austria  
Finance



Austrian  
Development  
Cooperation